
Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE CONSEIL
DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

Projekti kundër Krimet Ekonomik në Kosovë¹ (PKEK)

RAPORT VLERËSIMI

mbi pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare në fushën e Luftimit të Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT)

CIKLI 1

10 qershor 2013

¹ Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

PËRMBAJTJA

HYRJE - INFORMATAT DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR VLERËSIMIN E KOSOVËS	4
PËRMbledhje Ekzekutive.....	6
RAPORT I DETAJUAR I VLERËSIMIT LPP/LFT	19
1. TË PËRGJITHSHME.....	19
1.1. Informata të përgjithshme rreth Kosovës dhe ekonomisë së saj.....	19
1.2. Gjendja e përgjithshme në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	21
1.3. Pasqyrë e përgjithshme e sektorit financiar	23
1.4. Pasqyrë e përgjithshme e Sektorit të Profesioneve dhe Bizneseve të Caktuara Jofinanciare (SPBCJ).....	27
1.5. Pasqyrë e përgjithshme e ligjeve dhe mekanizmave komerciale që qeverisin marrëveshjet dhe personat juridikë.....	31
1.6. Pasqyrë e përgjithshme e strategjisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.....	33
2. SISTEMI LIGJOR DHE MASAT E NDËRLIDHURA INSTITUCIONALE	40
2.1. Ndëshkimi i pastrimit të parave (R.1).....	40
2.2. Përgjegjësia për veprën penale PP (R.2).....	57
2.3. Penalizmi i financimit të terrorizmit (RV.II)	65
2.4. Konfiskimi, ngrirja dhe sekuestrimi i të ardhurave nga krimi (R.3).....	79
2.5. Ngrirja e fondeve të përdorura për financimin e terrorizmit (RV.III)	88
2.6. Njësia e inteligjencës financiare dhe funksionet e saj	92
2.7. Zbatimi i ligjit, prokuroria dhe autoritet tjera kompetente – korniza e punës për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të PP-së dhe FT-së, si dhe për konfiskim e ngrirje (R.27 dhe 28)	100
2.8. Deklarimi ose paraqitja ndërkufitare (RV.IX).....	107
3. MASAT PARANDALUESE - INSTITUCIONET FINANCIARE	113
3.1. Rreziku nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit.....	116
3.2. Kujdesi i duhur ndaj klientit (<i>Customer Due Diligence</i>) (R.5 ^(*))	117
3.3. Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP) (R.6).....	145
3.4. Ligjet për fshehtësinë në përputhje me Rekomandimet (R.4)	152
3.5. Mbajtja e shënimeve (R.10*).....	154
3.6. Raportimi i transaksioneve të dyshimta (R.13* & RV.IV).....	161
3.7. Mbrojtja dhe moszbulimi (R.14)	169
3.8. Bankat guaskë (R.18)	177
3.9. Mbikëqyrja e vazhdueshme, monitorimi dhe hyrja në treg (R.23)	182
3.10. Mbikëqyrësit (R.29).....	203
3.11. Sanksionet (R.17)	212
3.12. Shërbimet e transferimit të parave apo vlerës (RV.VI)	222
3.13. Teknikat moderne të transaksioneve të sigurta (R.20)	229
4. PERSONAT JURIDIKË – QASJA NË INFORMATAT MBI PRONËSINË PËRFITUESE DHE KONTROLLIN (R.33)	235
4.1. Përshkrimi dhe Analiza	235

4.2.	Rekomandimet dhe Komentet	240
4.3.	Klasifikimi për Rekomandimin 33	241
5.	ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE (RV.VIII)	242
5.1.	Përshkrimi dhe Analiza	242
5.2.	Rekomandimet dhe komentet	260
5.3.	Klasifikimi për Rekomandimin e veçantë VIII.....	262
6.	BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR	264
6.1.	Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar (R.31).....	264
6.2.	Ndihma juridike ndërkombëtare (R. 36).....	267
6.3.	Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar (R. 40).....	273
7.	ÇËSHTJET E TJERA.....	277
7.1.	Burimet dhe të dhënat statistikore	277
8.	TABELAT	278
	Tabela 1: Vlerësimi i përputhshmërisë me rekomandimet e FATF.....	278
	Tabela 2: Plani i veprimit i rekomanduar për përmirësimin e sistemit LPP/LFT	289
SHTOJCAT	303	
Shtojca 1:	Lista e shkurtesave.....	303
Shtojca 2:	Hollësitë për të gjitha organet me të cilat janë organizuar takime gjatë vizitës në terren	305
Shtojca 3:	Lista e ligjeve kryesore, rregulloreve dhe materialit tjetër të pranuar	306

HYRJE - INFORMATAT DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR VLERËSIMIN E KOSOVËS

1. Ky vlerësim është përgatitur nga Projekti i Përbashkët i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PKEK), i zbatuar gjatë një periudhe prej 30 muajve, duke filluar nga 1 shkurti 2012 deri më 31 korrik 2014. Ky raport është produkt i ciklit të parë (nga dy sa janë) të vlerësimit, i cili ka zgjatur nga shtatori 2012 deri në maj 2013. Vlerësimi përfshin dy komponentë: Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT), si dhe Luftimin e Korrupsionit (LK), të cilat janë vlerësuar në kuadër të një procesi të vetëm të integruar.

2. Vlerësimi i sistemit të Kosovës në luftimin e pastrimit të parave dhe në luftimin e financimit të terrorizmit është bazuar në Rekomandimet e FATF-së të vitit 2003 dhe në Rekomandimet e veçanta mbi Financimin e Terrorizmit të vitit 2001 të Task Forcës së Veprimit Financiar – *Financial Action Task Force* (FATF)² dhe është përgatitur duke përdorur metodologjinë e LPP/LFT të vitit 2004³.

3. Ekipi vlerësues ka kryer një vlerësim të përqendruar të pajtueshmërisë së Kosovës me rekomandimet kyçe dhe thelbësore si dhe me disa rekomandime të tjera të rëndësishme të FATF-së, posaçërisht me rekomandimet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 10, 13, 14, 17, 18, 20 (KTh.20.2) 23, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 36 dhe 40, si dhe RV.II, RV.III, RV.IV, RV.VI, RV.VIII, RV.IX⁴. Për shkak të natyrës së përqendruar të vlerësimit, struktura e raportit nuk pasqyron plotësisht raportet e hartuara nga FATF apo nga organet rajonale të ngjashme me FATF-në. Për shkak të natyrës së përbashkët të detyrës së vlerësimit, e cila ka mbuluar masat LPP/LFT dhe LK, raporti do të ndërreferojë ato gjetje të komponentit kundër korrupsionit, të cilat janë të përshtatshme për LPP/LFT.

4. Për më tepër, në raport mbulohen gjithashtu një mori çështjesh të përzgjedhura në lidhje me Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 26 tetor 2005, për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (më tutje në tekst “Direktiva e tretë e BE-së”) dhe Direktiva 2006/70/EC (“Direktiva e zbatimit”), si dhe një mori elementesh të Konventës së Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (CETS 198). Vlerësimi të këtyre çështjeve i është caktuar ndonjë klasifikim.

5. Vlerësimi është bazuar në ligje, rregullore dhe materiale të tjera të siguruar nga autoritetet, si dhe në informatat e siguruar nga ekipi vlerësues gjatë vizitës së tij në Prishtinë nga 26 deri 30 nëntor 2012, dhe më pas. Gjatë vizitës në terren, ekipi i vlerësimit është takuar me zyrtarë dhe përfaqësues të ministrive dhe agjencive përkatëse, si dhe të sektorit privat në Kosovë. Lista e përfaqësuesve të organeve të takuara është paraqitur në shtojcën 2 të raportit të detajuar të vlerësimit.

6. Vlerësimi është kryer nga një ekip ekspertësh të Projektit të Përbashkët të BE/KE kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PKEK), i cili përbëhej nga: Z. Lajos Korona (vlerësues

² Ky raport nuk është i bazuar në rekomandimet e korrigjuara të FATF, të cilat janë nxjerrë në shkurt të vitit 2012.

³ Siç janë azhurnuar në shkurt të vitit 2009.

⁴ R.35 dhe RV.I, të cilët ndër të tjera përcaktojnë kërkesat për nënshkrimin dhe ratifikimin e instrumenteve përkatëse të KB-së, janë përjashtuar nga vlerësimi për shkak të moszbatueshmërisë së tyre në Kosovë, e cila për shkak të statusit të saj juridik në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të KB nuk mund të jetë palë e këtyre instrumenteve. RV.V është përjashtuar, meqë është rekomandim përmbledhës që mbulon fushat në lidhje me R.36, 37, 38, 39 dhe 40, ndërsa Kosova është vlerësuar vetëm sa i përket R.36 dhe 40.

ligjor), z. Herbert Zammit LaFerla (vlerësues financiar), z. Cedric Woodhall (vlerësues i zbatimit të ligjit), z. Edmond Dunga, këshilltar projekti i PKEK-së dhe z. Igor Nebyvaev, administrator i sekretariatit të KE-së. Ekspertët bënë shqyrtimin e kornizës institucionale, të ligjeve, rregulloreve, udhëzuesve dhe të kërkesave të tjera të LPP/LFT-së, si dhe të rregullatorëve dhe sistemeve të tjera të krijuara për pengimin e Pastrimit të Parave (PP) dhe Financimit të Terrorizmit (FT) përmes institucioneve financiare, si dhe bënë ekzaminimin e kapacitetit, zbatimit dhe efikasitetit të të gjitha këtyre sistemeve.

7. Ky raport ofron një përmbledhje të masave LPP/LFT të krijuara dhe të ndërmarra nga autoritetet lokale në Kosovë në datën e vizitës apo menjëherë pas saj. Raporti bën përshkrimin dhe analizën e këtyre masave, përcakton nivelet e pajtueshmërisë së Kosovës me rekomandimet FATF-së (shih tabelën 1), dhe ofron rekomandime se si mund të përmirësohen aspekte të caktuara të sistemit (shih tabelën 2).

8. Disa nga rekomandimet e bëra në këtë raport përmbajnë projekttekstin e propozuar ligjor për të korrigjuar mangësitë e identifikuara. Këto propozime duhet të konsiderohen si tregues dhe mund të redaktohen apo të rihartohen nga autoritetet në Kosovë në mënyrë që të lidhen me aspekte të ndryshme të strukturës legjislative në Kosovë.

9. Gjatë vizitës në vend, ekzistonte një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit LPP/LFT. Ndryshimet e propozuara janë ende subjekt i ndryshimeve dhe për këtë arsye nuk janë marrë në konsideratë në analizën, komentet dhe rekomandimet e bëra në këtë raport, ndonëse për hir të qartësisë dhe të lidhjes logjike disa referenca mund të bëhen, por këto nuk merren parasysh për qëllime të klasifikimit dhe nuk kanë për qëllim që të tregojnë ndonjë analizë teknike të propozimit për ndryshimin e ligjit.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacion i përgjithshëm

10. Përmes këtij dokumenti ofrohet një përmbledhje ekzekutive e masave të LPP/LFT-së në Kosovë deri më datën e vizitës në terren (26-30 nëntor 2012), apo menjëherë pas saj (deri me 31 janar 2013). Në dokument përshkruhen dhe analizohen këto masa, si dhe ofrohen rekomandime se si disa aspekte të sistemit LPP/LFT të Kosovës do të mund të fuqizoheshin. Përmes dokumentit po ashtu përshkruhet niveli i përputhshmërisë së Kosovës me Rekomandimet e FATF-së.

Gjetjet kryesore

- Ky është vlerësimi i parë i Kosovës karshi standardeve ndërkombëtare të LPP/LFT. Korniza ligjore e Kosovës në këtë fushë është bazuar në shkallë të madhe në akte të ndryshme ligjore të miratuara nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe vetëm gjatë disa viteve të fundit është bërë një tranzicion i dispozitave në legjislacion vendor. E njëjta vërehet edhe në lidhje me kornizën institucionale, e cila ka qenë dhe deri në një masë mbetet në kuadër të juridiksionit të Misionit të Sundimit të Ligjit në Kosovë (EULEX). Më konkretisht, tranzicioni i NjIF-së nga EULEX-i në pronësi vendore është kompletuar tek në vitin 2012. Disa juridiksione të EULEX-it mbeten me Zyrën e Prokurorit Special të Kosovës (ZPSK), e cila ka juridiksion ekskluziv në lidhje me ndjekjen penale të veprave penale të pastrimit të parave. EULEX-i po ashtu ka gjyqtarë dhe policë të specializuar; një pjesë e personelit të EULEX-it mbetet me NjIF.
- Ekziston një njohuri e vogël e përbashkët, informacion i ditur ose çfarëdo e dhënë statistikore publike mbi fenomenin e pastrimit të parave apo financimin e terrorizmit në Kosovë. Shtrirja e pastrimit të parave ndërlidhet me shtrirjen e ekonomisë së zezë joformale (drogat, prostitucionin, kontrabandën e mallrave ilegale dhe aktivitetet e tjera kriminale), duke e përjashtuar, në këtë kontekst, shmangien nga tatimet, si pjesë e ekonomisë së hirtë. Kërcënimi i financimit të terrorizmit është konfirmuar nga disa autoritete në Kosovë, të cilët i kemi takuar gjatë vizitës në terren.
- Në nivel të politikave zhvillimi më i rëndësishëm është ai i strategjisë LPP/LFT, e cila është miratuar në shtator 2012. Në shtator 2012, Qeveria e Kosovës ka miratuar katër strategji të ndërlidhura për periudhën 2012-2017: strategjinë kundër krimit të organizuar, strategjinë kundër drogave, strategjinë për luftimin e financimit të terrorizmit dhe strategjinë për mbrojtjen e kufijve.
- Në përgjithësi, sistemi kundër pastrimit të parave, si një sistem shumënivelesh në mes agjencive ka arritur ta nxjerrë një numër jashtëzakonisht të vogël të rezultateve sporadike dhe pa ndonjë rezultat. Edhe pse mund të mos jetë e saktë nëse i konsiderojmë këto rezultate të vogla si të rastit, në përgjithësi, ato më shumë e konfirmojnë se sa e mohojnë paaftësinë e përgjithshme të zinxhirit institucional LPP për të funksionuar në mënyrë të integruar me përfshirjen e të gjitha komponentëve: raportimin - inteligjencën/analizimin - hetimin - ndjekjen penale - dënimin/konfiskimin. Kjo shkaktohet nga një numër i faktorëve të ndërlidhur, përfshirë mungesën e mekanizmit të bashkëpunimit/koordinimit sistematik dhe informacioneve në tërë segmentet, si dhe mungesën e burimeve të duhura në shumicën prej tyre.
- Analiza e komponentëve të ndryshme, të ndërmarra në këtë Raport po ashtu ka prodhuar një listë gjithëpërfshirëse të faktorëve specifikë në nivel të institucioneve individuale të cilat po ashtu ndikojnë negativisht në sistemin në tërësi, ku prej më të rëndësishmëve janë:
 - Efikasiteti i dobët në anën parandaluese, i cili pengohet më tutje nga një regjim rregullativ i mangët (mangësi thelbësore në Ligjin LPP/LFT dhe në dokumentet

- e tjera) dhe nga mungesa e mbikëqyrjes së duhur dhe regjimit të zbatimit/sanksionimit. Kjo nënkupton se sistemi parandalues është në mënyrë të konsiderueshme duke dështuar në dy funksionet e tij më të rëndësishme: ndalimit të pasurisë së fituar me vepër penale për të hyrë në sistemin financiar dhe për të siguruar se autoritetet kompetente janë të informuara kur ndodhin fakte të tilla.
- Qëndrueshmëria e pamjaftueshme institucionale e NjIF-së, që reflektohet në kapacitetet e saj për ta shtrirë bashkëpunimin me autoritetet e tjera vendore, qasjen në informacione dhe përmirësimin e cilësisë së analizave;
 - Ngurrimi, mungesa e të kuptuarit dhe kapaciteti i zbatimit të ligjit/prokurorëve për të zhvilluar hetime/ndjekje penale dhe marrje/konfiskim të pasurive të fituara përmes veprës penale;
 - Mungesa e kapaciteteve në gjyqësor dhe ngurrimi për të marrë një qasje proaktive në çështjet e marrjes/konfiskimit të pasurive të fituara nga veprat penale.
- Autoritetet në Kosovë nuk e kanë zbatuar një qasje të bazuar në rreziqe në lidhje me çfarëdo komponenti të sistemit LPP/LFT.

Sistemi ligjor dhe masat përkatëse institucionale

11. Vepra penale e PP, e cila është e radhitur në mesin e veprave penale në pjesën e posaçme të Kodit Penal, por e definuar ndaras në kuadër të legjislacionit preventiv LPP/LFT, paraqet një nivel të shquar të përputhshmërisë me përkufizimin në Konventat e Vjenës dhe Palermos, në veçanti sa i përket elementeve materiale (fizike) të veprës penale. Disa dispozita, megjithatë, të cilat shkojnë përtej këtij fushëveprimi, ngrenë disa brenga (p.sh. disa prej tyre kanë karakter të tepërt, duke krijuar dyfishime me veprat e tjera penale të përshkruara në nenin e njëjtë). Njëjtë, dispozitat të cilat e definojnë “pasurinë e fituar me vepër penale” dhe termet e tjera të ngjashme janë të gjitha të dyfishuara në mënyrë të dukshme, gjë kjo që çon në teprime dhe konfuzione (p.sh. nëse pasuria e fituar nga aktiviteti kriminal në përgjithësi mund t’i nënshtrohet PP-së).

12. Legjislacioni i Kosovës aplikon parimin e universalitetit për veprat penale kryesore (“qasja me të gjitha krimet”) që përfshijnë të gjitha përveç një nga 20 kategoritë e veprave penale kryesore për PP të kërkuara nga rekomandimet e FATF-së përveç veprës penale të manipulimit të tregut. Ekipi i vlerësimit ka vërejtur një pasiguri të përgjithshme në mesin e punonjësve të fushës në lidhje me nivelin e provës për veprën penale kryesore dhe mungesën e udhëzimeve adekuate. Njëjtë, dispozita e cila definojnë mbulimin e vetëpastrimit është e paqartë dhe e formuluar në mënyrë joadekuate, që mund të paraqesë problem për punonjësit e këtij lëmi.

13. Ndashmëria e veprave penale të PP-së mund të jetë arsye pse koncepti dhe terminologjia duken aq të ndryshme nga ajo në Kodin Penal, edhe në rast të termeve të përgjithshme, siç është gama dhe shtrirja e veprave penale ndihmëse apo standardeve të dijës të aplikuara në rastet e veprave penale të PP-së, të cilat mund të shkaktojnë vështirësi në rastet konkrete dhe duhet prandaj të rishqyrtohen në mënyrë që termet dhe konceptet e njëjta të mund të përdoren në çfarëdo burimi të ligjit material penal. Efektshmëria e aplikimit të veprës penale të PP-së nuk ka mundur të vlerësohet për shkak të statistikave kundërthënëse të ofruara ekipit të vlerësimit dhe mungesës së plotë të informacioneve shtesë në lidhje me rastet që presin zgjidhje.

14. Përderisa përgjegjshmëria penale e personave juridikë ekziston në mënyrë të përgjithshme, ekipi i vlerësimit ka gjetur një numër të dispozitave kundërthënëse në ligjet përkatëse në lidhje me përgjegjësinë bazike penale të korporatave (nëse apo jo varet nga fajësia e personit fizik ose nëse një person juridik duhet po ashtu të jetë përgjegjës për veprën penale nëse personi përkatës, i cili ka kryer veprën penale, nuk është dënuar për këtë). Kjo

çështje thërret për harmonizim urgjent të legjislacionit përkatës. Për më shumë, vlerësuesit kanë gjetur se sanksionet penale (gjoba) që aplikohen për personat juridikë janë të buta në mënyrë jo të efektshme (joproporcionale dhe bindëse) për dallim nga sanksionet përkatëse që aplikohen ndaj personave fizikë.

15. Vepra penale e FT-së siç përcaktohet në Kodin Penal (ndihma e kryerjes së terrorizmit) nuk mbulon financimin e një terroristi individual për çfarëdo arsye, dhe nga një aspekt i përgjithshëm, mund të gjendet një terminologji jokonsistente dhe e tepërt që aplikohet në tërë dispozitat që kanë të bëjnë me FT të KP, gjë kjo e cila rritë rrezikun e konfuzionit. Mbulimi i “aktit të terrorizmit” siç kërkohet me Konventën e FT është i mangët, duke pas parasysh mungesën e një nocioni të kompletuar dhe “të përgjithshëm” të veprës penale të terrorizmit si subjekt i FT-së, si dhe mbulimin e kufizuar të “veprave penale në traktate” për FT, duke kërkuar një element shtesë. Përveç kësaj, dyshohet nëse dhe në çfarë mase përkufizimi i “aktit terrorist” në KP shtrihet në vepra penale të ndërlidhura me financimin e terrorizmit (p.sh. rekrutimi i terrorizmit), në veçanti nëse financimi i këtyre veprave penale mund të konsiderohet si vepër penale e FT-së.

16. Vlerësuesit kanë vërejtur se Draftligji i fundit, përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet Ligji për LPP/LFT (i miratuar pas vizitës në terren) do ta prezantojë një vepër penale të FT “të re” që do të jetë më shumë në përputhje me kërkesat e RV.II, por që nuk do të ketë ndonjë ndikim në veprën penale të “vjetër” të FT në Kodin Penal. Ekipi i vlerësimit ka bregua serioze se vepra e “re” penale e FT do të jetë një “trup i huaj” në kuadër të Ligjit LPP/LFT dhe, për më tepër, se dyfishimi i penalizimit përfundimisht do të çojë në paqartësi juridike dhe probleme serioze në aplikimin efektiv të dispozitave përkatëse.

17. Korniza e sekuestrimit dhe konfiskimit në Kosovë është e rregulluar në mënyrë parësore me Kodin Penal (KP) dhe Kodin e Procedurës Penale (KPC) dhe është në përgjithësi adekuate në lidhje me dizajnin dhe fushëveprimin legjislativ, megjithatë ka një numër të paqartësive. Kodi Penal i Kosovës (KPP) Neni 96⁵ parasheh konfiskimin e “përfitimeve materiale të fituara përmes kryerjes së veprës penale”. Kjo mbulon të gjitha krimet të cilat gjenerojnë pasuri kriminale, përfshirë PP, FT, dhe veprat e tjera penale kryesore. Neni 69 i KP parasheh konfiskim të përgjithshëm të objekteve (instrumentaliteteve) të përdorura në kryerjen e veprës penale. Korniza ligjore, megjithatë, nuk përfshinë ndonjë standard të provës apo procedura për konfiskimin përfundimtar të *instrumentaliteteve të synuara për përdorim* në kryerje të një vepre, gjë e cila ngritë dyshime në lidhje me mundësinë e konfiskimit të tyre përfundimtar. Përderisa KP lejon që një pronë apo një vlerë “ekuivalente” (ose korresponduese) të konfiskohet, kjo nuk ka ndodhur kurrë në praktikë. Edhe përfitimet direkte edhe indirekte mund të konfiskohen. Ekziston një dispozitë konfliktuozë në mes të KPP dhe KP në lidhje me konfiskimin nga palët e treta, ku KPP parasheh një standard më të lartë të provës, që mund të ndikojë në fund të fundit në efektshmërinë e zbatimit të ligjit pasi që dhe kur ata të ndërmarrin masa të konfiskimit. Përveç kësaj, ekziston një jo konsistencë e formulimeve në lidhje me përkufizimin e masave të përkohshme, siç është sekuestrimi apo marrja dhe konfuzioni i tyre me disa dispozita që kanë të bëjnë me konfiskimin. Dispozitat parashohin që prona të konfiskohet *ex parte* dhe pa paralajmërim, megjithatë nuk është demonstruar që kjo të ketë ndodhur në praktikë. Edhe pse disa autoritete të zbatimit të ligjit duket se kanë mjetet e duhura për të ndërmarrë gjurmimin e aseteve, në praktikë është bërë shumë pak në këtë aspekt. Përderisa hapat që duhet ndërmarrë nga palët e treta në mirëbesim duket të jenë të qarta dhe transparente në legjislacion, barra e provës është ndoshta në mënyrë të paarsyeshme kaluar tek personi në mirëbesim, duke e bërë të pamundur shumë shpesh për atë të provojë të drejtat e tij legjitime dhe synimet në lidhje me pronën. Nuk ka autoritet në ndërmarrjen e hapave për të parandaluar apo anuluar veprime, kontraktuale apo të tjera, kur

⁵ Neni 96 i Ligjit nr. 04-L-082.

personat e përfshirë kanë ditur apo është dashur të dinë që si rezultat i këtyre veprimeve autoritetet do të paragjykoreshin në aftësinë e tyre për ta kthyer pronën e konfiskuar.

18. Nuk ka kornizë specifike ligjore që do t'ua mundësonte autoriteteve të Kosovës të ndër marrin masa të duhura parandaluese dhe ndëshkuese për ngrirjen dhe, nëse duhet, për marrjen pa vonesë të fondeve që kanë të bëjnë me terrorizëm apo asetëve të tjera në pajtim me rezolutat e Kombeve të Bashkuara. Nga një këndvështrim më i përgjithshëm, Kosova nuk i përmbush asnjë prej Kritereve thelbësore të RV.III, dhe ekipi i vlerësimit fuqimisht u rekomandon autoriteteve të Kosovës të miratojnë një pako të rregullave gjithëpërfshirëse (gjyqësore ose administrative), të cilat do të mundësonin zbatimin adekuat të sanksioneve të synuara financiare, të përfshira në Rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e veprave të financimit të terrorizmit dhe ngrirjes së asetëve terroriste, duke i adresuar të gjitha kërkesat sipas RV.III të FATF-së.

19. Njësia e inteligjencës financiare është themeluar në fund të vitit 2010. NjIF ka trashëguar ndërtesën dhe strukturën e paraardhësit- Qendrës së Inteligjencës Financiare (QIF), një organ i themeluar nga UNMIK-u dhe më pas i qeverisur nga EULEX-i për të kryer funksionet e një NjIF-së. Kjo Njësi funksionon si një qendër për pranimin e RTD-ve, analizimin e tyre dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit. NjIF ka lëshuar udhëzime për entitetet raportuese përmes "Direktivave administrative", të cilat parashohin mënyrën e raportimit, veçoritë e fushave të rrezikuara, për të cilat raportuesit duhet të kenë parasysh. Entitetet raportuese duhet të ofrojnë RTD dhe raporte të tjera në mënyrë elektronike përmes sistemit të zhvilluar nga KB-ja goAML, që përdoret si sistem kryesor nga NjIF-ja. Duket të jenë disa të meta të veçanta në lidhje me këtë, që rezultojnë në një barrë më të madhe të resurseve për sektorin privat. Fushëveprimi dhe mënyra e qasjes së NjIF-së në baza të ndryshme të të dhënave nuk është shumë e kënaqshme, gjë që ndikon negativisht në funksionimin analitik të Njesisë. Procedura për të kërkuar informacione shtesë nga entitetet raportuese siç përshkruhet në Ligjin për LPP/LFT përmban paqartësi thelbësore dhe është e hapur ndaj sfidave ligjore nga entitetet raportuese, edhe pse NjIF ka shpjeguar se nuk kanë ndodhur probleme të tilla në praktikë. NjIF shpërndan materiale Policisë ose Prokurorisë Speciale (PSRK), megjithatë gama dhe kualiteti i informacioneve të marra mbi progresin dhe rezultatin e këtyre shpërndarjeve është shumë e ulët dhe josistematike. NjIF është operacionalisht e pavarur; në kuptim të mbikëqyrjes së përgjithshme, ajo i raporton Bordit menaxhues, të përbërë nga kryesuesit e agjencive kyçe të përfshira në sistemin KPP në Kosovë. Zyrat e NjIF-së janë fizikisht të sigurta. Asnjë raport publik mbi aktivitetin e NjIF-së nuk është lëshuar deri sot. NjIF ka bërë përpjekje për të aplikuar për anëtarësim në grupin Egmont, por njëkohësisht ka deklaruar se nuk ka aplikuar Parimet Egmont për shkëmbim informacionesh në aktivitetet e saj. Për fat të keq, ekipi i vlerësimit nuk ka pas informacione të mjaftueshme për ta gjykuar në mënyrë gjithëpërfshirëse efektshmërinë e NjIF-së. Mungesa e statistikave të kuptimita që demonstrojnë rezultatet e shpërndarjeve të NjIF-së tek zbatuesit e ligjit është mangësia kryesore, që rezultojnë nga mungesa e informacionit ndërmjet agjencive dhe duhet të përmirësohet nga autoritetet e Kosovës në një kohë sa më të shkurtër të mundshme përmes një përpjekje kolektive në mes të agjencive. Në të njëjtën kohë, NjIF ka ofruar së paku një shembull kur informacioni i tij është përdorur në një hetim të suksesshëm të PP-së. Ekipit të vlerësimit i janë ofruar po ashtu edhe dosje të pastruara të synuara për shpërndarje tek autoritetet e zbatimit të ligjit. Këto materiale demonstrojnë aftësinë e plotë të analistëve në NjIF që të kryejnë analiza deri në pikën ku është e mundur të dëshmohet një vepër e mundshme penale kryesore nga të dhënat e disponueshme.

20. Të gjitha agjencitë kosovare të zbatimit të ligjit kanë përgjegjësi për të siguruar se veprat penale të pastrimit të parave të hetohen, megjithatë ekziston një njësi e specializuar në kuadër të Policisë së Kosovës-Njësiti i hetimeve financiare dhe kundër pastrimit të parave në kuadër të Drejtoratit kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit. Ndjekjet penale kundër pastrimit të parave janë kompetencë e rezervuar për Zyrën e Prokurorit Special (ZPS).

Hetimet e pastrimit të parave udhëhiqen nga prokurori, ku autoritetet për zbatimin e ligjit veprojnë si “dorë e djathtë” e prokurorëve. Autoriteti i zbatimi të ligjit duhet ta njoftojë prokurorin për çfarëdo informacioni të zbuluar gjatë hetimit të PP-së. Neni 87 i Kodit të procedurës penale përshkruan një gamë teknikash që duhet të zbatohen nga autoritetet për zbatimin e ligjit. Këto përfshijnë në mes tjerash përgjimin e komunikimeve, operacionet e fshehta, agjentët bashkëpunues, shpërndarjen e kontrolluar të postës dhe zbulimin e të dhënave financiare. Nuk ka statistika mbi shkallët kur teknikat speciale hetimore janë aplikuar në rastet e hetimit të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë nuk kanë në dispozicion të plotë masën e shtyrjes së një arresti kur, për shembull, kërkohet një grumbullim i mëtutjeshëm i dëshmitë. Neni 119 i Kodit të ri të PP-së i jep prokurorit të drejtë të marrë të gjitha dëshmitë e dokumentuara, përfshirë të dhënat financiare. Në nenin 121 të KPP-së renditet një gamë e dëshmitë joekskluzive, të cilat mund të merren nga prokurori në fazën e dëshmisë paraprake. Dispozita duket se e përfshinë gamën e plotë të llojeve të dokumenteve të kërkuara sipas Rekomandimit 28 të FATF-së. Nenet 70-73 të Kodit të ri të PP-së i japin agjencive të zbatimit të ligjit kompetenca për të grumbulluar informacione për hetimin e krimit në fazën fillestare të hetimit. Kjo përfshinë intervistimin e dëshmitarëve dhe marrjen e dëshmitë. Masat e tjera të mbuluara dhe të fshehta të përgjimit dhe hetimit po ashtu mund të ndërmerren (nenet 86-96 të KPP-së) nga policia me autorizim të gjyqtarit të procedurës paraprake apo si në raste ekskluzive të PP- me autorizim të një prokurori, nëse rrethanat kërkojnë një urgjencë. Dëshmitë dhe materialet e grumbulluara me përdorimin e masave të tilla, përfshirë të dhënat financiare, janë të pranueshme nëse merren në pajtim me procedurën penale. Ekziston një numër i konsiderueshëm i çështjeve lidhur me kapacitetin dhe numrin e stafit brenda policisë, si dhe me rastet e ndërhyrjeve politike.

21. Statistikat dhe të dhënat e mbajtura nga Policia dhe Prokuroria nuk përputhen, as në aspektin e kriterëve as në numrat përfundimtarë. Statistikat e dhëna nga prokurori tregojnë rritje graduale të lëndëve për veprat penale të PP dhe rritjen e numrit të rasteve të pazgjidhura - po thuaj 100 në vitin 2012. Pasi që krimet e pastrimit të parave i takojnë kompetencës ekskluzive të PSRK-së, i cili merret me një numër të madh të veprave të tjera penale me vetën 10-15 prokurorë në dispozicion, është e qartë se duhet të shqyrtohet një ndryshim në qasje. Po ashtu, mungesa e kapacitetit të PSRK-së për tu marrë me numrin në rritje të rasteve të PP mund të jetë dekurajuese për autoritetet e zbatimit të ligjit, të cilat do të hezitonin në kërkimin e pasurive të fituara nga krimi edhe kur kemi të bëjmë me ndonjë vepër të dukshme penale kryesore që gjeneron pasuri. Në vitin 2012, barra në rritje e lëndëve të prokurorëve ka përkuar me një zbritje të dukshme në numrin e rasteve të PP-së të raportuara tek ta nga Policia (sipas statistikave të KPK). Nëse i marrim statistikave të policisë për rastet e hetuara të PP-së, shihet një zbritje e njëjtë e mprehtë në hetime, por kjo paraqitet në vitin 2011. Duke e lënë anash çështjen e statistikave kundërtënëse, mund megjithatë të thuhet se ka rënie në aktivitetin policor për të hetuar dhe referuar raste të PP në prokurori gjatë viteve të fundit. Është e paqartë cili është shkaku për këtë, por është indikator i qartë i rënies së efektshmërisë. Kjo po ashtu konfirmohet nga fakti se nuk ka shkallë në ngritje të dënimeve (që do të kishte treguar një rritje të cilësisë, duke shkuar në dëm të sasisë).

22. Shërbimi Doganor i Kosovës kanë zbatuar një kontroll ndërkuftar të valutës dhe instrumenteve të negociueshme, ku parashihet që çdo person që hyn apo del nga Kosova dhe mbanë instrumente monetare prej një vlere prej dhjetë mijë euro (10,000) apo më shumë duhet ta deklarojë shumën e instrumenteve monetare dhe burimin e instrumenteve të tilla monetare me shkrim. Një deklaram konsiderohet i rrejshëm nëse përmban të dhëna jo të sakta ose jo të plota. Nëse ndodh kjo, Doganat kanë kompetencë për të marrë dhe mbajtur instrumentet monetare të deklaruara rrejshëm ose të padeklaruara. Autoritetet kosovare kanë po ashtu kompetenca të marrin në pyetje dhe të kërkojnë personat fizikë dhe bagazhet e tyre. Kompetencat për të mbajtur valutat dhe për të kërkuar dhe marrë në pyetje personat fizikë dhe bagazhet e tyre aplikohen në mënyrë të njëjtë kur ka dyshim të arsyeshëm se instrumentet monetare janë përfitime nga krimi apo janë përdor ose synohen të përdoren për të kryer ose ndihmuar pastrimin e parave apo veprën penale kryesore prej nga ka rrjedhur pasuria

kriminale pse kanë të bëjnë me financimin e terrorizmit. Autoritetet doganore nuk i kanë treguar ekipit të vlerësimit se si i mbajnë informacionet e grumbulluara lidhur me dyshimet për deklarimet, deklarimet e rrejshme apo për rastet e PP/FT-së. Përderisa një informacion i tillë është raportuar për NjIF, regjimi i mbajtjes së të dhënave brenda Doganës mbetet i paqartë. Doganat e Kosovës ia përcjellin kopjen e të gjitha deklarimeve NjIF-së. Kjo bëhet njëherë në muaj përmes përcuesit elektronik, që është i shkarkuar në bazën e të dhënave të NjIF-së. Doganat po ashtu ia raportojnë NjIF-së të gjitha incidentet e dyshimta të PP/FT-së në formë të një RTD-je. Doganat e Kosovës kanë bashkëpunuar në mënyrë të suksesshme me PK, NjIF, agjencitë për menaxhimin e integruar të kufijve dhe me EULEX-in. Veprime të përbashkëta operacionale mbahen për të gjitha parregullsitë ndërkufitare dhe të gjitha llojet e krimeve të cilat përfshijnë korrierët e parave të gatshme. Këto veprimet kanë çuar në rezultate specifike. Doganat e Kosovës kanë kompetenca të hetojnë veprat penale nga fushat e doganave, dhe duhet të shihen si me kompetenca dhe përgjegjësi të policisë ose policisë gjyqësore për këto hetime. Doganat e Kosovës mund të aplikojnë sanksione të tilla për personat të cilët bëjnë deklarime të rrejshme ose zbulime. Këto sanksione fillojnë prej referimit për hetime apo ndjekje penale të veprave penale, konfiskimi i tërë shumës së valutës e shkojnë deri tek gjoha administrative në shumë deri në 25% të vlerës. Duhet të theksohet se ekziston mungesë e punonjësve në Dogana, gjë e cila ndikon negativisht në efektshmërinë e saj.

Masat parandaluese - institucionet financiare

23. Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë është i bazuar kryesisht në Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (Ligji Nr. 03/L-196 të vitit 2009)⁶. Ligji kryesor është i plotësuar me Rregullin X dhe Letrën këshilluese 2007-1 të majit 2007, të dyja të lëshuara nga BQK. Letra këshilluese që ofron udhëzim për institucionet dhe organizatat përkatëse, dhe Rregulla X lëshohen mbi bazën e Rregullores së UNMIK-ut 1999/21 për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave dhe bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 për zbulimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të ngjashme. Të dy rregulloret e UNMIK-ut janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit LPP/LFT dhe Ligjit për bankat. Prandaj, ekipi i vlerësimit e vë në pikëpyetje vlefshmërinë e këtyre dy dokumenteve në kontekst të Ligjit LPP/LFT. Ekipi i vlerësimit megjithatë e pranon se Rregulli X është i harmonizuar më shumë me standardet ndërkombëtare se sa vet Ligji dhe kështu e konsideron si të duhur që bankat dhe institucionet financiare të vazhdojnë t'i përcjellin kushtet e parapara në të. Pavarësisht nga kjo, kriteret më thelbësore për Rekomandimet kyçe - në veçanti Rekomandimin 5 - që duhet të parashihen sipas ligjit ose rregullores janë megjithatë të pranishme në Rregullin X, i cili nuk e përmbush definicionin e Rregullores për qëllimet e këtij vlerësimi.

24. Ligji LPP/LFT është më tutje i plotësuar përmes direktivave administrative dhe udhëzimeve administrative të lëshuara nga QIF. Me përjashtim të Direktivës administrative 014 të dhjetorit 2011 dhe Udhëzimit administrativ FICAD 49/2011, të lëshuar mbi bazën e Ligjit LPP/LFT, të gjitha direktivat dhe udhëzimet administrative janë lëshuar mbi bazën e Rregullores së shfuqizuar të UNMIK-ut 2004/2. Ekipi i vlerësimit e vë në pikëpyetje vlefshmërinë ligjore të këtyre Direktivave pasi që me shfuqizimin dhe zëvendësimin e Rregullores së UNMIK-it 2004/2, Ligji LPP/LFT nuk parasheh vazhdimin e asnjë prej këtyre rregullave dhe direktivave.

25. Edhe pse fushëveprimi i mbulimit për sektorin financiar sipas Ligjit LPP/LFT përmbush fushëveprimin sipas standardeve të FATF-së, ekipi i vlerësimit konstaton se termi

⁶ Ligji Nr. 03/L-196 i vitit 2009 është ndryshuar pas vizitës në terren, por jo brenda periudhës së lejuar për t' marrë parasysh në këtë raport. Aty ku është e duhur, raporti bën referenca përmes fusnotave për këto ndryshime.

“institucion financiar”, siç definohet në ligjet përkatëse financiare, nuk është harmonizuar dhe prandaj mund të krijojë një element të paqartësisë.

26. Kosova nuk ka ndërmarrë një vlerësim të rrezikut në nivel kombëtar të dobësive dhe rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. BQK nuk ka ndërmarrë një vlerësim të rrezikut të dobësive brenda sektorit financiar, përderisa nuk kërkon nga bankat dhe institucionet financiare që ta ndërmarrin një vlerësim të rreziqeve të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të tyre për të identifikuar dobësitë e tyre individuale. Rrjedhimisht, Kosova nuk e ka përfshirë asnjë aktivitet financiar nga obligimet sipas Ligjit LPP/LFT.

27. Masat e KDK sipas Ligjit LPP/LFT kanë mangësi të ndryshme, prej të cilave më kryesorja është mungesa e një obligimi ligjor për të aplikuar masa të plota KDK-së për dallim nga proceset e identifikimit dhe verifikimit, dhe mungesa e qartësisë ligjore mbi pronarët përfitues. Përderisa Ligji LPP/LFT e definon se çka përbënë masë të KDK-së në pajtim me standardet ndërkombëtare, ai çalon në aplikimin e tyre. Kjo mangësi ka ndikim negativ në shumicën e kriterëve themelore për Rekomandimin 5. Në këtë aspekt, institucionet financiare e përcjellin Rregullën X të BQK-së, e cila është më shumë e harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

28. Koncepti i pronarit përfitues nuk është i qartë në Ligjin LPP/LFT dhe kështu nuk ka obligime të qarta për institucionet dhe organizatat përkatëse për ta përcjellë këtë koncept. Përsëri, Rregulla X është më e qartë mbi këtë çështje edhe pse këto institucione dhe organizata përkatëse kanë shprehur brenga për implementimin e konceptit, këto kanë më shumë të bëjnë me mungesën e një pragu në definicion.

29. Ligji LPP/LFT në mënyrë specifike e ndalon hapjen apo mbajtjen e llogarive anonime dhe kërkon identifikim të konsumatorit *para hapjes së llogarisë*. Ligji megjithatë është i heshtur mbi hapjen dhe mbajtjen e llogarive në emra fiktivë, edhe pse BQK ka konfirmuar se llogari të tilla nuk ekzistojnë.

30. Ligji LPP/LFT parasheh që subjektet raportuese të aplikojnë kujdes të shtuar të duhur ndaj konsumatorëve në prezencë të një rreziku më të madh të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Në Ligj parashihet ky obligim në situata specifike, me ç'rast ceket edhe masa e shtuar që duhet të aplikohet. Ligji LPP/LFT megjithatë nuk e specifikon llojin e masës së shtuar që duhet të aplikohet në situata dhe marrëdhënie të tjera të cilat paraqesin rrezik më të madh. Mungesa e udhëzimit dhe paqartësia mbi aplikimin e një qasjeje të bazuar në ligj janë brenga të shprehura nga sektori dhe kështu duket qartë se kjo ka ndikim negativ në efektshmërinë e sistemit.

31. Edhe pse nocioni i rrezikut të madh për konsumator të identifikuar si PEP është adresuar në Ligjin LPP/LFT, të meta të ndryshme janë identifikuar në lidhje me definicionin; mungesën e obligimit për të aplikuar masën e kujdesit të shtuar në të gjitha instancat; mungesën e identifikimit të statusit të PEP për pronarët përfitues në obligimin për të pas një sistem të menaxhimit të rrezikut; dhe mungesën e obligimit për aprovimin e menaxhmentit të lartë kur një konsumator ekzistues identifikohet si PEP. Industria ka treguar se ka nevojë për udhëzim mbi aplikimin e obligimeve të PEP në rastet e PEP-ve vendor.

32. Edhe pse në parim dispozitat e Ligjit LPP/LFT reflektojnë kriteret kryesore për mbajtje të të dhënave sipas Rekomandimit 10 ekzistojnë dobësi serioze, të cilat nëse nuk adresohen, mund të zhvillohen në brenga mbi zbatimin efektiv të Ligjit. Këto përfshijnë mes tjerash paqartësitë në Ligjin LPP/LFT mbi fillimin e periudhës së mbajtjes së të dhënave të identifikimit dhe mungesën e udhëzimeve.

33. Obligimi raportues është thelbësisht i lidhur me definicionin e *aktit apo transaksionit të dyshimtë*. Rrjedhimisht, obligimi raportues nuk përfshinë instancat kur informata që ekziston tregon lidhje me pastrim të parave apo financim të terrorizmit dhe nuk i mbulon transaksionet e tentuara. Edhe më serioze, obligimi nuk përfshinë transaksionet apo veprat që mund të jenë të lidhura me financimin e terrorizmit. Numri i vogël i RTD (Raporteve të Transaksioneve të Dyshimta), të cilat i dorëzohen NjIF-së në krahasim me numrin e RTD ngrisin pyetje nëse transaksioni i raportuar sipas regjimit RTC (Raportimi i Transaksionit Cash apo me para të gatshme) raportohet po ashtu edhe sipas regjimit RTD nëse është i dyshimtë.

34. Dispozitat e fshehjes dhe zbulimit (nxjerrjes së informacionit të raportuar) në Ligjin LPP/LFT në kontekstin e Rekomandimit 14 të FATF janë joadekuate dhe nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Në shumicën e rasteve dispozitat e fshehjes nuk përfshijnë qartazi drejtorët, zyrtarët apo punëtorët (të përkohshëm ose të përgjithshëm), përderisa ndalimi i zbulimit nuk aplikohet për bankat dhe institucionet financiare si organe korporative.

35. Procedurat e licencimit të aplikuara nga BQK-ja për licencimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare mbulojnë ndalimin për themelimin e bankave guaskë. Ekziston megjithatë mungesa e qartësisë ligjore në Ligjin LPP/LFT në bërjen e dallimit në mes të institucioneve korrespondente dhe jokorrespondente në mungesë së definicionit të marrëdhënies së bankës korresponduese.

36. BQK ka mandat sipas Ligjit për BQK-në dhe Ligjit për bankat për të licencuar, rregulluar dhe mbikëqyrur bankat dhe institucionet e tjera financiare. BQK e përmbush këtë përgjegjësi përmes vizitave në terren dhe ekzaminimeve jashtë terrenit përmes Departamentit të saj për mbikëqyrje bankare. Ligji për bankat parasheh licencimin e bankave dhe institucioneve financiare. BQK zhvillon procedura të rrepta të kujdesit të shtuar, të cilat përfshijnë testet e përshtatura dhe të duhura për aksionarët, drejtorët dhe menaxhmentin e lartë. Departamenti përfshin një Divizion që është përgjegjës për të siguruar pajtueshmëri me Ligjin LPP/LFT dhe rregulloret. Divizioni megjithatë ka mungesë të burimeve për një funksion të plotë mbikëqyrës LPP/LFT.

37. Ligji LPP/LFT megjithatë nuk e cakton BQK-në si autoritet mbikëqyrës për qëllime të Ligjit. Rrjedhimisht, nga kjo del se funksioni mbikëqyrës i LPP/LFT merret nga BQK-ja si pjese e mandatit të saj mbikëqyrës sipas Ligjit për BQK-në dhe Ligjit për bankat. Duke e kuptuar punën mbikëqyrëse të ndërmarrë nga BQK-ja në këtë drejtim, rekomandohet se një mandat i duhur ligjor për BQK-në apo çfarëdo autoriteti tjetër për monitorimin e sektorit financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT, të plotësuar me mandat ligjor për të lëshuar rregulla, rregullore dhe udhëzime duhet të parashihet në Ligjin LPP/LFT.

38. Mungesa e mandatit ligjor mbikëqyrës bartë me vete mungesën e një mandati ligjor për BQK-në për të aplikuar kompetencat e veta mbikëqyrëse sipas ligjit të BQK-së dhe Ligjit për bankat, për qëllime të Ligjit LPP/LFT. Rrjedhimisht, një mandat mbikëqyrës ligjor për BQK-në apo çfarëdo autoriteti tjetër që veç ka mandat mbikëqyrës sipas ligjeve të tjera duhet të shoqërohet me një mandat për të aplikuar kompetenca të tilla mbikëqyrëse për qëllime të Ligjit LPP/LFT. Për më tepër, edhe pse në përgjithësi NjIF ka kompetenca mbikëqyrëse sipas Ligjit LPP/LFT për të gjitha subjektet raportuese, prapë se prapë ende nuk ka kompetenca për të ndërmarrë ekzaminime jashtë terrenit dhe për të kërkuar dokumente për qëllime të tilla.

39. Ligji LPP/LFT parasheh vepra penale brenda juridiksionit të gjykatave të qarkut (tani janë ndryshuar) dhe për sanksione që aplikohen nga NjIF për palët e treta, të cilat nuk japin informacione të kërkuara nga NjIF. Prandaj nuk ekziston regjim i sanksionimit dhe rrjedhimisht nuk ka autoritet të caktuar për të aplikuar sanksione. Edhe pse BQK aplikon kompetenca mbikëqyrëse sipas Ligjit për bankat, sanksionet e plotësuara sipas Ligjit për

bankat nuk janë të aplikueshme për shkeljet e Ligjit LPP/LFT. Në të vërtetë, asnjë sanksion nuk është shqiptuar ndonjëherë, as nga NjIF-ja e as nga BQK-ja.

40. Ofruesit e shërbimeve të Transfereve të Parave ose Vlerave (TPV) i nënshtrohen obligimeve të parapara në Ligjin LPP/LFT, ku parashihen obligime shtesë për ta sipas RV VII. Ligji për bankat nuk është i qartë mbi emërimin e agjentëve nga institucionet financiare dhe për këtë arsye nuk ka obligime për ofruesit e shërbimeve TPV të mbajnë listë të agjentëve. Për më tepër, mungesa e harmonizimit mbi përkufizimin e një “institucioni financiar” ngritë pyetje në lidhje me regjimin e licencimit.

41. Kosova ka një ekonomi të bazuar në para të gatshme. Ligji për Administratën Tatimore parasheh që *çdo transaksion që kalon pesëqind euro (500), i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, pas 1 janarit 2009 duhet të bëhet përmes llogarisë bankare*. BQK është në proces të prezantimit të mjeteve elektronike të pagesave dhe sistemeve të tjera të pagesës për ta zvogëluar përdorimin e parave të gatshme. Statistikat e ofruara nga BQK tregojnë divergjenca të mëdha në para të gatshme të lëshuara në qarkullim dhe para të gatshme të tërhequra nga qarkullimi, të cilat tregojnë importim të mundshëm ilegal të parave të gatshme të vendosura në sistemin bankar. Kjo ngritë brenga mbi kontrollimet e Doganave në kufi dhe implementimin efektiv të dispozitave sipas Ligjit për Administratën Tatimore.

Personat juridikë - Qasja në pronësinë përfituese dhe kontrolli i informacionit

42. Kosova aplikon një sistem të regjistrimit përmes sistemit të regjistrimit të bizneseve të qeverisur sipas Ligjit për shoqëritë tregtare (Ligji nr. 02/L-123) të shtatorit 2007, të ndryshuar në vitin 2011. Llojet e ndryshme të organizatave afariste tregtare mund të regjistrohen në Kosovë. Aktualisht, Regjistri i bizneseve përmban gjithsej 122.249 kompani. ARBK brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, është autoritet përgjegjës për implementimin e Ligjit dhe mbajtjen e regjistrimit. Në praktikë, ARBK synon të ofrojë një ‘one stop shop’ për regjistrimin e bizneseve. Për këtë qëllim, Agjencia operon përmes 28 qendrave komunale. Të gjitha format e regjistrimit janë të disponueshme online (në internet) dhe regjistrimi mund të bëhet online.

43. Sistemi i regjistrimit për organizatat e biznesit duket adekuat edhe pse disa mangësi mund të identifikohen kryesisht në lidhje me mbajtjen, azhurnimin dhe disponueshmërinë në kohë të informacionit dhe informacionit në lidhje me pronësinë përfituese.

44. Në rast të shoqërive aksionare dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuara, edhe pse Ligji kërkon që çfarëdo ndryshimi në çfarëdo informacioni të përmbajtur në aktin e regjistrimit të shoqërisë aksionare ose shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara t’i raportohet ARBK-së, dhe pavarësisht nga obligimi i shoqërisë aksionare për ta mbajtur listën e aksionarëve, nuk ka obligim direkt për ta informuar menjëherë ARBK-në për ndryshime në aksionar. ARBK ka informuar se në mënyrë që të merret një informacion i tillë më herët se raporti vjetor, Agjencia insiston që shoqëritë tregtare ta caktojnë personin me përgjegjësi për ta informuar Agjencinë menjëherë pas ndryshimit.

45. Saktësia e informacionit të disponueshëm është po ashtu diskutabile për shkak të dispozitave në Ligj që regjistrimi i një dokumenti nuk paraqet asnjë lloj të përcaktimit ligjor apo prezumimit mbi vlefshmërinë e tij ose që çfarëdo informacioni që e përmban ai është i saktë apo i pasaktë. Pra, ekziston mungesë e kujdesit të shtuar së paku për themeluesit e një shoqërie tregtare.

46. Sistemi nuk ofron procedura për ARBK apo çfarëdo personi ose autoriteti për ta identifikuar nëse një numër i shoqërive tregtare i takojnë individit të njëjtë - përveç ATK-së

përmes numrit të regjistrimit tatimor. Për më tepër, sistemi nuk e identifikon ndërlidhjen në mes të shoqërive tregtare përmes niveleve të pronësisë, disa kompani mund ta kenë në pronësi njëra tjetrën.

47. Ligji për shoqëritë tregtare parasheh që të gjitha të dhënat, dokumentet, parashtrimet, formularët, rregullat dhe materialet e tjera të kërkuara sipas Ligjit t'i dorëzohen ARBK-së apo të përgatiten nga ARBK në lidhje me operimet a procedurat e tij ose të çfarëdo shoqërie tregtare, janë pa përjashtim, dokumente publike, dhe ARBK duhet ti ketë të gatshme dhe në mënyrë rutinore t'ia bëjë të disponueshme secilit person, sipas kërkesës së personit të tillë, për rishikim apo kopjim. Në lidhje me këtë, Agjencia duhet t'i shënojë çfarëdo kopje të kërkuar nga çdo person si "kopje të vërteta".

48. Ligji më tutje kërkon që çdo kompani që është regjistruar, ARBK të publikojë në një faqe të internetit të hapur për publikun detajet relevante dhe informacionet përfshirë emrat e themeluesve, drejtorëve dhe personave të tjerë të autorizuar dhe çfarëdo ndryshimi në to, brenda një muaji nga data e regjistrimit të shoqërisë së tillë, apo çfarëdo ndryshimi në informacion të tillë. Qasja në këto informacione është e mundur për publikun në përgjithësi përmes faqes së internetit të Agjencisë. Në mënyrë që të ketë qasje në të dhëna të tilla, personi duhet të ketë informacionin qoftë për numrin e regjistrimit të biznesit, emrin e biznesit, numrin personal të personit të autorizuar, numrat personal të themeluesve, aktivitetin kryesor apo qoftë edhe për çfarëdo aktiviteti tjetër.

49. Pasi që ndryshimet në aksionar dhe drejtor raportohen përmes raporteve vjetore, ekziston një periudhë kur informacioni i disponueshëm mund të mos jetë i kohës ose i saktë.

50. Ndryshimet e fundit në Ligj e kanë zvogëluar kërkesën për kapital themeltar për Sh.A. dhe Sh.P.K. së bashku me periudhën e regjistrimit, e cila është zvogëluar në tri (3) ditë. Edhe pse nga perspektiva ekonomike ndryshimet më lart mund të kontribuojnë pozitivisht, nga një perspektivë LPP/LFT këto mund të ngrenë shqetësime pasi që e bëjnë regjistrimin e biznesit më të lehtë përveç nëse nuk monitorohen në mënyrë të rreptë në fazën e regjistrimit, duke pas parasysh mungesën e kujdesit të shtuar.

Organizatat jofitimprurëse

51. Organizatat jofitimprurëse (OJF) apo Organizatat Joqeveritare (OJQ) siç quhen në Kosovë, qeverisen me Ligjin për OJQ-të (Ligji nr. 04/L-057 i vitit 2011). Përmes Ligjit për OJQ-të rregullohet themelimi, regjistrimi, menaxhimi i brendshëm, aktiviteti, shpërbërja dhe fshirja nga regjistri i personave juridikë të organizuar si OJQ. Ligji megjithatë nuk aplikohet për parti politike, sindikata dhe organizata sindikale, si dhe qendra apo tempuj fetarë dhe fusha të tjera të rregulluara me ligj të veçantë. Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të (DRNOJQ) në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike është autoritet kompetent për implementimin e Ligjit për OJQ-të.

52. Një OJQ e regjistruar sipas Ligjit mund të aplikojë për status të përfituesit të beneficuar publik nëse organizohet dhe operon për të ndërmarrë si veprimtari parësore një po më shumë veprime të specifikuara, siç është asistenca dhe ndihma humanitare, përkrahja për persona me aftësi të kufizuara, si dhe aktivitetet arsimore, shëndetësore e bamirëse apo çfarëdo aktiviteti tjetër që mund të shërbejë si përfitim publik. Sipas ligjit, OJQ-të me status të përfituesit të beneficuar publik duhet të ketë të drejtë për beneficione tatimore, përveç atyre të cilat janë kryesisht kanë të bëjnë me pagesa për shërbime publike komunale.

53. OJQ-të janë rregulluar për herë të parë sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/22 dhe më vonë sipas ligjit të miratuar si Ligj 03/L-134 në vitin 2009, i cili është rishikuar dhe zëvendësuar në vitin 2011 me Ligjin aktual 04/L-057. Që nga atëherë, një Rregullore mbi

përputhshmërinë është miratuar nga Qeveria, përderisa Rregullorja mbi regjistrimin pritet të miratohet së shpejti. Megjithatë, rishikimi i ligjit nuk ka pas për qëllim vlerësimin e dobësive të sektorit në fushën e LPP/LFT-së.

54. Edhe pse procedurat e regjistrimit duket të jenë të duhura, ende nuk ka procedura të kujdesit të shtuar mbi themeluesit. Në të vërtetë, DRNOJQ nuk është në pozitë për të treguar rreziqet e financimit të terrorizmit dhe dobësitë, ndaj të cilave mund të ekspozohen OJQ-të. Sipas këtij Departamenti, kjo çështje nuk përfshihet në kuadër të mandatit të tij sipas Ligjit për OJQ-të, mandati i të cilit kufizohet vetëm në regjistrim. Që nga viti 1999 deri më sot, janë regjistruar 6,926 OJQ, prej të cilave 6,428 janë vendore dhe të tjerat ndërkombëtare. Deri në kohën e hartimit të këtij raporti 88 OJQ kanë pushuar së ekzistuari.

55. Nuk ka detyrim specifik ligjor mbi çfarëdo autoriteti për të ndërmarrë aktivitete informuese për sektorin e OJQ-ve në kontekst të LPP/LFT-së. NjIF ka informuar se në vitin 2007 ka udhëhequr disa sesione trajnimi për OJQ-të në lidhje me obligimet sipas Ligjit LPP/LFT dhe në lidhje me inspektimet e përputhshmërisë. Ekziston megjithatë një nevojë definitive për të identifikuar përgjegjësitë dhe për t'i formalizuar dhe strukturuar më mirë aktivitetet informuese për sektorin dhe për ta ngritur vetëdijen mbi dobësitë dhe rreziqet që i kanosen OJQ-ve përmes keqpërdorimit të organizatave të tilla. Në lidhje me këtë, ekziston nevoja për më shumë bashkëpunim, koordinim dhe ndarje të informatave në mes të autoriteteve relevante, siç janë DRNOJQ, NjIF, Administrata Tatimore dhe autoritetet e tjera, të cilat mund të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes.

56. Në praktikë, mungon mbikëqyrja e duhur apo monitorimi i çfarëdo kategorie të OJQ-ve. Administrata Tatimore ndërmerr ekzaminimin e sektorit vetëm për qëllime të përgjegjësisë tatimore e cila, sipas Administratës Tatimore, është e vogël. DRNOJQ pohon se nuk ka mandat monitorues sipas Ligjit për OJQ dhe kështu nuk ndërmerr mbikëqyrje të sektorit, i cili duhet të jetë brenda kufijve të autoriteteve të tjera kompetente-pavarësisht asaj që Ligji i jep DRNOJQ kompetenca adekuate për të ndërmarrë masa korrigjuese dhe të shqiptojë sanksione administrative, siç është pezullimi apo tërheqja e statusit të përfutësimit publik. NjIF nuk ka mandat të qartë sipas Ligjit LPP/LFT për të monitoruar OJQ-të për qëllime të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT- pavarësisht se paragrafi (4) i nenit 24 kërkon nga OJQ të që t'ua vejnë në dispozicion NjIF-së dhe DRNOJQ-së për inspektim çfarëdo dokumenti të marrë sipas paragrafit të përmendur të Ligjit. Përveç kësaj, Ligji LPP/LFT i jep autoritet DRNOJQ-së për ta suspenduar ose revokuar regjistrimin e çfarëdo OJQ-je për shkelje të dispozitave të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT sipas nenit 21 të Ligjit për OJQ, por nuk ofron mekanizëm se si të bëhet kjo në mungesë të mandatit mbikëqyrës për NjIF ose DRNOJQ.

57. Sipas Ligjit për OJQ-të, nuk ka dispozita të kompetencës që DRNOJQ-së të kërkojnë çfarëdo informacioni tjetër që mund t' nevojitet me përjashtim të dokumenteve të mbajtura nga OJQ-të për qëllime të paragrafit (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT.

58. Njëjtë, dhe pavarësisht se OJQ-të obligohen ta raportojnë çfarëdo akti ose transaksioni të dyshimtë tek NjIF, Ligji LPP/LFT nuk i jep kompetencë NjIF-së t'ua kërkojë çfarëdo informacioni OJQ-ve përveç raporteve vjetore të parapara sipas nenit 18 të Ligjit për OJQ-të dhe të dhënave të mbajtura sipas paragrafit (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT.

59. Me 16 dhjetor 2011, NjIF ka hyrë në marrëveshje bashkëpunimi me DRNOJQ për shkëmbim të informatave. Memorandumi i Mirëkuptimit, parashihet procedura, kushte dhe kritere për shkëmbim të informatave dhe obligimet e çdo pale mbi trajtimin e informacionit të shkëmbyer dhe funksionet e përputhshmërisë.

60. Pavarësisht se nëse një OJP duhet të hetohet proceset normale hetimore dhe sanksionet penale do të aplikoheshin, ekziston problem serioz nëse OJQ-të që duhet të hetohen nuk mund të identifikohen. Mungesa e masave të kujdesit të shtuar mbi themeluesit

në fazën e regjistrimit, fakti që DRNOJQ nuk është në pozitë për të treguar nëse një OJQ që është duke u regjistruar mund të ketë lidhje me financimin e terrorizmit dhe mungesa e mbikëqyrjes për qëllime LPP/LFT ndikojnë negativisht në procesin hetimor.

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar

61. Në nivel politikash zhvillimi kryesor është Strategjia LPP/LFT, e cila është miratuar në shtator të vitit 2012. Ekziston një grup punues ndër-agjencial për implementimin e saj. Kur dhe nëse kompletohet, kjo do të ketë ndikim të madh në mundësinë e Kosovës për të organizuar dhe informojë vetveten për ta luftuar më mirë pastrimin e parave, krimin ekonomik dhe financimin e terrorizmit. Sipas strategjisë, një zyre kombëtare për zbatimin e krimit ekonomik do të shërbejë si mekanizëm kryesor koordinues dhe monitorues për aktivitetet e të gjithë akterëve qeveritarë në fushën e luftimit të krimit ekonomik, përfshirë PP dhe FT, megjithatë nuk ka pas progres në themelimin e kësaj zyre deri më sot.

62. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka zhvilluar rishtazi një Plan strategjik për bashkëpunim ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit për 2013-2015. Ky dokument synon përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimin e informatave për rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Është e qartë se KPK dhe strategjitë LPP/krimeve ekonomike mbulojnë një numër të çështjeve të njëjta. Kjo çon tek brenga se si strategjitë e KPK dhe KPP do të lidhen në kuptim të implementimit praktik.

63. Në lidhje me koordinimin operacional është e qartë se agjencitë e zbatimit të ligjit janë ende në fazën fillestare të krijimit të një mekanizmi të duhur dhe sistematik për shkëmbim të informatave dhe bashkëpunim mes agjencive. Në këtë drejtim, Policia, Doganat, NjIF dhe prokurorët kanë nënshkruar një numër të MM-ve, megjithatë disa marrëveshje kyçe siç janë MM mes Policisë-NjIF⁷, NjIF-Prokurorisë janë ende në fillim, pasi që janë trashëguar nga koha e UNMIK-ut dhe nuk e reflektojnë kornizën aktuale rregullative. Ato as nuk janë të përcjella si duhet nga agjencitë pjesëmarrëse.

64. Kosova ka mundësi të ofrojë një gamë të gjerë të formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale, përfshirë asistencën ligjore procedurale në çështjet penale në përgjithësi, ekstradimin dhe transferimin e procedurave. Sa i përket asistencës ligjore procedurale, kërkesat e jashtme bëhen përmes Ministrisë së Drejtësisë, e cila i përcjell ato tek autoritetet gjyqësore vendore (ekziston rregulli i përgjithshëm ku nuk parashihet asnjë bashkëpunim direkt me autoritetet e jashtme gjyqësore). Nuk janë vërejtur baza kufizuese për refuzimin në legjislacionin përkatës. Përderisa bashkëpunimi është thënë të jetë bërë në kohë të arsyeshme dhe se është konstruktiv e efektiv, vlerësuesve iu është bërë e ditur për vonesa të gjata dhe grumbullim të madh të procedurave, të cilat shkojnë përmes gjykatave, kështu që janë propozuar standarde të qarta të dërgimit të dokumentacionit lidhur me kohën e përpunimi të kërkesave të jashtme për fushën e KPP-së.

65. Bashkëpunimi ndërkombëtar jo-KPA në fushën e LPP/LFT zhvillohet nga NjIF dhe Policia. Neni 14.1.7 i Ligjit LPP nr. 03/L-196 e lejon NjIF-në që spontanisht ose sipas kërkesës, si dhe në baza reciprociteti, të ndajë informacione me çfarëdo homologu të jashtëm që kryen funksione të ngjashme dhe i cili i nënshtrohet obligimeve të ngjashme në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht natyrës së agjencisë. Informacioni i ofruar duhet të përdoret vetëm pas aprovimit nga agjencia dhe vetëm për qëllime të luftimit të pastrimit të

⁷ Ekipi i vlerësimit është informuar më pas se NjIF dhe Policia kanë nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi me 19 shkurt, 2013, megjithatë kjo mbetet jashtë fushëveprimit të këtij vlerësimi pasi që nënshkrimi ka ndodhur dy muaj pas vizitës në terren.

parave dhe veprave penale të ndërlidhura dhe financimin e terrorizmit. NjIF mund të bëjë kërkime në emër të homologëve të huaj të informacioneve të disponueshme publikisht dhe të bazave të veta të të dhënave (informacione lidhur me RTD). NjIF ka të drejtë të kërkojë dhe marrë nga organet publike apo qeveritare ose organet a organizatat ndërkombëtare ose ndër-qeveritare (në Kosovë) të dhëna, informacione, dokumente në lidhje me një person, entitet, pronë ose transaksion, dhe mundet spontanisht apo në bazë të kërkesës të ndajë informacione me çfarëdo agjencie homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për mbrojtjen e konfidencialitetit, pavarësisht natyrës të agjencisë sipas reciprocitetit. Në të njëjtën kohë, Ligji LPP/LFT nuk e lejon NjIF që të bëjë kërkesa tek institucionet financiare për informacion bazuar në kërkesën e një NjIF-je të huaj. Në rast të kërkesës të referuar për NjIF, neni 37 i Ligjit KPP thotë se sekreti profesional nuk mund të përdoret si bazë për refuzimin e një kërkesë për informacion që duhet të ofrohet sipas ligjit apo që është marrë në pajtim me këtë Ligj. Policia e Kosovës dhe Doganat duhet të përmbushin kërkesat e Agjencisë Kosovare për Mbrojtje të të Dhënave. Kërkesat për informacion të lëshuar duhet të jenë në pajtim me standardet minimale.

66. Që nga viti 2011, Policia e Kosovës ka krijuar një Njësi të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zbatimit të Ligjit (ILECU) në kuadër të kornizës së projektit rajonal që synon lehtësimin e shkëmbimit të informacionit në mes të autoriteteve të zbatimit të ligjit. Shkëmbimi i informacioneve me johomologët do të shkojë përmes kanaleve të tërthorta. ILECU ose INTERPOL-i do të kanalizojnë kërkesën, por në rast të Interpol-it duhet po ashtu të ketë kërkesë përmes kanaleve diplomatike, e cila bëhet brenda 18 ditëve - kështu që kemi të bëjmë me një rrugë të tërthortë. Në cilindo rast, pozicionimi i ILECU apo Interpol-it nënkupton se ka një proces të ndërmjetshëm. Autoritetet e Kosovës nuk kanë ofruar statistika në lidhje me shkëmbimin ndërkombëtar të informacioneve nga policia, as përmes ILECU-s as ndryshe, duke e bërë kështu të pamundur gjykimin në lidhje me efektshmërinë.

RAPORT I DETAJUAR I VLERËSIMIT LPP/LFT

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Informata të përgjithshme rreth Kosovës dhe ekonomisë së saj

67. Kosova shtrihet në Evropën Juglindore në qendër të gadishullit Ballkanik dhe ka një sipërfaqe prej 10.908 km². Kosova ka një popullsi prej 1.739.825 milion banorësh sipas regjistrimit të fundit⁸, prej të cilëve, 92% janë shqiptarë dhe 8% janë serbë dhe pakica të tjera. Popullsia e Kosovës është njëra nga më të rejat në Evropë me një përqindje të përllogaritur prej 40 për qind të qytetarëve të saj me moshë nën 20 vjeçare. Gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë. Në nivel komunal, gjuhët turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare.

68. Sipas analizës së fundit të kryer nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), në vitin 2012⁹, Kosova ka pasur një rritje reale të PBV-së prej 3.8 për qind, nga 5% sa ishte në vitin 2011¹⁰. Kërkesa e brendshme e madhe është financuar nga dërgesat dhe nga hyrjet e kapitalit që në një masë të madhe krijohen nga diaspora e Kosovës¹¹. Sipas vlerësimeve të ndryshme ende ka një rrezik të lartë të të bërit biznes në Kosovë¹². Ekonomia joformale është ende e lartë. Kosova është ende një ekonomi e bazuar në import; e detyruar të importojë mallra dhe lëndë të parë, të cilat nuk ofrohen nga tregu lokal. Në mallrat kryesore të importuara përfshihen mallrat e prodhuara, makineritë dhe pajisjet, produktet ushqimore, pijet dhe duhani si dhe produktet e naftës. Prej 1 janarit 2002 Kosova përdor euron si valutë zyrtare.

69. Këshilli i Sigurimit i OKB-së më 10 qershor 1999 miratoi Rezolutën 1244. Kjo rezolutë, duke konfirmuar kufijtë ndërkombëtar të Serbisë, hoqi Kosovën nga juridiksioni i Serbisë duke e zëvendësuar atë me një zgjidhje të përkohshme të një administrate të mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të institucioneve funksionale dhe të mëvetësishme në Kosovë. Duke u bazuar në Rezolutën 1244 të KS të OKB-së është krijuar Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Këtij Misioni i janë dhënë kompetenca administrative, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë.

70. Më 17 shkurt 2008 Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia. Në muajin prill 2008, autoritetet e Prishtinës miratuan Kushtetutën e cila hyri në fuqi në muajin qershor të vitit 2008. Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara¹³.

71. Gati 14,000 trupa të Forcës së Kosovës (KFOR) e cila u vendos në Kosovë nën Rezolutën 1244 të KS të KB-ve janë ende në Kosovë për të ndihmuar në mbajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të qetë. KFOR bashkëpunon dhe u ndihmon Kombeve të Bashkuara dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), si dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, sipas nevojës, për të mbështetur zhvillimin e një Kosove stabile, demokratike, shumetnike dhe paqësore. EULEX-i filloi funksionimin në fushën e sundimit të ligjit më 9

⁸ <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/?cid=2.40>

⁹ Sipas Bankës Botërore (<http://data.worldbank.org/country/kosovo>), PBB në Kosovë për vitin 2011 ishte rreth 6.5 miliardë dollarë.

¹⁰ <http://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2012/cr12180.pdf>

¹¹ *Po aty*.

¹² Kosova pozicionohet në vendin e 126 prej 183 ekonomive sipas raportit Të bërit biznes (Doing Business) 2012. Megjithatë, më mirë pozicionohet në të bërit biznes për vitin 2013 (98 prej 185 ekonomive).

¹³ Kosova u bë anëtare e Bankës Botërore dhe e Fondit Monetar Ndërkombëtar më 29 qershor 2009.

dhjetor 2008 në kuadër të kornizës së Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe nën autoritetin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Qëllimi kryesor i EULEX-it është të ndihmojë dhe të përkrahë autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, e posaçërisht në lidhje me policinë, gjyqësinë dhe doganën. Aktualisht, EULEX-i është duke shqyrtuar mënyrën e pranisë së vet në Kosovë dhe është në proces të reduktimit, veçanërisht në komponentët e policisë dhe të doganës, për t'u dorëzuar më shumë përgjegjësi autoriteteve lokale.

72. Kosova ka sistem ligjor të bazuar në ligjin civil, ku Kushtetuta është akti më i lartë juridik dhe të gjitha ligjet dhe aktet e tjera ligjore duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën.

Transparenca, qeverisja e mirë, etika dhe masat kundër korrupsionit (shih gjithashtu Raportin e vlerësimit të PKEK mbi komponentin kundër korrupsionit)

73. Gjatë viteve të fundit, mediet, shoqëria civile dhe disa palë të tjera me interes kanë raportuar shpesh rreth korrupsionit dhe çështjeve të tjera të ndërlidhura, të cilat konsiderohen të jenë një sfidë serioze në Kosovë. Ka pasur edhe akuza të herëpashershme të zyrtarëve që kanë lidhje me veprimtaritë e organizuara kriminale. Sipas indeksit të perceptimit të korrupsionit të Transparency International për vitin 2011, Kosova shënon shkallën 2.9 (ku 10 përfaqëson nivelin më të ulët të korrupsionit), që njëherësh paraqet klasifikimin më të ulët në Ballkan¹⁴. Në bazë të Indikatorëve Globalë të Qeverisjes të Bankës Botërore, që nga viti 2003 kontrolli i korrupsionit në Kosovë ka treguar përmirësime të vogla, dhe ende mbetet i dobët, diku rreth 30% (100% paraqet kontroll të plotë të korrupsionit), me një tendencë jo të qartë që nga viti 2005¹⁵. Gjatë viteve të fundit janë bërë ndërhyrje të ndryshme dhe të rëndësishme institucionale dhe ligjore, si dhe janë miratuar standarde ligjore lidhur me fushën që ka të bëjë me korrupsionin, sistemin gjyqësor, çështjet penale, qeverisjen e mirë, administratën publike dhe transparencën.

74. Këshilli i Evropës gjatë 5-6 viteve të fundit në Kosovë dhe në rajon ka realizuar një numër aktiviteteve përmes programeve të bashkëpunimit dhe të asistencës teknike. Këto aktivitete ishin përqendruar në fushën ekonomike dhe të krimeve të rënda, d.m.th. pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale. Më konkretisht, këto veprimtari janë kryer përmes projekteve PACO Impact, PACO Kosova, CARDS dhe PROSECO. Projektet e tjera të asistencës teknike janë ofruar në kuadër të programeve IPA të Komisionit Evropian. Për qëllime të këtij Raporti, është me rëndësi të përmendet fuqizimi i burimeve njerëzore dhe i kapaciteteve institucionale të administratës publike lokale të Kosovës (IPA 2009), përmirësimi i sistemit të teknologjisë së informacionit në tatime (IPA 2009), objektet e përshtatshme të punës për Prokurorinë Publike (IPA 2009). Projektet e tjera të financuara nga vendet anëtare të BE-së dhe nga Shtetet e Bashkuara janë CRINIS-Hedhja e dritës mbi paratë në politikë, i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, dhe asistencë teknike e siguruar nga Departamenti i Thesarit i Shteteve të Bashkuara – Zyra e Asistencës Teknike (ZAT).

75. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve dhe sektorit privat është në një fazë të hershme. Privatizimi i sektorëve strategjikë ekonomikë ka filluar kohët e fundit nën një mjedis të kritikave shumë të zhurshme në lidhje me mungesën e transparencës dhe konsultimeve, keqpërdorimeve të dyshuara dhe mungesës së arsytimit të mjaftueshme përgatitore ekonomike dhe financiare. Nuk ka ende reforma të shëndosha strukturore për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për tërheqjen e investimeve të huaja direkte sipas një procesi të efektshëm dhe konkurrues.

¹⁴ <http://cpi.transparency.org/cpi2011/results/>

¹⁵ Banka Botërore, <http://info.worldbank.org/governance/wgi/>

1.2. Gjendja e përgjithshme në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Veprat e ndërlidhura penale të cilat gjenerojnë të ardhura

76. Shkalla e pastrimit të parave është e ndërlidhur me nivelin e ekonomisë së zezë joformale (kontrabandën me drogë, prostitucionin, kontrabandën e mallrave të paligjshme dhe veprimtaritë e tjera kriminale) duke mos përfshirë, në këtë kontekst, shmangien e tatimeve, si pjesë të ekonomisë së hirtë. Në raporte të ndryshme është llogaritur se ekonomia joformale e Kosovës gjendet në shkallën prej 39%-50%, duke përdorur tregues si: numrin e punonjësve në ekonominë formale dhe joformale, numrin e ndërmarrjeve të cilat funksionojnë në sferat formale dhe joformale, analogjinë me shtetet e tjera, etj.¹⁶ Në vitin 2007 në Kosovë, niveli i qarkullimit në ekonominë e zezë gjatë periudhës 2004-2006 në shkallë vjetore është vlerësuar të jetë më shumë se 300 milionë euro.

77. Sipas Raportit të fundit të Europol-it mbi “Vlerësimin e kërcënimit të BE-së nga krimi i organizuar për vitin 2011”, Kosova është ende një rajon me organizata kriminale shumë aktive, posaçërisht në fushën e trafikimit të drogës dhe të armëve¹⁷. Të ardhurat nga këto burime kriminale janë subjekt i veprimtarive të pastrimit të parave.

78. Sipas Shërbimit Doganor, Kosova është një treg i zi aktiv për mallrat e kontrabanduara të konsumit dhe për produktet e piraterisë. Të ardhurat e paligjshme nga veprimtaritë kriminale vendore dhe të huaja janë të krijuara po ashtu nga korrupsioni zyrtar, shmangia e tatimeve, mashtrimi doganor dhe kontrabanda.

79. Tabela e mëposhtme përmban statistika të siguruara nga autoritetet për veprat penale që janë burim kryesor i të ardhurave të paligjshme në Kosovë:

Tabela 1: Veprat penale që janë burim kryesor i të ardhurave të paligjshme (autoritetet e Kosovës nuk kanë saktësuar dëmin ekonomik të shkaktuar nga këto vepra penale)

Lloji i krimit	Viti	Krime të regjistruara	Hetime të përfunduara	Persona të akuzuar
Vepra penale të lidhura me drogën				
	2010	314		461
	2011	407		547
	2012	517		575
Grabitje				
	2010	432	516	
	2011	486	608	
	2012	152	410	
Krime doganore dhe tatimore				
	2010		21	15
	2011		14	11
	2012		9	14

¹⁶ Shih Friedrich Schneider në “Shadow Economies of 145 Countries all over the World: Çfarë dimë ne në të vërtetë?” (2006); Edward Christie dhe Mario Holzner në publikimin e tyre “Household Tax Compliance and the Shadow Economy in Central and South-eastern Europe” (2004); Banka Botërore në “Memorandum Ekonomik i Kosovës” (2004); publikim i FMN-së “Kosova—Orientimi i politikave drejt tritjes dhe zhvillimit” (2004).

¹⁷ www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/octa_2011.pdf

Lloji i krimit	Viti	Krime të regjistruara	Hetime të përfunduara	Persona të akuzuar
Vjedhje përmes keqpërdorimit të detyrës				
	2010		281	142
	2011		40	151
	2012		37	130
Mashtrim				
	2010		132	68
	2011		12	45
	2012		15	37
Qarkullim i parave të falsifikuara				
	2010			
	2011			
	2012	205	108	25
Vepra të tjera (të paspecifikuara)				
	2010		21	14
	2011		14	11
	2012		9	14

Pastrimi i parave

80. Ka shumë pak njohuri, informata ose ndonjë e dhënë statistikore e disponueshme në publik mbi fenomenin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë. Njësia për Inteligjencë Financiare (NjIF) harton raporte statistikore, mirëpo nuk hartohen raporte vjetore dhe nuk publikohen të dhëna për publikun e gjerë¹⁸. Njëkohësisht, sasia dhe cilësia e të dhënave nga autoritetet për zbatimin e ligjit dhe ato gjyqësore në të kaluarën është konsideruar si e pamjaftueshme për të vlerësuar numrin dhe karakteristikat e krimeve të hetuara të pastrimit të parave, të ndjekura penalisht dhe të përpunuara nga gjykatat¹⁹.

81. Sasi të mëdha të parave janë investuar në patundshmëri, restorante, bare dhe lojëra të fatit të tilla si, kazino, sllot makina dhe objekte të basteve sportive, dhe nuk ka kapacitet për të mbikëqyrur këto lëvizje. Gjithashtu ka një tendencë për të kryer biznes dhe për t'u angazhuar në transaksione të biznesit në llogari private pa regjistruar biznesin. Andaj, nuk është befasi se më shumë se 420.000 transaksione të parave të gatshme (mbi 10.000 euro) janë raportuar në vit tek NjIF, një numër ky shumë i lartë nëse e krahasojmë me numrin e popullsisë në Kosovë dhe me ekonominë e saj.

82. Në vitin 2007, policia e Kosovës dhe ajo ndërkombëtare arrestuan dy persona; këshilltarin politik të Kryeministrit të atëhershëm, dhe drejtorin e Kasa Bankes mbi dyshimin për pastrimin e parave. Sipas akuzave, Kasa Banka ishte administruese e fondit të veçantë të ish-kryeministrit Ramush Haradinaj. Këshilltari i ish-kryeministrit është akuzuar se ka pasur rol në këtë çështje të pastrimit të parave. Për të shtuar në listë, guvernatori i Bankës së Kosovës është arrestuar për pastrim parash, si dhe këshilltari i lartë i ministrit të Shëndetësisë

¹⁸ UNODC, "Raport i vlerësimit teknik", prill 2010.

www.unodc.org/documents/southeasterneurope/Technical_Assistance_Report_Kosovo_UNSCR_1244_final_ENG.pdf, në f.26.

¹⁹ B&S Europe, 2007 "Hulumtim mbi shkallën dhe parandalimin e ekonomisë së jashtëligjshme dhe pastrimin e parave në Kosovë. Raport i përgatitur për Agjencinë Evropiane për Rindërtim", f.21 www.eulex-kosovo.eu/training/police/PoliceTraining/ORGANIZED_CRIME/DOCUMENTS/2.pdf

është akuzuar për shmangie nga tatimet. Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit ka qenë i akuzuar për shpëlarje të parave dhe për marrje të haraçit nga kontraktuesit, mirëpo këto akuza janë ndërprerë për shkak të mungesës së dëshmive. Kohët e fundit në gusht të vitit 2012, Njësi special kundër korrupsionit ka arrestuar katër persona në komunën e Klinës, të dyshuar për shpëlarje të parave. Sipas policisë, këto arrestime erdhën si rezultat i arrestimeve që kanë ndodhur në vitet 2009 dhe 2011 për të njëjtin rast, ku u arrestuan 26 persona²⁰. Ishte supozuar që personat e arrestuar kanë përfituar 1,257.928 euro përmes mashtrimit të një kompanie e cila bën dhënien e makinave me qira (rent-a-car).

Terrorizmi dhe financimi i terrorizmit

83. Autoritete të ndryshme në Kosovë, të takuara gjatë vizitës në terren, konfirmuan kërcënimin nga financimi i terrorizmit. NjIF gjithashtu raporton se ka vërejtur disa transaksione të dyshimta lidhur me financimin e terrorizmit.

84. Duke marrë parasysh kufizimet që paraqiten nga gjendja e saj financiare, Qeveria e Kosovës ka zgjeruar përpjekjet e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të adresuar lëvizjen e individëve që në mënyrë të paligjshme kalojnë transit nëpër Kosovë dhe për të identifikuar kërcënimet e mundshme, si nga brenda, ashtu dhe nga jashtë²¹.

85. Gjatë vitit 2010, Qeveria e Kosovës ka bërë përpjekje për të ekstraduar një shtetas të Kosovës në SHBA për t'u përballur me ndjekje penale në lidhje me akuzat për terrorizëm. Zyra e Prokurorit të Shtetit dhe Zyra e Prokurorisë Speciale e Kosovës kanë paraqitur kërkesën e Shteteve të Bashkuara për ekstradimin e të arratisurit, por një panel i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga dy gjykatës të misionit evropian për sundimin e ligjit dhe një gjykatës i Gjykatës Supreme të Kosovës, ka refuzuar kërkesën për ekstradim²².

86. Disa organizata radikale islamike të lidhura me terrorizmin kanë tentuar të rekrutojnë ndjekës në mesin e shqiptarëve myslimanë të Kosovës, por këto përpjekje kanë dështuar. Në vitin 2004, autoritetet në Shqipëri arrestuan dhe ekstraduan në Kosovë, një shtetas të Kosovës i dyshuar për një sulm vdekjeprurës terrorist në vitin 2001 kundër një autobusi i cili bartte serbë të Kosovës. Ky person u akuzua më vonë nga një prokuror vendas i prokurorisë së qarkut të Kosovës për terrorizëm dhe vrasje²³.

1.3. Pasqyrë e përgjithshme e sektorit financiar

87. Sipas analizës së sektorit financiar të nivelit të lartë të kryer në tetor të vitit 2011, stabiliteti makroekonomik i Kosovës është i dobët në krahasim me standardet globale, me sfida të veçanta të pasqyruara në deficitin e lartë të llogarisë rrjedhëse dhe deficitin fiskal. Ndërsa sektori financiar është i vogël dhe i thjeshtë, sektori bankar mbetet i shëndoshë. Pjesa më e madhe është në pronësi të huaj dhe shumë e koncentruar në disa banka. Intensiteti dhe sofistikimi i shërbimeve financiare është i dobët, me bankat dhe institucionet mikrofinanciare të cilat kryesisht ofrojnë vetëm produkte bazike të kredisë²⁴.

²⁰ <http://www.kosovapress.com/?cid=2,85,151119>

²¹ <http://www.unhcr.org/refworld/country,,USDOS,,SRB,,4e52482332,0.html>

²² *Po aty.*

²³ *Shih* "Country Reports on Terrorism 2004", Departamenti i Shtetit i SHBA-së, prill 2005, f. 49.

²⁴ Kosovo High Level Financial Sector Overview përgatitur nga Partners for Financial Stability Program, Deloitte Consulting LLC for USAID, tetor 2011.

http://www.pfsprogram.org/sites/default/files/Kosovo_High_Level_Financial_Sector_Overview_Oct_15_2011.pdf

88. Gjatë vitit 2010, totali i asetëve të sektorit financiar ka arritur në 3.2 miliardë euro dhe është rritur për 13.7 për qind krahasuar me vitin 2009. Asetet e sektorit bankar përbënin rreth 77 për qind të totalit të asetëve të sektorit financiar, ndërsa fondet e pensionit përbënin 15.5 për qind, institucionet mikrofinanciare 4.3 për qind, të përcjella nga kompanitë e sigurimeve me 3.1 për qind dhe institucionet e tjera financiare me 0.1 për qind²⁵.

89. Aktualisht, në Kosovë janë 9 banka komerciale të licencuara dhe funksionale²⁶, 2 fonde pensionale të licencuara, 13 kompani sigurimesh të licencuara, 14 institucione mikrofinanciare të licencuara, 4 ndërmjetësues sigurimesh (1 licencë e anuluar), 4 institucione financiare jobankare (2 regjistrime janë tërhequr për shkak të mosveprimit), 5 agjenci për transferim parash, dhe 29 këmbimore²⁷.

90. Tabela e mëposhtme përcakton llojin e institucioneve financiare, të cilat mund të angazhohen në veprimtari financiare që sipas rekomandimeve të FATF-së janë në kuadër të përkufizimit të “institucioneve financiare”:

Tabela 2: Llojet e institucioneve financiare të cilat mund të angazhohen në veprimtari financiare

Lloji i veprimtarisë financiare (shih fjalorin e 40 rekomandimeve)	Lloji i institucionit financiar i cili kryen këtë veprimtari
1. Pranimi i depozitave dhe fondeve të tjera të pagueshme nga publiku (përfshirë veprimtarinë bankare private)	1. Bankat
2. Huadhënia (përfshirë kreditë konsumuese dhe hipotekare; blerjen dhe shitjen me ose pa të drejtë tërheqjeje të parave dhe financimin e transaksioneve tregtare (përfshirë humbjen)	1. Bankat 2. Institucionet mikrofinanciare 3. Institucionet financiare jobankare
3. Lizingu financiar (tjetër nga marrëveshjet e lizingut financiar në lidhje me produktet e klientëve)	1. Bankat 2. Institucionet financiare jobankare
4. Transferi i parave ose i vlerës, përfshirë veprimtarinë financiare si në sektorin formal, ashtu edhe në atë joformal (p.sh.: veprimtaria e dërgimit alternativ), por duke mos përfshirë personat fizik dhe juridik të cilët pajisin institucionet financiare vetëm me porosi apo me sisteme tjera mbështetëse për bartjen e fondeve)	1. Bankat 2. Institucionet financiare jobankare (dërgues parash) 3. Shërbimet postare të cilat kryejnë shërbime të pagesave
5. Emetimi dhe administrimi i mjeteve të pagesave (p.sh.: kartat e kreditë dhe debisë, çeqet, çeqet e udhëtarit, urdhrat për para, çeqet e bankës, dhe paratë elektronike)	1. Bankat [2. Çdo subjekt tjetër fizik/juridik i cili lëshon/menaxhon pagesat]
6. Garancionet dhe zotimet financiare	1. Bankat 2. Institucionet financiare jobankare
7. Tregtimi i: (a) instrumenteve të tregut të parasë, (çeqet, kambialet, certifikatat e depozitave, derivativet etj.); (b) valutës së huaj; c) këmbimit, përqindjes së interesit dhe indeks	1. Bankat 2. (b) Këmbimoret e huaja 3. Institucionet financiare jobankare

²⁵ Investimi në Kosovë, KPMG, botimi 2011, f. 17.

²⁶ Licenca e një banke është anuluar në vitin 2009.

²⁷ Burimi Banka Qendrore e Kosovës (BQK) (<http://www.bqk-kos.org/?cid=2,14>)

Lloji i veprimtarisë financiare (shih fjalorin e 40 rekomandimeve)	Lloji i institucionit financiar i cili kryen këtë veprimtari
instrumenteve; (d) letrat me vlerë të transferueshme; (e) tregtimi i produkteve të ardhshme	
8. Pjesëmarrja në çështjet e letrave me vlerë dhe sigurimi i shërbimeve financiare lidhur me çështjet e tilla	1. Bankat 2. Institucionet financiare jobankare
9. Administrimi i portofolios kolektive dhe individuale	1. Bankat
10. Ruajtja dhe administrimi i parave të gatshme apo letrave likuide me vlerë në emër të personave të tjerë	1. Bankat 2. Institucionet financiare jobankare
11. Investimi, administrimi apo menaxhimi i fondeve ose parave në emër të personave të tjerë	1. Bankat
12. Nënshkrimi dhe vendosja e sigurimit jetësor dhe sigurimeve të tjera lidhur me investimet (përfshirë sipërmarrjet e sigurimeve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit (agjentët dhe brokerët)	1. Kompanitë e sigurimit jetësor / agjentët / ndërmjetësuesit / fondet pensionale
13. Këmbimi valutator dhe i parave	1. Bankat 2. Institucionet financiare jobankare 3. Këmbimoret e huaja

Spektori bankar (institucionet financiare bankare dhe jobankare)

91. Në fund të vitit 1999 asnjë bankë nuk funksiononte në Kosovë. Një bankë, Micro-Enterprise Bank e Kosovës (MEB-Kosovë), me BERZH-in dhe IFC-në si pjesëmarrëse të kapitalit, mori aprovimin për të filluar funksionimin në janar të vitit 2000. Institucioni i dytë financiar (teknikisht “jobankar”), Grameen-Missione AMF, mori gjithashtu licencën për të vepruar si një institucion mikrofinanciar, megjithëse nuk ishte aktiv që prej tremujorit të dytë të vitit 2000. Licencat paraprake janë miratuar nga ana e autoritetit mbikëqyrës dhe licencues për katër banka me një histori të funksionimit në Kosovë në pranverë të vitit 2000. Në fillim të vitit 2000, mobilizimi i depozitave dhe kreditimit ishte praktikisht joekzistent në sektori bankar përveç 2.000 e ca llogarive të cilat ishin hapur në MEB-Kosovë. Transferet bazike përmes bankave virtualisht janë ndaluar në mënyrë që të mund të njihet sistemi i pagesave. Megjithatë, në mungesë të një sistemi bankar funksional, përgjithësisht këto shërbime ishin ofruar nga kompanitë e udhëtimit me një pagesë prej 5 deri 7 për qind për transferim.

92. Sektori bankar në Kosovë përbëhet nga dy nivele, ku Banka Qendrore e Kosovës operon si bankë e nivelit të parë dhe bankat komerciale si banka të nivelit të dytë.

93. Produktet dhe shërbimet bankare janë grupuar në: (1) Depozita; (2) Kredi; (3) Produkte të tjera, (4) Kryerja e pagesave dhe transfertave, 5) Letrat me vlerë. Bankat në Kosovë ofrojnë një numër të konsiderueshëm të produkteve dhe shërbimeve bankare. Edhe pse shumica e këtyre produkteve hyjnë në grupin e shërbimeve klasike bankare, kohëve të fundit bankat kanë filluar zgjerimin e gamës së shërbimeve të tyre me disa risi për tregun, të tilla si: lizingu, shërbimet bankare elektronike (Mobile Banking) dhe shërbime të tjera. Në përgjithësi, produktet dhe shërbimet e ofruara nga bankat përfshijnë:

- Depozita,
- Kredi,
- Kryerja e pagesave/transfereve të brendshme dhe të jashtme,
- Biznes në formë të dokumenteve (garancione dhe letërkredi),

- Shërbime elektronike,
- Produkte të tjera²⁸.

94. Në vitin 2010 sistemi bankar është karakterizuar me zgjerim të infrastrukturës, numri i degëve dhe nëndegëve të bankave komerciale arriti në 303, që paraqet një rritje vjetore prej 16 njësi. Prej vitit 2009, në tregun bankar të Kosovës kanë operuar tetë banka komerciale, numër ky që është rritur në 9 në vitin 2012, prej të cilave gjashtë ishin me pronësi të huaj (Austrië, Gjermanisë, Francës, Turqisë, Sllovenisë, Serbisë), ndërsa dy nga to ishin me pronësi vendore. Bankat me pronësi të huaj dominojnë tregun bankar në Kosovë, duke menaxhuar 90.2 për qind të gjithsej aseteve të sistemit bankar në dhjetor të vitit 2010 (91.1 për qind në vitin 2009). Pjesa e mbetur e aseteve (9.8 për qind në dhjetor 2010) menaxhohet nga dy bankat me pronësi vendore. Sistemi bankar në Kosovë vazhdon të karakterizohet me një shkallë të lartë të përqendrimit të tregut, ku rreth 77.4 për qind e gjithsej aseteve të sistemit bankar menaxhohen nga tri bankat më të mëdha. Dy bankat më të mëdha ProCredit Bank dhe Raiffeisen Bank kanë një pjesëmarrje në tregun e përgjithshëm të kredive prej 68%. Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, asnjë nga këto banka nuk ka pozitë dominuese pasi që nuk e tejkalojnë kufirin e 40% të pjesëmarrjes në treg. Megjithatë, duhet të theksohet se rritja e vazhdueshme e aktivitetit të bankave më të vogla ka ndikuar që shkalla e përqendrimit në tregun bankar të shënojë rënie të vazhdueshme që nga viti paraprak²⁹.

Tabela 3: Lista e subjekteve të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës prej vitit 2009

Nr.	Subjektet	2009	2010	2011	2012
1	Banka dhe degë të huaja	8	8	8	9
2	Institucioneve financiare jobankare	6	5	5	4
3	Institucione mikrofinanciare	14	13	15	14
4	Ndërmjetësues dhe kompani sigurimesh	11	11	13/3	13/4
5	Fonde pensionale	2	2	2	2
6	Ndihmës financiarë/zyra këmbimore dhe transferi	23/3	26/4	30/4	31/5

95. Përveç bankave komerciale, institucionet mikrofinanciare (IMF) përbëjnë një faktor tjetër të rëndësishëm në tregun e kredive në Kosovë. Në vitin 2010, në Kosovë funksiononin 13 IMF dhe pesë institucione të tjera jobankare. Portofolio e kredive të lëshuara nga IMF gjatë vitit 2010 arriti në 116 milionë euro, një rritje prej 6.5 për qind krahasuar me vitin 2009. Përfituesit kryesorë të kredive të IMF-ve janë ndërmarrjet e vogla dhe ekonomitë familjare.

Sektori i letrave me vlerë dhe i këmbimit të aksioneve

96. Në Kosovë nuk ka treg të letrave me vlerë. Nuk ka ligj për letrat me vlerë dhe nuk ka ndonjë treg të licencuar ku do të mund të tregtoheshin publikisht letrat me vlerë. Tregtimi i parë i letrave me vlerë në formën e letrave me vlerë të qeverisë/bonot e thesarit është kryer gjatë vitit 2012. Në Prishtinë nuk ka bursë për këmbimin e aksioneve.

Sektori i sigurimit (sigurimit jetësor)

97. Kompanitë e Sigurimit (KS) në Kosovë janë relativisht të vogla dhe të pakta, ku asetet e kombinuara të tyre në vitin 2007 kapnin vlerën prej 70.8 milionë euro. Krahasuar me nivelin në vitin 2005, vlera e këtyre aseteve është rritur për më shumë se 53 për qind (në vitin 2005 shifra ishte 46.2 milionë euro). Në vitin 2007, përqindja e totalit të aseteve të KS-ve të

²⁸ http://ak.rks-gov.net/repository/docs/Analysis_of_Monitoring_BSK_311011.pdf

²⁹ Po aty.f.9

totalit të aseteve të sektorit financiar në Kosovë ishte rreth pesë për qind. Aktualisht në Kosovë operojnë 13 kompani të sigurimit dhe 4 kompani ndërmjetësuese të sigurimeve, nga të cilat 10 janë kompani të sigurimit jojetësor dhe 3 janë kompani të sigurimit jetësor. Dhjetë nga kompanitë e sigurimit në Kosovë janë në pronësi të kapitalit të huaj dhe menaxhojnë rreth 77.4 për qind të totalit të aseteve të këtij sektori³⁰. Gjatë vitit 2010, depozitat dominuan asetet e kompanive të sigurimeve, duke përfaqësuar 63 për qind të aseteve të kompanive të sigurimeve. Sigurimi jetësor si produkt ka ekzistuar prej vitit 2010.

98. Veprimtaria kryesore e kompanive të sigurimit është ofrimi i policave të sigurimit nga përgjegjësia për palët e treta (TPL), që do të thotë polica të sigurimit të automjeteve, të cilat gjenerojnë 57 për qind të të gjitha primeve, përderisa pjesa tjetër e primeve të pranuar ka ardhur nga policat për sigurim vullnetar³¹.

99. Fitimi neto i kompanive të sigurimit në vitin 2010 ishte 1.5 milion euro, krahasuar me neto humbjen prej 4.9 milionë euro. Gjatë vitit 2010, numri i policave të sigurimit të lëshuara nga kompanitë e sigurimit që operojnë në Kosovë arriti në 540.700 që paraqet një rritje vjetore prej 5.7%. Vlera e primeve të pranuar shënoi rritje prej 5.1%, duke arritur vlerën prej 71.3 milionë euro në fund të vitit 2010. Megjithatë, rritja e vlerës së primeve të pranuar ishte më e ulët në vitin 2010 krahasuar me rritjen vjetore në vitin 2009, ku shkalla e rritjes ishte 20.0%. Gjatë vitit 2010, kompanitë e sigurimit gjeneruan pjesën më të madhe të primeve të pranuar (57% të gjithsej primeve)³².

100. Pavarësisht ngritjes së shpejtë të fitimeve, kompanitë e sigurimit në Kosovë vazhdojnë të kritikohen nga rregullatori i këtij sektori, gjegjësisht nga Banka Qendrore e Kosovës dhe nga të siguruarit lidhur me mospagesën e shpejtë të kërkesave³³.

Sektori për transferimin e gjërave të vlefshme apo të parave

101. Ndërmjetësit financiarë në Kosovë përbëhen nga byrotë e këmbimit dhe Agjencitë për Transferimin e Parave (ATP). Deri në vitin 2009 kanë qenë tre operatorë të transferimit të parave, të quajtur gjithashtu si ndërmjetës aktivë financiarë në Kosovë. Numri i këtyre është rritur në 5 operatorë në vitin 2012. Diaspora preferon këtë mënyrë për dërgimin e mbështetjes financiare për të afërmit e tyre në Kosovë, për shkak se kjo është shndërruar në një mënyrë më të lehtë për konsumatorët. Kjo është po ashtu shumë tërheqëse për shkak se përdoruesit nuk kanë nevojë për të hapur një llogari dhe për shkak se transferimi bëhet brenda disa minutave. Pothuajse 41% të të gjitha dërgesave/remitancave gjatë vitit 2010 janë dërguar përmes këtij kanali. Megjithatë, pjesa e saj në totalin e transfereve ndërkombëtare është vetëm rreth 4.4%³⁴. Pjesa më e madhe e transfereve ndërkombëtare (rreth 78% të gjithsej transfereve) kryhet përmes bankave komerciale.

1.4. Pasqyrë e përgjithshme e Sektorit të Profesioneve dhe Bizneseve të Caktuara Jofinanciare (SPBCJ)³⁵

³⁰ http://www.eurojournals.com/EJEFAS_45_11.pdf

³¹ Investimi në Kosovë, KPMG, botimi 2011, f. 21.

³² http://www.bogalaw.com/pdf/Investment_Kosovo_January12.pdf p.31.

³³ Burimi Balkan Insight (<http://www.balkaninsight.com/en/article/insurance-companies-failing-to-pay-out>)

³⁴ https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13692/FisnikLatifi_CapstoneProject_Report_5-09-2011.pdf?sequence=5

³⁵ Ky raport nuk përshkruan zbatimin e masave LPP/LFT në sektorin e SPBCJ (R.12, 16, 24). Analiza e siguruar në pjesën 1 është e dhënë vetëm për qëllim të informimit.

102. Kategoritë e SPBCJ-ve, siç përcaktohen në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë agjentët dhe ndërmjetësit e pasurive të patundshme, noterët publikë, avokatët dhe përfaqësuesit e tjerë ligjorë; kontabilistët e certifikuar të pavarur, auditorët e licencuar, këshilltarët tatimorë dhe zyrat për këshillim financiar; tregtarët e gurëve dhe metaleve të çmuara; subjektet e angazhuara në administrimin e pasurisë së palëve të treta (trusti dhe ofruesit e shërbimeve), dhe kazinotë, përfshirë ato në internet.

Tabela 4: Numri i subjekteve nga autoritetet në secilin sektor të SPBCJ-së

SPBCJ	Numri i subjekteve të licencuara	Organi mbikëqyrës
Noterë	43	Oda e Noterëve/Ministria e Drejtësisë
Avokatë	577 ³⁶	Oda e Avokatëve/Ministria e Drejtësisë
Auditorë të pavarur dhe firma auditimi	45 auditorë 19 firma auditimi (prej të cilave 13 vendore dhe të huaja)	1. Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar ³⁷ /Ministria e Financave
Kontabilistë të pavarur dhe firma të kontabilitetit	67 kontabilistë	2. Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar/Ministria e Financave
Personat dhe kazinotë që organizojnë lojëra të fatit përfshirë personat që organizojnë lojëra fati në internet	155 licenca të reja apo të vazhduara për vitin 2011 (9 licenca të reja, 32 vazhdime të licencave dhe 114 vazhdime të veprimtarive) 331 biznese të ndërlidhura janë regjistruar në regjistrin komercial (9 kazino)	Divizioni i lojërave të fatit / Administrata Tatimore e Kosovës
Agjentët/agjencitë e pasurive të patundshme	46	NjIF
Trustet; ofruesit e shërbimit të regjistrimit të personave juridikë	I panjohur	
Tregtarët e metaleve të çmuara; tregtarët e gurëve të çmuar	108	Departamenti i metrologjisë/MTI

Kazinotë (përfshirë kazinotë e internetit)

103. Lojërat e Fatit në Kosovë janë legalizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 2004/35 për lojërat e fatit, dhe aktualisht janë të rregulluara me Ligjin nr. 04/L-080, të datës 6 prill 2012. Me këtë Ligj rregullohet mënyra e organizimit dhe funksionimit të lojërave të fatit, llojet e lojërave të fatit, licencimi i subjekteve dhe regjistrimi i punonjësve të lojërave të fatit, themelimi i autoritetit të lojërave të fatit dhe mbikëqyrja e tyre. Përmes këtij Ligji gjithashtu rregullohet statusi, qeverisja, menaxhimi dhe të drejtat e bartshme dhe të përcaktuara të Llotarisë së Kosovës. Lojërat e fatit realizohen përmes Llotarisë së Kosovës, e cili është

³⁶ <http://www.oak-ks.org/cms/data/1680ee750e362bf397b4495fb81332ee.pdf>

³⁷ <http://mf.rks-gov.net/en-us/zyrat/sekretariatiikkrfse/listaeauditorvedhefirmaveaudituese.aspx>

subjekt juridiko-publik, dhe përmes subjekteve të tjera ligjore, të regjistruara dhe të licencuara për ushtrimin e lojërave të fatit. Me këtë Ligj janë të qeverisura lojërat e fatit në vazhdim:

- Lojërat e llotarisë;
- Lojërat e kazinos;
- Bastet sportive;
- Lojërat në automate;
- Tombola bingo në lokale të mbyllura.

104. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është autoriteti rregullator i lojërave të fatit.

105. Miratimi i legjislacionit për lojërat e fatit nuk u mirëprit nga qytetarët e Kosovës, dhe një numër i OJQ-ve organizuan protesta duke kërkuar nga qeveria të shfuqizojë Ligjin pasi që ai dëmton ekonominë familjare, të cilat edhe ashtu janë të varfra. Edhe mediet publikuan artikuj duke pretenduar se zyrtarët e qeverisë dhe politikanët janë pronarë të shumë kazinove dhe objekteve të basteve sportive në Kosovë. Këta artikuj ngritën shqetësime se lojërat e fatit në Kosovë janë të përhapura dhe janë duke u bërë një fenomen kriminal³⁸.

106. Prej 331 operatorëve të lojërave të fatit, të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e bizneseve, 261 janë ndërmarrje individuale apo partneritete të përgjithshme, 70 të tjerat përfshijnë 56 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 6 shoqëri aksionare dhe 8 kazino. Gjatë vitit 2011 Divizioni për lojëra të fatit në kuadër të ATK-së ka lëshuar 11 licenca të reja, si dhe 114 njësi të reja të cilat funksionojnë në kuadër të operatorëve tashmë të regjistruar si pjesë e zgjerimit të veprimtarisë. Gjithsej 1.606 vizita janë kryer gjatë vitit 2010 dhe 957 gjatë vitit 2011. Shuma e përgjithshme e gjobave të shqiptuara ishte 25.000 euro gjatë vitit 2010 dhe 40.000 euro gjatë vitit 2011.

Agjentët e pasurive të paluajtshme

107. Ligji për PPP/LFT mbulon sektorin e pasurive të paluajtshme banesore dhe komerciale. Sektori i pronës së paluajtshme në Kosovë është i rregulluar përmes ligjit: Ligji nr. 03/L-154 i datës 25.06.2009 për pronësinë dhe të drejtat tjera pronësore; Ligji nr. 2003/25 i datës 18.02.2009 për kadastrën (siç është ndryshuar); Ligji nr. 2002/05 i datës 17.10.2002 për themelimin e një regjistri për të drejtat në pronën e paluajtshme (siç është ndryshuar); Ligji nr. 03/L-139 i datës 26.03.2009 për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Toka në Kosovë dhe transaksionet përkatëse duhet të noterizohen dhe më pas të regjistrohen në Zyrat Komunale përkatëse të Kadastrës (ZKK). Agjencia Kadastrale e Kosovës ka autoritetin për administrimin e përgjithshëm të regjistrit në Kosovë.

108. Nuk ka mundësi të kryhet ndonjë transaksion në lidhje me pronën e patundshme në formë elektronike, si dhe nuk mund të ketë qasje elektronike në informatat mbi pronësinë e pronës së patundshme të regjistruar.

109. Siç u theksua më lart, sektori i pasurisë së paluajtshme konsiderohet si rrezik i lartë për PP. Përveç kësaj, shfrytëzimi i parave të gatshme gjatë transaksioneve të pronës së paluajtshme është shumë i zakonshëm.

Avokatët, noterët, profesionistët e tjerë të pavarur ligjorë dhe kontabilistët

110. Avokatët në Kosovë janë të organizuar përmes Odës së Avokatëve të Kosovës (Avokatia) e cila ka gjithsej 577 avokatë të regjistruar. Ekzistojnë 6 zyre të përbashkëta/shoqëri të avokatëve dhe 54 praktikantë të avokatisë. Veprimtaria e Odës dhe

³⁸ <http://www.botasot.info/lajme/169028/RaJOKaH/>

organizatave të saj udhëhiqet përmes Ligjit për avokatinë nr. 03/L-117, statutit të OAK-së dhe Kodit të mirësjelljes për avokatët.

111. Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për të siguruar që profesioni i juristit është duke u ushtruar normalisht dhe në përputhje me ligjin. Oda e Avokatëve të Kosovës bënë mbikëqyrjen e avokatëve për qëllime të LPP/LFT.

112. Në kohën e Jugosllavisë, në Kosovë nuk kishte sistem të noterisë dhe si pasojë e kësaj nuk kishte ekzistonte as ekspertiza në këtë fushë. Gjykatat komunale bënë mbikëqyrjen e transaksioneve të thjeshta, si blerja dhe shitja e pronës. Në fillim të nëntorit të vitit 2011, Ministria e Drejtësisë certifikoi 48 noterët e parë në Kosovë³⁹. Ligji për noterinë (03/L-10) i miratuar në vitin 2008, si dhe udhëzimet administrative që përcaktojnë procedurat e aplikimit dhe shtrirjen territoriale të shërbimit të noterisë përbëjnë kornizën legjislative për shërbimin e noterisë në Kosovë. Noteritë në Kosovë janë të organizuara përmes Odës së Noterëve të Kosovës që është një organ relativisht i ri.

113. Ministri i Drejtësisë përcakton numrin e përgjithshëm të noterëve dhe të mbuluarit relativ për secilën komunë. Noteritë janë të përfshira në të gjitha transaksionet që kanë të bëjnë me shitjen e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë pasurinë e paluajtshme apo mallrat, siç janë veturat. Ministria e Drejtësisë bën mbikëqyrjen e noterisë për qëllime të LPP/LFT.

Kontabiliteti, auditimi dhe raportimi financiar

114. Kontabiliteti, raportimi financiar dhe auditimi në Kosovë janë të rregulluara përmes Ligjit për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin (Ligji nr. 04/L-014). Nëpërmjet këtij Ligji rregullohet sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar i organizatave afariste, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për raportim financiar, kërkesat e auditimit, kualifikimet për kontabilistë profesionistë, licencimin e auditorëve si dhe të firmave të huaja dhe vendore të auditimit. Kontabiliteti dhe raportimi financiar për institucionet financiare është i rregulluar nga Banka Qendrore e Kosovës. Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe të Auditorëve të Kosovës është një organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e cila ofron trajnime në fushën e kontabilitetit⁴⁰.

115. Në bazë të këtij Ligji, organizatat e mëdha afariste dhe të gjitha organizatat afariste të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare në Kosovë, duhet të aplikojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS) si dhe interpretimet, rekomandimet dhe këshillimet e lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat duhet të miratohen nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF).

116. Ligji parasheh që pasqyrat financiare të organizatave të mëdha afariste të auditohen nga firmat e auditimit, të cilat janë të licencuara për të kryer auditim në Kosovë, ndërsa deklaratat financiare të organizatave afariste të mesme duhet të auditohen qoftë nga firmat audituese të licencuara apo nga auditorët e licencuar për kryerjen e auditimeve në Kosovë. Organizatat e mëdha afariste janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim: (1) qarkullim vjetor neto më të madh se 4 milionë euro; (2) asete bruto në datën e bilancit të gjendjes më të mëdha se 2 milionë euro dhe (3) numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar më i madh se 50.

³⁹ http://www.swisscooperation.admin.ch/kosovo/en/Home/Domains_of_Cooperation/Rule_of_Law_and_Democracy/Establishment_of_a_Notary_System_in_Kosovo_Phase_III

⁴⁰ http://www.scaak.org/index.php?option=com_content&view=article&id=2&Itemid=2

Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar

117. Tregtarë të metaleve dhe gurëve të çmuar janë individët apo subjektet juridike. Sipas regjistrimit komercial në këtë sektor janë të regjistruar 108 tregtarë. Veprimtaria e tyre është e rregulluar në mënyrë specifike përmes Ligjit nr. 2004/28 për punimet nga metalet e çmuara. Sipas këtij Ligji, punimet nga metalet e çmuara para se të vihen në qarkullim publik, i nënshtrohen ekzaminimit dhe vulosjes së detyrueshme. Ato duhet të vulosen me vulën e Institutit të Metrologjisë Legale të Kosovës (IMLK) – aktualisht Departamenti i metrologjisë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ekzaminimi bëhet në laboratorin e punimeve nga metalet e çmuara.

Trustet dhe kompanitë ofruese të shërbimeve

118. Ndonëse në bazë të ligjit këta ofrues konsiderohen si subjekte raportuese për qëllime të LPP/LFT, me sa duket trustet aktualisht nuk ekzistojnë në Kosovë. Megjithatë disa shërbime të ofruara nga kompanitë, të cilat veprojnë ai agentë formues apo persona juridikë, të cilat ofrojnë zyre të regjistruar, adresë tregtare apo strehim për kompanitë, ofrohen nga avokatët, noterët apo kontabilistët. Megjithatë, edhe kjo mundësi ligjore është shumë e kufizuar në kushtet praktike.

1.5. Pasqyrë e përgjithshme e ligjeve dhe mekanizmave komerciale që qeverisin marrëveshjet dhe personat juridikë

119. Subjektet e mëposhtme fitimprurëse mund të regjistrohen sipas Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare, dhe Ligjit nr. 04/L-006 për ndryshimit dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare. Subjektet tregtare të cilat mund të regjistrohen në regjistrin tregtarë në Kosovë janë: ndërmarrje individuale, ortakëritë e përgjithshme, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësit të kufizuar dhe shoqëritë aksionare.

120. Përveç subjekteve të mësipërme, subjektet e huaja mund të regjistrojnë një degë të tyre në Kosovë (ajo duhet të regjistrohet në regjistër në përputhje me ligjin si shoqëri e huaj tregtare). Dega e shoqërisë së huaj tregtare nuk ka personalitet të ndarë juridik. Si pasojë, të drejtat dhe detyrimet e saj i takojnë kompanisë “amë” dhe jo degës.

121. Ndërmarrje individuale (“NI”) – është një subjekt i cili mund të themelohet dhe të jetë pronë e vetëm një personi fizik dhe nuk ka status të ndarë juridik. Pronari i një subjekti të tillë ka përgjegjësi të pakufizuar për të gjitha borxhet dhe detyrimet e NI-së. Ndonëse NI nuk është person juridik, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur, në emrin e saj apo të pronarit. Ndërmarrja individuale me qëllim të ushtrimit të një veprimtarie ekonomike mund të zgjedh të regjistrohet ose jo në regjistër.

122. Shoqëria kolektive (“ShKl”) – është partneriteti i përbërë nga dy apo më shumë persona fizikë apo juridikë, të cilët ndërmarrin veprimtarinë afariste për përfitim në përputhje me marrëveshjen mbi partneritetin. Pronarët e subjekteve të tilla janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet e ShKl-së. Kjo përgjegjësi është e pakufizuar. ShKl-ja nuk është person juridik, mirëpo mund të themelohet nga personat juridikë, të cilët janë bërë ortak të përgjithshëm të ShKl-së. ShKl-ja menaxhohet nga ortak(ët) e përgjithshëm të saj. Ndonëse ShKj-ja nuk është person juridik, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur, në emrin e saj apo të pronarit.

123. Shoqëria komandite (“ShKm”) – është shoqëri që përbëhet nga së paku një ortak i përgjithshëm dhe së paku një ortak i kufizuar. ShKm-ja mund të përbëhet nga personat fizikë apo organizatat afariste, të cilët mund të shërbejnë qoftë si ortakë të përgjithshëm ose të kufizuar. Ndonëse është e ngjashme me ShKl-në, ShKm-ja ka së paku një ortak të kufizuar,

përgjegjësia personale e të cilit është e kufizuar në investimet e bëra nga ana e tij në ShKm. Ortaku i kufizuar gjithashtu ka kompetenca të kufizuara për të menaxhuar apo përfaqësuar ShKm-në. ShKm-ja menaxhohet nga ortak(ët) e përgjithshëm të saj. Ndonëse ShKm-ja nuk është person juridik, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur, në emrin e saj apo të pronarit. Zyra e Regjistrimit nuk është e autorizuar që t'i shqyrtojë mangësitë ligjore ose formale të marrëveshjes së shoqërisë komandite dhe/ose të refuzojë regjistrimin e shoqërisë komandite për çfarëdo arsye e cila ka të bëjë me formën, përmbajtjen ose kushtet e marrëveshjes së shoqërisë komandite⁴¹.

124. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (“ShPK”) – është një person juridik që themelohet nga/dhe është pronë e një apo më shumë personave fizikë apo juridikë, duke përfshirë OJQ-të. ShPK-ja është juridikisht e ndarë dhe e dallueshme nga pronarët. Përgjegjësia personale e pronarëve është e kufizuar në kapitalin të cilin ata e kanë investuar në ShPK. ShPK-ja udhëhiqet nga asambleja e aksionarëve dhe nga drejtori menaxhues (ose bordi i drejtorëve). Aksionet e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar u shpërndahen vetëm themeluesve të saj, dhe kompania nuk mund të bëjë ofertë publike për aksionet e saj. –Më parë, numri i aksionarëve nuk mund të tejkalonte numrin 50, përderisa kapitali themeltar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duhej të ishte së paku 1.000 euro. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-006 që ndryshon Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, kërkesa për kapital themeltar minimal prej 1,000 Euro dhe kufizimet mbi aksionarët është hequr. Subjektet e huaja lejohen të kenë pronë dhe të marrin pjesë në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Për t'u krijuar një ShPK, është e detyrueshme që ajo të regjistrohet në Zyrën e regjistrimit.

125. Shoqëria aksionare (“ShA”) – është person juridik në pronësi të aksionarëve të saj, por është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët. Pra, aksionarët kanë përgjegjësi personale të kufizuar për borxhet dhe detyrimet e ShA-së. Një kapital themeltar prej së paku 25.000 euro është kërkuar për të themeluar një ShA, e cila shumë tani është zvogëluar në 10,000 euro me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 04/L-006 që ndryshon Ligjin nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare. Aksionarë të ShA-së mund të jenë personat fizikë, shoqëritë tregtare dhe/ose shoqëri të tjera. Shoqëria aksionare mund të ketë një aksionar. Aksionet e shoqërisë aksionare mund të barten nga pronar(ët) pa miratimin e aksionarëve apo të kompanisë. Aksionarët bëjnë zgjedhjen e bordit të drejtorëve, i cili menaxhon ShA-në. Bordi i drejtorëve merr në punë zyrtarët, domethënë menaxherët e lartë të ShA-së. ShA mund të krijohet vetëm përmes regjistrimit në Zyrën e Regjistrimit.

126. Adresa e zyrës së regjistruar të shoqërisë tregtare, si dhe emri dhe adresa e agjentit të regjistruar duhet të paraqiten në dokumentet e regjistrimit të shoqërisë tregtare. Çdo shoqëri tregtare ka detyrim të vazhdueshëm për të siguruar që (i) një dokument i regjistrimit të azhurnohet të paktën brenda dhjetë (10) ditëve kalendrike nëse janë shfaqur rrethana të cilat kanë ndikuar në saktësinë ekzistuese të dokumentit-tani është reduktuar në tri (3) ditë me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 04/L-006 që ndryshon Ligjin nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe (ii) personi ose shoqëria tregtare e emëruar si agjenti i saj i regjistruar është në dispozicion në bazë të rregullt në zyrën e regjistruar⁴².

127. Shoqëria e huaj tregtare, sikur që është përcaktuar në ligjin për Shoqëritë Tregtare, mund të angazhohet në aktivitete tregtare në Kosovë, njësoj sikurse edhe shoqëritë tregtare vendore. Fillimisht ajo duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit si “shoqëri e huaj tregtare” dhe të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit. Një shoqëri e huaj tregtare është subjekt i regjistrimit nëse ajo, apo ndonjë agjent, i punësuar apo përfaqësues që vepron në emër të saj, angazhohet në çfarëdo lloji të aktivitetit tregtar në Kosovë. Me anë të ligjit nuk duhet të

⁴¹ *Id.* Neni 31.

⁴² *Id.* Neni 23.

kërkohej që ajo të regjistrohet në zyrën e regjistrimit nëse aktiviteti tregtar i saj është i kufizuar ekskluzivisht në eksportin e produkteve apo shërbimeve në Kosovë, të cilat janë të importuara nga një konsumator apo blerës i vendosur ose që banon në Kosovë. Për të themeluar një degë, një person i autorizuar i shoqërisë së huaj tregtare duhet të nënshkruajë dhe të dorëzojë një formular standard të aplikimit, “memorandumin e shoqërisë së huaj tregtare”, i cili përfaqëson informatat dhe të dhënat në lidhje me shoqërinë, strukturën e kapitalit dhe qëllimin e kompanisë amë, strukturën dhe qëllimin e degës, certifikatën e regjistrimit të kompanisë amë brenda juridiksionit të themelimit dhe statutin e kompanisë amë.

128. Në rastin e një degë tërësisht në pronësi në Kosovë, atëherë duhet të themelohet një kompani e re sipas dispozitave të legjislacionit të vendit.

129. Regjistri i bizneseve është një regjistër qendror, i cili mirëmban të dhënat e të gjitha kompanive të regjistruara. Regjistri i bizneseve është përgjegjës për: regjistrimin e kompanive të reja; regjistrimin e emërtimeve tregtare; regjistrimin e degëve të kompanive të huaja; pranimin e një kopje të pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve tregtare të Sh.P.P. dhe Sh.A. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-006 që ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, një kopje e pasqyrave financiare duhet po ashtu të dorëzohet në Ministrinë e Financave.

130. Aktualisht, në Regjistër të bizneseve gjithsej janë të regjistruara 122,249 shoqëri. Prej tyre, 108.022 janë NI, 3.461 ShKI, 86 ShKm, 9.540 ShPK, 390 ShA dhe 607 shoqëri të huaja tregtare, 77 kooperativa bujqësore, 23 ndërmarrje shoqërore, 10 ndërmarrje publike, me 33 kompani që janë nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

1.6. Pasqyrë e përgjithshme e strategjisë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Strategjitë dhe prioritetet e LPP/LFT

131. Në nivel të politikave, zhvillimi më i rëndësishëm është ai i një strategjie të LPP/LFT e cila është miratuar në shtator të vitit 2012. Një grup punues ndërmjet agjencive është duke punuar në zbatimin e tyre. Kur të kompletohet dhe nëse kompletohet, ajo do të ketë një ndikim të madh në aftësinë e Kosovës për të organizuar dhe për të informuar veten mbi trajtimin e rreziqeve nga pastrimi i parave, krimi ekonomik dhe financimi i terrorizmit. Në veçanti, Strategjia parashihet themelimin e një zyre kombëtare për ndjekjen e krimeve ekonomike, e cila do të shërbejë si mekanizëm kyç i bashkërenditjes dhe mbikëqyrjes për aktivitetet e të gjithë akterëve të qeverisë në fushën e luftimit të krimit ekonomik, duke përfshirë LPP dhe FT (shih gjithashtu pjesën 6.1 të këtij Raporti).

132. Në shtator të vitit 2012, qeveria e Kosovës ka miratuar katër strategji përkatëse për periudhën 2012-2017, gjegjësisht, Strategjinë kundër krimit të organizuar, Strategjinë kundër drogës, Strategjinë për luftimin e terrorizmit dhe Strategjinë për mbrojtjen e kufijve. Këto katër strategji janë miratuar në mbledhjen e kabinetit të qeverisë, dhe janë sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

133. KPK-ja ka përgatitur dhe e ka miratuar nga një plan strategjik për bashkëpunimin ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Qëllimi kryesor i saj është përmirësimi i bashkëpunimit të sistemit prokurorial me institucionet tjera, në veçanti autoritetet e zbatimit të ligjit (shih gjithashtu pjesën 6.1 të këtij Raporti).

Korniza institucionale për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

134. Ekzistojnë disa institucione të cilat janë të përfshira në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, kompetencat, detyrat dhe korniza ligjore e të cilave është e përmbledhur në vazhdim.

Bordi i përbashkët bashkërendues për sundimit e ligjit

135. Prioritetet në luftën kundër krimit ekonomik diskutohet rregullisht në takimet e Bordit të përbashkët bashkërendues për sundimin e ligjit, i cili bashkërendon politikat dhe nismat kombëtare ndërmjet departamenteve të qeverisë. Ky bord bashkëkryesohet nga zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë H. Kuçi dhe përfaqësuesi i posaçëm i BE-së në Kosovë. Bordi takohet çdo tre muaj dhe procesverbali i takimit u jepet palëve pjesëmarrëse.

Bordi menaxhues i Njësisë së inteligjencës financiare

136. Bordi menaxhues i Njësisë së inteligjencës financiare është themeluar në përputhje me Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Mandati i Bordit është që të mbikëqyrë dhe të sigurojë pavarësinë e NjIF-së. Bordi nuk ka fuqi ekzekutive ose zbatim kundrejt NjIF-së. Bordi menaxhues përbëhet nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, i cili shërben në cilësinë e kryetarit të Bordit, ministri i Punëve të Brendshme, kryeprokurori i Kosovës, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, drejtori i Administratës Tatimore, drejtori i përgjithshëm i Doganave të Kosovës, drejtori menaxhues i Bankës Qendrore të Kosovës (shih gjithashtu pjesën 2.6 të këtij Raporti).

Ministria e Financave

137. Ministria e Financave (MF) bënë formulimin dhe zbatimin e politikave të qeverisë në lidhje me çështjet financiare, tatimore dhe doganore. Detyrat e saj parësore në lidhje me sferën e LPP/LFT përfshijnë përgjegjësinë e plotë për legjislacionin në fushën e LPP/LFT si dhe kryesimin e Bordit menaxhues të Njësisë së inteligjencës financiare. Përmes divizionit të posaçëm në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës, MF-ja gjithashtu bënë edhe licencimin dhe mbikëqyrjen e kompanive private të auditimit, të auditorëve dhe kontabilistëve si dhe të operatorëve të lojërave të fatit përmes divizionit të caktuar të Administratës Tatimore të Kosovës.

138. Ministria ka sponsorizuar hartimin e ligjit të ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 30 shtator 2010. Megjithatë, ky Ligj është kritikuar nga palët e interesuara si Ligj me të meta, duke bërë që Ministria të iniciojë ndryshimin.

Ministria e Drejtësisë

139. Ministria e Drejtësisë është themeluar në vitin 2006 në pajtim me rregulloret e UNMIK-ut 2005/53 dhe 2006/26. Struktura e saj është një bashkim/përzjerje e strukturave nga ministritë e tjera dhe nga struktura e UNMIK-ut. Rregulloret e UNMIK-ut të përmendura më lart kanë përcaktuar mandatin e MD-së. Përveç kësaj, një numër i rregulloreve dhe ligjeve janë nxjerrë para dhe pas shpalljes së pavarësisë, d.m.th. ato që kanë të bëjnë me provimin e jurisprudencës, noterinë, ndërmjetësimin, ndihmën juridike, institutin gjyqësor, si dhe ligjet për gjykatat, prokurorinë, KGJK-në dhe KPK-në, të cilat kanë zgjeruar mandatin ligjor të ministrisë. Ministria ka struktura të ndryshme të cilat në vende të tjera janë të organizuara si agjenci të ndara, d.m.th. shërbimi korrektues dhe provues, mjekësia ligjore, etj.

140. MD-ja është përgjegjëse për zhvillimin e politikave, për lehtësimin, përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e gjyqësisë, duke përfshirë sistemin prokurorial, si dhe për sistemin profesionale të lira juridike, sistemin disiplinor dhe bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar. Në ndërkohë, ligji në mënyrë eksplicite përjashton mundësin që Ministria të

përfshihet në çfarëdo mënyrë në çështjet e lidhura me administrimin e gjyqësorit dhe të gjykatave. Kompetencat për harmonizimin dhe përmirësimin e legjislacionit nuk i takojnë MD-së, por Zyrës së Kryeministrit (zyrës për shërbimet e ndihmës juridike).

141. Ministria është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve mbështetëse për zyrën e Prokurorit Publik të Kosovës për të siguruar funksionimin efektiv të sistemit prokurorial. Në ndërkohë IGJK është përgjegjës për të ofruar trajnimin, duke përfshirë trajnimin profesional, të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe për të organizuar provimet për kualifikimin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, avokatëve (përshirë përfaqësuesit ligjorë) dhe profesionistëve të tjerë juridikë.

142. MD-ja, përmes Departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, kryen përgjegjësitë e saj, përkatësisht bënë hartimin e legjislacionit, mbështet gjyqësorin dhe vepron si një autoritet bashkërendues në bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale, duke përfshirë ndihmën juridike reciproke dhe ekstradimin. Siç u tha më lart MD është gjithashtu përgjegjëse për licencimin dhe mbikëqyrjen e noterëve.

Njësia për inteligjencës financiare

143. Njësia për inteligjencë financiare është themeluar sipas ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Drejtori i NjIF-it emërohet nga bordi menaxhues i Njesisë për inteligjencë financiare dhe të gjitha rolet, përgjegjësitë dhe kompetencat i janë bartur NjIF-it nga ana e EULEX-it me anë të një marrëveshjeje të nënshkruar më 15 korrik 2012. NjIF nuk kryen hetimet e veta, por u siguron inteligjencë/informata organeve të tjera hetuese, të cilat do të përdoren për të filluar ose për të vazhduar hetimet (shih gjithashtu pjesën 2.6 të këtij Raporti).

Policia e Kosovës

144. Policia e Kosovës (PK) është përgjegjëse *ndër të tjera* për të mbajtur rendin dhe qetësinë publike, luftuar krimin e organizuar dhe për të garantuar e integritetin e kufijve. Policia e Kosovës, në kuadër të Departamentit të hetimeve ka themeluar Drejtorinë për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit. SHKEK-u merret me të gjitha llojet e krimeve financiare dhe në kuadër të saj përsihen tri njësi: Njësia e hetimit të korrupsionit, Njësia e hetimit të krimeve financiare dhe Njësia e hetimit të pastrimit të parave (shih gjithashtu pjesën 2.7 të këtij Raporti). Komponenti i policisë së EULEX-it ndihmon PK-në përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit. Zyrtarët policorë të EULEX-it janë të vendosur bashkë me homologët e tyre, megjithatë zyrtarët policorë të EULEX-it kryesisht veprojnë në rol mbështetës, dhe KP-ja bën udhëheqjen operacionale⁴³.

145. Policia e Kosovës mbikëqyret nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB). Strukturat tjera në kuadër të departamentit të hetimeve janë: Drejtoria kundër krimit të organizuar, Drejtoria e analizës së krimeve dhe Drejtoria e shërbimeve të mjekësisë ligjore (forenzikës). Po ashtu ekzistojnë edhe departamenti i kufirit, laboratorit i forenzikës dhe strukturat tjera mbështetëse.

146. Njësia Kundër Terrorizmit (NjKT), dikur në kuadër të Departamentit të hetimeve, ka shpërndarë përgjegjësitë dhe disa nga personeli i saj dhe janë riemëruar në Departamentin Kundër Terrorizmit (DKT). DKT-ja gjithashtu funksionon në nivel të mbledhjes së inteligjencës.

Zyra e Prokurorit të Shtetit

⁴³ www.eulex-kosovo.eu/en/police/

147. Prokurori i Shtetit është një institucion i pavarur kushtetues me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale apo për ndonjë veprë tjetër sikurse është rregulluar me ligj. Zyra e Prokurorit të Shtetit është një sistem i unifikuar i autorizuar që: të iniciojë procedurën penale; të sigurojë hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në kohën e duhur kundër personave të dyshuar ose të akuzuar për kryerjen e veprave penale; të paraqesë paditë para gjyqit; të ushtrojë mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme kundër vendimeve gjyqësore; të mbrojnë të drejtat ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshuarve, dhe personave të akuzuar dhe të dënuar; të bashkëpunojë me policinë, gjykatat dhe institucionet tjera; të ndërmerr të gjitha veprimet tjera të parapara me ligj.

148. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Kosovës me propozim të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit. Kryeprokurori i Shtetit është udhëheqës i prokurorisë së shtetit dhe ka përgjegjësi të përgjithshme për menaxhimin e Prokurorisë së Shtetit dhe për mbikëqyrjen e të gjithë prokurorëve.

149. Prokuroria Speciale (PSRK) në kuadër të Prokurorisë së Shtetit është themeluar në pajtim me Ligjin nr. 2008/03-L-052 për Prokurorinë Speciale, i cili rregullon juridiksionin territorial, fushëveprimin, kompetencat, përbërjen dhe emërimin e Kryeprokurorit të saj. PSRK-ja ka kompetencë të veçantë që të hetojë dhe ndjek penalisht ndër të tjera pastrimin e parave, veprat penale të terrorizmit, krimin e organizuar (neni 5), si dhe kompetencat plotësuese për veprat penale të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit (veprat penale të trafikimit, falsifikimit të parasë, veprat penale të korrupsioni dhe mashtrimit si dhe veprat e tjera të rënda penale).

Doganat e Kosovës

150. Shërbimi Doganor i Kosovës është kompetent për mbledhjen e taksave siç janë taksat doganore, tatimin mbi vlerën e shtuar; kontrollin e importit dhe eksportit, mbrojtjen e të drejtave të pronës intelektuale, dhe sigurimin e statistikave tregtare. Përveç mbledhjes së të ardhurave doganore, Doganat e Kosovës ndërmarrin masa të tjera për të parandaluar kontrabandën e drogës dhe të mallrave të tjera të ndaluara me efekt paragjykes të krimit ekonomik dhe evazionit në të ardhurat.

151. Shërbimi Doganor i UNMIK-ut është themeluar në gusht të vitit 1999 nga Shtylla e BE-së, për të siguruar zbatimin e drejtë dhe unik të rregullave dhe të dispozitave të tjera doganore të aplikueshme për mallrat, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes doganore. Më 12 dhjetor 2008, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut u bë Doganat e Kosovës. Kodi i ri doganor është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 11 nëntor 2008.

152. Prej vitit 2004, Doganat e Kosovës kanë filluar me zbatimin e sistemit për transportimin ndërkuftar të parave dhe të instrumenteve të transferueshme në formë të bartësit. Shërbimi doganor kryen kontrole për kalimin e parave të gatshme në kufi. Qytetarët dorëzojnë një formular standard të plotësuar të përcaktuar nga dogana, me të cilin sigurojnë informata për çdo shumë të transferuar mbi 10.000 euro. Të dhënat e mbledhura regjistrohen dhe i dërgohen NjIF-it. Doganat janë gjithashtu subjekt i ligjit për LPP/LFT dhe bashkëpunojnë me NjIF-in dhe autoritetet tjera të zbatimit të ligjit.

Administrata Tatimore e Kosovës

153. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është themeluar në 17 janar 2000 nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK-ut. Drejtor i parë i ATK-së ishte ndërkombëtar i punësuar nga një kontraktues i USAID-it. Nga tetori i vitit 2001 deri në shkurt të vitit 2003, ishin dy bashkëdrejtore në ATK, njëri nga USAID-i dhe tjetri vendor që ndanin rolin e

drejtorit. Me 18 shkurt 2003, autoriteti për administratën tatimore u bart nga UNMIK-u te Ministria e Financave (ish-Ministria e Ekonomisë dhe Financave) dhe drejtori vendor mori detyrat e drejtorit të ATK-së.

154. ATK-ja ka një qendër të centralizuar të përpunimit të dokumenteve, përmes të cilës përpunohen të gjitha deklaratat, ndonëse përpunimi i TVSh-së është decentralizuar me qëllim të lehtësimit të intervenimit të përmbushjes së menjëhershme. Është krijuar Njësia për tatimpaguesit e mëdhenj që të merret me tatimpaguesit e mëdhenj në Kosovë.

155. Administrata Tatimore bashkëpunon ngushtë me doganën, policinë, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, shërbimet e prokurorisë, entin statistikor dhe me NjIF-in.

156. ATK është përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e lojërave të fatit në Kosovë (në kuadër të saj ekziston Divizioni i lojërave të fatit). Ajo mbikëqyrë dhe menaxhon procesin e regjistrimit organizatorëve të sistemit të ndërlidhur, laboratorit të pavarur të kontraktuar për testimin e automateve dhe punonjësit e lojërave të fatit. Në përputhje me ligjin, ATK-ja bënë gjithashtu lëshimin dhe menaxhimin e procesit të licencimit të operatorëve të lojërave të fatit. ATK-ja ka të drejtë *ndër të tjera* të mbikëqyrë dhe të kontrollojë veprimtaritë e subjekteve të cilat organizojnë lojëra të fatit në Kosovë, të vendos për shumën e gjobave në rast të një shkeljeje, të kontrollojë dhe të verifikojë certifikimin e pajisjeve të lojërave të fatit, të mirëmbajë regjistrin e subjekteve në këtë sektor, të përcaktojë listën e personave të cilët janë të përjashtuar nga lokalet e lojërave të fatit, të detyrojë mbylljen e subjekteve të cilat funksionojnë pa licencë dhe/ose të konfiskojë të gjitha pajisjet shoqëruese.

157. Në kryerjen e detyrave të saj, ATK-ja bashkëpunon me institucionet e tjera, veçanërisht me Policinë e Kosovës, Doganën, shërbimin e prokurorisë dhe me NjIF-in.

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

158. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) është themeluar në pajtim me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (Ligji nr. 03/L-063) si një agjenci për siguri dhe inteligjencë në Kosovë. Ajo ka personalitet juridik dhe ka mandat për të vepruar në tërë territorin e Kosovës. Mjetet financiare për veprimtarinë e AKI-së sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. AKI mbledhë informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës, d.m.th. nga terrorizmi, krimi i organizuar, trafikimi, etj. AKI nuk ka kompetenca ekzekutive.

159. Emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të AKI-së e bëjnë së bashku Presidenti dhe Kryeministri. Drejtori mund të ketë një zëvendës drejtor, dhe Presidenti dhe Kryeministri bëjnë emërimin e një Inspektori të Përgjithshëm për AKI-në, i cili ka mandat të kryejë inspektimin e veprimtarive të AKI-së⁴⁴.

Banka Qendrore e Kosovës

160. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është mbikëqyrëse dhe rregullatore e institucioneve financiare në Kosovë. Banka Qendrore e Kosovës është pasardhëse e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (ABPK) prej vitit 1999 dhe e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës (AQBK) prej vitit 2006, dhe është themeluar në qershor të vitit 2008 me miratimin nga ana e Kuvendit të Kosovës të Ligjit nr. 03/L-074 për “Bankën Qendrore të Kosovës”.

⁴⁴ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (Ligji nr. 03/L-063).

http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=150&Itemid=56&lang=en

161. Sipas ligjit në fuqi në Kosovë, BQK-ja është një organ juridik i pavarur me autoritet të plotë të një personi juridik, dhe i raporton Kuvendit të Kosovës.

162. BQK-ja mbikëqyrë dhe siguron përputhshmërinë me LPP/LFT të bankave, institucioneve mikrofinanciare, institucioneve financiare jobankare (duke përfshirë këmbimoret e huaja dhe agjencitë e transferit të parave) të kompanive të sigurimit, фондеве, tregjeve dhe operatorëve privat pensional dhe të veprimtarive të tjera financiare jobankare (shih gjithashtu analizën e Rekomandimit 23 dhe Rekomandimit 29 në këtë Raport).

Oda e Avokatëve të Kosovës

163. Oda e Avokatëve të Kosovë (OAK) është një organizatë vetëqeverisëse e avokatëve të Kosovës, e cila vepron e pavarur nga organet e shtetit. Është përgjegjëse për rregullimin dhe kontrollin e profesionit të juristit në Kosovë.

164. OAK-u është përgjegjës për të monitoruar pajtueshmërinë me ligjin, statutin e OAK-ut dhe Kodin e etikës profesionale të avokatëve dhe, kur është e aplikueshme, të shqiptojë sanksione disiplinore. Në rregullimin dhe kontrollin e profesionit të avokatit, OAK-u mund të nxjerrë akte normative me qëllim të rregullimit dhe organizimit të avokaturës. OAK-u po ashtu përcakton masat për trajnim të vazhdueshëm profesional për avokatët. OAK-u është i organizuar në shtatë degë.

165. OAK-u është autoritet i vetëm për licencimin e avokatëve në Kosovë si një pjesë integrale e sistemit të drejtësisë. Para konfliktit në vitin 1999, OAK-u ka pasur rreth 600 anëtarë. Pas vendosjes së misionit të KB-ve në Kosovë, ajo ka pasur 106 anëtarë dhe ky numër është rritur në vitin 2001, 2004 dhe 2007 si dhe 2011. Në vitin 2011, OAK-u ka pasur 603 avokatë të licencuar, të cilët kaluan me sukses provimin e jurisprudencës që është një parakusht për t'u bërë anëtar i OAK-ut.⁴⁵

166. OAK-u është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat e LPP/LFT në profesionin juridik, mirëpo nuk ndërmeret ekzaminime të LPP/LFT.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK)

167. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK) është themeluar në qershor të vitit 2010 si një organ në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, pas miratimit të Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar (Ligji nr. 03/L-141). Mandati i AAPSK-së është plotësisht administrativ dhe përveç tjerash përfshinë përgjegjësitë: menaxhimin, administrimin, dhe/ose shitjen e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar. Struktura funksionale dhe organizative e Agjencisë rregullohet me akt ë veçantë nënligjor, të cilin e nxjerr Ministria e Drejtësisë.

168. Agjencia ushtron veprimtarinë e vetë në bashkëpunim me institucionet e tjera të përfshira në procesin e administrimit të pasurisë së sekuestruar/konfiskuar, siç janë gjykatat, zyra e prokurorit, bankat, komunat si dhe zyrat komunale të kadastrës.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

169. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është përgjegjëse për themelimin dhe mbikëqyrjen e zyrës së regjistrimit të shoqërive tregtare dhe emrave tregtar. Ky funksion sigurohet prej vitit 2011 përmes Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) – ish zyra e regjistrimit – e cila është në kuadër të MTI-së në pajtim me kërkesat e Ligjit nr.

⁴⁵ <http://www.oak-ks.org/historiku-78-0-1>

02/L-123 për shoqëritë tregtare. ARBK-ja në përputhje me ligjin mirëmban regjistrin, krijon dhe publikon formularë dhe procedura përkatëse për funksionet në regjistrin, si dhe siguron regjistrimin, publikimin dhe qasjen pa pagesë përmes internetit në të dhënat e regjistrin. Të gjitha të dhënat, dokumentet, formularët, rregullat dhe materialet e tjera të kërkuara me ligj të cilat i janë dorëzuar zyrës së regjistrimit ose që janë përgatitur nga ARBK-ja në zyrën e regjistrin janë dokumente publike (shih gjithashtu pjesën 4 të këtij Raporti).

Agjencia Kadastrale e Kosovës

170. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) u themeluar nga UN-Habitati në vitin 2000, është agjenci qeveritare nën Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. AKK-ja është autoriteti më i lartë për kadastrën, gjeodezi dhe hartografi në Kosovë, ndërsa Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK) funksionojnë në nivel komunal. AKK-ja dhe ZKK-të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me Ligjin nr. 04/L-013 për kadastrën dhe Ligjin nr. 2002/5 për themelimin e regjistrin të të drejtave të pronës së paluajtshme.

171. Tani, AKK është duke zbatuar sistemin informativ për tokë dhe kadastrë si dhe regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme në Kosovë.

172. Në këtë kontekst, Agjencia Kadastrale e Kosovës është themeluar gjatë Programit Përkrahës për Kadastrën e Kosovës-PPKK (2000-2003), e ndihmuar financiarisht nga Suedia, Norvegjia dhe Zvicra. Qëllimi kryesor i PPKK-së ka qenë zhvillimi dhe menaxhimi i regjistrimit të kadastrës dhe të tokës në nivelin qendror⁴⁶.

EULEX – Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (shih gjithashtu pjesën 1.1)

173. EULEX-i e ka arritur funksionalitetin e plotë në prill të vitit 2009. Veprimi i përbashkët i BE-së i muajit shkurt 2008 dhe vendimi i Këshillit i muajit qershor të vitit 2010 e paraqesin bazën ligjore për këtë mision. EULEX-i punon në kuadër të kornizës së Rezolutës 1244 të OKB-ës.

174. Misioni është i ndarë në dy 'sektorë': 'Sektori ekzekutiv' dhe 'Sektori i fuqizimit'. Sektori ekzekutiv heton, ndjek penalisht dhe gjykon raste të ndjeshme, duke i përdorur funksionet e tij ekzekutive. Sektori i fuqizimit i monitoron, udhëzon dhe këshillon kolegët vendas në fushën e policisë, drejtësisë dhe doganës. EULEX-i ka rreth 2.250 të punësuar ndërkombëtarë dhe vendas.

175. Mandati dhe kompetencat e prokurorëve dhe të gjyqtarëve të EULEX-it janë të rregulluara përmes Ligjit nr. 2008/03-L053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Sipas këtij Ligji, prokurorët e EULEX-it janë kompetent për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë kompetencë e veçantë e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK).

Qasja në lidhje me rrezikun

176. Autoritetet e Kosovës nuk kanë zbatuar një qasje të bazuar në rrezik në lidhje me ndonjë komponentë të regjimit LPP/LFT.

⁴⁶ <http://mmpk.rks-gov.net/?cid=2,54,194>

2. SISTEMI LIGJOR DHE MASAT E NDËRLIDHURA INSTITUCIONALE

2.1. Ndëshkimi i pastrimit të parave (R.1)

2.1.1. Përshkrimi dhe analiza

Ndëshkimi i pastrimit të parave – elementet fizike dhe materiale të veprës (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.1)

177. Në ligjin penal të aplikueshëm në territorin e Kosovës, qoftë ai legjislacionin i lëshuar me anë të një rregulloreje të UNMIK-ut apo i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, vepra penale e PP-së gjithnjë është paraparë ndaras nga organi i kodit penal përkatës, duke u përcaktuar në mënyrë të veçantë në legjislacionin parandalues LPP/LFT. PP-ja së pari është përshkruar si një vepër penale në nenin 10.2 deri 10.4 të rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, e cila ishte në fuqi prej muajit mars 2004 deri në nëntor të vitit 2010. Kjo Rregullore e UNMIK-ut është zëvendësuar me ligjin nr. 03/L-196 (2010) për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (më tej – Ligji LPP/LFT) i cili prej ditës që është miratuar parasheh ndëshkimin e PP në nenet e tij 32.2 deri 32.4 në mënyrë të ngjashme, nëse jo identike, me përkufizimin e paraparë me rregulloret e UNMIK-ut (përmirësimi kryesor është shtimi i dy paragrafëve të reja që mbulojnë faktorë të ndryshëm të fshehjes/maskimit dhe të veprave ndihmëse të zbatueshme për PP).

178. Fakti që vepra penale e PP është përcaktuar në legjislacionin parandalues duhet të njihet si një traditë juridike në Kosovë, e cila në vetvete nuk mund të konsiderohet si mangësi përderisa vendndodhja e veprës penale të PP nuk shkakton asnjë vështirësi për praktikuesit në zbatimin e dispozitave tjera të përgjithshme të legjislacionit penal ose procedural në lidhje me këtë vepër të veçantë penale. Në këtë aspekt, tendenca e saj është pozitive.

179. Në fillim, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/2 për luftimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të ndërlidhura, paraardhës i ligjit aktual mbi LPP/LFT, përmbante një gamë të veçantë të dispozitave mbi masat e përkohshme dhe të konfiskimit në lidhje me PP (neni 11 deri 12) pavarësisht ekzistimit të dispozitave të ngjashme në Kodin e Përkohshëm Penal (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25, më tej - KPP) dhe në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26, më tej – KPPP) që ishin në fuqi atëherë. Nga kjo qasje e dyfishtë u hoq dorë me Ligjin e ri LPP/LFT, i cili më nuk parasheh konfiskimin dhe masat e përkohshme pasi që ato mund të gjenden në kodet përkatëse. (Nga ana tjetër, neni 34 i ligjit LPP/LFT parasheh ende në mënyrë të veçantë përgjegjësinë penale të personave juridikë për veprën penale të PP edhe pse kjo çështje është rregulluar në kuptimin e përgjithshëm me anë të ligjit nr. 04/L-030 (2011) për përgjegjësinë e personave juridikë për veprat penale.)

180. Përfundimisht, vepra penale e PP është përfshirë formalisht në mesin e veprave të tjera penale “të zakonshme” të renditura në pjesën e veçantë në Kodin e ri Penal (Ligji nr. 04/L-082 (2012) i cili është në fuqi nga 1 janari 2013, më tej – KP). Si rezultat, vepra penale e PP zyrtarisht ndëshkohet me nenin 308 në kuadër të kapitullit XXV të Kodit Penal (veprat penale kundër ekonomisë) mirëpo ky nen parasheh vetëm që “*kushdo që kryen vepër penale të pastrimit të parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*” dhe kështu përkufizimi aktual i veprës penale PP si dhe i sanksioneve penale të zbatueshme nga kjo vazhdojnë të jenë të rregulluara ekskluzivisht me Ligjin LPP/LFT.

181. Ndërsa legjislacioni penal për luftimin e pastrimit të parave ka qenë gjithmonë në përputhje me formulimin e Konventës së Vjenës dhe të Palermos, ky standard është ndjekur

edhe më për së afërmi që prej miratimit të Ligjit të ri LPP/LFT në të cilin vepra penale e PP mund të gjendet në nenin 32.2 si në vazhdim:

“Pastrimi i parave

2. Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale apo kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës:

2.1. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;

2.2. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij/saj;

2.3. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të shmangies së detyrimit të Raportimit sipas këtij ligji;

2.4. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal; apo

2.5. merr, posedon ose shfrytëzon apo përpiqet të marrë, të posedojë ose të shfrytëzojë pasurinë;

2.6. fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;

2.7. merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 2.1. deri në 2.6. të këtij paragrafi;

2.8. kryen veprë penale të dënueshme me një afat burgosjeje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale.”

182. Në krahasim me përkufizimin e veprës penale në Rregulloren e UNMIK-ut, zhvillimi kryesor ishte shtimi i paragrafëve të mësipërm 2.6 dhe 2.7, si rezultat i të cilëve vepra penale e PP tani reflekton më shumë nga struktura dhe terminologjia e brendshme e modelit të veprës penale të PP, siç është përcaktuar në nenin 6(1) të Konventës së Palermos. Llojet kryesore të veprimtarive të shpëlarjes të renditura në nënparagrafët (a/i) (a/ii) dhe (b/i) të nenit 6(1) të Konventës së Palermos janë të trajtuara dhe të mbuluara në mënyrë adekuate me paragrafët në vazhdim të nenit të mësipërm 32.2:

- nënparagrafi (a/i) plotësohet me paragrafët 2.1 dhe 2.2

- nënparagrafi (a/ii) plotësohet me paragrafin 2.6

- ndërsa nënparagrafi (b/i) plotësohet me paragrafin 2.5.

183. Këta paragrafë paraqesin nivel të konsiderueshëm të ngjashmërisë me formulimin e Konventës që, në disa gjëra, rezultojnë në identitetin e plotë, në veçanti kur ka të bëjë me vet sjelljet (pra, aktivitetet që mund të përbëjnë veprën e pastrimit të parave). Ky aspekt i elementeve materiale (fizike) i veprës penale në mënyrë adekuate reflekton kërkesat ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 6(1) të Konventës së Palermos, si dhe në nenin 3(1) nënparagrafi (b) dhe (c) i Konventës së Vjenës.

184. Përveç kësaj, prapëseprapë, vepra penale e PP në nenin 32.3 përmban një numër të dispozitave të cilat me sa duket shkojnë përtej fushëveprimit të përcaktuar nga Konventat e përmendura më lart. Sigurisht, në kushte të përgjithshme, nuk do të duhej të duhej të paraqitej ndonjë vërejtje nëse legjislacioni kombëtar tejkalon minimumin e kërkesave gjatë zbatimit të standardeve ndërkombëtare, përderisa këto dispozita shtesë nuk kanë ndikim negativ në pajtueshmërinë me vet standardet.

185. E para nga këto dispozita mund të gjendet në paragrafin 2.3, ku parashihet dënimi për konvertimin ose transferimin (e kompletuar ose të tentuar) e të ardhurave nga krimi në mënyrë specifike *“me qëllim të shmangies së detyrimit të Raportimit sipas këtij Ligji”*. Përtej çdo dyshimi ky është një lloj i veçantë i veprës penale të PP, në të cilën elementi specifik mendor është i formuluar mjaft qartë por, në anën tjetër, zbatimi aktual i kësaj dispozite mund të jetë më problematik.

186. Në ligjin LPP/LFT, rregullat themelore të detyrimit për të raportuar në NjIF mund të gjenden në nenin 22 (në lidhje me bankat dhe institucionet financiare). Detyrimi për të raportuar mund të lind të rast të ndonjë akti ose transaksioni (paragrafi 1.1.) apo të transaksioneve me para të gatshme në vlerë prej 10.000 euro ose më shumë në një ditë të vetme (paragrafi 1.2). Megjithatë, vepra penale në nenin e mësipërm 32 paragrafin 2.3, nuk specifikon se cili lloj i detyrimit për të raportuar është i rëndësishëm në këtë kontekst. Në qoftë se i referohet detyrimit për të raportuar transaksionet e dyshimta, vepra penale domosdoshmërisht do të përputhet me atë në paragrafin 2.1 duke pas parasysh se në këtë rast, konvertimi ose transferimi do të shërbej për të fshehur apo maskuar natyrën e vërtetë (gjegjësisht atë të dyshimtë) të pronës së përfshirë në transaksion. Në qoftë se i referohet shmangies së Raportimit të transaksioneve të parave të gatshme në shkallë të gjerë (p.sh.: me kryerjen e transferimit të parave të gatshme përmes disa transaksioneve që janë nën pragun e caktuar ose në afat kohor prej më shumë se një dite për të shmangur përmbledhjen ditore të shumave të transferuara), kjo po ashtu do të na sjell mbrapa tek vepra penale në paragrafin 2.1 dhe transaksionet si të tilla do të shërbejnë për të fshehur ose maskuar lokacionin, renditjen ose lëvizjen përveç, eventualisht, natyrës së pandershme të pronës përkatëse. Kjo është arsyeja pse vepra penale në paragrafin 2.3 duket e tepërt.

187. “Ekstra” vepra e dytë penale e PP është paraparë me paragrafin 2.4 përmes të cilit (tentim) shndërrimi ose bartja e të ardhurave nga krimi është i dënueshëm po ashtu nëse është kryer *“me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal”*. Në fakt, një veprim i tillë nuk duhet të klasifikohet si vepër penale e PP, e cila normalisht përbëhet nga legalizimi i të ardhurave që rrjedhin nga një vepër penale e ndërlidhur e cila është kryer më parë (pra kryerja e saj mund të rezultojë me përfitim material që përbën të ardhura nga krimi). Me fjalë të tjera, vepra penale e ndërlidhur duhet të jetë kryer dhe përfunduar para se bëhet veprimtaria e shpëlarjes. Pasi vepra penale tashmë të jetë kryer, ajo nuk mundet më tej të “promovohet” nga një veprimtari pasuese e pastrimit të parave.

188. Pavarësisht kësaj, në të vërtetë mund të ketë raste ku nuk është vetëm një vepër penale, por një aktivitet i vazhdueshëm kriminal, të ardhurat e të cilit do të shpërlahen kështu që pasuria e legalizuar mund të përdoret për të ndihmuar veprimtarinë kriminale. Edhe në raste të tilla, megjithatë, qëllimi kryesor i veprimtarisë së shpëlarjes duhet të jetë legalizimi i të ardhurave, d.m.th. fshehja ose maskimi i origjinës, natyrës ose burimit të tyre të pandershëm – i cili, përsëri, shpie tek vepra penale në paragrafin 2.1

189. Një tjetër karakteristikë specifike e veprës penale të PP në nenin 32.2 është referenca e shpeshtë tek “masat e fshehta” gjegjësisht tek zgjerimi eksplicit i veprës penale të PP në veprimtarinë e kryera ose të tentuara të shpëlarjes si rezultat i masave të fshehta ku asetet subjekt i pastrimit nuk ishin të ardhura nga krimi dhe kështu është vetëm kryesi i cili beson (ose është detyruar të besoj) se asetet janë përfituar nga një vepër kriminale. Referenca në raste të tilla mund të gjendet në pjesën fillestare të paragrafit 2 (...”*apo kushdo që, duke*

besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës”) si dhe në paragrafin 2.2 (“...me qëllim të ndihmës së personit i cili është (...) siç pandehet i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e (...) pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij/saj”).

190. Në mënyrë të qartë kjo çështje shkon përtej asaj çfarë kërkohet më standardet përkatëse të LPP që përbën fushëveprimin e vlerësimit aktual dhe për këtë arsye nuk është domosdoshmërisht subjekt i vlerësimit. Megjithatë, ekipi vlerësues duhet të theksoj se nënra 32.2 *per definitionem* është dispozitë e të drejtës materiale penale (që përcakton bazën e përgjegjësisë penale) referimi te masat e fshehta e përzien atë me komponentin e të drejtës së procedurës penale i cili mund të jetë, nga aspekti i dogmatikës juridike, një kombinim fatkeq. Përtej faktit që në mënyrë të saktë nuk është bërë e qartë se në cilin lloj të masave të fshehta të renditur në kapitullin XXIX të KPPP-së është menduar (vetëm disa prej tyre duket të jenë të zbatueshme në këtë kontekst) nuk është e qartë përse vepra penale e PP është e vetmja ku mund të gjendet një referim i drejtpërdrejtë i përfaqësimeve të bëra si pjesë e masave të fshehta përderisa përfaqësimet e (si rezultat i të cilës kryesi disi do të mund të mashtrohet nga autoritetet) mund të bëhet gjithashtu edhe në lidhje me veprat e tjera penale (referenca mund të bëhet, për shembull, për masat e fshehta “stimulim i veprës së korrupsionit” të përcaktuar në nenin 256.8 të KPPP ose 87.9 në KPP). Ekipi vlerësues është i mendimit se masat e fshehta mund të rregullohen në mënyrë ideale ekskluzivisht në legjislacionin e procedurës penale, megjithatë, siç u përmend më lart, kjo çështje nuk ka ndikim në rezultatin e vlerësimit aktual.

191. Duhet të theksohet se ligji LPP/LFT parasheh, për arsye të panjohura për ekipin vlerësues, dy përkufizime alternative për shpëlarjen e parave. E para është vetë vepra penale në nenin 32.2, për të cilin është diskutuar në hollësi më lart, por është edhe një në nenin 2 (“Përkufizimet”) nën paragrafin 1.23 si në vazhdim:

“1.23. Shpëlarje e parave – çdo veprim me synim maskimin e origjinës së parave ose pronës tjetër të fituara nga ndonjë vepër penale, ku përfshihen:

1.23.1. konvertimi ose çdo transferimi i parave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal;

1.23.2. fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendit, lëvizjes, rregullimit, të drejtave, ose pronësisë në lidhje me paratë ose pronën tjetër të fituara nga aktiviteti kriminal.”

192. Ekipi vlerësues nuk ka mundur të gjejë arsyen përse ligjvënësit e konsideruan të nevojshme për të futur të dy përkufizimet për “shpëlarje të parave” në të njëjtin ligj. Ndodhë që në juridiksionet e tjera ndonëse vepra e PP (si bazë e përgjegjësisë penale) është e përcaktuar në legjislacionin penal (në mënyrë tipike në KP), një përkufizim tjetër për PP mund të gjendet në legjislacionin parandalues, i cili shërben për qëllime të regjimit (Raportimit) parandalues (çfarë është për t’u raportuar, etj.) dhe në të vërtetë, në shumë raste përkufizimi i fundit është më shumë në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare se vetë vepra.

193. Kjo nuk ndodh në Kosovë. Këtu, ekzistojnë dy përkufizime për PP në të njëjtin legjislacion parandalues – dhe ndonëse mund të supozohet se përkufizimi në nenin 2.1.23 shërben për qëllime të raportimit të transaksioneve të dyshimta, njeriu nuk mund të jetë i sigurt në lidhje me këtë duke marrë parasysh, se ky përkufizim dhe ai tjetri në nenin 32.2 janë të emërtuar njëjtë si “shpëlarje e parave” pa ndonjë dispozitë të veçantë se cila do të duhej përdorur dhe në cilat rrethana. Përveç kësaj, përkufizimi në nenin 2.1.23 nuk është i plotë ose është i mangët krahasuar me veprën penale të PP në nenin 32.2 si në aspektin e elementit të qëllimshëm ashtu edhe në atë të kryerjes. Aplikimi i “përkufizimit të dyfishtë” ka qenë gjithmonë pikë e kritikave në secilin vend të përfshirë dhe kjo i referohet në veçanti këtij rasti ku fushëveprimi i përkufizimit “shtesë” është dukshëm më i kufizuar se sa ai i veprës penale të PP.

Prona e shpërlarë (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.2, CETS 198 neni 9(6))

194. Duke u kthyer në qëllimin e veprës penale të PP, që është, pasuria e cila përfaqëson të ardhurat nga krimi, Ligji LPP/LFT parashihet përkufizim të hollësishëm në lidhje me “të ardhurat nga vepra penale” dhe “pronën ose mjetet financiare” në nenin 2 paragrafi 1.29, përkatësisht 1.30.

195. Në përputhje me këtë përkufizim “të ardhurat nga krimi” do të thotë “*çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale*” (ku “vepra e ndërlidhur penale” është përcaktuar me paragrafin 1.28 disi e tepruar si “*çdo vepër penale e cila gjeneron të ardhura nga vepra penale*”). Sa i përket fushëveprimit të “pronës” është dhënë një përkufizim i gjerë dhe i detajuar me paragrafin 1.30 në vazhdim:

“1.30. Pronë ose mjete financiare – çfarëdo lloj pasurie, materiale ose jomateriale, të luajtshme ose të paluajtshme dhe dokumente ose instrumente ligjore të çdo lloji, duke përfshirë ato elektronike ose digjitale, të cilat dëshmojnë të drejtën ose interesin në një pasuri të tillë, duke përfshirë në mes të tjerash, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, mandapostat, aksionet, letrat me vlerë, çeqet dhe letrat akreditive si dhe çdo interes, dividendë ose të hyra të tjera apo vlera të cilat shtohen ose rrjedhin nga një pasuri e tillë;”

196. Përkufizimi i “pronës” duket të jetë plotësisht në përputhje me standardet e përcaktuara nga Konventat përkatëse të KB-së (neni 2(d) i Konventës së Palermos dhe neni 1(q) i Konventës së Vjenës) me vetëm një, më tepër si dallim formal që nuk përfshinë tiparet “e prekshme ose të paprekshme”. Kjo mungesë, megjithatë, nuk mund të konsiderohet si një e metë që do të kufizonte zbatueshmërinë e përkufizimit, duke marrë parasysh se referenca është thënë me një shprehje shumë të ngjashme “materiale ose jomateriale” qëllimi i së cilës plotëson (ose së paku e mbulon deri në një masë) qëllimin “e prekshme ose të paprekshme” dhe kështu efekti i njëjtë mund të arrihet. (Natyrisht, Konventat japin referimin e të dy tipareve “materiale/jomateriale” dhe “të prekshme/paprekshme” në përkufizimet përkatëse megjithatë nuk duhet të harrohet të kuptuarit aktual të këtyre shprehjeve ku shprehja “e prekshme” është praktikisht e njëjtë me atë “materiale”.) Për më tepër, përkufizimi në paragrafin 1.30 përgjithësisht i referohet “*çfarëdo lloj pasurie*” dhe përmban një listë të shembujve të pasurisë së paprekshme.

197. Në bazë të paragrafit 1.29 siç u tha më lart, shprehja “të ardhurat nga krimi” i referohet pronës që rrjedhë “*nga vepra e ndërlidhur penale*” në të cilin kontekst shprehja “vepër penale” padyshim duhet të zbatohet për të treguar një akt konkret të dënueshëm me ligjin penal i cili është kryer në kohën dhe vendin e caktuar. Më fjalë të tjera, duhet të ekzistojë një vepër penale specifike me të cilën është gjeneruar pasuria (vepra e ndërlidhur penale) dhe ndjekja penale duhet të dëshmojë lidhjen ndërmjet kësaj vepre dhe veprës përkatëse të PP.

198. Pavarësisht nga kjo, çështja e kriminalitetit të ndërlidhur është vënë në një kontekst të ndryshëm nga paragrafi paraprak i veprës penale të PP në nenin 32.2, i cili përcakton objektin e veprës duke bërë referencë në të dijeninë se “*pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale*”. Pjesa e dytë e kësaj fjalie (që i referohet pasurisë e cila është “në fakt” e ardhur nga krimi) vetvetiu do të ishte plotësisht në përputhje me përkufizimet që u diskutuan më lart, mirëpo pjesa e parë (që i referohet pasurisë e cila është e ardhur “*nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal*”) prish logjikën e brendshme dhe harmoninë e dispozitës. Ndërsa pjesa e parë e fjalisë hapë veprën penale të PP drejt të ardhurave që burojnë nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal pa ndonjë nevojë të dukshme për të specifikuar saktësisht se cila vepër penale është burim i të ardhurave (meqë kjo do të mjaftonte për të dëshmuar se pasuria e shpërlarë buron nga “krimi i drogës”

ose “trafikimi” në përgjithësi, pavarësisht nëse ndonjë akt specifik kriminal mund të identifikohet brenda këtij “aktiviteti” dhe nëse po, kur dhe ku është kryer kjo veprë e ndërlidhur) kjo qasje gjithëpërfshirëse është në kundërshtim me pjesën e dytë të fjalisë ku qëllimi i veprës penale është i kufizuar qartë në “të ardhurat nga krimi” e cila shprehje nënkupton, me anë të nenit 2 paragrafit 1.28 të përmendur më lart, pasurinë që buron nga një veprë e ndërlidhur penale.

199. Në këtë kontekst, të referuarit në “ndonjë formë të aktivitetit kriminal” në nenin 32.2 është plotësisht kundërtë dhe çorientues. Me sa duket, kjo mangësi tashmë është identifikuar edhe nga autoritetet e Kosovës. Në versionin e fundit të ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit LPP/LFT⁴⁷ kjo çështje është trajtuar përmes futjes së paragrafit të ri 1.40 deri 1.42 për të paraparë përkufizimin për “aktivitetit kriminal” i cili nuk është përcaktuar në mënyrën e duhur në ligj. Sipas kësaj projekt dispozite “aktivitetit kriminal” nënkupton “*çdo lloj përfshirjeje kriminale në kryerjen e një vepre penale, siç përcaktohet në bazë të ligjeve të Kosovës*”. Sigurisht, një shpjegim i tillë do të eliminonte vetkontradiktën e dukshme brenda paragrafit paraprak të nenin 32.2 meqë të dy pjesët e fjalisë problematike eventualisht do t’i referoheshin konceptit të “veprës penale” (dhe jo nocionit më të përgjithshëm të “aktivitetit kriminal”).

200. Nga ana tjetër, futja e një përkufizimi të tillë padyshim do të shpinte në tepricë. Me fjalë të tjera, pjesa paraprake e nenit 32.2 do të mbulonte

- (i) pasurinë e cila është e ardhur e ndonjë forme të [aktivitetit kriminal]
 - = pasurinë e cila është e ardhur e ndonjë forme të [çdo lloj përfshirjeje kriminale në kryerjen e një vepre penale]
 - = pasurinë e cila është e ardhur e çdo lloj përfshirjeje kriminale në kryerjen e një vepre penale
 - = pasurinë e cila është e ardhur e një vepre kriminale
- (ii) pasurinë e cila është në fakt [e ardhur e krimit]
 - = pasurinë e cila është në fakt [çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale]
 - = pasurinë e cila është në fakt e ardhur nga vepra e ndërlidhur kriminale
 - = pasurinë e cila është e ardhur e një vepre kriminale

201. Si përfundim, mund të konkludohet se objekt i PP mund të jetë çdo pasuri (siç përcaktohet me anë të paragrafit 1.30), e cila buron nga kryerja e një apo më shumë veprave penale konkrete, duke përfshirë çdo lloj të veprave penale të cilat mund të gjenerojnë të ardhura, por jo të një koncepti më të gjerë të “aktivitetit kriminal” në kushte të kriminalitetit të pacaktuar (krimet e drogës, krimet e trafikimit, etj., në përgjithësi). Asnjë dënim nuk duket i mundshëm për PP në rastet kur është provuar se pasuria e cila përbën objektin e PP ka origjinën nga vepra e ndërlidhur penale, por nuk mund të përcaktohet saktësisht se cila veprë (CETS 198 neni 9 (6)).

202. Përkufizimi i të ardhurave nga krimi në paragrafin 1.29, të dhënë në vazhdim, në mënyrë të qartë përfshinë të dy të ardhurat, direkte dhe indirekte:

“(…) Pasuria e fituar në mënyrë indirekte nga vepra e ndërlidhur penale përfshin pasurinë në të cilën më vonë është konvertuar, transformuar ose ngatërruar çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale;”

⁴⁷ Ligji përmes të cilit ndryshohet dhe plotësohet Ligji nr. 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit (Ligji nr. 04/L-178) është miratuar me 11 shkurt 2013. Neni 2.1.40 është miratuar ashtu siç citohet këtu.

203. Asnjë prag/kufi monetar nuk është specifikuar me anë të përkufizimit të “të ardhurave nga krimi” dhe kështu çdo pasuri mund të jetë subjekt i veprës penale të PP pavarësisht vlerës së saj. Ekipit vlerësues nuk i është bërë me dije për ndonjë praktikë të kundërt në rastet konkrete të PP.

Të provuarit se pasuria është e ardhur nga krimi (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.2.1, CETS 198 neni 9(5))

204. Ekipi vlerësues ka vërejtur një pasiguri të përgjithshme në mesin e praktikuesve në lidhje me nivelin e provës së veprës së ndërlidhur penale, siç kërkohet për të provuar nëse në të vërtetë pasuria është e ardhur nga krimi, gjegjësisht nëse kryerja e një vepre specifike të ndërlidhur është provuar dhe nëse po, nëse është i nevojshëm apo jo dënimi paraprak për krimin e ndërlidhur. Pavarësisht përpjekjeve të ligjberësve për të zgjidhur këtë çështje në ligjin pozitiv, dispozitat ekzistuese deri më tani ishin të pamjaftueshme për të eliminuar këtë kundërthënie.

205. Prapavija ligjore përbëhet nga neni 32 paragrafi 4.1 i Ligjit LPP/LFT, ku parashihet se:

“(…) personi mund të dënohet për veprë penale të pastrimit të parave madje edhe nëse nuk ka qenë i dënuar asnjëherë për veprë të ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale”

206. Ndërsa disa nga autoritetet me të cilat u takua ekipi vlerësues (përfaqësuesi i policisë dhe i Ministrisë së Drejtësisë) ishin të bindur se dispozita e cituar më lart e bënë të panevojshme për të siguruar dënimin paraprak ose të njëkohshëm për veprën e ndërlidhur penale me qëllim për të provuar se pasuria është e ardhur nga krimi, prokurorët duket se kanë një mendim krejtësisht të kundërt. Përgjigjet e dhëna në pyetësor nga Prokuroria e Shtetit si dhe deklaratat e përfaqësuesve të Prokurorisë Speciale të dhëna me gojë gjatë vizitës në terren përmbajnë ankesa se dispozita në nenin 32 paragrafi 4.1 në një shkallë të gjerë është i pakuptueshëm dhe prandaj kërkon sqarime shtesë.

207. Në këtë pikë, ekipi vlerësues duhet të theksojë së ky paragraf nuk mund të konsiderohet si një risi në ligjin e Kosovës, i cili ka ende nevojë për disa sqarime hyrëse që të mund të zbatohet në mënyrën e duhur nga praktikuesit. Dispozita e njëjtë ende mund të gjendet në legjislacionin paraardhës me formulimin e njëjtë duke qenë se neni 32 paragrafi 4.1 i ligjit aktual të LPP/LFT është fjalë për fjalë i njëjtë sikurse neni 10 paragrafi 4(a) i Rregullores së UNMIK-ut 2004/2.

208. Gjatë dhe pas vizitës në terren, ekipi vlerësues bëri përpjekje për të hulumtuar se çfarë problemesh mund të kenë prokurorët e Kosovës me paragrafin 4.1 dhe në cilat pika ata do të kërkojnë sqarim ose shpjegim të mëtejshëm, mirëpo deri më tani nuk është arritur asnjë përgjigje definitive. Në përgjigjet e tyre me shkrim të dhëna në pyetësor, Kryeprokuroria e Shtetit tregoi se problemi kryesor që ata kishin ishte se “*vepra penale e pastrimit të parave duhet të jetë në një themel me veprën e ndërlidhur penale. Si rezultat i kësaj nuk mund të ketë dënim vetëm për veprën penale të pastrimit të parave*”. Siç është shpjeguar më tej gjatë vizitës, prokurorët kanë mendim të vendosur se PP është gjithmonë një akt kriminal ndihmës, që nuk ekziston, dhe si pasojë nuk mund të ndiqet penalisht, si një veprë e ndarë *sui generis*. Në përputhje me këtë qasje, prokurorët që u takuan me ekipin vlerësues u shprehën se dënimi paraprak apo së paku paralel për veprën e ndërlidhur penale ka mundësi të jetë parakusht për të realizuar një dënim të veprës penale të PP. Ky është këndvështrimi kryesor i cili dukej të ishte praktikisht në mospërputhje me kuptimin e mundshëm të paragrafit 4.1 të cituar më lart.

209. Në fakt, formulimi i paragrafit 4.1 nuk e lehtëson aspak të kuptuarit e domethënies së tij aktuale. Në këtë paragraf vetëm parashihet që kryesi mund të *dënohet për veprë penale të PP madje edhe nëse ai/ajo nuk ka qenë i/e dënuar për veprë të ndërlidhur penale, por kjo nuk është ajo çfarë kërkohet me FATF R.1. Ndërsa paragrafi 4.1 është i kufizuar në mënyrë të qartë në kryesin e veprës penale të PP (nëse ai/ajo mund të dënohet për PP nëse nuk dënohet për krimin e ndërlidhur) FATF R.1.2.1 parasheh se kur provohet se pasuria është e ardhur nga krimi, nuk është e nevojshme që një person, gjegjësisht cilido person e jo vetëm ai i cili e ka kryer veprën penale të PP, të dënohet për veprën e ndërlidhur penale. Për këtë arsye paragrafi 4.1, nga këndvështrimi formalist, është tepër kufizues për të përmbushur FATF R.1.2.1 edhe pse vlerësuesit mbeten të pasigurt për sa i përket qëllimit aktual që ligjbërësit mund të kenë pasur me këtë dispozitë – duke pasur parasysh se disa autoritete (p.sh.: Ministria e Punëve të Brendshme) e kanë interpretuar atë gjerësisht për të përfshirë konceptin e përgjithshëm të FATF R.1.2.1.*

210. Sido që të jetë, në Kosovë nuk ka pasur dënime për PP dhe në këtë mënyrë nuk mund të dihet se çfarë standardi do të aplikonte gjykata në këtë kontekst. Mungesa e informacioneve relevante për rastet e që presin zgjidhje ka parandaluar ekipin e vlerësimit nga nxjerrja e konkluzioneve të mëtutjeshme në këtë fushë.

Fushëveprimi i veprës së ndërlidhur penale & qasja e pragut për veprat e ndërlidhura penale (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.3 dhe 1.4)

211. Legjislacioni i Kosovës zbaton parimin e universalitetit të veprave të ndërlidhura penale aq sa vepra penale e PP parasheh qartë një “qasje të të gjitha krimeve” në vend të përdorimit të pragut apo kategorizimit të mëtejshëm.

212. Më lart i është janë bërë referenca në definicionet e hollësishme (ndonëse të vjetërsuara), të cilat parashihen në Ligjin kundër PP/FT për termet si “të ardhurat nga krimi” dhe “veprë penale e ndërlidhur”. Si rezultat i këtyre përkufizimeve, mund të konkludohet se vepra penale e PP mbulon të ardhurat e krimin të cilat nënkuptojnë çdo pasuri që buron direkt apo indirekt nga një veprë e ndërlidhur penale ku shprehja e fundit paraqet çdo veprë e cila gjeneron të ardhura nga krimi. Si rezultat, çdo akt të cilin legjislacioni penal i Kosovës e paraqet si një veprë penale, e cila mund të gjenerojë përfitime materiale mund të jetë veprë e ndërlidhur penale e PP.

213. Legjislacioni i Kosovës mbulon kategoritë e caktuara të veprave penale të FATF (dhe CETS 198) siç tregohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5: Kategoritë e caktuara të veprave penale

Kategoritë e caktuara të veprave penale bazuar në metodologjinë e FATF dhe në CETS 198	Veprat penale në legjislacionin vendor sipas Kodit të ri Penal	Nenet përkatëse në Kodin e vjetër Penal
Pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe zhvatja;	Neni 283 – Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar	Neni 274
Terrorizmi, përfshirë financimin e terrorizmit	Neni 136 – Kryerja e veprës terroriste dhe veprat e mëpasshme në nenin 137 deri 144 duke përfshirë nenin 138 – lehtësimi në kryerjen e terrorizmit	Nenet 110 deri 113

Kategoritë e caktuara të veprave penale bazuar në metodologjinë e FATF dhe në CETS 198	Veprat penale në legjislacionin vendor sipas Kodit të ri Penal	Nenet përkatëse në Kodin e vjetër Penal
Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i migrantëve	Neni 171 – Trafikimi me njerëz Neni 170 – Kontrabandimi me migrantë Neni 172 – Fshehja e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë ose trafikimit me njerëz	Nenet 138 deri 140
Shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve;	Kapitulli XX – Veprat penale kundër integritetit seksual (më shumë)	Kapitulli XIX
Trafikimi i paligjshëm i narkotikëve dhe i substancave psikotrope;	Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve (më shumë)	Nenet 229 deri 231
Trafikimi i paligjshëm i armëve	Neni 372 – Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse (veprat e tjera në kapitullin XXX)	Nenet 327 dhe 330
Trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe mallrave të tjera	Neni 345 – Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale	Neni 272
Korrupsioni dhe ryshfeti	Kapitulli XXXIV – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (më shumë)	Kapitulli XXIX
Mashtrimi	Nenet 335 deri 337 – Mashtrimi (lloje të ndryshme) Neni 288 – Mashtrimi në procedurën e falimentimit Neni 310 – Mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë	Nenet 261-262
Falsifikimi i parasë	Neni 302 – Falsifikimi i parasë Neni 293 – Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës Neni 294 – Falsifikimi i shenjave me vlerë	Neni 239 Neni 244
Falsifikimi dhe pirateria e produkteve	Neni 295 – Cenimi i të drejtave të patentës Neni 296 – Cenimi i të drejtave të autorit	Nenet 240-241
Krimi mjedisor	Kapitulli XXVIII – Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore (më shumë)	Kapitulli XXIV
Vrasja, lëndimi i rëndë trupor	Nenet 178 deri 179 – Vrasja Neni 189 – Lëndimi i rëndë trupor	Nenet 146-147 Neni 154
Rrëmbimi, burgosja e kundërligjshme dhe marrja e pengjeve	Neni 194 – Rrëmbimi Neni 196 – Privimi i kundërligjshëm i lirisë Neni 175 – Marrja e pengjeve	Neni 159 Neni 162 Neni 143
Grabitja ose vjedhja;	Nenet 325 deri 327 – Vjedhja Neni 328 – Vjedhja grabitqare Neni 329 – Grabitja	Nenet 252 deri 256
Kontrabandimi	Neni 317 – Kontrabandimi i mallrave	Neni 273
Detyrimi	Neni 340 – Detyrimi	Neni 267-268

Kategoritë e caktuara të veprave penale bazuar në metodologjinë e FATF dhe në CETS 198	Veprat penale në legjislacionin vendor sipas Kodit të ri Penal	Nenet përkatëse në Kodin e vjetër Penal
	Neni 341 – Shantazhi	
Falsifikimi	Nenet 398 deri 399 – Falsifikimi i dokumenteve Neni 434 – Falsifikimi i dokumentit zyrtar dhe veprat e tjera specifike (p.sh.: nenet 314, 376, 403)	Neni 332-335 Neni 348
Piratëria	Neni 168 – Piratëria	Neni 136
Tregtimi me informatat e brendshme dhe manipulimi i tregut	Neni 311 – Keqpërdorimi i informatave të brendshme	(i pambuluar)

214. Kështu, legjislacioni penal i Kosovës mbulon 19 nga 20 kategoritë e veprave të ndërlidhura penale për PP të kërkuara nën fjalorin e FATF Rekomandimeve. Më saktësisht, Kodi i Përkohshëm Penal kishte mbuluar plotësisht 19 prej këtyre kategorive, përveç veprave penale për tregtimin me informatat e brendshme dhe manipulimin e tregut. Meqë neni 311 i Kodit të ri Penal përfshiu prej 1 janarit 2013 keqpërdorimin e informatave të brendshme si vepër penale *sui generis*, tani i vetmi përjashtim është manipulimi i tregut i cili, siç është konfirmuar nga Ministria e Drejtësisë, mbetet për t'u mbuluar nga legjislacioni penal.

Veprat e ndërlidhura penale të kryera jashtë territorit (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.5 dhe 1.8, CETS 198 neni 11)

215. Veprat e ndërlidhura penale për shpëlarje të parave zgjerohen edhe në sjelljet që kanë ndodhur në një juridiksion tjetër në bazë të nenit 32 paragrafi 4.3 i cili parasheh, që

“... gjykatat e Kosovës mund të kenë juridiksion mbi veprën penale të pastrimit të parave, madje edhe nëse ato nuk kanë juridiksion territorial mbi veprat e ndërlidhura penale prej të cilave është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale të pastrimit të parave, ngaqë ka qenë kryer jashtë Kosovës.”

216. Kjo dispozitë është e qartë në atë se të ardhurat që burojnë nga veprat e ndërlidhura të kryera jashtë vendit aktualisht mund të formojnë bazën e një vepre penale vendore të PP në Kosovë. Për më tepër, dispozita në paragrafin 4.3 nuk duket se kërkon që vepra penale e huaj të përmbush standardin e kriminalitetit të dyfishtë (d.m.th. vepra e njëjtë gjithashtu do të përbënte vepër të ndërlidhur penale nëse do të ndodhte brenda vendit), i cili tipar do të mund të lehtësonte më tej shtrirjen e zbatueshmërisë së veprës penale të PP në të ardhurat e huaja. Pavarësisht kësaj, autoritetet e Kosovës (Kryeprokurori i Shtetit) kishin mendim se vepra nga e cila kanë buruar të ardhurat e shpëlarja duhet të jetë një vepër penale e përcaktuar në një juridiksion tjetër, por, nga ana tjetër, ajo gjithashtu duhet të përbëjë një vepër penale në pajtim me ligjin e Kosovës (prandaj zbatohet kriminaliteti i dyfishtë) edhe pse kjo kërkesë duket se nuk është e përfshirë në paragrafin 4.3

217. Për shkak të mendimeve të tilla, ekipi vlerësues nuk mund të ishte i sigurt në lidhje me pranueshmërinë e të ardhurave nga veprat e ndërlidhura të huaja që cilat nuk plotësojnë standardin e kriminalitetit të dyfishtë. Rrjedhimisht, nuk mund të përcaktohej nëse, ose jo, pastrimi i pasurisë e cila buron nga një veprim që ka ndodhur në një juridiksion tjetër, i cili nuk përbën vepër penale në atë juridiksion, por i cili do të përbënte një vepër të ndërlidhur penale nëse do të ndodhte në Kosovë, do të përbënte një vepër penale të PP.

218. Ekipi vlerësues dëshiron të theksoj në këtë pikë se nocioni veprat e ndërlidhura penale të kryera jashtë vendit nuk i është dukur i qartë shumicës së praktikuesve me të cilët ata u takuan. Autoritetet e Kosovës duket se e marrin në konsideratë këtë çështje nga aspekti nëse Kosova ka apo jo juridiksion ndaj veprave penale të kryera jashtë territorit të saj, gjë e cila nuk është një çështje në kontekstin e FATF R.1.5 dhe 1.8. Këto standarde i referohen në mënyrë të qartë shpëlarjes vendore të të ardhurave të huaja, me fjalë tjera, dënueshmërisë vendore të aktiviteteve të shpëlarjes të cilat padyshim bien nën juridiksionin e vendit përkatës (qoftë meqë shpëlarja është kryer territorin e atij vendi apo për shkak të shtetasve të atij vendi) por që pasuria e cila është shpërlarë është e ardhur nga krimi i kryer jashtë vendit. Nuk shtrohet pyetja nëse Kosova ka juridiksion mbi këto vepra të ndërlidhura penale të huaja ashtu siç kërkohet me standardet FATF (për të cilën arsye është e parëndësishme nëse ajo vepër e ndërlidhur plotëson kushtet në lidhje me zbatueshmërinë e ligjeve penale të Kosovës në përputhje me vendin e kryerjes së veprës penale siç përcaktohet në kapitullin XI të Kodit të përkohshëm Penal apo në kapitullin XII të Kodit të ri Penal). Pyetja e vërtetë është nëse shpërlarja vendore e të ardhurave të cilat burojnë nga këto vepra të ndërlidhura do të përbënin një vepër penale të PP në Kosovë – dhe kësaj pyetjeje i është dhënë përgjigje pozitive me paragrafin 4.3, sipas të cilit gjykatat e Kosovës mund të kenë gjithashtu juridiksion mbi veprat penale të PP në rastet kur nuk kanë juridiksion territorial për veprat e ndërlidhura.

219. Në mungesë të përvojës, ende nuk janë testuar para gjykatave dispozitat të cilat rregullojnë çështjen e veprave të ndërlidhura të huaja. Ekipi vlerësues nuk ka asnjë informatë specifike për të ndodhurit e rasteve të cilat përfshijnë të ardhura të huaja në mesin e atyre që janë hetuar apo ndjekur penalisht në fazat e mëhershme të procedurës. Është bërë me dije, prapëseprapë, se absolutisht nuk ka asnjë përvojë në lidhje me shpërlarjen e të ardhurave të veprimeve të cilat nuk përbëjnë një vepër penale kur ajo është kryer jashtë, por e cila do të përbënte një vepër penale në Kosovë (d.m.th. rastet e PP të lidhura me të ardhurat e huaja aty ku kërkesa e kriminalitetit të dyfishtë nuk plotësohet).

220. Mungesa e një informacioni të tillë nuk lejon përcaktimin, nëse ka, ose do të kishte, ndonjë jurisprudence të duhur në Kosovë për të siguruar mundësinë e marrjes parasysh, kur bëhet përcaktimi i dënimit, të vendimin të formës së prerë kundër personave fizikë ose juridikë, i cili merret në një vend tjetër në lidhje me veprat penale në pajtim me CETS 198 nenin 11 (sido që të jetë, nuk ekziston legjislacion specifik për të trajtuar këtë çështje).

Pastrimi i mjeteve vetanake të paligjshme (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.6)

221. Nuk ekzistojnë dispozita specifike në Ligjin LPP/LFT apo diku tjetër, ku parashihet të mbuluarit formal të shpërlarjes nga një autor i veprës së ndërlidhur penale edhe pse, nga ana tjetër, ekzaminuesit nuk kishin njohuri për ndonjë kundërshtim ligjor themelor ose fundamental në lidhje me të. Formulimet për veprën penale të PP, ashtu siç janë përcaktuar në nenin 32.2 të ligjit LPP/LFT, duket se përfshinë veprat e ndërlidhura penale pa dallim të veçantë apo kufizim varësisht se kush ishte autor i veprës së ndërlidhur penale. Pasi që nuk ka përjashtim formal të bërë në rastet ku kryesi bënë pastrimin e të ardhurave nga krimi të cilin ai ose ajo e ka kryer, autoritetet e Kosovës kanë qëndrim të fortë se vepra penale e PP përfshin, pa ndonjë specifikim të mëtejshëm, shpërlarjen e të ardhurave të vetanake.

222. Ky argumentim është i mbështetur, edhe pse në mënyrë indirekte, në nenin 32, paragrafin 4.2 të Ligjit LPP/LFT, ku parashihet që:

“(…) i njëjti person mund të ndiqet dhe të dënohet në procedura të veçanta për vepra penale të pastrimit të parave dhe të veprës së ndërlidhur penale prej të cilës është nxjerrë pasuria e fituar me anë të veprës penale”.

223. Sipas kësaj dispozite, i njëjti person mund të ndiqet penalisht për shpëlarje të parave si dhe për veprën e ndërlidhur të caktuar, e cila mund të bëhet vetëm nëse pastrimi i të ardhurave të vetanake është i mbuluar me legjislacionin penal të LSHP. Si pasojë, ekipi vlerësues është i gatshëm të pranoj se penalizimi i vetshpëlarjes, ashtu siç kërkohet me FATF R.1 është i mbuluar me legjislacionin penal në Kosovë, edhe nëse fushëveprimi aktual ende nuk është konfirmuar përmes praktikës përkatëse gjyqësore dhe jurisprudencës.

224. Pavarësisht të gjithë këtyre faktorëve, vlerësuesit kishin disa vështirësi në të kuptuarit e kuptimit aktual dhe qëllimit të paragrafit 4.2 të cituar më lart. Ndërsa është e qartë se personi i njëjtë mund të mbahet përgjegjës penalisht për krimin e ndërlidhur dhe për aktin e shpëlarjes, struktura dhe formulimi i dispozitës, në të dy mënyrat mund të thotë njësoj si në vazhdim:

(i) në këtë dispozitë, ligji në mënyrë eksplicite lejon ndjekjen penale dhe dënimin e personit të njëjtë për të dy veprat të cilat, megjithatë, mund të ndodhin në dy procedura të ndara (këtu “mund” i referohet pjesës së mbetur të fjalisë)

(ii) ndjekja penale dhe dënimi i personit të njëjtë për të dy veprat penale është marrë ashtu siç parashihet, ligji vetëm lejon që kjo gjithashtu mund të zhvillohet në dy procedura të ndara (këtu “mund” i referohet degëzimit opsional të procedurave).

225. Formulimi i dispozitës lejon hapësirë për të dy interpretimet për shkak të referencës në “procedurat e ndara” e cila pa nevojë sjell një komponentë “procedurale” ngatërruese në përkufizimin përndryshe të bazuar në të drejtën materiale penale. Pasi pastrimi i të ardhurave të vetanake të jetë i dënueshëm, normalisht ajo do të duhej të ndiqet penalisht qoftë në të njëjtën procedurë ose, nëse është e nevojshme, gjithashtu në një procedurë të ndarë varësisht nga karakteristikat e rastit. (Mund të ndodhë, për shembull, se personi tashmë është dënuar për krimin e ndërlidhur kur aktivitetet e tij të pastrimit të jenë vërejtur në të cilin rast ai mund të ndiqet penalisht vetëm për PP në një procedurë të ndarë).

Veprat plotësuese (FATF R.1: Kriteri themelor 1.7)

226. Veprat plotësuese me veprën PP janë të mbuluara në një paragraf të veçantë (2.7) brenda nenit 32.2 të Ligjit LPP/LFT. Ky paragraf është një nga ata që ende nuk janë përfshirë në veprën penale pasi që ishte i penalizuar në legjislacionin e mëparshëm për LPP/LFT (Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2) dhe cilat i janë shtuar veprave penale vetëm me Ligjin aktual LPP/LFT.

“2.7. merr pjesë, bashkëpunon për të kryer dhe ndihmuar-inkurajuar, lehtësuar e këshilluar në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nënparagrafët 2,1-2,6 të këtij paragrafi ”

227. Veprat plotësuese të renditura në këtë paragraf janë formuluar në përputhje të plotë me formulimin e nenit 6 (1) (b / ii) të Konventës së Palermos për sa i përket pjesëmarrjes, bashkimit, ndihmesës-inkurajimit, lehtësimit dhe këshillimit. Sigurisht, një qasje me të cilën vet dispozitat e një konvente ndërkombëtare janë kopjuar dhe vendosur në legjislacionin e brendshëm, padyshim do të sigurojë zbatimin më të saktë të origjinalit, megjithatë ajo është gjithashtu një kërkesë që ligjvënësit t'i kushtojnë vëmendje nëse dhe se si një dispozitë e tillë e importuar do të përshtatej në kontekstin e legjislacionit ekzistues.

228. Pikërisht në këtë rast mund të gjeni një grup të veprave të ngjashme në Ligjin LPP/LFT që ekskluzivisht në mënyrë specifike është i aplikueshëm për veprën e PP nga njëra anë, kurse nga ana tjetër ato vepra plotësuese të cilat janë të përkufizuara në Pjesën e përgjithshme të Kodit Penal përkatës me qëllim të zbatimit të tyre të përgjithshëm për të gjitha veprat penale - duke përfshirë gjithashtu edhe veprën penale të PP. Zbatueshmëria e njëtrajtshme e legjislacionit penal normalisht do të kërkojë që i njëjti koncept dhe terminologji për çështjet e përgjithshme të së drejtës penale materiale (të tilla si, dhe ndër të

tjera,shtrirja dhe fushëveprimi i veprave plotësuese) të përdoret në të dyja, Kodin Penal (si *lex generalis*) dhe të tjerë, dhe burime tjera të ligjit penal të tilla si Ligji LPP/LFT (si *lex specialis*). Megjithatë, në rastin e veprave plotësuese koncepti dhe terminologjia e aplikuar në qoftë në Kodin Penal apo në Ligjin LPP/LFT shfaqin dallime të rëndësishme në këtë fushë të cilat praktikuesve të ligjit mund të u shkaktojnë probleme në interpretim.

229. Sigurisht, një analizë më e thellë tregon se koncepti i pjesëmarrjes, bashkimit, ndihmës-inkurajimit, lehtësimit dhe këshillimit, siç përmendet më sipër në paragrafin 2.7, të gjitha janë adresuar nga cilido prej Kodeve Penale, pavarësisht dallimeve të dukshme në terminologji. Kjo do të thotë se të dy, Kodi i Përkohshëm Penal dhe Kodi i ri Penal aktin "bashkëkryerje" e përkufizojnë si (siç është e paraparë si i dënueshëm sipas nenit 23, përkatësisht sipas nenit 33), që mbulon nocionin e pjesëmarrjes dhe veprimin e "bashkimit kriminal" (si në nenin 24 përkatësisht nenin 34) që mbulon bashkimin dhe "ndihmën" (si në nenin 25 dhe nenin 33) që mbulon ndihmën-inkurajimin, lehtësimin dhe këshillimin. Megjithatë, një përfundim i tillë pozitiv mund të nxirret vetëm si rezultat i interpretimit të gjerë të teksteve ligjore konkurrenente (veçanërisht ai i Kodit Penal dhe Ligjit LPP/LFT nuk ofrojnë përkufizime për termat përkatës), por nuk mund të përjashtohet se dallimet e rëndësishme formale në mes të dy burimeve ligjore gjithashtu mund të çojnë në një interpretim më restriktiv.

230. Komploti është lloji i vetëm i veprës plotësuese që kërkohet nga Konventat e Vjenës dhe Palermos e i cili qartë mungon, për arsye të panjohura për ekipin vlerësues, nga lista e veprave të ngjashme sipas nenit 32, paragrafi 2.7 të Ligjit LPP/LFT. Pavarësisht nga kjo duket se pjesa e përgjithshme e të dy kodeve penale e mbulon këtë veprim në terma të përgjithshëm, gjithashtu edhe sa i përket veprës penale të PP, duke përdoruar dispozita si në vijim (pak a shumë me një paralelizëm të emërtimi i "bashkimit" të diskutuar më lart).

- Bashkimi kriminal (neni 26 i KPP / neni 34 i KP) nënkupton se kushdo që shprehimisht apo në mënyrë të heshtur merret vesh me një apo me më shumë persona për të kryer ose për të nxitur kryerjen e një vepre penale të dënueshme me së paku pesë (5) vjet burgim dhe ndërmer veprime përgatitore për realizimin e marrëveshjes së tillë.

- Marrëveshja për të kryer vepër penale (neni 35 – Vetëm në Kodin e ri Penal) nënkupton se kushdo që merret vesh me një apo me më shumë persona për të kryer vepër penale dhe një apo më shumë nga ata persona ndërmer çfarëdo veprimi të rëndësishëm (d.m.th. një hap të rëndësishëm përgatitor) për kryerjen e veprës penale.

231. Tentativa nuk është përmendur në mënyrë veçantë në paragrafin 2.7, por tentativa për PP shumë qartë është penalizuar në të gjithë paragrafët paraprak, përveç në njërin prej paragrafëve të nenit 32.2, përmes të të cilëve përkufizohen veprat e ndryshme të PP (të tilla si "shndërron ose transferon, apo tenton të shndërrojë apo transferojë" në paragrafin 2.1). Përderisa kjo qasje është përcjellë në vazhdimësi në paragrafët 2,1-2,5 nuk mund të kuptohet se pse përmendja specifike për tentativë mungon në paragrafin 2.6 (i cili ishte paragrafi tjetër që vetëm i ishte shtuar veprës penale në Ligjin aktual LPP/FT).

232. Dispozitat e përgjithshme me të cilat tentativa është penalizuar mund të gjenden në Pjesën e përgjithshme (ose) të të dy kodeve penale (d.m.th. nenin 20 të KPP dhe nenin 28 të KP të ri). Dy kodet penale të sigurojnë që tentativa për të kryer vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi prej së paku tri (3) vite në përgjithësi është e dënueshme, ndërsa në raste të veprave të tjera penale (më pak serioze) tentativa dënohet vetëm nëse shprehimisht parashihet me ligj .Në rast të veprës penale të PP sipas Nenit 32.2 të Ligjit LPP/LFT, dënimi për tentativë shprehimisht është paraparë me ligj (me përjashtim në paragrafin 2.6),

megjithatë vepra në vetvete është e dënueshme me burgim deri në 10 vjet dhe kështu një veprë në tentativë do të jetë e dënueshme gjithsesi edhe në rastin e veprave nën paragrafin 2.

233. Me fjalë të tjera, tentativa për të kryer veprat nga paragrafët 2,1-2,5 është përshkruar si e dënueshme mu aty dhe me të njëjtët paragrafë, ndërsa tentativa për veprë penale në paragrafin 2.6 mbulohet vetëm nga dispozitat e përgjithshme të kodeve penale përkatëse. A bën kjo ndonjë ndryshim? Në fakt ajo e bëri deri në fund të vitit 2012 duke pasur parasysh se neni 20.3 i KPP-së parashihet se personi i cili ka tentuar të kryejë veprë penale "*dënohet më butë se sa kryerësi, në përputhje me nenin 65 (2) të këtij Kodi*" ku dispozitat e mëvonshme ishin "*jo më shumë se tre-katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për veprë penale*", ndërsa në paragrafët 2,1 deri 2,5 tentativa për PP kërcënonte me po të njëjtën shtrirje të dënimit sikurse edhe vepra penale e kryer. Që nga 01.01.2013 regjimet sanksionuese në të dy ligjet janë harmonizuar, duke pas parasysh se neni 28.3 i KP të ri zbaton të njëjtën shtrirje të dënimit për orvatësin i cili *dënohet sikur se ai ose ajo të kenë kryer veprë penale, megjithatë, dënimi mund të zvogëlohet*".

Statistikat dhe efektiviteti

234. Ekipi vlerësues ka hasur vështirësi serioze gjatë përpjekjeve për të marrë statistika gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme në lidhje me numrin e hetimeve penale, ndjekjeve penale dhe dënimeve për PP. Autoritetet kosovare deri më tani nuk kanë siguruar statistika të duhura dhe të besueshme kurse informacionet statistikore të rasteve, të cilat vlerësuesit i kanë pranuar deri më sot në thelb janë kontradiktore. Zyra e Prokurorisë së Shtetit dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës kanë dhënë shifra të ndryshme, tutje edhe Ministria e Punëve të Jashtme ka ofruar vetëm të dhëna të pjesshme.

235. Mospërputhjet në këto statistika janë aq të mëdha sa që vlerësuesit nuk janë në pozitë që të përcaktojnë, për shembull, nëse ndonjëherë ka pasur edhe një dënim të vetëm për veprën penale PP. Këshilli Gjyqësor në lidhje me këtë ka deklaruar se sipas statistikave të gjykatave nuk ka pasur ndonjë vendim të prerë për rastet e PP (as dënime por as shfajësim) gjatë tri viteve të fundit, veç kësaj në të njëjtën periudhë kohore nuk ka pasur madje asnjë kallëzim penal për veprë penale të PP.

236. Zyra e Prokurorit të Shtetit, megjithatë, pohoi se në fakt kishte parashtruar padi në rastet e PP në periudhën kohore të specifikuar më sipër.

- Gjatë vitit 2009, prokurorët kishin zgjidhur raste për 5 persona, ndërsa asnjëri nuk ishte zgjidhur me aktakuzë.
- Gjatë vitit 2010, prokurorët kishin zgjidhur gjithsej 21 raste, me 8 aktakuza të ngritura për 8 persona.
- Gjatë vitit 2011, prokurorët kishin zgjidhur gjithsej 33 raste dhe ishin ngritur 7 aktakuza.
- Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012, prokurorët kishin zgjidhur 32 raste dhe kishin ngritur 7 aktakuza.

dhe për më tepër ishte referuar të paktën një rast me PP që kishte përfunduar me një dënim (i ashtuquajtur "rasti Koalicioni", ku të dhënat aktuale megjithatë nuk ishin siguruar për vlerësuesit).

237. Ka një mospërputhje të madhe në mes të numrit të rasteve të hetuara për PP raportuar nga KPK-ja dhe atyre të raportuara nga policia (shihni seksionin 2.7 të këtij Raporti)

238. Ndërsa vlerësuesit mbesin pranë kërkesës së tyre për shifra statistikore të plota (sidomos nga gjyqësori), ata kanë mendimin, madje edhe në bazë të statistikave të tilla jo të plota dhe jo të besueshme, se nga shifrat në dispozicion ka një tendencë premtuese dhe se

mund të shihen disa shenja premtuese që prokuroria së shpejti do të jetë në gjendje për të arritur më shumë se një dënim të vetëm për PP e që duhet të pasohet nga shumë e më shumë raste për të zhvilluar jurisprudencën duke u bazuar praktikën gjyqësore. Për fat të keq, për shkak të mungesës së plotë të informacioneve në lidhje me karakteristikat e veprave penale të PP, të cilat u janë nënshtruar deri më tani hetimeve dhe ndjekjeve penale në Kosovë, ekipi i vlerësimit nuk ka arritur të nxjerrë konkluzione në lidhje me veprat penale paraprahe tipike, metodat e pastrimit, përfshirjen e palëve të treta në PP dhe vetëshpëlarje, si dhe me faktorët e tjerë relevantë në këtë fushë. Si rezultat, aplikueshmëria efektive e penalizimit të PP nuk ka mundur të vlerësohet.

2.1.2. Rekomandime dhe komente

Penalizimi i pastrimit të parasë – elementet fizike dhe materiale të veprës penale (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.1)

239. Ekipi i vlerësimit nuk ka komente specifike në lidhje me veprën PP deri në atë masë që rregullon çështjet brenda fushëveprimit të Konventave të Vjenës dhe Palermos, duke pas parasysh përputhshmërinë e saj të gjithëmbarshme me standardet përkatëse ndërkombëtare. Ekipi i vlerësimit megjithatë ka disa shqetësime sa i përket dispozitave të mëtejshme në nenin 32 që duket se shkojnë përtej fushëveprimit të përcaktuar nga konventat e mësipërme.

240. Dispozitat në paragrafët 2,3 dhe 2,4 që paraqesin vepra PP “shtesë” me komponentë të veçanta funksionale duket se shkaktojnë probleme atëherë kur zbatohen në raste konkrete, kryesisht për shkak të karakterit të tyre të tepruar, me të cilin ato mbulojnë njëra tjetrën në veprat e tjera të parashikuara diku tjetër në të njëjtin nen. Për këto arsye, autoritetet e Kosovës duhet të rishqyrtojnë këto dispozita nëse dhe deri në çfarë mase ato mund të mbulojnë njëra tjetrën me dispozitat e tjera.

241. Gjithashtu më lart u diskutua dhe për të drejtën materiale dhe atë procedurale penale për ato pjesë të veprës PP që drejtpërdrejt apo tërthorazi i referohen zbatimit të "masave të fshehta", që janë të pacaktuara dhe të palogjikshme dhe kështu mund të shkaktojnë probleme në praktikë. Edhe pse kjo është një çështje tjetër që shkon përtej qëllimit të këtij vlerësimi, vlerësuesit përsërisin se masat e fshehta duhet të rregullohen në mënyrë ideale, në veçanti për legjislacionin penal procedural në atë mënyrë që përmes tyre ato të mund të jenë të zbatueshme për cilëndo vepër penale në mënyrë të lehtë dhe efektive.

242. Pasi që në mënyrë më të detajuar u diskutua më lart, ekipi vlerësues e pa si shumë problematik përkufizimin e kopjuar të “pastrimit të parasë” në po të njëjtën pjesë të legjislacionit (neni 2.1.23 ndaj nenit 32.2 i Ligjit të LPP/LFT). Paqartësia ligjore që mund ta shkaktohet nga degëzimi i përkufizimeve mund të eliminohet vetëm me përdorimin e një përkufizimi të vetëm për PP, i cili në mënyrë të njëjtë mund të jetë i zbatueshëm për qëllimet e juridiksionit penal dhe për to të sistemeve parandaluese. Prandaj ekipi vlerësues fuqishëm rekomandon fshirjen e nenit 2.1.23 ashtu që të kemi vetëm një dispozitë në nenin 32.2 ku PP përkufizohet për cilindo nga qëllimet e përmendura më lart.

Pasuria e shpërlarë (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.2, CETS 198 neni 9(6))

243. Dispozitat aktuale në Ligjin LPP/LFT që përkufizojnë "pronën" "të ardhurat nga krimi" dhe "vepër të ndërlidhur penale" (neni 2 paragrafi 1,28-1,30), janë të gjitha në një mbivendosje të shprehur (në disa pika ato vërtiten rrotull), gjë e cila çon në tepriçë të panevojshme. Sistemi dhe fushëveprimi aktual i këtyre përkufizimeve duhet rishqyrtuar urgjentisht. Çfarë është më e rëndësishme është të përcaktohet nëse neni 32.2 i referohet të ardhurave të një "veprimtarie kriminale" të paqartë ose të një "vepre penale" më të saktë para

se të fusim paragrafin e tanishëm 1,40 në nenin 2, përndryshe fjalët e tepërta do të rriten pa e rritur zbatueshmërinë e dispozitave përkatëse.

244. Në të vërtetë, ndoshta do ishte më e përshtatshme fshirja e referencës për "veprimtari kriminale" në nenin 32.2 në mënyrë që pjesa tjetër e paragrafit në fjalë thjesht do t'i referohet të ardhurave të gjeneruara nga vepra penale-të gjitha në përputhje me nenet e tjera përkatëse të Ligjit LPP/LFT. Sigurisht, ky nuk është opsioni i vetëm pasi që ligjvënësit kosovarë mund të zgjedhin cilëndo zgjidhje për këtë situatë fatkeqe. Megjithatë, do të ishte kërkesë minimale që e njëjta terminologji të përdoret për të treguar konceptin e njëjtë në tërë Ligjin për LPP/LFT, dhe të gjitha përkufizimet përkatëse duhet të jenë të harmonizuara në mënyrë që të shmanget hutimi dhe fjalët e tepërta.

Vërtetimi se pasuria vjen prej të ardhurave nga krimi (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.2.1 CETS 198 Neni 9(5))

245. Pasiguria e përgjithshme në mes të praktikuesve në lidhje me nivelin e provës për veprën e ndërlidhur penale ishte alarmante, andaj kërkohej hapa urgjentë nga ana e autoriteteve të Kosovës. Më e pakta që do të duhej të bëhej do të ishte që Ministria e Financave si autoritet përgjegjës për hartimin e legjislacionit aktual LPP/LFT (dhe veçanërisht për nenin 32, paragrafi 4.1 i Ligjit LPP/LFT) apo cilido organ tjetër kompetent duhet të nxjerrë udhëzime të përshtatshme për sa i përket interpretimit dhe zbatimit e dispozitave përkatëse. Kjo është një mangësi e madhe e sistemit pasi që praktikuesit, veçanërisht prokurorët publikë, duket të jetë lënë pa udhëzimin e duhur në çështje të tilla të rëndësishme si kjo.

246. Nëse udhëzimi shpjegues nuk mund të korrigjojë mosnjohjen dhe rezistencën ndaj dispozitave përkatëse (dhe konceptet themelore në përgjithësi), ekipi i vlerësimit rekomandon që kjo çështje të diskutohet në kudër të shkëmbimit të tryezave të rrumbullakëta midis autoriteteve të përfshira. Në këtë kontekst ka nevojë të eksplorohet nëse dhe çfarë jurisprudenca ka zhvilluar EULEX-i në këtë fushë e që mund të bëhet e dobishme për autoritetet e Kosovës (duke pasur parasysh se zyrtarët e EULEX-it duket të mos kenë pasur ndonjë problem të veçantë me dispozitat e njëjta që kanë qenë pjesë e Rregullores së UNMIK-ut për një kohë të gjatë).

Fushëveprimi i veprës së ndërlidhur penale dhe pragu i ulët i qasjes për veprat e ndërlidhura penale (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.3 dhe 1.4)

247. Vepra e manipulimit të tregut duhet të futet në legjislacionin penal të Kosovës në mënyrë që kategoria e fundit e veprave të ndërlidhura penale që mungonte gjithashtu të mbulohej.

Veprat e ndërlidhura penale të kryera jashtë vendit (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.5 dhe 1.8, CETS 198 neni 11)

248. Në legjislacionin aktual sipas nenit 32, paragrafi 4.3 i Ligjit LPP/LFT duhet të vihet përtej çdo dyshimi nëse dhe për çfarë kërkohet ekstradimi për veprën e ndërlidhur penale që është kryer nën një juridiksion tjetër. Në rast se nuk ka nevojë për të zbatuar këtë standard (gjegjësisht vepra PP që përfshin edhe asetet që rrjedhin nga një sjellje që ka ndodhur në një juridiksion tjetër, e cila atje nuk përbën vepër, por që po të kishte ndodhur në Kosovë do të përbënte një vepër ndërlidhur penale), atëherë ajo me ligj duhet të specifikohet saktësisht në mënyrë të barabartë që t'i shmanget çdo problemi të interpretimit në të ardhmen.

Pastrimi i mjeteve të vetanake të paligjshme (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.6)

249. Ligji i miratuar do duhet që shprehimisht të përcaktojë nëse pastrimi i kryer nga kryerësi i veprës së ndërlidhur penale mbulohet nga vepra PP. Në këtë kontekst, shpjegimi i ofruar në nenin 32, paragrafi 4.2 nuk e lehtëson të kuptuarit dhe qëllimin e vërtetë të veprës sa i përket pastrimit të mjeteve të vetanake me prejardhje nga krimi, përkundrazi, ky shpjegim e bën të kuptuarit edhe më të vështirë.

250. Ligjvënësit së paku duhet të vendosin se çfarë duhet të përcaktohet sipas paragrafit 4.2, që do të thotë se a e parasheh ndjekjen penale të vetëpastrimit (gjegjesisht, a mbahet dikush penalisht përgjegjës për të dyja veprat penale) ose që kjo ndjekje të zhvillohet në dy procedura të ndara, ose si një tjetër opsion nëse parashihet që vepra e ndërlidhur penale dhe vetëpastrimi mund të ndiqen veçmas (të cilat përndryshe nuk do të kishin aq shumë kuptim, por kjo gjithashtu mund të rrjedhë nga teksti i ligjit). Në përgjithësi, referenca për "procedura të ndara" duhet të rishikohet, dhe nëse nuk është e domosdoshme, të braktiset pasi që pastrim i të ardhurave vetanake të fituara nga krimi normalisht do duhej ndjekur penalisht qoftë në të njëjtën procedurë ose, nëse nevojitet, edhe në procedura të veçanta.

251. Megjithatë nëse ekziston një mendim i përbashkët se pastrimi i të ardhurave të vetanake të fituara nga krimi padyshim mbulohet (për shkak se ajo nuk është e përjashtuar) përmes veprës së PP-së me nenin 32.2, atëherë ligjvënësit kosovarë gjithashtu mund të konsiderojnë që thjesht të fshijnë dispozitën shpjeguese në paragrafin 4.2 - me ose pa rritjen e mbulimit formal pozitiv të vetëpastrimit të parave në nenin 32.2

Veprat plotësuese (FATF R.1: Kriteri thelbësor 1.7)

252. Ndërsa veprat plotësuese të veprës penale të PP, siç parashihet me nenin 32, paragrafi 2.7 të Ligjit LPP/LFT janë në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe në fakt ato kanë gjasa të sigurojnë, edhe pse në një strukturë dhe logjikë të ndryshme, mbulimin e njëjtë si veprat përkatëse në Pjesën e përgjithshme të KP-së (si u tregua më lart), përdorimi i dy grupeve të ndryshme të veprave ndihmëse është larg nga të qenit një zgjidhje optimale.

253. Dyfishimi i terminologjisë dhe përdorimi i koncepteve më shumë ose më pak të ndryshëm në këtë fushë ka më shumë disavantazhe se rezultate pozitive. Autoritetet e Kosovës duhet urgjentisht të sigurojë për bashkëjetesë harmonike të dispozitave penale në KP-së dhe atyre në Ligjin *lex specialis* LPP/LFT në mënyrë që të sigurojnë veten se dallimet në koncept dhe terminologji nuk shkaktojnë probleme kur këto dy burime ligjore duhet zbatuar së bashku. Në mënyrë të veçantë, duhet të bëhet e qartë nëse shtrirja e veprave të ngjashme (veprave ndihmëse) në 2,7 mund të konsiderohet se ofron mbulueshmëri të njëjtë si dispozitat përkatëse të përgjithshme të KP-së (siç është cekur) dhe nëse po, pse është e nevojshme të përdoret një terminologji e ndryshme.

254. Në mënyre ideale të njëjtat shprehje dhe koncepte duhet të përdorur në çdo burim të së drejtës penale materiale. Për më tepër, pasi veprat plotësuese që lidhen me PP janë menduar të ketë mbulim të njëjtë si ato në Pjesën e përgjithshme të KP-së, është e tepërt që ato të përsëriten madje edhe sipas shprehjeve të ndryshme në *lex specialis*, e në veçanti pasi që tani PP-ja është zyrtarisht e përfshirë në Kodin e ri Penal në mesin e veprave të tjera të zakonshme penale (neni 308). Nëse megjithatë cilado prej veprave plotësuese në 2,7 shkon përtej fushëveprimit të KP-së, atëherë ajo vepër kërkon një përkufizim të duhur.

2.1.3. Klasifikimi për Rekomandimin 1

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
R.1	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Vepra e manipulimit të tregut nuk është e mbuluar në mesin e veprave të ndërlidhura penale me PP

		<ul style="list-style-type: none"> • Konfuzion dhe tepricë në përkufizimet që lidhen me të ardhurat nga krimi, si dhe në aspektin e nëse të ardhurat e veprimtarisë kriminale në përgjithësi mund të jetë subjekt i PP-së • Rregullimi i pamjaftueshëm i nivelit të kërkuar të provave për veprën e ndërlidhur penale në nenin 32, paragrafi 4.1 që shkakton paqartësi në mesin e praktikuesve dhe mosnjohje me dispozitat përkatëse nga ana e tyre. • Formulimi i paqartë dhe joadekuat i dispozitës që përcakton mbulimin e vetëpastrimit (neni 32, paragrafi 4.2) • Harmonizimi i kërkuar mes Ligjit për LPP/LFT dhe KP-së në drejtim të konceptit dhe terminologjisë sa i përket veprave plotësuese. • Efektiviteti i zbatimit të veprës PP nuk mund të vlerësohet për shkak të statistikave kundërbënës të ofruara për ekipin vlerësues dhe për shkak të mungesës së plotë të informacioneve shtesë në lidhje me rastet e pazgjidhura.
--	--	--

2.2. Përgjegjësia për veprën penale PP (R.2)

2.2.1. Përshkrimi dhe analiza

Përgjegjësia e personave fizikë (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.1, CETS 198 neni 9(3)) dhe elementi mendor i veprës penale PP (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.2)

255. Vepra penale PP shtrihet edhe te personat fizikë të cilët me vetëdije angazhohen në veprimtari të PP dhe madje shkon përtej këtij kufiri. Elementi i dijes sipas nenit 32.2 të Ligjit LPP/LFT është njohuria e kryerësit ("*kushdo që e ka ditur*") ose ka pasur bazë të arsyeshme për të ditur ("*ka pasur arsye për të ditur*") që pasuria që i nënshtrohet pastrimit përbën pasuri të fituar nga të ardhurat e krimit.

256. Elementi i fundit shkon përtej standardit të të qenit në dijeni, duke bërë që vepra penale e PP të jetë e zbatueshme për këdo në rast kur dijenia e drejtpërdrejtë e fajit nuk mund të provohet, por megjithatë mund të demonstron se ata kishin një shkak faktik, përmes të cilit ata duhet të kenë qenë në dijeni se pasuria kishte prejardhje nga krimi . Kjo do të thotë se kërkesa minimale është ulur në nivelin e standardit "duhet të ketë pas njohuri" ("duhet të ketë marrë me mend" në CETS 198), qasje e cila padyshim lehtëson provat e elementit mendor në raste të PP-së dhe kështu zgjeron fushëveprimin, ku neni 32.2 në mënyrë efektive mund të zbatohet në praktikë.

257. Në lidhje me këtë, dispozitat e Kosovës duket se tejkalojnë kërkesat e Konventave të Vjenës dhe Palermos. Nga ana tjetër, praktikuesit do të duhet t'i kushtojnë vëmendje faktit se standardi i zakonshëm i ligjit i tipit "duhet të ketë ditur" nuk përshtatet automatikisht në të drejtën civile në sistemin e formësuar të përgjegjësisë penale që tradicionalisht bazohet në konceptin e qëllimit dhe të neglizhencës (shih nenin. 17.1 të KP të ri ose nenin 11.1 i KPP-së që parashohin se personat janë penalisht përgjegjës nëse ata kryejnë një vepër penale me dashje ose nga pakujdesia). Standardi "Duhet të ketë qenë në dijeni" padyshim shkon përtej fushëveprimit të qëllimit të drejtpërdrejtë apo të mundshëm (shih nenin 21 të KP-së ose nenin 15 të KPP-së). Po ashtu, ato mund të merren edhe si të krahasueshme, të paktën teorikisht, për pakujdesi të pavetëdijshme, siç përcaktohet në nenin 23.3 të KP-së (neni 16.3 i KPP-së).

“Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mundur të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi”

258. Megjithatë, neni 17.2 i KP-së së ri (neni 11.3 i KPP-së) parasheh se përgjegjësia penale për kryerjen e një vepre penale nga pakujdesia zbatohet vetëm nëse këtë shprehimisht e përcakton ligji (p.sh. në rastin e vrasjes nga pakujdesia, neni 181 i KP-së, të bartjes së sëmundjeve ngjitëse nga pakujdesia, nenet 255.3 ose 258.2 të KP-së, të shkaktimit të falimentimit nga pakujdesia, neni 286.3 i KP-së, etj.) Në këto raste, ligji në mënyrë veçantë i referohet veprave përkatëse nga pakujdesia (në mënyrë tipike në një paragraf të veçantë), duke i emërtuar ato me përdorimin e termit të saktë ligjor "nga pakujdesia" ose "pakujdesia". Ligjvënësit në rastin e veprës penale të PP-së zgjodhën përdorimin e një koncepti dhe terminologjie të ndryshme për përcaktimin e nivelit të kërkuar të elementit mendor ("që të ketë arsye për të ditur", d.m.th. standardin e duhet të ketë ditur) i cili nuk shfaqet automatikisht i këmbyeshëm ose i zëvendësueshëm me termin përkatës të KP-së "neglizhencës (pavetëdije)" edhe nëse këto koncepte janë të përafërta dhe të krahasueshme me njëri-tjetrin.

259. Tani dikujt mund të i duket e ngatërruar se nga një aspekt formal, neni 32.2 nuk ka mbulim të qartë të *per definitionem* të një vepre të PP-së nga pakujdesia (i tillë që do ishte në përputhje me nenin 17.2 të KP-së), ndërsa PP e kryer nga një lloj *gjoja* pakujdesie të pavetëdijshme (standardi "duhet të ketë ditur") është një nga shumë drejtimet që janë thelbi i veprës penale të PP-së. Kjo mospërputhje në terminologjinë padyshim ka origjinën në faktin se zhvillimi i legjislacioni penal të LPP-së në Kosovë ka qenë gjithmonë (dhe aktualisht është) i ndarë nga kodet penale të cilës do periudhë kohore. Megjithatë vlerësuesit nuk e konsiderojnë këtë çështje mjaft serioze për të penguar zbatueshmërinë efektive të veprës penale të PP-së (të paktën ekipi i vlerësimit nuk është në dijeni të ndonjë përvojë negative në këtë drejtim).

260. Kërkesat e FATF R.2 janë adresuar në mënyrë të qartë dhe gjithashtu plotësuar nga neni 22 i KP-së së ri, sipas të cilit “*dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike*”.

261. Dispozita e cituar më lart është një risi në KP të ri duke qenë se ka hyrë në fuqi që nga 1 Janari i 2013. Deri atëherë, nuk kishte asnjë dispozitë të ngjashme me legjislacionin paraardhës, pra në Kodin e Përkohshëm Penal, dhe për këtë arsye pranueshmëria e konkluzioneve nga provat rrethore mund të bëhej e mundur përmes dispozitave të Kodit të procedurës penale që lejonin vlerësimin e lirë të provave (neni 152.2 i KPPP-së që parashihte që gjykata, “në bazë të vlerësimit të vet mund të pranojë dhe të marrë parasysh çdo provë të pranueshme që ajo e konsideron të rëndësishme dhe që ka vlerë dëshmuese (...) dhe do të ketë autoritetin të vlerësojë lirisht të gjitha provat e paraqitura në mënyrë që të përcaktojë rëndësinë ose pranueshmërinë e saj”, gjë e cila pak a shumë tani është e mbuluar me nenin 361,2 KPP).

Përgjegjësia e personave juridikë (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.3)

262. Përgjegjësia penale e personave juridikë për veprën penale të PP-së në mënyrë të veçantë parashihet në Ligjin aktual të LPP/LFT, dhe atë si më poshtë

“Neni 34

Përgjegjësia penale e personave juridikë

1. Nëse një person juridik kryen një veprë penale, të paraparë në këtë Ligj, çdo drejtues dhe person tjetër në lidhje me menaxhimin e personit juridik (dhe çdo person që pretendon të veprojë në kapacitet të tillë) kryen veprë penale, përveç nëse ai person dëshmon se:

1.1. vepra penale është kryer pa pëlqimin apo dijeninë e tij dhe

1.2. ka ndërmarr hapa të arsyeshëm për të parandaluar kryerjen e veprës që do të ishte ushtruar nga ai person duke pas parasysh natyrën e funksioneve të tij në atë kapacitet.

263. Siç mund të shihet, kjo dispozitë nuk e parashikon drejtpërdrejtë përgjegjshmërinë penale të personave juridikë, pasi që e merr si fakt që personat juridikë mund të kryejnë një veprë të PP-së. Në vend të kësaj, parashihet përgjegjësinë kolektive të personave fizikë që marrin pjesë në drejtimin dhe menaxhimin e personit juridik për vendimin e tyre kolektiv si rezultat i së cilit është kryer vepra përkatëse penale (aspektet e tjera të kësaj dispozite do të diskutohet më poshtë).

264. Sfondi më i gjerë ligjor, në ligjin e Kosovës, me të cilin përgjegjësia penale për PP shtrihet në personat juridik, përbëhet nga pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

- Ligji nr. 04/L-030 (2011) mbi përgjegjësinë penale të personave juridikë për veprat penale (në tekstin e mëtejshëm Ligji për PPPJ)

- KP i ri (sidomos neni 40 për përgjegjësinë penale të personave juridikë)

265. Të dy ligjet, LPPPJ dhe KP i ri hynë në fuqi më 1 janar 2013 (edhe pse i mëparshmi ishte miratuar që më 31 gusht 2011), që do të thotë se korniza ligjore sipas së cilës personat juridikë mund të ndiqen dhe të dënohen për vepra penale është themeluar së fundmi (KPP nuk ka përmbajtur ndonjë dispozitë të veçantë në këtë drejtim). Duke pasur parasysh se deri në këtë datë nuk kishte asnjë legjislacioni aktual në fuqi që parashihet përgjegjësinë penale të personave juridikë, është e qartë se neni 34 i cituar si më lart i Ligjit LPP/LFT, i cili ka të bëjë me përgjegjësinë penale të personave juridikë, mund të konsiderohet si i aplikueshëm de facto që nga 1 janari 2013 (edhe në qoftë se ai formalisht kishte qenë në fuqi edhe më parë).

266. Sipas nenit 3 të Ligjit PPPJ, dispozitat e KP dhe KPP të Kosovës janë përgjithësisht të zbatueshme ndaj personave juridikë, të cilët mund të marrin përgjegjësi për veprat penale të parashikuara në pjesën e posaçme të KP-së dhe për vepra të tjera penale, në kuptim që kushtet për përgjegjësinë penale të personave juridikë të jenë plotësuar. Pasi që vepra e PP është, të paktën formalisht, e parashikuar në KP të ri (neni 308) nuk ka asgjë kundër zbatueshmërisë së Ligjit PPPJ-së ndaj saj.

267. Përgjegjësia penale e korporatave shtrihet si tek personat juridikë vendas, ashtu edhe tek ata të huaj për vepra penale të kryera qoftë brenda ose jashtë territorit të Kosovës (për sa i entiteteve të huaja, përgjegjësia për vepra penale të kryera jashtë vendit zbatohet për aq sa vepra e dëmton Kosovën apo qytetarët e saj ose u shkakton dëme personave juridikë shtetërorë). Organet administrative dhe të qeverisjes vendore, si dhe organizatat e qeverive të huaja që veprojnë në Kosovë nuk do të thirren në përgjegjësi për veprat penale.

268. Baza dhe kufijtë e përgjegjësive penale të korporatave janë të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit PPPJ, nen i cili është në të gjitha detajet identik me nenin 40 të KP të ri. (Ekipi i vlerësimit në këtë pikë duhet të tërheq vëmendjen se përsëritja fjalë për fjalë këtij neni të njëjtë ndoshta ishte një tepëri e panevojshme veçanërisht duke marrë parasysh nenin 119 të KP ku është vendosur një lidhje e duhur në mes të dy ligjeve)

“Neni 5

Baza dhe kufiri i përgjegjesisë së personave juridikë

1. Personi juridik është përgjegjës për veprë penale të personit përgjegjës i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve ka kryer veprë penale me qëllim që atij personi juridik t’i realizoj ndonjë dobi ose dëm. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe atëherë kur veprimi i atij personi juridik ka qenë në kundërshtim me politikën afariste apo urdhrat e personit juridik.
2. Nën kushtet e parapara në paragrafin 1. të këtij neni, personi juridik është përgjegjës për veprë penale edhe nëse personi përgjegjës i cili ka kryer veprën penale nuk është dënuar për atë veprë penale.
3. Përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës.
4. Elementet subjektive të veprës penale të cilat ekzistojnë vetëm te personi përgjegjës vlerësohen në raport me personin juridik, nëse është realizuar baza e përgjegjesisë nga paragrafi 1. i këtij neni.”

269. Sipas nenit 5.1, baza e përgjegjesisë së korporatave është përgjegjësia e “personit përgjegjës”. Në ligjin e Kosovës ky term tregon një person fizik në kuadër të personit juridik, i cili ka besimin për kryerjen e detyrave të caktuara ose autorizimin për të vepruar në emër të personit juridik, si dhe ekziston besueshmëria e lartë se ai është i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik (përkufizimi i fundit mund të gjendet në mënyrë të barabartë në një formulim praktikisht identik, në nenin 2. paragrafi 1.1 i Ligjit PPPJ dhe nenin 120.5 të KP. Në këtë pikë, vlerësuesit kanë vërejtur se formulimi kumulativ i këtij paragrafi (përdorimi i “dhe” para fjalisë së fundit) nënkupton që dy kushtet e fundit duhen plotësuar në të njëjtën kohë, kështu që, Ligji duket se kërkon mundësi të lartë për autorizim në rast të personit i cili faktikisht është autorizuar tanimë. Duke pas parasysh se ky kusht shtesë kumulativ mundet qartazi ta kufizojë fushëveprimin e të dy ligjeve, formulimi në këtë paragraf duhet të rishikohet urgjentisht.

270. Paragrafët 2 dhe 3 parashohin hollësi të mëtejshme për sa i përket fushës së përgjegjesisë penale. Paragrafi 3 saktëson se përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit fizik përgjegjës, në të cilin konteksti termi "fajësi" domosdoshmërisht do të thotë se personi përgjegjës duhet të shpallet fajtor për veprën përkatëse penale si një parakusht që personi juridik të mund të thirret në përgjegjësi për të njëjtën veprë. Kjo është një normë e qartë, duke qenë në përputhje (nëse jo në mbivendosje) me dispozitat në paragrafin 1 të cituar më lart .

271. Pavarësisht nga e gjithë kjo, paragrafi 2 duket se është në drejtim të kundërt me atë që është dhënë në paragrafët fqinjë 1 dhe 3 në saktësimin se personi juridik do të jetë gjithashtu përgjegjës për veprën penale nëse personi përkatës, i cili ka kryer veprë penale, nuk është dënuar për këtë. Kjo rregull është në kundërshtim të qartë me ato të diskutuara më lart dhe kjo shkon deri në atë masë sa që tashmë pengon zbatueshmërinë e tërë nenit. Formulimi i paragrafit 2 ka pak gjasa të jetë rezultat i përkthimit të gabuar (duke pasur parasysh se formulim shumë i njëjtë mund të gjendet në dy pjesë të ndryshme të legjislacionit), por edhe në qoftë se ajo është bërë me qëllim, ekipi i vlerësimit deri më tani nuk kanë mundur të kuptojnë qëllimin e vërtetë që ligjvënësit kishin menduar ta arrijnë.

272. Kjo mund të jetë zgjidhje e mundshme nëse fjalia "nuk është dënuar për këtë" do ishte kufizuar në rastet kur personi përgjegjës fizik në të vërtetë ka kryer veprën penale megjithatë ai nuk mund të dënohet për atë për shkak të vdekjes së tij apo arratisjes. Në raste të tilla, mungesa e dënimit nuk do jetë e barabartë me mungesën e fajësisë, kështu që paragrafët 2 mund të zbatohen së bashku me dy paragrafët e tjerë. Megjithatë, në qoftë se shprehja "nuk është dënuar për veprë penale", përfshin rastet kur gjykata gjykon personin përgjegjës fizik,

por në fund i jep atij një gjykim të pafajësisë (për cilëndo arsye të parashikuar në nenin 364.1 të KPP të ri) përfundimisht do ndikonte në çështjen e fajësisë dhe kështu paragrafi 2 nuk do të jetë i zbatueshëm në kontekstin aktual.

273. Pyetja e radhës është nëse dhe se si neni 34 i lartcekur i Ligjit LPP/LFT mund të zbatohet së bashku me rregullat e përgjithshme të KP të ri dhe veçanërisht Ligjit PPPJ. Kjo do thotë se ndërsa KP dhe Ligji PPPJ parashikojnë që një person juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës (ku përgjegjësia penale e personit juridik varet nga fajësia e personit fizik përgjegjës), Ligji LPP/LFT parashikon që përgjegjësia penale e personit juridik sjell përgjegjësinë e të gjithë drejtuesve të tij dhe atyre të përfshirë në menaxhimin e tij (përveç nëse ata mund të përjashtohen në pajtim me nënparagrafët 1.1 ose 1.2). Me fjalë të tjera, përgjegjësia *quasi* kolektive thuhet se e të gjithë drejtuesve dhe menaxherëve për veprën penale të PP-së të kryer nga personit juridik përkatës kërkon që vepra të jetë kryer nga personi juridik (shih Nenin. 34 të Ligjit LPP/LFT), i cili megjithatë mund të zë vend vetëm me kusht që një ose më shumë persona përgjegjës të subjektit të njëjtë (një ose më shumë prej drejtuesve dhe menaxherëve të përmendur më lart) mund të shpallen personalisht përgjegjës, si persona fizikë, për të njëjtën veprë (shih nenin 5.1 dhe 5.3 të Ligjit PPPJ - dhe interpretimin më të favorshëm të nenit 5.2). Gjersa këto dispozita nuk janë domosdoshmërisht të kundërta me njëra-tjetrën, ato padyshim tregojnë dy qasje të ndryshme në lidhjen e subjekteve juridikë për personat fizikë, duke qenë përgjegjës për aktet e kryera përkatëse nga ose në emër të personit juridik, i cili mund të ngrejë disa çështje të interpretimit në rastet konkrete, veçanërisht pasi që regjimi i ndryshëm vlen vetëm për veprën e PP dhe jo për veprat e ndërlidhura penale.

274. Sa i përket përputhjes me nenin 10, paragrafët (1) dhe (2) të CETS 198, mund të përcaktojmë se neni 5.1 i Ligjit PPPJ mbulon veprën e përkufizuar në nenin 10 (1), por jo atë të përkufizuar në nenin 10 (2). Përkufizimi në nenin 10 (1) parasheh që personat juridikë të konsiderohen përgjegjës për veprat penale të PP-së të kryera për përfitimin e tyre nga një person fizik që ka një pozicion drejtues brenda këtij personi juridik, i cili është mbuluar afërsisht në veprën penale të kryer nga personi fizik përgjegjës në bazë të nenit 5.1 të Ligjit PPPJ. Përkufizimi në nenin 10 (2) megjithatë i referohet përgjegjësisë së personave juridikë në rastet kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga i njëjti person fizik (d.m.th. ai që i plotëson kushtet për "person përgjegjës" në ligjin PPPJ) ka bërë të mundur kryerjen e veprës së PP-së për të mirën e atij personit juridik" nga një person fizik nën autoritetin e tij", pra që vepra e PP-së në vetvete nuk është kryer nga "personi përgjegjës", por si pasojë e mosveprimit të tij – ku kuptimi i tij qartë shkon përtej fushëveprimit të nenit 5 të Ligjit PPPJ pasi që ai është i bazuar në përgjegjësinë penale të personit fizik përgjegjës.

Procedurat e mundshme paralele civile apo administrative (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.4)

275. As KP e as Ligji PPPJ nuk përmbajnë ndonjë dispozitë të qartë në lidhje me mënyra të tjera të përgjegjësisë (civile apo administrative) të zbatueshme për persona juridikë, prandaj ende nuk ka mundur të përcaktohet se nëse dhe deri në çfarë mase përgjegjësia penale e personave juridikë do parandalonte masat e mundshme paralele civile, administrative ose sanksionet - edhe në qoftë se nuk ka gjasa që burime të tjera të legjislacionit administrativ të përmbajnë dispozita përkatëse në këtë fushë.

276. Veç kësaj, ekipi vlerësues ka dyshime rreth kuptimit të përgjithshëm të kësaj çështjeje duke pasur parasysh përgjigjet thellësisht të ndryshme që ata kanë pranuar nga autoritetet ndryshme në lidhje me këtë. Ndërsa Prokuroria e Shtetit u shpreh se ishte e mundur për të kryer dy ose më shumë procedura të ndara kundër të njëjtit person juridik në të njëjtën kohë (p.sh. një procedurë administrative dhe një procedurë penale në të njëjtën kohë), Ministria e Punëve të Brendshme nga ana tjetër kishte mendimin se në raste të tilla, procedurat e tjera civile apo administrative nuk mund të kryhen derisa fajësia apo pafajësia e personit juridik

shpallet me një gjykim përfundimtar. Ekipit të vlerësimit nuk i është dhënë informacion i mëtutjeshëm në lidhje me atë se çfarë procedurash të tjera civile ose administrative mund të aplikohen në këtë kontekst, dhe cilat sanksione mund të shqiptohen.

Sanksionimi i pastrimit të parave (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.5)

277. Sanksionet penale të zbatueshme për personat fizikë për veprën e PP-së, të parapara në nenin 32, paragrafi 2.8 të Ligjit LPP/LFT janë si në vijim:

- deri në 10 vjet burg;

- dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe se vlera e pasurisë që është subjekt i veprës penale të PP-së.

278. Neni 46.1 i KP të ri parasheh se dënimi me gjobë nuk mund të jetë më i vogël se 100 € apo më i madh se 25.000 €, megjithatë, në rastin e veprave penale që lidhen, ndër të tjera, me terrorizëm, krim të organizuar apo vepra penale të kryera për përfitim material, shuma maksimale e gjobës shkon deri në 500.000 € (shtrirja e paraparë në nenin. 39.1 të KPP-së që ishte në fuqi deri në fund të vitit 2012 ishte 50 € deri 25.000 € dhe 500,000 € përkatësisht). Natyrisht, kategoria e fundit i referohet edhe veprave që penale të PP që lidhen me veprat e ndërlidhura penale që i plotësojnë këto kushte. Nëse personi i dënuar nuk është i gatshëm ose nuk ka mundësi të paguajë gjobën, gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim (shih nenin 46.3 të KP-së ose nenin 39,3 të KPP-së).

279. Kjo shtrirje e dënimit përgjithësisht është zbatueshme për cilëndo formë të veprës penale të PP-së pasi që ligji nuk saktëson ndonjë rast të rëndë të PP-së që do të kërcënohej me sanksione më të ashpra. Nga ana tjetër, sanksionet janë padyshim jobindëse (edhe në kontekstin e dënimeve në dispozicion për krime tjera të rënda ekonomike) dhe shtrirja e tyre është mjaft e gjerë për t'i lejuar hapësirë të mjaftueshme gjykatës të diskutojë mbi dënimin që është proporcional me veprën përkatëse.

280. Në pajtim me nenin 8.2 të Ligjit PPPJ, llojet e dënimeve të zbatueshme për personat juridikë janë gjobat dhe ndërprerja e veprimtarisë. Llogaritja e shumës së gjobës së zbatueshme për personat juridikë për një vepër të caktuar penale është e bazuar në shtrirjen përkatëse të dënimit të paraparë në KP për të njëjtën vepër. Rregullat për shndërrimin e dënimeve të imponuara për persona fizikë ndaj atyre që zbatohen për subjektet juridike mund të gjenden në nenin 9 të Ligjit PPPJ. Pasi që vepra penale e PP-së kërcënohet me 10 vjet dënim, ajo është trajtuar në nenin 9, paragrafi 2.3 i cili parashikon se për vepra penale, ku dënimi është dhënë me burgim në kohëzgjatje 8-20 vjet, gjykata mund të shqiptojë dënim me gjobë prej 15,000 € 35,000 € . Krahasuar me gjobat e zbatueshme për personat fizikë për të njëjtën vepër penale, ky kufi është jashtëzakonisht i ulët edhe nëse marrim parasysh se gjobë mund të shqiptohet edhe në bazë të vlerës së pronës së pastruar (deri në trefishin e kësaj vlere). Ekipit të vlerësuesve i ka mbetur e paqartë nëse këto dy lloje të gjobave mund të aplikohen kumulativisht.

281. Pushimi i veprimtarisë mund të shqiptohet nëse personi juridik (përveç njësive të vetëqeverisjes lokale dhe partive politike) është themeluar me qëllim të kryerjes së veprave penale apo veprimtarinë e ka shfrytëzuar kryesisht për kryerjen e veprave penale (neni 11 i Ligjit PPPJ). Ky sanksion zbatohet përmes likuidimit të personit juridik.

2.2.2. Rekomandime dhe komente

Përgjegjësia e personave fizikë (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.1, CETS 198 neni 9(3)) dhe elementi mendor i veprës penale të PP (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.2)

282. Ngjashëm me çështjen e veprave plotësuese, vepra e PP-së ngërthen formulimet dhe konceptin, i cili nga njëra anë është në përputhje me standardet ndërkombëtare përkatëse (madje edhe shkon tutje nga to), por në anën tjetër nuk përshtatet lehtë në kontekstin e Kodit Penal për shkak të qasjes dhe terminologjive të ndryshme të përdorura në këto dy ligje. Elementi i njohurisë për nenin 32.2 të Ligjit LPP/LFT (dijenja ose arsyeja për të ditur) mund të shndërrohet me një interpretim pak a shumë më të gjerë në gjuhën e KP-së bazuar në konceptin e niveleve të ndryshme të qëllimit dhe pakujdesisë, por ekipi vlerësues do ta konsideronte si më të përshtatshme nëse konceptet the termat e njëjtë do të përdoreshin në të gjitha burimet e të drejtës materiale penale, që në veçanti i referohet elementeve të tilla themelore të përgjegjësisë penale si këto komponentë të *mens rea*.

283. Autoritetet e Kosovës prandaj duhet të rishqyrtojnë nëse dhe si elementi i dijenisë në veprën e PP-së i plotëson standardet përkatëse të përcaktuara nga KP dhe të sigurojë barasvlefshmërinë e ndërsjellë të këtyre shprehjeve qoftë përmes një zgjidhjeje legjislative (p.sh. duke shtuar një dispozitë tjetër shpjeguese në paragrafin 4) ose duke zhvilluar jurisprudencën në këtë fushë. Nga ana tjetër, do të ishte më e leverdishme nëse ligjvënësit do e përshtatnin formulimin aktual të nenit. 32.2 në terminologjinë përkatëse të Kodit Penal (duke përfshirë mbulimin e qartë të pakujdesisë në PP pasi që shprehja "arsyeja për të ditur", në të vërtetë e mbulon, siç është supozuar nga ana e ekipit të vlerësimit, formën e veprës së pakujdesisë).

Përgjegjësia e personave juridikë (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.3)

284. Autoritetet e Kosovës duhet të rishikojnë nëse në të vërtetë është nevojshme të përdoren gërmë për gërmë dispozitat e nenit 5 të Ligjit PPPJ dhe nenit 40 të KP-së të ri gjatë përkufizimit të bazës dhe kufijve të përgjegjësisë penale të korporatave, me një vëmendje të veçantë për nenin 119 të KP që krijon një tjetër lidhje të përshtatshme në mes të dy ligjeve. Njëri nga këto nene duhet përfundimisht të braktiset (duket më e arsyeshme të mbahet ai në Ligjin PPPJ dhe të fshihet tjetri nga KP).

285. Në këtë kontekst, problemi më urgjent është kundërthënia ndërmjet paragrafëve 1 dhe 3, në njërin anë dhe paragrafit 2, nga ana tjetër, ashtu siç u diskutua më në hollësi në pjesën përshkruese. Siç u vërtetua, duket se paragrafi 2 është në kundërshtim me paragrafët fqinjë 1 dhe 3 në saktësimin se personi juridik gjithashtu është përgjegjës për veprën penale nëse personi përkatës, i cili ka kryer vepër penale, nuk është dënuar për atë. Ekipi vlerësues u përpoq të gjente zgjidhje të mundshme ku bashkëjetesa e dispozitave në dukje kundërthënëse mund të shpjegohej, por duhet lënë autoriteteve kosovare të vendosin, së pari, cili është qëllimi që ata në të vërtetë kanë synuar të arrijnë me këtë legjislacion dhe së dyti cilat ndryshime duhet bërë në mënyrë që formulimet e ligjit në fakt të përfaqësojnë këto qëllime. Cilado zgjidhje që merret qoftë paragrafët 1 dhe 3 ose paragrafi 2 duhet të modifikohen në përputhje me rrethanat.

286. Formulimi kumulativ në definicionin “personi përgjegjës” (neni 2.1.1 i Ligjit për PPPJ dhe neni 120.5 KP) duhet të rishikohet urgjentisht dhe të përmirësohet. Teksti aktual nënkupton se kërkohen së paku të plotësohen dy kushte në të njëjtën kohë, dhe edhe nëse vlerësuesit besojnë se ky formulim nuk e reflekton dëshirën aktuale të ligjvënësve, definicioni, ashtu si është tani, mundet qartazi ta kufizojë fushëveprimin e aplikimit të të dy ligjeve. Nëse këto kushte janë menduar të jenë alternative, atëherë kjo karakteristikë duhet të pasqyrohet duke e përdorur termin “apo/ose” në vend të “dhe”.

287. Pasi që ligjvënësit të kenë krijuar harmoni brenda kontekstit të nenit 5 të PPPJ-së (ose nenit 40 të KP-së), ata duhet të gjejnë harmoninë mes legjislacionit të përgjithshëm mbi

përgjegjësinë penale të korporatave dhe rregullat përkatëse të veçanta në nenin 34 të Ligjit LPP/LFT. Siç u vërtetua më lart, këto dispozita nuk janë domosdoshmërisht të kundërta me njëra-tjetrën, por ato paraqesin dy qasje të ndryshme në lidhjen e subjekteve juridike për personat fizikë përkatës që janë përgjegjës për veprat e kryera nga ose në emër të personit juridik, dhe mospërputhjet e tilla përfundimisht mund ngrenë çështjen e interpretimit në raste konkrete, veçanërisht në qoftë se është fjala për persona juridikë që mbahen përgjegjës për veprën penale të PP-së dhe për vepra të tjera penale (jo domosdoshmërisht për vepra të ndërlydhura penale) në procedurën e njëjtë.

288. Autoritetet e Kosovës duhet të gjejnë gjithashtu një zgjidhje legislative për të siguruar mbulimin e nenit 10, paragrafi (2) të CETS 198 sa i përket përgjegjësisë së personave juridikë në rastet kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga ana e personit përgjegjës ka bërë të mundur kryerjen e veprës së PP-së për përfitimin e atij personi juridik, por nga një person tjetër fizik nën autoritetin e tij (që do të thotë se vepra e PP-së në fakt është kryer si pasojë e mosveprimit të personit përgjegjës).

Procedurat e mundshme paralele civile apo administrative (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.4)

289. Për shkak të mungesës së plotë të informacioneve relevante, ekipi i vlerësuesve nuk ka mundur ta vlerësojë nëse dhe cilat procedura të tjera civile apo administrative aplikohen për personat juridikë, si dhe të krijojë një opinion e të jap rekomandime adekuate në këtë fushë.

Sanksionet për pastrimin e parave (FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.5)

290. Ndërsa sanksionet penale të aplikueshme për personat fizikë për veprën PP u konstatuan të jenë jobindëse dhe proporcionale, e njëjta nuk mund të thuhet në lidhje me dënimet në dispozicion ndaj personave juridikë. Një gjobë prej 15,000 € deri 35,000 € nuk mund të merret si proporcionale dhe bindëse kështu që nuk mund të jetë as efektive. Në mënyrë që të zgjidhet ky problem, autoritetet e kosovare duhet të rishqyrtojnë vlerat për konvertimin e dënimeve me burgim në dënim me gjobë, të zbatueshme për personat juridikë ose futjen e faktorëve shtesë, përmes të cilëve shuma e konvertuar mund të rritet më tej ose në rrethana të caktuara edhe të shumëzohet.

2.2.3. Klasifikimi për Rekomandimin 2

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
R.2	PP	<ul style="list-style-type: none"> • paqartësi serioze në legjislacionin që ka të bëjë me çështjet themelore të përgjegjësisë penale të korporatave (nëse janë apo jo kjo varet nga fajësia e personit fizik) • dispozita joefektive dhe të buta për sanksionimin e personave juridikë për vepra penale (prag i ulët i dënimit) • kërkohet harmonizimi ndërmjet Ligjit LPP/LFT dhe KP-së ose Ligjit PPPJ në kuptimin e termave, koncepteve dhe terminologjisë sa i përket: <ul style="list-style-type: none"> ○ standardit të dijenisë të zbatueshëm në veprat penale të PP (Ligji LPP/LFT ndaj KP) ○ baze të përgjegjësisë penale të korporatave dhe ato në lidhje me personat fizikë (neni 34 i Ligjit LPP/LFT ndaj nenit 40 të KP-së / nenit 5 të ligjit PPPJ)

2.3. Penalizmi i financimit të terrorizmit (RV.II)

2.3.1. Përshkrim dhe analizë

Penalizmi i financimit të terrorizmit (FATF RV.II: Kriteri thelbësor II.1)

Financimi i aktit terrorist

291. Financimi i terrorizmit ka qenë tradicionalisht i penalizuar në ligjin e Kosovës në kuadër të veprës penale të lehtësimit të kryerjes së terrorizmit. Ishte neni 112 i Kodit të Përkohshëm Penal që ishte në fuqi deri në fund të vitit 2012 që këtë vepër e ka paraparë si në vijim:

“Neni 112 Lehtësimi i kryerjes së terrorizmit

(1) Kushdo që siguron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde a mjete të tjera materiale që përdoren pjesërisht ose tërësisht me qëllim të kryerjes së terrorizmit dënohet me burgim prej pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

(2) Kushdo që nga pakujdesia kryen vepër nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.”

292. Dy paragrafët e radhës (3-4) i referohen aspekteve të tjera, përmes të cilave terrorizmi mund të lehtësohet, siç janë: rekrutimi si dhe dhënia ose marrja e udhëzimeve dhe trajnimi për qëllime terroriste, i cili gjithashtu ka mbetur jashtë fushëveprimit të FT. Atëherë ka qenë paragrafi (5) i cili ka mbuluar ndër të tjera, dërgimin ose transferimin e "burimeve materiale të tjera" në Kosovë dhe jashtë saj, me qëllim të kryerjes së terrorizmit:

“(5) Kushdo që me qëllim të kryerjes së terrorizmit dërgon ose transferon grupe të armatosura, pajisje, armë ose mjete materiale të tjetra në Kosovë ose jashtë saj dënohet me burgim prej dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

i cili në këtë drejtim ishte në një paralelizëm të dukshëm me veprën e përcaktuar në paragrafin (1) si më lart. Ndërsa të gjitha këto vepra mbulojnë veprimet të cilat shtrihen vetëm për financimin e aktit terrorist ("për qëllime të kryerjes së terrorizmit") ishte edhe një dispozitë e veçantë nën nenin 113.2 që parashihet financimin e organizatës (grupit) terrorist i dhënë si në vijim:

“Neni 113 Organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste

(2) Kushdo që i siguron përkrahje një grupi terrorist dënohet me burgim prej tre deri në dhjetë vjet.

Ku neni 109. 6 përkufizonte se shprehja “përkrahje grupit terrorist” përfshinte (në mes tjerash) “sigurimin a mbledhjen e fondeve ose mjeteve të tjera financiare me qëllim, dijëni ose arsye të bazuar për të besuar se ato do të përdoren tërësisht ose pjesërisht nga një grup terrorist”.

293. Në procesin e hartimit të KP-së të ri kjo strukturë e ndërlikuar është ndryshuar me një qëllim të dukshëm për të mbledhur dhe të ndarë veprimet e FT-së brenda fushës së veprave penale të karakterit terrorist. Si rezultat, vepra penale e lehtësimit të kryerjes së terrorizmit, parashikuar tani në nenin 138 të KP-së së ri, përfshin edhe financimin e aktit terrorist dhe atë të organizatës terroriste:

“Neni 138 Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit

1. Kushdo që në çfarëdo mënyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ofron, kërkon, mbledh ose fsheh fonde apo mjete të tjera materiale me dashje, dijeni ose bazë të arsyeshme për të besuar se do të përdorën tërësisht ose pjesërisht për apo nga grupi terrorist ose për kryerjen e veprës terroriste, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

2. Kushdo që e ndihmon kryesin apo bashkëpjesëmarrësin pas kryerjes së një vepre terroriste, duke i siguruar fonde ose burime të tjera materiale personit apo personave të tillë, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

294. Legjislacioni i ri më nuk e parasheh veprën e pakujdesisë në FT (siç ishte në nenin 112.2 të KPP-së), e cila është mjaft e arsyeshme në rast të një vepre penale që bazohet në element të qëllimshëm. Rekrutimi dhe trajnimi tani janë penalizuar në vepra të veçanta (neni 139-140) dhe vepra e organizimit dhe pjesëmarrjes në grup terrorist (neni 143) më nuk e përfshin komponentin e financimit (pasi që tani ai bën pjesë në nenin 138.1). Vepra e rënduar e përkufizuar në nenin 112.5 të KPP-së tani mund të gjendet në strukturën e një vepre tjetër penale të quajtur përgatitja e veprave terroriste apo veprave penale kundër rendit dhe sigurisë së Kosovës (neni 144), ku paragrafi 4 parasheh:

“Kushdo që me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave terroriste nga ky Kapitull, dërgon apo bart grupe të armatosura, pajisje ose burime të tjera materiale në Kosovë ose jashtë saj, dënohet me burgim prej dhjetë (10) deri në njëzet (20) vjet.”

në të cilin përkufizimi i “burimeve materiale” në paragrafin (2) përfshin në mes të tjerash një varg burimesh, duke përfshirë “shërbimet financiare” që këtë vepër prapë e sjell në një paralelizëm me veprën e duhur FT-së në nenin 138.1 të cituar më lart.

295. Sido që të jetë, legjislacioni i ri penal parasheh një strukturë dhe formulim që është më në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare të përcaktuara me nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare për Shuarjen e Financimit të Terrorizmit (më tutje në tekst Konventa FT) dhe rekomandimeve të veçanta të FATF II. Duke pasur parasysh, se ekipi vlerësues nuk ishte në dijeni të ndonjë zbatimi aktual të legjislacionit penal të ish LFT –së në çfarëdo rasti konkret penal (nuk ka pasur hetime ose ndjekje për çfarëdo vepre në lidhje me FT) duket si e panevojshme t’i hyhet ndonjë analize të thellë dispozitave të vjetra të KKP-së që ishin të zbatueshme në penalizimin e FT deri në fund të vitit 2012, dhe në vend të tij vlerësimi do të përqendrohen në dispozitat përkatëse të KP-së së ri.

296. Në strukturën e KP-së së ri janë paraparë, deri në çfarëdo mase, veprat e financimit aktual të çdo aspekti të terrorizmit si në vijim:

- Neni 138 - Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit (financimi i aktit terrorist apo organizatës terroriste, shihni citatin si më lart)

- Neni 144.4 - Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (mundësia mbulimit të financimit të aktit terrorist, shihni citatin si më lart)

- Neni 137.3 - Ndihma në kryerjen e terrorizmit (ky paragraf për arsye të panjohura është pothuajse fjalë për fjalë identik me nenin 138.2 të cituar si më lart)

- Neni 139 - Rekrutimi për terrorizëm (shprehimisht i referohet atyre që rekrutojnë financues të terrorizmit).

297. Financimi i aktit terrorist, siç kërkohet në Kriterin II.1 (a) shprehimisht është i penalizuar nën nenin 138.1 të KP-së (“për kryerjen e aktit terrorist”). Përkitazi me këtë, shprehjes “akt terrorist ” i është dhënë një përkufizim gjithëpërfshirës dhe i rëndësishëm në nenin 135.1 dhe atë si në vijim:

“Terrorizëm, vepra terroriste apo vepër penale e terrorizmit - kryerja e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të moskryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Kosovës, të një shteti tjetër ose të një organizate ndërkombëtare⁴⁸

- 1.1. vrasja apo vrasja e rëndë (nenet 178 dhe 179)
- 1.2. shtytja apo ndihma në vetëvrasje (neni 183)
- 1.3. sulmi, sulmi me lëndim të lehtë trupor dhe sulmi me lëndim të rëndë trupor (nenet 187-189)
- 1.4. veprat penale kundër integritetit seksual (nenet 230-232, 235-239 ose 241)
- 1.5. marrja e pengjeve, rrëmbimi ose privimi i kundërligjshëm nga liria (nenet 175, 194 ose 196)
- 1.6. ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore; ndotja ose shkatërrimi i mjedisit (neni 270 dhe Kapitulli XXVII)
- 1.7. shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm; zjarrvënia apo djegia ose shpërthimi nga pakujdesia (nenet 334 ose 365)
- 1.8. shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike apo rrezikimi i trafikut publik (nenet 129, 366, 378 ose 380)
- 1.9. furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike apo kimike (nenet 176, 369 ose 372-377)
- 1.10. përvetësimi i paautorizuar, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorimi i armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike apo kimike, ose hulumtimet për armët biologjike ose kimike apo krijimi i tyre (referenca e njëjtë si më lart te 1.9)
- 1.11. rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht (neni 173)
- 1.12. rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to (neni 174)
- 1.13. rrëmbimi i fluturakes ose marrja e kundërligjshme e fluturakes (neni 164) apo rrëmbimi i mjeteve të tjera të transportit publik a të transportit të mallrave (nuk është dhënë ndonjë referencë e veçantë)
- 1.14. rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil (neni 1.15)
- 1.15. rrëmbimi i anijeve ose rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar (neni 166)
- 1.16. rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në dete apo oqeanë (neni 167)
- 1.17. përvetësimi, përdormi, transferimi ose deponimi i paautorizuar i materialeve nukleare (neni 176)

⁴⁸ Formati (por jo përmbajtjet) i listës së veprave është redaktuar për qëllimet e këtij Raporti. Referencat janë dhënë në nenet përkatëse të KP-së së ri.

1.18. kanosja për përdorimin apo vjedhjen ose grabitjen e materialeve nukleare (Neni 177)

ose

1.19. kanosja për kryerjen e ndonjëres prej veprave të saktësuara në nënparagrafët 1.1 deri në 1.18 të këtij paragrafi

298. Siç mund të shihet më lart, neni 135.1 parasheh një përkufizim të përgjithshëm për "terrorizëm" "akt terrorist" dhe "vepër të terrorizmit" e që këto shprehje paraqiten si të barasvlershme në legjislacionin penal të Kosovës. Në anën tjetër vepra e FT në nenin 138.1 i referohet financimit të "aktit terrorist", i cili më tutje është një shprehje tjetër ligjore madje edhe në origjinalin në shqip (shprehjet e përkufizuara me nenin 135.1 janë "*terrorizëm*" "*veprim terrorist*" dhe "*vepër e terrorizmit*", ndërsa në nenin 138.1 është paksa më ndryshe "*vepra terroriste*") ku paraqiten një laramani e shprehjeve, që në vështrim të parë, janë paksa të ngatërruara për ata që nuk janë aq të njohur me terminologjinë ligjore të gjuhës shqipe.

299. Duke qëndruar me nenin 136, përmes të cilit përkufizohet vepra penale e kryerjes së veprës terroriste, dikush mund të konstatojë se kjo zbatohet edhe më tutje me shprehje të ndryshme për të njëjtin koncept, domethënë "vepër e terrorizmit" dhe "veprim terrorist" si në vijim:

"Neni 136

Kryerja e veprës terroriste

1. Kushdo që kryen një vepër terroriste dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim.
2. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndime të rënda trupore të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim.
3. Kur vepra nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me vdekje të një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet ose me burgim të përjetshëm.

300. Të dy këto shprehje në anglisht janë megjithatë ekuivalente me shprehjen origjinale shqipe "*vepra terroriste*" e që është, siç u diskutua më sipër, e përkthyer si "akt terrorist" në veprën FT në nenin 38.1 kështu që mund të thuhet se në këtë aspekt të dy veprat penale i referohen konceptit shumë të njëjtë. Për më tepër, neni 144, paragrafi (1) dhe (4) saktësojnë se nenet 135-142 të gjitha përkufizojnë "(veprimin e) veprave terroriste" (që qartë shkon përtej përkufizimit të dhënë në nenin 135.1). Gjithashtu duke pasur parasysh se neni 135 nuk parasheh vepër penale, por përcakton shpjegime të shprehjeve të përdorura në nenet e mëvonshëm të KP-së, ekipi vlerësues ka mendimin se mospërputhje e lehtë në terminologji nuk duket të jetë e qëllimshme dhe për këtë arsye ata janë të gatshëm për të pranuar, për momentin, se shprehjet "akt terrorist" në nenin 138.1 dhe "akt / vepër terroriste" në nenin 136 janë të mbuluara në mënyrë të barabartë me përkufizimin shpjegues në nenin 135.1 të cituar më lart. Rrjedhimisht, përkufizimi i gjerë në nenin 135.1 është i zbatueshëm edhe për veprën e FT-së në nenin 138.1 dhe veprën terroriste në nenin 136 (kjo është një pyetje tjetër për t'u diskutuar më poshtë nëse veprat në lidhje me terrorizmin në nenet 136-144 do të hyjnë në këtë kategori).

301. Në këtë kontekst, një "vepër e terrorizmit" në nenin 136 do bëhej me kryerjen e ndonjëres prej veprave penale të përkufizuara dhe të renditura në nenin 135.1 të cituar më lart, më saktësisht, cilado prej veprave penale të renditura në nënparagrafët 1,1-1,18 nëse vepra përkatëse është kryer për qëllimet e saktësuara në pjesën paraprake të paragrafit 1 ("*me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, etj*")

302. Ligjvënësit kosovarë pra nuk kanë zgjedhur të parashohin, nga njëra anë, një veprë "gjenerike" të aktit terrorist në përputhje me përkufizimin e dhënë në nenin 2 (1) b të Konventës së FT-së dhe në anën tjetër, të penalizojnë veprat e ndryshme terroriste të përshkruara në nëntë traktate që janë si aneksi i të njëjtës Konventë në pajtim me nenin 2 (1) a. Ndërsa ata kanë penalizuar pothuajse secilën nga nëntë "veprat e traktatit" (shih tabelën më poshtë) ata vendosën për të mbuluar pjesën e mbetur "gjenerike" të aktit terrorist, duke iu referuar veprave penale përkatëse tradicionale përmes të cilave mund të barten komponentët e tij. Si rezultat, trajtimi i nenit 2 (1) të Konventës FT parasheh si në vijim:

- Neni 2(1)a ("një veprim që përbën shkelje brenda kuadrit të shkeljeve të përcaktuara në një prej traktateve të renditura tek aneksi") shihni nënparagrafët 1.5 dhe prej 1.11 to 1.18 të nenit. 135.1 të KP-së (referencat në tabelën e mëposhtme)

- Neni 2(1)b ("çdo akt tjetër që ka për qëllim të shkaktojë vdekjen ose plagosjen e rëndë trupore të një civili ose të çdo personi i cili nuk merr pjesë aktive në armiqësitë e situatave të një konflikti të armatosur ...") shihni nënparagrafët e tjerë të cilët i referohen veprave penale ku mund të shkaktohet vdekja apo lëndime të rënda, siç janë vrasja (1.1), sulmi (1.2) dhe të tjera.

303. Siç u përmend më lart, të gjitha shkeljet e renditura në paragrafin 1,1-1,18 mund të përbëjnë një akt terrorist nëse kryhen për qëllimin e parashikuar në paragrafin paraprak të nenit 135.1 e cila është e pranueshme për veprat që mbulojnë veprën "gjenerike" (neni 0,2 (1) b i Konventës FT), por përfundimisht jo për ato përmes të cilave mbulohen nëntë "kundërvajtjet nga traktati" (neni 2 (1) a idem).Arsyeja është se neni 2 (1) kërkon nga shtetet që të penalizojnë financimin e veprave nga traktati pa asnjë element shtesë të qëllimshëm dhe kështu ajo është në kundërshtim me konventat që parashohin kërkimin e provave se një veprë e veçantë nga traktati është bërë me qëllim të caktuar (të tilla si ato në nenin 135.1).

304. Për shembull, vepra e rrëmbimit në Konventën për ndalimin e marrjes së paligjshme të Avionëve (e cila është e shënuar në aneks të Konventës FT) nuk kërkon prova se rrëmbimi është bërë për një qëllim të veçantë. Konventa FT vetëm kërkon që financimi i kësaj vepre rrëmbimi të penalizohet. Në rastin e Kosovës, KP i ri e ka penalizuar veprën e rrëmbimit plotësisht në përputhje me Konventën përkatëse (shih nenin 164), por ajo vetëm mund të konsiderohet si një "akt terrorist" dhe kështu financimi i tij mund të konsiderohet si një veprë FT e paraparë në nenin 138.1 nëse rrëmbimi është kryer për qëllimin e parashikuar në pjesën paraprake të nenit 135.1, ku qasja është kufizuese dhe nuk plotëson standardet e Konventës FT.

305. Në rastin e marrjes së pengjeve, e cila është një nga veprat e parapara në traktat, elementi i qëllimshëm bëhet pjesë e vet veprës sipas Konventës ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve. Në këtë rast, KP i ri ka penalizuar veprën (neni 175) me një miratim jo të plotë të elementit të qëllimshëm përkatës (nuk është përfshirë detyrimi për persona fizikë ose juridikë apo për një grup personash), e që është vetëm problemi i parë. Problemi i dytë është renditja e kësaj vepre në nenin 135, paragrafi 1.5 që do të thotë se ajo mund të konsiderohet si një "akt terrorist" nëse kryhet për qëllimet e saktësuara në nenin. 135.1 - dhe kjo është qartazi e tepërt në rastet e veprës penale që përndryshe përmban element të qëllimshëm.

Tabela 6 : Konventat e renditura në Aneksin e Konventës së FT

Konventa për ndalimin e rrëmbimit të paligjshëm të aeroplanëve, e hartuar në Hagë më 16 dhjetor 1970	Neni 135.1.13 ← Neni 164 i KP Rrëmbimi i aeroplanit apo marrja e paligjshme e aeroplanit
Konventa për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil, e hartuar	Neni 135.1.14 ← Neni 165 i KP Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil

në Montreal më 23 shtator 1971	
Konventa për parandalimin dhe ndëshkimin e krimeve kundër personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, përfshirë diplomatët, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 14 dhjetor 1973	Neni 135.1.11 ← Neni 173 i KP Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare Neni 135.1.12 ← Neni 174 i KP Rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe personelit në marrëdhënie me to
Konventa ndërkombëtare kundër marrjes së pengjeve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 17 dhjetor 1979	Neni 135.1.5 ← Neni 175 i KP Marrja e pengjeve (me një mbulim të kufizuar në lidhje me organet që mund të detyrohen)
Konventa për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor, e miratuar në Vjenë më 3 mars 1980	Neni 135.1.17 ← Neni 176 i KP Përvetësimi i paautorizuar, shfrytëzimi, transferi dhe vendosja e materialeve bërthamore Neni 135.1.18 ← Neni 177 i KP Kërcënimet për përdorimin, ose kryerjen e vjedhjes apo të plaçkitjes të materialeve bërthamore
Protokolli për shtypjen e akteve të paligjshme të dhunës në aeroportet që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar, shtojcë e Konventës për shtypjen e akteve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil, hartuar në Montreal më 24 shkurt 1988	Neni 135.1.14 ← Neni 165 i KP Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil
Konventa për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar (Konventa SUA), hartuar në Romë më 10 mars 1988	Neni 135.1.15 ← Neni 166 i KP Rrëmbimi i anijeve apo rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar ⁴⁹
Protokolli për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse në dete dhe oqeanë (Protokolli SUA), hartuar në Romë më 10 mars 1988	Neni 135.1.16 ← Neni 167 i KP Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në dete dhe oqeanë ⁵⁰
Konventa ndërkombëtare për ndalimin e bombardimeve terroriste, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 15 shtator 1997	Nuk ka mbulim të veçantë (pjesërisht i mbuluar me nenin 135.1.7 ← Neni 334 Zjarrvënja apo neni 365 Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm)

306. Për shkak të kërkesës së përgjithshme të elementit shitesë të qëllimit dhe zbatimit nganjëherë të mangët, mbulimi i "veprave të traktatit" është vetëm pjesërisht në përputhje me standardet e përcaktuara nga Konventa FT dhe e njëjta gjë mund të thuhet gjithashtu edhe në lidhje me veprën "gjenerike" të aktit terrorist. Sigurisht, koncepti i nenit 2 (1) të Konventës FT deri në një masë të madhe mbulohet nga veprat e ndryshme (vrasje, sulme etj) I të

⁴⁹ Neni 166 i KP nuk e mbulon përkufizimin e ndryshuar të veprave penale në Konventën SUA i bartur në Protokollin 2005, por Konventa FT kërkon vetëm mbulimin e Konventës SUA.

⁵⁰ Neni 167 i KP nuk e mbulon përkufizimin e ndryshuar të veprave penale në Protokollin SUA i bartur në Protokollin 2005 gjithashtu, por Konventa FT kërkon vetëm mbulimin e Protokollit SUA të vitit 1988.

renditura nën nenin 135.1 por Konventa përfshin "cilindo akt tjetër" që ka për qëllim të shkaktojë vdekje etj. dhe jo vetëm ato që mund të përfshihen në veprat penale të renditura nën nenin 135.1. Ndërsa formulimi ka të ngjarë të jetë i zbatueshëm në shumicën e rasteve, mbulimi aktual nuk mund të jetë aq i madh sa ai i veprës në Konventën FT.

307. Sa i përket lidhjes ndërmjet fondeve të mbledhura apo të siguruara dhe aktit terrorist përkatës, elementi i dijenisë në veprën FT në nenin 138.1 është i kufizuar në kryerjen e thjeshtë (kryerjen) e aktit terrorist, por jo në organizimin dhe përgatitjen e tij. Ideale do ishte që financimi i një akti terrorist tashmë duhet të penalizohet në fazën e përgatitjes ose organizimit, gjë e cila aktualisht nuk ndodh me nenin 138.1. Megjithatë, kjo mangësi e dukshme është trajtuar në nenin 145, i cili parasheh se për një veprim që përbën vepër penale, siç përcaktohet në nenet 135-144 (duke përfshirë veprën FT) nuk është e nevojshme që një vepër terroriste në fakt edhe të kryhet.

308. Përveç kësaj çështjeje, ekipi i vlerësimit ka disa dyshime nëse përkufizimi "akti terrorist" në nenin 135.1 në fakt shtrihet edhe në veprat e tjera të lidhura me terrorizmin në nenet 136-144. Kjo nuk vlen për nenin 136 (i cili parasheh kryerjen e ndonjë prej veprave të renditura nën nenin 135,1) dhe vepra FT në nenin 138.1 (përndryshe do të penalizohet "financimi i financimit"), por jo në rast të shkeljeve të tjera të lidhura të tilla si:

- Ndihma në kryerjen e terrorizmit (neni 137 mbulon dështimin për të raportuar përgatitjen e një veprë terroriste apo kryesit e saj)
- Rekrutimi për terrorizëm (neni 139)
- Trajnim për terrorizëm (neni 140)
- Nxitja për të kryer një vepër terroriste (neni 141)
- Fshehja ose dështimi për të raportuar terroristët dhe grupeve terroriste (neni 142)
- Organizimi dhe pjesëmarrja në një grup terrorist (neni 143) dhe
- Përgatitja e veprave terroriste apo veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës (neni 144).

309. Pasi që këto vepra nuk janë të renditura dhe kështu, teorikisht, nuk mund të përfshihen në përkufizimin në nenin 135.1 është e dyshimtë nëse dhe si mund të merret edhe financimi i këtyre veprave si një vepër FT në kuptimin e nenit 138.1. Disa prej tyre mund të mbulohen në mënyrë indirekte (p.sh. financimin e kryerjen së veprës penale në nenin 143 që përfshin organizimin ose pjesëmarrjen në një grup terrorist mund të konsiderohet padyshim si financimin e një grupi terrorist, siç i referohet në nenin 138.1). Të tjerat mund të jenë, në një farë mase, të mbuluara nga neni i lartcekur 144.4, i cili parashikon se kushdo që me qëllim të kryerjes së një ose më shumë veprave penale të terrorizimit në të njëjtin Kapitull të KP, dërgon ose bart grupe të armatosura, pajisje ose burime të tjera materiale në ose jashtë Kosovës (kjo duket e pazbatueshme për burimet materiale që nuk e kalojnë kufirin e Kosovës). Megjithatë mund të ketë vepra (p.sh. mbledhja dhe sigurimi i aseteve, vetëm brenda territorit të Kosovës, për qëllime të rekrutimit për terrorizëm), të cilat janë zbuluar me sa duket nga vepra FT në nenin 138.1.

Financimi i ndonjë organizate terroriste dhe i ndonjë terroristi individual

310. Për sa i përket mbulimit të aktiviteteve financuese përtej fushëveprimit të nenit 2 të Konventës kundër financimit të terrorizmit, që është, koncepti i përgjithshëm i financimit të organizatave terroriste dhe i terroristëve individualë, ekipi vlerësues duhet të theksojë se legjislacioni penal i Kosovës këto aspekte i ka trajtuar vetëm pjesërisht nga.

311. Mangësia më e rëndësishme në këtë fushë është se legjislacioni përkatës penal fare nuk e mbulon çështjen e financimit të ndonjë terroristi individual. Në nenin 138 mbulohet financimi i terrorizmit vetëm në atë masë që fondet apo burimet materiale ofrohen, kërkohen, mbledhen apo fshihen për ta mbështetur ndonjë grup të terroristëve apo për kryerjen e ndonjë akti terrorist. Në anën tjetër, në nenin 138.2 të KP-së (e njëjta dispozitë ekziston edhe në

nenin 137.3 të KP-së) penalizohet ofrimi i fondeve apo i burimeve të tjera materiale për ndonjë terrorist individual, por vetëm pas kryerjes së ndonjë akti të terrorizmit. Kjo kuazi ndërlidhje pas ndërtimit të faktit është drejtpërdrejt e lidhur me ndonjë akt specifik terrorist, i cili është kryer (apo së paku janë bërë përpjekje për t'u kryer) dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si financim i ndonjë terroristi individual për çfarëdo qëllimi, përfshirë aktivitetet legjitime, siç kërkohet në FATF RV.II.

312. Në vend të “organizatave terroriste” vepra e FT i referohet financimit të një “grupi terrorist”, term i cili është përkufizuar në nenin 135.4 si

“Grup terrorist – grup i strukturuar prej më shumë se dy personave, i themeluar gjatë një periudhe kohore dhe i cili vepron në marrëveshje për të kryer terrorizëm. Grupi i strukturuar është grup i cili nuk formohet rastësisht për kryerjen e menjëhershme të ndonjë veprë dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role të përcaktuara formalisht të anëtarëve të vet, vazhdimësi të anëtarësisë së tij apo strukturë të zhvilluar.”

313. Duke e pasur parasysh përkufizimin e gjerë që KP i ri e jep lidhur me “terrorizmin” në nenin 135.1 ky përkufizim e plotëson përmbajtjen e përkufizimit të “organizatës terroriste” siç parashihet në fjalorthin e përkufizimeve që i është bashkangjitur metodologjisë FATF. Fakti se grupi terrorist duhet të jetë “i strukturuar” nënkupton nivel më të lartë të integritetit dhe strukturës sesa ajo që kërkohet nga përkufizimi në fjalorth për organizatën terroriste, i cili i referohet vetëm *‘çfarëdo grupi të terroristëve’*, por fjalia e dytë e përkufizimit më lart e zgjeron fushëveprimin e termit “grup i strukturuar” mjaft gjerë sa për të qenë në përputhje me standardin FATF (me të vetmin kusht që grupi të mos jetë formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të ndonjë veprë).

314. Nuk është e specifikuar shprehimisht me legjislacion, por nga përkufizimi më lart duket se financimi i ndonjë organizate terroriste (pra ndonjë grupi terrorist) nuk kërkon që fondet të jenë përdorur për kryerjen apo për tentimin për të kryer ndonjë akt terrorist apo të kenë qenë të lidhura me ndonjë akt specifik terrorist (siç kërkohet nga FATF RV.II.1.c). Ky konkluzion lejohet nga përkufizimi disi i papërcaktuar më lart, si dhe formulimi i veprës në nenin 138.1 që nuk është i lidhur, për sa i përket financimit të ndonjë grupi terrorist me ndonjë akt konkret terrorist. Në anën tjetër, ky interpretim i gjerë duket se jep hapësirë për diskutime, kështu që duhet të vërtetohet në praktikë sa më parë që të jetë e mundur.

315. Një aspekt tjetër ku legjislacioni aktual duket se ka nevojë për qartësime apo plotësime ka të bëjë me atë se nëse dhe deri në çfarë mase mbulohet financimi i grupit terrorist për çfarëdo qëllimi (përfshirë aktivitetet legjitime, siç është financimi i shpenzimeve ditore të grupit). Sigurisht, KP nuk i mbulon aktivitetet e financimit kur fondet kanë për qëllim të përdoren nga një grup i tillë pa kurrfarë specifikimi apo kufizimi eksplicit për sa i përket qëllimit të vërtetë të fondeve. Pavarësisht kësaj, ekipi vlerësues është i mendimit se përputhshmëria e plotë si me formulimin, ashtu edhe me kuptimin e RV.II, mund të arrihet vetëm nëse ky aspekt mbulohet edhe me ligj pozitiv, apo së paku, me jurisprudencë.

316. Këtu është edhe një çështje tjetër që duhet të ceket. Ndonëse vepra e FT është e paraparë dhe e përkufizuar në KP siç u diskutua më lart, në nenin 2 të paragrafit 1.36 të Ligjit LPP/LFT gjithashtu parashihet përkufizimi i termit “financimi i terroristëve” – ku ligjvënësit e kanë ndjekur qasjen e njëjtë që ka rezultuar në përkufizimin e “pastrimit të parave” në paragrafin 1.23 të atij neni. Ky përkufizim qartazi i referohet “financimit të terroristëve” në krahasim me emërtimin e veprës së FT në nenin 138.1 “Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit”.

“Financimi i terroristëve – sigurimi apo mbledhja e fondeve, në çfarëdo mënyre, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me qëllimin që ato të përdoren apo me dijeninë se ato do të përdoren, plotësisht apo pjesërisht, për kryerjen e cilësdo veprë në kuptim të

neneve 112 dhe 113 të Kodit Penal të Kosovës dhe në kuadër të përkufizimeve specifike të parapara nga FATF në Rekomandimin e veçantë II.”

317. Ndërsa në rastin e përkufizimit të pastrimit të parave në paragrafin 1.23, ekipi vlerësues vetëm mund të supozojë se futja e tij në ligjin parandalues mund të ketë shërbyer për qëllimet e regjimit parandalues raportues, ata janë pothuajse të sigurt rreth kësaj për sa i përket përkufizimit të FT më lart.

318. Problemi më i vogël me këtë përkufizim është referimi i tij në numrat e nenit të Kodit penal të përkohshëm i cili tanimë është i vjetërsuar duke e pas parasysh se neni 440 i KP të ri parasheh se të gjitha referimet në nenet në ligjet e tjera të Kosovës apo të rregulloreve të UNMIK-it (përkatësisht KP të përkohshëm) duhet t'i referohen numrave të neneve të KP-së së ri si rezultat i të cilit referimi në nenet 112 dhe 113 të KP të përkohshëm duhet t'i referohet nenit të ri 138 (Lehtësimi në kryerjen e terrorizmit) dhe neni 144 (Përgatitja e veprave terroriste apo veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës).

319. Më problematike është fushëveprimi dhe domethënia e vërtetë e këtij përkufizimi. Së pari, ai është qartazi i kufizuar në financimin e veprave, duke e përjashtuar kështu financimin e organizatave terroriste apo të terroristëve individualë për çfarëdo qëllimi. Në këtë aspekt, ai është edhe më kufizues sesa vepra e FT në nenin 138.1 i cili, së paku, e mbulon financimin e organizatave (grupeve) terroriste. (Sjelljet me të cilat kryhet financimi janë praktikisht të njëjta me ato në veprën e FT me vetëm disa ndryshime të vogla për sa i përket formulimit). Megjithatë, është çështje tjetër se cilat vepra mund në të vërtetë t'i nënshtrohen financimit sipas këtij përkufizimi: këto janë veprat “*në kuptim të neneve 112 dhe 113 të Kodit Penal të Kosovës (që janë nenet 138 dhe 144 të KP-së së ri) dhe në kuadër të përkufizimeve specifike të parapara nga FATF në Rekomandimin e veçantë II.*” Në kuadër të kuptimit të neneve të lartcekura të KP-së, pikë së pari mund të shihet vetë vepra e FT, dhe në anën tjetër një vepër tjetër përgatitore për kryerjen e terrorizmit me sjellje specifike të ngjashme me FT në nenin 144.4 siç u cek më lart. Në kuadër të përkufizimeve specifike të FATF RV.II prap mund të shihen përkufizimet lidhur me veprën e financimit të terroristëve, meqë ajo duhet të penalizohet sipas fushëveprimit të Konventës për FT dhe përtej saj. Nëse i bashkojmë të gjitha këto pjesë, përkufizimi i cituar më lart qartazi i referohet sigurimit apo mbledhjes së fondeve me qëllim të përdorimit të tyre për kryerjen e veprave të financimit terrorist, që është, financimi i financimit të terroristëve, që është absurde.

320. Po ashtu, referimi në FATF RV.II – tipar unik që ka mundësi të jetë veçori e legjislacionit të Kosovës – është në vetvete problematik. Problemi më pak i rëndësishëm është se RV.II si i tillë është tanimë i vjetërsuar, andaj referimi duhet t'i bëhet Rekomandimit të ri 5, i cili e ka zëvendësuar atë. Megjithatë, më serioze është çështja se RV.II (apo Rekomandimi i ri 5) nuk përputhet me kontekstin e rekomandimeve (të veçanta) të FATF që janë standarde ndërkombëtare, por jo norma juridike të cilat do të mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Shtetet duhet ta gjejnë mënyrën optimale për t'i zbatuar standardet e caktuara nga këto rekomandime, për të cilat një referim i thjeshtë sikur ky, megjithatë, nuk mund të konsiderohet zgjedhje.

Përkufizimi i fondeve (FATF RV.II: Kriteri thelbësor II.1.b)

321. Vepra e FT në nenin 138.1 shtrihet në çdo fond, siç është i përkufizuar ai term në Konventën lidhur me FT. Vargu i fondeve të aplikueshme për veprën e FT është i përkufizuar me nenin 135.2 të KP-së në mënyrë identike me përkufizimin përkatës për veprën FT si “*pasuri e çfarëdo lloji, qoftë e prekshme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që jetë fituar, dhe dokumentet apo instrumentet ligjore në çfarëdo forme, përfshirë formën elektronike ose digjitale, përmes të cilave dëshmohet pronësia ose interesi në pasuritë e tilla, përfshirë, në mes të tjerash, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letërkreditë*”.

322. Përmes përdorimit të shprehjes “sido që të jetë fituar” përkufizimi qartazi i përfshinë fondet qofshin ato nga ndonjë burim legjitim apo jolegitim.

Tentativa për të kryer veprën dhe veprat shitesë (FATF RV.II: Kriteri thelbësor II.1.d dhe e)

323. Tentativa për të kryer veprën e FT është e mbuluar me dispozitën e përgjithshme në nenin 28 të KP të ri, ku për tentativë të kryerjes së veprës penale parashihet dënimi me burg prej së paku 3 viteve dhe është në përgjithësi e dënueshme (që siç duket i referohet veprës së FT-së që është e dënueshme me burgim deri në 15 vite).

324. Neni 2.4 i Konventës lidhur me FT parasheh penalizimin e pjesëmarrjes si bashkëpunëtor në ndonjë veprë të kryer apo veprë në tentativa të pastrimit të parave, në organizimin apo drejtimin e të tjerëve për të kryer këtë veprë, si dhe për kontribuimin në kryerje në formë të asocimit/bashkimit a konspiracionit. Siç është diskutuar lidhur me veprën e PP-së, këto të gjitha trajtohen në KP të ri ku veprimi i “bashkëkryerjes” (neni 33) e mbulon nocionin e pjesëmarrjes si bashkëpunëtor, vepra “bashkimi kriminal” (neni 34) e mbulon çështjen e bashkimi/asocimit, ndërsa nocioni i konspiracionit mbulohet me nenin e fundit apo me aktin e “marrëveshjes për të kryer veprë penale” (neni 35). Organizimi apo drejtimi i të tjerëve për të kryer veprën gjithashtu mund të mbulohet (përveç atyre që u cekën më lart) me aktin e shtytjes (neni 32).

Veprat e FT-së si vepra të ndërlidhura për PP-në (FATF RV.II: Kriteri thelbësor II.1.f)

325. Siç është diskutuar lidhur me veprën e PP-së, çdo veprë penale sipas legjislacionit të Kosovës mund të përbëjë veprë të ndërlidhur për PP-në, përfshirë veprën e FT-së.

Juridiksioni për veprën e financimit të terroristëve (FATF RV.II: kriteri thelbësor II.3)

326. Në legjislacionin penal të Kosovës nuk specifikohet nëse vepra e FT-së aplikohet pavarësisht asaj nëse personi që dyshohet ta ketë kryer veprën e financimit në të njëjtin juridiksion apo në ndonjë juridiksion tjetër, nga ai në të cilin ka ndodhur apo do të kishte ndodhur veprimi terrorist apo ku është i vendosur terroristi apo organizata përkatëse. Kjo do të thotë se vepra e FT-së në nenin 138.1 të KP-së nuk përmban ndonjë dispozitë të ngjashme me atë në nenin 32, paragrafin 4.3 të Ligjit kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit, përmes së cilit parashihet juridiksioni për pastrimin e të ardhurave të jashtme të fituara përmes krimit.

327. Sigurisht, fushëveprimi i nenit 138.1 dhe veprat e ndërlidhura brenda KP të ri nuk janë të kufizuara me format vendore të terrorizmit dhe kështu që, financimi i terroristëve të huaj apo i organizatave të huaja terroriste, si dhe i veprave terroriste që kanë për qëllim të kryhen në ndonjë shtet tjetër mund të përfshihen në veprën e FT-së. Pavarësisht kësaj, ky është vetëm një mbulim i nënkuptueshëm, i cili duhet të parashihet me legjislacion pozitiv.

328. Duhet të theksohet se për sa i përket disa veprave që ndërlidhen me terrorizëm, Ligji penal i Kosovës aplikohet për çdo person i cili kryen veprë penale të paraparë në nenet 136-145 të KP-së jashtë territorit të Kosovës, nëse ajo veprë përbënë kërcënim për sigurinë e Kosovës apo të popullsisë së saj, në plotëni apo pjesërisht (neni 115.2 i KP-së), por ky lloj legjislacioni nuk e përmbushë FATF RV.II.3. Këto rregulla mund ta rregullojnë çështjen nëse shteti ka juridiksion mbi veprat penale të kryera jashtë shtetit, si dhe në çfarë kushtesh mund ta ketë këtë juridiksion, por formulimi i FATF RV.II.3 nuk lë asnjë dyshim se pyetje kryesore është nëse financimi i terrorizmit mund të dënohet në një shtet kur aktivitetet përkatëse terroriste (planifikohen të) ndodhin apo organizatat terroriste ose individët terrorist janë të vendosur në një shtet tjetër, gjë që rezulton në një degëzim të caktuar për sa i përket vendit të kryerjes së krimit (d.m.th financimi i aktiviteteve në shtetin “A” ndërsa

aktivitetet/organizatat/individët përkatës terroristë në shtetin “B”). Kjo lloj situatë duhet të trajtohet me një dispozitë specifike që aktualisht mungon në legjislacionin e Kosovës.

Elementi mendor i FT-së (aplikimi i FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.2)

329. Siç është diskutuar në lidhje me veprën PP, standardi përkatës i FATF lidhur me konkluzionin e elementit të qëllimshëm nga provat rrethore përmbushet me nenin 22 të KP të ri sipas së cilit “*Dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike*”.

Përgjegjësia e personave juridikë (aplikimi i FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.3 & 2.4)

330. Përgjegjësia penale e personave juridikë aplikohet, siç është diskutuar më lart në lidhje me veprën e PP, në lidhje me të gjitha veprat përfshirë veprën e FT. Për këtë arsye, të gjeturat dhe rekomandimet e bëra nga ekipi vlerësues në lidhje me veprën PP janë po aq relevante sa edhe për veprën FT.

Sanksionet për FT (aplikimi i FATF R.2: Kriteri thelbësor 2.5)

331. Dënimet e shqiptueshme për veprën e FT-së janë mjaftë të ashpra për të qenë efektive, parandaluese dhe gjithashtu proporcionale me kërcënimin që paraqitet nga vepra. Kryerja e veprës së FT-së sipas nenit 138.1 kërcënohet me burgim nga 5 deri 15 vite, ndërsa për veprën e ndërlidhur shtesë sipas nenit 138.2 parashihet dënim me burg nga 3 deri në 10 vite që është plotësisht në përputhje me vargun e dënimeve për veprat e tjera të ndërlidhura me terrorizëm. Kështu, kryerja e një vepre terroriste sipas nenit 136 është e dënueshme me së paku 5 vite burgim, por niveli minimal është 10 vite në rast se vepra rezulton në lëndime të rënda trupore dhe burgim me 15 vite apo të përvetshëm në rast se vepra shkakton vdekje.

Statistikat dhe efektiviteti

332. Si statistikë që i janë dhënë vlerësuesve, ashtu edhe informatat e mbledhura nga tereni e konfirmojnë se asnjëherë nuk ka pasur asnjë hetim apo ndjekje penale të FT-së apo të ndonjë vepre tjetër të ndërlidhur me FT-në në Kosovë. Në mungesë të rasteve konkrete nuk mund të bëhet asnjë vlerësim i efektivitetit dhe zbatimit të dispozitave përkatëse e lerë më të praktikës gjyqësore.

2.3.2. Rekomandimet dhe komentet

Penalizimi i financimit të terrorizmit (FATF RV.II: Kriteri thelbësor II.1)

333. Për sa i përket terminologjisë së përdorur në nenet 135 deri 144 të KP të ri, vlerësuesit e kanë vërejtur rrezikun e tepicës apo hutisë që mund të shkaktohet nga përdorimi i termeve pak të ndryshme në dispozitën shpjeguese të nenit 135.1 dhe veprave në nenet 136 dhe 138. Meqë nuk ka ndonjë shenjë të diskrepancës substanciale për sa i përket fushëveprimit të termeve të ndryshme (neni 135.1 e parasheh mu të njëjtin përkufizim për tri terme njëkohësisht), legjislatorët duhet ta rishqyrtojnë thjeshtësimin dhe njëtrajtshmërinë e terminologjisë së përdorur në nenet përkatëse.

334. Mbulimi i fushëveprimit të veprës terroriste të përgjithshme siç kërkohet nga neni 2(1)b i Konventës rreth FT bëhet nga neni 135 përmes paraqitjes së veprave të ndryshme penale të KP-së. Kjo zgjidhje mundet deri në një masë të madhe ta mbulojë konceptin e nenit 2(1)b, por meqë Konventa e rumbullakëson “çdo akt tjetër” lista e veprave përkatëse (vrasje, sulm, etj.) nuk mund të jetë aq e madhe sa vepra në Konventën rreth FT-së. Rrjedhimisht, neni 2(1)b i Konventës për FT-në duhet të adresohet nga një vepër e ndarë (mund të

formulohet qoftë brenda dispozitës shpjeguese në nenin 135 ose, çka është më adekuate, brenda strukturës së veprës në nenin 136) dhe kështu që referimet e vrasjes, sulmit, etj. në nenin 135.1 mund të hiqen.

335. Për sa i përket penalizimit të “veprave me traktat” këto mund të konsiderohen vetëm “akte terroriste” dhe financimi i tyre mund të konsiderohet vetëm veprë e FT-së sipas nenit 138.1 nëse ato kryhen për qëllimin e paraparë në pjesën paraprake të nenit 135.1. Duke e pasur parasysh se neni 2(1)a i Konventës për FT-në kërkon nga shtetet që ta penalizojnë financimin e veprave me traktat pa asnjë element tjetër të qëllimshëm, është në përputhje me këtë standard të kërkohej dëshmi se një veprë e caktuar e traktatit është kryer për qëllimin e caktuar. Për shkak të kushtit të përgjithshëm të elementit shtesë të qëllimshëm dhe zbatimit nganjëherë të mangët (shih shembujt në pjesën shpjeguese) mbulueshmëria e “veprave me traktat” është vetëm pjesërisht në përputhje me Konventën rreth FT-së, gjë që me urgjencë duhet të rregullohet në legjislacionin përkatës penal.

336. Është e dyshimtë nëse dhe deri në çfarë mase përkufizimi i “aktit terrorist” në nenin 135.1 shtrihet për veprat që ndërlidhen me terrorizmin në nenet 136 deri 144 (përmes neneve 136 dhe 138.1), në veçanti nëse financimi i këtyre veprave mund të konsiderohet veprë e FT në kuptim të nenit 138.1. Kjo çështje duhet të rishqyrtohet nga autoritetet e Kosovës dhe duhet të gjendet një zgjidhje e duhur legjislative (p.sh. zgjerimi i nenit 135.1 për këtë aspekt) në mënyrë që financimi i këtyre veprave gjithashtu të mund të përfshihet në fushëveprimin e veprës së FT-së.

337. Çështja e financimit të një terroristi individual, siç kërkohej nga FATF RV.II, plotësisht mungon në legjislacionin e Kosovës dhe kjo çështje duhet urgjentisht të rregullohet. Vepra e paraparë në nenin 138.2 nuk është relevante në këtë aspekt.

338. Ligji nuk e specifikon shprehimisht se financimi i një grupi terrorist nuk kërkon që fondet të jenë përdorur për ta kryer ndonjë akt terrorist apo për të tentuar kryerjen e ndonjë akti terrorist ose që ato të kenë pasur lidhje me ndonjë akt terrorist specifik. Ndonëse ky konkluzion mund që në mënyrë të tërthortë të nxirret nga dispozitat ekzistuese, mbetet ca hapësirë për diskutime, kështu që kjo çështje duhet të vërtetohet me jurisprudencë apo me ndonjë legjislacion tjetër pozitiv më preciz. Gjithashtu, legjislacioni aktual ka nevojë të qartësohet apo të plotësohet për sa i përket financimit të grupeve terroriste për çfarëdo qëllimi (përfshirë aktivitetet legjitime, siç është financimi i shpenzimeve ditore).

339. Siç është rekomanduar lidhur me përkufizimin “shtesë” të PP-së në nenin 2, paragrafin 1.23, ekipi vlerësues nuk mund ta kupton arsyen pse do të kishte nevojë për dy përkufizime të financimit terrorist – edhe nëse, në këtë rast, dy përkufizimet mund të gjinden në pjesë të ndryshme të legjislacionit dhe vepra e FT nuk është klasifikuar si “financim terrorist” (që megjithatë në të vërtetë është). Juridiksionet e tjera e kanë konsideruar si më të përshtatshme që veprat penale të PP dhe FT të përkufizohen në ligjin penal për të drejtën materiale dhe që dispozitat e duhura të përfshihen në ligjin parandalues që e bëjnë të qartë referimin e këtyre veprave (ku legjislacioni parandalues thjesht parasheh se për qëllimet e regjimit të Raportimit, termi “FT” nënkupton veprën në KP përkatës).

340. Për të qenë konsistent me konkluzionet e tyre të dhëna rreth përkufizimit të PP-së, ekipi vlerësues e rekomandon fshirjen e përkufizimit “shtesë” të FT-së në nenin 2, paragrafi 1.36. Kjo zgjidhje automatikisht do ta rregullonte mbulimin e mangët të këtij përkufizimi (lidhur me financimin e organizatave terroriste dhe të terroristëve individualë), si dhe problemet me referimet e tij hutuese (dhe me siguri plotësisht të gabuara) për nenet e caktuara të ndërlidhura me FT të KP-së (të mëparshëm) dhe të FATF RV.II.

341. Vlerësuesit theksojnë se versioni i fundit i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit do të përfshinte një paragraf të

ri 1.42 në nenin 2 të Ligjit AML/CFT për të paraparë përkufizimin e “aktit terrorist për qëllime të këtij ligji” që nënkupton aktet “që kanë për qëllim t’i shkaktojnë vdekje apo lëndime të rënda trupore ndonjë qytetari apo personi tjetër që nuk është pjesë aktive në luftime në situatë të konfliktit të armatosur, kur qëllimi i këtij akti, nga natyra apo konteksti, është frikësimi i popullatës apo detyrimi i qeverisë a i ndonjë organizate ndërkombëtare që ta kryejë ndonjë akt apo të abstenojë nga kryerja e ndonjë akti.” Kjo ka mundësi ta zëvendësojë përkufizimin e vjetër në nenin 2.1.36 (ndonëse formalisht nuk e shfuqizon atë) duke e përmirësuar atë në shumë aspekte. Megjithatë, për qëllimet e mësipërme, ekipi vlerësues do ta konsideronte si më të favorshme që ai term të mos përkufizohet përsëri në ligjin parandalues por në KP⁵¹.

342. Për fat të keq, ky nuk është rasti i vetëm ku Projektligji i lartpërmendur do ta ndikojë, pas miratimit, kornizën ligjore për penalizimin e FT-së. Më konkretisht, Neni 19B i draftit e shton edhe një vepër penale të FT-së *sui generis* në Ligjin LPP/LFT (nuk mund të dihet, megjithatë, me saktësi se ku do të vendosej kjo dispozitë në ligj), që thotë si më poshtë:

Vepra Penale e Financimit të Terrorizmit

1. *Kushdo, që me qëllim merr pjesë si bashkëpunëtor, organizon ose drejton të tjerët të ofrojnë ose të mbledhin fonde ose tenton ta bëjë këtë përmes çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me qëllim që ato të përdoren ose në njohuri se ato do të përdoren në mënyrë të plotë ose pjesërisht për:*
 - 1.1 për të kryer një akt terrorist;
 - 1.2 nga një terrorist; ose
 - 1.3 nga një organizatë terroriste;
 - 1.4 do të konsiderohet të ketë kryer aktin e financimit të terrorizmit.
2. *Vepra penale është kryer pavarësisht se a ka ndodh një akt terrorist i përmendur në paragrafin 1 ose nëse fondet realisht janë përdorur për të kryer akt të tillë.*
3. *Financimi i terrorizmit do të jetë i dënueshëm me një gjobë deri pesëqind mijë (500 000) euro ose me burgim shtatë (7) deri njëzetë (20) vite apo ndonjëra nga këto dënime.*
4. *Tentativa për të kryer veprën penale të financimit të terrorizmit apo ndihmesa, mbështetja, lehtësimi ose këshillimi në kryerjen e ndonjë vepre të tillë, do të dënohet sikur vepra të ishte kryer.*

343. Në njërën anë, përcaktimi i kësaj vepre penale duhet të jetë shumë më shumë në pajtim me standardet ndërkombëtare përkatëse se sa me kornizën aktuale ligjore në KP, siç përshkruhet më lart. Në anën tjetër, ekipi i vlerësimit ka brena serioze në lidhje me një zgjidhje të tillë legislative për arsyet si në vijim.

344. Vepra penale e FT do të ishte plotësisht “trup i huaj” në kontekstin e Ligjit LPP/LFT. Duhet të theksohet se vlerësuesit nuk e konsiderojnë si mangësi në vetvete që kjo vepër penale të parashihet në një ligj të veçantë dhe jo në KP, në veçanti pasi që PP është përshkruar si vepër penale në ligjin e njëjtë të ndarë.

⁵¹ Mesa duket ligjvënësit e Kosovës kanë ardhur në një konkluzion të ngjashëm për shkak se në versionin e fundit të miratuar të Ligjit nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit, përkufizimi në paragrafin 1.42 është si më poshtë: “Akt Terrorist - nënkupton definicionin e përcaktuar me Kodin Penal të Kosovës”. Nga ana tjetër, paragrafi 1.36 ka mbetur i paprekur.

345. Megjithatë, për dallim nga vepra e PP-së, kjo draft vepër penale e FT-së nuk mund të interpretohet dhe të implementohet si e vetme. Financimi i terrorizmit është një vepër penale e cila tradicionalisht është rrënjësor në kontekstin e veprave penale që ndërlidhen me terrorizmin dhe definicionet përkatëse të veprave terroriste, qoftë individuale ose të organizatave terroriste. Dispozitat e KP-së, me të cilat është mbuluar aktualisht penalizmi i FT-së në Kosovë, janë të bazuara në këtë qasje kontekstuale. Draftvepra penale e FT-së do të jetë përfundimisht jashtë këtij konteksti, gjë që do të çojë në një situatë ku vepra penale e FT-së të mund të gjendet në një ligj, ndërkohë që të gjitha veprat që ndërlidhen me terrorizmin dhe definicionet përkatëse të veprave terroriste të ofrohen në ligjin tjetër.

346. Për më tepër, projektligji duket që nuk ka ndikim në KP në kuptim të ndryshimit ose shfuqizimit të çfarëdo neni përkatës në KP. Si rezultat, korniza ekzistuese e LFT në Pjesën e veçantë të KP-së, siç përshkruhet dhe analizohet më lart, do të mbetet tërësisht e paprekshme edhe pas futjes së veprës së re penale të FT-së në Ligjin LPP/LFT si rezultat i të cilës do të ishin dy vepra penale të konkureshme, një në KP dhe një në Ligjin LPP/LFT, nën të cilat aktivitetet e FT-së mund të përmbledheshin në mënyrë të barabartë. Një situatë e tillë, do të çonte pa dyshim në pasiguri juridike dhe probleme serioze në aplikimin efektiv të dispozitave përkatëse⁵².

Juridiksioni për veprën e financimit terrorist (FATF RV.II: Kriteri thelbësor II.3)

347. Ndonëse fushëveprimi i nenit 138.1 (dhe veprave të ndërlidhura) nuk është qartazi i kufizuar në format e brendshme të terrorizmit dhe kështu që vepra nuk e përjashton aplikueshmërinë e saj për financimin e terroristëve ose organizatave të huaja apo të akteve terroriste të kryera në ndonjë shtet tjetër (nga mungesa e ndonjë praktike të kundërt, vlerësimi nuk ndikohet në këtë pikë) kjo mbulueshmëri e nënkuptuar m mirë do të rregullohej përmes legjislacionit pozitiv.

2.3.3. Vlerësimi për Rekomandimin e veçantë II

	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që janë bazë e vlerësimit
RV.II	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Financimi i një terroristi individual (për çfarëdo qëllimi) qartazi nuk është i paraparë në veprën e FT-së • Terminologji jokonsistente dhe/apo e tepërt e përdorur në dispozitat lidhur me FT në KP • Mbulueshmëri e mangët e “aktit të terrorizmit” siç kërkohet nga neni 2(1) i Konventës kundër FT-së: <ul style="list-style-type: none"> ○ Nuk ka mbulueshmëri të plotë dhe të përgjithshme të veprës “së përgjithshme” të terrorizmit si çështje e FT ○ Mbulueshmëri e mangët e “veprave me traktat” si çështje e FT përmes kërkimit të një elementi shtesë të qëllimshëm • Është e paqartë nëse përkufizimi i “aktit terrorist” në nenin 135.1 shtrihet për veprat e ndërlidhura me terrorizëm (p.sh. rekrutimi për terrorizëm) në mënyrë që financimi i këtyre veprave gjithashtu të mund të konsiderohet vepër e FT-së

⁵² Në versionin përfundimtar të miratuar të Ligjit të ndryshuar nr. 04/L-178 vepra penale e FT-së ka mbetur praktikisht e njëjtë me atë që është cituar më lart nga drafti. Vepra e re e FT-së mund të gjendet kështu në nenin 36B të Ligjit LPP/LFT (në një kontekst me sa duket pa lidhje). Siç mund të parashikohej, Ligji nuk ka sjellë asnjë ndryshim në nenet përkatëse të KP-së.

2.4. Konfiskimi, ngrirja dhe sekuestrimi i të ardhurave nga krimi (R.3)

2.4.1. Përshkrim dhe analizë

348. Korniza e Kosovës për sekuestrim dhe konfiskim është e rregulluar fillimisht përmes Kodit Penal (KP) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe në përgjithësi është adekuate për sa i përket dizajnit dhe fushëveprimit legjislativ. Megjithatë ekzistojnë një numër mospërputhjesh. Kodi i ri Penal i ri dhe Kodi i ri i Procedurës Penale kanë hyrë në fuqi menjëherë pas vizitës në terren. Para kësaj janë përdorur KP dhe KPP të përkohshëm, të cilët kishin një kornizë dukshëm më të ngushtë për sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit.

Fushëveprimi i pronës që i nënshtrohet konfiskimit (FATF R.3: Kriteri thelbësor 3.1)

349. Neni 46⁵³ i Kodit Penal të Kosovës (KPK) e parasheh konfiskimin e ‘përfitimeve materiale të fituara përmes kryerjes së veprave penale’. Kjo i mbulon të gjitha krimet që gjenerojnë të ardhura kriminale, përfshirë PP, TF dhe veprat e tjera të ndërlidhura. Neni 69 i KP e parasheh konfiskimin e përgjithshëm të objekteve (sendeve) të përdorura për kryerjen e veprave penale apo që rrjedhin nga kryerja e veprave penale, që së bashku me dispozitat e lartëcekura rreth “përfitimit material” i përmbushin kushtet e FATF KTH.3.1.a - c.

350. Për të bërë konfiskimin e përfitimeve materiale, procedura penale duhet të përmbyllet me një aktgjykim ku i akuzuari shpallet fajtor (neni 280 i KPP). Prokurori duhet që në aktakuzë t’i paraqesë pronat që i nënshtrohen konfiskimit (neni 274 i KPP-së të ndryshuar). Mosbërja e kësaj mund ta rezultojë me kërkesë që prona t’i lirohet pronarit.

351. Për ta konfiskuar pronën e përdorur në ndonjë vepër penale (*sendet*) prokurori duhet që në gjykimin kryesor ta dëshmojë se aseti është përdorur në veprën penale (neni 283 i KPP). Nuk është plotësisht e qartë nëse nevojitet verdikti mbi fajësinë për t’i konfiskuar këto *sende*. Megjithatë në KPP nuk përfshihet asnjë standard i dëshmisë apo procedurë për konfiskimin final të *sendeve që kanë për qëllim të përdoren* për kryerjen e ndonjë veprë, gjë që ngritë dyshime rreth mundësisë së konfiskimit të tyre përfundimtar.

352. Në nenin 97.1 të KP parashihet pagesa e një vlere ‘të barasvlershme’ (pra korresponduese) kur dobia pasurore nuk mund të konfiskohet. Kjo në praktikë nuk ka ndodhur asnjëherë.

Konfiskimi i të ardhurave të drejtpërdrejta apo të tërthorta nga vepra penale (FATF R.3: Kriteri thelbësor 3.1.1a)

353. Në përputhje me nenin 120.34 dobia pasurore është “çfarëdo pasurie e cila fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga vepra penale. Pasuria e cila fitohet tërthorazi nga vepra penale përfshinë pasurinë në të cilën çfarëdo pasurie që drejtpërdrejtë është fituar nga vepra penale më vonë është konvertuar, transformuar apo përzier, si dhe të ardhurat, kapitalin apo dobitë tjera ekonomike të fituara ose realizuara për pasurinë e tillë në çfarëdo kohe që prej kryerjes së veprës penale”. Në nenin 276 të KPP-së në përgjithësi parashihet një përkufizim i ngjashëm, i cili i përmbushë kushtet e standardit FATF për sa i përket konfiskimit të të ardhurave të drejtpërdrejta.

⁵³ Neni 96 i Ligjit nr. 04-L-082.

Konfiskimi nga një palë e tretë (KTH.3.1.1.b)

354. Për sa i përket konfiskimit nga një palë e tretë, dispozitat e KP-së dhe të KPP-së dallojnë në mënyrë mjaft të konsiderueshme, gjë që krijon dykuptimësi, dhe me mundësi që të shpie në probleme serioze të zbatimit në të ardhmen. Në nenin 97.2 të KP-së lejohet konfiskimi nga palët e treta kur ata i kanë marrë dobive pasurore pa 'kompensim' apo më pak sesa vlera e vërtetë, duke e ditur (apo kur ata është dashur ta dinë) se dobia pasurore është marrë përmes krimit. Kur transferi i dobive është bërë tek anëtari i familjes, barra e dëshmisë i kalon anëtarit të familjes për të dëshmuar se "e ka kompensuar tërë vlerën". Këto dispozita janë në përgjithësi të pranueshme për t'i përbushur kushtet e standardeve ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, neni 278 i KPP-së, e parasheh një barrë edhe më të lartë të dëshmisë, duke theksuar se përfitimet kriminale që i *transferohen/kalohen* palëve të treta mund t'i nënshtrohen konfiskimit vetëm në tri raste:

1. të ardhurat nga vepra penale janë kaluar nga posedimi i të pandehurit;
2. kalimi ka qenë për një shumë substancialisht më të ultë se sa çmimi real në tregu i të ardhurave nga vepra penale dhe
3. ka prova se i pandehuri ende kontrollon ose shfrytëzon të ardhurat nga vepra penale.

355. Përveç kësaj, nga pikëpamja e ekipit vlerësues formulimi nënkupton se për t'u bërë konfiskimi duhet që njëkohësisht të përbushen të tria kushtet e lartëcekura.

356. Nëse të ardhurat nga vepra penale janë në posedim të ndonjë pale të tretë, këto të ardhura i nënshtrohen konfiskimit nëse:

1. Pala e tretë e ka marrë posedimin e të ardhurave nga vepra penale si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës penale;
2. ka prova se i pandehuri ende i kontrollon ose i shfrytëzon të ardhurat nga vepra penale ose e kontrollon palën e tretë

357. Andaj konflikti mes dispozitave të KPP-së dhe të KP-së krijon pengesë për zbatimin e normave të Kodit Penal, duke caktuar një standard më të lartë të dëshmisë, gjë që mund të ndikojë patjetër në efektivitetin e zbatimit të ligjit me rastin e ndërmarrjes së masave të konfiskimit.

Masat e përkohshme (FATF R.3: Kriteri thelbësor 3.2)

358. Me nenin 247⁵⁴ të Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale (RE2003_26) Prokurorit publik i është dhënë kompetencë e përgjithshme për 'konfiskim të përkohshëm'. Në nenet 490-499⁵⁵ janë paraparë kompetenca për gjykatat për kryerjen e konfiskimit përfundimtar të dobive pasurore dhe të shumave të barazvlefshme të dobive pasurore (që si konkluzion nuk janë në dispozicion) pas dënimit.

359. Në nenin 264 të KPP⁵⁶ të ndryshuar parashihet një sistem për ngrirjen e përkohshme të asetëve që janë të ardhura nga krimi apo që janë dëshmi për hetimet si masë parandaluese apo për të parandaluar heqjen a shpërndarjen e tyre. Kjo përfshinë një urdhër të lëshuar nga Prokurori i Shtetit dhe i cili është i vlefshëm për 72 orë, gjatë të cilës kohë prokurori duhet

⁵⁴ Tani neni 264 'ngrirja e përkohshme e asetëve' në KPP të ri 2012-04/L-123.

⁵⁵ Tani kapitulli VIII, neni 274 e në vazhdim.

⁵⁶ 2012_04-L-123-eng, në fuqi që nga 1/1/2013.

menjëherë ta bëjë një kërkesë tek gjyqtari i procedurës paraprake për një ‘urdhër shtesë’ për t’i ngrirë asetet. Urdhri shtesë zgjatë fillimisht 30 ditë ku gjatë kësaj kohe dhe me një njoftim trijavor caktohet seanca dëgjimore për të shqyrtuar ndonjë kundërshtim nga të prekurit prej urdhrit shtesë.

360. Me nenin 112 gjithashtu parashihet sekuestrimi i përkohshëm i objekteve, dhe përkufizimi përfshinë dobitë pasurore nga kryerja e ndonjë vepre penale. Nga hartimi nuk është e qartë nëse kjo ka të bëjë vetëm me objektet që gjinden gjatë ndonjë bastisje meqë kjo pjesë vazhdon prej neneve që kanë të bëjnë me bastisjet me urdhër të gjykatës dhe pa të. Gjuha e tekstit është jokonsistente meqë i referohet sekuestrimit të përkohshëm dhe konfiskimit të përkohshëm në të njëjtën frymë. Termet e njëjta duhet të përdoren për qëllime të qartësisë dhe konsistencës.

361. Sipas Ligjit kundër pastrimit të parave NjIF-i ka kompetencë që ta vonojë ndonjë transaksion të raportuar deri në 48 orë (Ligji LPP/LFT, neni 22.6). Kjo është një kompetencë tjetër për ngrirje të përkohshme, por vlen vetëm për transaksione të caktuara për të cilat NjIF-i njoftohet nga ndonjë entitet raportues.

362. Po sipas këtij Ligji kundër pastrimit të parave (neni 29.10), Dogana e Kosovës ka kompetencë që t’i sekuestrojë sendet monetare që dyshohen të jenë të ardhura të krimit. Lidhur me këtë duhet menjëherë të njoftohet prokurori në mënyrë që të fillojnë hetimet. Dogana gjithashtu duhet ta informojë NjIF-në.

Konfiskimi ex-parte (i njëanshëm) dhe pa paralajmërim (FATF R.3: Kriteri thelbësor 3.3)

363. Nga teksti i nenit 264 të KPP-së është e qartë se urdhri për ngrirje i dhënë nga Prokurori i Shtetit është si konkluzion i njëanshëm dhe pa njoftim. Mundësia për ta kundërshtuar urdhrin shtesë jepet në seancën pasuese. Ekipi vlerësues nuk ka pasur mundësi të merr ndonjë konfirmim nëse këto masa janë zbatuar në praktikë.

Kompetencat për të gjurmuar pasuritë (FATF R.3: Kriteri thelbësor 3.4)

364. Agjencitë për zbatimin e ligjit si Policia e Kosovës dhe Doganat kanë kompetenca të mjaftueshme për bastisje dhe sekuestrim të pasurisë e cila është apo dyshohet të jetë rezultat i krimit. Neni 240 i KPP-së të mëparshëm (dhe neni 105 i KPP-së të ri) jep kompetenca të përgjithshme të bastisjes dhe konfiskimit përmes një urdhri të gjykatës. Megjithatë, duket se në praktikë autoritetet e zbatimit të ligjit janë duke bërë shumë pak në këtë fushë (shih më poshtë vlerësimin e efektivitetit).

365. Nuk ka autorizime në ligj që lejojnë autoritetet për të përcaktuar nëse pasuria mund të bëhet si e ardhur nga krimi.

366. NjIF ka kompetenca sipas ligjit LPP/LFT të kërkojë informacione nga subjektet gjegjëse dhe bazat e të dhënave komerciale, si dhe të ndajnë ato informacione me agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet tatimore, AKI-në dhe prokurorët për qëllim të hetimeve brenda kompetencave të tyre.

367. Ka kufizime në aftësinë e të gjitha agjencive për të përcaktuar pronësinë e pronave të patundshme. Regjistra të tillë ekzistues janë të vjetër. Janë dhënë shembuj për ekipin vlerësues, ku pasuritë ende janë të regjistruara në emër të gjyshërve të vdekur, por që familjet e tyre ende jetojnë në pronat e tyre dhe nuk kanë regjistruar ndonjë ndryshim të emrit. Në të vërtetë, pronësia mund t’i përkas shumë anëtarëve të familjes, por nuk mund të regjistrohet si e tillë.

368. Nuk ekziston asnjë forcë që ta detyrojë një kriminel të dënuar të riatdhesojë asetet që janë për konfiskim, të cilat ai mund t'i ketë larguar nga juridiksioni/shteti.

Të drejtat e palëve të treta në mirëbesim FATF Rec 3.5

369. Neni 270 i KPP-së u jep palëve të treta mundësinë për të ngritur kundërshtimet e tyre ndaj masave të përkohshme të marra lidhur me pasurinë e tyre që ka qenë e përdorur si mjet në një vepër. Lidhur me këtë, pala e tretë duhet të dëshmoj se:

- Ai/ajo nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë rreth përdorimit të pasurisë në vepër penale;
- Pasuria nuk mund të përdoret përsëri në kryerjen e ndonjë veprë;
- Masat e përkohshme dëmtojnë paarsyeshëm interesat e palës së tretë.

370. Në rastet kur pasuria e personit të tretë është e lidhur me dobinë pasurore të fituar nga një vepër penale, ky person i tretë duhet të dëshmoj se:

- Ai/ajo ka pasur interes pasuror për më shumë se 6 muaj para konfiskimit të përkohshëm të pasurisë;
- Ai/ajo ka paguar një normë tregu për interesin pasuror në një ndërtesë, pronë të paluajtshme, pronë të luajtshme apo asete;
- Ai/ajo nuk ka qenë në dijeni për veprimet në mbështetje të veprës penale;
- I dyshuari apo i pandehuri nuk do të jetë në gjendje ta përdorë, transferojë apo në ndonjë mënyrë të ketë qasje në ndërtesë, pronë të paluajtshme, pronë të luajtshme apo asete dhe
- Masa e përkohshme e propozuar do të dëmtojë paarsyeshëm interesat e personit kundërshtues.

371. Ndërsa hapat e përshkruar më lart që duhet të ndermirren në mirëbesim nga pala e tretë duket të jenë të qarta dhe transparente, barra e provës është zhvendosur paarsyeshëm në mirëbesim, ndonjëherë duke e bërë të pamundur që ai/ajo ta provojë të drejtën e tyre të legjitimitetit dhe qëllimet lidhur me pasurinë.

372. Neni 279 i KPP-së të ri i jep të drejtën e palës së tretë që në mirëbesim të bëjnë kërkesat e tyre për pronësi gjatë procesit të konfiskimit.

Autorizimi për të bërë të pavlefshme veprimet dhe kontratat FATF Rec 3.6

373. Përtej autorizimit të NjIF-it të vonojë apo të shtyjë transaksionet e caktuara të raportuara tek ajo nga subjektet e obliguara për një gjë të tillë, nuk ekziston asnjë autoritet që të ndërmerr hapa për të parandaluar ose për të bërë të pavlefshme veprime kontraktuese ose të tjera në rastet kur personat e përfshirë ishin në dijeni ose kanë mundur ta dinë se si rezultat i atyre veprimeve, autoritetet do të paragjykojnë për aftësinë e tyre për të rimarr pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit.

374. Kompetenca për të ngrirë dobinë pasurore të kriminalitetit me qëllim të ruajtjes së tyre nga konfiskimi i mundshëm, mund të aplikohet, por kjo nuk adreson drejtpërdrejt rekomandimet nga FATF 3.6.

Elementet shtesë

375. Ekziston një draftligj 'Kompetencat e zgjeruara për konfiskim' që aktualisht është në Kuvend, përmes të cilit shtrihet kompetenca për konfiskim në rastet kur i pandehuri ka vdekur ose është jashtë juridiksionit dhe nuk mund të gjykojë për veprën në fjalë. Ky draftligj parasheh konfiskimin e aseteve ku ekziston një dënim, por asetet nuk janë të ardhura nga

vepra e ndërlidhur penale. Prokurori duhet të tregojë se ato ishin fituar në të njëjtën periudhë kohore me veprën dhe nuk kanë burim legjitim. Ky ligj është planifikuar të miratohet deri në fund të vitit 2012.

376. Nuk ekziston asnjë dispozitë në ligj për konfiskimin e pasurisë së organizatave kryesisht të natyrës penale.

377. Kosova nuk ka ndonjë ligj që lejon konfiskimin e të ardhurave nga krimi *in rem*, me përjashtim të disa veprave të korrupsionit, siç përcaktohet me nenin 281 i KPK-së të ri. Në këto raste elementet ligjore të veprës penale duhet të krijohen, dhe duhet të vërtetohet se është pranuar një shpërblim, dhuratë ose përfitim. Përndryshe çdo konfiskim duhet të jetë i lidhur me një aktakuzë penale.

378. Neni 6 i Kompetencave të Zgjeruara për Konfiskim, do të zgjerojë kompetencat për konfiskim për:

“1.1 Asete të tjera (të fituara) përgjatë së njëjtës periudhë me veprat penale, për të cilat është dënuar i pandehuri, por nuk kishte dobi pasurore për ato vepra penale,

1.2 Të ardhurat e ligjshme të të pandehurit ishin të pamjaftueshme për të mundësuar marrjen e atyre aseteve të tjera, 1.3 I pandehuri ishte angazhuar në një formë të aktivitetit të ngjashëm me atë me të cilën ai ose ajo është dënuar dhe

1.4 Modeli i aktivitetit në paragrafin 1.3 do të lejojë marrjen e atyre aseteve tjera.”

379. Barra është mbi Prokurorin e Shteti për të treguar një ‘shkak bazë’ dhe nëse është i suksesshëm, gjykata lëshon një kopje të kërkesës për të pandehurin, i cili pastaj duhet të provojë brenda 30 ditëve “të paraqes prova se asetet janë blerë me të ardhura të ligjshme.”⁵⁷

380. Pason seanca gjyqësore në të cilën Gjykata përcakton nëse është e përshtatshme për konfiskimin e këtyre aseteve duke pasur parasysh çështjet e referuara më lart, të drejtat e palëve të treta dhe/ose palëve të dëmtuara, ku nuk ka pasur padrejtësi dhe pastaj lëshon një urdhër për asetet të dorëzohen në Kosovë.

381. Neni 7 i Kompetencave të Zgjeruar për Konfiskim siguron që kur një procedurë penale nuk mund të vazhdojë për shkak të vdekjes së të pandehurit në bazë të nenit 160 të KPK-së të rishikuar, por asetet i nënshtrohen urdhrit përcjellës sipas nenit 265 të KPK-së të rishikuar, ose aktakuza është ngritur e që përmban asetet të cilat janë objekt i konfiskimit sipas nenit 241.1.9 të KPK-së të rishikuar, Gjykata me propozimin e marr nga prokurori i shtetit apo pala e dëmtuar mund të vazhdojë me procedimin e konfiskimit. Asetet në fjalë duhet të kalojnë vlerën prej €1000 dhe duhet të jetë në interes të drejtësisë për të vazhduar konfiskimin.

382. Neni 8 i Kompetencave të Zgjeruara për Konfiskim siguron që kur pasuria e zotëruar nga një i pandehur i arratisur mund të konfiskohet. Asetet (të cilat duhet të kalojnë vlerën prej €5000) duhet të jetë të shënuara në aktakuzë apo të kenë një urdhër përcjellës të bërë për to. Gjykata pastaj vendos nëse i pandehuri është në arrati, nëse ka kryer një krim, nëse asetet përfaqësojnë dobinë pasurore të veprës dhe të drejtën e mirëbesimit të ndonjë pale të tretë. Nëse Gjykata është e kënaqur lëshon një Aktgjykim mbi këto çështje dhe urdhëron që asetet të dorëzohen në Kosovë. Kjo mund të nënshtrohet ankesës.

⁵⁷ Art.6.4

383. Nenet 6, 7 & 8⁵⁸ nuk e përmbushin kriterin FATF 3.7 për konfiskimin civil/konfiskimin pa dënim. Sipas ligjit të Kosovës një rast penal duhet të jetë kundër një të pandehuri dhe prokuroria (me përjashtim të kriterëve të nenit 6 më sipër) ka për të treguar asetet/ dobinë pasurore si rezultat i atij kriminaliteti. Nuk ka asnjë koncept në ligj ku tregon që nuk ekziston e drejta e titullit të ardhurave të krimit *in rem*.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në ngrirje/sekuestrim të aseteve jo të lidhur me sanksionet penale (CETS 198 23.5)

384. Neni 36 i Ligjit LPP/LFT (03-L/196) jep kompetenca për të zgjeruar bashkëpunimin në juridiksione tjera në çështjet e ngrirjes/sekuestrimit dhe konfiskimit të të ardhurave të krimit, pastrimit të parave dhe financimit e terrorizmit për qëllim të ndjekjes penale dhe konfiskimit. Deri më tani ende nuk janë bërë urdhra të jashtëm të kësaj natyre në Kosovë. Nuk ka **asnjë** legjislacion që mundëson heqjen e pasurisë që **nuk** është e lidhur me sanksionet penale që do të aplikohen.

Kompensimi i lidhur me pasurinë e konfiskuar (CETS 198 25.2)

385. Kosova asnjëherë nuk ka zbatuar ndonjë kërkesë të jashtme për të ngrirë apo sekuestruar apo konfiskuar pasuri ashtu siç parashihet nga nenet 23, 24 të CETS 198. Në vijim, nuk ka pasur asnjë pasuri ose vlerë të barabartë të kthyer tek pala kërkuese tek CETS 198. Nuk ka asnjë ligj ndërkombëtarë për ndarjen e aseteve apo ndonjë dispozitë tjetër edhe pse kjo nuk është e përjashtuar nga legjislacioni, në të vërtetë ligji i LPP/LFT siguron bashkëpunimin më të gjerë të mundshëm në çështjet e konfiskimit. Një interpretimi i së cilës mund të jetë për të mundësuar shkëmbimin ndërkombëtarë të aseteve.

386. Ligji i Kosovës parashih që viktimat e krimit mund të kompensohen. Kodi ekzistues i Procedurës Penale, nenet 107-118 parashohin kërkesat pronësore.

387. Neni 490 i procedurave të konfiskimit (KPK ekzistues) siguron për palët e dëmtuara paraqitjen e kërkesës me përparësi ndaj të ardhurave nga krimi të konsideruara për konfiskim.

388. Neni 62 i Kodit të ri të Procedurës Penale, përcakton të drejtën e palës së dëmtuar në kompensim. Neni 458 lejon kërkesat pronësore të tilla për dëmtime apo për rimarrjen e një objekti si rezultat i kryerjes së veprës penale.

389. Në KPP-në e re neni 275 i jep të drejta palëve të dëmtuara që të paraqesin kërkesë gjatë procesit të konfiskimit të dobive pasurore nga krimi. Nëse Kosova eventualisht ekzekuton një Urdhër Konfiskimi të jashtëm, kjo do t'i mundësonte palëve të dëmtuara që të paraqesin kërkesë për kthim apo kompensim gjatë këtij procesi.

390. Ende nuk ka marrëveshje të arritura për ndarjen e pasurisë së konfiskuar me juridiksionet tjera (CETS 198 25.3). MD ka deklaruar se aty ku nuk ekzistojnë marrëveshje formale me palët tjera do të vlejnjë parimet e reciprocitetit. Nuk ka pasur raste të ndarjes së pasurisë së konfiskuar, nëse kjo kërkohet atëherë çdo rast do të konsiderohet veçmas.

Statistikat

⁵⁸ Këtij vlerësuesi i është dukur gjatë vizitës në terren se këto dispozita ishin të panjohura për Prokurorët. Pyetjet lidhur me atë se çfarë ndodh me asetet kriminale të mbajtura nga i vdekuri dhe i arratisuri u hasen me turbullim, po ashtu ishin të paqarta për ta.

391. Në vitin 2010 Kosova krijoi një Agjenci për Menaxhimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara⁵⁹. Përgjegjësitë e agjencisë janë të ruaj dhe menaxhojë asetet që i dërgohen nga prokurori, si dhe t'i hedh apo shesë asetet atëherë kur Gjykata jep urdhër për konfiskim përfundimtar. Statistikat e pasurisë së konfiskuar që i janë dërguar agjencisë janë dhënë më poshtë.

Tabela 7: Të hyrat e Agjencisë për administrimin e asetëve të sekuestruara apo konfiskuara për periudhën kohor 1 janar -31 dhjetor 2011, dhe periudha prej 10 muajsh, 1 janar – 31 tetor 2012

Periudha kohore	Procedurat e shitjes	Ri-shpalljet	Të hyrat nga asetet e konfiskuara	Të hyrat nga depozitat e asetëve të sekuestruara	Totali
1 janar – 31 dhjetor 2011	12	0	27.390.94€	26.410.64€	53.801.58€
1 janar – 31 tetor 2012	27	6	29,926.27 €	231,612.38 €	261,538.65€

392. Në kohën e vizitës në teren në dhjetor 2012, ekipit vlerësues iu tha se ka pasur dërgesa shtesë duke qar totalin e asetëve të sekuestruara në përafërsisht 2.5m €. Këto janë statistikat e vetme mbi konfiskimin që i janë dhënë ekipit vlerësues dhe mund të jenë vetëm treguese, pasi që jo e tërë pasuria e sekuestruar apo konfiskuar menaxhohet nga Agjencia. Ekziston një rezervë e asetëve të konfiskuara që qëndrojnë në objektet e institucioneve tjera (KGJK, KPK, Policia, etj) për të cilën AMPSK po përpiqet të gjejë modalitete që t'i rigrupojë dhe sigurojë pranimin dhe menaxhimin e tyre, si dhe ta konsiderojë shitjen potenciale.

393. Përndryshe, nuk janë dhënë statistika me zbrërthimin e numrit dhe llojit të veprës penale, dhe nëse ndonjëra nga të ardhurat e konfiskuara është lidhur me pastrimin e parave, që e bën të vështirë vlerësimin e efikasitetit të regjimit konfiskues

Efikasiteti

394. Ekipi vlerësues kishte shqetësime serioze rreth efikasitetit të sistemit të sekuestrimit dhe konfiskimit në Kosovë. Mjetet ligjore dhe procedurale që ishin në dispozicion në legjislacionin e kaluar, edhe pse jo-konsistente, nuk qenë përdorur mirë dhe janë injoruar qartazi në nivelet e ndryshme të sistemit, përfshirë policinë dhe prokurorinë.

395. Në veçanti, ekipi vlerësues u informua rreth një rasti ku pasuria e patundshme e blerë me të ardhurat nga krimi nuk ishte konfiskuar sepse ishte e regjistruar në emër të bashkëshortes së të akuzuarit. Në vend të kësaj, ishin konfiskuar disa artikuj me vlerë shumë më të vogël, përkatësisht vetura, duke demonstruar qartë qasjen selektive të prokurorit përgjegjës. Në rastet e tilla, gjyqësori duhet të lejohet dhe të inkurajohet që të merr një qasje proaktive për marrjen e masave të domosdoshme, ku prokurori ka dështuar qartë në një rast specifik që të vazhdojë me sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve/të ardhurave nga krimi që janë të ditura.

396. Ekipi vlerësues kishte përshtypjen e përgjithshme se autoritetet për zbatimin e ligjit nuk janë të gatshme që të ndërmarin aktivitetet për zbulimin e të ardhurave penale, që po rezultojn në një numër të vogël sekuestrimesh dhe konfiskimesh. Pengesa tjetër e autoriteteve

⁵⁹ AMPSK – Ligji 03/L-141.

Kosovare për zhvillimin e kapaciteteve për marrjen e asetëve është mungesa e komunikimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm në sistem – NjIF, policia dhe prokurorët, të cilët duhet të punojnë në një mënyrë të integruar me qëllim të identifikimit dhe ndjekjes së suksesshme të të ardhurave penale. Është e qartë se kjo nuk po ndodh në praktikë. Përveç kësaj, nuk ka ndonjë sistem efikas të referimit dhe monitorimit në fushën e hetimeve financiare dhe në ndjekjen/sekuestrimin e konfiskimit të asetëve. Zyra Kombëtare e Zbatimit të Krimeve Ekonomik, e propozuar si pjesë e Strategjisë Kombëtare kundër Krimeve Ekonomike, do të mund të bëjë një autoritet i tillë gjithëpërfshirës me qëllim që t'i jep prioritet dhe monitorojë masat në këtë fushë si në nivel të agjencive individuale ashtu edhe në një kornizë pune ndër agjenci.

2.4.2. Rekomandimet dhe Komentet

397. Kodi i Procedurës Penale duhet të ndryshohet që të përfshijë dispozitat që tregojnë standardin e provës që nevojitet për mundësimin e konfiskimit të mjeteve të destinuara që të përdoren në një vepër penale.

398. Kosova duhet t'i harmonizojë normat e KP-së dhe KPP-së sa i përket konfiskimit nga pala e tretë. Në këtë rast prioritet duhet t'i jepet kornizës së paraqitur në KP, që përgjithësisht është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe nuk do të paraqiste probleme të efikasitetit në kuptim të implementimit, për dallim nga normat e KPP-së.

399. Kosova duhet t'i rishikojë dispozitat e KPK-së që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta në mirëbesim. Duhet të ulet standardi i provës që kërkohet nga pala në mirëbesim për t'i dëshmuar të drejtat dhe qëllimet e tyre legjitime në lidhje me pasurinë.

400. Kosova duhet të vendos mekanizma për të parandaluar apo shmangur veprime, kontraktuale apo tjera, ku personat e përfshirë e dinin apo është dashur që ta dinin se si rrjedhë e atyre veprimeve autoritetet do të jenë të paragjykuara në aftësinë e tyre për ta marrë pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit.

401. Gjyqësori duhet të lejohet dhe të inkurajohet që të merr një qasje proaktive për marrjen e masave të domosdoshme, ku prokurori ka dështuar qartë në një rast specifik që të vazhdojë me sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve/të ardhurave nga krimi.

402. Kosova duhet që sa më parë t'i zbatojë komponentët relevantë të strategjisë LPSH/PFT, posaçërisht për të forcuar rolin e hetimeve financiare, mekanizmat e marrjes së asetëve dhe koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive në këto fusha.

403. Zyra kombëtare për zbatimin e ligjit kundër krimeve ekonomike, e paraparë me strategjinë, duhet të plotësohet me personel dhe të bëhet operacionale sa më parë me qëllim të monitorimit dhe forcimit të efikasitetit të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet agjencive në fushën e krimit financiar.

404. Agjencia për Menaxhimin e Asetëve, policia, KPK dhe KGJK duhet të obligohen të mbajnë statistika të bashkërenduara dhe më të hollësishme mbi shumat e pasurisë së ngrirë, të sekuestruar, dhe konfiskuar lidhur me PP, FT, të ardhurat penale dhe veprave të ndërlidhura penale.

405. Ka mospërputhje të formulimeve të përdorura nëpër legjislacion lidhur me dispozitat e sekuestrimit dhe konfiskimit. Ligji LPSH/PFT i referohet veprave që prodhojnë të ardhura nga krimi, Kodi Penal i referohet 'dobisë pasurore'. Gjithashtu, neni 112 i KPP-së njëkohësisht i referohet sekuestrimit të përkohshëm dhe konfiskimit të përkohshëm. Gjuha e tekstit është kundërtëse. Duhet të përdoren fjalët e njëjta. Duhet të këtë përputhje të

terminologjisë në tërë legjislacionin për t'i përjashtuar ambiguitetet, përfshirë dallimet ndërmjet KP-së dhe KPP-së.

406. Zëvendësimi i aseteve të siguruara në mënyrë jopenale në vend të konfiskimit të të ardhurave aktuale/dobisë pasurore nënkuptohet në nenin 97.1 të Kodit Penal. Kjo duhet të riformulohet për ta larguar çdo dyshim.

407. Urdhrat e përkohshëm për ngrirje iniciohen nga prokurori. Ka dispozita për ankesë nga ata që janë prekur nga Urdhri, por nuk është vetëm shprehimisht e cekur në KPP se kërkesat për këto Urdhra janë ex parte. Formulimet e dispozitës përkatëse (neni 274 KPP) duhet të jetë e sakta për të hequr çdo dyshim.

408. Kosova duhet ta konsiderojë implementimin e një sistemi të konfiskimit *in rem* të të ardhurave nga krimi. Ndryshimet në ligjin e zgjeruar mbi konfiskimin nuk e parashohin këtë.

2.4.3. Vlerësimi për Rekomandimin 3

	Vlerësimi	Përmbledhja e faktorëve që janë bazë e vlerësimit
R.3	MP	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ka procedurë apo standard të provës në KPP për të mundësuar konfiskimin e mjeteve të pastrimit të parave të destinuara për përdorim në një vepër penale. Ndërsa dispozitat e konfiskimit të palës së tretë të përfshira në KP plotësojnë standardet ndërkombëtare, nenet mbështetëse të KPP-së bien në kundërshtim me këto dispozita. Standardi i dëshmisë për palën e tretë në mirëbesim është tepër e lartë, shpesh duke e bërë të pamundshme për atë që t'i dëshmojë të drejtat e veta legjitime dhe synimet lidhur me pronën. Nuk ka autoritet që të merr masa për të parandaluar apo shmangur veprime, kontraktuale apo tjera, ku personat e përfshirë e dinin apo është dashur që ta dinin se si rrjedhë e atyre veprimeve autoritetet do të jenë të paragjykuara në aftësinë e tyre për ta marrë pasurinë. Efikasiteti i masave ekzistuese duhet të konsiderohet i ulët për shkak të pamjaftueshmërisë së ndjekjeve penale që rezultojnë në nivele të ulëta të konfiskimit të të ardhurave nga krimi. Nuk mbahen statistika kuptimplota mbi pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke e bërë të vështirë matjen e saktë të nivelit të efikasitetit të regjimit. Autoritetet për zbatimin e ligjit dhe autoritetet prokuroriale nuk ndërmarrin zbulimin dhe marrjen pro-aktive të aseteve kur ndjekin ndonjë krim përvetësues. Organet e zbatimit të ligjit edhe organet prokuroriale nuk ndërmarrin gjurmimi dhe kthimin e aseteve në mënyrë proaktive kur ndiqen krimet e përvetësimit.

2.5. Ngrirja e fondeve të përdorura për financimin e terrorizmit (RV.III)

2.5.1. Përshkrimi dhe analiza

Ngrirja e asetëve sipas S/Res/1267 (FATF RV.III: Kriteri thelbësor III.1) dhe sipas S/Res/1337 (FATF RV.III: Kriteri esencial III.2)

409. Ekipi vlerësues gjeti pothuaj mungesë absolute të strukturës legale të dedikuar për shndërrimin praktik në ligjin vendor të përcaktimeve sipas RKS KB 1267 dhe 1373 (përfshirë konsiderimin e përcaktimit të vendeve të treta) dhe mungesën e delegimit e pushtetit kombëtar për RKS KB 1373. Si pasojë e kësaj nuk ka legjislacion specifik që parashihet ngrirjen e asetëve të personave të caktuar dhe të subjekteve në Kosovë sipas RKS KB-së relevante.

410. Me një përjashtim të vjetruar të cekur më poshtë, as legjislacioni primar por as ai sekondar që kanë qenë në dispozicion të vlerësuesve nuk përmbajnë ndonjë dispozitë ligjore pozitive lidhure me ndonjë listë të personave të caktuar dhe subjekteve të shpallur ose nga Këshilli i sigurimit të KB ose nga ndonjë subjekt a autoritet tjetër ndërkombëtar. Nocioni i një liste të atillë është praktikisht joekzistues në ligjin e Kosovës, i cili nuk e parashikon njohjen e tyre, shpalljen publike dhe azhurnimin (aq më pak elaborimin e listave kombëtare) dhe as nuk i përcakton pasojat ligjore për ata që janë vënë në listë nga RKS KB ose nga ndonjë autoritet tjetër.

411. Në fakt, rasti i vetëm që nocioni i “listave terroriste” është përmendur fare në ndonjë pjesë të legjislacionit të Kosovës kanë qenë dy Udhëzimet Administrative të lëshuara nga Qendra e Inteligjencës Financiare (pararendësi i NjIF-së të tanishme) në vitet 2007 dhe 2008 si vijon:

- Në Udhëzimin administrativ nr. 003 (16 shkurt 2007) u publikua një listë e 19 personave dhe subjekteve të ndryshëm të pretenduar si të dyshuar për përfshirje në aktivitetet financuese terroriste. Përcaktimi ishte bërë pas marrjes së “informatave nga qeveritë e huaja” por nuk ishte bërë asnjë referencë e qartë nëse këta persona dhe subjekte kanë qenë të përfshirë në listë nga RKS KB ose diku tjetër, apo jo. Udhëzimi kërkonte që çdo bankë dhe institucion financiar të merrte masa adekuate për të vërtetuar nëse ata kishin ndonjë marrëdhënie afariste ose ishin të përfshirë në ndonjë transaksion me personat dhe subjektet nga lista dhe nëse po, bankat dhe institucionet financiare ishin të obliguar t’ia dërgonin një RTD (RTD – Raport të Transaksionit të Dyshimtë) Qendrës brenda 24 orëve sipas obligimit të tyre për Raportim, siç ishte e përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 që ishte atëherë në fuqi.
- Udhëzimi administrativ nr. 006 (11.03.2008) parashikonte që bankat dhe institucionet financiare ta zhvillonin një sistem të brendshëm, përmes të cilit klientët ekzistues të cilët vlerësohen që paraqesin rrezik të lartë, në bazë të procedurave NKT-së, do të krahasohen me listat e personave dhe subjekteve të dyshuar si në vijim:
 - Lista e konsoliduar e individëve dhe e subjekteve që i përkasin ose janë të ndërlidhur me organizatën Talibane ose të Al-Kaidës, siç është përcaktuar dhe vendosur nga Komisioni 1267 i KB-së (me URL të siguruar për versionin rregullisht të azhurnuar të listës në faqen e internetit të KB-së)
 - Lista e shtetasve të veçantë të caktuar dhe të personave të bllokuar të lëshuar nga Thesari i ShBA-ve, Zyra e kontrollit të asetëve të huaja (gjithashtu me URL të listës rregullisht të azhurnuar).

Pasojat ligjore ishin të ndryshme varësisht se për cilën listë bëhej fjalë. Nëse emri i klientit ekzistues ose të ardhshëm paraqitej në listën 1267, banka ose institucioni financiar ndalohej të ndërmernte veprime të mëtejshme që do të rezultonin me dhënien ose transferimin e fondeve ose të pasurisë së klientit nga kontrolli i bankës dhe, njëkohësisht, një RAD duhej t'i dërgohej QIF-it në bazë të Rregullores së lartpërmendur të UNMIK-ut. Por nëse klienti është paraqitur në ndonjë listë tjetër të njohur (ishte vetëm një) banka ose institucioni financiar ishte i obliguar ta dërgonte një RAD si më lart dhe të aplikonte monitorimin e shtuar për të reflektuar rrezikun më të lart të kanosur nga klienti, por nuk është ndaluar nga vazhdimi i marrëdhënies afariste.

412. Në kohën e nxjerrjes, ky Udhëzim administrativ është konsideruar si legjislaturë sekondare e nxjerrë me autorizim të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 (meqë është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit PLSH/PFT), i cili ka qenë burim i legjislacionit primar asokohe. Që të dy udhëzimet administrative i referohen nenit 2.1, paragrafi (1) të Rregullores në fjalë të UNMIK-ut, përmes së cilës autorizohet QIF-ja për të nxjerrë udhëzime administrative, urdhëresa dhe këshilla për çështjet lidhur me sigurimin ose promovimin e zbatimit të Rregullores, duke përfshirë në mes të tjerash, (i) përdorimin e formularëve standardë të raportimit; (ii) natyrën e akteve të dyshimta të transaksioneve për qëllimet e Rregullores përfshirë përpilimin e listave të treguesve të akteve dhe transaksioneve të atilla; dhe (iii) përjashtimin e personave ose subjekteve apo kategorive të personave ose subjekteve nga Raportimi i obligimeve sipas Rregullores së tashme dhe metodat e Raportimit të përjashtimeve të atilla.

413. Megjithatë Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 nuk e përcaktonte çështjen nëse dhe në çfarë rrethana QIF-i ose autoritetet e tjera kanë kompetencë t'i ngrijnë asetet që i përkasin personave dhe subjekteve të caktuara të përfshirë në listë të Këshillit të Sigurimit të KB ose gjetiu. Në veçanti neni 2.1, paragrafi (1) nuk duket të jetë mjaft specifik për të ofruar një bazë të fuqishme ligjore për një mekanizëm të atillë ngrirës dhe raportues që është krijuar nga vendimet administrative të lartpërmendura të QIF-it. Shkaku i kësaj, kontrolluesit mendojnë që QIF-i i tejkaloi kompetencat kur e zgjeroi fushëveprimin e regjimit të Raportimit të implementuar nga Rregullorja e UNMIK-ut në asetet që i përkisnin personave dhe subjekteve të caktuara.

414. Pos mungesës së kompetencës së duhur, ka edhe probleme të tjera me këto vendime administrative. Sa për Vendimin nr. 003 (2007) është krejtësisht e paqartë nëse kishte të bënte fare me listën e konsoliduar të listës së personave dhe subjekteve që i përkasin ose ndërlidhen me Talibanët ose Al-Kaidën, siç është shpallur dhe përpiluar nga komiteti kompetent i Këshillit të Sigurimit të KB të krijuar nga RKS KB 1267. Duket të mos ketë lidhshmëri të drejtpërdrejt mes dy listave dhe prandaj ka më shumë gjasa që lista relativisht e shkuar e personave edhe subjekteve të bashkëngjitura në Vendimin administrativ të lartpërmendur në fakt është përpiluar nga QIF, e cila e përpiloi në bazë të "informatave nga qeveritë e huaja". Duke e bërë këtë, është e qartë që QIF ka vepruar si një autoritet kombëtar përcaktues në kuptim të RKS KB 1373 për çka është e qartë që s'ka qenë e autorizuar nga legjislacioni ekzistues i asaj kohe (në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 ose gjetiu).

415. Ndryshe nga ai i diskutuar më lart, Udhëzimi administrativ nr. 006 (11.03.2008) së paku e bëri një referencë adekuate të listës së azhurnuar të Këshillit të Sigurimit të KB dhe të përpiluar sipas RKS KB 1267 dhe shkoi madje përtej kësaj, duke e zgjeruar shtrirjen në listat e tjera të personave dhe subjekteve të caktuara (nga të cilat megjithatë vetëm lista ZPKAH e ShBA-ve është përmendur, por jo edhe lista e personave, grupeve dhe subjekteve të përfshira në aktivitetet terroriste siç është aprovuar përmes Pozitës së përbashkët 2001/931/ PSPH të Këshillit të BE). Por ky Udhëzim administrativ nuk e ka trajtuar çështjen e asaj se pse klientët "e rrezikut të lartë" ekskluzivisht janë shqyrtuar në këto lista, pse ka pasur regjim më pak të

rreptë për ata të përfshirë në listat e “tjera” terroriste dhe çfarë procedura janë ndjekur kur asetet e personave dhe subjekteve të atilla janë identifikuar.

416. Për qëllim të vlerësimit të tanishëm, pyetja kryesore është nëse dhe deri në çfarë mase këto Vendime administrative mund të konsiderohen të vlefshme dhe legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë sidomos meqë që të dy i janë dhënë kontrolluesve si pjesë e legjislacionit ekzistues në këtë fushë. Në anën tjetër, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2, gjegjësisht legjislacioni primar mbi të cilin janë nxjerrë dhe cilit i janë referuar si bazë e autorizimit, nuk është në fuqi që nga viti 2001 dhe edhe nëse Ligji LPSH/PFT pothuaj i jep kompetenca të njëjta NjIF-së për të nxjerrë vendime administrative (neni 14.1.12) nuk është përcaktuar askund në ligj që Vendimet Administrative të QIF mundet ose duhet të jenë të përshtatshëmrisht të aplikueshme në kornizën e re ligjore. Është konfirmuar nga autoritetet pas vizitës në terren, se nuk mund të aplikohen sanksione mbi bazën e këtyre Vendimeve administrative të QIF-së, pasi që këto mund të shërbejnë vetëm si udhërrëfim - të cilat, megjithatë, duken diskutabile në vetvete pasi që asnjë nga Vendimet administrative të lartpërmendura nuk mund të gjendet në faqen e internetit të NjIF-së të Kosovës mes udhëzimeve dhe këshillave të aplikueshme. Si pasojë e kësaj, kontrolluesit detyrohen të mos i konsiderojnë Vendimet administrative të QIF-së nr. 003 dhe nr. 006 si pjesë e legjislacionit valid dhe të zbatueshëm tash për tash.

417. Pos vendimeve administrative të diskutuara më lart, nuk ka legjislacion tjetër në Kosovë që merret me ngrirjen e fondeve të përdorura për financimin e terrorizmit. Kur janë pyetur për legjislacionet që mund të jenë të aplikueshme për qëllim të aseteve të atilla, disa autoritete të Kosovës pranuan që nuk ekzistonte një legjislacion adekuat, ndërsa të tjerët iu referuan regjimit të ngrirjes të përcaktuar me Ligjin PLSH/PFT, masave të përkohshme të parapara me Kodin e Procedurës Penale ose madje me kombinim e këtyre dy regjimeve (ku transaksioni që përfshinë asetet terroriste mund të ngrihet përkohësisht, duke u mbështetur në nenin 22.6 të Ligjit PLSH/PFT dhe asetet eventualisht do të mund të siguroheshin përmes masave të përkohshme në bazë të KPP-së). Megjithatë, asnjëri nga këto ligje nuk është përdorur ndonjëherë për ngrirjen e aseteve që janë përdorur për financimin e terrorizmit.

418. Aplikueshmëria e regjimit të ngrirjes së LPSH/PFT të fondeve të përfshira në ndonjë transaksion (p.sh. asetet e depozituara) është më i diskutueshëm dhe e njëjta vlen edhe për aplikimin e masave të përkohshme detyruese të parashikuara me Kodin e Procedurës Penale. Në këtë kontekst, kontrolluesi duhet të ketë parasysh që rregullat e procedurës penale nuk kanë mundur të aplikohen pa inicimin e procedurës formale penale, e cila kërkon një veprë penale nën juridiksionin e Kosovës derisa vet paraqitja e emrit në ndonjë listën terroristësh doemos nuk përbën një veprë penale vendore. Për më tepër, pas inicimit të procedurës penale, veprimi i ngrirjes atëherë do të varej nga rezultati i procedurës.

419. Duke konsideruar që aktualisht nuk ka legjislacion në Kosovë për t'i bartur përcaktimet e RKSKB 1267 dhe 1373 në ligjin vendor (më saktësisht, RKSKB 1267, 1988 dhe 1373 meqë listat e Talibanit dhe të Al-Kaidës janë ndarë në vitin 2011 dhe se e para tash është duke u mbuluar nga RKSKB 1988) për të emëruar dhe autorizuar një autoritet të caktuar kombëtar për RKSKB 1373 dhe që në mënyrë efektive, nëse mundet fare, të parashikojë ngrirjen e aseteve të personave dhe subjekteve të caktuara, vlerësuesit erdhën në përfundim që mund të dëshmohej pa analizë të mëtejshme të kritereve thelbësore përkatëse që Kosova nuk i përmbushë, deri në asnjë masë, kërkesat e Rekomandimeve të veçanta III të FATF-së.

2.5.2. Rekomandimet dhe komentet

420. Nuk ka kornizë specifike ligjore që do t'ua mundësonte autoriteteve të Kosovës të marrin masa preventive dhe ndëshkimore për të ngrirë dhe, nëse duhet, konfiskuar fondet që ndërliken me terrorizëm ose asetet e tjera pa asnjë vonesë, në përputhje me rezolutat

relevante të Kombeve të Bashkuara. As Ligji LPP/LFT dhe as Kodi i Procedurës Penale nuk mund të aplikohen në këtë drejtim dhe e njëjta do të vlente edhe për Vendimet administrative nr. 003 dhe nr. 006 të QIF-së, të cilat madje as nuk janë legjislacion i zbatueshëm, edhe pse disa autoritete i konsiderojnë ato si udhëzime (duke mos harruar që ky i fundit i ka paraparë listat e terroristëve në mënyrë më specifike, me faktin që klienti është shënuar në cilëndo nga këto lista si njëfarë treguesi shtesë që e bën transaksion të dyshimtë dhe kështu jep arsye për Raportim dhe, nëse është e aplikueshme, ngrirje të një transaksioni të atillë përmes përdorimit të regjimit të përcaktuar me Ligjin LPP/LFT që ka qenë atëherë në fuqi.

421. Kështu ekipi vlerësues rekomandon fuqishëm që autoritetet e Kosovës të miratojnë një grup rregullash gjithëpërfshirëse (juridike ose administrative), të cilat do t’ua mundësonin atyre që të zbatojnë në mënyrë të përshtatshme sanksionet e synuara financiare, të përfshira në RKS KB përkatëse në lidhje me parandalimin dhe përmbajtjen e sulmeve financiare terroriste dhe ngrirjen e aseteve terroriste, duke i adresuar të gjitha kërkesat nën FATF RV.III. (Eshhtë e nevojshme të përmendet në këtë kontekst që qasja e ndjekur në vendimet e lartpërmendura administrative të NjIF-së është e papërshtatshme dhe e pamjaftueshme, prandaj edhe nuk duhet ndjekur në *lex ferenda*.)

422. Kur flitet në përgjithësi për arsyet e diskutuara më lart, obligimi për ngrirjen duhet të tejkaloj shprehjen “transaksion” dhe aplikimin e drejtpërdrejt të rregullave të procedurës penale. Për më shumë, duhet të jetë një mekanizëm për konvertimin në ligjin vendor të qëllimeve të përcaktuara në RKS KB 1267 dhe 1988 e gjithashtu edhe në kontekst të RKS KB 1373. Për përcaktimin e kësaj ka nevojë për një autoritet vendor të qartë, siç përcaktohet me 1373, dhe për marrjen parasysh të kërkesave të jashtme. Të gjitha përcaktimet me RKS KB 1267/1988 dhe 1373 duhet që të komunikohen menjëherë për të gjithë pjesët e sektori financiar, të cilat në anën tjetër kanë nevojë për një udhëzim të qartë në kuptimin e gjerë të fondeve ose aseteve tjera në kontekst të RV.III.

423. Procedurat e heqjes nga lista dhe zhbllokimi duhet të jenë të njohura edhe për publikun dhe për ata që preken pa qëllim nga mekanizmi i ngrirjes. Atëherë kur mekanizmi të jetë funksional, përputhshmëria me FATF RV.III duhet të kontrollohet në mënyrë aktive, dhe sanksionet duhet të jetë të gatshme në rast të mos pajtimit.

2.5.3. Klasifikimi për Rekomandimin e veçantë III

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve që nënvizojnë klasifikimin
RV.III	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka asnjë ligj ose procedurë efektive për ngrirjen e fondeve terroriste ose aseteve tjera të personave a subjekteve të caktuar në pajtim me RKS KB 1267/1988 dhe 1373 ose sipas procedurave të iniciuara nga vendi i tretë dhe për të siguruar se veprimet e ngrirjes të çojnë te fondet ose asetet të kontrolluara nga personat e caktuar; • Nuk ka asnjë autoritet të përcaktuar me RKS KB 1373; • Nuk ka asnjë sistem efektiv për veprime komunikuese nën mekanizmin e ngrirjes për sektorin financiar dhe nuk ka udhëzim praktik në këtë fushë; • Nuk ka procedurë për vlerësimin e kërkesave për heqjen nga lista dhe për zhbllokimin e fondeve ose aseteve të tjera të personave të hequr nga lista ose subjekteve dhe persona a subjekteve të prekura pa qëllim nga mekanizmi i ngrirjes. • Nuk ka procedurë për qasje të autorizuar të fondeve ose aseteve të tjera të ngrira në përputhje me RKS KB 1267/1988 dhe në pajtim me RKS KB 1452

		<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka procedurë specifike për kundërshtimin e veprimeve për ngrirje të marra në pajtim me RKSKB-të përkatëse; • Nuk ka masa për monitorimin e pajtueshmërisë me zbatimin e obligimeve sipas RV.III dhe vënien e sanksioneve.
--	--	--

2.6. Njësia e inteligjencës financiare dhe funksionet e saj

2.6.1. Përshkrimi dhe Analiza

Funksionet e NjIF (FATF R.26: Kriteri thelbësor 26.1)

424. Njësia e inteligjencës financiare është themeluar në fund të vitit 2010 sipas nenit 1 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Ligji LPP/LFT). NjIF ka trashëguar ndërtesën dhe strukturën të paraardhësit të saj, Qendrës për Inteligjencë Financiare (QIF), një organ i themeluar nga UNMIK-u dhe më vonë nga EULEX-i për të kryer funksionin e NjIF. Periudha e tranzicionit prej QIF-së të udhëhequr nga EULEX-i në NjIF të udhëhequr nga vendorët ka marrë disa vite, prej 2010- 2012 dhe në mënyrë formale është kompletuar në qershor të vitit 2012.

425. NjIF bie nën Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MEF) dhe sipas nenit 4 është institucioni qendror i pavarur përgjegjës për kërkimin, pranimin, analizimin dhe shpërndarjen e informatave të zbuluara - Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta⁶⁰ (RTD).

426. Legjislacioni kërkon nga subjektet raportuese që t'i japin informata NjIF-së nëpërmjet RTD-ve dhe brenda 24 orëve kur ata dyshojnë për pastrim të parasë dhe/ose financim të terroristëve. Gjithashtu, ata janë të obliguar që NjIF-it t'i raportojnë për gjitha transaksionet në valutë prej 10,000 € ose më shumë. Transaksionet e shumëfishta trajtohen si transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni ka njohuri se transaksionet janë për ose në emër të ndonjërit dhe tejkalojnë 10,000 € në një ditë.

427. NjIF ka zbatuar sistemin e zhvilluar nga KB “goAML” për menaxhimin e RTD-ve. Për praninë të sigurt ky sistem ofron ruajtje, analizë dhe shpërndarje të paketave inteligjente. Janë disa MiM që mbulojnë kërkesën dhe shkëmbimin e të dhënave në mes të NjIF dhe Doganave të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës. MiM me Policinë e Kosovës është ende në negociatë. MiM me Doganat e Kosovës gjithashtu edhe draft MiM me policinë parashikohen me zyrtar ndërlidhës që punojnë në NjIF me qëllim të ndihmës në shkëmbimin e informatave. Këta zyrtarë ndërlidhës gjithashtu funksionojnë si analistë në NjIF, qartazi të fokusuar në ato raste të cilat janë relevante dhe në interes të agjencisë.

Udhëzimi institucional (FATF R.26: Kriteri thelbësor 26.2)

428. NjIF ka lëshuar një udhëzim për subjektet raportuese përmes “Udhëzimit administrativ” me urdhër të drejtorit të Njesisë së Inteligjencës Financiare (NjIF). Deri në dhjetor 2011 janë lëshuar 14 udhëzime të tilla. Megjithatë, ashtu si u tha më lart, si pasojë e shfuqizimit të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, e cila formon bazën për këto udhëzime, njësiti i vlerësimit është i prirë që të mos i merr parasysh ato si pjesë e legjislacionit të vlefshëm dhe zbatueshëm për këtë kohë. Prandaj paragrafët përcjellës duhet të lexohen brenda këtij konteksti.

⁶⁰ Përfshin edhe veprimet e dyshimta (definicion nga neni 2.1.35)

429. Kjo mbulon mënyrën e Raportimit, veçanërisht fushat me rrezik që raportuesit duhet t'i kushtojnë vëmendje të shtuar, imponimit të RKSKB 1267 për individë dhe subjekte të caktuara, udhëzim se kur duhet të raportoj deponim të madh të parave të gatshme që tejkalojnë 10,000 €.

430. Nga subjektet raportuese kërkohet që të parashtrojnë RTD-të dhe raportet e tjera në mënyrë elektronike përmes sistem goAML. Qartazi shihet se ka disa pengesa të veçanta në këto përgatitje, që rezultojnë në ngarkesë të madhe nga aspekti i resurseve për sektorin privat. Formulari raportues i goAML është mjaft kërkues në kuptim të identifikimit të informacionit për konsumatorin e kërkuar. Në të njëjtën kohë kërkesa për Raportimin e deponimit të madh të parave të gatshme mbi 10,000 € do të thotë se çdo konsumator i ri pa marrë parasysh shumën e deponuar duhet të regjistrohen plotësisht në terminalin e goAML të subjektit raportues. Kjo shkakton disa ngarkesa të tepërta në industri për të parafutur një sasi të madhe të të dhënave në goAML, vetëm nëse një RTD mund të ketë nevojë të plotësohet në lidhje me një klient.

431. Në të njëjtën kohë formulari raportues i goAML është mjaft i ngurtë sepse nuk lejon subjektet të raportojnë analizat e tyre përmes tekstit narrativ dhe ta bashkëngiesin ndonjë referencë mbështetëse nëse autoritetet dëshirojnë të ofrojnë informata më gjithëpërfshirëse. Megjithatë, NjIF është e obliguar shumë shpesh të kthehet te subjektet raportuese me kërkesa për informata shtesë për gati 100 % të rasteve, gjithashtu duke i shtuar edhe burimit që ngarkon analistët e vet e gjithashtu edhe institucionet financiare të cilat janë të shtyra të gjejnë burime shtesë për të iu përgjigjur kërkesave të NjIF në vend se të rritet *kualiteti* i Raportimit. Ky kualitet i dobët i Raportimit edhe më tutje rëndohet nga një mungesë e përgjithshme të përgjigjeve te subjektet raportuese në rezultatet e rasteve specifike, gjithashtu edhe si çështje e përgjithshme të tipologjisë PP dhe tendencave⁶¹.

Qasja në informata (FATF R.26: Kriteri thelbësor 26.3)

432. Fusha dhe modeli i qasjes së NjIF në bazën e të dhënave të ndryshme nuk është plotësisht i kënaqshëm, e cila ndikon negativisht në funksionin analitik të Njesisë.

433. NjIF ka qasje të drejtpërdrejt (në bazë të MiM) në bazat e të dhënave të:

- Agjencisë Kosovare të Regjistrimit të Bizneseve brenda Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë dhe
- Departamentit të regjistrimit të OJQ-ve brenda Ministrisë së Administratës Publike.

434. Gjithashtu bazat e të dhënave janë të disponueshme për publikun e përgjithshëm, megjithatë NjIF ka qasje në versionin e gjerë i cili është i barabartë me zbatimin e ligjit, taksat dhe autoritetet tjera specifike. NjIF shfleton këto baza të të dhënave përmes një lidhje të internetit i disponueshme në kompjuter i cili është i ndarë nga struktura analitike kryesore kompjuterike. Kjo e bën të pamundur për të kryer çdo analizë vizuale të integruar me përdorimin e këtyre bazave të të dhënave, që ngadalëson në mënyrë të dukshme dhe zvogëlimin e kualitetit të procesit analitik.

435. NjIF nuk ka qasje të drejtpërdrejt në bazën e të dhënave në polici ose Dogana. Dogana ka ngarkuar një informacion të ri në bazën e të dhënave të NjIF në baza mujore bazuar në MiM të nënshkruara.

⁶¹ Raporti Vjetor i NjIF-it i cili do të publikohet në vitin 2013 do të përmbajë tipologji të dobishme për sektorin privat.

436. NjIF ka krijuar një lidhje elektronike përmes goAML me Doganat dhe Policinë përmes së cilës mund të kërkohen kërkimet e informatave ose shkëmbimin e rezultateve të analizës dhe shpërndarjet. Edhe pse NjIF do të dëshironte të kishte qasje në bazën e të dhënave të AZL-së por momentalisht kjo nuk është e mundur, kërkon sistemin e tanishëm për qasje indirekte, zakonisht përmes zyrave ndërlidhëse është një nevojë e përshtatshme.

437. NjIF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi (MiM) me disa institucione vendore, p.sh., Administratën Tatimore, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Agjencinë Kadastrale. Këto MiM nuk i janë ofruar ekipit të vlerësimit. Nuk është e qartë nëse NjIF ka qasje indirekte në bazën e të dhënave të Agjencisë Kadastrale dhe cila është gjendja edhe qëllimi i shkëmbimit të informatave me Administratën Tatimore dhe AKK-në. Në çdo rast është e qartë se marrëveshjet e tanishme në lidhje me fushën dhe gjendjen e qasjes në bazën e të dhënave nuk janë të mjaftueshme për NjIF për të ndërmarrë funksione të përshtatshme. Duhet të rritet numri i bazave të të dhënave që NjIF të ketë qasje. Këto baza të të dhënave ku NjIF është e lejuar të ketë qasje të drejtpërdrejt duhet të integrohen në strukturën analitike të goAML.

Autoriteti i NjIF për të marrë informata shtesë (FATF R.26: Kriteri thelbësor 26.4)

438. Paragrafi (2) i nenit 22 i obligon bankat dhe institucionet financiare që të ofrojnë informata shtesë në lidhje me raportimet e dyshimta që banka ose institucionet financiare do t'i kishin raportuar në NjIF. Megjithatë, nuk paraqitet se subjektet raportuese janë të obliguara të ofrojnë informata kur nuk ka lidhje me raportin e dorëzuar më herët nga institucioni i subjektit raportues. Më tutje, neni i lartpërmendur, ashtu siç duket, nuk e aprovon të drejtën ligjore të NjIF që t'i adresohet subjektit raportues me kërkesë për informata shtesë. Ç'është e vërteta, autorizime të tilla nuk sigurohen në asnjë pjesë tjetër të Ligjit LPP/LFT, p.sh.: neni 14 për detyrat dhe kompetencat e NJIF-it, i cili i jep autorizimin që të kërkohet informacione nga *organet publike ose qeveritare apo organe a organizata ndërkombëtare ose ndërqeveritare (në Kosovë), të dhëna, informacione, dokumente në lidhje me një person, subjekt, pronë ose transaksion*. Shihet qartë se kjo nuk i përfshinë subjektet raportuese.

439. Në përputhje me nenin 14.1.4, NjIF-i "kërkon të dhëna, dokumente dhe informata lidhur me kërkesat specifike të të dhënave ose analizave nga të detyruarit ligjërisht, të cilët duhet t'i ofrojnë ato me përpikëri për inspektim nga NJIF-ja dhe të lejojnë kopjimin dhe riprodhimin e tyre, vetëm për përdorim të Njësisë. Të detyruarit ligjërisht që i refuzojnë këto kërkesa duhet që brenda tri (3) ditëve pasi të jenë njoftuar rreth kërkesës së NJIF-së, të dërgojnë me shkrim arsyet e refuzimit të tyre. Pas kësaj, NJIF-ja merr një qëndrim dhe e njofton të detyruarin ligjërisht nëse ai/ajo është ose nuk është në pajtueshmëri me detyrimet e parapara në këtë dispozitë". Ky formulim, që është mjaftë i paqartë, duket se ndërlidhet me funksionin mbikëqyrës të NjIF-së ashtu siç rregullohet me nenin 30 të Ligjit LPP/LFT, dhe nuk e rregullon procedurën për të kërkuar informacione shtesë nga subjektet raportuese për qëllime analitike.

440. Pavarësisht nga interpretimi, është mjaftë e qartë se procedura për të kërkuar informacione shtesë nga subjektet raportuese ashtu siç është e përshkruar në Ligj përmban paqartësi të theksuara dhe është e hapur ndaj kundërshtimeve ligjore nga ana e subjekteve raportuese. NjIF ka shpjeguar se nuk janë paraqitur probleme të tilla në praktikë, megjithatë, rekomandohet që teksti të ndryshohet në atë mënyrë që autorizimi për të kërkuar informacione shtesë nga ana e NjIF-së të jetë i qartë dhe mos t'i nënshtrohet ndonjë interpretimi.

Autorizimi i NjIF për shpërndarje të informatave kur dyshohet për PP/FT (FATF R.26: Kriteri thelbësor 26.5)

441. Neni 15.2 i Ligjit LPP/LFT e autorizon NjIF-në që të shpërndajë tek organet për zbatimin e ligjit çdo informacion të pranuar sipas nenit 15.1, pra, të dhënat nga raportet e NjIF-së, të cilat i identifikojnë individë, të dhënat e transaksionit, veçantit e llogarive, të dhëna që kanë të bëjnë me personin ose identitetin e personit, i cili i ka siguruar informacionet tek NjIF-ja.

442. Drafti i ndryshimit të legjislacionit shton, tek neni 15 i Ligjit LPP/LFT, kompetencën e shprehur që “NjIF mund të shkëmbej, si brenda ashtu edhe jashtë vendi, të gjitha informacionet që janë të qasshme ose që sigurohen qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga ana e NjIF-së”. Një gjë të tillë NJIF mund ta bëj “më vetë iniciative ose në bazë të kërkesës”

443. NjIF e përdor sistemin GoAML për shpërndarjen e informatave tek Dogana. I njëjti mekanizëm i shpërndarjes po ashtu parashihet edhe në draft MeM, i cili tani është në proces të negocimit me Policinë. Ekipi vlerësimit po ashtu është njoftuar se NjIF i shpërndan materialet drejtpërdrejt tek Prokuroria Speciale (PSRK), e cila e ka kompetencën ekskluzive mbi rastet e PP. Ekipi i vlerësimit nuk ka arritur të kuptoj qartë se cilat kriterë ishte duke i përdorur NjIF-ja në përzgjedhjen se a duhet të shpërndahen materialet tek Policia apo tek PSRK-ja.

444. Shihet se NjIF nuk merr ndonjë koment sistematik sa i përket përparimit si rezultat i informatave të dhëna, edhe pse formulari i shpërndarjes së informatave përmban edhe kërkesën ndaj autoriteteve pranuese që ta njoftojnë NjIF-në në lidhje me rezultatet e hetimit. Përgjigjet e pakta të marra janë zakonisht sporadike dhe josistematike.⁶²

Pavarësia Operacionale e NjIF-së (FATF R.26: Kriteri thelbësor 26.6)

445. Neni 4 i Ligjit LPP/LFT nr. 03/L-196 parasheh themelimin e NjIF-së në kuadër të Ministrisë së Financave, si institucionin qendror të pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit.

446. Neni 5 i Ligjit LPP/LFT themelon Bordin menaxhues për të mbikëqyrë dhe siguruar pavarësinë e NjIF-së e që përbëhet nga Ministria i Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Kosovës, Policia, Administrata Tatimore, Doganat e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës. Bordi me ligj nuk ka fuqi ekzekutive ose detyruese kundrejt NjIF-së. Bordi takohet dy herë në vit dhe nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në ndonjë mënyrë në rastet që janë duke u zhvilluar nga NjIF-ja. Prandaj është e qartë se NjIF-ja ka pavarësinë dhe autonominë operacionale. Nga praktika duket se është kështu.

447. Bordi është i autorizuar që të rishikojë, miratojë dhe të refuzojë raportet e NJIF-së, të vëzhgojë dhe vlerësojë në mënyrë periodike performancën e drejtorit të NJIF-së; të emërojë dhe shkarkojë drejtorin e NJIF-së; të caktojë buxhetin e NJIF-së sipas propozimit të drejtorit të NJIF-së; të kontrollojë dhe vëzhgojë pasurinë e deklaruar nga drejtori i NJIF-së dhe rastet e konfliktit të interesit në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat e parapara përkatëse.

448. Një (1) herë në vit, Drejtori i NJIF-K-së i siguron çdo anëtar të Bordit një raport të azhurnuar pesëmbëdhjetë (15) ditë para çdo takimi të Bordit ku përmbledhen: vendimet dhe aktivitetet administrative, ekzekutive dhe rregullatore të NjIF-së; si dhe të gjitha aspektet e menaxhimit financiar, të hyrat dhe shpenzimet e NjIF-së. Deri me tani një raport i tillë është dorëzuar një herë tek Bordi.

⁶² Ekipi i vlerësimit është informuar më pas se NjIF dhe Policia kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me 19 shkurt 2013, megjithatë kjo mbetet jashtë fushëveprimit të këtij vlerësimi, pasi që nënshkrimi është bërë më shumë se dy muaj pas vizitës në terren.

Informacionet e NjIF-së janë të mbrojtura në mënyrë të sigurt ((FATF R.26: Kriteri thelbësor 26.7)

449. Neni 14 i Ligjit LPP/LFT nr. 03/L-196 parasheh që punonjësit e NjIF-së që informacionet e pranuar gjatë detyrave të tyre t'i mbajnë si të besueshme dhe të shpërndahen vetëm në përputhje me ligjin. Neni 33.6 e përcakton si vepër penale kurdo që zyrtari i NjIF-së zbulon informacione, heq apo shkatërron shënimet pa autoritet ligjor. Objektet e NjIF-së janë fizikisht të siguruara.

Raportet publike të NjIF-së FATF 26.8

450. Neni 10 i Ligjit LPP/LFT e obligon drejtorin e NjIF-së që t'ia paraqes Bordit raportin vjetor me shkrim. Ky raport duhet të përmbaj vendimet dhe aktivitetet administrative, ekzekutive dhe rregullatore të Bordit. Neni 14.1.9 i lejon NjIF-së që "t'i bëjë këto raporte publike si dhe të ndihmojë në kryerjen e detyrave të saj". Raporti i parë i NjIF-së' i është parashtruar Bordit në vitin 2011.

451. Raporti i vitit 2011 siç shihet nuk është bërë publik dhe nuk i përmban tipologjitë e SHP-së të cilat do të ishin ndihmuese për sektorin raportues.

Kërkesa e NjIF-së për t'iu bashkangjitur Grupit Egmont (FATF 26: Kriteri thelbësor 26.9)

452. NjIF e ka fituar sponsorimin prej NjIF-së të Sllovenisë që të anëtarësohet në grupin Egmont të NjIF-ve. Në fund të vitit 2011 ka paraqitur kërkesë që t'i lejohet pjesëmarrja në takimet e Grupit Punues të Egmont si vëzhgues, mirëpo kjo gjë është refuzuar nga ana e Egmont. NjIF është në pritje që ndryshimet e propozuara të Ligjit LPP/LFT të aprovohen, gjë që do të mund të i rriste gjasat e anëtarësimit në grupin Egmont.

Miratimi nga ana e NjIF-së të parimeve të Egmont për shkëmbim të informacioneve (FATF 26: Kriteri thelbësor 26.10)

453. NjIF ka theksuar se nuk i ka miratuar Parimet e Egmont për shkëmbim të Informacioneve ngase nuk është anëtar i Egmont. Përderisa një gjë e tillë është e vërtet, ato parime janë praktikata më të mira në këtë fushë dhe duhet të miratohen menjëherë.

A ka zbatuar Kosova nenin 25.1 të DSHP 3 të BE-së?

454. Nuk ka ndonjë obligim të posaçëm ndaj BQK-së ose ndaj Mbikëqyrësve të tjerë që të raportojnë ndonjë dyshim për PP/FT të cilin mund ta zbulojnë gjatë kryerjes së inspektimeve të tyre. Megjithatë, neni 14.1.5 i Ligjit LPP/LFT Nr. 03/L-196 e obligon NJIF si dhe organet e tjera si dhe institucionet në Kosovë që "të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke, të ndihmojnë njëra tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe t'i koordinojnë aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre" Nëse gjatë inspektimit Mbikëqyrësi krijon dyshimin për PP/FT sipas këtij artikulli duket se ai e ka obligimin që të raportoj rastin ngase kjo do të i ndihmonte NJIF. BKQ-ja ka njoftuar që ka pasur së paku një rast ku pas një inspektimi informacionet përkatëse për një rast të tillë iu janë përcjell NJIF-it. Siç duket BQK-ja nuk ka pranuar ndonjë përgjigje për rezultatet e rastit, dhe NJIF as që ka mund ta rikujtoj të ketë pranuar informacione të tilla nga BQK-ja.

Statistikat e mbajtura nga NjIF

455. NjIF mban statistika minimale për RTD/RTPSH të pranuar dhe të shpërndara. Ata nuk mbajnë statistika për transferimet elektronike ngase ato nuk raportohen tek NjIF. Në NjIF nuk ka statistika në dispozicion për rezultatet e shpërndarjeve të bëra tek organet për zbatim të ligjit.

Tabela 8 : Raportimi/shpërndarja totale e RTD

	2010	2011
Numri i RTD-ve të pranuar	145	131
Shpërndarja		
Policia e Kosovës	15	23
Administrata Tatimore	6	9
PSRK-ja		1
NjIF e huaj	1	
Banka Qendrore	1	
EULEX-i	4	1
Doganat		4
Totali i shpërndarjeve	27	38

Tabela 9: Statistikat për financimin e terrorizmit

	2010	2011	2012
Nr. i rasteve që kanë të bëjnë me <i>financim të terrorizmit</i>	13	5	3
Totali	13	5	4

Tabela 10: Raportet që u janë dërguar Policisë së Kosovës, Policisë së EULEX-it dhe PSRK-së

Rastet e shpërndara (dalur nga RTD-të)	2011	2012	Kërkesa informacione për të shpërndara (nga LE)	2011	2012
	Policia e Kosovës	15		23	Policia e Kosovës
PSRK	0	1	PSRK	4	3
Policia e EULEX	4	2	EULEX	16	7
Totali	19	26	Totali	41	34

456. Ankesa kryesore nga ana e NjIF është se ata nuk marrin ndonjë përgjigje ndaj RTD/analizave që ata i kanë shpërndarë. Numri i shpërndarjeve nuk është edhe aq i lartë që të mund përbënte ngarkesë tek agjencisë e tjera.

A financohet NjIF në mënyre adekuate, a ka personel të duhur e të trajnuar dhe me standarde të larta profesionale?

457. NjIF konsideron se buxheti i saj, si dhe numri i personelit e po ashtu edhe burimet teknike në përgjithësi janë të mjaftueshme që NjIF të jetë efektive në ushtrimin e mandatit të vet. Drejtori i NjIF-së ka paraqitur lutje për vlerësimin e nevojave financiare dhe teknike me qëllim që të mbesë në krye të trendëve në zhvillim të PP dhe FT-së.

Tabela 11 : Burimet financiare dhe njerëzore të NjIF-së

Viti	2009	2010	2011	2012	2013
Buxheti në total	328.603,00 €	368,255.00 €	327,293,00 €	332,920.00 €	334.250.00 €
Personeli	16	16	16	20	20

458. Po ashtu në NjIF janë edhe dy këshilltarë të EULEX-it që punojnë si analistë.

459. Personeli i NjIF-së ka marr pjesë në trajnime të shpeshta për aspektet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, analizave strategjike dhe taktike, hetimeve financiare, auditimeve dhe kontroleve financiare, menaxhim të kompjuterëve, GoAML. Këto janë siguruar si brenda vendit po ashtu dhe në nivelin ndërkombëtar. Pavarësisht prej trajnimeve, ne jemi njoftuar se akoma nuk është kryer analiza strategjike.

460. Prej personelit pritet që të mbajnë standarde të larta të integritetit. Ashtu siç u cek edhe më lart, drejtori duhet ta deklarojë pasurinë e vet.

461. Personeli rekrutohet sipas ligjit për rekrutimin e shërbyesve civil, ku kërkohet prej tyre që me rastin e nënshkrimit të kontratës së punësimit, ata të veprojnë në përputhje me ligjin për konfliktin e interesit dhe të demonstrojnë standarde të lartë të profesionalizmit, integritetit, ndershmërisë dhe shkathtësitë e duhura (shikoni po ashtu rekomandimet në seksionin 2.4 të Raportit të vlerësimit të në fushën e luftimit të korrupsionit).

462. Siç duket konkurrenca për plotësimin e pozitave në NjIF është tejet e lartë-përafërsisht 40 kandidatë për një vend të lirë. Kjo gjë i mundëson NjIF-së që të rekrutojë personelin që është mirë i arsimuar dhe me shkathtësi të larta. Lëvizja e personelit, gjë që ishte problematike para disa viteve nuk është problem më tutje.

463. Qasja e personelit në informacione të besueshme kalon përmes një procedure të verifikimit që shërben për të verifikuar të kaluarën e tyre.

Efektiviteti

464. Fatqësisht ekipit të vlerësimit nuk i janë dhënë informata të mjaftueshme për të gjykuar në mënyrë gjithëpërfshirëse efektivitetin e NjIF-it. Mungesa e statistikave të mirëfillta të cilat tregojnë rezultatet e informatave të dhënave prej NjIF-it ndaj zbatuesve të ligjit është mangësia kryesore, e cila rezulton nga mungesa e informatave kthyesë prej agjencive qeveritare dhe që duhet të korrigjohet në një afat sa më të shkurtër të mundshëm nga autoritete kosovare përmes përpjekjeve kolektive të agjencive qeveritare.

465. Në të njëjtën kohë NjIF-i ka ofruar së paku një shembull ku informatat janë përdorur në mënyrë të suksesshme në hetimet e PP-së. Ekipit për vlerësim gjithashtu i janë dhënë dosjet e përpunuara me qëllim të shpërndarjes së tyre autoriteteve për zbatimin e ligjit. Këto materiale tregojnë aftësinë e qartë të analistëve në NjIF për të kryer analiza të mirëfillta deri në momentin kur mund të ndërhyjnë ndaj veprës së mundshme të ndërlidhur, cila parashihet nga të dhënat në dispozicion. Sikurse është cekur më lart, procesi analitik me siguri mundet të bëhet në mënyrë më efektive dhe gjithëpërfshirëse po që se NjIF-i të kishte qasje të integruar në një spektër më të gjerë të bazave për të dhëna.

466. Qasja e kufizuar e NjIF-it ndaj bazave për të dhëna në agjencitë e tjera është shenjë e qëndrimit dhe njohjes së kufizuar institucionale të NjIF-it nga autoritetet tjera. Fakti që NjIF-i nga aspekti organizativ është e ndarë nga ministria/agjencia (në këtë rast Ministria e Financave) pasqyron pozitivisht në pavarësinë e saj operative, sido që të jetë rregullimi i tillë nuk liron Ministrinë e Financave nga përgjegjësia e përgjithshme (përfshirë atë si kryesues i Bordit menaxhues të NjIF-it) për Njësinë në kuptimin e sigurimit dhe promovimit të pozitës së tyre institucionale ndaj autoriteteve tjera. Përveç kësaj, Bordi menaxhues, kur i merr parasysh dhe i diskuton aspektet e ndryshme të punës së NjIF-it, duhet të përqendrohet në një masë më të madhe në ndihmën ndaj integritetit të NjIF-it me autoritetet tjera, në veçanti lidhur me qasjen në informata dhe në baza të të dhënave. Kjo do të ishte e udhës ngase Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e agjencive të cilat janë kyçe dhe partner të drejtpërdrejt të NjIF-it.

2.6.2. Rekomandimet dhe komentet

467. Ministria e Financave dhe Bordi menaxhues i NjIF-it duhet të marrin masa për të ndihmuar dhe promovuar imazhin institucional të NjIF-it ndaj autoriteteve tjera.

468. Rregullimet e tanishme në lidhje me shtrirjen dhe llojin e qasjes ndaj bazave të dhënave nuk mjaftojnë që NjIF-i në mënyrë të duhur të realizon funksionet e saj. Numri i bazave të dhënave, në të cilat NjIF-i mund të qaset duhet të zgjerohet. Më e rëndësishme është që NjIF-it t'i ofrohet qasja në bazë të dhënave policore. Në ato baza të dhënave ku NjIF-i ka qasje të drejtpërdrejt duhet të integrohen në korniza kryesore analitike të LPP-së për të fuqizuar cilësinë, spektrin dhe shpejtësinë e analizave.

469. Formularët e raportimit nuk duhet të paraqesin obligime mbi subjektet raportuese të cilat shkojnë përtej Ligjit të LPP/LFT-së (ngarkesë shtesë të resurseve mbi sektorin privat).

470. Praktikrat e tanishme të kërkesave për informata shtesë nga subjektet raportuese në pothuajse 100% janë të stërngarkuara. Lidhur me masat shtesë për rritjen e cilësisë së RTD-ve dhe, si rrjedhojë, zvogëlimin e ngarkesës së kërkesave shtesë, NjIF duhet të punoj me sektorin e Raportimit duke ofruar informata kthyesë të përgjithshme (tipologjike) dhe të synuara në rezultatin e RTD-ve të shpërndara.

471. Masat e përshkruara më lart, duhet përfundimisht dhe në përgjithësi si tërësi të zvogëlojnë ngarkesën e resurseve teknike mbi NjIF-në dhe subjektet raportuese, duke ju lejuar atyre që të përqendrohen në cilësinë e informatës së ofruar, si dhe në cilësinë e analizave të bëra. Megjithatë, disa nga masat kërkojnë përpjekje të orkestruara nga ana e një numri të agjencive. Për shembull, mungesa e informatave kthyesë të targetuara nga NjIF-i ndaj subjekteve raportuese buron nga mungesa e zbatimit të ligjit në fushën e kthimit të komenteve për NjIF-in, u ky është një problem për sistemin si tërësi, i cili ka nevojë të zbutet.

472. Pa informatë kthyesë nga zbatuesit e ligjit, NjIF-ja gjithashtu nuk ka mundësi që në mënyrë të drejt të standardizojë analizat e saj, gjë e cila në masë të madhe pengon ndonjë përmirësim të cilësisë së materialeve analitike të krijuara nga NjIF-i. Sistemi i rregullt dhe formal i informatave kthyesë mbi progresin e referimeve të NjIF-it duhet të zbatohet së bashku me polici, dogana dhe prokurorët. Kjo çështje duhet të konsiderohet si njëra nga prioritetet e zyrës kombëtare për luftën kundër krimit ekonomik, në momentin kur kjo zyre të themelohet.

473. Mungesa e statistikave kuptimplota që tregojnë rezultatet e shpërndarjes së informatave nga NjIF-ja deri të zbatuesit e ligjit është mangësia më e madhe, e cila rezulton nga mungesa e informatave kthyesë ndërmjet agjencive qeveritare. Andaj, autoritetet kosovare duhet ta korrigojnë këtë në një afat sa më të shkurtër të mundshëm përmes përpjekjeve kolektive të agjencive qeveritare.

474. Publikimi i Raportit vjetor nga NjIF-i duhet të konsiderohet si prioritet në mënyrë që të rritet vetëdijesimi lidhur me aktivitetet e NjIF-it në mesin e komunitetit të agjencive qeveritare, si dhe të sektorit raportues. Ky raport duhet të përdoret, ndër të tjera, si një mjet efektiv nga NjIF-i për të ofruar informata kthyesë për sektorin raportues, dhe për këtë duhet që gjithnjë të përfshijë informata mbi tipologjitë e tanishme të PP-së.

475. Rekomandohet të modifikohet teksti i Ligjit të LPP/LFT-së ashtu që t'i jep kompetenca NjIF-it që të kërkoj informata shtesë pa mundësi për keqinterpretim dhe mos të jetë subjekt i ndonjë interpretimi. Rrjedhimisht, rekomandohet që të futet një paragrafi i ri (1.2A) në nenin 14 të Ligjit LPP/LFT ku ka të bëjë me detyrat dhe kompetencat e NjIF-it për të kërkuar çfarëdo informata, të dhëna apo dokumente nga subjekti raportues, të cilat janë të nevojshme për Njësinë për të plotësuar obligimet e saj në bazë të Ligjit. Ky rekomandim

gjithashtu do të mbulonte situatat kur nga NJIF-i kërkohet nga partnerët e saj të huaja të cilët Njësia për momentin i përmbush nën paragrafin (2) e nenit 22 i cili ligjërisht nuk është korrekt dhe në rrethana të tilla asnjë RTD nuk do të dorëzohej:

Neni 14 (1.2A) me qëllim të plotësimit të ndonjërit nga obligimet e saja në bazë të këtij ligji, NJIF-i mund të kërkoj nga ndonjë subjekt raportues të gjitha informacionet, të dhënat, apo dokumentet të cilat Njësia mund ti kërkoj;

476. Që NJIF-i të zbatojë Parimet e Egmontit për shkëmbimin e informacionit në marrëdhëniet me NjIF-të e huaja.

477. NjIF-i duhet të realizojë vlerësimin e nevojave financiare dhe teknike për periudhën e tri viteve në vijim. Kjo duhet të plotësohet dhe të jetë e bazuar në informata nga vlerësimi i kërcënimeve për pastrim të parave dhe rreziqeve ndaj Kosovës (sikurse parashihet me strategjinë e LPP/LFT-së), ku NJIF-i duhet të marrë rolin udhëheqës. Dy vlerësimet duhet të krijojnë një plan veprimi/alokimi të fondeve me prioritetet e përbashkëta të përcaktuara për NjIF-në, zbatuesit e ligjit, autoritetet mbikëqyrëse dhe politikëbërësit.

2.6.3. Klasifikimi për Rekomandimin 26

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
R.26	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi dhe mënyra e qasjes së NjIF-it në bazat e ndryshme të të dhënave janë të pamjaftueshme dhe negativisht ndikojnë në funksionin analitik të Njësisë; • Paqartësia në kompetencat e NjIF-it për të kërkuar informata shtesë nga subjektet raportuese hap sfida ligjore; • NjIF-i i Kosovës duhet të konsiderojë miratimin e Parimeve të grupit të Egmontit për shkëmbimet ndërkombëtare të informatave; • Mungesa e informatave kthyesë nga zbatuesit e ligjit ndaj informatave të dhëna nga NjIF-i negativisht ndikon në efektivitetin e kësaj Njësie; • Mungesa e statistikave mbi rezultatet e informatave të dhëna nga NjIF-i nuk lejon gjykimin e drejtë lidhur me efektivitetin dhe rëndësinë e analizave të NjIF-it; • Mungesa e informatave specifike dhe strategjike kthyesë si dhe e udhëzimeve për subjektet raportuese shpjen në cilësinë e dobët të RTD-ve dhe numër të madh të informatave shtesë duke vënë ngarkesë shtesë në të dyja palët – NjIF-në dhe sektorët përkatës, si dhe duke ndikuar në zvogëlimin e efikasitetit; • Nevoja që vazhdimisht të kërkohen informata shtesë (rrjedhojë nga cilësia e dobët dhe RTD-të joinformuese) vë ngarkesë të resurseve mbi NjIF-në, duke ndikuar negativisht në efikasitetin e saj. • Raporti vjetor i NjIF-së nuk përmban tipologjitë e PP-së dhe nuk i është vënë në dispozicion publikut të gjerë.

2.7. **Zbatimi i ligjit, prokuroria dhe autoritet tjera kompetente – korniza e punës për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të PP-së dhe FT-së, si dhe për konfiskim e ngrirje (R.27 dhe 28)**

2.7.1. Përshkrimi dhe Analiza

Rekomandimi 27

478. Të gjitha agjencitë kosovare të zbatimit të ligjit kanë përgjegjësi për të siguruar se veprat e pastrimit të parave të hetohen. Ekziston një njësi e specializuar brenda Policisë së Kosovës – Njësia për hetimet financiare dhe të pastrimit të parave në kuadër të Drejtorisë kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit. Doganat e Kosovës kanë përgjegjësi hetuese, ku e NJIF-jatu ka përgjegjësi për t'i referuar rastet për hetim kur të vërehet apo dyshohet se ndodh pastrimi i parave.

479. Ndjekjet penale të pastrimit të parave janë përgjegjësi e rezervuar e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK). Për momentin janë 10 prokurorë të PSRK-së, me plan të rritjes së numrit të tyre në 15. Në kohën e vizitës në vend ishin tri nivele të prokurorëve; prokurorë të qarkut, prokurorë të shtetit dhe prokurorë specialë. Nga 1 janari 2013, Kosova ka riorganizuar prokurorinë dhe shërbimet e gjyqit në strukturë më të rrafshët. Zyra e Prokurorëve Specialë është mbajtur dhe gjithashtu ka rezervuar kompetencat e saj që në baza ekskluzive të ndjek penalisht rastet e PP-së.

480. Policia rregullisht pranon informatat e dhëna nga NJF-i dhe kryen kontrollimin preliminar brenda 24 orëve para dorëzimit të dosjes në PSRK. Hetimet iniciohen kur PSRK-së i prezantohen informatat apo provat e mjaftueshme nga Policia e Kosovës apo burimet tjera (përfshirë prokurorët shtetërorë) se një vepër është kryer. Hetuesit e pastrimit të parave udhëhiqen nga prokurori ku zbatuesit e ligjit veprojnë si “dorë e djathtë” e prokurorit. Zbatuesit e ligjit duhet të lajmërojnë prokurorin për çdo informatë të re të zbuluar gjatë hetimeve të PP-së. Ekipi i vlerësimit është informuar se gjithnjë është prezent në detyrë në polici për të përshpejtuar procesin e vendimmarrjes në raste urgjente.

481. PSRK-ja pastaj kërkon hapjen zyrtare të hetimeve nga gjykatësi i procedurës paraprake. Gjykatësi i procedurës paraprake mund të autorizoj një spektër të teknikave të hetimeve të fshehta, të cilat kërkohen për të mbledhur prova të mjaftueshme që do ta mbështesnin ndjekjen penale të pastrimit të parave apo ndonjë vepër tjetër.

482. Neni 87 i Kodit të Procedurës Penale⁶³ përshkruan një spektër të teknikave në dispozicion. Këto përfshijnë në mes të tjerash përgjimin e komunikimeve, operacione sekrete, agjent bashkëpunues, kontrollimin e dërgesave postare dhe zbulimin e të dhënave financiare.⁶⁴ Nuk ka statistika në dispozicion për shembujt kur janë përdorur teknikat hetuese në rastet e pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit.

483. FATF R.27: KTH.27.2 rekomandon që të konsiderohet (me ligj apo ndryshe) lejimi i vonesës apo anulimit të arrestimit. Koha e arrestimit është çështje e gjykimit të prokurorit apo gjykatësit të procedurës paraprake. E vetmja dispozitë e identifikueshme në legjislativ kur arresti mund të anulohet apo kur nuk preferohet padia është në rastet kur i akuzuari potencial pajtohet të bëhet dëshmitar bashkëpunues. Neni 235 i PK-së përcakton kërkesat dhe obligimet e dëshmitarit bashkëpunues. Kjo nuk është plotësisht në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare, të cilat kërkojnë që të ketë mundësi të masës së shtyrjes kur, për shembull kërkohet më shumë mbledhje të provave .

484. Nuk ka prova për ndonjë rishikim të trendëve dhe teknikave të PP/FT-së nga autoritetet kompetente të agjencive të ndryshme dhe në baza të rregullta.⁶⁵

⁶³ 2012_04-L-123-eng në fuqi nga 1 janari 2013.

⁶⁴ Neni 256 i KPK i vjetër i ka definicionet e njëjta.

⁶⁵ Rekomandimi 27.6 i FATF-it.

485. Autoritetet kompetente përgjegjëse për hetimin e rasteve të PP-së dhe FT-së kanë kompetenca të përgjithshme të hetimeve të veprave penale të bastisjes dhe konfiskimit, të cilat rrjedhin nga neni 105 (Urdhëri gjykatës për bastisje/kontrollim) dhe neni 110 (Bastisje pa urdhër të gjykatës) i KPK-së.

Rekomandimi 28

486. Neni 119 i KPK-së së re jep prokurorit të drejtë të merr të gjitha dokumentet provë, përfshirë regjistrat financiare. Neni 121 i KPK-së cek një spektër të provave joekskluzive që mund të merren nga prokurori në fazën e dëshmisë së procedurës paraprake. Kjo dispozitë duket se mbulon një spektër të plotë të llojeve të dokumenteve që kërkohen në rekomandimin 28 të FATF-së. Në të njëjtën kohë, neni cek se provat e prekshme në mes të tjerash janë “ndonjë... provë e prekshme e marrë në mënyrë ligjore sipas këtij Kodi të Procedurës Penale, ekzistimi dhe forma e së cilës ofron prova të mjaftueshme relevante për hetim”. Provat e prekshme në mënyrë të duhur mund të përdoren në procedurat penale.

487. Nenet 122 dhe 123 të KPK-së parashohin marrjes e deklaratës së dëshmitarëve gjatë fazës së procedurës paraprake. Intervistimi i dëshmitarit mund të bëhet nga prokurori apo ai mund t'i delegojë këtë përgjegjësi përfaqësuesit të organit për zbatimin e ligjit.

488. Nenet 70 - 73⁶⁶ të KPK-së së re u japin agjencive për zbatimin e ligjit kompetencën për të mbledhur informata për hetimin e krimit në fazën fillestare të hetimeve. Këtu përfshihet intervistimi dëshmitarëve dhe marrja/konfiskimi i provave.⁶⁷

489. Masat e fshehta dhe teknikat e përcjelljes e hetimit gjithashtu mund të ndërmerren (nenet 86-96 të KPK-së) nga policia me autorizim të gjykatësit të procedurës paraprake apo nëse është rast ekskluziv i PP-së – nga prokurori, në rast se rrethanat kërkojnë veprim urgjent. Provat dhe materialet e mbledhura me përdorim të masave të tilla, përfshirë edhe regjistrat financiarë, janë të pranueshëm nëse merren në përputhje me procedurat penale. Pranueshmëria e tyre gjithashtu mund të sfidohet nga e akuzuari gjatë kohëzgjatjes së procedurave.

490. Përveç kësaj, neni 14 i Ligjit të LPP/LFT-së i jep NjIF-it të drejtën që të kërkojë dhe të marrë kopjet e të dhënave të caktuara dhe informatat nga organet që i obligohen. Neni 15.2 i ligjit të LPP/LFT-së lejon që informatat që mbahen nga NjIF-i të zbulohen për polici dhe prokurorë për qëllime hetuese, por kjo nuk mund të ofrohet si dëshmi pa autorizimin e drejtorit të NjIF-it (neni 15.3).⁶⁸ Njohuria që informata ekziston lejon qasje më të përqendruar në mbledhjen e provave.

Resurset dhe personeli (R.30)

491. Njësia e Policisë së Kosovës kundër krimeve financiare dhe pastrimit të parave është e vogël me vetëm tre zyrtarë. Pasi që krimi financiar pothuajse gjithnjë lidhet me veprat e pastrimit të parave ekipi i vlerësimit konsideron se kjo nuk është adekuate. Pasi që hetimet e PP-së të rriten në numër dhe përfshijnë më shumë nga forcat policore, është e qartë se kjo Njësi do të merr detyra të rolit mbikëqyrjes dhe udhëzues për të gjitha hetimet e tilla.

492. Ekipi i vlerësimit është informuar se 50% të drejtuesve policorë kanë pozita të ushtruesit të detyrës, p.sh. duke punuar me gradë më të lartë se sa grada të cilën e kanë dhe

⁶⁶Neni 201 i KPK të vjetër – kompetencat e përgjithshme të policisë për hetime.

⁶⁷FATF i referohet rekomandimit 28.2.

⁶⁸FATF i referohet rekomandimit 28.1.

kjo shkakton që ata të jenë më jofleksibil në marrjen e vendimeve. Si duket janë rreth 5000 ankesa të bëra kundër PK-së, ku vetëm 500 prej tyre janë hetuar, që ndikon në humbje të besimit të qytetarëve në integritetin e PK-së. Ekipi vlerësues është informuar nga burimet e ndryshme se “ndërhyrjet” politike në polici janë një problem dhe se “nuk ka” mjaft polici.

493. Doganat e Kosovës dhe NjIF-i kanë dhënë informata të shumta për trajnimet përkatëse të natyrës së pastrimit të parave, analizave financiare dhe kompetencave të tjera profesionale. Këto trajnime janë organizuar si nga donatorët e jashtëm ashtu edhe nga ofertuesit vendorë. Trajnimi gjithashtu u janë ofruar PK-së, hetuesve të PK-së, prokurorëve, gjykatësve, inspektorëve për tatim, doganierëve, NjIF-it, bankave dhe agjencive tjera.

494. Instituti Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë. Në kuadër të Programit arsimor të vazhdueshëm ligjor, gjatë viteve 2009-2012, ata kanë ofruar module trajnime për 38 gjykatës dhe 22 prokurorë në fushën e luftimit të krimit të organizuar, të cilët kanë përfshirë: krimin financiar, korrupsionin, ekonominë joformale dhe pastrimin e parave. Po ashtu, 37 gjykatëse, 30 Prokurorëve dhe 24 vijues të tjerë⁶⁹ kanë përfituar nga modulet për luftimin e korrupsionit, ku janë përfshirë: teknikat e hetimit në raste të korrupsionit, të kuptuarit e korrupsionit – parandalimi, pasojat dhe luftimi i tij, veprat penale që lidhen me korrupsion dhe elementet e tyre. Në kuadër të moduleve për krimet financiare dhe ekonominë joformale, janë trajtuar tematikat e ndjekjes penale dhe hetimit të rasteve të pastrimit të parave, format dhe elementet e veprave penale të pastrimit të parave, mjetet ligjore të cilat sanksionojnë krimet financiare, institucionet e autorizuara për luftimin e krimeve financiare, veprat penale të cilat përmbajnë elementet e krimit financiar, masat për parandalimin e krimeve financiare, hetimi dhe konfiskimi i pasurisë, e cila vjen nga kryerja e krimeve financiare – provat, sigurimi dhe analiza e provave financiare, si dhe puna në bazë të provave; dokumentet me shkrim dhe ekspertët të kompjuterëve (65 persona kanë marrë pjesë, nga ata 26 gjykatës, 17 prokurorë dhe 22 të tjerë⁷⁰). Në kuadër të Programit fillestar për arsimimin juridik (kandidatët për gjykatës dhe prokurorë) është mbajtur moduli për krimet financiare dhe korrupsion në 20 seanca trajnuese. Ky modul i trajnimit është vijuar nga 141 kandidatë, ku pjesa më e madhe e tyre kane qenë tanimë të emëruar dhe ushtrojnë funksionin e gjykatësit apo të prokurorit.

495. Është e paqartë nga informatat e ofruara nëse një numër më i madh i zyrtarëve policorë është përfshirë në trajnime të përgjithshme për vetëdijesim lidhur me temat e pastrimit të parave dhe identifikimit të veprimeve në kontekstin e hetimeve të krimeve ekonomike. Në mënyrë që të zgjerohen përpjekjet për luftimin e krimeve ekonomike është imperativ që të përfshihen dhe të ngrihet vetëdijesimi i policisë lidhur me nevojën për ndjekjen proaktive të veprave penale të cilat lidhen me ndonjë krim të përfitimit të paligjshëm.

Statistikat dhe efektiviteti

496. Policia i ka ofruar ekipit për vlerësim statistikat vijuese lidhur me arrestime dhe hetime të veprave të PP-së:

Tabela 12 : Arrestimet dhe hetimet e veprave të PP-së

Rastet e pastrimit të parave	2010	2011	2012

⁶⁹ Asociacionet profesionale të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, anëtarët e PK-së dhe përfaqësuesit e njësive anti-korrupsion nga Shqipëria.

⁷⁰ Asociacionet profesionale të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, përfaqësuesit nga sektori kundër krimit të organizuar (Shqipëri), pjesëtarët nga PK-ja.

Rastet nën hetim	22	3	8
Paditë penale të dorëzuara	3	3	3
Kundër të dyshuarve	7	6	14
Të arrestuar	6	1	7

497. Përndryshe, Zyra e Prokurorisë ka raportuar statistikat vijuese mbi pastrimin e parave:

- Gjatë vitit 2009, prokurorët kanë pranuar në total 10 raporte që lidhen me 38 persona, ku kanë punuar në total prej 43 rasteve gjatë këtij viti. Nga informatat e marra, 8 prej tyre ishin raportuar nga policia dhe 2 nga QIF-i. Pesë raste ishin zgjidhur, por nuk janë bërë paditë;
- Gjatë vitit 2010, prokurorët kanë pranuar në total 17 raporte lidhur me 33 persona, ku ata kanë punuar në gjithsej 71 raste. Nga informatat e marra: 15 ishin raportuar nga policia, ndërsa 1 prej QIF-it dhe një 1 prej të tjerëve. 21 raste janë zgjidhur dhe tetë 8 padi janë ngritur kundër 8 personave.
- Gjatë vitit 2011, prokurorët kanë pranuar në total 34 raporte lidhur me 79 persona, ndërsa gjatë këtij viti ata kanë punuar në gjithsej 129 raste. Nga informatat e marra: 30 ishin raportuar nga policia, 1 prej QIF-it, 1 drejtpërdrejt nga prokurori dhe 2 prej të tjerëve. Nga këto, 33 raste janë zgjidhur dhe shtatë 7 padi janë dorëzuar.
- Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012, prokurorët kanë pranuar në total 10 raporte lidhur me 35 persona, ndërsa gjatë këtij viti ata kanë punuar në gjithsej 131 raste. Nga informatat e marra: 4 ishin raportuar nga policia, 2 nga QIF/NjIF-i, 2 nga prokurorët dhe 2 prej të tjerëve. Nga këto, 32 raste janë zgjidhur dhe 7 padi janë dorëzuar.

498. Informatat e ofruara nga KGjK-ja si dhe nga KPK-ja sugjerojnë se ka pasur dënime për vepra të PP-së (nuk është e qartë nëse rasti i ashtuquajtur ‘koalicioni’ (shih pjesën 2.1) ka përfunduar në dënim).

499. Shihet se statistikat dhe regjistrat e mbajtura nga ana e Policisë dhe prokurorët nuk përputhen si nga aspekti i kriterëve, ashtu edhe nga ai i numrave përfundimtarë. Ekipi i vlerësimit ishte informuar që policia dhe prokuroria kanë bërë progres të dukshëm drejt sinkronizimit të rasteve të tyre në lidhje me sistemin referues, sido që të jetë e njëjta gjë duhet të bëhet për referenca statistikore. Statistika policore nuk reflektojnë ndjekjet penale të rasteve të PP-së apo rezultatet e tyre. Ekipi vlerësues është njoftuar se policia ndonjëherë është e informuar mbi ndjekjet penale, megjithatë është e qartë se të dhënat e tilla nuk ofrohen në mënyrë sistematike dhe nuk regjistrohen në mënyrë sistematike nga vetë policia.

Statistikat e dhëna nga prokuroria tregojnë një rritje graduale të ngarkesës me raste të PP-së më të cilët ata merren, si dhe rritje të rasteve me të cilat duhet të merren – gati 100 në vitin 2012. Pasi që rastet e PP-së i takojnë kompetencave ekskluzive të PSRK-së, e cila merret me numër të madh të veprave me vetëm 10-15 prokurorë në dispozicion, është e qartë se duhet të konsiderohet ndryshimi i qasjes. Gjithashtu, PSRK-ja ka mungesë të kapacitetit për tu ballafaquar me rastet në rritje të PP-ve, gjë e cila mund të dekurajojë zbatuesit e ligjit, të cilët do të hezitojnë që të kërkojnë të ardhurat nga krimi edhe nëse ekzistojnë veprimet e qarta të realizimit të vepër së ndërlidhur penale.

500. Rritja e numrit të rasteve për prokurorët përkon me rënien e madhe të numrit të rasteve të PP të raportuara tek ata nga policia gjatë vitit 2012 (sipas statistikave të ShPK-së). Nëse do të merreshin statistikat e policisë për rastet e hetuara të PP-së, do të vërej rënie të madhe të hetimeve për vitin 2011. Duke lënë anash çështjen e statistikave kontradiktore, megjithatë mund të thuhet se ka pasur rënie në aktivitetin e policisë për të hetuar dhe për t'i

referuar prokurorisë rastet gjatë viteve të fundit. Nuk është e qartë se cili është shkaku për këtë, por ky është një tregues i qartë i rënies së efikasitetit. Kjo është konfirmuar po ashtu me faktin se nuk ka rritje të shkallës së dënimeve (gjë e cila mund të paraqiste një rritje të cilësisë, duke sakrifikuar ndërkohë sasinë).

Bashkëpunimi polici/NjIF

501. Ekipi vlerësues është informuar se policia ka pasur përvoja jo të mira të bashkëpunimit me NjIF-in, shpeshherë për shkak të mungesës së qartësisë në materialet e dorëzuara nga ana e NjIF-it. Me sa duket gjendja është duke u përmirësuar, megjithatë ekipi vlerësues ka shqetësime me numrin e pamjaftueshëm të informatave kthyesë të ofruara NjIF-it për rezultatet e hetimeve policore.

502. Policia ishte në gjendje të informoj ekipin vlerësues lidhur me një hetim të suksesshëm të shfrytëzimit të materialit nga NjIF-ja në lidhje me një ish-gjyqtar, i cili u dënua me dhjetë vjet burgim. Me sa duket NjIF-i nuk ishte në dijeni të këtij rezultati.

503. Policia ka ofruar statistikën në vazhdim në lidhje me përpunimin e materialeve të pranuar nga NjIF-i:

2012

22 raste janë pranuar nga NjIF

4 raste nën hetime

25 raste të hetimeve paraprake

PPN nën hetime 6

Raste të mbyllura 3

Me raport të veçantë 10

2011

31 raste janë pranuar nga NJIF

Nën hetime 3

Kallëzime penale 2

Hetime paraprake 24

PPN nën hetime 3

Raste të mbyllura 7

Me raport të veçantë 2

2010

18 raste të pranuar nga NJIF-

Nën hetime 4

Kallëzime penale 2

Hetime paraprake 14

Raporte të veçanta 8

504. Siç është shpjeguar më lartë, pas pranimit të rastit nga NjIF-i, policia fillon hetimet paraprake për të verifikuar informatën, e cila përmbahet në Raportin e NjIF-it. Nëse hetimi paraprak vërteton të gjeturat e NjIF-it, atëherë i dorëzohet një kërkesë prokurorit për hapjen e një rasti të hetimit penal. Nga statistikën e mësipërme është e qartë se 10-25% e rasteve të NjIF-it shkojnë përtej fazës së hetimit paraprak. Statistikat duket të jenë pakë a shumë stabile. Ky është një fakt që është shqetësues në vetvete, meqë demonstroi dhe konfirmon mungesën e informatave kthyesë nga policia tek NjIF-i. Këto informata kthyesë do t'ia mundësonin NjIF-it që të rregullojë qasjen e saj analitike, e cila do të rezultonte me më pak raste të hedhura poshtë nga policia.

505. Ndërsa ekipi vlerësues ka identifikuar disa mangësi në kapacitetet analitike të NjIF-it (shih analizat në pjesën 2.6 të këtij Raporti), mostrat e materialeve të NjIF-it dhëna ekipit vlerësues demonstrojnë më shumë një analizë të orientuar nga rezultatet sesa nga informacionet. Në këtë mënyrë, mangësitë në zinxhirin inteligjencë-hetim-ndjekje penale nuk takojnë vetëm NjIF-i, por në një masë të madhe edhe policisë, e posaçërisht pasi që është një përqindje e madhe e rasteve të hedhura poshtë në fazën e hetimit paraprak. Për më tepër, një numër kaq i madh i rasteve të hedhura poshtë do të thotë se nga 75-90 % e kohës së burimeve dhe personelit të NjIF-it të shfrytëzuar për të prodhuar materiale në lidhje me rastet janë të paraqitura si jorelevante. Kjo është më shumë një statistikë demotivuese, e cila duhet të përmirësohet sa më shpejt që të jetë e mundur përmes vendosjes dhe monitorimit të bashkëpunimit NjIF-polici, dhe kjo duhet të jetë një prioritet urgjent i zyrës kombëtare për ndjekjen e krimeve ekonomike.

2.7.2. Rekomandime dhe komente

506. Zyra kombëtare për ndjekjen e krimeve ekonomike duhet urgjentisht të dizajnoj masat për një bashkëpunim më të afërt të NjIF-it me policinë dhe të monitorojë zbatimin e tyre me qëllim që të rris efikasitetin e shfrytëzimit nga ana e policisë të burimeve të NjIF-it.

507. Zyra kombëtare për ndjekjen e krimeve ekonomike duhet të krijojë një sistem të mirëmbajtjes së statistikave të unifikuara midis policisë dhe prokurorisë për rastet e PP-së, me qëllim që të sigurojë se mund të bëhen analiza të sakta të efikasitetit të sistemit.

508. Duhet të rritet numri i personelit të njësisë së Policë së Kosovës për luftimin e krimeve financiare dhe pastrimit të parave.

509. Zyrtari ndërlidhës i policisë pas nënshkrimit të planifikuar të MM duhet të bëhet kanali kryesor i informatave kthyesë ndërmjet dy agjencive, në veçanti në lidhje me sigurimin e informatave mbi përparimin e rasteve të NjIF-it. Kjo duhet të specifikohet në mënyrë eksplicite në tekstin e MM-së. Përveç kësaj NjIF-i duhet të mbajë konsultime të rregullta dhe takime bashkërenduese me njësinë e policisë për PP mbi çështjet të cilat lidhen me përmbajtjen e materialit të furnizuar.

510. Të prezantohen objektivat dhe kriteret transparente për emërimin/shkarkimin e drejtorit të përgjithshëm dhe të menaxhmentit të lartë me qëllim për të siguruar pavarësinë operationale të policisë (shih përshkrimin në Raportin KK, pjesa 2.3).

511. Rekomandohet që të miratohen udhëzues për policinë në lidhje me aprovimin e angazhimit të jashtëm të veçantë për oficerët policorë dhe të vendoset një kufizim për kompensimin e atyre angazhimeve (shih përshkrimin në Raportin KK, pjesa 2.3).

512. Inspektorati i Policisë së Kosovës duhet të zgjerohet për të përfshirë një vlerësim nëse PK është efektive dhe “e përshtatshme për qëllimin”. Këto raporte duhet të bëhen publike.

513. Duhet të ketë një përpjekje të bashkërenduar për të pastruar (përfunduar) numrin e rasteve të mbetura të PP në sistemin prokurorial.

514. Autoritetet kompetente të Kosovës duhet të bëjnë rishqyrtimin e teknikave dhe të trendit të PP/FT në baza të rregullta ndërmjet agjencive me të dhëna të hollësishme nga policia dhe prokuroria.

2.7.3. Klasifikimi për rekomandimin 27 dhe rekomandimin 28

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
--	--------------------	--

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
R.27	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e statistikave të unifikuara e bënë të pamundur gjykimin me saktësi të plotë të efikasitetit të hetimeve dhe të ndjekjes penale të PP; • Rritja e numrit të rasteve në PSRK që kanë të bëjnë me rastet e PP tregon mungesën e burimeve dhe nivelin e ulët të efikasitetit; • Personeli joadekuat në njësitë e specializuara të policisë për luftimin e PP ndikon në efikasitet; • Policia nuk i ofron NJIF-it informata kthyesë për rastet, duke zvogëluar efikasitetin e përgjithshëm të sistemit; • Prokuroria nuk i ofron asnjë informatë kthyesë policisë dhe organeve tjera të zbatimit të ligjit mbi rezultatet e ndjekjes penale; • Rënia e madhe e numrit të rasteve të PP të raportuara nga ana e policisë në PSRK gjatë vitit 2012 tregon rënien e efikasitetit të policisë në ndjekjen e PP; • Ekziston mungesa e vetëdijesimit në polici në lidhje me nevojën për të ndjekur në mënyrë proaktive të ardhurat kriminale kur ato kanë të bëjnë me krimin e përvetësimit; • Nuk ekziston kompetencë e qartë për të shtyrë apo për të hequr arrestimin me qëllim të mbledhjes së dëshmive apo identifikimit të personave të tjerë të përfshirë.
R.28	P	Ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

2.8. Deklarimi ose paraqitja ndërkufitare (RV.IX)

2.8.1. Përshkrimi dhe analiza

515. Prej vitit 2004 Shërbimi Doganor i Kosovës ka bërë zbatimin e një sistemi për kontrollin ndërkufitar të kalimit të parave dhe të instrumenteve të transferueshme. Ky sistem tani është duke u zbatuar përmes ligjit LPP⁷¹, neni 29 – detyrimi për të deklaruar. Sistemi parasheh që secili person i cili hyn ose del nga Kosova dhe i cili bart mjete monetare në një vlerë që tejkalon shumën prej dhjetëmijë (10.000) euro apo më shumë duhet të paraqesë me shkrim shumën e mjeteve monetare dhe burimin e tyre në një formë e cila duhet të përcaktohet nga Doganat e Kosovës, para nëpunësit të autorizuar të doganës dhe nëse kjo kërkohet nga nëpunësi, ai duhet ti paraqesë këto mjete monetare. Detyrimi i njëjtë përfshinë edhe të dërguarit/pranuarit e mjeteve monetare përmes postës apo kuririt komercial.

516. Deklarimi konsiderohet të jetë i rremë nëse ai përmban informata të pasakta ose të paplota. Në rast se ndodhë kjo Dogana ka kompetenca për të konfiskuar dhe për të mbajtur mjetet monetare të cilat nuk janë deklaruar ose të cilat nuk janë deklaruar rrejshëm (neni 29, paragrafi 12, ligji LPP/LFT). Autoritetet doganore kanë po ashtu kompetenca për të marrë në pyetje dhe për të kontrolluar personat fizik dhe bagazhin e tyre (neni 29, paragrafi 11, ligji LPP/LFT). Kompetencat për të mbajtur paratë, si dhe për të marrë në pyetje dhe për të kontrolluar personat e tillë aplikohen njëjloj në qoftë se ekziston dyshimi i arsyeshëm se mjetet e tilla janë fryt i krimit, ose janë përdorur ose kanë pas për qëllim të përdoren për të

⁷¹ 03/L-196

kryer ose për të lehtësuar shpërlarjen e parave ose janë presupozuar për vepër penale nga e cila kanë buruar frytet e krimit ose janë të lidhura me financimin e terrorizmit.

517. Statistikat doganore mbajnë statistika për transportin ndërkufitar të parave dhe instrumenteve të transferueshme.

Tabela 13 : *Transporti ndërkufitar i parave dhe instrumenteve të transferueshme*

VITI	BIZNESE	PERSONA FIZIKË	TOTALI I NR. TË RASTEVE TË DEKLARIMEVE PËR VIT
2008	536	443	979
2009	608	360	968
2010	653	349	1002
2011	731	705	1436
2012 (Janar - gusht)	520	425	945

518. Autoritetet doganore nuk i kanë treguar ekipit vlerësues se si ata mirëmbajnë informatat e siguruar si rezultat i deklarimeve/deklarimeve të rrejshme/rastet e dyshimeve të PP/FT. Ndonëse informacioni i tillë është raportuar në NJIF, megjithatë regjimi i mbajtjes së të dhënave në kuadër të doganës nuk është i qartë. Doganat kanë raportuar se ekziston një sistem funksional që mban informacionet e marra si rezultat i deklaratave/deklaratave të rrejshme/rasteve të dyshuara të PP/FT. Këto informacione mbahen në formë elektronike në bazën e të dhënave të Doganës si dhe në dosje fizike, megjithatë, ekipi i vlerësimit nuk ka parë asnjë dokument rregullativ që do ta konfirmonte këtë.

519. Dogana e Kosovës ia përcjell NJIF-it të gjitha kopjet e deklaratave. Kjo bëhet një herë në muaj përmes një dërgese elektronike, e cila është e ngarkuar në bazën e të dhënave të NJIF-it. Dogana po ashtu lajmëron NJIF-in për të gjitha incidentet e dyshimta të PP/FT në formë të një RTD-je. Deri më tani, dogana i ka dërguar NJIF-it 3 RTD të tilla.

Tabela 14 : *Njoftimet ndërkufitare të parave të gatshme të bëra nga Dogana e Kosovës për NJIF-in*

Viti	Raste
2010	1 002 raste
2011	1 436 raste
2012	1 075 raste

520. Dogana e Kosovës bashkëpunon ngushtë me PK, NjIF, agjencitë për menaxhimin e integruar të kufirit dhe me EULEX-in. Organizohen ushtrime operationale të përbashkëta për të gjitha parregullsitë ndërkufitare dhe për të gjitha format e krimit të cilat përfshijnë korrierët e parave të gatshme. Ekziston një raport 6 mujor për zhvillimin e zonave të rrezikut në të cilat duhet fokusuar. Lista e operacioneve të përbashkëta është paraqitur në vazhdim.

- 2012 deri në shtator - janë organizuar 102 operacione të përbashkëta;
- 2011 - janë organizuar 115 operacione të përbashkëta;
- 2010 - janë organizuar 98 operacione të përbashkëta.

521. Këtu përfshihet disa operacione të veçanta me synim konfiskimin e parave të gatshme, dhe këto operacione kanë sjell rezultate. Në këtë drejtim *modus operandi* i përgjithshëm i doganës në aspektin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive mund të konsiderohet efektiv.

522. Dogana raporton për reagime/informata kthyesë të mira nga policia e Kosovës në fazën e hetimeve. Doganat e Kosovës kanë caktuar një pikë kontakti zyrtar në mes të Doganës dhe PK për lehtësimin e shkëmbimit të informacioneve dhe për përsheptimin e procesit të shkëmbimit të informacionit (inteligjencës), si dhe për koordinimin e veprimeve të përbashkëta në mes të dy agjencive. Po ashtu, edhe një zyrtar ndërlidhës është caktuar si pikë kontakti në mes të Doganës dhe Njësisë për hetime tatimore në kuadër të Administratës Tatimore, i cili ka si rol të përsheptojë procesin e shkëmbimit të informacioneve dhe koordinimin e veprimeve të përbashkëta.

523. Doganat e Kosovës kanë marrëveshje të nënshkruara të bashkëpunimit me Shqipërinë, Finlandën, Turqinë, Slloveninë, Maqedoninë, Malin e Zi, Francën, Hungarinë dhe Austrinë. Me shtetet fqinje, si Maqedonia dhe Shqipëria, dogana ka krijuar mekanizma të integruar të këmbimit të të dhënave. Dogana shfrytëzon objektet në kuadër të ILECU si një kanal i komunikimit me shërbimet doganore në grupin rajonal të ILECU (për më shumë informata për ILECU, shih pjesën 6.3 të këtij Raporti).

524. Në raste specifike, brenda kufizimeve të legjislacionit ekzistues, Doganat e Kosovës bashkëpunojnë me autoritetet përkatëse të shteteve të tjera (ku ekziston një marrëveshje bashkëpunimi) në lidhje me çfarëdo hetimi të kontrabandës së arit, metaleve dhe gurëve të çmuar, përfshirë ato në të cilat dyshohet për shpëlarje të parave. Deri tani, Doganat e Kosovës nuk kanë regjistruar ndonjë rast të këtij lloji të kontrabandimit që lidhet me shpëlarjen aktuale apo të dyshuar të parave.

525. Doganat e Kosovës kanë zbatuar standarde shërbimi për kthimin e informatave në rast të kërkesave ndërkombëtare për informata si në vazhdim:

- 10 ditë kur merren me dërgimin e informatave brenda afatit kohor normal
- 5 ditë kur merren me dërgimin e informatave me prioritet
- 1 ditë kur merren me dërgimin e informatave me prioritet më të lartë
- Brenda ditës kur merren me dërgimin e informatave urgjente

526. Këto afate kohore për kthimin e informatave, nga ekipi vlerësues konsiderohen në përgjithësi adekuate.

Sanksionet

527. Doganat e Kosovës kanë kompetenca për të hetuar veprat penale doganore dhe në këto raste duhet të konsiderohen se kanë kompetencat dhe përgjegjësinë e policisë ose policisë gjyqësore për këto hetime⁷².

528. Doganat e Kosovës mund t'u shqiptojnë sanksione personave të cilët bëjnë deklaram apo paraqitje të rrejshme. Këto sanksione/gjoha ndryshojnë prej referimit për hetim/ndjekje penale të një vepre penale, konfiskimit të tërë shumës së parave dhe deri tek një gjobë administrative në shumë prej 25% të vlerës. Pas konfiskimit, oficeri doganor i autorizuar do t'ia lëshojë personit në fjalë një vërtetim me shkrim në të cilin cekën faktet përkatëse dhe shuma e mjeteve monetare të konfiskuara dhe të mbajtura. Mjetet monetare të konfiskuara

⁷² Ligji për Doganat nr. 03-L-109, nenet 302 & 303.

duhet, ku ajo është e mundur, të ruhen në një llogari të veçantë pa kamatë në emër të BQK-së ose përndryshe të mbahen në kujdestari të sigurt në BQK derisa gjoba nuk paguhet plotësisht.

Tabela 15 : Konfiskimet nga Dogana e Kosovës në të cilat është shqiptuar gjoba

2010	3 raste të zbuluara ku paratë e gatshme të konfiskuara përbëjnë 43,870.00 euro (25% të parave të gatshme të padeklaruara).
2011	30 raste të zbuluara ku paratë e gatshme të konfiskuara përbëjnë 162,240.95 euro (25% të parave të gatshme të padeklaruara).
2012	13 raste të zbuluara ku paratë e gatshme të konfiskuara përbëjnë 94,058.16 euro (25% të parave të gatshme të padeklaruara).

529. Në rastet kur paratë janë konfiskuar, pas 10 ditëve prokurori mund të kërkoj ngrirjen, konfiskimin ose kthimin e tyre pronarit.

530. Doganat i kanë referuar prokurorit rastet në vazhdim:

- Gjatë vitit 2010, 49 kallëzime penale i janë përcjell prokurorit përkatës për dyshimin e shmangies nga tatimi në vlerë prej 4,233,034.57 €;
- Gjatë vitit, 36 kallëzime penale i janë dërguar prokurorit përkatës për dyshimin e shmangies nga tatimi në vlerë prej 7,071,221.97 €;
- Gjatë vitit, 37 kallëzime penale i janë përcjell prokurorit përkatës për dyshimin e shmangies nga tatimi në vlerë prej 23,482,723.21 €.

531. Në të shumë prej këtyre rasteve kishte dëshmi të pastrimit të parave. Nuk ka informata kthyesë në lidhje me rezultatet nga këto raste, nëse ka të tilla, për shkak të vonësive në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, kohën e fundit doganat kanë caktuar një zyrtar ndërlidhës i cili punon drejtpërdrejt me shërbimet prokuroriale duke përcjellë rastet e lidhura me doganën dhe duke u siguruar që ato të shqyrtohen më shpejt. Ekipi i vlerësimit nuk ka patur mundësi ta verifikojë rezultatin praktik dhe efikasitetin e kësaj marrëveshjeje, megjithatë Doganat kanë raportuar më pas se me caktimin e zyrtarit ndërlidhës ka patur progres në shkëmbimin e rezultateve dhe në përshpejtimin e rishikimit të disa rasteve të cilat konsiderohen të rëndësishme së lartë.

Mbrojtja e të dhënave në sistemet doganore

532. Doganat e Kosovës respektojnë procedurat për mbrojtjen e të dhënave personale, siç parashihen me Ligjin nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale. Sistemet që përdoren për transaksionet ndërkombëtare, të cilat përmbajnë të dhëna personale, kufizojnë qasjen vetëm për personat e veçantë të autorizuar nga Drejtoria e zbatimit të ligjit.

Struktura dhe burimet

533. Numri i personelit doganorë është gjithsej 584. Niveli i personelit për njësi të specializuara është si vijon: hetuesia - 15, inteligjenca - 18, anti-korrupsioni - 4. Doganat besojnë se struktura e tyre dhe financimi janë të përshtatshme për detyrat e tyre.

534. Ekziston një numër i caktuar i vendeve të lira. Me sa duket kjo mungesë është shkaktuar *ndër të tjera* për shkak të rreziqeve personale që lidhen me detyrat e uniformës. Kjo ndikon në efikasitetin dhe funksionimin e Doganave. Doganat e kanë njoftuar ekipin e vlerësimit se janë në proces të rekrutimit të stafit të përshtatshëm për Drejtorinë e zbatimit të

ligjit⁷³, më konkretisht, është shpallur vendi i punës në fund të vitit 2012, janë kryer procedurat e testimit dhe intervistimit dhe pritet që zyrtarët e zgjedhur t'i mbushin plotësojnë postet e zbrazëta.

535. Nuk ka ndonjë shqyrtim të efikasitetit ndonëse njësia e auditimit të brendshëm i raporton Auditorit të përgjithshëm të Kosovës për shpenzimet e departamentit. Nga doganat kërkohet të mbajnë standardet më të larta të profesionalizmit, duke përfshirë standardet në lidhje me fshehtësinë, integritetin, ndershmërinë, si dhe me shkathtësitë e duhura. Është e qartë se ka pasur raste të korrupsionit në Doganat e Kosovës, megjithatë nuk ka pasur aktakuza. Masat e ndërmarra kryesisht kanë qenë suspendimi dhe sanksione të tjera disiplinore. Në vitin 2003 ata kanë krijuar Njësinë e standardeve profesionale dhe gjatë vitit 2009 kanë shtuar edhe Njësinë e inspektimit të brendshëm, e cila në kuadër të Departamentit merret me aktivitetet kundër korrupsionit⁷⁴.

536. Njësia e trajnimit e Doganës ka identifikuar nevojën e trajnimit të personelit të përfshirë në luftimin e krimit të organizuar. Gjatë vitit 2012 janë ofruar trajnimet e specializuara në vazhdim: OTA ShBA-pastrimi i parave e bazuar në tregti/operacionet sekrete/analizë e avancuar e pastrimit të parave/teknika të avancuara të analizës financiare; Prezantimi i EULEX-it kundër pastrimit të parave/konfiskimi i pasurisë; ambasada e Francës-rekrutimi dhe menaxhimi i informatorit; kontrolli EXBS i vendeve të fshehta në mjetet e transportit.

2.8.2. Rekomandime dhe komente

537. Në përgjithësi, ekipi vlerësues konstatoi se kompetencat dhe funksionimi praktik i autoritetit doganor është në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, megjithatë disa faktorë që lidhen për personelin ende paraqesin shqetësim për ekipin vlerësues, posaçërisht shtrirja dhe fushëveprimi i operacioneve të Doganave të Kosovës.

538. Roli i autoritetit doganor në Kosovë është posaçërisht i rëndësishëm duke marrë parasysh pasojat më të gjera rajonale nga trafikimi i drogës dhe armëve dhe nga krimi i organizuar⁷⁵, i cili ka origjinën/kalon transit nga/përmes Kosovës. Në këtë drejtim, duhet ti kushtohet rëndësi përforcimit të mëtejshëm të doganës përmes ndarjes së burimeve shtesë për të motivuar dhe për të lehtësuar plotësimin e vendeve të lira, si dhe për të përforcuar integritetin e personelit.

539. Duhet të bëhet një vlerësim periodik i jashtëm, i përshtatshëm për qëllimin, në lidhje me Doganat e Kosovës me qëllim të vlerësimit të funksionit, strukturës, efikasitetit dhe vlerës për para. Rezultatet duhet të bëhen publike.

2.8.3. Klasifikimi për Rekomandimin e veçantë IX

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
RV.IX	KP	<ul style="list-style-type: none"> Në doganë nuk ka rregulla të mbajtjes së shënimeve në lidhje me informatat mbi deklaratimet/deklarimet e rrejshme dhe dyshimet për PP/FT;

⁷³ Në Qershor 2013, Doganat e informuan ekipin e vlerësimit se të gjitha vendet e lira në Drejtorinë për zbatimin e ligjit janë plotësuar, megjithatë mbeten afërsisht 25 pozita të lira në sektorë të tjerë të Doganave.

⁷⁴ Në Qershor 2013, Doganat e informuan ekipin e vlerësimit se një Kod i etikës i ri i brendshëm është miratuar në Dogana.

⁷⁵ Shih EUROPOL Vlerësimi i kërcënimit nga krimi i organizuar, 2011.

		<ul style="list-style-type: none">• Prokurori nuk ofron informata kthyese të strukturuar për rastet e referuara nga dogana;• Mungesa e personelit ndikon në efikasitetin e doganës.
--	--	--

3. MASAT PARANDALUESE - INSTITUCIONET FINANCIARE

Korniza ligjore

- Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (Ligji nr. 03/L-196 i datës 30/09/2010), më tej Ligji LPP/LFT
- Ligji për Bankën Qendrore të Kosovës (ligji nr. 03/L-209 i datës 22 korrik 2010), më tej Ligji për BQK-në;
- Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (Ligji nr. 04/L-093 i datës 12 prill 2012), më tej Ligji për bankat;
- Ligji për fondet pensionale të Kosovës (Ligji nr. 04/L-101 i datës 6 prill 2012), më tej Ligji për fondet pensionale;
- Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit e të ndërmjetësuesve të sigurimit – më tej Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25⁷⁶.
- Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK) – letër këshilluese 2007-1 e muajit maj 2007 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- BQK (BQK) – Rregulla X për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit⁷⁷;
- Qendra e Inteligjencës Financiare (QIF) - Direktivat administrative

Shtrirja e mbulimit të masave parandaluese të LPP/LFT⁷⁸

540. Sipas nenit 16 të Ligjit LPP/LFT, bankat dhe institucionet financiare të cilat ofrojnë aktivitete financiare, siç definohet në Ligjin LPP/LFT u nënshtrohen dispozitave dhe detyrimeve sipas Ligjit LPP/LFT.

541. Ligji LPP/LFT e përcakton “bankën” në pajtim me përkufizimin për bankat të ligjit për BQK-në. Ky i fundit e përkufizon bankën si “një subjekt i përcaktuar me ligjin bankar”. Ligji për bankat përkufizon bankat si “një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur ose dege të bankës së huaj”. Ligji për bankat më tutje përkufizon “veprimtarinë bankare” si “veprimtaria e pranimi të depozitave nga publiku dhe përdorimin e fondeve qoftë tërësisht apo pjesërisht me qëllim të dhënies së kredive apo investimeve në rrezik të vetë bankës”.

542. Në pajtim me nenin 44 të ligjit për bankat, bankat në licencat e tyre mund të autorizohen që të angazhohen në aktivitetet financiare vijuese:

- pranimin e depozitave (në formën e llogarisë rrjedhëse, depozitave me afat ose në forma të tjera depozite) me ose pa interes në një valutë të këmbëshme;
- blerjen dhe shitjen për llogari të vetë bankës, të letrave me vlerë të lëshuara ose të garantuara nga qeveria ose Banka Qendrore e Kosovës apo Bashkimi Evropian të

⁷⁶ Projektligji i cili mbulon sektorin e sigurimit është në proces.

⁷⁷ BQK-ja ka informuar se versioni i korrigjuar i rregullës X është përgatitur dhe do të lëshohet nëse dhe kur BQK-ja do të caktohet si një autoritet mbikëqyrës për qëllime të Ligjit LPP/LFT. Kopja e projektversionit të korrigjuar është siguruar mirëpo fushëveprimi i këtij Raporti nuk është që të ndërmerret një vlerësim i projektversionit të korrigjuar.

⁷⁸ Për më shumë informata mbi sektorin financiar, ju lutemi t'i referoheni pjesës 1.3 të këtij Raporti.

denominuara dhe të pagueshme në valutën euro të depozitave të bankës dhe me afat maturimi që nuk tejkalon një vit;

- ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe arkëtimeve;
- emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesave (duke përfshirë kartat e pagesave, çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankës);
- blerjen dhe shitjen e valutës së huaj në kesh për llogari të klientit;
- ofrimin e shërbimit të ruajtjes së letrave me vlerë dhe sendeve të tjera të çmueshme; dhe
- dhënien e kredive, duke përfshirë kreditë konsumuese dhe hipotekare; blerjen dhe shitjen me ose pa të drejtë tërheqjeje të parave dhe financimin e transaksioneve tregtare; dhe blerjen dhe shitjen e mjeteve të kredive nga një bankë tjetër a institucion financiar;
- marrjen hua të fondeve dhe blerjen e shitjen për llogari të bankës ose për llogari të klientëve (përveç nënshkrimit) të instrumenteve të tregut të parasë (duke përfshirë kartëmonedhat, kambialet dhe certifikatat e depozitave); blerjen e letrave me vlerë; kontratat e të ardhmes a opsionale lidhur me letrat me vlerë ose përqindjen e interesit, apo instrumentet e përqindjes së interesit;
- të veprojnë si ndërmjetës në mes të huamarrësve dhe huadhënësve (komisionimin e parave);
- lizingun financiar;
- ofrimin e shërbimeve për informacione rreth kredive;
- ofrimin e shërbimeve të agjentit ose këshilltarit financiar (pa përfshirë shërbimet e përcaktuara në nene...);
- operimin me ari apo një ose me më shumë valuta në vend të valutës në të cilën është denominuar bilanci i bankës, duke përfshirë këtu kontratat ardhshme për blerje dhe shitje të valutave të huaja;
- ofrimin e shërbimeve trust, duke përfshirë investimin dhe administrimin e fondeve të pranuar në trust dhe administrimin e letrave me vlerë;
- ofrimin e shërbimeve si menaxher i portofolit të investimit ose këshilltar për investime;
- nënshkrimin dhe shpërndarjen e borxhit dhe pjesëmarrjes me letra me vlerë me çmim fiks dhe operacionet me këto letra me vlerë;
- financimin islamik ose veprimtarinë bankare islamike, me pëlqim të BQK-së dhe sipas këtyre kushteve dhe në pajtueshmëri me rregulloret që mund të përcaktohen nga BQK-ja;
- ndonjë aktivitet tjetër që mund të përcaktohet me rregullore nga BQK-ja që ka të bëjë me aktivitetin financiar e që nuk bie ndesh me dispozitat e këtij ligji.

543. Përkufizimi i “bankës” është në përputhje me përkufizimin evropian të institucioneve të tilla në direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian.

544. Ligji LPP/LFT përkufizon “institucionet financiare” si person ose subjekt që drejton një ose më shumë aktivitete për ose në emër të një klienti duke përfshirë aktivitetet si më poshtë:

- huadhënien, duke përfshirë por pa u kufizuar në kredinë për konsumatorë; kredinë për hipotekë; faktorizimin (biznesi i blerjes së çeqeve, obligacioneve etj.) me ose pa të drejtë tërheqjeje; dhe financimin e transaksioneve komerciale duke përfshirë edhe humbjen;

- qiradhënien financiare, përveç marrëveshjeve për qiradhënie financiare që kanë lidhje me produktet për konsum;
- dërgimin e parasë ose të instrumenteve monetare në çdo mënyrë, duke përfshirë edhe sistemin e dërgimit të parave në mënyrë jozyrtare ose me anë të rrjetit të personave a subjekteve të cilët mundësojnë dërgimin e parave jashtë sistemit tradicional të institucioneve financiare;
- këmbimin e parave dhe monedhave;
- lëshimin dhe menaxhimin e mënyrave të pagesës, duke përfshirë, por jo të kufizuar në kartelat debitore dhe kreditore, çeket, çeket e udhëtarëve, urdhërpagesat, çeket e bankierëve ose paratë elektronike;
- dhënien e garancive financiare dhe zotimeve;
- tregtimin në emër të personave ose subjekteve të tjera në një ose më shumë nga sa vijon:
 - instrumentet e tregut të parasë, çeket, bankënotat, certifikatat e depozitave, produktet e prejardhura (që vijnë nga një veprimtari tjetër etj.);
 - këmbimin e valutës së jashtme;
 - këmbimin, shkallën e interesit dhe instrumentet e indeksit;
 - letrat me vlerë të transferueshme; dhe
 - tregtimin e mallrave me transaksione të afatizuara;
- menaxhimin e portofolit individual dhe kolektiv;
- pjesëmarrjen në emetimin e letrave me vlerë dhe sigurimin e shërbimeve financiare lidhur me këto emetime;
- ruajtjen dhe administrimin e parave të gatshme ose letrave me vlerë likuide në emër të personave të tjerë;
- në të kundërt, investimin, administrimin ose menaxhimin e fondeve apo parave në emër të personave ose subjekteve të tjera;
- të vepruarit si kompani e sigurimeve, sigurimeve të jetës ose si ndërmjetës i sigurimeve të jetës, siç është përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 të datës 5 tetor 2001, për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive e ndërmjetësve të sigurimit; dhe
- të vepruarit si garantues siç është përkufizuar në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/35 të datës 22 dhjetor 2001, mbi pensionet në Kosovë.

545. Ligji për BQK-në më tutje përkufizon “institucionet financiare” si “subjekte si banka, zyra të këmbimit valutor, kompani të sigurimeve, fonde pensionale, si dhe subjekte të tjera që ushtrojnë aktivitete financiare, siç përcaktohet në ligjet relevante për qëllimet e këtij Ligji, për të cilat Bankës Qendrore i është dhënë autoritet mbikëqyrës me ligj”

546. Ligji për bankat nuk e përcakton një “institucion financiar” përveç në atë masë që termi përfshinë bankat, institucionet financiare dhe institucionet financiare jobankare, mirëpo ofron përkufizimin se çfarë përbënë një “institucion financiar jobankar” si “person juridik që nuk është as bankë e as institucion mikrofinanciar, që është licencuar nga BQK-ja sipas këtij ligji, për t’u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënien e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënie financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare, siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktoringun, ose garancitë a shërbimet e tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operationale, si dhe shërbimet e tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja”.

547. Është me rëndësi të theksohet se përkufizimet e “institucionit financiar” që parasheh Ligji LPP/LFT dhe Ligji për bankat përfshijnë edhe sektorin e sigurimeve.

548. Edhe pse ka ngjashmëri shumë të mëdha të aktiviteteve financiare që mund të ndërmerren nga institucionet financiare ose institucionet financiare jobankare, siç përcaktohet në Ligjin LPP/LFT, Ligjin për bankat dhe në Ligjin për BQK-në, duke marrë parasysh aktivitetet financiare të lejuara në bazë të nenit 94 të ligjit për bankar, mbetet disa dallime ndërmjet këtyre përkufizimeve, të cilat mund të ndikojnë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare siç pasqyrohet në legjislacionin vendor për licencimin apo regjistrimin e të gjitha llojeve të institucioneve financiare, duke përfshirë zbatimin e detyrimeve sipas Ligjit LPP/LFT.

549. Për më tepër, Ligji për bankat parasheh gjithashtu edhe përkufizimin për “institucionin mikrofinanciar”, i cili është “person juridik i organizuar ose si OJQ sipas Ligjit për OJQ-të ose si shoqëri aksionare sipas Ligjit për shoqëritë tregtare, aktiviteti primar i të cilit është dhënia e kredive dhe ofrimi i një numri të kufizuar të shërbimeve financiare për mikro dhe subjektet e vogla juridike, ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe personat me të hyra të ulëta”.

550. Ndonëse nuk ka përkufizime të tjera për institucionet mikrofinanciare në Ligjin për BQK-në dhe në Ligjin LPP/LFT, është e qartë nga aktivitetet financiare të lejuara, siç përcaktohet në nenin 93 të Ligjit për bankat, se institucionet financiare mund të gjenden nën përkufizimet e “institucioneve financiare/jobankare” të dhëna më lart dhe për këtë arsye janë subjekt i detyrimeve të Ligjit LPP/LFT.

3.1. Rreziku nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit⁷⁹

551. Kosova nuk ka ndërmarrë një vlerësim të rrezikut kombëtar të dobësive të saj dhe të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

552. BQK-ja nuk ka ndërmarrë një vlerësim brenda sektorit financiar të rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Gjithashtu nuk ka kërkuar nga bankat dhe institucionet financiare që të ndërmarrin një vlerësim të rrezikut të aktiviteteve, të produkteve dhe shërbimeve të tyre për të identifikuar dobësitë e tyre ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe për t'i zhvilluar sistemet e tyre të brendshme ashtu si duhet.

553. Pavarësisht kësaj, në shtator të vitit 2012, qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë dhe Planin e veprimit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Strategjia përfshinë objektivat specifike në përpjekjet kombëtare për të rritur nivelin e luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Objektivat kryesore të strategjisë janë:

- Arritja dhe mbajtja e përputhshmërisë administrative dhe ligjore me standardet ndërkombëtare;
- Ndërtimi dhe ruajtja e kapaciteteve të organeve për zbatimin e ligjit në përbushjen e detyrave të tyre dhe
- Përfshirja e praktikave të menaxhimit të përqendruara në parandalimin dhe ndjekjen penale të veprave të lidhura me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit

⁷⁹ Për më shumë informata për rrezikun nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, ju lutemi referohuni pjesës 1.6 të këtij Raporti.

554. Nga ana tjetër, këto objektiva të përgjithshme strategjike përmbajnë objektiva specifike të cilat përbëjnë aktivitete të veçanta për zhvillimin e një sistemi efektiv dhe efikas të luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

555. BQK-ja ka informuar se në vitin 2009 ka themeluar një grup punues për të zhvilluar një metodologji për qasje të mbikëqyrjes të bazuar në rrezike dhe përfundimisht ka prezantuar metodologjinë CAMEL (kapital, pasuri, menaxhment, fitim dhe likuiditet/*Capital, Assets, Management, Earnings and Liquidity*). Megjithatë, metodologjia CAMEL⁸⁰ aplikohet në nivel ndërkombëtar për qëllime të maturisë meqë ajo nuk është e dizajnuar për të identifikuar çështjet lidhur me shpëlarjen e parave ose financimin e terrorizmit. Prandaj, duket se, qasja mbikëqyrëse e bazuar në rrezik për qëllime të ekzaminimit të përputhshmërisë së masave parandaluese të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nuk është aplikuar në sektorin financiar.

556. Rrjedhimisht, siç është paraqitur në pjesën 1.3 të këtij Raporti, Kosova nuk ka përjashtuar asnjë aktivitet financiar nga detyrimet e parapara në Ligjin LPP/LFT.

3.2. Kujdesi i duhur ndaj klientit (*Customer Due Diligence*) (R.5^{(*) 81})

3.2.1. Përshkrimi dhe analiza

557. Rekomandimi 5 i FATF kërkon që masat e KDK-së, siç përcaktohen në Rekomandim, të aplikohen në rrethana të veçanta, ashtu siç parashihet me Ligj. Në Rekomandim gjithashtu kërkohet që aty ku KDK nuk mund të kompletohet në mënyrë të kënaqshme, atëherë aktiviteti nuk duhet të ndërmerret, llogaritë duhet të mbyllen dhe mundësisht një RTD duhet të dorëzohet tek autoritetet përkatëse.

558. Neni 17(1) i ligjit LPP/LFT⁸² përcakton që masat KDK të aplikohen në pajtim me përkufizimin e Rekomandimit 40 FATF. Në këtë mënyrë, masat KDK përfshijnë:

- Identifikimin e klientit dhe verifikimi i identitetit të tij;
- Identifikimin, aty ku është e zbatueshme, të mbajtësit të së drejtës së pronës dhe vërtetimin e identitetit përmes masave adekuate të rrezikshmërisë;
- Të kuptuarit e qëllimit dhe të natyrës së marrëdhënies afariste dhe
- Kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies dhe të transaksioneve.

559. Pavarësisht këtij përkufizimi, Ligji LPP/LFT nuk i referohet më tutje KDK-së. Në pajtim me dispozitat e nenit 17(2), nuk është i obligueshëm për subjektet raportuese aplikimi i masave të plota të KDK-së, por vetëm aplikimi i masave të identifikimit dhe të verifikimit të klientëve (duke mos përfshirë mbajtësin e së drejtës së pronës). Në të vërtetë, me nenin 21, Ligji LPP/LFT krijon një dallim midis “kujdesit të shtuar ndaj klientit” dhe “masave të identifikimit”, edhe pse kjo e fundit është komponentë e asaj/të kaluarës. Në të vërtetë, neni 21(3) i Ligjit LPP/LFT konstaton *Kërkesat për identifikim dhe kujdes të duhur ndaj klientit konsiderohen të përmbushura edhe pa prezencën fizike të klientit, në rastet e mëposhtme:*

⁸⁰ E cila tani përfshin një “S” në fund për “ndjeshmërinë e tregut/market Sensitivity”, duke u bërë kështu ‘CAMELS’.

⁸¹ Në pajtim me metodologjinë e standardeve FATF, një yll (*) në Rekomandim ose Kriter thelbësor nënkupton se Rekomandimi ose Kriteri thelbësor duhet të mbulohet me ligj ose rregullore.

⁸² Projektligji për ndryshimin e Ligjit LPP/LFT e zëvendëson përkufizimin e tanishëm për kujdesin e shtuar ndaj klientit i cili është në përputhje me përkufizimin e FATF-së.

560. Duhet të theksohet se neni 23 i Ligjit LPP/LFT mbulon detyrimet e bankave dhe institucioneve financiare në mirëmbajtjen e programeve të brendshme adekuate. Detyrimet e vendosura me nenin 23(2) rreth shqyrtimit të mbulimit të programit të brendshëm nuk mbulojnë kërkesat për vendosjen e procedurave për banka dhe institucione financiare për të ndërmarr masat KDK, por vetëm për të ndërmarr ato të komponenti të parë që është identifikimi i klientit (pa ju referuar procesit të verifikimit) dhe duke përjashtuar të gjithë komponentët tjerë të masave KDK, ashtu siç parashihet me vet Ligjin nën nenin 17(1).

561. Neni 6 i Rregullës X të BQK-së parasheh një version pak më të ndryshëm të masave të KDK-së, mirëpo në esencë, ajo mbulon atë që është paraparë me Ligjin LPP/LFT sipas nenit 17(1). Rregulli kërkon që bankat dhe institucionet financiare të bëjnë zbatimin e plotë të KDK-së, ashtu siç përcaktohet në këtë rregull. Detyrimi sipas Rregullës X për aplikimin e plotë të masave KDK, edhe pse është në kundërshtim me kërkesat e Ligjit dhe për këtë arsye është e diskutueshme se deri në çfarë mase dispozitat e rregullës X mbivëhen me ato të Ligjit LPP/LFT, është në pajtim me kërkesat sipas standardeve ndërkombëtare.

562. Duhet të theksohet se Rregulla X e BQK-së bazohet në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/21 mbi bankat, licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e cila është shfuqizuar me ardhjen në fuqi të Ligjit për bankat përmes nenit 117 në të cilin theksohet se *Rregullorja e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/21 e datës 15 nëntor 1999, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/28 e datës 28 maj 2008, dhe çdo ndryshim i tyre zëvendësohen me hyrjen në fuqi të këtij Ligji. Çdo rregull e nxjerrë sipas këtyre rregulloreve vazhdon të jetë në fuqi deri në masën që ajo nuk është në kundërshtim me këtë Ligj apo deri në ndryshimin ose shfuqizimin e saj nga BQK-ja.*

563. Për më tepër Rregulla X e BQK-së edhe më tutje i referohet Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 e cila është zëvendësuar plotësisht me hyrjen në fuqi të Ligjit LPP/LFT përmes nenit 39, i cili thekson se *Ky ligj e shfuqizon dhe e zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 për pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale.*

564. E mësipërmja po ashtu zbatohet ndaj Letrës këshilluese 2007/1, të majit 2007 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit të BQK-së, i cili po ashtu bazohet dhe ofron lidhje dhe referenca tek Rregulloret e UNMIK-ut të cekura më lart që janë shfuqizuar.

565. Rrjedhimisht, vlefshmëria e Letrës këshilluese dhe Rregullës X të BQK-së si “rregullore” për qëllimet metodologjike të FATF është e dyshimtë⁸³.

566. Paragrafët pasues përmes të cilëve analizohet zbatimi i masave KDK sipas Ligjit LPP/LFT do të adresojnë vetëm një komponentë të konceptit KDK, qofshin ato masat identifikuese ose verifikuese të sapocekura, mirëpo përshtatshmërisht do të sigurojnë komente dhe rekomandime.

567. Çdo reference tek dispozitat e Rregullës X dhe Letrës këshilluese 2007/1 të BQK-së janë mbajtur për hir të vazhdimësisë me praktikën e tanishme, mirëpo referencat e tilla, në veçanti kur kërkesat sipas një standardi të caktuar pritet të gjenden në ligj ose rregullore, janë duke mos paragjykuar, dhe duhet lexohen dhe interpretohen përbrenda, si dhe konteksti i brengave të shprehura sa i përket vlefshmërisë së dy dokumenteve.

568. Mosreferimi i plotë tek masat e KDK-së në dispozitat përkatëse të LPP/LFT ka ndikim të rëndësishëm në tërë obligimit për masat KDK sipas standardeve ndërkombëtare,

⁸³ BQK ka informuar se është në proces të rishikimit dhe azhurnimit të Rregullit X dhe Letrës këshilluese 2007/1 pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Ligjin LPP/LFT.

duke përfshirë edhe identifikimin e pronarit përfitues. Edhe pse varet nga interpretimi, kjo mund të zbutet lehtë përmes dispozitave të nenit 18 të LPP/LFT e cila megjithatë, në një masë i referohet përfituesit, që është më shumë me referencën për përfituesin e transaksionit. Megjithatë, kërkesa për procesin verifikues sipas nenit 18 jo detyrimisht zbatohet në përputhje me afatin e duhur sipas nenit 17 (2) ngase në të theksohen rrethana të tjera.

569. Dallimet në mes të Ligjit LPP/LFT dhe Rregullës X të BQK-së me referencë në aplikimin e masave KDK (Rregulli X reflekton standarde ndërkombëtare) nuk shfaqet vetëm në letër, por po ashtu janë duke ndikuar në efektivitetin e zbatimit të obligimeve në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Kjo gjë është konfirmuar edhe nga një pjesë e sektorit gjatë vizitës tonë në terren, edhe pse ata në praktikë pretendojnë se i aplikojnë plotësisht masat e KDK-së ngase janë në dijeni të kërkesave ndërkombëtare, në veçanti kur pjesëtarët e këtij sektori janë pjesë e një grupi bankar ndërkombëtar më të madh.

570. Megjithatë, këshillohet që kjo anomali në Ligjin LPP/LFT të adresohet menjëherë, duke siguruar që subjektet raportuese sipas nenit 16 të Ligjit të jenë të obliguara që t'i zbatojnë masat e plota të KDK-së sipas nenit 17 (2), ashtu siç parashihet në paragrafin (1) të nenit 17 dhe në pajtim me obligimet nën Rregullin X.

571. Po ashtu, me urgjencë duhet të rishikohen që të dyja, qoftë përmbajtja ashtu edhe ligjshmëria e Rregullës X të BQK-së, që pasojë pas shfuqizimit të rregulloreve mbështesë të UNMIK-ut, si dhe hyrja në fuqi e Ligjit për Bankat dhe Ligjit LPP/LFT. Kjo do të i largonte me tutje anomali të dhe do ofronte qartësi ligjore më të madhe si për sektorin, ashtu edhe për vetë autoritetet. Kjo i referohet Letrës këshilluese 2007/1 të BQK-së⁸⁴.

Llogaritë anonime- Kriteri thelbësor 5.1

572. Neni 18 (1) e Ligjit LPSH/FT në mënyrë specifike ua ndalon bankave dhe institucioneve financiare që të mbajnë llogari anonime. Në të vërtetë neni 18 (2) kërkon që bankat dhe institucionet financiare ta verifikojnë identitetin e klientit të fituar në përputhje me nenin 17 (2) *para hapjes së llogarisë*.

573. Në Rregullën X dhe Letrën këshilluese 2007/1 të BQK-së nuk ka ndonjë reference ndaj llogarive anonime.

574. BQK-ja ka konfirmuar se bankat në Kosovë kurrë nuk kanë mbajtur llogari anonime ngase kjo gjithmonë ka qenë e ndaluar me ligj⁸⁵. Rregullorja e UNMIK-ut për pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, duke qenë pararendëse e Ligjit LPP/LFT nuk ka pas ndonjë referim që i ndalonte llogaritë anonime, mirëpo parashihte verifikimin e emrit dhe adresës si dhe të datës së lindjes (për personin fizik) para se të hapesh llogaria.

575. Në të vërtetë, neni 15.2 i Rregullës X të BQK-së, parasheh që *për të gjithë marrëdhëniet ekzistuese me konsumatorë, duke filluar nga dita kur Rregulla hyn në fuqi, atëherë bankat dhe institucionet financiare do të aplikojnë kujdes të duhur ndaj konsumatorëve, siç është dhënë në paragrafin 6 nga data 30 Prill, 2007*. Supozohet se edhe nëse bankat mbajnë llogari anonime, ato duhet të shndërrohen në llogari emërore përshtatshëmrisht. BQK-ja ka konfirmuar se kjo ka ndodhur.

⁸⁴ BQK ka informuar se është në proces të rishikimit dhe azhurnimit të Rregullës X dhe Letrës këshilluese 2007/1 pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Ligjin LPP/LFT.

⁸⁵ Draftligji me ndryshime u referohet llogarive anonime në të kaluarën. Në të vërtetë neni 18 i Ligjit LPP/LFT po ndryshohet që të reflektojë ndaj llogarive anonime të tanishme.

576. Megjithatë, Ligji LPP/LFT nuk ua ndalon bankave dhe institucioneve financiare që të mbajnë llogari në emra të rrejshëm. Përderisa kjo mund të jetë në përputhje me Direktivën e tretë⁸⁶ të Bashkimit Evropian për LPP, mbajtja e llogarive të tilla sipas standardeve të FATF-së nuk lejohet. Llogaritë me emra të *rrejshëm* mund të jenë llogari që janë emëruar mirëpo që ai emër që paraqitet në llogari është i rrejshëm, edhe pse banka ose institucioni financiar mund të ketë zbatuar dhe mbajtur plotësisht të dhëna për KDK-në e plotë - mirëpo ato llogari nuk mund të identifikohen lehtësisht prej llogarive që janë emëruar në mënyrë normale. Pronarët përfitues të llogarive në emër të rrejshëm normalisht do të ishin të njohur për zyrtarin e caktuar të atij institucioni⁸⁷.

577. Edhe pse sipas informacioneve në dispozicion nuk duket se në Kosovë ekzistojnë ose mund të hapen llogari të rrejshme për shkak të masave të rrepta të identifikimit të vendosura për hapjen e llogarive në përgjithësi, megjithatë Ligji nuk e ndalon *mbajtjen* e tyre. BQK ka konfirmuar se nuk ekzistojnë llogari të tilla në bankat në Kosovë.

578. Ndaj për të hapur dhe mirëmbajtur llogari anonime në mënyrë të duhur është mbuluar me Ligjin e LPP/LFT. Në praktikë nuk mund të konstatohet nëse bankat dhe institucionet financiare mirëmbajnë ose nuk mirëmbajnë llogari anonime prej kohëve të mëparshme, edhe pse siç është thënë, BQK ka konfirmuar se si rezultat i ekzaminimeve në terren bankat dhe institucionet financiare nuk mbajnë llogari të tilla⁸⁸.

579. Megjithatë, mungesa e ndalimit të mbajtjes së llogarive në emra të rrejshëm, si dhe mungesa e udhëzimit për llogari të tilla, do të mund të shpinte në keqpërdorim të sistemit dhe për këtë do të përbente cenueshmeri për bankat dhe institucionet financiare.

580. Prandaj, rekomandohet shumë që neni 18 (1) i Ligjit LPP/LFT të ndryshohet në atë mënyrë që të ndaloj hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive në emra të rrejshëm, duke shtuar fjalën “ si dhe llogaritë në emra të rrejshëm” në fund të paragrafit - ju lutem referojuni po ashtu edhe Direktivës së tretë të LPP-së, neni 6 më poshtë.

Kur kërkohet kujdesi i duhur për klientin – Kriteri thelbësor 5.2*

581. KTh 5.2 i Standardeve FATF parasheh që institucionet financiare të marrin masat e plota të KDK-së në pesë raste specifike:

- a) Themelimi i marrëdhënieve biznesore;
- b) Kryerja e transaksioneve të rastit përtej pragut të caktuar të aplikuar (15,000 USD/€)
- c) Kryerja e transaksioneve të rastit që janë transferime elektronike në rrethanat që mbulojnë nga Shënimi interpretues i RV VII;
- d) Ekziston dyshimi për pastrim të parave ose financim të terrorizmit, pavarësisht nga përjashtimi ose pragu ose
- e) Institucioni financiar dyshon për vërtetësinë apo saktësinë e të dhënave identifikuese të klientit të pranuar më parë.

⁸⁶ Direktiva 2005/60/EC e Parlamentit Evropian si dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2005 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit - GZ L 309, 25.11.2005, faqe 15- 36.

⁸⁷ Llogaritë në emra të rrejshëm do të mund të ishin të ngjashëm me llogaritë numerike mirëpo që kanë emër rrejshëm kundrejt një numri të paracaktuar. Megjithatë, llogaritë numerike identifikohen lehtë si dhe janë të lejuar si me standardet e BE-së , ashtu edhe me TFVT me kusht që masat e plota për kujdesin e duhur ndaj klientit të janë zbatuar përshtatshëm. Llogaritë numerike kryesisht përdoren në sektorin bankar privat dhe duhet t'i nënshtrohen monitorimit të shtuar si nga institucioni përkatës, ashtu edhe nga autoriteti mbikëqyrës.

⁸⁸ Ndryshimet e propozuara në nenin 18 të Ligjit LPP/LFT ngrisin dyshime për mosekzistencën e llogarive anonime.

582. Neni 17 (2) i Ligjit LPP/LFT kërkon prej subjekteve raportuese që të identifikojnë klientët e vet dhe ta verifikojnë identitetin e tyre në tri raste specifike, ku një rast përmban tri elemente:

2.1. krijojnë marrëdhënie afariste;

2.2. kryejnë transaksione të rastit kur klienti dëshiron të kryejë:

2.2.1. një transaksion në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) euro ose më shumë, qoftë i kryer si një transaksion i vetëm ose në disa transaksione që kanë lidhje me njëra tjetrën. Nëse shuma e transaksionit nuk dihet në kohën kur kryhet veprimi, identifikimi i saj duhet të bëhet posa të bëhet e ditur shuma apo të arrihet pragu;

2.2.2. transfer bankar vendor ose ndërkombëtar i fondeve;

2.2.3. ekzistojnë dyshime rreth saktësisë dhe mjaftueshmërisë së të dhënave identifikuese të marra të klientit;

2.3. ka dyshim për pastrim të parave ose financim të terrorizmit.

583. Edhe pse ka ngjashmëri në mes të kërkesave sipas standardeve FATF dhe Ligjit LPP/LFT, megjithatë ka dallime serioze të cilat ndikojnë si në përmbajtjen ndaj obligimeve, ashtu edhe në efektivitet.

584. Ashtu siç u theksua më lart në nenin 3.2 të këtij Raporti, përderisa Standardi i TFVT-së shërben për të KDK të plotë në rastet specifike, Ligji i LPP/LFT kërkon vetëm kryerjen e identifikimit të klientit si dhe verifikimit e identitetit.

585. Një krahasim i afërt i të dy kërkesave vë në dukje mospërputhjet si në vijim:

- (i) Edhe pse standardi TFVT i referohet rrethanave gjatë kryerjes së transaksioneve të rastit që janë transaksione elektronike në rrethanat e mbuluara sipas Shënimit interpretativ të RV VII, ku krijohet pragu prej 1,000 €, Ligjit LPP/LFT (neni 17 (2.2.2)) nuk e krijon prapun dhe mu për këtë mund të i nënshtrohet interpretimeve-qofshin se masat identifikuese duhet të zbatohen për secilin transaksion që është transfer elektronik pa ndonjë prag ose që pragu të jetë i vendosur në 10,000 € sipas pikës 2.2.1. Në të vërtetë afati kohor për verifikim ashtu siç përcaktohet në paragrafin (2) të nenit 18 duket se është përcaktuar për një transaksion të rastit, i cili do të mund të ishte transaksion elektronik, sipas pikës 2.5 të paragrafit të lartcekur (2).
- (ii) Edhe pse paragrafi (2.2.3) i nenit 17 të Ligjit LPP/LFT mbulon situatat kur paraqiten dyshime për vërtetësinë ose saktësinë e të dhënave identifikuese të klientit të siguruara më parë, ngjashëm me pikën (e) në Standardin e FATF, edhe pse kur standardi i FATF zbatohet në të gjitha rrethanat, obligimi sipas Ligjit LPP/LFT zbatohet vetëm kur klienti kryen transaksionin e rastit.

Vlen të cekët se në këtë rrethanë Ligji LPP/LFT nuk e përkufizon “transaksionin e rastit”. Megjithatë, përkufizimi logjik do të ishte se ai transaksion është kryer jashtë një marrëdhënie biznesore të themeluar dhe mu për këtë nuk është pjesë e një veprimtarie biznesore të vazhduar në mes të subjektit raportues dhe klientit. Në të vërtetë, në përkufizimin e “Marrëdhënieve Biznesore” Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së thotë: *Marrëdhënia e biznesit me bankën apo institucionin financiar do të thotë përdorimi i shërbimeve financiare*

të bankës apo institucionit financiar për më shumë se një transakcion apo transaksione të rastit.

586. Udhëzimi administrativ 006 i datës 11 mars 2008, i lëshuar nga Qendra e Inteligjencës Financiare⁸⁹ kërkon prej bankave dhe institucioneve financiare që t'i kenë të themeluara mekanizmat, përmes të cilëve klientët e ri dhe ata ekzistues të cilët janë vlerësuar si rrezik i lartë, sipas procedurave të themeluara për të njohur-klientin-tënd, të kontrollohen sipas listës së Kombeve të Bashkuara (Al Kaida dhe Taliban 1267) si dhe Listës për shtetasit e përcaktuar posaçërisht dhe personat e bllokuar, të lëshuar nga Thesari i ShBA-ve, Zyra për Kontrollimin e Aseteve të Huaja (OFAC) për persona dhe subjekte të dyshuara. Ky raport shpreh shqetësime sa i përket vlefshmërisë së Udhëzimit administrativ në atë drejtim se Udhëzimi i lëshuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, e cila është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit LPP/LFT nuk përcakton mundësin e vazhdimësisë së udhëzimeve të tilla.

587. BQK-ja ka njoftuar se disa banka i përdorin softuerët më këto lista, si dhe i përditësojnë ato lista prej listës së pranuar nga ta prej Ministrisë së Punëve të Jashtme. Duhet të theksohet se listat u dërgohen bankave si dhe shoqatave përkatëse për njoftim.

588. Në anën tjetër një pjesë e caktuar e sektorit nuk e kishte të qartë se si pranohen listat e tilla dhe se si ato zbatohen në procesin e KDK-së. Një pjesë prej tyre ka pretenduar se ata kanë pranuar një listë të personave të tillë që ka qenë e bashkangjitur me Udhëzimin administrativ 003 të datës 16 shkurt 2007 të Qendrës së Inteligjencës Financiare dhe se kurrë më pas nuk kanë pranuar ndonjë listë tjetër.

589. Paqartësitë që shtrohen nga interpretimi që mund të i bëhet kërkesave të nenit 17 (2) për identifikimin e klientëve tregojnë mospërputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe do të mund të ndikonin negativisht në zbatimin e tyre.

590. Përderisa obligimi në nenin 17 (2) shërben për të identifikuar klientin dhe verifikuar identitetin në bazë të të gjitha masave të KDK-së, ashtu siç specifikohet vetë në Ligj, atëherë del se nuk ka obligim për ta identifikuar pronarin përfitues (paragrafi 1.2) i nenit 17(1) për definicionin e KDK-së) nën rrethanat siç është definuar me nenin 17(2) të Ligjit LPP/LFT-sih gjithashtu komentet e tjera për KTh 5.5* më poshtë.

591. Rrjedhimisht, siç është cekur më lart, rekomandohet që kjo anomali në Ligjin LPP/LFT të adresohet menjëherë duke u përkujdesur që subjektet raportuese sipas nenit 16 të Ligjit të aplikojnë KDK-në të plotë sipas nenit 17(2).

592. Për më tepër, më tutje rekomandohet që të rishikohet paragrafi (2.2.2) dhe paragrafi (2.2.3) i nenit 17 të LPP-së për ta mënjeluar subjektivitetin e tyre të interpretimit dhe të sigurohet që masat nën të, të aplikohen në rrethana të duhura.

593. Në fund, rekomandohet që menaxhimi i mëtejshëm i qarkullimit të listës së Kombeve të Bashkuara dhe të listave të tjera të personave dhe subjekteve të caktuara, si dhe udhëzimet e mëtejshme të përdorimit të tyre do të ishin të përshtatshme për fuqizimin e mëtejshëm të efikasitetit.

Masat e duhura KDK – Identifikimi i klientit dhe verifikimi i identitetit – Kriteri thelbësor 5.3*

⁸⁹ Qendra e Inteligjencës Financiare (QIF) është pararendësi i NjIF-it të tanishëm.

594. KTh 5.3 parasheh që institucionet financiare t'i identifikojnë klientë e tyre dhe të verifikojnë identitetin e klientit, duke përdorur dokumente burimore, të dhëna dhe informata të pavarura të besueshme.

595. Neni 17 i Ligjit LPP/LFT kërkon që subjektet raportuese t'i identifikojnë 'klientët' e tyre dhe të verifikojnë atë identifikim përmes dokumentit burimor të besueshëm të pavarur, të dhënave ose informatave të besueshme. Sipas definicionit (Ligji LPP/LFT e definojnë 'klientin' dhe jo 'konsumatorin', edhe pse për qëllimin e kësaj analize kuptohet që i referohet personit të njëjtë) përfshinë të dy, personin fizik dhe subjektin, por nuk ka referencë për "rregullimin ligjor", i cili term nuk është definuar në Ligjin LPP/LFT.

596. Neni 17 i Ligjit LPP/LFT më tej definojnë tipin e dokumenteve burimore të pavarura dhe të informatave që banka dhe institucionet financiare duhet t'i marrin për verifikimin e personit fizik ose të subjektit. Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së ofron udhëzime shtesë për dokumentet dhe informatat që bankat dhe institucionet financiare duhet të kërkojnë për verifikimin e identitetit të klientit.

597. KTh 5.3* duket të jetë e përcaktuar në mënyrë adekuate nga Ligji LPP/LFT dhe udhëzimet shtesë të dhëna në Letrën këshilluese 2007/1 të BQK-së edhe pse rafinimet e mëtejshme për procesin verifikues dhe dokumentacion verifikues mund të jenë të nevojshme.

598. Në këtë aspekt, në shqyrtimin e Rregullës X dhe Letrës këshilluese 2007/1 të BQK-së, rekomandohet fuqishëm që referencat t'i bëhen dy publikimeve të Komitetit të Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare, të cilat duhet të shërbejnë si dokumentacion burimor për identifikimin e klientit dhe verifikimin e atij identifikimi. Kujdesi i Duhur i Klientit për Bankat, tetori 2001 (botimi 85) dhe shtojca e tij Udhëzimi i përgjithshëm për hapjen e llogarisë dhe identifikimin e klientit, shkurt 2003.

Masat e nevojshme KDK -verifikimi për personat juridikë dhe rregullimet ligjore - Kriteri thelbësor 5.4

599. Kërkesa sipas KThH 5.4 është e dyfishtë. Së pari institucionet financiare duhet të identifikojnë nëse ndonjë person që ka për qëllim të veprojë në emër të një personi juridik ose rregullimi ligjor është i autorizuar ta bëjë këtë (një kërkesë që duhet të gjendet në ligj) dhe të identifikojë dhe të verifikojë identitetin e atij personi. Nën dy, duhet të verifikohet statusi ligjor i personit juridik ose rregullimit ligjor.

600. Paragrafi (3) i nenit 18⁹⁰ i Ligjit LPP/LFT kërkon që një person i cili e themelon një marrëdhënie biznesi me një bankë ose institucion financiar të deklarojë me shkrim nëse ai person vepron në emër të tij ose në emër të një personi a subjekti tjetër.

601. Për më tepër, paragrafët (4) dhe (5) të nenit 17 më tej e definojnë obligimin për të identifikuar atë person dhe subjektin që ai e përfaqëson dhe të sigurohet që personat e atillë të jenë autorizuar në mënyrë adekuate nga subjekti ligjor përmes një dokumenti që e identifikon një autorizim të atillë.

602. KTh 5.4 duket të jetë përfshirë në mënyrë adekuate në Ligjin LPP/LFT dhe udhëzimet shtesë të përcaktuara nga Letra këshilluese 2007/1 të BQK-së, edhe pse, siç është cekur tashmë, sipas analizës së KTh 5.3 më lart, rafinimi i mëtejshëm dhe procesi i verifikimit dhe dokumentet verifikuese mund të jenë të nevojshme.

⁹⁰ Referenca "pjesëmarrje në një transaksion sipas paragrafit (3) të nenit 17 të Ligjit duket të çorientojë meqë paragrafi (3) vetëm përcakton identifikimin e personit fizik.

603. Prandaj rekomandohet fuqimisht që procedurat verifikuese sipas Ligjit LPP/LFT dhe sipas Rregullës X të plotësuar të BQK-së t'i konsiderojnë botimet a lartpërmendura të Komiteti të Bazelit për mbikëqyrjen bankare.

Identifikimi i pronarit përfitues - Kriteri thelbësor 5.5*⁹¹

604. KTh 5.5 kërkon identifikimin e pronarit përfitues dhe marrjen e masave të duhura për të verifikuar që i identifikojnë me të dhënat, informatat dhe dokumentet e pavarura nga një burim i besueshëm.

605. Sipas standardeve të FATF-së termi 'pronari përfitues' i referohet personit (ave) fizik, i cili është pronar ose e kontrollon një klient dhe/ose person në emër të të cilit kryhet një transaksion. Gjithashtu i inkorporon ata persona të cilët ushtrojnë kontroll ndaj një personi juridik ose rregullimi.

606. Ligji LPP/LFT e definojnë pronarin përfitues si person fizik, i cili është pronar ose e kontrollon një klient ose një llogari, personin në emër të të cilit një transaksion është duke u kryer ose personi i cili e ushtron kontrollin efikas ndaj një personi ose rregullimi juridik.

607. Vlen të ceket që definicioni i Ligjit LPP/LFT është shumë i afërt me atë të Fjalorit të FATF-së. Në fakt definicioni në Ligjin LPP/LFT në mënyrë konsekuente i referohet pronarit përfitues të "rregullimit ligjor" kur Ligji nuk e definojnë një term të atillë dhe nuk i referohet më rregullimit ligjor, siç janë trustet - varësisht nga pranimi i tyre në strukturën ligjore të Kosovës.

608. Sipas nenit 17(1) Ligjit LPP/LFT definojnë se çfarë përbëjnë masat e KDK-së, të cilat përfshijnë identifikimin e pronarit përfitues dhe verifikimin e identitetit. Neni 17(2) atëherë përcakton identifikimin e klientit dhe verifikimin e atij identifikimi, pa iu referuar pronarit përfitues.

609. Për më tepër, neni 18 i Ligjit LPP/LFT, i cili e përcakton kohën e verifikimit për të gjithë klientët⁹², nuk i referohet kohës së verifikimit për identifikimin e pronarit përfitues. Në të vërtetë, referimi i vetëm i mundshëm gjendet në pikën 3.2 të paragrafit (3) të nenit 18 i cili thekson: *të ketë marrë masat e duhura për të verifikuar se secili person ose subjekt është pronari ose mbajtësi i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit dhe ka mirëbesimin se çdo person ose subjekt i identifikuar është pronari dhe/ose mbajtësi i të drejtës së pronësisë së çdo prone që i nënshtrohet transaksionit..* Megjithatë, është mjaft e diskutueshme se në ç'masë kjo mund të interpretohet si referim në 'pronar përfitues', siç përcaktohet në LPP/LFT për dallim nga 'përfituesi' i një transaksioni të bërë.

610. Vlen të ceket se përkufizimi i 'klientit' në LPP/LFT, i cili përkufizohet si: *një person ose subjekt që kryen një transaksion në bankë ose shfrytëzon shërbimet e saj, të një institucioni financiar, të një avokati, të një kontabilisti të certifikuar, të një auditori të licencuar, ose të një këshilltari tatimor. Termi klient përfshin çdo pronar, përfitues, person ose subjekt tjetër në emër të të cilit kryhet transaksioni apo pranohen shërbimet.* Një definicion pothuajse i ngjashëm për 'blerësin' gjendet në Letrën këshilluese 2007/1 të BQK-së, e cila megjithatë përmban një ndryshim shumë të vogël nga ajo që i referohet 'pronarit

⁹¹ Çështja e procedurës që mund të aplikohet për identifikimin e pronarit përfitues është diskutuar më tej në Pjesën 4 të këtij Raporti.

⁹² Ndërsa Ligji LPP/LFT e definojnë një "klient", ligji the rregullat i referohen ose "konsumatorit" ose "klientit". Për qëllimet e këtij Raporti, këto dy terme interpretohen të jenë të njëjta për nga definicioni. Referenca të ngjashme janë bërë në Rregullën X të BQK-së.

përfitues' ndryshe nga referimi në 'përfituesi' në LPP/LFT. Prandaj, se në çmasë referimi në 'përfitues' sipas definicionit i referohet 'pronarit përfitues' të subjektit juridik ndryshe nga 'përfituesi' i një transaksioni – që më gjasë është ky i fundit – mbetet i diskutueshëm dhe subjekt i interpretimit.

611. Pa paragjykuar në shqetësimet e ngritura me herët në këtë Raport rreth vlefshmërisë aktuale të përmbajtjes të të dyja dokumenteve, Letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulla X e BQK-së i referohet më tej konceptit të pronarit përfitues.

612. Për shembull, Letra këshilluese 2007/1, ndonëse e ngjashme me LPP/LFT, nuk jep ndonjë udhëzim apo obligim për identifikimin e pronarit përfitues dhe verifikimin e atij identifikimi, por përfshinë referimin e mëposhtëm në konceptin e pronarit përfitues:

- në lidhje me KDK-në e shtuar, ai i referohet vështimit të identifikimit të blerësit (duke përfshirë edhe pronarin përfitues dhe kontrolluesin);
- në lidhje me pyetjet rreth funksionit të përputhshmërisë, ai përfshinë referimin në profesionin apo aktivitetin afarist të blerësit dhe pronarit përfitues dhe referimin lidhur me atë se a është blerësi apo pronari përfitues PEP;
- në mënyrë të ngjashme, në rrethana të ngjashme, referimi bëhet në kërkesën për funksionin e përputhshmërisë për marrjen e informacioneve në formë të shkruar apo gojore nga blerësi apo pronari përfitues; dhe në vizitën në vendeve të afarizmit të blerësit dhe pronarit përfitues; dhe
- kur adresohen çështjet që kanë të bëjnë raportet bankare përkatëse ku Letra kërkon informata rreth pronarit përfitues të bankave jorezidente;

613. Në anën tjetër, Rregulla X e BQK-së duket se njeh që LPP/LFT nuk parasheh ndonjë obligim për identifikimin dhe verifikimin e pronarit përfitues, prandaj ajo përfshin referimin e mëposhtëm:

- sipas nenit 6, ajo kërkon që bankat dhe institucionet financiare të sillen sipas KDK-së, duke përfshirë (a) identifikimin e blerësve, përfshirë këtu edhe pronarët përfitues;
- sipas nenit 6.2 në përcaktimin e pronarëve përfitues ku kërkon që *bankat apo institucionet financiare ndërmarrin masa për të përcaktuar nëse një blerës vepron në emër të një a më tepër pronarëve përfitues në përputhje me nenin 3.2 të Rregullores 2004/2 dhe verifikimin e një identifikimi të këtillë kundrejt burimeve të besueshme – ndonëse kjo varet nga interpretimi se deri në çmasë i referohet pronarit përfitues apo personit juridik ndryshe nga përfituesi i një transaksioni përkundër definicionit të pronarit përfitues në nenin e njëjtë; dhe*
- sipas nenit 8 në lidhje me mbajtjen e shënimeve ku cek se komponentët e nevojshëm të shënimeve të transaksionit përfshijnë (a) emrin e blerësit dhe të pronarit përfitues;

614. Dispozitat në LPP/LFT që kanë të bëjnë me identifikimin e pronarit përfitues dhe verifikimin e atij identiteti kanë mangësi serioze që qojnë në përfundim se koncepti i pronarit përfitues të subjekteve juridike nuk është paraparë në mënyrë adekuate dhe të qartë.

615. Serioziteti i kësaj situate është vërejtur edhe në diskutimin me sektorin privat që ka shpreh shqetësime rreth obligimeve dhe vështirësive në identifikimin e pronarit përfitues të subjektit juridik, që po ashtu është rezultat i përkufizimit të pronarit përfitues i cili nuk përfshin pragu e pronësisë.⁹³

⁹³ Projektligji për ndryshimin e LPP/LFT paraqet një prag për pronësinë përfituese.

616. Në të vërtetë, përkufizimi 'pronar përfitues' në LPP/LFT është shumë i ngjashëm me atë të paraparë në fjalorin e FATF-së, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe pronarin përfitues të marrëveshjes juridike, e cila mund të përfshijë, për shembull, trustet.

617. Në rast të marrëveshjeve juridike siç janë trustet, zakonisht pritet që të gjendet një shtrirje e mëtejshme e definicionit të pronarit përfitues që përcakton se kush do të ishin këta pronarë sipas trustit. Kjo mungon në LPP/LFT dhe në rregullat relevante të BQK-së pasi që në LPP/LFT mungojnë referimet e mëtejme në marrëveshjet juridike përveç përfshirje së tyre në përkufizim.

618. Dispozitat e Ligjit LPP/LFT duket se janë të paqarta sa i përket obligimeve ligjore për të identifikuar gënjeshttrat e pronarit përfitues

619. Në të vërtetë i vetmi obligim i bankave dhe institucioneve financiare është që të identifikojnë pronarin përfitues të një subjekti ligjor, si dhe të verifikojnë identifikimin e tillë është i theksuar në Rregullën X të BQK-së në nenin 6, i cili kërkon prej bankave dhe institucioneve financiare se duhet të i kryejnë KDK e detajuar duke përfshirë (a) identifikimin e klientëve, duke përfshirë pronarët përfitues - vërejeni po ashtu edhe dallimin prej Ligjit LPP/LFT, i cili kërkon vetëm identifikimin e klientëve sipas nenit 17 (2) në bazë të aplikimit të plotë të KDK-së.

620. Megjithatë, për qëllime të kësaj analize, vlefshmëria e kësaj kërkesë është e dyshimtë ngase standardet ndërkombëtare kërkojnë që një obligim i tillë të rrjedhë nga ligji - duke pasur parasysh po ashtu edhe faktin se Rregulla X është lëshuar sipas kushteve të Rregullores së UNMIK-ut 1999/21, e cila tani është shfuqizuar, dhe në këtë rast, mund të jetë në kundërshtim me Ligjin LPP/LFT- edhe pse është Rregulla X ajo e cila i implementon standardet ndërkombëtare që duhet të përcillen nga bankat dhe institucionet financiare.

621. Prandaj rekomandohet fuqimisht që Ligji LPP/LFT të ndryshohet në atë mënyrë që drejtpërdrejt të sigurojë identifikimin e pronarit përfitues të subjektit ligjor dhe verifikimin e po të njëjtit. Një gjë e tillë do të mund të arrihej duke iu referuar obligimeve për zbatimin e plotë të masave KDK përtej obligimeve për identifikim - ju lutem referojuni po ashtu më poshtë Direktivës së tretë LPP të BE-së, neni 3(6).

Vërtetimi nëse klienti është duke vepruar në emër të palës së tretë– Kriteri thelbësor 5.5.1*

622. KTh 5.5.1, përmes legjislationit ose rregullores, kërkon që të gjitha institucionet financiare të klientëve të vërtetojnë nëse personi është duke vepruar në emër të personit tjetër, si dhe duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për ta identifikuar palën e tretë.

623. Paragrafi (3) i nenit 18⁹⁴ i LPP/LFT kërkon që personi i cili krijon marrëdhënie afariste me bankën ose institucionin financiar të deklaroj me shkrim nëse ai person vepron në emër të vet apo në emër të ndonjë personi ose subjekti tjetër.

624. Gjithashtu, paragrafët (4) dhe (5) të nenit 17 më tutje parashohin obligimet në bankë dhe institucione financiare për të identifikuar atë person dhe personin ose subjektin autorizuar të cilin ai e përfaqëson.

625. Pa ndonjë paragjykim për shqetësimet e paraqitura në këtë Raport mbi vlefshmërinë e tij, ky obligim edhe me tutje reflektohet në Rregullin X të BQK-së në nenin 6 i cili kërkon

⁹⁴ Referenca 'hyrja në transaksion sipas paragrafit (3) të nenit 17 të këtij Ligji' duket të jetë çorientuese, pasi që paragrafi (3) parasheh vetëm identifikimin e personit fizik.

identifikimin në pronarin përfitues ashtu siç përcaktohet në nen kur një person vepron në emër të ndonjë tjetri.

626. KTh 5.5.1* duket të jetë mbuluar në mënyrë të përshtatshme.

Pronësia dhe struktura e kontrollit – Kriteri Thelbësor 5.5.2

627. KTh 5.5.2 kërkon që institucionet financiare fillimisht të kuptojnë pronësinë dhe strukturën e kontrollit të një personi ligjor ose marrëveshje dhe së dyti (përmes dispozitave ligjore) të përcaktojnë këta persona të cilët ushtojnë kontrolle efektive përfundimtare. Metodologjia më tutje përcakton udhëzimin në lidhje me këtë. Për subjektet juridike kjo do të përfshinë identifikimin e personave fizikë me interes kontrollues dhe personat të cilët përbëjnë aftësitë mendore dhe udhëheqësin. Për marrëveshjet ligjore, si trustet, ky obligim do të kërkonte identifikimin e sistemuesit, të besueshmit ose personit që ushtron kontrolle mbi trustin dhe përfituesit.

628. Me përjashtim të dispozitave në lidhje me analizimin e KTh 5.5. dhe KTh 5.5.1 të këtij Raporti në lidhje me identifikimin e pronarit përfitues dhe subjekti pastaj i komenteve të Ligjit LPSH/PFT është i heshtur në nevojat në KTH 5.5.2 në kuptim të pronësisë dhe kontrollit të strukturës të personit juridik ose marrëveshjes ligjore.

629. Me përjashtim të një reference të vogël në nenin 3 për dhënien e udhëzimeve shtesë lidhur me identifikimin e dokumenteve, Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së gjithashtu nuk parasheh asgjë lidhur me kërkesat për bankat dhe institucionet financiare në arritjen e masave që kërkohen me KTh 5.5.2.

630. Neni 6.2 i Rregullit X i BQK-së ofron udhëzim për bankat dhe institucionet financiare në këtë aspekt, ku thuhet: *Për konsumatorët të cilët janë subjekte, ashtu si përcaktohet në Rregulloren 2004/2, banka ose institucioni financiar duhet të marr masa përgjegjëse për të kuptuar pronësinë dhe strukturën kontrolluese të subjektit. Kjo përfshinë personat fizik të cilët kanë në pronësi ose e kontrollojnë subjektin.* Megjithatë duhet të shënohet se në lidhje me rezervimet në vlefshmërinë e Rregullit, Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 mbi parandalimin e pastrimit të parasë dhe vepra penale të ngjashme është shfuqizuar plotësisht me hyrjen në forcë të Ligjit mbi LPP/LFT.

631. Dispozitat dhe referencat e vogla në Letrën këshilluese 2007/1 dhe Rregullin X të BQK-së janë të papërshtatshme për të mbuluar kërkesat sipas KTh 5.5.2 të Rekomandimit 5 të Standardeve të FATF-së.

632. Kur kemi të bëjmë me subjekte juridike, bankat dhe institucionet financiare duhet të kenë obligime të detyrueshme sipas Ligjit LPP/LFT se çfarë masa ata pritet t'i ndërmarrin, të plotësuara me një udhëzim të qartë se si të arrihet pajtueshmëria.

633. Në të vërtetë mungon i gjithë koncepti se si të ndërmerren masa të plota të KDK-së, në veçanti kur kryhen transaksionet me subjekte juridike dhe marrëveshjet juridike, gjë e cila ka pasoja negative në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit, i cili momentalisht është i cenueshëm.

634. Prandaj fuqimisht rekomandohet se të gjitha dispozitat në lidhje me aplikimin e identifikimit të konsumatorit nga bankat dhe institucionet financiare duhet të shqyrtohen tërësisht në pajtim me kërkesat relevante për ndërmarrjen e plotë të masave të KDK-së sipas Standardeve të FATF-së.

Qëllimi dhe natyra e menduar e marrëdhënieve afariste – Kriteri Thelbësor 5.6

635. Në përcaktimin e 'Kujdesit të Duhur ndaj Konsumatorit', neni 17 (1) përfshinë nevojë e marrjes së informatës mbi qëllimin dhe natyrën e menduar të marrëdhënieve afariste. Megjithatë, ashtu si u përmend edhe më lart në këtë Raport, Ligji LPP/LFT nuk e përcakton që bankat dhe institucionet financiare të ndërmarrin masa të plota KDK-së në rast se kërkohen, por të aplikohet një komponent të masave, gjegjësisht identifikimi dhe verifikimi i komponentit

636. Përndryshe Ligji LPP/LFT mbetet i heshtur në obligimet për bankat dhe institucionet financiare për të marrë informata dhe kuptuar qëllimin dhe natyrën e menduar të marrëdhënieve afariste.

637. Në thelb, Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së nuk parasheh asgjë për bankat dhe institucionet financiare lidhur me marrjen e informatave për qëllimin dhe natyrën e menduar të marrëdhënieve afariste. Kjo bënë vetëm një referencë të lehtë, e cila mund të lidhet me këtë obligim kur të adresohet pranimi i transaksioneve të dyshimta, duke kërkuar që institucionet financiare duhet të i mbledhin informatat për të mësuar në lidhje me konsumatorin dhe biznesin e konsumatorit në mënyrë që ato t'u ndihmojnë në identifikimin e transaksionit të jashtëzakonshëm.

638. Në anën tjetër, neni 6.4 i Rregullit X të BQK-së kërkon që bankat dhe institucionet financiare të mbledhin informata në lidhje me qëllimin dhe natyrën e menduar të marrëdhënieve afariste në mënyrë që bankat dhe institucionet financiare të mund të krijojnë dhe mirëmbajnë profilin e mjaftueshëm dhe të hollësishëm për secilin konsumator.

639. Në sistem e bazuar në risk, i cili aplikon konceptin e KDK-së, është shumë e rëndësishme që bankat dhe institucionet financiare të kuptojnë qëllimin dhe natyrën e menduar të marrëdhënieve afariste që ata hyjnë. Kjo është e rëndësishme për bankat dhe institucionet financiare që jo vetëm të ndërtojnë profilin e konsumatorit, por edhe të zhvillojnë politikat e pranimit të konsumatorit dhe të përcaktojnë ata konsumatorë, të cilët përmes afarizmit të tyre dhe profilit të riskut do të jenë në përputhje me politikat e pranimit të konsumatorit.

640. Duke mos paragjykuar në lidhje me shqetësimet e shfaqura në këtë Raport lidhur me vlefshmërinë e Rregullit X, ky Rregull përcakton nevojat për banka dhe institucione financiare për të marrë informata për qëllimin dhe natyrën e menduar të marrëdhënieve afariste që mund të jetë përtej asaj që parashihet sipas Ligjit kryesor, ku nuk përcaktohet kjo çështje, përveç faktit që përmendet në përkufizimin e KDK-së.

641. Gjithashtu, referenca në Letrën këshilluese 2007/1 të BQK-së ashtu siç paraqitet edhe më lart është vetëm në lidhje me njohjen e transaksioneve të dyshimta dhe, edhe pse mund të arrihet deri në një nivel të obligimeve të parapara, nuk e mbulon plotësisht nevojat sipas standardeve ndërkombëtare për aplikimin e konceptit të KDK-së.

642. Është e kuptueshme se shqetësimet e paraqitura nga institucionet përkatëse lidhur me zbatimin e drejtë të KDK-së, të çojnë në shqetësimet për nevojën e të kuptuarit të fushës dhe qëllimit të natyrës së menduar të marrëdhënieve afariste - pavarësisht se disa institucione mund të sigurojnë informacione të tilla për shkak të lidhjeve të tyre brenda grupeve bankare, pjesë e të cilave janë.

643. Duket përsëri se kjo e metë në ligjin e LPP/LFT lind nga fakti që subjektet raportuese sipas ligjit janë të obliguara të aplikojnë vetëm identifikimin dhe masat e verifikimit pavarësisht përcaktimit të detajuar të asaj që përbëjnë masat KDK të pranuar ndërkombëtarisht.

644. Prandaj, prapë rekomandohet fuqishëm që të gjitha dispozitat në lidhje me aplikimin e identifikimit të klientit nga bankat dhe institucionet bankare të rishikohen tërësisht në përputhje me kërkesat përkatëse për ndërmarrjen e masave të plota KDK-së sipas standardeve FATF.

Kujdesi i duhur në vazhdimësi për marrëdhëniet afariste – Kriteri thelbësor 5.7 *

645. KTh 5.7 parasheh ekzistimin e dispozitave ligjore, duke obliguar institucionet financiare që vazhdimisht të kryejnë kujdesin e duhur të marrëdhënieve të tyre afariste.

646. Në përkufizimin se çfarë përbën ‘Kujdesi i Duhur ndaj Klientit’, Ligji për LPP/LFT përfshinë komponentin që ka të bëjë me obligimet për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve afariste. Sidoqoftë, nuk ka referenca të mëtejme ndaj këtij detyrimi në Ligjin e LPP/LFT, me përjashtim të pikës (5.4), të paragrafit (5), të nenit 21 që ka të bëjë me kujdesin e rritur që kërkohet prej bankave dhe institucioneve financiare të sigurojnë monitorim të vazhdueshëm dhe të forcuar të marrëdhënieve të bankave ose veprimeve në vend për marrëdhëniet afariste me PEP që gjenden jashtë Kosovës.

647. Në fakt, sipas nenit 23 të Ligjit LPP/LFT, që parasheh bankat dhe institucionet financiare të zhvillojnë programe të brendshme me procedura të shkruara dhe kontrole për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nuk ka asnjë reference se procedurat duhet të përfshijnë masa për të ndërmarr monitorime të vazhdueshme të marrëdhënieve afariste - edhe pse lista e dhënë nuk është shteruese.

648. Për më tepër, neni 7 i Rregullit X të BQK-së, më konkretisht kërkon që bankat dhe institucionet financiare të kryejnë kujdesin në vazhdimësi (Ligji përcakton vetëm procesin KDK, por nuk e zbaton në mënyrë specifike në marrëdhëniet afariste).

649. Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së nuk e parasheh kujdesin e vazhdueshëm dhe monitorimin e marrëdhënieve afariste.

650. Mangësia e madhe dhe e rëndë e Ligjit LPP/LFT është se nuk parasheh që bankat dhe institucionet financiare të ndërmarrin masa të plota të KDK-së, por vetëm të aplikojnë një komponent, si identifikimin e klientit dhe verifikimin e atij identifikimi. Kjo mangësi ka ndikime serioze negative dhe implikime për tërë procesin e konceptit të KDK-së. Kjo është identifikuar sërish në kërkesën për institucionet financiare për të ndërmarrë monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve afariste në të gjitha instancat dhe jo pjesërisht dhe në rastet e klientëve me rrezik më të lartë.

651. Pra, Ligji LPP/LFT nuk e parasheh këtë kusht, dhe vetëm kërkon të aplikohet kjo kërkesë për një kategori të klientëve me rrezik më të lartë.

652. Pa paragjykime ndaj shqetësimeve të shprehura në këtë Raport mbi vlefshmërinë e Rregullit X të BQK-së, Rregulli X mbulon këtë kërkesë, por duke e bërë këtë, kalon përtej kërkesave sipas Ligjit LPP/LFT, i cili është i heshtur në këtë çështje dhe vlen vetëm në situata me rrezik më të lartë. Fakti që Rregulli X ndonjëherë kalon kërkesat e Ligjit LPP/LFT, është gjithashtu një shqetësim i shprehur nga institucionet përkatëse. Kjo krijon konflikt me këto institucione nëse duhet të zbatohen kërkesat e Ligjit LPP/LFT apo të shkohet përtej dhe të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullit X - i cili në fakt është më shumë i harmonizuar me standardet ndërkombëtare se sa vetë Ligji LPP/LFT. Zakonisht, aty ku nuk autorizohen me ligjin kryesor, rregullat dhe rregulloret duhet të shërbejnë vetëm për të dhënë orientim dhe praktikant më të mira për institucionet përkatëse që në mënyrë efikase t’i zbatojnë obligimet e tyre me ligj.

653. Megjithatë, pasi që Ligji LPP/LFT nuk i obligon subjektet raportuese që të ndërmarrin masa të plota KDK që përfshijnë monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies afariste, edhe pse e definojnë procesin, ekziston një çështje në faktin se Rregulli X shkon përtej kërkesave të Ligjit dhe reflekton standarde ndërkombëtare, mirëpo kjo mund të krijojë paqartësi në sistem.

654. Rrjedhimisht, rekomandohet që kjo mangësi në Ligjin LPP/LFT të korrigjohet si pjesë e mbikëqyrjes së përgjithshme të zbatimit të masave KDK sipas nenit 17 të Ligjit, siç është rekomanduar tashmë.

Shqyrtimi i vazhdueshëm i transaksioneve – Kriteri thelbësor 5.7.1*

655. Si pjesë e kujdesit të duhur të vazhdueshëm, KTh 5.7.1 parasheh që institucionet financiare të ndërmarrin shqyrtimin e kujdesëshëm të të gjitha transaksioneve që janë ndërmarrë gjatë marrëdhënies afariste për të siguruar përputhjen me profilin e konsumatorit, njohurinë e tyre për konsumatorin, dhe, aty ku është e domosdoshme, burimin e fondeve.

656. Siç është përshkruar tanimë sipas analizës së lartcekur për KTh 5.7 më lart, me përjashtim të pikave (5.4) të paragrafit (5) të nenit 21 që ka të bëjë me kujdesin e shtuar të duhur që obligon bankat dhe institucionet financiare të sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm dhe të përforcuar të marrëdhënies së bankës apo zotimeve të menjëhershme për marrëdhëniet afariste me PEP që ndodhen jashtë Kosovës, Ligji LPP/LFT është i heshtur për këtë çështje.

657. Megjithatë, neni 20 i Ligjit LPP/LFT mbi monitorimin e veçantë të transaksioneve të caktuara kërkon nga bankat dhe institucionet financiare t'i kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse dhe të mëdha të pazakonshme, si dhe mostrave të pazakonshme të transaksioneve, të cilat nuk kanë ndonjë qëllim të dukshëm ekonomik apo ligjor, si dhe marrëdhënieve afariste e transaksioneve me personat, përfshirë personat juridikë dhe marrëveshjet, nga shtetet që nuk i zbatojnë apo i zbatojnë në mënyrë të pamjaftueshme standardet relevante ndërkombëtare për ta luftuar pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit apo në to.

658. Për më tepër, por vetëm në rastet e zbatimit të KDK-së së shtuar për konsumatorët me rrezik të lartë, Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së obligon bankat dhe institucionet financiare, që në mes të tjerash, të zbatojnë KDK të shtuar nëpërmjet inspektimit të përforcuar të transaksioneve si shtesë e shqyrtimit të burimit të pasurisë dhe burimit të fondeve të konsumatorit.

659. Gjithashtu, neni 7 i Rregullit X të BQK-së më specifikisht obligon bankat dhe institucionet financiare që jo vetëm të kryejnë kujdes të duhur të shtuar (Ligji përkufizon vetëm procesin e KDK-së, por nuk e zbaton specifikisht) mbi marrëdhënien afariste, por edhe t'i shikojnë me kujdes transaksionet që kryhen të jenë në pajtim me njohurinë e institucionit rreth konsumatorit, biznesin e tyre dhe profilin e riskut,

660. Kërkesat nën nenin 20 të cekura më lart për monitorimin e veçantë të disa transaksioneve nuk i mbulojnë obligimet për KDK-në e vazhdueshme sipas Rekomandimit 5 të Standardeve FATF, por në fakt obligimet nën Rekomandimin 11 FATF dhe Rekomandimin 21 FATF.

661. Ligji LPP/LFT rrjedhimisht është i mangët në këtë kërkesë dhe vetëm përpiqet ta zbatojë këtë kërkesë për një kategori të konsumatorëve me rrezik të lartë.

662. Përndryshe, komentet e njëjta si për KTh 5.7 më lart vlejnjë për implementimin e KTh 5.7.1.

663. Andaj, rekomandohet që kjo mangësi në Ligjin LPP/LFT të korrigjohet në kuadër të shqyrtimit të përgjithshëm të zbatimit të masave në bazë të nenit 17 të Ligjit LPP/LFT, ashtu siç është rekomanduar më herët.

Mirëmbajtja e vazhdueshme e dokumenteve të kujdesit të shtuar dhe të dhënave – kriteri thelbësor 5.7.2*

664. KTh 5.7.2 parasheh përditësimin e dokumenteve, të dhënave dhe informatave të KDK-së përmes shqyrtimeve periodike, posaçërisht për konsumatorët me rrezik të lartë. Duhet të theksohet se kriteri vë theks në konsumatorët me rrezik të lartë, por nuk kufizon kushtin vetëm për situata të rrezikut të lartë.

665. Siç është theksuar tanimë për KTh 5.7 më lart, Ligji LPP/LFT nuk parasheh asgjë për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies afariste. Referenca në pikën (5.4) të paragrafit (5) të nenit 21 që ka të bëjë me kujdesin për PEPs, dhe e cila parasheh që institucionet financiare të sigurojnë monitorim të vazhdueshëm e të fuqizuar të marrëdhënies së bankave nuk specifikon obligimin për shqyrtimin periodik të dokumenteve, të dhënave dhe informatave të KDK-së.

666. Në kuadër të obligimeve për ndërmarrjen e masave KDK në bazë të nenit 6 të Rregullës X të BQK-së, pjesa 6.6 parasheh që bankat dhe institucionet financiare vazhdimisht të grumbullojnë dhe mirëmbajnë informatat e konsumatorëve. Në këtë drejtim, dokumentet, të dhënat apo informatat e grumbulluara në kuadër të procesit të KDK-së (Ligji vetëm përkufizon procesin e KDK-së, por nuk e zbaton në mënyrë specifike) janë të nevojshme për t'u përditësuar dhe për të qenë relevante përmes shqyrtimeve periodike të regjistrave ekzistuese, duke përfshirë regjistrat e transaksionit.

667. Nga ana tjetër, Letra këshilluese 2007/1 nuk parasheh asgjë në këtë drejtim.

668. Obligimi për plotësimin e kushtit për monitorimin e vazhdueshëm të dokumenteve, të dhënave dhe informatave të KDK-së mund të gjendet vetëm në Rregullën X të BQK-së. Megjithatë, shqetësimet e shprehura në këtë raport për vlefshmërinë e disa prej dispozitave të Rregullës dhe shqetësimet e shprehura në këtë raport, që pasqyrojnë shqetësimet e sektorit që Rregulla nganjëherë shkon përtej kërkesave të parapara në Ligjin LPP/LFT, gjithashtu vlen edhe për këtë rast - edhe pse Rregulli X qartazi i reflekton standardet ndërkombëtare më shumë se vetë ligji LPP/LFT.

669. Përndryshe, komentet e njëjta për KTh 5.7 më lart vlejné edhe për zbatimin e KTh 5.7.2.

670. Andaj, rekomandohet që kjo mangësi në Ligjin LPP/LFT të korrigjohet në LPP/LFT kuadër të shqyrtimit të përgjithshëm të zbatimit të masave të KDK-së në bazë të nenit 17 të Ligjit, ashtu siç është rekomanduar më herët.

Rreziku: Kujdesi i shtuar për konsumatorët me rrezik të lartë, marrëdhëniet afariste dhe transaksionet – kriteri thelbësor 5.8

671. Në kërkimin nga institucionet financiare për të ndërmarrë kujdes të rritur për situatave të tilla, të cilat nuk janë shteruese.

672. Neni 21 i Ligjit LPP/LFT parasheh që subjektet raportuese të zbatojné kujdes të rritur në rast të pranisë së rrezikut më të lartë të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizimit. Më tej, neni 21 parasheh në mënyrë specifike këtë obligim në situatat kur nuk kemi marrëdhënie sy me sy, marrëdhënie të punëve bankare korresponduese dhe marrëdhënie me PEP. Në këtë drejtim, në Ligj specifikohen masat e përmirësuara që duhet të zbatohen.

673. Ligji LPP/LFT megjithatë nuk specifikon llojin e masave të përmirësuara që duhet të aplikohen nga subjektet raportuese në situatat dhe marrëdhëniet e tjera që paraqesin rrezik më të lartë.

674. Letra këshilluese 2007/1 e QBK-së paraqet një listë joshteruese të kategorive të konsumatorëve dhe situatave që mund të paraqesin rrezik më të lartë. Në Letrën këshillëdhënëse gjithashtu parashihen masat indikative të kujdesit të shtuar që mund të zbatohen *Përveç kontrollit të burimit të pasurisë dhe të fondeve të konsumatorit.*

675. Neni 6.3 i Rregullës X i BQK-së, në trajtimin e zbatimit të KDK-së, parasheh që bankat dhe institucionet financiare të zbatojnë CD të përmirësuara për konsumatorë, marrëdhënie afariste dhe transaksione që kanë gjasa të paraqesin rrezik më të lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizimit. Ky nen parasheh që marrëdhëniet afariste me PEP gjithmonë do të konsiderohen se përbëjnë rrezik më të madh. Ky nen megjithatë nuk parasheh se për çka duhet të zbatohen masat e përmirësuara përveç referencës në burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve.

676. Edhe pse si Ligji LPP/LFT, Letra këshilluese, ashtu edhe Rregulla X e QBK-së, pa paragjykuar shqetësimet e shprehura për shkallën e vlefshmërisë të këtyre dy të fundit, kërkon zbatimin e KDK-së së përmirësuar për konsumatorë që përbëjnë rrezik më të lartë, asnjë nga këto tri burime nuk parashohin obligim për bankat dhe institucionet financiare të zbatojnë procesin e ndjeshmërisë së rrezikut dhe nuk kategorizojnë e shkallëzojnë konsumatorët e rrezikut më të lartë.

677. Për më tepër, në rastet specifike Ligji LPP/LFT parasheh zbatimin e masave të rritura të kujdesit, por nuk specifikon se këto masa të rritura duhet të zbatohen si shtesë ndaj zbatimit të masave të zakonshme të KDK-së – pavarësisht se Ligji nuk parasheh zbatimin e masave të plota të CD-së.

678. Mosekzistimi i kushtit në Ligjin LPP/LFT që subjektet raportuese të zbatojnë KDK të plota (ekziston kushti që të aplikohen vetëm proceset e identifikim mospërputhje dhe në konflikt me kushtet e parapara sipas Ligjit të njëjtë lidhur me zbatimin e KDK-së së rritur në situatat e rrezikut më të lartë.

679. Për më tepër, ekziston mungesë e plotë e udhëzimeve për sektorin lidhur me mënyrën e zbatimit të qasjes së bazuar në rrezik dhe për llojin e masave të rritura të kujdesit për t'i zbatuar në situata të rrezikut të lartë përtej atyre të specifikuara nga vet Ligji. Në fakt, është vetëm Letra këshillëdhënëse 2007/1, ku jepen disa udhëzime për masat e rritura.

680. Mungesa e udhëzimeve dhe pasiguria për zbatimin e qasjes së bazuar në rrezik janë shqetësime të shprehura nga vet sektori, dhe qartazi shihet se kjo ka ndikim negativ për efektshmërinë e sistemit.

681. Rrjedhimisht, rekomandohet fuqimisht që dispozitat në Rregullën X dhe në Letrën këshilluese 2007/1 që i referohet situatave të rrezikut të lartë, të cilat duhet të shqyrtohen në përputhje me ndryshimin e Ligjit LPP/LFT lidhur me futjen e këtij obligimi për subjektet raportuese:

- Që të zhvillohen dhe krijohen procedura të efektshme për të identifikuar rrezikun që paraqet çdo konsumatorë, duke përfshirë kategorizimin e konsumatorëve në bazë të rrezikut;
- Që të zhvillohet dhe të zbatohet prirja për rrezik në pranimin e rrezikut të ndërlidhur me pastrimin e parave dhe me financimin e terrorizimit;

- Që të zhvillohen dhe krijohen politikat e efektshme për pranimin e konsumatorëve në përputhje me prirjen për rrezik të institucionit dhe
- Që të zhvillohen dhe krijohen procedura për zbatimin e masave të rritura të KDK-së në bazë të rrezikut.

682. Rekomandimet e lartcekura duhet të jenë pjesë e rekomandimeve paraprake për të siguruar zbatimin e plotë të masave të plota të KDK-së në bazë të nenit 17 të Ligjit LPP/LFT në vend të procedurave të identifikimit dhe të verifikimit.

683. Për më tepër, Ligji duhet të parasheh që masat e rritura të kujdesit duhet të zbatohen, përveç aplikimit të masave të rregullta të KDK-së, ashtu siç është parashikuar me Ligj.

Rreziku: Zbatimi i masave të reduktuara apo të thjeshtësuara për situatat e rrezikut të ulët-Kriteri thelbësor 5.9

684. KTh 5.9 mundëson zbatimin e masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara ku rreziku nga pastrimi i parave apo financimi i terrorizimit është i vogël. Ky kriter parasheh një listë indikative të situatave, ku rreziku do të mund të konsiderohej i ulët, duke pasur parasysh llojin e konsumatorit, prodhimin e transaksionit apo vendndodhjen e konsumatorit, pra, faktin e rrezikut gjeografik.

685. Ligji LPP/LFT nuk parasheh situatat e rrezikut të ulët dhe rrjedhimisht nuk dallon nivelet e masave që duhet të aplikohen në situatat të tilla.

686. Po ashtu, si Letra këshilluese 2007/1, ashtu edhe Rregulla X e BQK-së nuk parashohin zbatimin e masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara për situatat e rrezikut të ulët.

687. Në fakt, në parashikimin që bankat dhe institucionet financiare të krijojnë dhe mirëmbajnë profilin e konsumatorit për çdo konsumator, neni 6.4 i Rregullës X të QBK-së nuk parasheh që profili i konsumatorit të përdoret për qëllime të zbatimit të masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara të KDK-së, por më, specifikisht, parasheh të shihet nëse janë të nevojshme masat e rritura të kujdesit. Pavarësisht kësaj, ruajtja e profilit të konsumatorit nuk i përmbahet domosdoshmërisht procesit të vlerësimit të rrezikut të konsumatorit për të identifikuar nivelin e rrezikut, të cilin i njëjti e paraqet.

688. Zbatimi i masave të zvogëluara dhe të thjeshtësuara të KDK-së në situata që paraqesin nivel më të ulët të rrezikut nuk është i obligueshëm sipas standardeve të FATF-së. Megjithatë, moszbatimi i masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara të kujdesit ka implikime më të gjëra, për shembull, gjatë transaksioneve prej bankës në bankë në llogari të tyre.

689. Nuk është e qartë nëse opsioni i zbatimit të masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara qëllimisht nuk është përfshirë në Ligjin LPP/LFT pas procesit të vlerësimit të rrezikut apo nëse kjo është bërë përmes mbikëqyrjes.⁹⁵

690. Pavarësisht kësaj, në rast se autoritetet e Kosovës vendosin të përfshijnë këtë opsion, është e preferueshme që:

- Të zbatohet ky opsion pas vlerësimit të rrezikut të atyre zonave dhe institucioneve që paraqesin rrezik më të vogël për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizimit;

⁹⁵ Projektligji për ndryshimin e Ligjit për LPP/LFT do t'i parashikojë masat në këtë drejtim.

- Është i kufizuar për situatat e parapara në Ligj (do të ishte e udhës të bëhet referenca në shembuj të Metodologjisë FATF lidhur me KTH 5.9);
- Bankat dhe institucionet financiare duhet të krijojnë procedura të brendshme për zbatimin e masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara të kujdesit;
- Procedurat e tilla duhet të jenë pjesë e procesit të bazuar në ndjeshmërinë e rrezikut për konsumatorë;
- Procedurat e tilla duhet të jenë pjesë të shqyrtimit të përgjithshëm të zbatimit të masave të KDK-së në vend të procedurave të identifikimit dhe të verifikimit që aktualisht janë të parapara në nenin 17 të Ligjit LPP/LFT, ashtu siç tanimë është rekomanduar në këtë raport dhe
- Çështjet e tjera të ndërlidhura, ashtu siç është shpjeguar në kriteret esenciale 5.10 dhe 5.12

Rreziku: Zbatimi i masave të zvogëluara dhe të thjeshtësuara për konsumatorët e juridiksioneve të tjera – Kriteri thelbësor 5.10

691. KTh 5.10 parasheh që në rastet kur masat e zvogëluara apo të thjeshtësuara të kujdesit të shtuar për konsumatorë të juridiksioneve të tjera janë të lejueshme, ai juridiksion duhet të jetë në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe t'i ketë zbatuar ato në mënyrë të efektshme.

692. Siç është shpjeguar në kuadër të analizës së KTh 5.9 më lart, parandalimi i pastrimit të parave dhe sistemi i parandalimit të financimit të terrorizimit në Kosovë nuk parasheh zbatimin e masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara të KDK-së.

693. Nëse autoritetet e Kosovës vendosin ta përfshijnë këtë opsion në legjislaturë, atëherë përpos masave të rekomanduara në kuadër të analizës së KTh 5.9 më lart, ato duhet të sigurohen që bankat dhe institucionet financiare të kenë procedura të duhura për identifikimin e këtyre vendeve, të cilat nuk zbatojnë fare rekomandimet e FATF-së apo të cilat nuk i zbatojnë ato në mënyrë të duhur.

694. Përndryshe, komentet dhe rekomandimet e dhëna në kuadër të analizës së KTh 5.9 vlejné edhe për KTh 5.10.

Rreziku: Zbatimi i masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara në rastet kur ka dyshim për skenarët e rrezikut më të lartë – Kriteri thelbësor 5.11

695. KTh 5.11 parasheh që masat e zvogëluara apo të thjeshtësuara të kujdesit nuk duhet të zbatohen në rastet kur ka dyshim për pastrim të parave apo financim të terrorizimit ose kur vlejné skenarët për rreziqe më të larta.

696. Siç është përshkruar në kuadër të analizës së KTh 5.9 më lart, sistemi për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizimit në Kosovë nuk parasheh zbatimin e masave KDK të zvogëluara apo të thjeshtësuara.

697. Nëse autoritetet e Kosovës vendosin ta përfshijnë këtë opsion në legjislacion, atëherë përpos masave të rekomanduara në kuadër të analizës së KTh 5.9 më lart, ato gjithashtu duhet të sigurohen që bankat dhe institucionet financiare ta kenë të ndaluar me ligj zbatimin e masave të zvogëluara apo të thjeshtësuara të kujdesit në rrethanat e parapara në KTh 5.11.

698. Përndryshe, komentet dhe rekomandimet e dhëna në kuadër të analizës së KTh 5.9 vlejné edhe për KTh 5.11.

Rreziku: Udhëzimet e lëshuara nga autoritete relevante – Kriteri thelbësor 5.12

699. KTh 5.12 parasheh që në rastet kur institucioneve financiare u lejohet përcaktimi i zbatimi i masave të KDK-së, nga ato kërkohet që t'u përmbahen udhëzimeve të nxjerra nga autoritetet kompetente. Ky kusht për institucionet financiare paraqet obligim për autoritete relevante kompetente për të nxjerrë udhëzimet e duhura në rrethana të tilla.

700. Vetëm neni 21 i Ligjit LPP/LFT i referohet përcaktimit të shkallës së KDK-ve, por vetëm për aq sa masat e shtuara të kujdesit zbatohen në situatat e rrezikut më të lartë. Kjo më tej plotësohet përmes nenit 6.3 të Rregullës X të BQK-së, ku përsëriten dispozitat e nenit 21 – luteni t'i referoheni analizës së KTh 5.8 më lart.

701. Vetëm Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së paraqet indikacion të kufizuar për llojin e masave shtesë të kujdesit të shtuar që mund të aplikohen.

702. Ashtu siç është theksuar në analizën e KTh 5.8 më lart, nuk ka obligim të qartë ndaj bankave dhe institucioneve financiare për të aplikuar qasjen e bazuar në rrezik dhe, rrjedhimisht, ka pak udhëzime për nivelin e zbatimit të KDK-ve, veçanërisht, duke marrë parasysh se Ligji LPP/LFT çalon në zbatimin e masave të KDK-së.

703. Kështu, përveç mosekzistimit të kushtit ligjor për bankat dhe institucionet financiare lidhur me krijimin e procedurave të bazuara në rrezik për pranimin e konsumatorëve, mungesa e udhëzimeve për zbatimin e masave të KDK-së në bazë të ndjeshmërisë së rrezikut është shqetësim serioz për sektorin, dhe negativisht ndikon në efektshmërinë e sistemit.

704. Rekomandohet fuqimisht që përveç rekomandimit të bërë në kuadër të analizës së KTh 5.8 më lart për futjen e obligimit ndaj bankave dhe institucioneve financiare lidhur me respektimin e qasjes së bazuar në rrezik, që autoritetet po ashtu të krijojnë dhe të publikojnë udhëzime të efektshme për qasjen e bazuar në rrezik, duke dhënë praktikat më të mira për zhvillimin e metodologjive të rrezikut - udhëzuesi për referencat në praktikat më të mira i lëshuar nga FATF rekomandohet në këtë aspekt.

Koha e verifikimit – Kriteri thelbësor 5.13

705. KTh 5.13 parasheh që nga institucionet financiare duhet të kërkohet që të verifikojnë identitetin e konsumatorit para fillimit të marrëdhënies afariste pas gjatë saj ose gjatë kryerjes së transaksionit të rastit për konsumatorët e rastit.

706. Në nenin 18 të Ligjit LPP/LFT parashihet koha e verifikimit të identitetit të konsumatorit. Në bazë të nenit 18, verifikimi i identitetit të konsumatorit duhet të kryhet para:

- Hapjes së llogarisë;
- Marrjes së aksioneve, fletëobligacioneve apo letrave të tjera me vlerë;
- Dhënies së instrumenteve për deponim të sigurt;
- Krijimit të marrëdhënies afariste në ndonjë mënyrë tjetër ose
- Hyrjes në çfarë transaksioni në valutë prej më shumë se dhjetë mijë (10.000) euro. Transaksionet me valuta të shumëfishta trajtohen si transaksion i vetëm nëse banka apo institucioni financiar është në dijeni se transaksionet kryhen nga personi a entiteti ose në emër të tyre në shumë prej më shumë se dhjetë mijë (10000) euro në ditë.

707. Si Letra këshilluese, ashtu edhe Rregulla X e BQK-së nuk parashohin asgjë lidhur me kohën e procesit verifikimit dhe të identifikimit.

708. Neni 18 i Ligjit LPP/LFT në mënyrë të duhur mbulon dispozitën KTh 5.13. Pika e katërt *krijimi i marrëdhënies afariste në ndonjë mënyrë tjetër* duhet të interpretohet në kuptimin e saj më të gjerë për të mbuluar çfarë mënyre tjetër të ofrimit të shërbimit ndaj konsumatorit, e cila nuk është e specifikuar në kuadër të pikave ekzistuese.

709. Megjithatë, siç është shpjeguar më herët në kuadër të analizës për KTh 5.5 më lart, koncepti i pronarit përfitues dhe procesi pasues i identifikimit dhe verifikimit të pronarit përfitues gjithashtu mungon.

710. Andaj, është e këshillueshme që përveç rekomandimeve të bëra më lart për përfshirjen e masave të plota të KDK-së, koha e verifikimit dhe identifikimit të pronarit përfitues duhet gjithashtu të trajtohet – referojuni gjithashtu analizave në nenin 7b të direktivës së tretë të BE-së LPP.

Koha e verifikimit: Opsioni për plotësimin e procesit të verifikimit pas krijimit të marrëdhënies afariste – Kriteri thelbësor 5.14.

711. KTh 5.14 parasheh opsionin që institucionet financiare të kryejnë procesin e verifikimit pas krijimit të marrëdhënies afariste me kusht që:

- Kjo të ndodh sa më shpejt që kjo të jetë arsyeshmërisht praktike;
- Të jetë thelbësore për mosndërprerjen e rrjedhës normale të afarizmit;
- Që rreziqet nga pastrimi i parave të menaxhohen në mënyrë të efektshme.

712. Më tej, në Metodologji jepen shembuj kur mund të jetë thelbësore mosndërprerja e rrjedhës normale të afarizmit.

713. Ligji LPP/LFT drejtpërdrejtë nuk parasheh asgjë lidhur me këtë çështje. Në dispozitat e nenit 18 për kohën e verifikimit, siç është përkrahur më lart në analizën e KTh 5.13, një opsion i tillë duket se nuk është në dispozicion.

714. Dispozitat e nenit 18 të Ligjit LPP/LFT aktualisht mbulojnë kushtet e KTh 5.14.

715. Megjithatë, nëse autoritetet vendosin të miratojnë opsionin e lejimit të vazhdimin të marrëdhënieve afariste brenda kushteve të caktuara para procesit të verifikimit, këshillohet që kjo të bëhet në bazë të dispozitave të qarta ligjore dhe me udhëzime të duhura për sektorin me qëllim të shmangies së situatave ku ndërmerren transaksionet, të cilat më vonë mund të identifikohen si të dyshimta.

Koha e verifikimit: Procedurat e menaxhimit të rrezikut – Kriteri thelbësor 5.14.1

716. KTh 5.14.1 parasheh që institucionet financiare të miratojnë procedurat për menaxhimin e rrezikut, ku konsumatorit i lejohet të shfrytëzojë marrëdhënien afariste para procesit të verifikimit.

717. Aktualisht nuk parashihet që bankat apo institucionet financiare të kenë procedura për menaxhimin e rrezikut në mënyrë që t'ju lejohet konsumatorëve shfrytëzimi i marrëdhënieve afariste para procesit të verifikimit, pasi që situatat e tilla ndalohen sipas Ligjit LPP/LFT.

718. Megjithatë, nëse autoritetet vendosin të miratojnë këtë opsion, atëherë rekomandohet që ndryshimet përkatëse në ligj të sigurojnë ekzistimin e obligimit për bankat dhe institucionet financiare që të kenë procedura të duhura dhe të efektshme për menaxhimin e rrezikut, përmes të cilave do të përkufizoheshin kushtet, brenda së cilave një gjë e tillë mund të ndodh.

719. Këto procedura, të cilat duhet të miratohen nga autoriteti relevant kompetent, në mes të tjerash duhet të përfshijnë:

- Vlerësimin e rrezikut që mund të vjen nga konsumatori dhe menaxhimin e atij rreziku;
- Kohen brenda së cilës duhet të kryhet procesi i verifikimit;
- Procedurat që do të aplikohen nëse verifikimi nuk mund të kryhet brenda kohës së paraparë;
- Llojin e aktivitetit që konsumatori mund të lejohet të ndërmerë brenda kohës së paraparë për verifikim;
- Kthimin e transaksioneve në rast të përfundimit të marrëdhënies afariste (për shembull, nëse llogaria është hapur dhe nëse depozitat janë pranuar, mënyrat e kthimit të atyre parave pa pasur nevojë të ndihmës së institucioneve për *pastrimin* e tyre) dhe
- Objektivi për mosndërprerjen e rrjedhës normale të afarizmit (rekomandohet referenca në shembujt e dhënë në Metodologjinë e FATF-së).

Moszbatimi i procesit të kujdesit ndaj konsumatorit – Kriteri thelbësor 5.15

720. KTh 5.15 parasheh që në rastet kur institucioni financiar nuk mund të zbatojë masat e nevojshme të KDK-së, atëherë nuk duhet të lejohet të hap llogarinë, të fillojë marrëdhënien afariste apo të bëjë transaksion. Në këto rrethana nga institucioni financiar duhet të kërkohet të merr parasysh parashtrimin e RTD-së.

721. Neni 18(6) i Ligjit LPP/LFT parasheh që nëse banka apo institucioni financiar nuk është në gjendje të identifikojë klientin, marrëdhënia afariste duhet të përfundojë, çfarëdo llogarie të mbyllet dhe prona të kthehet në burimin e saj. Për më tepër, këto veprime do të jenë pa paragjykim ndaj obligimit të bankës apo institucionit financiar për të raportuar veprimet e ose transaksionet e dyshimta në pajtim me nenin 22(1) dhe për të raportuar informata materiale shtesë në pajtim me nenin 22 të Ligjit LPP/LFT.

722. Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së nuk parasheh asgjë në këtë drejtim.

723. Duke pasqyruar, deri në një masë, dispozitën e nenit 18(6) të Ligjit LPP/LFT, neni 6.5 i Rregullës X të BQK-së parasheh: *Në rastet kur banka apo institucioni financiar nuk është në gjendje të verifikojë identitetin e konsumatorit në përputhje me nenin 3.7 të Rregullores 2004/2, banka apo institucioni financiar refuzojnë transaksionin dhe marrin parasysh mundësinë e parashtrimit të Raportit për transaksion të dyshimtë, ashtu siç parashihet në nenin 3.9 të Rregullores 2004/2.*

724. Edhe pse duket se neni 18(6) mund të mbulojë kushtet për bankat dhe institucionet financiare në përputhje me KTh 5.15, ka dallime që ndikojnë dukshëm në zbatim.

725. KTh 5.15 i referohet mospërbushjes së obligimeve të kritereve esencial 5.3 – 5.6, ku parashihet:

- Identifikimi i konsumatorit dhe verifikimi i atij identifikimi nga burimi i pavarur dhe i besueshëm (KTh 5.3*);
- Për personat apo rregullimet juridike, verifikimin se personi që vepron në emër të personit juridik është i autorizuar për një gjë të tillë; identifikimin dhe verifikimin e atij përfaqësuesi; verifikimin e statusit juridik të personit juridik apo të rregullimit juridik (KTh 5.4);

- Identifikimin e pronarit përfitues dhe verifikimin e identitetit të tij; përcaktimi nëse aplikuesi është duke vepruar në emër të personit tjetër; identifikimin dhe verifikimin e palës së tretë, në emër të cilës aplikuesi është duke vepruar; të kuptuarit e strukturës së pronësisë dhe të kontrollit të personave a rregullimeve juridike, duke përfshirë edhe personat fizikë që mbajnë kontrollin kryesor (KTh 5.5) dhe
- Marrjen e informatave për qëllimin dhe natyrën e paraparë të marrëdhënies afariste (KTh 5.6).

726. Krahasuar me këtë, neni 18(6) parasheh që në rastet kur banka apo institucioni financiar *nuk është në gjendje të verifikojë identitetin e klientit*, duhet të ndërmer masat e parapara në KTh 5.15.

727. Për më tepër, neni 6.5 i Rregullës X të BQK-së ende i referohet Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2, e cila është shfuqizuar plotësisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit LPP/LFT dhe, rrjedhimisht, nuk është relevante për qëllime të këtij vlerësimi për KTh 5.15.

728. Dallimet e identifikuarra më lart janë prapë rezultat që Ligji LPP/LFT vetëm përcakton konceptin e KDK-së, por nuk e zbaton.

729. Andaj, fuqimisht rekomandohet që gjatë shqyrtimit të Ligjit LPP/LFT në kontekstin e zbatimit të masave të plota KDK përmes nenit 17, dispozitat e nenit 18(6) të shqyrtohen në mënyrë të duhur dhe të harmonizohen me kushtet e parapara në Standardet e FATF-së, duke iu referuar pikave përkatëse të procesit të KDK-së dhe jo vetëm procesit të verifikimit.

Moszbatimi i procesit të kujdesit ndaj konsumatorit në rastet kur marrëdhënia afariste ka filluar – Kriteri thelbësor 5.16

730. KTh 5.16 parasheh se në rastet kur marrëdhënia afariste tanimë ka filluar, nga institucionet financiare duhet të kërkohet të ndërpresin marrëdhënien afariste dhe të shqyrtojnë bërjen e RTD-së.

731. Siç është cekur më herët në KTh 5.14 më lart, Ligji LPP/LFT nuk parasheh asgjë lidhur me çështjen e lejimit të shfrytëzimit të marrëdhënies afariste para përfundimit të procesit të KDK-së (Ligji i referohet vetëm zbatimit të procesit të identifikimit dhe procesit të verifikimit) në mënyrë të drejtpërdrejtë, por përmes dispozitave të nenit 18 për kohën e verifikimit siç është përshkruar më poshtë në analizën të KTh 5.13, një opsion i tillë nuk është në dispozicion.

732. Megjithatë, neni 6.7 (Përfundimi i marrëdhënies me konsumatorë) i Rregullës X të BQK-së parasheh: *Nëse banka ose institucioni financiar nuk mund të plotësojë kujdesin e duhur për konsumatorë, përfundon marrëdhënien afariste me konsumatorin, dhe vendos nëse duhet të parashtrijë Raportin për transaksion të dyshimtë, ashtu siç parashihet në nenin 3.9 të Rregullores.*

733. Pasi Ligji LPP/LFT nuk lejon përdorimin e marrëdhënies afariste para përfundimit të procesit të verifikimit, duket se kushti i paraparë në KTh 5.16 mund të mos jetë i zbatueshëm.

734. Megjithatë, KTh 5.16 nuk duhet të interpretohet vetëm në situata, ku konsumatorit i lejohet të shfrytëzon marrëdhënien afariste para procesit të verifikimit (KTh 5.14), por edhe për situatat kur nuk ka dyshim për vërtetësinë dhe përshtatshmërinë e të dhënave identifikuese për konsumatorin (KTh 5.17).

735. Neni 6.7 i Rregullës X i BKQ duket se parasheh situata për konsumatorët ekzistues. Megjithatë, vlefshmëria e këtij neni, edhe për shkak të arsyeve të shpjeguara më lart në raport, është e debatueshme:

- I referohet përputhshmërisë me KDK-në e nevojshme për konsumatorin, kur Ligji LPP/LFT përcakton vetëm procesin e KDK-së, por nuk e zbaton plotësisht atë, ashtu siç bëhet përmes Rregullës X – duke bërë kështu që Rregulla X të parasheh obligime që shkojnë përtej Ligjit LPP/LFT pa pasur bazë ligjore për një gjë të tillë dhe
- Neni i referohet Rregullores së UNMIK-ut 2004/2, e cila është shfuqizuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit LPP/LFT, dhe rrjedhimisht mund të krijojë konflikt.

736. Kjo situatë prapë ngritet si pasojë e moszbatimit të plotë të procesit të plotë të KDK-së në bazë të Ligjit LPP/LFT, përkatësisht nenit 17 të tij.

737. Rrjedhimisht, rekomandohet që kjo çështje të rishikohet përkitazi me zbatimin e procesit të plotë të KDK-së përmes Ligjit LPP/LFT dhe me dispozitat e tjera relevante.

Zbatimi i procesit të kujdesit për konsumatorët ekzistues – Kriteri thelbësor 5.17

738. KTh 5.17 parasheh që institucionet financiare të zbatojnë kushtet e plota të KDK-së për konsumatorët ekzistues në bazë të materialitetit dhe rrezikut, si dhe të aplikojnë kujdesin e duhur ndaj atyre marrëdhënies në kohën e duhur.

739. Në bazë të Ligjit LPP/LFT nuk duket të ketë ndonjë obligim për bankat ose institucionet financiare që të zbatojnë kushtet KDK ndaj konsumatorëve ekzistues apo që të kenë kujdes ndaj atyre marrëdhënies ekzistuese afariste.

740. Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së gjithashtu nuk parasheh zbatimin e kushteve të KDK-së ndaj konsumatorëve ekzistues.

741. Megjithatë, neni 15.2 i Rregullës X së BQK-së parasheh *që për të gjitha marrëdhëniet ekzistuese të konsumatorëve deri në atë datë kur kjo rregull hyn në fuqi, bankat dhe institucionet financiare zbatojnë masat e kujdesit ndaj konsumatorëve, ashtu siç parashiheh në nenin 6, të 30 prillit 2007. BQK ka konfirmuar se kjo ka ndodhur.*

742. Zbatimi i kushteve të KDK-së nda konsumatorëve ekzistues, madje edhe në bazë të materialitetit dhe rrezikut, është i rëndësishëm për efektshmërinë e sistemit.

743. Edhe pse Ligji LPP/LFT nuk parasheh drejtpërdrejt që bankat ose institucionet financiare të zbatojnë plotësisht kushtet e KDK-së në rastin e konsumatorëve ekzistues, në Ligj kjo nuk përjashtohet. Kështu, sa herë që në Ligj ceket obligimi për bankat dhe institucionet financiare, për shembull, monitorimi i vazhdueshëm i marrëdhënies afariste, në Ligj nuk bëhet dallimi mes llogarive të reja dhe atyre ekzistuese.

744. Obligimi i paraparë në nenin 15.2 të Rregullës X mbulon këtë kusht, mirëpo vetëm deri në shkallën e aplikimit të nevojshëm sipas rregullës të kushteve KDK. Për më tepër, ky kusht i paraparë ka pasur afat dhe që nga data 30 prill 2007 nuk është më i vlefshëm.

745. Pavarësisht çështjes kryesore që në kuadër të Ligjit LPP/LFT nuk aplikohen kushtet e plota të KDK-së, edhe pse i përkufizon ato, kjo reflekton në përputhshmërinë me këtë kriter.

746. Rrjedhimisht rekomandohet që në kuadër të shqyrtimit të aplikacionit të zbatimit të plotë të masave KDK sipas nenit 17 të Ligjit LPP/LFT të përfshihet dispozita specifike për

zbatimin e vazhdueshëm të kushteve të KDK-së për konsumatorët ekzistues në bazë të materialitetit dhe rrezikut – me ç'rast ky obligim duhet të lidhet me qasjen e bazuar në rrezik.

Zbatimi i kujdesit të shtuar ndaj konsumatorëve për llogaritë ekzistuese anonime – Kriteri thelbësor 5.18

747. KTH 5.18 parasheh që institucionet financiare të ndërmarrin masa të plota KDK për llogaritë ekzistuese anonime.

748. Ligji LPP/LFT nuk parasheh një kusht të tillë. Ky kusht nuk parashihet as në Letrën këshilluese 2007/1 të BQK-së.

749. Rregulla X e BQK-së përfshinë (më 30 prill 2007) obligimin ndaj bankave dhe institucioneve financiare të ndërmarrin KDK të plota në përputhje me Rregullën (në Ligj nuk parashihet zbatimi i KDK-së, përveç për qëllime të identifikimit) për të gjitha marrëdhëniet ekzistuese afariste me konsumatorë, në interpretimin e saj të përgjithshëm, do të mund të përfshinte edhe llogaritë e përgjithshme.

750. BQK konsideron se nuk ka e as që ka pasur ndonjëherë llogari anonime, pasi që ato gjithmonë kanë qenë të ndaluara me ligj. Ligji LPP/KFT, përmes të cilit ndalohen llogaritë anonime, ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2010 dhe, përveç nëse ka qenë e ndaluar në mënyrë specifike përmes Rregullores tani të shfuqizuar të UNMIK-ut nr. 2004/2 – që nuk është rasti – bankat dhe institucionet financiare kanë mundur të kenë llogari të tilla.

751. Supozohet se nëse bankat dhe institucionet financiare kanë respektuar kushtet e parapara në nenin 15.2 të Rregullës X të BQK-së, atëherë çfarëdo llogarie anonime e mbajtur deri më 30 prill 2007 do të jetë shndërruar në llogari në emër. Periudha mes prillit 2007 dhe shtatorit 2010 mbetet e pambuluar nga çfarëdo obligimi për ndërmarrjen e masave të KDK-së ndaj çfarëdo llogarie ekzistuese anonime.

752. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë këshillohet që pas ndryshimit të Ligjit LPP/LFT të përfshihen dispozitat për zbatimin e masave të plota të KDK-së gjithashtu edhe për llogaritë ekzistuese anonime.⁹⁶

Qëndrimi lidhur me librezat bankare në emrat fiktivë – neni 6 i Direktivës së tretë i LPP

753. Neni 6 i Direktivës së tretë të BE-së për LPP ua ndalon institucioneve financiare të mbajnë llogari anonime në librezat bankare dhe kërkon nga këto institucione të ndërmarrin masa të plota KDK ndaj pronarëve të atyre llogarive dhe librezave. Neni 6 i Direktivës së tretë të BE-së për KShL nuk ndalon llogaritë në emra fiktivë⁹⁷, por parasheh që të gjitha llogaritë t'i nënshtrohen masave të KDK-së.

754. Ligji LPP/LFT ndalon llogaritë anonime, por nuk ndalon llogaritë në emra fiktivë, të cilët me rregull i nënshtrohen masave KDK.

⁹⁶ Projektligji për ndryshimin e Ligjit për LPP/LFT parasheh disa dispozita në këtë drejtim.

⁹⁷ Llogaritë në emra fiktivë mund të jenë të ngjashme me llogaritë në numra, por mbajnë emra fiktivë dhe jo numër të parackatuar. Llogaritë në numra identifikohen lehtë dhe lejohen sipas standardeve të BE-së dhe atyre të FATF-së me kusht që masat e plota të kujdesit të shtuar të zbatohen në mënyrë të duhur. Llogaritë në numra kryesisht përdoren për punët private bankare dhe duhet t'i nënshtrohen monitorimit si nga institucioni, ashtu edhe nga autoritetet mbikëqyrëse.

755. Çështja e librezave bankare në emra fiktivë trajtohet në kuadër të analizës së KTh 5.1 më lartë lidhur me llogaritë anonime të këtij Raporti.

Pragu për transaksionet e rastit – neni 7b i Direktivës së tretë të BE LPP/KFT

756. Duke marrë parasysh se në bazë të standardeve të FATF-së nga institucionet financiare kërkohet të ndërmarrin masa të plota të KDK-së për transaksionet e rastit *mbi* pragun e paraparë, neni 7b i Direktivës së tretë të BE LPP/KFT parasheh këtë obligim për transaksionet e ndërlidhura që janë të barabarta me pragun e paraparë prej 15.000 euro apo më shumë.

757. Neni 17(2) i LPP/LFT parasheh zbatimin e procedurave të identifikimit (Ligji nuk parasheh zbatimin e masave të plota të KDK-së) për transaksionet e rastit apo transaksionet e ndërlidhura në shumë prej 10,000 euro apo më shumë. Më tej, në nen parashihet që *nëse shuma e transaksionit nuk është e njohur në kohën e operacionit, identifikimi do të bëhet sapo që shuma të bëhet e njohur apo sapo që pragu të arrihet.*

758. Neni 18 i Ligjit LPP/LFT parasheh identifikimin e të dhënave identifikuese për konsumatorin para hyrjes në çfarëdo transaksioni në valutë prej më shumë se dhjetë mijë (10.000) euro. Transaksionet me valuta të shumta trajtohen si transaksion i vetëm nëse banka ose institucioni financiar ka njohuri që transaksionet zbatohen nga personi apo në emër të tij ose të entitetit në shumë e përgjithshme prej më shumë se dhjetë mijë (10,000) euro në ditë.

759. Letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulla X e BQK-së nuk shton udhëzime materiale në dispozitat e nenit 17 dhe nenit 18 të Ligjit LPP/LFT në këtë drejtim.

760. Edhe pse, së paku në masën e identifikimit të konsumatorit dhe verifikimit të atij identifikimi, Ligji LPP/LFT duket se mbulon si standardet e FATF-së, ashtu edhe Direktivën e tretë të BE-së LPP, pasi që Ligji parasheh nivelin e ulët të pragut prej 10,000 euro, krahasuar me pragun e FATF-së dhe me të BE-së prej 15,000 euro, ekziston një mospërputhje mes nenit 17 (identifikimi) dhe nenit (verifikimi) të Ligjit.

761. Neni 17 parasheh obligimin për identifikim të transaksioneve të rastit apo të transaksioneve të ndërlidhura *që janë të barabarta me dhjetë mijë (10,000) euro apo më shumë*, ndërsa neni 18 i Ligjit parasheh obligimin për verifikim për transaksionet e rastit apo transaksionet e ndërlidhura në *shumë* prej më shumë se 10,000 euro. Kjo krijon anomali për atë nëse procesi i identifikimit për transaksionet e rastit që janë të *barabarta* me 10,000 euro duhet të pasohet me procesin e verifikimit.

762. Për më tepër, neni 17 parasheh obligimin për identifikim të transaksioneve të ndërlidhura të rastit ku shuma totale nuk dihet dhe *sapo që shuma të bëhet e ditur apo që pragu të arrihet*. Në anën tjetër, neni 18 parasheh obligimin për verifikim të transaksioneve të ndërlidhura të rastit në emër të një personi apo entiteti nëse të njëjtat arrijnë shumën *totale prej më shumë se dhjetë mijë (10,000) euro në një ditë*. Ndërsa obligimi për identifikim mund të parashihet edhe nëse shuma e transaksioneve tejkalohet brenda një dite të vetme.

763. Këto anomali do të kishin pasoja edhe më të larta në aplikimin e masave të plota KDK siç është rekomanduar.

764. Prandaj është e këshillueshme që të dyja dispozitat e nenit 17 dhe të nenit 18 të harmonizohen meqenëse procesi i identifikimit është sinonim me procesin e verifikimit në kuadër të rishikimit të rekomanduar të Ligjit për aplikimin e plotë të KDK. Çdo periudhë për matjen e transaksioneve të ndërlidhura mund të përcaktohet me rregullore që e udhëzon industrinë për zbatimin e procesit të KDK - ju lutem referojuni edhe te analiza e KTh 5.13.

Përkufizimi i pronarit përfitues – Direktiva e tretë e BE-së kundër pastrimit të parave, neni 3(6)

765. Ndonëse përkufizimet e pronarit përfitues në fjalorthin FATF dhe në Direktivën e tretë të BE-së kundër pastrimit të parave janë të njëjta, kjo e fundit jep më shumë informata të detajuara për pronarin përfitues në rast të personave juridikë kryesisht përmes caktimit të një pragu të përqindjes së aksioneve prej 25% plus një aksion/hise. Direktiva e tretë e BE-së LPP e përkufizon më tej se pronari përfitues në kontesktin e aranzhimit juridik si fondacione apo truste.

766. Siç është përkufizuar në analizën për KTh 5.5* përkufizimi i pronarit përfitues në Ligjin LPP/LFT është shumë i ngjashëm me atë të FATF, por nuk i përmbanë kriteret shtesë për Direktivën e tretë të BE-së LPP – luteni t'i referoheni analizës së KTh 5.5 më lart për analizë më të detajuar.

767. Në diskutimet me institucionet përkatëse janë shprehur shqetësime rreth vështirësive që hasen në përmbushjen e detyrimeve lidhur me pronarin përfitues. Një nga shqetësimet e shprehura kishte të bënte me përkufizimin e pronarit përfitues, i cili nuk e përmbanë ndonjë prag, ashtu siç parashihet në Direktivën e tretë të BE-së LPP.

768. Ndonëse përfshirja e një pragu duket se jep garanci, prapë se prapë ai sjell me vete detyrime shtesë. Caktimi i një pragu – të themi 25% plus një aksion/pjesë në kapital – nënkupton se institucionet financiare do të duhet t'i identifikonin të gjitha personat që mbajnë 25% plus një aksion/pjesë në kapital. Gjithashtu, nëse personi i tillë nuk ekziston, institucionet financiare do të duhet ta identifikojnë personin fizik, i cili përndryshe ushtron kontrol mbi menaxhimin e entitetit juridik.

769. Përkufizimi i pronarit përfitues në Ligjin LPP/LFT nuk përmbanë zgjerim të konceptit të pronarit përfitues për aranzhimet juridike, siç janë trustet apo fondacionet, siç përkufizohen në Direktivën e tretë të BE-së LPP.

770. Pa i paragjykuar dhe në vijim të rekomandimeve të bëra në analizën e KTh 5.5 në këtë raport, rekomandohet që të merren parasysh:

- Përfshirja e një kufiri për identifikimin e pronarit përfitues për personat juridikë;
- Zgjerimin e përkufizimit të pronarit përfitues për pronarin përfitues të aranzhimeve juridike në përputhje me dispozitat e Direktivës së tretë të BE-së LPP dhe meqë aranzhimet juridike njihen me ligjet e Kosovës;
- Sigurimi i udhëzimeve adekuate dhe të përshtatshme me shkrim për industrinë rreth aplikimit të masave KDK për pronarët përfitues.

Efektshmëria (në përgjithësi për Rekomandimin 5)

771. Në këtë Raport janë paraqitur shqetësime të rënda rreth efektshmërisë së sistemit për kujdesin e duhur ndaj konsumatorit. Së pari për shkak se Ligji LPP/LFT e përmbanë vetëm një përkufizim të konceptit, por nuk e rregullon zbatimin e tij të plotë. Së dyti, për shkak se dallimet mes Ligjit dhe rregullave të nxjerra nga BQK-ja, edhe pse dispozitat e Rregullit X të BQK në lidhje me këtë janë më të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, dhe së fundmi për shkak se industria rrjedhimisht e siguron interpretimin e vet për zbatimin e këtij koncepti.

772. Efektshmëria e sistemit ndikohet negativisht edhe përmes konflikteve të koordinimit të zbatimit të procesit për identifikimin e konsumatorit dhe të procesit të verifikimit. Kjo ndikohet më tej nga dobësitë e identifikuar aty ku ka dështim për kompletimin e procesit të identifikimit.

773. Gjithashtu, dobësia e identifikuar për zbatimin e duhur të nocionit të pronarit përfitues dhe shqetësimet e ngritura nga institucionet lidhur me këtë çështje i kontribuojnë më tej shqetësimeve rreth efektshmërisë.

774. Gjithashtu, efektshmëria e sistemit ndikohet negativisht edhe përmes mungesës së udhëzimeve, kërkesave dhe dobësive të identifikuara për zbatimin e një qasjeje të bazuar në rrezik.

3.2.2. Rekomandimet dhe komentet (në përgjithësi për Rekomandimin 5 të FATF)

775. Siç mund të shihet prej analizës sipër të kriterit esencial për rekomandimin 5, Ligji LPP/LFT, letra këshillëdhënëse 2007/1 dhe rregulli X i BQK-së lënë një numër zbrazëtirash, që, në kombinim me shqetësimet e shprehura nga industria për zbatimin e detyrimeve të tyre në disa fusha specifike, ka pasoja negative për efektshmërinë e sistemit parandalues për procesit të kujdesit të shtuar ndaj konsumatorit.

776. Në këtë Raport shprehen shqetësimet rreth vlefshmërisë së Letrës këshilluese 2007/1 dhe Rregullit X të BQK-së në kontekstin se Rregullorja e UNMIK-it 2004/2 është shfuqizuar plotësisht me hyrjen në fuqi të Ligji LPP/LFT, ndërsa Rregulloret e UNMIK-ut 1999/21 dhe 2008/28 janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit për banka, duke i lënë rregullat apo rregulloret e nxjerra aty të vlefshme me kusht që ato të mos bien ndesh me Ligjin. Letra këshilluese dhe Rregulli X ende i referohen në mënyrë specifike të gjitha këtyre rregulloreve pavarësisht pozitës së tyre sipas ligjit⁹⁸.

777. Në këtë raport gjithashtu shprehet shqetësimi lidhur me përfkufizimet e ‘institucionit financiar’ në ligjet përkatëse, të cilat dallojnë në disa raste.

778. Në këtë raport theksohet se duhet të adresohet shpërndarja dhe aplikimi i listës së Kombeve të Bashkuara dhe i listave të tjera të personave dhe entiteteve të përcaktuara.

779. Zbrazëtitrat apo dobësitë e identifikuara në legjislacion dhe sistem ashtu siç aplikohen kryesisht përqëndrohen në:

- Moszbatimin e masave të kujdesit të shtuar ndaj konsumatorit në Ligjin LPP/LFT në krahasim me zbatimin e procedurave të identifikimit dhe verifikimit – me pasoja të rënda mbi disa dispozita të tjera të Ligjit LPP/LFT (KTh 5.1);
- Mosndalimin e mbajtjes së llogarive me emra fiktivë (KTh 5.1 dhe EUD neni 6);
- Qartësinë lidhur me kohën se kur nevojitet kujdesi i shtuar ndaj konsumatorit (KTh 5.2);
- Nevojën për rafinimin e procesit të verifikimit (KTh 5.3 dhe KTh 5.4);
- Fuqizimin dhe qartësinë juridike për obligimet lidhur me identifikimin e pronarit përfitues (KTh 5.5 dhe EUD neni 3(6));
- Fuqizimin e kushtit për të identifikuar pronësinë dhe kontrolluar strukturën e personave juridikë (KE5.5.2)
- Fuqizimin e detyrimit për të përcaktuar qëllimin dhe natyrën e synuar të raportit afarist (KTh 5.6);

⁹⁸ BQK ka ka njoftuar se është në proces t[ri] rishikimit dhe përditësimit të Rregullit X dhe të Letrës këshilluese 2007/1 pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Ligjin LPP/LFT.

- Mosdetyrimin për kujdesin e shtuar të vazhdueshëm ndaj raporteve afariste (KTh 5.7 dhe 5.7.1/5.7.2);
- Mungesën e qasjes së bazuar në rrezik (KTh 5.8);
- Mungesën e udhëzimit rreth qasjes së bazuar në rrezik (KTh 5.12)
- Caktimin e kohës së verifikimit për pronarët përfitues (KTh 5.13 dhe EUD neni 7(b));
- Mospërmbushjen e kujdesit të shtuar ndaj konsumatorit (KTh 5.15);
- Mosaplikimin e kujdesit të shtuar ndaj konsumatorit (KTh 5.16) dhe
- Aplikimin e kujdesit të shtuar ndaj konsumatorëve ekzistues (KTh 5.17).

780. Duke i pasur parasysh zbarëzitat e ndryshme të identifikuar dhe të cilat janë paraqitur në hollësi më lart, nënpjesët e Raportit që gjinden më lart përmbajnë rekomandime të hollësishme për pëmirësimin e legjislacionit, dhe rrjedhimisht të sistemit që janë dhënë në analizën përkatëse të KTh-së.

781. Është mirë nëse rekomandimet lexohen përmes kontekstit të analizës përkatëse të KTH-së dhe brenda atij konteksti. Megjithatë rekomandimet kryesore janë të përqëndruara në:

- Një shqyrtim të Rregullit X⁹⁹, duke përfshirë Letrën këshilluese 2007/1, të BQK-së brenda kontekstit të legjislacionit të ri dhe shfuqizimit të Rregulloreve të UNMIK-ut;
- Harmonizimin e përkufizimit të ‘institucionit financiar’ në ligjet dhe rregulloret përkatëse për qëllime të harmonizimit;
- obligimi ligjor për aplikimin e masave të plotë për kujdes të shtuar ndaj konsumatorëve, siç përcaktohet në Ligjin LPP/LFT krahasuar me zbatimin e identifikimit dhe verifikimit që vetëm përbëjnë një komponent të konceptit të kujdesit të shtuar ndaj konsumatorëve;
- Një shqyrtim të shpërndarjes dhe aplikimit të listës së Kombeve të Bashkuara dhe listave të tjera të personave dhe entiteteve të përcaktuara;
- Një shqyrtim të përgjithshëm të Ligjit LPP/LFT në fusha specifike që ndërliken me kujdesin e duhur të shtuar dhe të ulur ndaj klientit brenda kontekstit të zbatimit dhe udhëzimit në qasjen e bazuar në rrezik dhe harmonizimin e dispozitave, siç përcaktohet në kriteret përkatëse esenciale.

3.2.3. Vlerësimi për Rekomandimin 5

	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve të vlerësimit
Rek. 5	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka detyrim ligjor për aplikimin e masave të plota të kujdesit të duhura ndaj konsumatorit; • Nuk ka ndalim të shprehur qartë për mbajtjen e llogarive me emra fiktivë; • Pragu i paqartë rreth transfereve elektronike; • Kur dyshimet ngriten rreth vërtetësisë apo përshtatshmërisë së të dhënave identifikuese të klientit të cilat janë marrë më parë, vlen vetëm për transaksionet e caktuara; • Detyrimi i pamjaftuar ligjor për ta identifikuar pronaritn përfitues; • Fuqizimi i detyrimit për të kuptuar pronësinë dhe strukturën

⁹⁹ Banka Qendrore ka deklaruar se e ka shqyrtuar Rregullin X, por që ai nuk do të hyjë në fuqi në pritje të ndryshimeve legjislative të Ligjit themelor LPP/LFT.

	Vlerësi mi	Përmbledhje e faktorëve të vlerësimit
		kontrolluese të konsumatorit; <ul style="list-style-type: none"> • Fuqizimi i detyrimit për ta kuptuar qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies afariste; • Fuqizimi i detyrimit për të ushtruar monitorim të vazhdueshëm mes Raportit dhe transaksionit në të gjitha rrethanat përtej konsumatorëve të rrezikut të lartë; • Fuqizimi i detyrimit të institucioneve financiare për ta zbatuar qasjen e bazuar në rrezik; • Mungesa e udhëzimeve rreth zbatimit të një qasje të bazuar në rrezik; • Mospërputhjet për sa i përket afateve kohore të procesit të verifikimit kundrejt afateve kohore të procesit të identifikimit; • Mospërmbushja e procesit të kujdesit të duhur ndaj konsumatorëve vlen vetëm për procesin e verifikimit; • Mospërmbushja e kujdesit të duhur ndaj konsumatorëve ku marrëdhënia afariste ekziston nuk është e mbuluar siç duhet; • Detyrimi për ta zbatuar kujdesin e duhur ndaj konsumatorëve ekzistuesë ka datë dhe parashihet vetëm në rregullin X në lidhje me rregulloret e shfuqizuara të UNMIK-ut; • Shpërndarja dhe aplikimi më i mirë i listave të personave të përcaktuar dhe • Çështjet e efektshmërisë për sa i përket fushëveprimit dhe nivelit të aplikimit të kujdesit të duhur ndaj konsumatorëve, identifikimit të pronarit përfitues dhe zbatimit të qasjes së bazuar në rrezik

3.3. Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP) (R.6)

3.3.1. Përshkrimi dhe analiza

782. Fjalorthi i FATF për metodologjinë i përkufizon PEP si individë kanë apo që kanë pasur funksione të larta publike në ndonjë shtet të huaj, për shembull, udhëheqësit e shtetit apo të qeverisë, politikanët e lartë, zyrtarët e lartë qeveritarë, gjyqësorë apo ushtarakë, ekzekutivët e lartë të korporatave shtetërore, zyrtarët e rëndësishëm të partive politike. Raportet afariste me anëtarët e familjes apo bashkëpunëtorët e afërt të PEP përfshijnë rreziqe reputacioni ngjashëm me ato të vet PEP-ve. Përkufizimi nuk ka për qëllim t'i mbulojë individët e rangut të mesëm apo individët më të ri në kategoritë e mëparshme.

783. Direktiva e tretë e BE-së LPP i përkufizon PEP si persona fizikë që u janë besuar funksione të larta publike dhe anëtarët e familjes së afërt apo personat që njihen si bashkëpunëtorë të afërt të këtyre personave.

784. Direktiva zbatuese e Komisionit të BE-së¹⁰⁰ parasheh udhëzime të mëtejme për sa i përket përkufizimit të PEP, duke e përkufizuar 'funksionin publik të lartë' me terme të ngjashme me standardin FATF dhe duke e përfshirë rangun e mesëm dhe zyrtarët më të ri

¹⁰⁰ Direktiva e Komisionit 2006/70/EC e datës 1 gusht 2006 që përcakton masat zbatuese për Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me përkufizimin e "personave të ekspozuar politikisht" dhe kriteret teknike për procedura të thjeshtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit, si dhe për përjashtimin mbi bazën e një aktiviteti financiar të bërë sipas rastit apo në raste shumë të kufizuara. GZ L 214, 04.08.2006, fq. 29-34.

për qëllime të përkufizimit. Ajo gjithashtu parasheh udhëzime për përkufizimin e asaj se kush përbënë ‘anëtarët e familjes së afërt’ dhe ‘personat që njihen si bashkëpunëtorë të afërt’.

785. Paragrafi (1.26) i nenit 2 të Ligjit LPP/LFT e përkufizon PEP *si çdo person të cilit i është besuar funksioni lartë publik në çfarëdo shteti, si dhe anëtarët e familjet së këtij personi apo ata që kanë lidhje të afërta me të.*

786. Letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulli X i BQK-së nuk i japin udhëzime shtesë interpretimit të përkufizimit të PEP.

787. Ndonëse përkufizimi i PEP në Ligjin LPP/LFT është shumë afër me atë të FATF dhe Direktivës së BE-së, prap se prapë përkufizimi është i mangët në dhënien e një përkufizimi apo udhëzimi lidhur me atë se çka përbëjnë ‘funksioni i lartë publik’, ‘anëtarët e familjes së këtij personi’ dhe ‘ata që janë për së afërmi të ndërlidhur me atë’.

788. Dhënia e udhëzimit rreth këtyre përkufizimeve institucioineve përkatëse, të cilat kanë shprehur shqetësime rreth përkufizimit të duhur dhe procedurave të zbatimit në përgjithësi, do të ishte hap në drejtimin e duhur për një zbatim efektiv të këtij detyrimi.

789. Andaj rekomandohet që përkufizimi PEP të rishikohet për të përfshirë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt apo përmes udhëzimit nga autoritetet përkatëse, përkufizime të zgjeruara për interpretimin e duhur dhe konsistent të ‘funksionit të lartë publik’, ‘familjarëve të këtij personi’ dhe ‘atyre që kanë lidhje të afërt me atë’.

790. Gjithashtu, përkufizimi në Ligjin LPP/LFT nuk e përjashton rangun e mesëm dhe zyrtarët e ri nga qëllimet e vlefshmërisë së përkufizimit.

791. Përveç nëse ka arsye specifike që përkufizimi në Ligjin LPP/LFT ta mbulojë edhe rankun e mesëm dhe zyrtarët më të rinjë, në cilin rast do të ishte më e duhur që ata të përfhisheshin në mënyrë më specifike, autoritetet mund ta shqyrtojnë ndryshimin e përkufizimit sipas nevojës.

792. Gjithashtu, ndonëse përkufizimi i PEP i referohet *një personi që i është besuar funksioni i lartë publik në çfarëdo shteti*, neni 21 i Ligjit LPP/LFT e shqipton kujdesin e duhur të shtuar dhe monitorimin e shtuar të PEP *që jetojnë jashtë Kosovës*. Rrjedhimisht, kujdesi i duhur i shtuar dhe monitorimi i shtuar nuk do të vlenin në të gjitha rrethanat kur ndonjë personi i është besuar funksioni publik brenda Kosovës apo në ndonjë shtet tjetër, por që jeton në Kosovë – shih analizën e Kriterit shtesë 6.5 më poshtë.

Sistemet e duhura të menaxhimit të rrezikut – Kriteri thelbësor 6.1

793. Me KTh 6.1 kërkohet që institucionet financiare të kenë sisteme të menaxhimit të rrezikut për të përcaktuar nëse ndonjë konsumator potencial apo ndonjë konsumator a pronar përfitues është PEP.

794. Siç është shpjeguar në analizën e KTh 5.8 në këtë raport Ligji LPP/LFT nuk e parasheh detyrimin që bankat dhe institucionet financiare të zhvillojnë procedura të ndjeshme ndaj rrezikut dhe kështu që të aplikojnë qasje të bazuar në rrezik ndaj konsumatorëve të tyre. Megjithatë, e rëndësishme për KTh 6.1 është dispozita në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT e cila kërkon se për sa i përket transaksioneve, marrëdhënieve apo shërbimeve që iu ofrohen PEP që jetojnë jashtë Kosovës, tema e Raportimit duhet të jetë procedura të duhura të bazuara në rreziqe për të përcaktuar nëse konsumatori është PEP.

795. Ndonëse letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulli X i BQK-së iu referohen PEP që paraqesin rrezik më të lartë, ato nuk e parashohin apo nuk kërkojnë nga bankat dhe

institucionet financiare që të kenë sisteme të menaxhimit të rrezikut për përcaktimin e statusit PEP të konsumatorëve.

796. Mungesa e dispozitave dhe e udhëzimeve rreth qasjes së bazuar në rrezik ka pasoja të gjëra mbi zbatimin efektiv të sistemit. Në të vërtetë vet institucionet dhe organizatat kanë shprehur shqetësime rreth udhëzimeve në këtë aspekt.

797. Duket se referenca e vetme që bankat dhe institucionet financiare të kenë sisteme të menaxhimit të rrezikut për përcaktimin e rrezikut të ndonjë konsumatori gjinden vetëm në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT dhe kjo vetëm duke iu referuar PEP, duke iu referuar kështu detyrimeve në KTh 6.1.

798. Pavarësisht kësaj, duhet të theksohet se dispozitat në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT vlejné vetëm për konsumatorët potencialë, me mundësi që të shtrihen edhe për konsumatorët aktualë, dhe në situatat kur personi jeton jashtë Kosovës – duke e pasur parasysh se përkufizimi i PEP i referohet ‘cilitdo shtet’.¹⁰¹ Megjithatë, këto dispozita nuk i mbulojnë pronarët përfitues dhe aplikohen vetëm në rrethana të kujdesit të duhur të shtuar.

799. Andaj, rekomandohet që në një shqyrtim të Ligjit LPP/LFT të futen masat e duhura për qasjen e bazuar në rrezik sipas rekomandimit në analizën e KTh 5.8 në këtë raport, dhe duke i përfshirë udhëzimet pasuese për zbatimin, duhet të mirren parasysh që këto masa të identifikojnë nëse ndonjë konsumator potencial apo ndonjë konsumator a pronar përfitues është PEP si pjesë e qasjes së bazuar në rrezik dhe jashtë procedurave të kujdesit të duhur të shtuar për t’u aplikuar për konsumatorët e rrezikut të lartë.

Miratimi i menaxhmentit të lartë për marrëdhëniet afariste të PEP – Kriteri thelbësor 6.2

800. Në KTh 6.2 kërkohet që institucionet financiare të marrin miratimin e menaxhmentit të lartë për krijimin e marrëdhënieve afariste me ndonjë PEP. Standardi FATF nuk e përkufizon ‘menaxhmentin e lartë’ për këtë qëllim.

801. Në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT kërkohet që bankat dhe institucionet financiare ta marrin miratimin e drejtorit të përgjithshëm, të caktuarit të tij apo të ndonjë punonjësi që kryenë funksion të barazvlefshëm para krijimit të marrëdhënieve afariste me ndonjë PEP që jeton jashtë Kosovës.

802. Ndonëse Letra këshilluese 2007/1 nuk e trajton këtë çështje, Rregulli X i BQK-së parasheh detyrime më të përgjithshme në atë se *një bankë apo institucion financiar nuk duhet të fillojë apo të mbajë marrëdhënie afariste me ndonjë konsumator të rrezikut të lartë, përveç nëse ndonjë anëtar i lartë i menaxhmentit të bankës apo të institucionit financiar e ka dhënë miratimin me shkrim.*

803. Për qëllimet e KTh 6.2, kushtet duken të jenë përmbushur në mënyrën e duhur përmes nenit 21 të Ligjit LPP/LFT dhe Rregullit X të BQK-së.

Vazhdimësia e marrëdhënies afariste me PEP – Kriteri thelbësor 6.2.1

804. Në KTh 6.2.1 parashihet që miratimi i menaxhmentit të lartë të mirret për vazhdimësinë e marrëdhënieve afariste kur konsumatori është pranuar dhe kur konsumatori apo pronari përfitues më vonë vërtetohet se është PEP ose më vonë bëhet PEP.

¹⁰¹ Për përkufizimin e PEP, në lidhje me termin ‘çfarëdo shteti’, Letra këshilluese 2007/1 thekson se *Në përputhje me Rekomandimin 6 FATF, AQBK-ja mund të zgjedhë për ta mbajtur këtë kusht vetëm për PEP të huaj apo për ta zbatuar atë edhe për PEP të brendshëm.*

805. Siç u tha në hollësi në analizën paraprake, neni 21 i Ligjit LPP/LFT parasheh miratimin e menaxhmentit të lartë para krijimit të marrëdhënieve afariste me ndonjë PEP që jeton jashtë Kosovës. Përndryshe, Ligji nuk i trajton masat që duhet të ndërmerren kur konsumatori është pranuar.

806. Dispozitat e nenit 21 siç u tha më lartë zbatohen vetëm para se banka apo institucini financiar të fillojë marrëdhënie me personin, i cili identifikohet si person me status PEP.

807. Rrjedhimisht, nuk ka detyrim që të aplikohen procedurat e njëjta për marrjen e miratimit të menaxhmentit të lartë lidhur me vazhdimin e marrëdhënies afariste nëse konsumatori ose pronari përfitues vërtetohet se është PEP apo bëhet PEP.

808. Gjithashtu, detyrimi nuk vlen në radhë të parë për pronarët përfitues. Ligji LPP/LFT nuk i parasheh vlerësimet e vazhdueshme lidhur me atë nëse ndonjë konsumator është bërë me status të PEP, por vetëm kërkon monitorim të vazhdueshëm të shtuar kur konsumatori është identifikuar si PEP.

809. Andaj, në vijim të rekomandimeve lidhur me analizën e KTh 6.1 më lartë është me rëndësi që çdo dispozitë që futet në Ligj për identifikimin e statusit PEP të ndonjë konsumatori potencial, të ndonjë konsumatori ekzistues apo të ndonjë pronari përfitues dhe zbatimi i masave të duhura të shtuara të zgjerohet vazhdimisht për të identifikuar nëse ndonjë konsumator apo pronar përfitues në ndërkohë e ka marrë statusin PEP dhe për të aplikuar masat e parashikuara për këto rrethana.

Burimi i pasurisë dhe burimi i fondeve – Kriteri thelbësor 6.3

810. KTh 6.3 kërkon që një pjesë e masave për kujdes të duhur të shtuar që duhet të zbatohen ndaj personit, i cili identifikohet të jetë me status PEP, është që institucionet financiare të ndërmarrin masa të arsyeshme për të vërtetuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve.

811. Neni 21 i Ligjit LPP/LFT parasheh që për sa i përket transaksioneve, relacioneve apo shërbimeve që u jepen PEP-ve që jetojnë jashtë Kosovës, bankat dhe institucionet financiare t'i ndërmarrin masat adekuate për ta vërtetuar prejardhjen e aseteve dhe fondeve që përdoren në marrëdhëniet afariste dhe transaksionet.

812. Gjithashtu, për trajtimin e aplikimit të kujdesit të duhur të shtuar ndaj konsumatorëve për konsumatorët e rrezikut të lartë, Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së parasheh masa të tjera që duhet të aplikohen përveç shqyrtimit të burimit të pasurisë dhe burimit të fondeve të konsumatorit. Kjo është pasqyruar edhe në Rregullin X të BQK-së.

813. Edhe pse neni 21 i Ligjit LPP/LFT si dhe dispozitat e Letrës këshilluese 2007/1 të BQK-së duket se i kanë mbuluar obligimet sipas KTh 6.3, ekziston një mangësi e vogël në Ligj, e cila më pas është eliminuar përmes Letrës këshilluese.

814. Fillimisht duhet të cekët se KTh 6.3 parasheh që të ndërmerren dy masa. Së pari, duhet të ndërmerret masa e vërtetimit të burimit të pasurisë, të cilën e posedon klienti dhe të cilën mund ta këtë grumbulluar gjatë viteve. Së dyti, është burimi i fondeve që zbatohet ndaj të parës dhe transaksionet pasuese të ndërmarrja nga klienti brenda statusit të vet si PEP.

815. Fjalët “prejardhja e aseteve dhe fondet e përdorura në marrëdhënie ose transaksion” në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT mund të i nënshtrohen interpretimit sa i përket asaj se a po i

referohen burimit të pasurisë së grumbulluar ose burimit të fondeve që do të vërtetojnë marrëdhënien dhe transaksionet.¹⁰²

816. Prandaj, rekomandohet që teksti i nenit 21 të i Ligjit LPP/LFT të rishikohet në përputhje me atë që është përdorur në Letrës Këshilluese dhe Rregullën X të BQK-së për hir të përputhshmërisë në mënyrë që të mos ketë paqartësi për institucionet dhe organizatat përkatëse.

Monitorimi i shtuar në vazhdimësi i marrëdhënies së PPE- Kriteri thelbësor 6.4

817. KTh 6.4 kërkon prej institucioneve financiare që për marrëdhëniet të ndërmarrin monitorim të shtuar në vazhdimësi. Përderisa nuk është siguruar udhëzimi se çka nënkupton “monitorimi i shtuar në vazhdimësi” kjo kuptohet që për shembull i referohet monitorimit më të shpeshtë të llogarive dhe transaksioneve; përditësimit më të shpeshtë të informatave të KDK-së; vlerësimit më të shpeshtë të profilit të klientit dhe të ngjashme.

818. Neni 21 i Ligjit LPP/LFT parasheh që sa i përket transaksioneve, marrëdhënieve ose shërbimeve të siguruar ndaj PEP që banojnë jashtë Kosovës, bankat dhe institucionet financiare të sigurojnë monitorim të fortë dhe të vazhdueshëm mbi marrëdhënien bankare ose veprimin e menjëhershëm.

819. Në nenin 7 të Rregullës X të BQK-së parashihet që: *Bankat dhe institucionet financiare duhet të aplikojnë monitorim të intensifikuar për konsumatorët, të cilët paraqesin një rrezik më të lartë. Çdo bankë dhe institucion financiar duhet të caktojë treguesit kryesor për llogari të tilla, duke marrë shënime për historinë e konsumatorit, siç janë: vendi, prejardhja dhe burimi i fondeve, lloji i transaksionit dhe faktorët e tjerë të rrezikut, siç janë dhënë në paragrafin 6 të kësaj Rregulle.*

820. Neni 21 i Ligjit LPP/LFT duket së në mënyrë të duhur i mbulon kërkesat e parapara në KTh 6.4.

821. Megjithatë, institucionet dhe organizatat përkatëse dhe, rrjedhimisht, efektiviteti i sistemit, do të përfitonin nga udhëzimet për zbatimin e monitorimit të shtuar në vazhdimësi për llogaritë më rrezik të lartë dhe marrëdhëniet afariste, sikurse ato me PPE. BQK ka konfirmuar se kjo çështje është duke u adresuar në kuadër të rishikimit të Rregullit X.

PPE të cilët mbajnë funksione të rëndësishme publike në vend – Kriteri shtesë 6.5

822. Në kuadër të Kriterit shtesë 6.5 shqyrtohet aspekti nëse obligimet e PEP me funksion publik të spikatur në një vend tjetër, po ashtu zbatohen ndaj PPE që kanë funksione publike të spikatura në vend.

823. Sipas përkufizimit të PPE në Ligjin e LPP/LFT, i cili i referohet çdo personi të cilit i është besuar funksioni i spikatur publik në çdo vend, PPE do të mund të ishte po ashtu person vendor.

824. Megjithatë, me zbatimin e masave të shtuara të kujdesit të duhur dhe monitorimit të shtuar përmes nenit 21, Ligji LPP/LFT i referohet PPE-së që banon jashtë Kosovës. Kjo e reflekton pozitën e PPE në Direktivën e tretë të BE për LPP.

¹⁰² Ky dallim në interpretim mund të jetë i natyrës gjuhësore, varësisht nga përkthimi.

825. Sipas dispozitave të nenit 21, kujdesi i duhur i shtuar dhe monitorimi i shtuar do të zbatoheshin vetëm ndaj një personit të vendit, të cilit i është besuar funksioni i spikatur publik në çfarëdo vendi më kusht që ai person të banoj jashtë Kosovës.

826. Në anën tjetër, masat e shtuara nuk do të zbatoheshin ndaj një personi të huaj, të cilit i është besuar funksioni i spikatur publik në Kosovë, por që banon në Kosovë ndërsa kjo do të zbatohet ndaj atij personi nëse, edhe pse mban pozitë të spikatur publike në Kosovë dhe banon jashtë Kosovës.

827. Institucionet dhe organizatat përkatëse kanë shprehur shqetësime sa i përket kuptimit të nocionit të PPE-së, veçanërisht sepse ato mendojnë se BQK-ja e zbaton obligimin si ndaj PPE të huaj, ashtu edhe ndaj atyre vendorë që janë në kundërshtim me Ligjin LPP/LFT. Sipas një analizë që i është bërë Letrës Këshilluese 2007/1 theksohet se BQK-ja vetëm thekson (në fusnotë brenda kontekstit të termit 'çdo shtet tjetër' të dhënë në përkufizimin e PPE-së) që *Në përputhje me FATF (Task Forcën për Veprim Financiar) Rekomandimin 6, BQK-ja mund zgjedh se a ta mbaj këtë kërkesë vetëm ndaj PPE-ve të huaj apo që ta zbatoj po ashtu ndaj PPE-ve vendorë*. Megjithatë, nuk përjashtohet se në praktikë BQK-ja i zbaton obligimet sipas Ligjit LPP/LFT po ashtu ndaj PPE-ve vendorë. Pavarësisht asaj se Ligji LPP/LFT nuk ia jep pushtetin BQK-së që të zgjedh sa i përket zbatimit, ngase neni 21 i Ligjit LPP/LFT në mënyrë specifike i referohet personit që banon jashtë Kosovës. E vetmja zgjedhje, brenda interpretimit të përkufizimit të PPE-së është që BQK-ja të sigurojë se bankat dhe institucionet financiare së paku t'i identifikojnë PPE vendorë. BQK ka konfirmuar se ajo ndërmerr masa të tilla në vizitat e saj në terren tek bankat.

828. Po ashtu vlen të theksohet se Standardet e FATF 2012 tanimë i kanë përfshirë PPE-të vendorë (edhe pse janë në nivel tjetër prej PPE të huaj dhe varësisht prej bazës së ndjeshmërisë së rrezikut) dhe se do të ishte e udhës që të qartësohen brengat me rishikimin e Rregullës X të BQK-së se a duhet që për qëllimet e Ligjit LPP/LFT BQK-ja të caktohet si autoritet mbikëqyrës.

Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (2003) – Kriteri shtesë 6.6

829. Në kuadër të Kriterit shtesë 6.6 tentohet të përcaktohet nëse shteti ka nënshkruar, ratifikuar dhe e ka zbatuar plotësisht Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit të vitit 2003.

830. Sipas përgjigjeve ndaj pyetjeve përkatëse në pyetësor, Kosova nuk e ka nënshkruar Konventën.

Direktiva e Komisionit të BE-së 2006/70/EC – Direktiva e tretë LPP, neni 3(8)

831. Neni 2 (4) i Direktivës zbatuese të BE-së 2006/70/EC sa i përket nenit 3 (8) të Direktivës së tretë të BE-së për LPP përcakton se në raste të rrezikut të ndjeshëm, shtetet duhet të kërkojnë prej institucioneve të veta financiare që të mos e konsiderojnë edhe me tutje një person brenda statusit të PPE-së, nëse ai person nuk gëzon më tutje pozitën e spikatur të funksionit publik për një periudhë prej 12 muajve.

832. Ligji LPP/LFT nuk parasheh asgjë në këtë drejtim.

833. Duket se Kosova nuk e ka miratuar këtë dispozitë të Direktivës zbatuese të BE-së 2006/70/EC.

Efektiviteti (në përgjithësi për Rekomandimin 6)

834. Janë identifikuar faktorë të ndryshëm në vlerësimin e zbatimit të ndikimit të nocionit PEP në efektivitetin e zbatimit të konceptit.

835. Së pari ka mangësi sa i përket përkufizimit të PEP-së dhe, në veçanti, mospërfshirjes së përkufizimit për ‘funksion të spikatur publik’, ‘anëtarët e familjes së personit të tillë’ dhe ‘ata me të cilët shoqërohet për së afërmi’, gjë që zbatimin e përkufizimit e bën që t’i nënshtrohet interpretimit. Kjo gjendje edhe më tej theksohet nga mungesa e udhëzimeve sa i përket zbatueshmërisë së konceptit për bazën e ndjeshmërisë së rrezikut, si dhe monitorimit të vazhduar të klientëve përmes statusit të PPE-së për të.

3.3.2. Rekomandimet dhe komentet (në përgjithësi për Rekomandimin 6)

836. Edhe pse Ligji LPP/LFT e shtron çështjen e PEP-së, në Ligj ka boshllëqe që duhet të adresohen për harmonizim më të mirë me dispozitat e Rekomandimit 6 të FATF.

837. Në përgjithësi, në këtë Raport shprehen shqetësime për përkufizimin e PPE-së në përputhje me përkufizimin që përcaktohet në Metodologjinë FATF dhe Direktivat e BE për LPP. Shkurtimisht, përkufizimi i PEP-së sipas Ligjit LPP/LFT nuk e përjashton pozitat e mesme, si dhe zyrtarët e ri për qëllimet e përkufizimit, si dhe nuk ofron udhëzime se kush e përben dhe se çfarë është ‘funksioni i spikatur publik’, ‘anëtarët e familjes së atij personi’, dhe ‘ata që shoqërohen së afërmi me atë person’. Për më tepër, kujdesi i duhur i shtuar dhe monitorimi i shtuar nuk mund të zbatohen ndaj PEP-së në të gjitha rrethanat, në veçanti kur personi të cilit iu është besuar funksioni i spikatur në një vend tjetër banon në Kosovë.

838. Boshllëqet dhe dobësitë e identifikuar në Ligjin LPP/LFT brenda kontekstit të Kriterëve Esenciale për Rekomandimet 6 të FATF do të mund të përmblihdeshin siç vijon më poshtë, edhe pse nuk duhet të përjashtohet leximi i Përshkrimit dhe Analizës për kritere specifike:

- Përkufizimi i PPE-së është i mangët dhe jo krejtësisht në përputhje me përkufizimin e FATF (KTh 6.1);
- Nuk ka udhëzim se kush përben “ funksionin e spikatur publik’ (KTh 6.1);
- Nuk ka udhëzim se kush e përben “anëtarët e familjes së personit të tillë” dhe “ata që shoqërohen së afërmi me të” (KTh 6.1);
- Obligimi për të zbatuar kujdesin e duhur të shtuar dhe monitorimin e shtuar ndaj PPE-ve që banojnë jashtë Kosovës i përjashton rastet kur një PPE i huaj banon në Kosovë (KTh 6.1);
- Obligimi për të pasur sisteme të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut për të identifikuar PPE-të nuk kërkon identifikimin e statusit të pronarit përfitues (KTh 6.1);
- Mungon obligimi që menaxhmenti i lartë të aprovoj vazhdimin e marrëdhënies me klientin i cili eventualisht është identifikuar si PPE (KTh 6.2.1); dhe
- Nuk është i qartë obligimi për të vërtetuar burimin e pasurisë në Ligjin e LPP/LFT (KTh 6.3)

839. Lidhur me këto mangësi ose dobësi janë bërë rekomandime të ndryshme që të përditësohet Ligji LPP/LFT me qëllim të plotësimit të kriterëve të Rekomandimit 6. Është e këshillueshme që rekomandimet e bëra të lexohen brenda kontekstit të përshkrimit dhe analizës së KTh-së specifike.

- Në Ligjin për LPP/LFT të harmonizohet përkufizimi i PEP me përkufizimin e FATF;

- Të vendoset obligimi ligjor për të identifikuar pronarin përfitues të subjektit ligjor bie brenda përkufizimit të PEP-së;
- Të ndryshohet neni 21 i Ligjit LPP/LFT që të sigurohet se procedurat janë zbatuar për të identifikuar në rast se një klient ose pronari përfitues është identifikuar eventalisht si PEP ose bëhet PEP;
- Në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT të qartësohet se përkufizimi për burimin e fondeve zbatohet sipas rasteve në vazhdimësi ndaj të gjitha transaksioneve me PPE-t;
- Të siguroj udhëzim për sektorin.

3.3.3. Shkalla e renditjes për Rekomandimit 6

	Shkalla	Përmbledhje e faktorëve në të cilët mbështet renditja
Rek. 6	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Mangësitë në përkufizimin e PEP-së • Mos zbatimi i masave të shtuara për PEP të huaj që banojnë në Kosovë • Mungesa e obligimit për të identifikuar nëse pronari përfitues është PEP; • Mungesa e obligimit për aprovimin e menaxhmentit të lartë për vazhdimin e punës me PEP; • Obligimi ligjor për të identifikuar burimin e pasurisë është i paqarta; dhe • Brengat e sektorit për zbatimin e nocionit PEP dhe • Çështjet e efektivitetit lidhur me përkufizimin e zgjeruar të PPE-së, udhëzime për monitorimin në vazhdimësi si dhe statusin e pronarit përfitues.

3.4. Ligjet për fshehtësinë në përputhje me Rekomandimet (R.4)

3.4.1. Përshkrimi dhe analiza

840. Rekomandimi 4 kërkon që ligjet përkatëse për fshehtësinë të mos pengojnë zbatimin efektiv të Rekomandimeve të FATF. Sipas KTh 1 për Rekomandimin 4 në Metodologjinë FATF, *Fushat ku kjo mund të këtë shqetësime të veçanta janë aftësitë e autoriteteve kompetente që t'i qasen informacioneve që atyre u duhen që në mënyrë të duhur t'i kryejnë funksionet në luftën e PP dhe FT; këmbimi i informacioneve në mes të autoriteteve kompetente, qofshin vendore ose ndërkombëtarë; dhe këmbimi i informacioneve në mes të institucioneve financiare kur kërkohet sipas R.7 ose RV VII.*

841. Neni 37 i i Ligjit LPP/LFT përcakton se: *Pavarësisht nga dispozitat kundërthënëse të ligjit në fuqi, sekreti profesional nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informatave që duhet zbuluar në pajtim me këtë ligj; ose janë mbledhur dhe ruajtur në pajtim me këtë ligj dhe kërkohen qoftë nga NjIF-ja, qoftë nga policia lidhur me një hetim për larjen e parave të urdhëruar apo të kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit apo gjyqtarit hetues. Kjo dispozitë është pa paragjykuar informacionet që i nënshtrohen privilegjit klient-avokat.*

842. Letrës Këshilluese 2007/1 dhe Rregulla X e BQK-së janë të heshtura sa i përket çështje së konfidencialiteti.

843. Sipas neni 79, Ligji për bankat i jep pushtetin BQK-së që të këmbëj informacione për çështjet e mbikëqyrjes me autoritetet e mbikëqyrjes financiare në Kosovë dhe shtetet tjera.

Sipas ligjit këmbimi i informacioneve të tilla mund të përfshijë informacione KONFIDENCIAL, me kusht që BQK-ja është e bindur se informacioni do të përdoret për qëllimet e mbikëqyrjes dhe se do të i nënshtrohet tretmanit të konfidencialiteti që është i ngjashëm me atë të cilin kërkohet prej BQK-së që ta zbatoj.

844. Për me tepër, sipas nenit 80 të Ligjit për banka, më tutje theksohet se çdo informacion jo-publik i pranuar nga BQK-ja prej ndonjë banke si dhe çdo informacion jo publik i cili i është siguruar BQK-së nga ndonjë autoritet tjetër mbikëqyrës apo rregullator me qëllim që BQK të kryej përgjegjësit e veta sipas Ligjit për Banka duhet të i nënshtrohet kushteve të kërkuara në Ligjin për BQK-n dhe mund të zbulohen jashtë BQK-së vetëm siç përcaktohet me ligj.

845. Në anën e vetë, përmes nenit 74 (2) të Ligjit për BQK-në thekson se: Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni personat e tillë mund të shpalosin informacionin jopublik jashtë Bankës Qendrore, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Bordi Ekzekutiv, nëse shpalosja e tillë:

- bëhet në përputhje me pëlqimin e qartë të personit fizik apo juridik me të cilin ka të bëjë informacioni;
- përmbush një detyrim për zbulimin e përcaktuar sipas ligjit penal, duke përfshirë ndihmësen për zbatimin e ligjit penal ose me urdhër të gjykatës që ka të bëjë me raste penale;
- bëhet për auditorët e jashtëm të Bankës Qendrore;
- jepet për autoritetet rregullatorë dhe mbikëqyrëse ose institucionet publike financiare ndërkombëtare, për realizim të detyrave të tyre zyrtare; ose
- nevojitet për interesa të vetë Bankës Qendrore në procedurë gjyqësore që kërkon shpalosje.

846. Në analizë, Rekomandimi 4 kërkon heqjen e dispozitave për konfidencialitet veçanërisht për rastet si në vijim:

- Qasja në informacione nga autoritetet kompetente relevante;
- Këmbimi i informacioneve në mes të autoriteteve kompetente, vendore e ndërkombëtarë;
- Këmbimi i informacioneve në mes të institucioneve financiare për shërbimet bankare përkatëse;
- Këmbimi i informacioneve në mes të institucioneve financiare për tu mbështetur në palët e treta sa i përket kërkesave të KDK kur një mbështetje e tillë lejohet me ligj; dhe
- Këmbimi i informacioneve për shërbimet e transferimeve elektronike.

847. Me përjashtim të ndarjes së informatave për mbështetje nga palët e treta ngase kjo masë nuk lejohet me ligj, Ligji LPP/LFT për të gjitha rastet e lartcekura përcakton dispozita për ndarjen e informacioneve në të gjitha rrethanat e përkufizuara më lartë.

848. Rrjedhimisht, heqja e konfidencialitetit i cili përcaktohet në çfarëdo ligji tjetër përmes nenit 37 të Ligjit LPP/LFT në ato raste kur informacioni kërkohet që të zbulohet në përputhje me Ligjin LPP/LFT do të i plotësonte kushtet e kërkuara në masë të madhe për Rekomandimin 4.

849. Megjithatë, duhet theksuar se autorizimi i BQK-së për të këmbyer informacione në përputhje me Nenin 79 të Ligjit për Banka është i kufizuar në çështjet e mbikëqyrjes së BQK-

së brenda Ligjit për Banka. Tutje ky autorizim i referohet informacioneve për qëllime të kujdesit ngase, siç do të shihet analizën për Rekomandimin 23 të këtij Raporti, Ligji për Bankat nuk siguron autorizime mbikëqyrëse të BQK-së për qëllimet e Ligjit LPP/LFT.

850. Për më tepër, ato zgjidhje që sigurohen përmes nenit 74 (2) të Ligjit për BQK-në në mënyrë specifike nuk i mbulojnë kushtet e kërkuara në Rekomandimin 4, përjashtimin ndaj ndalesës së përgjithshme sipas nenit 74 (1) të Ligjit për BQK-në- *përveç kur është e nevojshme që të kryhet detyrat e caktuara me këtë ligjit ose ndonjë ligj tjetër*- është më shumë objekt interpretimi, në veçanti kur lexohet brenda kontekstit të dispozitës së nenit 37 të Ligjit LPP/LFT që ka të bëjë me sekretin profesional.

851. Prandaj, përderisa BQK-ja ka autorizime mbikëqyrëse për qëllime të kujdesit për sektorin financiar dhe përderisa të gjitha zgjidhjet KONFIDENCIAL sipas Ligjit për Bankat dhe Ligjit për BQK-në shërbejnë për të mbuluar situatën që ndërlidhet me situatën e çështjeve të kujdesit mbikëqyrës, rekomandohet që siguria ligjore për heqjen e konfidencialitetit të forcohet për qëllimet e Ligjit LPP/LFT

Efikasiteti (Rekomandimi i përgjithshëm 4)

852. Dispozitat aktuale për ngritjen e besueshmërisë për qëllimet e dispozitave të Ligjit LPSH/PFT nuk ndikojnë në efikasitetin e regjimit të gjithëmbarshtëm.

3.4.2. Rekomandimet dhe komentet

853. Prandaj rekomandohet që në mënyrë që të men ajohet çfarëdo divergjence në interpretimin dhe kështu të sigurohet qartësia ligjore një pikë e re i shtohet Nenit 74(2) të Ligjit mbi BQK, në veçanti nëse BQK-[s eventualisht i jepen kompetenca mbikëqyrëse dhe për qëllimin e Ligjit LPSH/PFT si në vijim:

- është bërë për NJIF për qëllimin e obligimeve të tij sipas Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të parave dhe Financimin e Terrorizmit.

3.4.3. Klasifikimi për Rekomandimin 4

	Klasifikimi	Përmbledhja e faktorëve që i nënshtrohen klasifikimit
Rek. 4	KP	<ul style="list-style-type: none">• Ekziston nevoja për qartësi ligjore për ngritjen e besueshmërisë për BQK-në sa i përket dispozitave të Ligjit LPP/LFT përtej çështjeve të kursimit

3.5. Mbajtja e shënimeve (R.10*)

3.5.1. Përshkrimi dhe Analiza

854. Rekomandimi 10 kërkon nga institucionet financiare të mbajnë shënime të duhura për transaksionet dhe nevojat e identifikimit për një periudhë prej 5 vitesh dhe për t'ia vënë në dispozicion shënimet e këtylla autoriteteve relevante kompetente sipas autoritetit të duhur. Edhe pse Metodologjia FATF ofron udhëzime për llojin e shënimeve që duhet të mbahen shënimet e transaksioneve duhet që përgjithësisht të jenë ato që mund t'u ndihmojnë autoriteteve në rikonstruktimin e një transaksioni. Shënimet identifikuese kryesisht i referohen informatave të KDK-së dhe duhet të jenë të atilla sa që klienti të mund të ri-identifikohet.

855. Sipas Metodologjisë së FATF obligimi i institucioneve financiare është të mbajnë shënime siç është përcaktuar dhe duhet të ofrohen sipas ligjit ose rregullores dhe prandaj duhet të jenë të detyrueshme.

856. Analiza që pasoi e identifikoi obligimin për mbajtjen e shënimeve për bankat dhe institucionet financiare kryesisht përmes kërkesave sipas Ligjit LPSH/PFT por nuk e përjashton mundësinë e obligimit të marrjes së shënimeve sipas ligjeve të tjera.

Obligimi për mbajtjen e shënimeve të nevojshme për të gjitha transaksionet – Kriteri thelbësor 10.1

857. KTh 10.1 kërkon nga institucionet financiare ti mbajnë të gjitha shënimet e nevojshme për transaksionet vendore dhe ndërkombëtare për së paku pesë vjet pas përfundimit të transaksionit. Sipas autorizimit të duhur, autoritetet relevante kompetente mund të kërkojnë që institucionet financiare t'i mbajnë ato shënime për një periudhë më të gjatë, në rastet specifike.

858. Paragrafi (6) i nenit 17 të Ligjit LPP/LFT kërkon që bankat dhe institucionet financiare të mbajnë informata adekuate të atilla që mundëson rikonstruktimin e transaksionit kur:

- një transaksion është ekzekutuar;
- është tentuar atë ekzekutohet transaksioni;
- ka transaksione komplekse dhe të pazakonshme; dhe
- ka transaksione me personat dhe subjektet nga vendet që nuk i aplikojnë masat adekuate për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.

859. Ligji LPPP/LFT nuk e autorizon asnjë autoritetet kompetente që ta zgjatë periudhën e ruajtjes në raste specifike mbi ato të përcaktuara me Ligj.

860. Bankat dhe institucionet financiare kërkohet të ruajnë shënime e detajuara të lartpërmendura për një periudhë pesë vjeçare pas ekzekutimit ose tentimit të ekzekutimit të transaksionit. Vlen të ceket që Ligji LPP/LFT shkon përtej Standardeve FATF dhe kërkon mbajtjen e shënimeve madje edhe të transaksioneve të tentuara - një kërkesë kjo që duhet të lavdërohet.

861. Obligimi për të ruajtur të dhënat sipas përcaktimit me së paku dy pika si më lart përforcohet më tutje me paragrafin (3) të nenit 20 të Ligjit LPP/LFT.

862. Letra Këshilluese 2007/1 e BQK-së nuk ofron ndonjë udhëzim shtesë mbi ruajtjen e regjistrave të transaksioneve, përveç deri në masën që kërkon nga Zyrat Këmbimore dhe Operatorët e Transfereve, në mungesë të një marrëdhënieje të vazhdueshme të biznesit, për të mbajtur kopjet e të dhënave për transaksione për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas një transaksioni.

863. Neni 8 i Rregullës X të BQK-së reflekton obligimin sipas Ligjit LPP/LFT për të ruajtur të dhënat e gjitha transaksioneve. Për më tepër, në reflektim të më tutjeshëm të periudhës së ruajtjes prej pesë (5) vitesh, neni 8 i Rregullës X të BQK-së zgjat periudhën e ruajtjes për banka dhe institucione financiare për më gjatë, nëse kërkohet nga BQK-ja, NjIF-i (Rregulla i referohet ende Qendrës së inteligjencës financiare) ose ndonjë autoritet tjetër kompetent në rastet specifike.

864. Për më tepër, neni 8 i Rregullit X kërkon që “Aty ku banka dhe institucioni financiar është i vetëdijshëm që të dhënat në lidhje me hetimet e vazhdueshme, ku të dhënat e tilla duhet të ruhen deri sa të konfirmohet nga ana e ndonjë gjykate kompetente se rasti është mbyllur”.

865. Obligimi i ruajtjes së të dhënave të transaksioneve sipas nenit 17 të Ligjit LPP/LFT për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas përfundimit të transaksionit duket të mbulojë në mënyrë adekuate obligimet sipas KTH 10.1.

866. Ligji LPP/LFT dhe Rregulli X megjithatë kanë mangësi në kuptimin e përcaktimit të fillimit të periudhës pesë (5) vjeçare për ruajtjen e të dhënave për transaksionet anësore të ndërlidhura që së bashku arrijnë apo tejkalojnë pragun prej 10,000€ të përcaktuar me Ligjin LPP/LFT. Standardi i zakonshëm është që periudha pesë (5) vjeçare e ruajtjes të fillojë me përfundimin e transaksionit të fundit në një vijimësi të tillë transaksionesh.

867. Për më tepër, Ligji LPP/LFT nuk reflekton kërkesat tjera sipas KTh 10.1 për institucione financiare që duhet të ruajnë të dhënat për një periudhë më të gjatë, nëse kërkohet kjo nga autoritetet kompetente me autorizimin e duhur.

868. Ky fuqizim megjithatë reflektohet në Rregullin X të BQK-së, sipas nenit 8. Ekzistojnë dy çështje kryesore që sfidojnë këtë kompetencë të zgjeruar në Rregullin X. Së pari, kërkesa standarde duhet të vihet në ligjin primar apo në rregullore, pasi në këtë rast BQK-ja merr autorizime përtej atyre që përcaktohen me Ligj. Së dyti, vlefshmëria e shumicës së pjesëve të Rregullit X të BQK-së vihet në pikëpyetje përgjatë gjithë këtij Raporti, si dhe në çdo rast, Rregulli X nuk përmbush kriteret për një “rregullore” në kuptimin e Metodologjisë FATF.

869. Edhe nëse pranohet, fuqizimi sipas Rregullit X nuk do të vlejë për gjitha subjektet e Raportimit, si dhe si i tillë krijon pabarazinë e lojës në zbatimin e ligjit LPP/LFT.

870. Kështu, ky Raport gjen që për kohën e periudhës pesë (5) vjeçare të ruajtjes për vijimësinë e transaksioneve anësore të ndërlidhura, si dhe autorizimin e autoriteteve përkatëse që të zgjasin periudhën pesë (5) vjeçare me autorizimin e duhur, mungojnë në ligjin LPP/LFT.

871. Kështu, rekomandohet që paragrafi (6.2) i nenit 17 të Ligjit LPP/LFT të ndryshohet për të përfshirë fjalinë vijuese në fundin e tij:

Neni 17 para. (6.2): Aty ku të dhënat e transaksioneve i referohen një vijimësie të transaksioneve të ndërlidhura të kohëpaskohshme, periudha pesë (5) vjeçare e ruajtjes do të fillojë më ekzekutimin e transaksionit të fundit në atë vijimësi.

872. Më tutje, rekomandohet që të shtohet edhe një paragraf i ri (7) në nenin 17, si në vijim, duke e fuqizuar vetëm NjIF-në që të zgjasë periudhën e ruajtjes pasi që NjIF-i është autoriteti që pranon dhe përpunon RTD-të dhe do të ketë informata mbi statusin e Raportit:

Neni 17 para. (7) Në rastet e veçanta të përcaktuara sipas NjIF-it për qëllimet e funksioneve të saj në analizimin e raporteve të dyshimta të transaksioneve, NjIF-i mund të zgjasë periudhën pesë (5) vjeçare me urdhër me shkrim për subjektet raportuese në fjalë.

Të dhënat e mjaftueshme për të mundësuar rikonstruimin e transaksioneve individuale – Kriteri thelbësor 10.1.1

873. KTh 10.1.1 parasheh që hollësitë e ruajtura në regjistrin e transaksioneve të jenë të mjaftueshme për autoritetet për të rekonstruuar transaksionin individual, ashtu që të ofrojë dëshmi në ndonjë hetim të mundshëm eventual të një aktiviteti kriminal.

874. Neni 17 i Ligjit LPP/LFT, për krijimin e obligimit për të ruajtur regjistrat e transaksioneve për të mundësuar rekonstruimin e transaksionit ka mangësi në ofrimin e udhëzimeve të duhura.

875. Derisa Letra këshilluese 2007/1 nuk flet për këtë çështje, në reflektimin e dispozitave të mirëmbajtjes së regjistrave të transaksioneve, neni 8 i Rregullit X të BQK-së ofron udhëzime për llojin e regjistrave të elementeve të një transaksioni që duhet ruajtur. Këto përfshijnë:

- Emri i konsumatorit dhe pronarit përfitues (dhe të autorizuarit të tij, nëse vlen) si dhe adresave të tyre, si dhe informatat tjera identifikuese, që normalisht regjistrohen nga banka apo institucioni financiar;
- Natyra dhe data e transaksionit;
- Lloji dhe shuma e valutës në transaksion; si dhe
- Lloji dhe numri identifikues i llogarive të përfshira në atë transaksion.

876. Dispozitat për udhëzim sipas nenit 8 të Rregullit X të BQK-së kontribuojnë gjerësisht për bankat dhe institucionet financiare në kuptimin e ruajtjes së regjistrave të duhur të transaksionit që janë të dobishme për rikonstruimin e transaksionit.

877. Sa për të komentuar për efektshmërinë e gjithë sistemit parandalues sipas Ligjit LPP/LFT, autoritetet e Kosovës mund të marrin parasysh faktin që udhëzimet sipas Rregullit X vlejné vetëm për sektorin financiar, kështu në këtë rast, duke krijuar pabarazi me subjektet raportuese të tjerë në implementimin e Ligjit LPP/LFT.

878. Edhe pse udhëzimet e mëtuftjeshme për metodën e ruajtjes së të dhënave – elektronike, fizike, apo tjera – do të ishin të dobishëm për sistemin, kërkesat sipas KTH 10.1.1 aktualisht përmbushen për sektorin financiar.

Të dhënat për identifikim, dosjet e llogarive dhe korrespondenca afariste – Kriteri thelbësor 10.2

879. KTh 10.2 kërkon nga institucionet financiare që të ruajnë gjitha shënimet e të dhënave të identifikimit, dosjeve të llogarisë dhe korrespondencës afariste për së paku pesë (5) vjet pas mbylljes së një llogarie apo një marrëdhënieje afariste. Me autorizimin e duhur, autoritetet përkatëse kompetente mund të kërkojnë nga institucionet financiare që të ruajnë të dhëna të tilla për një periudhë më të gjatë në rastet e veçanta.

880. Paragrafi (6) i nenit 17 të Ligjit LPP/LFT kërkon nga bankat dhe institucionet financiare që të ruajnë kopjet e dokumenteve që vërtetojnë identitetin e klientit, titullarët e pronës, të marra në përputhje me nenin 17, dosjet e llogarive dhe korrespondencën afariste, për së paku pesë (5) vjet, pas ndërprerjes së marrëdhënies afariste.

881. Ky obligim përforcohet edhe më shumë përmes paragrafit (7) të nenit 18 të Ligjit LPP/LFT, i cili megjithatë kërkon që periudha pesë (5) vjeçare të fillojë *pasi që llogaria të jetë mbyllur, apo pasi të kenë përfunduar marrëdhëniet me klientin, cilado që të jetë më e vonshme.*¹⁰³

¹⁰³ Ndryshimet e propozuara të Ligjit LPP/LFT parashohin shlyerjen e paragrafit (7) të nenit 18 të Ligjit aktual.

882. Ligji LPP/LFT nuk e fuqizon asnjë autoritet kompetent që të zgjasë periudhën e ruajtjes në raste të veçanta përtej periudhës së përcaktuar me ligj.

883. Neni 8 i Rregullit X të BQK-së kërkon që: *Bankat dhe institucionet financiare duhet t'i ruajnë të gjitha të dhënat (shënimet) e nevojshme të cilat kanë të bëjnë me konsumatorin, pronarin përfitues, ose avokatin, dosjet e llogarive, dhe korrespondenca e biznesit së paku në periudhe kohore prej pesë vitesh duke filluar nga përfundimi i marrëdhënies së biznesit, apo në raste specifike edhe më gjatë nëse kërkohet nga AQBK, Qendra e Inteligjencës Financiare (QIF), apo ndonjë organi tjetër kompetent. Të dhënat duhet të identifikojnë anëtarin e stafit, i cili e ka bërë identifikimin e konsumatorit (pronarin përfitues, aty ku është e aplikueshme). Kështu, neni 8 jep më shumë udhëzime.*

884. Për më tepër, siç është theksuar më lart, neni 8 i Rregullit X më tutje përcakton që *Aty ku banka dhe institucioni financiar është i vetëdijshëm që të dhënat në lidhje me hetimet e vazhdueshme, ku të dhënat e tilla duhet të ruhen deri sa të konfirmohet nga ana e ndonjë gjykate kompetente se rasti është mbyllur.*

885. Edhe pse *prima facie* duket që kërkesat sipas KTh 10.2 mund të përmbushen përmes dispozitave të Ligjit LPP/LFT dhe Rregullit X të BQK-së, analiza e këtyre dispozitave shfaq disa mangësi, dobësi apo dallime të rëndësishme.

886. KTh 10.2 kërkon që të dhënat identifikuese të ruhen për një periudhë pesë (5) vjeçare pas mbylljes së llogarisë apo ndërprerjes së marrëdhënies afariste. Paragrafi (6) i nenit 17 të Ligjit LPP/LFT e përcakton këtë periudhë duke filluar vetëm nga ndërprerja e marrëdhënies afariste. Në anën tjetër, paragrafi (7) i nenit 18 të ligjit LPP/LFT, në përforcim të ruajtjes së të dhënave identifikuese, ka përcaktuar fillimin e periudhës pesëvjeçare *pasi llogaria të jetë mbyllur, ose pasi marrëdhëniet me klientin të jenë përfunduar, cilado që të jetë më e vonshme, duke qenë kështu në përputhje me Standardin.*¹⁰⁴ Rregulli X në anën tjetër reflekton nenin 17 të Ligjit LPP/LFT, duke kërkuar që periudha pesëvjeçare të fillojë pas përfundimit të marrëdhënies afariste.

887. Divergjencat e tilla në obligime, sidomos kur divergjenca e tillë paraqitet në të njëjtin ligj (neni 17 me nenin 18) krijojnë konflikte për sektorin, me implikime negative tek implementimi efektiv i kërkesave ligjore.

888. Për më tepër, ngjashëm si tek KTh 10.1, Ligji LPP/LFT nuk reflekton kërkesën shtesë sipas KTh 10.2 për institucionet financiare në ruajtje të të dhënave identifikuese për një periudhë më të gjatë, nëse kjo kërkohet nga autoritetet kompetente me autoritetin e duhur.

889. Ngjashëm si tek KTh 10.1, fuqizimi për të zgjatur periudhën e ruajtjes megjithatë reflektohet tek Rregulli X i BQK-së, tek neni 8. Si rrjedhojë, ekzistojnë dy çështje kryesore që sfidojnë këtë kompetencë të zgjeruar në Rregullin X. Së pari, kërkesa standarde duhet të përcaktohet me ligj primar apo rregullore. Së dyti, vlefshmëria e shumicës së pjesëve të Rregullit X të BQK-së vihet në pikëpyetje përgjatë gjithë këtij Raporti, si dhe në çdo rast, Rregulli X nuk përmbush kriteret për një “rregullore” në kuptimin e Metodologjisë FATF.

890. Edhe nëse pranohet, fuqizimi sipas Rregullit X nuk do të vlente për gjitha subjektet raportuese, duke krijuar kështu pabarazi në zbatimin e Ligjit LPP/LFT.

¹⁰⁴ Ndryshimet e propozuara të Ligjit LPP/LFT parashohin shlyerjen e paragrafit (7) të nenit 18 të Ligjit aktual, duke hequr kështu dallimin, por duke e bërë Ligjin të papërrputshëm me standardin.

891. Kështu, ky raport gjen që ka konflikt në vetë ligjin, në kuptimin e kohës së fillimit të periudhës pesëvjeçare për ruajtjen e të dhënave identifikuese, derisa kompetenca e autoriteteve përkatëse për zgjatjen e periudhës pesëvjeçare të ruajtjes sipas autoritetit të mirëfilltë për të dhëna të identifikimit mungon në Ligjin LPP/LFT.

892. Kështu, rekomandohet ndryshimi i paragrafit (6.1) të nenit 17 të Ligjit LPP/LFT, si në vijim: me mbylljen e llogarisë apo me ndërprerjen e marrëdhënies afariste, cilado që të jetë më e vonshme.

893. Sa i përket zgjatjes së periudhës së ruajtjes, rekomandimi i dhënë tek analiza e KTH 10.1 më lart për paragrafin e ri (7) tek neni 17 vlen edhe këtu.

Dispozicioni i të dhënave me kohë për autoritetet kompetente vendore – Kriteri thelbësor 10.3

894. KTh 10.3 kërkon nga institucionet financiare të sigurojnë që gjitha të dhënat e konsumatorëve dhe të transaksioneve, si dhe informatat e ruajtura sipas standardeve të përcaktuara, të vihen në dispozicion me kohë për autoritetet kompetente vendore me autorizimin e duhur.

895. Neni 17 i Ligjit LPP/LFT kërkon nga bankat dhe institucionet financiare të sigurojnë që dokumentacioni dhe informatat e ruajtura sipas nevojës të jenë të gatshme dhe t'i vihen në dispozicion NjIF-it, si dhe autoriteteve tjera kompetente.

896. Obligimi për ruajtjen e të dhënave të hollësishme të transaksioneve komplekse dhe jashtëzakonisht të mëdha, sipas paragrafit (3) të nenit 20 të Ligjit LPP/LFT specifikon që informatat e ruajtura mbi transaksionin duhet t'i vihen në dispozicion, nëse kërkohen, *autoritetit mbikëqyrës* përtej NjIF-it dhe autoriteteve tjera kompetente, sipas dispozitave të nenit 17.

897. Neni 8 i Rregullit X të BQK-së kërkon nga bankat dhe institucionet t'i vënë në dispozicion *sipas kërkesës* së BQK-së, NjIF-it (Rregulli ende i referohet Qendrës së Inteligjencës Financiare), si dhe autoriteteve kompetente tjera, gjitha shënimet dhe informatat në dispozicion mbi një konsumator, pronar beneficues, apo avokatin si mbajtës të autoritetit si dhe të gjitha të dhënat e kërkuara të transaksionit, në formë dhe mënyrë që është e hollësishme, me kohë dhe e kuptueshme.

898. Në thelb, kërkesat kryesore sipas KTh 10.3 duken të jenë në vend në ligjin LPP/LFT dhe Rregullin X të BQK-së, ky i fundit pa paragjykuar brengat e shprehura në këtë raport. Por, pasi që Metodologjia kërkon që kërkesat sipas Rekomandimit 10 duhen mbuluar me ligj apo rregullore, e për më tepër që vlefshmëria e Rregullit X si «rregullore» në termat e Metodologjisë është vënë në pikëpyetje, përputhshmëria me kërkesat e KTh 10.3 duhet vlerësuar vetëm me ligjin LPP/LFT.

899. Në këtë kuptim, duhet theksuar që në specifikimin e të dhënave të transaksionit që duhen ruajtur, duke përfshirë ato të transaksioneve të veçanta sipas nenit 20 të Ligjit LPP/LFT, duket të ketë papajtueshmëri mbi disponueshmërinë e informatave të tilla për autoritetet kompetente. Derisa neni 17 i kërkon bankave dhe institucioneve financiare që t'i vënë të dhënat e transaksioneve të specifikuar me nen në dispozicion të NjIF-it dhe autoriteteve kompetente, neni 20 i kërkon bankave dhe institucioneve financiare që të vënë në dispozicion informatat e ruajtura sipas nenit për NjIF-në, *autoriteteve mbikëqyrëse* dhe autoriteteve tjera kompetente *nëse kërkohen*. Kështu, nuk është e qartë se pse në nenin 20 autoritetet mbikëqyrëse përmenden veçanërisht, e pse në nenin 17 informatat nuk vihen në dispozicion nëse kërkohen.

900. Kështu, rekomandohet që të harmonizohen dispozitat e nenit 17 dhe nenit 20 në këtë kuptim.

Efektshmëria (në përgjithësi për Rekomandimin 10)

901. Siç është theksuar në analizën për Rekomandimin 10, disa prej mungesave apo mangësive të identifikuar do të mund të ndikojnë negativisht në efektshmërinë e implementimit të obligimeve për ruajtjen e të dhënave.

902. Mes këtyre dobësive, do të mund t'i referoheshin paqartësive në Ligjin LPP/LFT për fillimin e periudhës pesëvjeçare të ruajtjes, si dhe mungesës së referencës ndaj periudhës së fillimit të vijimësisë së transaksioneve të ndërlidhura. Papajtueshmëria në Ligj dhe Rregullin X për obligimin e ruajtjes së të dhënave për një periudhë më të gjatë, si dhe mungesa e kompetencës ligjore të NjIF-it apo ndonjë autoriteti tjetër për të kërkuar një zgjatje të periudhës së tillë, më tutje ndikojnë negativisht edhe disponueshmërinë e të dhënave relevante për autoritetet kompetente.

903. Për më tepër, çdo udhëzim i ofruar nga BQK-ja mbi këtë çështje mund të aplikohet vetëm për sektorin financiar, duke krijuar kështu pabarazi, bashkë edhe me ndikimin negativ tek i gjithë sistemi.

3.5.2. Rekomandimet dhe komentet – Rekomandimi 10 nga FATF

904. Edhe pse në parim, dispozitat e Ligjit LPP/LFT reflektojnë kriteret kryesore për Rekomandimin 10, ekzistojnë konflikte, dallime apo mangësi serioze të cilat, nëse lihen si të tilla, do të mund të zhvilloheshin në brenga për implementimin efektiv të Ligjit.

905. Konfliktet, mungesat dhe mangësitë e identifikuar në ligjin LPP/LFT në kontekstin e Kriterëve thelbësore për Rekomandimin 10 të FATF mund të përmbliidhen si në vijim, edhe pse leximi i analizës për kriteret e veçanta nuk duhet përjashtuar:

- Mungesa e dispozitave për fillimin e periudhës së ruajtjes për një vijimësi të transaksioneve të ndërlidhura të kohëpaskohshme (KTh 10.1);
- Mungesa e udhëzimeve mbi llojin dhe metodologjinë e ruajtjes së të dhënave (KTh 10.1.1);
- Mungesa e kompetencës ligjore të autoriteteve përkatëse për të zgjatur periudhën pesëvjeçare të ruajtjes, me autorizimin e duhur, për të dhëna të transaksioneve (KTh 10.1);
- Mungesa e kompetencës ligjore të autoriteteve përkatëse për të zgjatur periudhën pesëvjeçare të ruajtjes, me autorizimin e duhur, për të dhëna të identifikimit (KTh 10.2);
- Papajtueshmëria brenda vetë ligjit mbi kohën e fillimit të periudhës pesëvjeçare të ruajtjes për të dhënat e identifikimit (KTh 10.2); si dhe
- Dykuptimësia e ligjit mbi vënien në dispozicion të informatave për autoritetet kompetente (KTh 10.3).

906. Një numër rekomandimesh janë dhënë në analizat për KTh specifike për ndryshimin e kornizës ligjore parandaluese në këtë drejtim. Derisa është e këshillueshme që rekomandimet e tilla të lexohen në kontekstin e analizës së secilës KTh të veçantë, rekomandimet kryesore i referohen:

- Ndryshimit të paragrafit (6.2) të nenit 17 në lidhje me kohëzgjatjen e periudhës së ruajtjes për transaksione të ndërlidhura të kohëpaskohshme;

- Futjes së një paragrafi të ri (7) tek neni 17, duke fuqizuar NjIF-në për zgjatjen e periudhës së ruajtjes në raste të veçanta;
- Ndryshimit të paragrafit (6.1) të nenit 17 në përputhje me paragrafin (6) të nenit 18; si dhe
- Harmonizimit të nenit 17 dhe nenit 20 për dispozicionin e të dhënave të ruajtura për autoritetet kompetente.

3.5.3. Nota për Rekomandimin 10

	Vlerësimi	Përmbledhja e faktorëve që ndikojnë vlerësimin
Rek 10	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e dispozitave për fillimin e periudhës së ruajtjes për transaksione të ndërlidhura të kohëpaskohshme; • Mungesa e udhëzimeve për metodologjinë e ruajtjes së të dhënave; • Mungesa e kompetencës ligjore për zgjatjen e periudhës pesëvjeçare të ruajtjes për të dhënat e transaksioneve dhe të identifikimit sipas nevojës; • Papajtueshmëria juridike për kohën e fillimit të periudhës së ruajtjes për të dhënat e identifikimit; • Dykuptimësia e dispozicionit të të dhënave për autoritetet kompetente; si dhe • Çështjet e efektshmërisë në lidhje me dispozitat konfliktuoze apo munguese, si dhe parabazia që krijohet për gjitha subjektet raportuese

3.6. Raportimi i transaksioneve të dyshimta (R.13* & RV.IV)

3.6.1. Përshkrimi dhe analiza

907. Neni 22 i Ligjit LPP/LFT kërkon nga bankat dhe institucionet financiare që të dorëzojnë në NjIF dy lloje raportesh. Raportet e gjitha veprimeve dhe transaksioneve të përcaktuara me ligj dhe raportet mbi gjitha transaksionet individuale apo të ndërlidhura në shuma prej 10,000 € apo më shumë. Paragrafët në vijim i referohen Raportimit të parë, por mund të ketë referenca edhe për këtë të fundit, nëse dhe kurdo që është e domosdoshme.¹⁰⁵

908. Ligji LPP/LFT përkufizon “aktin apo transaksionin e dyshimtë” si veprim ose transaksion nga i cili buron dyshimi i arsyeshëm se pasuria e përfshirë në veprim ose transaksion është pasuri e fituar me vepër penale dhe do të interpretohet në pajtueshmëri me udhëzimin e lëshuar nga NjIF-i për veprimet ose transaksionet e dyshimta.

909. Obligimet për përmbushje të kriterëve për Rekomandimin 13 në nivel shtetëror kërkohen të përcaktohen me ligj apo rregullore. Në këtë drejtim, brengat e shprehura më herët në këtë Raport mbi vlefshmërinë e Letrës këshilluese 2007/1 dhe Rregullit X të BQK-së si «rregullore» për këto qëllime vlejné prapë. Pa anashkaluar këto, udhëzimet e mëtutjeshme mbi implementimin e ligjit LPP/LFT konsiderohen si pozitive në kontributin e tyre në implementimin efektiv të regjimit raportues sipas ligjit.

¹⁰⁵ Raportimi i shumave adresohet me Rekomandimin 19 nga FATF, i cili nuk përbën pjesë të këtij raporti vlerësues.

Raportimi i transaksioneve të dyshimta tek NjIF-i – Kriteri thelbësor 13.1

910. KTh 13.1 vendos një obligim ligjor për institucionet financiare që të raportojnë tek NjIF-i kur ka dyshim apo ka baza të arsyeshme për të dyshuar që fondet janë të ardhura prej veprimtarisë kriminale, së paku të jenë të ardhura e të gjitha veprave të ndërlidhura sipas Rekomandimit 1. Obligimi sipas ligjit duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe obligativ.

911. Neni 22 i Ligjit LPP/LFT kërkon nga bankat dhe institucionet financiare që të raportojnë tek NjIF-i, në mënyrën dhe formatin e specifikuar sipas NjIF-it, gjitha veprimet apo transaksionet e dyshimta brenda njëzetekatër (24) orësh nga koha kur veprimi apo transaksioni është identifikuar si i dyshimtë.

912. Në përkufizimin e «veprimit apo transaksionit të dyshimtë», Ligji LPP/LFT i referohet pronës së përfshirë në veprim apo transaksion që është e ardhur nga krimi. Në anën tjetër, Ligji LPP/LFT përkufizon «të ardhurat nga vepra penale» si «*çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte apo indirekte nga vepra e ndërlidhur penale. Pasuria e fituar në mënyrë indirekte nga vepra e ndërlidhur penale përfshin pasurinë në të cilën më vonë është konvertuar, transformuar ose ngatërruar çdo pasuri e përfituar në mënyrë direkte nga vepra e ndërlidhur penale si dhe të ardhurat, kapitali apo përfitimet e tjera ekonomike të realizuara nga pasuria e tillë në çfarëdo kohe të kryerjes së veprës penale*». «Vepër e ndërlidhur penale», në anën tjetër, përkufizohet *çdo vepër penale e cila gjeneron të ardhura nga vepra penale*.

913. Neni 22(2) i Ligjit LPP/LFT më tutje i kërkon bankave dhe institucioneve financiare që të vazhdojnë të raportojnë tek NjIF-i mbi gjitha informatat shtesë të rëndësishme mbi transaksionin(et) që i vihen në dispozicion bankës apo institucionit financiar pas dorëzimit të RTD-së përkatëse.^{106, 107}

914. Neni 22(3) i Ligjit LPP/LFT fuqizon NjIF-në që të lirojë disa transaksione apo kategori transaksionesh nga obligimi i raportimit, në rastet kur përcakton që transaksionet apo kategoria e transaksioneve janë rutinore dhe i shërbejnë një qëllimi legjitim. NjIF-i ka informuar që lirimet e tilla nuk janë aplikuar përveç për ato sipas Udhëzimit administrativ nr. 11 të lëshuar nga QIF në tetor 2010 në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, e cila tani është shfuqizuar me ardhjen në fuqi të Ligjit LPP/LFT.

915. Për më tepër, neni 23 i Ligjit LPP/LFT kërkon nga bankat dhe institucionet financiare që të kenë të vendosura programet dhe procedurat e brendshme, mes tjerash, për raportim tek NjIF-i në pajtim me kërkesat e raportimit sipas ligjit.

916. Letra Këshilluese 2007/1 e BQK-së, edhe pse ende i referohet rregulloreve të UNMIK-ut që janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit LPP/LFT, ofron udhëzime të rëndësishme për bankat dhe institucionet financiare për identifikimin e veprimeve apo transaksioneve të dyshimta, duke përfshirë Shtojcën me indikatorët, të cilët nuk duhen marrë si shterues. Ajo gjithashtu ofron udhëzime mbi veprimet që duhen ndërmarrë nga zyrtarët e përputhshmërisë në banka dhe institucione financiare pasi të informohen së brendshmi mbi

¹⁰⁶ Ligji i referohet raporteve të dorëzuara në kuptimin e paragrafit (1) të nenit 21, por referenca merret të jetë në lidhje me nenin 22, i cili përcakton obligimin e raportimit nga bankat dhe institucionet financiare.

¹⁰⁷ NjIF ka informuar që shfrytëzon obligimin sipas nenit 22(2) për të marrë informata nga bankat dhe institucionet financiare që nuk janë në dispozicionin e saj, por që kërkohen nga institucionet e huaja financiare. Ekipi vlerësues nuk ndan këtë interpretim të nenit 22(2) në kuptimin e dhënies së kompetencave të tilla NjIF-it, pasi që neni 22(2) thirret vetëm nëse institucioni tashmë ka dorëzuar RTD-në, si dhe informatat e tilla që janë në dispozicion tashmë janë të ndërlidhura me atë RTD – shih komentet në Rekomandimin 26 në këtë raport.

një veprim apo transaksion të dyshimtë, duke kontribuar kështu për konsistencë brenda sektorit në menaxhimin e regjimit të raportimit.

917. Derisa reflekton obligimin e raportimit sipas Ligjit LPP/LFT, Rregulli X i BQK-së ngjashëm ofron udhëzime mbi regjimin e raportimit, por duke iu referuar obligimeve të shpallura me rregulloret e UNMIK-ut, të cilat janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit LPP/LFT.

918. Në Udhëzimin administrativ Ref FICAD: 49/2011 të nxjerrë nga Qendra e Intelejencës Financiare më 31 maj 2011, bankat dhe institucionet financiare përkujtohen që gjitha veprimet apo transaksionet e dyshimta duhen raportuar pa asnjë proces filtrimi; që gjitha veprimet apo transaksionet e dyshimta duhen raportuar brenda 24 orësh nga identifikimi i tyre; si dhe që preferohet që këto duhen dorëzuar në formë elektronike me anë të sistemit GoAML.

919. NjIF-i ka informuar që ka pranuar 145 RTD më 2010, si dhe 125 raportime më 2011 nga bankat. 3 RTD të tjerë kanë ardhur nga ofruesit jobankarë të shërbimeve MVT. Njëkohësisht, ekipi vlerësues vëren disa mangësi në formularin e raportimit në goAML, të cilat mund të kenë ndikim në cilësinë dhe efektshmërinë e raportimit (shih seksionin 2.6 të këtij raporti). Përveç kësaj, ekipi vlerësues ka gjetur brenga në numrin e përgjithshëm të RTD-ve të dorëzuara, si dhe faktin që ato janë raportuar kryesisht nga sektori bankar.

920. Përveç raportimit të transaksioneve të dyshimta në NjIF, neni 22 i Ligjit LPP/LFT gjithashtu kërkon dorëzimin e RTPG-ve për transaksionet e shumave prej 10,000 € apo më shumë tek NjIF-i.

921. NjIF ka informuar që më 2010, ka pranuar gjithsej 2,431 RTPG (1,377 nga bankat dhe 1,054 nga këmbimoret, derisa më 2011, ka marrë 3,261 RTPG (1,284 nga bankat dhe 1,977 nga këmbimoret). Vlen të theksohet, siç është thënë edhe më lart, që në të njëjtën periudhë, NjIF ka marra 145, respektivisht 125 RTD nga bankat, e asnjë nga këmbimoret.

922. Obligimi i raportimit sipas paragrafit (1) të nenit 22 të Ligjit LPP/LFT, lidhur me përkufizimit të asaj që përbën «veprim apo transaksion të dyshimtë», duke përfshirë përkufizimet e të «ardhurave nga vepra penale», si dhe «veprat paraprake penale» përbëm obligim ligjor për bankat dhe institucionet financiare që të raportojnë në NjIF.

923. Megjithatë, derisa definicioni i transaksionit të dyshimtë i referohet «një veprimi apo transaksioni», obligimi për të raportuar nuk duket të mbulojë edhe rastet kur bankat apo institucionet financiare kanë «informata në dispozicion» që një person mund të jetë i përfshirë në pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit. Situata të tilla, sipas interpretimit, mund të mbulohen nga Shtojca e Letrës këshilluese 2007/1 të BQK-së, e cila ofron udhëzime përmes indikatorëve të dyshimit.

924. Rekomandohet që riformulimi i definicionit të «veprimeve apo transaksioneve të dyshimta» duhet të përmbajë në përfundim të tij;

(definicio) Definicioni përfshin edhe situata kur informatat në dispozicion tregojnë që një person apo subjekt mund të jetë i përfshirë apo mund të jetë përfshirë më herët në aktivitete kriminale.

925. Për më tepër, dallimi i madh mes numrit të RTPG-ve dhe RTD-ve të raportuara tek NjIF-i nga bankat dhe këmbimoret, siç përmendet më lart, thekson brengat e efektshmërisë së sistemit. Duket, edhe pse nuk ka prova në dispozicion të ekipit vlerësues, që subjektet raportuese, në dorëzimin e RTPG-ve, që gjithashtu mund të jetë veprim apo transaksion i dyshimtë në kuptimin e Ligjit LPP/LFT, nuk pasojnë edhe me dorëzimin e RTD-së së ndarë.

Kështu, një transaksion që mund të jetë i dyshimtë nuk do të hetohet nga NJIF-i, pasi që NjIF-i ruan RTPG-të vetëm për qëllime të inteligjencës dhe referimit.

926. Kështu, rekomandohet që NjIF-i të ndërmarrë masat e duhura, më së pari për të siguruar që kjo nuk është duke ndodhur, e më pastaj të rrisë vetëdijen e subjekteve raportuese mbi dallimet dhe pasojat e dorëzimit të dy raporteve të ndara (RTPG dhe RTD), ku RTPG-ja si përkufizim në ligjin LPP/LFT konsiderohet edhe si veprim apo transaksion i dyshimtë, edhe sipas definicionit në ligj.

Raportimi i dyshimeve për financim të terrorizmit – Kriteri thelbësor 13.2 dhe Kriteri thelbësor IV.1 në Rekomandimin e veçantë

927. KTh 13.2 dhe RV KTh IV.1 kërkojnë nga institucionet financiare që të dorëzojnë RTD-në kur ka baza të arsyeshme për të dyshuar, ose kur ka dyshim që fondet në transaksion kanë të bëjnë apo ndërlidhen me, apo priten të përdoren për terrorizëm, vepra terroriste ose nga organizatat terroriste, apo nga ato që financojnë terrorizmin.

928. Siç është përshkruar më lart, neni 22 i Ligjit LPP/LFT kërkon nga bankat dhe institucionet financiare që të raportojnë tek NjIF-i, brenda afatit të përcaktuar, gjitha veprimet apo transaksionet e dyshimta siç definohet në Ligj. Përndryshe, Ligji nuk ofron ndonjë referencë ndaj financimit të terrorizmit në dispozitat e tij të obligimit të raportimit.

929. Obligimi për raportimin e transaksioneve të dyshimta pra është i ndërlidhur me definicionin e «veprimeve apo transaksioneve të dyshimta» në Ligjin LPP/LFT ku theksohet që definicioni nuk i referohet financimit të terrorizmit.

930. Në ofrimin e udhëzimeve dhe indikatorëve mbi atë çka përbën veprim apo transaksion të dyshimtë, Letra Këshilluese 2007/1 e BQK-së nuk përmban referenca ndaj obligimeve të Raportimit për dyshime të financimit të terrorizmit, edhe pse disa indikatorë në Shtojcë i referohen financimit të terrorizmit – p.sh. transferet e shumave të mëdha, ose transferet e shpeshta, drejt apo prej vendeve që prodhojnë substanca të paligjshme apo të njohura për aktivitete terroriste.

931. Neni 10 i Rregullit X të BQK-së reflekton obligimin e Raportimit sipas nenit 22 të Ligjit LPP/LFT si dhe ofron udhëzime në pajtim me të. Neni 10 megjithatë përmban një paragraf i cili përcakton që: *[Bankat dhe institucionet financiare duhet të raportojnë Qendrën Intelegjente Financiare (QIF), për çdo konsumator ose transaksion nëse kanë të dhëna të arsyeshme për të dyshuar se kanë ndonjë lidhje në financimin e veprimtarive terroriste apo të individëve të cilët e përkrahin terrorizmin. Duhet kushtuar kujdes të veçantë monitorimit dhe mbajtjes së listës së fundit të organizatave dhe individëve të cilët kanë lidhje me terroristë apo terrorizëm, duke u bazuar në informacionin e marrë nga Qendra Intelegjente Financiare (QIF), apo nga burimet tjera të mundshme. Poashtu, duhet kushtuar kujdes organizatave jo profitabile dhe atyre humanitare, veçanërisht nëse këto veprimtari nuk janë në pajtueshmëri me veprimtarinë e regjistruara, nëse burimi i fondeve nuk është i qartë, apo nëse këto organizata kanë pranuar mjete nga burime të dyshimta.]*

932. Për arsye të caktuara të cilat nuk i janë qartësuar ekipit të vlerësuesve, ky paragraf i Rregullit X, ndoshta për faktin që shkon përtej dispozitave të Ligjit LPP/LFT, është brenda kllapave të mesme ([]).

933. NjIF ka informuar që më 2010, ka pranuar 10 raste në lidhje me financimin e terrorizmit, 5 raste më 2011, si dhe 3 raste më 2012, deri në kohën e vizitës në terren.

934. Industria ka informuar që edhe pse nuk ka obligim të qartë ligjor, do të ishin të kujdesshëm dhe do të dorëzonin RTD-në nëse do të kishin dyshime që një transaksion mund të jetë i ndërlidhur me financimin e terrorizmit.

935. Ligji LPP/LFT ndërlidh obligimin e Raportimit me definicionin e «veprimit apo transaksionit të dyshimtë», definicioni i cili nuk përmban referencë ndaj financimit të terrorizmit. Në fakt, definicioni i referohet «të ardhurave nga vepra penale», derisa financimi i terrorizmit jo detyrimisht mund të bëhet përmes të ardhurave nga vepra penale.

936. Për më tepër, dispozita në kllapa të mesme në nenin 10 të Rregullit X të BQK-së shkon përtej dispozitave të Ligjit, si dhe në çdo rast, vlefshmëria e Rregullit si rregullore për qëllimet e Metodologjisë FATF vihet në dyshim.

937. Përmes analizës më lart të kornizës për obligimin e bankave dhe institucioneve financiare për të raportuar veprimet dhe transaksionet e dyshimta, ose personat e tillë, rrjedh që nuk ka obligim ligjor sipas Ligjit LPP/LFT për Raportimin e transaksioneve apo personave të dyshuar të jenë të lidhur me financimin e terrorizmit.

938. Kështu, rekomandohet që neni 22 i Ligjit LPP/LFT të ndryshohet si në vijim, duke mbuluar edhe veprimet apo transaksionet e tentuara, që mund të lidhen me financimin e terrorizmit (*shkronja italike*):

Neni 22 (1.1). gjitha veprimet apo transaksionet e dyshimta, ose dyshimet që një veprim apo transaksion, apo veprim apo transaksion i tentuar, mund të jetë i lidhur me financimin e terrorizmit, apo që një person apo një subjekt mund të jetë përfshirë në financimin e terrorizmit, brenda njëzetekatër (24) orësh nga koha kur veprimi apo transaksioni i tillë është identifikuar si i dyshimtë;

939. Ndryshimi i propozuar i nenit 22 mund të kërkojë ndryshime tjera në nene tjera të Ligjit LPP/LFT duke iu referuar obligimit të Raportimit të subjekteve tjera raportuese që nuk janë në sektorin financiar.

Raportimi i transaksioneve të tentuara – Kriteri thelbësor 13.3 si dhe Kriteri thelbësor në Rekomandimin e veçantë IV.2

940. KTh 13.3 dhe RV KTh IV.2 kërkojnë që gjitha transaksionet e dyshimta, e edhe ato të mbetura në tentativë të raportohen, pa marrë parasysh shumën e tyre.

941. Sipas nenit 22(1) të Ligjit LPP/LFT, gjitha veprimet apo transaksionet e dyshimta duhen raportuar tek NjIF-i pa asnjë kufizim.

942. Neni 22(1) i ligjit LPP/LFT megjithatë nuk përmban ndonjë referencë për transaksionet në tentativë, por vetëm për «veprimet apo transaksionet e dyshimta», gjë që rrjedhimisht pason definicionin e termit në Ligj, definicion ky që nuk i referohet transaksioneve të tentuara.

943. Sipas nenit 22(5) të Ligjit LPP/LFT, bankat dhe institucionet financiare obligohen të njoftojnë NjIF-në para se të ndërmarrin veprime në lidhje me ndonjë veprim apo transaksion të dyshimtë, që do të mund të rezultonte në lirim apo transferimin e pronës që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i bankës apo institucionit financiar.

944. Letra këshilluese 2007/1 e BQK-së nuk thotë gjë mbi transaksionet në tentativë.

945. Në anën tjetër, si dhe pa paragjykuar qëndrimin e marrë me këtë Raport mbi vlefshmërinë si rregullore për qëllimet e Metodologjisë FATF, neni 10 i Rregullit X të BQK-

së kërkon që në rastet kur banka apo institucioni financiar vendos të mos hyjë në marrëdhënie afariste për shkak të dyshimit të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, ai institucion do t'i raportojë çështjen Qendrës së Inteligjencës Financiare (tani NjIF) menjëherë.

946. Obligimi i raportimit sipas nenit 22(1) të Ligjit LPP/LFT ndërlidhet me definicionin e «veprimit apo transaksionit të dyshimtë». Edhe pse definicioni nuk tregon nëse është në kohën e kaluar, pra nëse transaksioni është ndërmarrë tashmë, ose në të tashmen, që transaksioni të jetë duke u bërë apo propozohet që të ndërmerret, interpretimi i besueshëm do të ishte që definicioni i referohet veprimit apo transaksioneve që kanë ndodhur.

947. Obligimi i raportimit sipas nenit 22(5) mund të interpretohet si obligativ para se të kryhet transaksioni – në fakt, fryma e dispozitës është e tillë, sepse transaksioni nuk mund të ndërpritet nga NjIF-i me kohë. Megjithatë, kjo mund të interpretohet. Fjalët *që mund të rezultojë me lëshimin apo transferimin e pasurisë që i nënshtrohet transaksionit nga kontrolli i bankës apo institucioni financiar* tregojnë që transaksioni është në kohën e kaluar, pasi në një transaksion të tentuar, «pasuria që i nënshtrohet transaksionit» nuk do të kalonte në kontrollin e bankës apo institucionit financiar.¹⁰⁸

948. Dispozita e nenit 10 të Rregullit X të BQK-së është më e lidhur me themelimin e marrëdhënies afariste kundrejt tentimit të transaksionit – edhe nëse dispozitat e Rregullit X merren si të vlefshme në kontekstin e Metodologjisë FATF si rregullore.

949. Ky raport gjen pra që korniza aktuale e raportimit të transaksioneve të dyshimta nuk përfshin transaksionet në tentativë që nuk mund të ekzekutohen.

950. Kështu, rekomandohet që Ligji LPP/LFT të ndryshohet që të përcaktojë që obligimi i Raportimit të vlejë edhe tentativat e transaksionit, siç kërkohet me Standardin e FATF-së.

951. Një mënyrë e përfshirjes së këtij obligimi, derisa ruhet edhe korniza aktuale e raportimit brenda Ligjit LPP/LFT, është të ndryshohet definicioni i «veprimit apo transaksionit të dyshimtë» duke futur edhe referenca ndaj «veprimeve dhe transaksioneve në tentativë».¹⁰⁹

Raportimi i transaksioneve të dyshimta që mund të përfshijnë çështje tatimore – Kriteri thelbësor 13.4 dhe Kriteri thelbësor në Rekomandimin e veçantë IV.2

952. KTh 13.4 dhe RV KTh IV.2 kërkojnë që obligimi i raportimit për transaksione të dyshimta të vlejë edhe në rrethana ku transaksioni mund të përfshijë çështje tatimore.

953. Ligji LPP/LFT në thelb është i heshtur në përmendjen e kësaj çështjeje, pasi që obligimi i Raportimit është i ndërlidhur me definicionin e «veprimit apo transaksionit të dyshimtë», definicion ky që përfshin edhe referencën ndaj «të ardhurave nga veprat penale», si dhe që në anën tjetër i referohet pasurisë së fituar drejtpërdrejt apo tërthorazi nga një vepër paraprake penale, p.sh. ndonjë vepër që krijon të ardhura nga vepra penale.

954. Letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulli X i BQK-së janë të heshtura në këtë çështje.

955. Paragrafi (1) i nenit 313 (Shmangia nga tatimi) të Kodit Penal përcakton që: *Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo t'i shmanget, pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të*

¹⁰⁸ Pasi ndërprerja e transaksionit nuk bën pjesë në kriteret e Rekomandimit 13, autoritetet e Kosovës mund të marrin parasysh edhe ndërprerjen e transaksioneve, brenda kontekstit të shqyrtimit të ligjit.

¹⁰⁹ Duhet theksuar që Projektligji për ndryshim/plotësimin e Ligjit LPP/LFT tashmë e ka këtë propozim.

pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

956. Për më tepër, paragrafi (1) i nenit 314 (Dokumentet e rrejshme në lidhje me tatimin) i Kodit Penal përcakton që: *Kushdo që jep deklaratë të rrejshme ose lëshon dokument të rrejshëm kur paraqitja e deklaratës apo dokumentit të vërtetë kërkohet me ligj, ose kushdo që nuk lëshon dokumentin lëshimi i të cilit kërkohet me ligj, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.*

957. Pra, rrjedh që për qëllimet e nenit për shmangien nga tatimi në Kodin Penal, duke përfshirë edhe dorëzimin e dokumenteve të rrejshme në lidhje me tatimet, që është veprë penale, pra do të mund të përfshihej brenda definicionit të «veprimeve apo transaksioneve të dyshimta» në ligjin LPP/LFT.

958. Rrjedhimisht, obligimi i raportimit sipas nenit 22 të Ligjit LPP/LFT vlen edhe për qëllimet e KTh 13.4 dhe RV KTh IV.2.

Raportimi në rastet kur fondet dyshohen të jenë të ardhura nga veprat penale që përbëjnë veprë paraprake – Kriteri shtesë 13.5

959. Kriteri shtesë 13.5 kërkon që obligimi për institucionet financiare që të raportojnë të zgjerohet në dyshimet apo bazat e arsyeshme të dyshimit që fondet në një transaksion janë të ardhura nga gjitha veprat penale që do të përbënin veprë paraprake për pastrimin e parave në vend.

960. Siç theksohet më lart, obligimi i raportimit për banka dhe institucione financiare sipas nenit 22(1) të Ligjit LPP/LFT është i ndërlidhur me definicionin e “veprimeve apo transaksioneve të dyshimta” me referencë ndaj “të ardhurave nga veprat penale”, si dhe në anën tjetër definicioni i referohet pasurisë që është përfituar drejtpërdrejt apo tërthorazi nga një veprë paraprake penale, pra çfarëdo veprë që krijon të ardhura kriminale.

961. Obligimi për të raportuar sipas nenit 22(1) të Ligjit LPP/LFT mbulon gjitha veprat penale që përbëjnë veprë të ndërlidhur penale sipas definicionit të “veprimeve apo transaksioneve të dyshimta”.

962. Fjalët që “përbëjnë veprë të ndërlidhur penale për pastrim të parave brenda vendit” e bën të interpretueshëm obligimin sipas Kriterit shtesë 13.5. Kjo do të mund t’i referohej situatave në të cilat vepra penale kryhet brenda vendit apo situatave kur vepra penale është kryer jashtë vendit, aty ku paratë pastrohen.

963. Ligji LPP/LFT, në ndërlidhjen e obligimit të raportimit me definicionin e “veprimit apo transaksionit të dyshimtë” nuk bën dallimin nëse të ardhurat janë nga një veprë penale që është kryer brenda apo jashtë vendit.

964. Për më tepër, bankat dhe institucionet financiare nuk janë të obliguara të identifikojnë veprën paraprake penale dhe nëse vepra e tillë është e vendit apo e huaj, pasi që obligimi për Raportim i nënshtrohet vetëm dyshimit të arsyeshëm që fondet në transaksion janë të ardhura nga aktiviteti kriminal.

Efektshmëria (përgjithësisht për Rekomandimin 13 dhe Rekomandimin e veçantë IV)

965. Dobësitë e identifikuara si më lart dhe që theksohen më poshtë negativisht ndikojnë efektshmërinë e regjimit raportues. Ky është rezultat i cilësisë dhe sasisë së RTD-ve të pranuar nga NjIF-i, gjë që do të mund të ndikohej përmes sistemit raportues të RTPG-ve.

Gjithashtu, si rezultat i mangësive në vetë obligimin për raportim, në kuptimin e financimit të terrorizmit dhe transaksioneve në tentativë.

966. Mungesa e përgjigjes kthyese nga NJIF-i për subjektet raportuese në lidhje me përfundimin e rasteve, si dhe përgjigjeve kthyese të përgjithshme mbi tipologjitë, negativisht ndikon cilësinë e RTD-ve.

3.6.2. Rekomandimet dhe komentet (përgjithësisht për Rekomandimin FATF 13* dhe Rekomandimin e Veçantë IV)

967. Analiza e Rekomandimit 13 mbi obligimin e Raportimit, si dhe RV IV mbi obligimin e Raportimit për financimin e terrorizmit, identifikon dobësi të ndryshme serioze në kornizën e regjimit parandalues për banka dhe institucione financiare në Kosovë.

968. Ky raport ka shprehur brengat e përgjithshme për vlefshmërinë e Letrës Këshilluese 2007/1 dhe Rregullit X të BQK-së brenda kontekstit të Rregulloreve të shfuqizuara të UNMIK-ut, të cilave iu referohen të dy dokumenteve, si dhe statusit të tyre në kuptimin e Metodologjisë së FATF-së. Ky Raport gjen që të dy dokumentet nuk mund të konsiderohen si “rregullore”, edhe pse në momente të caktuara shkojnë edhe përtej dispozitave të vetë Ligjit.

969. Brenda këtij konteksti, dobësitë e mëdha të identikuara në Ligjin LPP/LFT brenda kontekstit të Kriterëve Thelbësorë për Rekomandimin 13* të FATF-së dhe RV IV do të mund të përmbledheshin si në vijim, edhe pse fillimisht rekomandohet leximi i Përshkrimit dhe Analizës për kriteret specifike:

- Obligimi i Raportimit nuk mbulon situatat në të cilat informatat në dispozicion tregojnë që personi mund të jetë ose mund të ketë qenë i përfshirë në pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit (KTH 13.1);
- Numri i vogël i RTD-ve të dorëzuara, si dhe kështu edhe brengat për dallimet e mëdha mes numrit të RTPG-ve dhe RTD-ve të dorëzuar, të cilat do të mund të ndikonin negativisht edhe në regjimin e Raportimit (KTH 3.1);
- Obligimi i Raportimit nuk mbulon Raportimin e transaksioneve apo veprimeve që mund të jenë të lidhur me financimin e terrorizmit (KTH 13.2 dhe RV IV.1); si dhe
- Obligimi i Raportimit nuk mbulon transaksionet në tentativë (KTH 13.3 dhe RV IV.2).

970. Rekomandimet për korrigjimin e dobësive të identikuara ofrohen në analizat e KTH specifike. Derisa këshillohet që rekomandimet të lexohen në kontekstin e analizës së KTH-së specifike, rekomandimet kryesore i referohen:

- Ndryshimit të definicionit të “veprimeve dhe transaksioneve të dyshimta” për të përfshirë edhe situatat ku informatat në dispozicion tregojnë që një person apo subjekt mund të jetë përfshirë në aktivitete kriminale;
- Ndryshimit të nenit 22 për të futur edhe obligimin e Raportimit për financimin e terrorizmit; si dhe
- Ndryshimit të definicionit të “veprimeve apo transaksioneve të dyshimta” për të përfshirë edhe veprimet dhe transaksionet në tentativë; dhe
- NJIF-it që të ndër marrë masa për të siguruar që RTPG-të që përbëjnë dyshim të raportohen edhe si RTD si dhe për të rritur vetëdijen për këtë.

3.6.3. Klasifikimi për Rekomandimin 13 dhe Rekomandimin e Veçantë IV

Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
-------------	---

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
Rek 13	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka obligim raportimi në situata ku informatat në dispozicion tregojnë pastrimin e mundshme të parave apo aktivitetet e financimit të terrorizmit; • Format rigjide të raportimit dhe mungesa e përgjigjeve kthyesa specifike dhe strategjike, si dhe udhëzimeve për subjektet raportuese, çojnë në RTD me cilësi të dobët, si dhe kërkesa të shumta për informata shtesë, duke e ngarkuar tepër NJIF-në dhe industrinë si të tillë; • Nuk ka obligim raportimi për financimin e terrorizmit; • Nuk ka obligim raportimi për veprimet apo transaksionet e dyshimta në tentativë; • Numri i vogël i RTD-ve; • Brenga për mosdorëzimin e RTPG-ve të dyshimta si RTD; dhe • Çështjet e efektshmërisë në lidhje me cilësinë dhe sasinë e raportimit të RTD-ve dhe raportimit të RTPG-ve të dyshimta.
RV IV	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka obligim raportimi në situatat ku informatat në dispozicion tregojnë aktivitete të mundshme të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit; • Format rigjide të raportimit dhe mungesa e përgjigjeve kthyesa specifike dhe strategjike, si dhe udhëzimeve për subjektet raportuese, çojnë në RTD me cilësi të dobët, si dhe kërkesa të shumta për informata shtesë, duke e ngarkuar tepër NJIF-në dhe industrinë si të tillë; • Nuk ka obligim raportimi për financimin e terrorizmit; • Nuk ka obligim raportimi për veprimet apo transaksionet e dyshimta në tentativë; • Numri i vogël i RTD-ve; • Brenga për mosdorëzimin e RTPG-ve të dyshimta si RTD; dhe • Çështjet e efektshmërisë në lidhje me cilësinë dhe sasinë e raportimit të RTD-ve dhe raportimit të RTPG-ve të dyshimta

3.7. Mbrojtja dhe moszbulimi (R.14)

3.7.1. Përshkrimi dhe analiza

971. Kërkesat në Rekomandimin 14 janë dydrejtimëshe. Rekomandimi 14 kërkon që institucionet financiare, drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët e tyre të mbrohen me dispozita ligjore nga përgjegjësia penale dhe civile për shkelje të konfidencialitetit, kur raportojnë dhe zbulojnë informatat para NjIF-it në mirëbesim dhe në pajtim me dispozitat e ligjit. Rekomandimi 14 më tutje parasheh që institucionet financiare, drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët e tyre ta kenë të ndaluar të zbulojnë që një RTD apo informata përkatëse do t'i raportohen NjIF-it.

Mbrojtja për Raportim tek NjIF-i – Kriteri thelbësor 14.1

972. KTh 14.1 kërkon që institucionet financiare, drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët e tyre, qofshin ata me afat të përhershëm apo të përkohshëm, të mbrohen me ligj nga përgjegjësia penale apo civile kur raportojnë në mirëbesim tek NjIF-i.

973. Neni 35 i Ligjit LPP/LFT përcakton që *pavarësisht nga dispozitat kundërthënëse të ligjit në fuqi, asnjë veprim për përgjegjësinë civile a penale dhe asnjë sanksion profesional*

nuk mund të ndërmerret ndaj ndonjë personi apo subjekti bazuar vetëm në transmetimin e informatave në mirëbesim, dorëzimin e raporteve apo veprimeve të tjera në pajtim me këtë Ligj, apo transmetimin vullnetar të informatave në mirëbesim lidhur me aktin apo transaksionin e dyshimtë, pastrimin e dyshimtë të parave apo financimin e dyshimtë të aktiviteteve terroriste tek NjIF-ja.

974. Letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulli X i BQK-së janë të heshtura në këtë çështje.

975. Ligji LPP/LFT ofron mbrojtje për “çdo person apo subjekt”. Brenda kontekstit të Ligjit LPP/LFT, termi “ndonjë person apo subjekt” do të mund të interpretohej që mbulon subjektet raportuese sipas nenit 16 të Ligjit, si dhe çdo person apo subjekt tjetër që obligohet të raportojë tek NjIF-i sipas Ligjit – për shembull OJQ-të dhe partitë politike. Është e vështirë që interpretimi i tillë të mbulojë edhe drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët e subjektit raportues.

976. Mbrojtja sipas Ligjit LPP/LFT ofrohet *pavarësisht nga dispozitat kundërthënëse të ligjit në fuqi*, duke siguruar kështu që *lex specialis* (ligj special), Ligji LPP/LFT të tejkalojë çdo dispozitë tjetër në çfarëdo ligji tjetër që mund të kërkojë përgjegjësi penale apo civile për shkelje të konfidencialitetit. Megjithatë, mbrojtja është e kushtëzuar me faktin që secili zbulim i tillë të bëhet në mirëbesim dhe brenda dispozitave të Ligjit LPP/LFT.

977. Pa anashkaluar këto, neni 35 i Ligjit LPP/LFT do të mund të ndryshohej pak për një mbulim më adekuat të KTh 14.1, duke futur edhe fjalët *dhe drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët e tyre, pa marrë parasysh a janë të përkohshëm apo të përhershëm*, menjëherë pas fjalëve “ndonjë personi apo subjekti”.

Ndalimi i zbulimit të raporteve për NjIF-në (zbulimi) – Kriteri thelbësor 14.2

978. KTh 14.2 kërkon që institucionet financiare, drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët e tyre, qofshin ata me afat të përhershëm apo të përkohshëm, ta kenë të ndaluar t’i zbulojnë cilitdo person, përfshirë edhe personit të dyshuar, faktin që RTD apo informata të tilla do t’i raportohen apo jepen NjIF-it.

979. Duhet theksuar më tutje që neni 28 i Direktivës së tretë të BE-së për LPP vendos ndalimin e zbulimit të informatave jo vetëm kur është dorëzuar Raporti apo i është raportuar informata NjIF-it, por edhe në situata ku hetimet për pastrim të parave apo financim të terrorizmit janë në vazhdim apo mund të ndërmerren.

980. Paragrafi (4) i nenit 22 të Ligjit LPP/LFT ndalon drejtorët, zyrtarët, punëtorët dhe agjentët e çdo banke apo institucioni financiar që bëjnë apo transmetojnë raporte në bazë të ligjit nga dhënia e Raportit, apo komunikimi i informatave në raport apo në lidhje me Raportin, për çfarëdo personi apo subjekti, duke përfshirë personin apo subjektin e përfshirë në transaksionin që është lëndë e Raportit, përveç NjIF-it dhe BQK-së. Megjithatë, neni 22 mundëson zbulimin e tillë nëse autorizohet me shkrim nga NjIF-i, prokurori apo gjykata.

981. Letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulli X i BQK-së janë të heshtur në këtë drejtim.

982. Paragrafi (4) i nenit 22 duket të ketë mbulesë adekuate të kërkesave të KTh 14.2. Megjithatë, analiza e dispozitave brenda nenit me kërkesat e KTh 14.2 prapë identifikon disa mangësi.

983. Paragrafi (4) i nenit 22 të Ligjit LPP/LFT nuk ndalon bankën apo institucionin financiar vetë, por vetëm drejtorët, zyrtarët, punëtorët dhe agjentët nga zbulimet e tilla.

984. Neni 22 nuk specifikon punëtorët si të përkohshëm apo të përhershëm, derisa termi “agjentë” nuk mund të interpretohet në mënyrë të mirëfilltë.

985. Ndalesa nuk ka të bëjë me zbulimin e faktit që Raporti është dorëzuar apo është duke u dorëzuar në NjIF, por me dhënien e raportit apo informatave të tilla për palët e treta, duke përfshirë vetë personin që është subjekt i raportit. Kështu që, edhe pse shkon përtej KTh, nuk e përfshin KTh-në.

986. Ndalesa nuk mbulon faktin që hetimi është duke u kryer apo mund të kryhet.

987. Pra, rekomandohet që paragrafi (4) i nenit 22 të Ligjit LPP/LFT të ndryshohet si në vijim (italike dhe të hijezuara) për qëllimet e Rekomandimit 14 të FATF-së. Megjithatë, këshillohet më tutje që t'i referoheni pjesëve të mëtuqjeshme të këtij Raporti tek rekomandimet për shqyrtim brenda kontekstit të nenit 28 të Direktivës së Tretë të BE-së për LPP, si dhe analizës së mëposhtme në lidhje me nenin 7 të Konventës së Këshillit të Evropës:

*Bankat dhe institucionet financiare, drejtorët, zyrtarët, punëtorët e tyre (qofshin të përkohshëm apo të përhershëm) dhe agjentët që hartojnë apo transmetojnë raporte sipas këtij neni, ose të cilët kanë njohuri për një fakt të tillë, duke përfshirë rastet kur është duke u bërë apo mund të bëhet hetimi për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, nuk duhet të ~~provide~~ zbulojnë faktin që raporti është dorëzuar apo është në proces të dorëzimit, apo të komunikojnë informata nëse është përmbajtje e raportit ose është në lidhje me raportin, duke përfshirë rastet kur informata të tilla janë në përgatitje për t'u dorëzuar, apo që hetimi është duke u bërë a mund të bëhet për pastrim të parave apo financim të terrorizmit, para asnjë personi apo subjekti të përfshirë në transaksionin që është subjekt i raportit *opo hetimit*, përveç NjIF-it apo BQK-së, përveç nëse ai person është i autorizuar me shkrim nga NjIF-i, prokurori apo gjykata.*

988. Më tutje rekomandohet që kjo ndalesë të zgjerohet edhe tek fushat tjera të raportimit sipas Ligjit LPP/LFT në lidhje me OJQ-të, partitë politike dhe «profesionistët e mbuluar»¹¹⁰, si dhe me subjektet e tjera raportuese.

Konfidencialiteti i emrave dhe informatave personale të punëtorëve që hartojnë raportin – Kriteri shtesë 14.3

989. Kriteri shtesë 14.3 kërkon të vendosë mbrojtjen që ofrohet për konfidencialitetin e identitetit të personelit të institucioneve financiare që hartojnë dhe dorëzojnë RTD-të tek NjIF-i.

990. Paragrafi (1.17) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT vendos obligimin tek personeli i NjIF-it për të ruajtur si konfidenciale gjitha informatat e siguruar brenda fushëveprimit të detyrave të tyre, edhe pas përfundimit të detyrave të tyre brenda Njësisë, si dhe informatat e tilla mund të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara me Ligjin LPP/LFT.

991. Paragrafi (1.3) i nenit 15 të Ligjit LPP/LFT megjithatë lë një hapësirë dhe përcakton të dhënat që mund të zbulohen nga NjIF-i, is dhe rrethanat në të cilat të dhënat e tilla mund të zbulohen. Një e dhënë e tillë që NjIF-i mund të zbulojë, me kusht që kjo të bëhet në pajtim me paragrafin (2) të nenit 15, përbën *çdo të dhënë që ka të bëjë me një person apo subjekt që ka ofruar informata apo regjistra për NjIF-në që drejtpërdrejt apo tërthorazi identifikon personin apo subjektin.*

¹¹⁰ Dispozitat e këtilla tanimë janë trajtuar me Projektligjin për ndryshime, si dhe ky rekomandim ka për synim të konfirmojë njohjen e atyre ndryshimeve.

992. Paragrafi (2) i nenit 15 të Ligjit LPP/LFT i cituar si më poshtë përcakton që NjIF-i të zbulojë informatat e lartpërmendura:

- 2.1. Njësinë përkatëse të policisë, Njësinë për Hetime Financiare, Agjencinë Kosovare të Inteligjencës, prokurorin kompetent, Doganat e Kosovës, Departamentin e Administratës Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ose KFOR-in, nëse informacioni do të ishte relevant për hetimet në kuadër të kompetencës së saj ose për ndonjë organ jashtë Kosovës me funksione të ngjashme të NJIF-it;
- 2.2. një organ publik ose qeveritar të Kosovës nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente NJIF-it;
- 2.3. organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit ose ato organe që kryejnë funksion të ngjashëm me NJIF-në, jashtë Kosovës, nëse ky publikim i informacionit do t'i shërbente ose do t'i ndihmonte NJIF-itt që të kryejë funksionet e saj;

993. Letra këshilluese 2007/1 dhe Rregulli X i BQK-së janë të heshtura për këtë çështje.

994. Ligji LPP/LFT duket të ofrojë një hapësirë nga konfidencialiteti absolut sipas Ligjit LPP/LFT për zbulim të çdo të dhëne në lidhje me një person apo subjekt që ka ofruar informata apo të dhëna për NJIF-në që drejtpërdrejt apo tërthorazi identifikon personin apo subjektin.

995. Për më tepër, paragrafi (2) i nenit 15 të Ligjit LPP/LFT përcakton një numër autoritetesh vendore dhe të huaja (për arsye të caktuara edhe NjIF-në vetë) tek të cilët NjIF-i mund ta zbulojë këtë informatë – arsyeja mbetet e paqartë.

996. Termi «person apo subjekt që ka ofruar informata» interpretohet si i tillë që mbulon subjektet e raportimit sipas nenit 16 të Ligjit, si dhe çdo person apo subjekt tjetër të obliguar të raportojë tek NjIF-i sipas ligjit – për shembull OJQ-të dhe partitë politike – në përputhje me interpretimin që ofrohet me këtë raport sipas analizës së KTh 14.1.

997. Gjithashtu duket që, edhe pse paragrafi (3) i nenit 15 kufizon zbulimet e tilla vetëm tek qëllimet e inteligjencës, NjIF-i mund t'i zbulojë informatat e tilla para autoriteteve të përmendura për arsye të tjera, përveç hetimit të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

998. Kështu duket që, sipas interpretimit të ofruar me këtë raport ndaj termit «secili person apo subjekt» brenda kontekstit të Ligjit LPP/LFT, Ligji tërthorazi mbron identitetin e punëtorëve që hartojnë raporte apo ofrojnë informata.

999. Kështu këshillohet që të sigurohet që paragrafi (1.3) i nenit 15 nuk mbulon emrat dhe kontaktet personale të personelit në bankë apo institucion financiar, apo ndonjë subjekti tjetër raportues që harton raportin apo ofron informatën.

1000. Pa anashkaluar këto, këshillohet që të rishikohet paragrafi (2) i nenit 15 të Ligjit, më së pari për të hequr dyfishimin (për shembull: referenca ndaj një organi jashtë Kosovës me funksione të ngjashme me NjIF-në tek 2.1 dhe tek 2.3), por më me rëndësi për të kufizuar subjektet apo autoritetet tek të cilët mund të jepet informata tek ata të cilëve NjIF-i do t'i dërgonte raportin e vet të analizës - edhe pse do të preferohej që një informacion i tillë të mos shpalohej fare.

1001. Referojuni edhe seksionit më poshtë në lidhje me nenin 27 të Direktivës së tretë evropiane të LPP-në.

Mbrojtja e punëtorëve nga kërcënimet apo veprimet armiqësore – neni 27, Direktiva e tretë evropiane LPP

1002. Neni 27 i Direktivës së tretë Evropiane LPP vendos obligimin tek shtetet anëtare që të ndër marrin gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur punëtorët e personave dhe subjekteve raportuese sipas Direktivës, të cilët raportojnë NjIF-it dyshimet e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit qoftë nga brenda apo nga jashtë, nga ekspozimi ndaj kërcënimeve dhe veprimeve armiqësore.

1003. «Përshkrimi dhe Analiza» sipas analizës së Kriterëve shtesë 14.3 më lart gjithashtu vlen për nenin 27 të Direktivës së tretë LPP të BE-së.

1004. Komentet e dhëna tek analiza për Kriteret shtesë 14.3 në përgjithësi vlejnë edhe për nenin 27 të Direktivës së tretë LPP të BE-së.

1005. Pavarësisht konkludimeve të këtij raporti sipas Kriterëve shtesë 14.3 më lart, Ligji LPP/LFT nuk përcakton llojin e mbrojtjes së punëtorëve siç përcaktohet me nenin 27 të Direktivës së tretë të BE-së LPP/LFT.

1006. Në vazhden e rekomandimeve sipas Kriterit shtesë 14.3 si më lart, rekomandohet që t'i shtohet një paragraf i ri (4) nenit 15, duke obliguar secilin autoritet që për një arsye të caktuar ka informata personale mbi punëtorët e subjekteve raportuese që kanë dorëzuar një raport apo kanë dhënë informata që t'i mbrojnë ato informata dhe t'i ruajnë si konfidenciale, si në vijim:

Neni 15 (4) NjIF-i, cilido autoritet hetues, akuzues, gjyqësor apo administrativ, dhe subjektet raportuese apo personat e subjektet tjera që posedojnë informata personale të punëtorëve të subjekteve raportuese që raportojnë dyshime për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, apo që ofrojnë informata përkatëse qoftë organeve të tyre të brendshme ose NjIF-së, duhet të mbrojnë dhe t'i ruajnë si konfidenciale ato informata personale».

Heqja e ndalesës së zbulimit – neni 28, Direktiva e tretë e BE-së për LPP

1007. Siç është theksuar më lart në analizën për KTh 14.2, neni 28 i Direktivës së tretë të BE-së për LPP parasheh ndalesën e zbulimit të informatave, jo vetëm kur dorëzohet raporti apo ofrohet informata për NjIF-në, por edhe në situata kur hetimi për pastrim parash apo financim terrorizmi është duke u kryer apo mund të kryhet.

1008. Neni 28 i Direktivës së tretë të BE-së për LPP megjithatë parasheh situata të kategorizuara ku ndalesa e zbulimit mund të hiqet:

- Zbulimi tek autoritetet kompetente mbikëqyrëse ose për qëllime të zbatimit të ligjit;
- Zbulimi mes bankave dhe institucioneve financiare që janë pjesë e të njëjtit grup të shërbimeve financiare;
- Zbulimi mes firmave të kontabilitetit dhe të profesionit juridik ose punëtorëve të tyre brenda të njëjtit person juridik apo «rrjet»;¹¹¹
- Zbulimi mes bankave, institucioneve financiare, si dhe kontabilitetit dhe profesionit juridik, në të cilat raste zbulimi përfshin të njëjtin konsumator dhe të njëjtat transaksione, si dhe personat apo subjektet raportuese që janë nga e njëjta kategori profesionale.

¹¹¹ Direktiva e BE-së definon «rrjetin» si «strukturë më e madhe të cilës personi i përket, si dhe e cila ndan kontrollin e përbashkët pronësor, menaxherial apo të përputhshmërisë».

1009. Heqja e ndalesës sipas nenit 28 vlen mes shteteve anëtare ose me ahtetet joanëtare që vendosin kërkesa për parandalimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, të cilat janë ekuivalente me ato që parashihen në Direktivë.

1010. Siç përshkruhet me analizën e epërme të KTh 14.2 në këtë raport, paragrafi (4) i nenit 22 të Ligjit LPP/LFT ndalon drejtorët, zyrtarët, punëtorët dhe agjentët e secilës bankë apo institucion financiar që harton apo transmeton raportet në bazë të ligjit nga ofrimi i raportit, apo komunikimit të informatave të raportit apo në lidhje me raportin, për cilindo person apo subjekt, duke përfshirë personin apo subjektin e përfshirë në transaksionin që është subjekt i raportit, përveç NjIF-it apo BQK-së. Megjithatë, neni 22 përcakton zbulimet nëse autorizohen me shkrim nga NjIF-i, prokurori apo gjykata.

1011. Paragrafi (4) i nenit 22 të Ligjit LPP/LFT në përgjithësi mund të interpretohet që mbulon nenin të Direktivës së Tretë të BE-së për LPP, në kuptimin që i jep autorizimin NjIF-it, prokurorit apo gjykatës që të heqë ndalesën e tillë. Për më tepër, ndalesa nuk përfshin edhe BQK-në, si ushtrues aktual i autoritetit mbikëqyrës.¹¹²

1012. Megjithatë, nuk duket që të përmbajë ndonjë udhëzim mbi rrethanat dhe qëllimet, në të cilat NjIF-i apo prokurori mund të heqë ndalesën e zbulimit.

1013. Një pjesë e institucioneve dhe organizatave, sidomos ato bankare dhe institucione financiare që përbëjnë pjesë të grupeve më të mëdha ndërkombëtare, kanë shprehur brengën që e kanë të ndaluar të ndajnë informata brenda grupit, pjesë e të cilit janë, përveç nëse autorizohen për këtë sipas dispozitës së ligjit.

1014. Vlen të theksohet që me Rekomandimin e ri 18 të Standardeve të FATF-së 2012 (më herët Rekomandimet 15 dhe 22), kërkesa është pjesërisht që programet e grupeve financiare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duhet të përfshijë ndarjen e informatave për KDK dhe qëllime të menaxhimit të rrezikut – gjë që interpretohet si përfshirje e ndarjes së informatave kur ka dyshim të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, që mund të jetë në nivel grupi.

1015. Pra, rekomandohet që autoritetet kosovare të shqyrtojnë dispozitat e nenit 28 të Direktivës së Tretë të BE-së, si dhe standardet FATF 2012 në këtë drejtim, me qëllim ose të ndryshimit të Ligjit LPP/LFT sipas tyre, ose të ndryshimit të ligjit LPP/LFT me qëllim të fuqizimit të NjIF-it, që të ofrojë udhëzime mbi rrethanat në të cilat do të ishte e përgatitur të jepte miratimin për zbulim, përveç atyre që përcaktohen me ligj. Më tutje, është me rëndësi që autoritetet kosovare ta shqyrtojnë këtë brenda kontekstit të bankave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë.

Ndalesa e zbulimit – neni 7 i CETS 198¹¹³

1016. Neni 7 i CETS 198 kërkon nga palët nënshkruese të Konventës që të miratojnë masa legislative apo të tjera për t'i mundësuar atyre që të:

- a përcaktojnë nëse një person fizik apo juridik është mbajtës apo pronar i beneficuar i një apo më shumë llogarive, të çfarëdo lloji natyre, në cilëndo bankë

¹¹² Referojuni nenit 3.9 dhe 3.10 në lidhje me autoritetin mbikëqyrës dhe pushtetin e BQK-së për qëllimet e ligjit LPP/LFT

¹¹³ Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës (CETS) 198 i referohet Konventës së Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit, të nënshkruar në Varshavë më 16 maj 2005, në të cilën Kosova nuk është palë nënshkruese, së paku jo në kohën e hartimit të këtij raporti.

të vendosur në territorin e tij, si dhe nëse është kështu, të marrin gjitha informatat mbi llogaritë e identifikuara;

- b marrin informatat mbi llogaritë e specifikuara bankare dhe mbi operacionet bankare që janë kryer gjatë një periudhe të specifikuar përmes një apo më shumë llogarive të specifikuara, duke përfshirë informatat e llogarive dërguese apo pranuese;
- c monitorojnë, gjatë një periudhe të specifikuar, operacionet bankare që janë duke u kryer përmes një apo më shumë llogarive të identifikuara

1017. Paragrafi (2d) i nenit 7 të CETS 198 në anën tjetër kërkon nga palët nënshkruese të Konventës që të kenë masa legislative apo të tjera për të siguruar që bankat të mos zbulojnë para personit në fjalë apo para palëve të treta që informatat e tilla janë kërkuar apo që hetimi është duke u bërë.

1018. Paragrafi (1.17) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT vendos obligimin mbi personelin e NjIF-it që të mbajë konfidenciale gjitha informatat që sigurohen brenda fushëveprimit të detyrave të tyre, edhe pas ndërprerjes së detyrave të tyre në Njësi, si dhe që informatat e tilla mund të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara me Ligjin LPP/LFT.

1019. Paragrafi (4) i nenit 22 të Ligjit LPP/LFT ndalon drejtorët, zyrtarët, punëtorët dhe agjentët e çdo banke apo institucioni financiar që bëjnë apo transmetojnë raporte në bazë të ligjit nga dhënia e Raportit, apo komunikimi i informatave në raport apo në lidhje me Raportin, për çfarëdo personi apo subjekti, duke përfshirë personin apo subjektin e përfshirë në transaksionin që është lëndë e Raportit, përveç NjIF-it dhe BQK-së. Megjithatë, neni 22 ofron zbulime, nëse autorizohen me shkrim nga NjIF-i, prokurori apo gjykata.

1020. Ndalesa e zbulimit brenda kontekstit të Standardeve FATF (Rekomandimi 14) tanimë është diskutuar në analizën e mësipërme të KTh 14.2 në këtë raport. Megjithatë, siç mund të shihet nga neni 7 i CETS 198, ndalesa e zbulimit në Konventë mbulon çështje të tjera që nuk përfshihen në standardet e FATF-së apo Direktivën e tretë të BE-së për LPP.

1021. Në paragrafin e përgjithshëm (1.17) të nenit 14 të Ligjit LPP/LFT që vendos konfidencialitetin për personelin e NjIF-it mund të interpretohet më gjerësisht si mbulim i situatave sipas nenit 7 të Konventës. Megjithatë, edhe Ligji aktual LPP/LFT përcakton që dispozitat specifike që ndalojnë zbulimin janë të nevojshme, siç mund të shihet tek paragrafi (4) i nenit 22 të Ligjit LPP/LFT.

1022. Megjithatë, ndalesa sipas paragrafit (4) të nenit 22 të Ligjit LPP/LFT, edhe me amandamentin e propozuar me analizën e mësipërme të KTh 14.2 nuk do të përmbushte obligimet sipas nenit 7 të CETS 198.

1023. Pra, propozohet që autoritetet të shqyrtojnë, pasi që Kosova nuk është nënshkruese e Konventës, që nëse dëshiron të bëhet nënshkruese e Konventës, ose përndryshe dëshiron të miratojë masa të tilla thjesht si praktikë e mirë për bashkëpunim më të mirë ndërkombëtar, atëherë në nenin 22 të Ligjit LPP/LFT duhet të shtohet një paragraf i ri (4A), si në vijim:

Neni 22 para 4A Për më tepër, bankat dhe institucionet financiare, drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët e tyre (qofshin të përkohshëm apo të përkohshëm), si dhe agjentët që kanë informata në këtë drejtim, nuk duhen t'i zbulojnë asnjë personi apo subjekti, duke përfshirë personin apo subjektin e përfshirë, faktin që banka apo institucioni financiar është obliguar që të:

- Përcaktojë dhe ofrojë informata nëse personi fizik apo juridik është mbajtës apo pronar përfitues i një apo më shumë llogarive;

- Marrë informatat mbi llogaritë e specifikuar bankare dhe operacionet bankare që janë kryer gjatë një periudhe specifike ose
- Monitorojë llogaritë e specifikuar bankare dhe operacionet bankare që janë kryer gjatë një periudhe të specifikuar.

1024. Shqyrtimi pozitiv i rekomandimit si më sipër do të përfshinte pastaj edhe më tutje ndryshime tjera në Ligjin LPP/LFT, duke fuqizuar NjIF-në të ndërmarrë masa, siç përcaktohen me paragrafët (a), (b), dhe (c) të nenit 7 të Konventës.

Efektshmëria (përgjithësisht për Rekomandimin 14)

1025. Dallimet në dispozitat përkatëse ligjore të Ligjit LPP/LFT nga standardi ndërkombëtar, siç janë identifikuar, do të mund të ndikojnë negativisht në implementimin e ndalesës së zbulimit.

3.7.2. Rekomandimet dhe komentet (në përgjithësi për Rekomandimin 15 FATF)

1026. Ligji LPP/LFT përfshin dispozita që sigurisht krijojnë ndalesën e zbulimit para personit në fjalë dhe palëve të treta, në rastet kur është dorëzuar Raporti apo informata përkatëse tek NjIF-i.

1027. Analiza megjithatë tregon që mbesin ende disa mangësi dhe dobësi në sistem, të cilat nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe për pjesë të të cilave industria ka shprehur brengat e saj.

1028. Edhe pse leximi i plotë i pjesës së Përshkrimit dhe Analizës për kriteret specifike është i këshillueshëm, në vijim janë përmbledhjet e dobësive apo mangësive kryesore të identifikuar:

- Mbrojtja në vend të sigurt për zbulim në mirëbesim sipas ligjit nuk vlen qartësisht për drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët, e përkohshëm dhe të përhershëm (KTh 14.1)
- Ndalesa nga zbulimi nuk vlen për vetë bankat dhe institucionet financiare (KTh 14.2);
- Ndalesa nga zbulimi nuk specifikon nëse vlen për punëtorët e përkohshëm dhe të përhershëm (KTh 14.2);
- Ndalesa nga zbulimi nuk mbulon informatat që raporti është dorëzuar, por dhënien e vetë raportit për një palë të tretë (KTh 14.2);
- Ndalesa nuk mbulon faktin që një hetim është duke u bërë apo mund të bëhet (KTh 14.2);
- Nevoja për të përforcuar mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të punëtorëve që hartojnë raporte (AC 14.3 dhe EUD neni 27);
- Heqja e ndalesës së zbulimit mund të bëhet vetëm nga NjIF-i, prokurori apo gjykatat, por nuk ka udhëzime mbi rrethanat e kësaj heqjeje (EUD neni 28);
- Nuk ka dispozita për ndalesën e zbulimit sipas Konventës së Këshillit të Evropës – por Kosova nuk është nënshkruese (CETS 198 neni 7).

1029. Raporti ofron rekomandimin për të korrigjuar dobësitë e identifikuar në secilin nen të veçantë. Në vijim janë indikatorët e amendamenteve të propozuara, të cilat nuk duhen lexuar si zëvendësim i leximit të plotë të nenit dhe rekomandimeve të plota:

- Ndryshimi i nenit 35 të Ligjit LPP/LFT për të zgjeruar mbrojtjen drejt drejtorëve, zyrtarëve dhe punëtorëve, të përkohshëm apo të përhershëm;

- Ndryshimi i paragrafit (4) të nenit 22 duke vendosur ndalesën e zbulimit në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Të merret parasysh zgjerimi i ndalesës së zbulimit drejt subjekteve e entiteteve tjera raportuese;
- Të sigurohet që paragrafi (1.3) i nenit 15 të mos mbulojë emrat dhe informatat personale të personelit në bankë apo institucion financiar që harton Raportin apo ofron informatën;
- Të shqyrtohet paragrafi (2) i nenit 15 të Ligjit për të kufizuar subjektet apo autoritetet tek të cilat informata mund të ofrohet, tek ata të cilëve iu ofron NjIF-i raportet e veta;
- Të shtohet një paragraf i ri (4) në nenin 15 të Ligjit LPP/LFT i cili obligon secilin autoritet që për çfarëdo arsye posedon informata personale mbi punëtorët e subjekteve raportuese që kanë dorëzuar Raportin apo kanë ofruar informatën, për të mbrojtur atë informatë dhe për ta mbajtur konfidenciale;
- Të merren parasysh dispozitat e nenit 28 të Direktivës së Tretë të BE-së për heqjen e ndalesave të zbulimit në rrethanat specifike, si dhe
- Të merret parasysh shtimi i një paragrafi të ri (4A) në nenin 22 të Ligjit LPP/LFT duke vendosur ndalesën e zbulimit në rrethanat e përcaktuara me Konventën e Këshillit të Evropës (CETS 198)

3.7.3. Klasifikimi për Rekomandimin 14

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
Rek 14	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është e qartë nëse mbrojtja në vend të sigurt për zbulime vlen për drejtorët, zyrtarët dhe punëtorët, e përkohshëm dhe të përhershëm; • Ndalea e zbulimit nuk vlen për bankat dhe institucionet financiare si entitete; • Ndalea e zbulimit nuk specifikon nëse vlen për punëtorët e përkohshëm dhe të përhershëm; • Ndalea e zbulimit mbulon situatat në të cilat vetë Raporti i jepet palës së tretë; • Ndalea e zbulimit nuk mbulon situatat në të cilat hetimi është duke u bërë apo mund të bëhet; • Pasiguria ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të punëtorëve që bëjnë Raportin apo ofrojnë informatën; • Kufizimet për heqjen e ndalesës së zbulimit në rrethanat e caktuara; si dhe • Çështjet e efektshmërisë për shkak të dallimeve nga standardi ndërkombëtar.

3.8. Bankat guaskë (R.18)

3.8.1. Përshkrimi dhe Analiza

1030. Në fjalorthin e Metodologjisë FATF, “banka guaskë” definohej si *bankë që nuk ka prani fizike në vendin, në të cilin është themeluar dhe licencuar, si dhe që nuk është e ndërlidhur me një grup të rregulluar të shërbimeve financiare që i nënshtrohet mbikëqyrjes efektive të konsoliduar*. Më tutje, fjalorthi definoi “praninë fizike” si një gjë që përbën prani

kuptimplote dhe menaxheriale të vendosur brenda vendit, pra ekzistenca thjesht e një agjenti lokal apo punëtori të nivelit të ulët nuk përbën prani fizike.

1031. Ligji LPP/LFT e definon “bankën guaskë” si bankë ose një institucion i angazhuar me aktivitete ekuivalente i themeluar në një shtet ku nuk ka prezencë fizike, e cila bën të mundur menaxhimin dhe drejtimin pa u shoqëruar me ndonjë grup financiar të rregulluar.

1032. Definicioni i “bankës guaskë” në Ligjin LPP/LFT afërsisht reflekton definicionin në Metodologjinë FATF. Kështu, paragrafët në vijim që vlerësojnë përputhshmërinë e dispozitave përkatëse të Ligjit LPP/LFT me kriteret thelbësore për Rekomandimin 18 kanë bazë të ngjashme për termin “bankë guaskë”.

1033. Praktikrat e krijuara kanë treguar që në vlerësimin e përputhshmërisë me Rekomandimin 18, është me rëndësi të analizohen dispozitat licencuese për banka dhe institucione financiare në ligjet dhe rregulloret përkatëse bankare për licenca, që mund të jenë nxjerrë nga autoritetet përkatëse mbikëqyrëse dhe rregullative.

Ndalesa e themelimit apo vazhdimit të operimit të bankave guaskë – Kriteri thelbësor 18.1

1034. KTh 18.1 kërkon nga vendet që të kenë të vendosura procedurat e licencimit për themelimin e bankave dhe që banka të tilla të licencuara të veprojnë në vendin që ka nxjerrë licencën.

1035. Pasi që Ligji LPP/LFT nuk është ligji që përcakton kërkesat e licencimit të bankave apo institucioneve financiare, Ligji është i heshtur në këtë drejtim.

1036. Sipas nenit 4 të Ligjit për Bankat, BQK-ja ka përgjegjësi të vetme për lëshimin e licencave për banka dhe institucione financiare. BQK-ja më tutje është kompetente sipas Ligjit për bankat që të mbajë një regjistër qendror të gjitha bankave dhe institucioneve financiare që janë licencuar nga ajo, i cili mes tjerash përmban emërtimin, zyrën qendrore dhe adresat e degëve.

1037. Në fakt, paragrafi (1) i nenit 5 të Ligjit për banka më tej përcakton që asnjë person nuk mund të merret me biznesin bankar, e as të ndërmarrë aktivitete financiare pa licencë efektive të nxjerrë nga BQK-ja në pajtim me dispozitat e Ligjit për bankat.

1038. Për më tepër, paragrafi (4) i nenit 5 kërkon më tutje që bankat e huaja do të lejohen të angazhohen në biznesin bankar në Kosovë, vetëm nëse banka e huaj ka marrë licencën e lëshuar nga BQK-ja për të ndërmarrë aktivitetin e tillë, përmes një dege në Kosovë, ose ka themeluar një bankë vartëse në Kosovë, për të cilën është lëshuar licenca nga BQK-ja, në pajtim me dispozitat e Ligjit për bankat.

1039. Pjesa II e Ligjit për bankat përcakton procedurat që duhen ndjekur për licencimin e bankave. Mes kërkesave të kujdesit, atyre operacionale, qeverisëse dhe administrative, Ligji për bankat kërkon që struktura organizative e bankës së propozuar dhe vartësve të saj t'i mundësojnë BQK-së që të ushtrojë efektivisht mbikëqyrje në baza të konsoliduara, si dhe që struktura e pronësisë së bankës të mos pengojë mbikëqyrjen efektive (neni 8). Për më tepër, lëshimi i licencës mund të ndërlidhet me kushtet të ndryshime, si informatat mbi rekrutimin dhe trajnimin e personelit të bankës, si dhe informatat mbi qiramarrjen, blerjen apo shfrytëzimin e lokaleve të bankës nga të cilat do të bëhet biznesi.

1040. Pjesa IV e Ligjit për bankat më tutje përcakton qeverisjen dhe pronësinë e bankave, duke përfshirë procedurat për mbledhjet e përgjithshme të aksionarëve, strukturën dhe procedurën për Bordin e drejtorëve, si dhe strukturën e menaxhmentit të lartë.

1041. Sipas nenit 92 të Ligjit për bankat, dispozitat e licencimit për banka sipas Pjesës II të Ligjit ngjashëm vlejnë për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve të tjera jobankare financiare të përkufizuara me ligj.

1042. Pjesa XVII e Ligjit për bankat përcakton organizimin, menaxhimin dhe administrimin e institucioneve mikrofinanciare dhe atyre jobankare financiare. Në këtë kuptim, Ligji definon qeverisjen e këtyre institucioneve, duke përfshirë strukturën dhe operacionet e Bordit të drejtorëve, të komiteteve të brendshme dhe strukturën e menaxhmentit të lartë.

1043. Brenda fushëveprimit të licencimit, BQK-ja ka nxjerrë rregulla e rregullore të ndryshme për procedurat e licencimit të bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucionet jobankare financiare, duke përfshirë kompanitë e sigurimit dhe ato ndërmjetëse.

1044. Dispozitat ligjore, të plotësuara me rregulla e rregullore të BQK-së për kornizën e licencimit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione tjera jobankare financiare, janë solide dhe qartësisht e ndalojnë themelimin e bankave “guaskë”, pasi që regjimi i licencimit kërkon që prania fizike dhe e menaxhmentit të bankës apo institucionit financiar të jetë e vendosur në Kosovë, me lokale pune dhe nivele të caktuara të personelit.

1045. Ligji për Bankat nuk trajton çështjen e ndalesës së veprimit të vazhduar të bankave guaskë. Por, kjo është e kuptueshme, pasi që siç thuhet më lart, që në rastin e parë regjimi juridik i licencimit nuk mundëson licencimin e bankave guaskë.

1046. Pra, duket kështu që kërkesat e KTh 18.1 përmbushen përmes regjimit të licencimit sipas Ligjit për bankat, si dhe rregullat e rregulloret e BQK-së.

Marrëdhëniet korrespondente bankare me bankat guaskë – Kriteri thelbësor 18.2

1047. KTh 18.2 parasheh që institucionet financiare të mos lejohen të hyjnë apo të vazhdojnë marrëdhënie korrespondente bankare me banka guaskë.

1048. Fjalorthi i Metodologjisë FATF përkufizon “shërbimet bankare korrespondente” si ofrim i shërbimeve bankare nga një bankë (banka korrespondente) për një bankë tjetër (banka pranuese). Bankat e mëdha ndërkombëtare zakonisht veprojnë si korrespondente për mijëra banka tjera në botë. Bankat pranuese mund të gëzojnë një spektër të gjerë shërbimesh, duke përfshirë menaxhimin e parave (p.sh. llogari me interes në një numër valutash), transferet ndërkombëtare bankare të fondeve, pagesën e çeqeve, llogaritë e ndërmjetësimit të pagesave, si dhe shërbimet e këmbimit të huaj.

1049. Ligji LPP/LFT nuk përmban definicion të bankave korrespondente.

1050. Paragrafi (6) i nenit 21 të Ligjit LPP/LFT kërkon që ndërmjetësit financiarë të mos hapin as të mos mbajnë llogari korrespondente me një bankë guaskë apo ndonjë bankë që njihet që ka lejuar bankën të përdoret si guaskë për llogaritë e saj.

1051. Pa paragjykuar shqetësimet e shprehura në këtë raport, në lidhje me Letrën këshilluese 2007/1 të BQK-së, në reflektimin e dispozitave të Ligjit LPP/LFT, Letra këshilluese kërkon që banka të mos themelojë e as të mos vazhdojë marrëdhënien bankare korrespondente me një bankë pranuese jovendore të themeluar në një juridiksion ku banka nuk ka prani fizike, si dhe që nuk është e ndërlidhur me një grup financiar të rregulluar (pra, bankë guaskë).

1052. Në anën tjetër, Rregulli X i BQK-së është i heshtur në këtë çështje.

1053. Terminologjia “ndërmjetës financiarë” në paragrafin (6) nuk definohet në Ligj, por për qëllimet e kësaj analize, ajo interpretohet si referencë ndaj “bankave dhe institucioneve financiare” në pajtim me përdorimin e përgjithshëm të këtij termi në Ligj.

1054. Fjalët *to allow a bank to be used by shell their accounts* në paragrafin (6) të nenit 21 nuk kuptohen. Terminologjia e duhur e përdorur në standardet ndërkombëtare është *të mundësojë që llogaritë e saj të përdoren nga banka guaskë*.¹¹⁴

1055. Pavarësisht kësaj, dispozitat e paragrafit (6) të nenit 21 të Ligjit LPP/LFT adresojnë vetëm njërën anë të marrëdhënies bankare korrespondente, duke qenë ndalesë për bankat që të hapin apo të mbajnë llogari korrespondente me bankën guaskë. Neni 21 nuk adreson çështjen kur një bankë në Kosovë i ofron marrëdhënie bankare korrespondente një banke pranuese nga një vend tjetër. Në fakt, derisa në KTh shqyrtohen marrëdhëniet korrespondente bankare me bankat guaskë, paragrafi (6) i nenit 21 adreson hapjen dhe mbajtjen e llogarive me një bankë guaskë.

1056. Letra këshilluese në anën tjetër duket të adresojë çështjen nga këndi i marrëdhënieve bankare korrespondente me “institucionet” respondente, si dhe kjo vlen për rastet kur banka në Kosovë i ofron shërbime bankare, kundrejt mundësisë së pranimit të shërbimeve të tilla, siç përcaktohet me paragrafin (6) të nenit 21 të Ligjit LPP/LFT.

1057. Në kuptimin e definicionit të “bankës korrespondente” të përcaktuar në fjalorin e Metodologjisë FATF të përmendur si më lart, bankat duhen ndaluar të veprojnë për bankat guaskë qoftë si “respondent”, ashtu edhe si “korrespondent”.

1058. Pra, rrjedh që dispozitat e Letrës këshilluese shkojnë përtej asaj që është synuar me Ligjin LPP/LFT, edhe nëse është mundësuar transponim më i mirë i kërkesave sipas KTh 18.2.

1059. Në këto rrethana këshillohet të rishikohen dispozitat e paragrafit (6) të nenit 21 të Ligjit LPP/LFT dhe të formulohen si në vijim:

Neni 21 para. (6) Bankat dhe institucionet financiare nuk duhet të hyjnë apo të vazhdojnë marrëdhëniet korrespondente bankare me një bankë guaskë apo një bankë që lejon që llogaritë e saj të përdoren nga bankat guaskë.

1060. Për hir të qartësisë ligjore, rekomandohet më tutje që termi “marrëdhënia bankare korrespondente” të definohet në Ligjin LPP/LFT në bazë të definicionit të fjalorthit të FATF:

Marrëdhënie bankare korrespondente – ofrimi i shërbimeve bankare nga njëra bankë (banka korrespondente) tek banka tjetër (banka respondente). Bankat në Kosovë do të veprojnë si “banka respondente” kur vendosin marrëdhënie për pranimin e shërbimeve bankare nga një bankë tjetër (korrespondente) ose si “banka korrespondente” kur vendosin marrëdhënie për ofrimin e shërbimeve bankare për një bankë tjetër (banka respondente).

Llogaritë e përdorura nga bankat guaskë – Kriteri thelbësor 18.3

1061. KTh 18.3 kërkon që institucionet financiare të obligohen që të përmbushin kërkesat e tyre që institucionet financiare në vendet e huaja për të cilat ofrojnë shërbime bankare të mos lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë.

¹¹⁴ Projektligji për ndryshim të ligjit LPP/LFT ndryshon paragrafin, por teksti në thelb mbetet i njëjti, *banka që është e njohur që lejon përdorimin e llogarive guaskë*, ku prapë terminologjia “llogaria guaskë” nuk kuptohet.

1062. Në përcaktimin mbi marrëdhëniet bankare korrespondente me bankat nga vendet e huaja, paragrafi (4) i nenit 21 vendos masa të avancuara për marrëdhënie të tilla, por nuk përcakton që bankat dhe institucionet financiare të konfirmojnë që institucioni respondent nuk lejon që llogaritë e tij të përdoren nga bankat guaskë.¹¹⁵

1063. Siç theksohet më hollësisht në kontekstin e analizës së sipërme për KTh 18.2 në këtë raport, Ligji LPP/LFT bashkë me dispozitat e Letrës këshilluese 2007/1 synojnë të mbulojnë kërkesat e KTh 18,3 duke ndaluar bankat dhe institucionet financiare që të hapin apo të mbajnë marrëdhënie të tilla.

1064. Kështu, nuk ka kërkesë specifike për banka dhe institucione financiare që të përmbushin kërkesat e veta që bankat respondente në një juridiksion të huaj të mos lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë.

1065. Ndryshimi i propozuar sipas analizës së KTh 18.2 si më lart, duke lejuar vendosjen apo mbajtjen e marrëdhënieve bankare korrespondente me bankat guaskë apo bankat që lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë do të kontribuojë për harmonizim më të mirë me standardet FATF.

1066. Pavarësisht nga kjo, do të ishte e përshtatshme që të ndryshohet paragrafi (4) i nenit 21 duke shtuar një paragraf të ri (4.6) si në vijim:

Neni 21 para 4.6 të sigurohet që institucioni bankar respondent të mos lejojë që llogaritë e tij të përdoren nga bankat guaskë.

Efektshmëria (përgjithësisht për Rekomandimin 18)

1067. Mungesa e qartësisë ligjore mes institucioneve korrespondente dhe respondente, kombinuar me mungesën e definicionit të “marrëdhënieve bankare korrespondente” do të mund të kontribuonte negativisht në efektshmërinë e sistemit, pasi që industria do të mund ta interpretonte ndryshe obligimin sipas Ligjit LPP/LFT.

3.8.2. Rekomandimet dhe komentet

1068. Dispozitat e Ligjit për bankat që mbulojnë kërkesat dhe procedurat për banka dhe institucione financiare janë gjithëpërfshirëse dhe sigurojnë që secila bankë apo institucion financiar i licencuar si i tillë të ketë praninë fizike dhe menaxhmentin në Kosovë, si dhe të vepron brenda dhe jashtë Kosovës nga lokalet afariste të vendosura në Kosovë. Kështu, KTh 18.1 është i mbuluar në mënyrë adekuate.

1069. Analiza e dispozitave ligjore dhe të tjerave që mbulojnë kërkesat tjera sipas Kriterit thelbësor 18.2 dhe 18.3 për Rekomandimin 18 identifikon mangësitë dhe dobësitë që duhen adresuar.

1070. Edhe pse këshillohet leximi i plotë i përshkrimit dhe analizës për kriteret specifike, në vijim janë dhënë indikacionet e dobësive apo mangësive kryesore të identifikuara:

- Ka mungesë të qartësisë ligjore në dallimin mes bankave korrespondente dhe respondente (KTh 18.2);

¹¹⁵ Paragrafi (4) i nenit 21 i Ligjit LPP/LFT mundohet t'i zhvendosë obligimet nën Rekomandimin 7 të FATF. Referencat në paragrafin (4) nuk synojnë të vlerësojnë nëse ai i përmbush apo jo kërkesat e Rekomandimit 7 por vetëm si referencë brenda kontekstit të Rekomandimit 18.

- Nuk ka definicion të marrëdhënies bankare korrespondente, që përfshin institucionet korrespondente dhe respondente (KTh 18.2);
- Nuk ka obligim për bankat që të sigurojnë që institucionet respondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë (KTh 18.3).

1071. Në këtë kuptim, raporti ofron rekomandime për ndryshimet e ligjit për harmonizim më të mirë të Ligjit LPP/LFT me Kriterin thelbësor për Rekomandimin 18:

- Reformulimi i paragrafit (6) të nenit 21 për të hequr paqartësitë ligjore;
- Futja e definicionit të “marrëdhënies bankare korrespondente”, që përfshin edhe institucionet “korrespondente” edhe “respondente” në pajtim me definicionin në fjalorthin FATF në Metodologji;
- Futja e një paragrafi të ri (4.6) në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT për të siguruar që bankat të konfirmojnë që institucionet e tyre respondente nuk lejojnë llogaritë e tyre të shfrytëzohen nga bankat guaskë.

3.8.3. Klasifikimi për Rekomandimin 18

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
Rek 18	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e qartësisë ligjore në dallimin mes bankave korrespondente dhe respondente; • Nuk ka definicion të marrëdhënies bankare korrespondente; • Nuk ka obligim për bankat që të sigurojnë që institucionet respondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë; si dhe • Brengat e efektshmërisë për shkak të mungesës së qartësisë ligjore,

3.9. Mbikëqyrja e vazhdueshme, monitorimi dhe hyrja në treg (R.23)

3.9.1. Përshkrimi dhe Analiza

1072. Dispozitat e Ligjit për BQK-në, Ligjit për bankat, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 për sektorin e sigurimeve, si dhe Ligjit për fondet pensionale, përcaktojnë autorizimet për rregullimin e kujdesit dhe mbikëqyrjes së autoriteteve kompetente përkatëse (BQK, si dhe paraardhësi i vet Autoriteti i Bankave dhe Pagesave të Kosovës (BPK)) në pajtim me ligjet përkatëse. Në fakt, neni 8 i Ligjit për BQK-në thekson në paragrafin (1) që detyrat e BQK-së në përmbushje të synimeve të përcaktuara me nenin 7 si dhe në dispozitat tjera të Ligjit për BQK-në duhet të përfshijë edhe rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, siç përcaktohet më tutje me këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër. Për më tepër, neni 23 i Ligjit për BQK-në më tutje thekson që BQK-ja do të ketë përgjegjësi ekskluzive për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve tjera financiare, siç përcaktohet më tutje në ligjet përkatëse.

1073. Por, Ligji LPP/LFT nuk i jep pushtet rregullator apo mbikëqyrës BQK-së ose ndonjë autoriteti tjetër kompetent për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ligji LPP/LFT i jep pushtet mbikëqyrës NjIF-së mbi gjitha subjektet raportuese, përveç sektorit financiar – bankat dhe institucionet financiare siç definoohen me vetë ligjin.

1074. Për më tepër, në përgjigjet e veta ndaj pyetësorit tek neni 2.6 dhe tjetërkund, NjIF-i thekson që “legjislacioni aktual në Kosovë nuk i jep autorizim ndonjë institucioni për të kryer

inspektimet e bankave, institucioneve financiare dhe kazinove, ashtu që kjo të jetë në përputhje me Ligjin nr. 03-L/196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”

1075. Në fakt, derisa Rregullorja e shfuqizuar e UNMIK-ut 2004/2 për ndalimin e pastrimit të parave dhe veprave tjera penale ka vendosur përgjegjësinë mbikëqyrëse tek Qendra Informativ Financiare (si paraardhëse e NjIF-së), ajo përcaktonte bashkëpunimin në mbikëqyrje me BQK-në (si BPK).

1076. Paragrafi (2) i nenit 83 të Ligjit për bankat kërkon nga bankat dhe institucionet financiare të jenë në përputhje me LPP/LFT, derisa obligon BQK-në dhe NjIF-në të bashkëpunojnë në pajtim me ligjet në fuqi.

1077. Dispozitat e ngjashme për institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare gjenden në paragrafin (2) të nenit 113 të Ligjit për bankat, me paragrafin (3) të njëjtit nen që kërkon nga këto institucione të respektojnë gjitha ligjet, rregulloret, rregullat, udhëzimet, procedurat dhe urdhrat në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1078. Vlerësimi i përputhshmërisë së BQK-së si autoritet mbikëqyrës me Parimet thelbësore bankare të Bazelit¹¹⁶, kryer nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, ka gjetur çështje të ngjashme në mbikëqyrje me ato të përshkruara si më lart, si dhe vijimisht ka vlerësuar BCP 18 për keqpërdorimin e shërbimeve financiare për aktivitete kriminale si në “mospërputhje”.

1079. Vlerësimi i Parimeve thelbësore bankare të Bazelit shpreh brengën për bazën juridike të autorizimeve mbikëqyrëse të BQK-së për qëllimet e Ligjit LPP/LFT dhe kështu edhe qëndrueshmërinë e regjimit të përputhshmërisë në LPP/LFT. Vlerësimi thekson që *Pohohet, që ligji i mëparshëm (ende Rregullore e UNMIK-ut) i jepte autoritet Qendrës Informativ Financiare (paraardhëses së NjIF-it) për të kryer inspektime in-situ të përputhshmërisë së bankave, në bashkërendim me paraardhësen e BQK-së, Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës*. Duket që vlerësimi i referohet Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 për ndalimin e pastrimit të parave dhe veprave të ndërlydhura penale, e cila është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit LPP/LFT, pra dispozitat e saj nuk vlejné më.

1080. Edhe pse neni 83 dhe 113 i Ligjit për bankat kërkon nga bankat dhe institucionet financiare të jenë në përputhje me Ligjin LPP/LFT si dhe rregullat e rregulloret tjera përkatëse, ky obligim nuk fuqizon BQK-në që të ushtrojë autoritetin e vet mbikëqyrës mbi bankat dhe institucionet financiare për qëllimet e Ligjit LPP/LFT pasi që ligji në fjalë, Ligji LPP/LFT, nuk i jep këtë pushtet BQK-së ose ndonjë autoriteti tjetër.

1081. Përveç nëse ka dispozita tjera në ligje tjera me këtë efekt, atëherë pushteti rregullator dhe mbikëqyrës i BQK-së apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, me përjashtim të NJIF-it, supozohet të merret përsipër nga ato sipas pushtetit të kujdesit që i jepet atyre me ligje të tjera të veçanta. Siç është thënë më tutje në këtë raport, kjo gjendje mund të krijojë konflikte dhe paqartësi në implementimin e dispozitave ligjore.

¹¹⁶ *Parimet thelbësore për mbikëqyrje efektive bankare* janë nxjerrë më së pari nga Komiteti i Bazelit për mbikëqyrjen bankare në shtator të vitit 1997, si dhe janë plotësuar me Metodologjinë e vlerësimit në vitin 1999. Parimet thelbësore janë rishikuar më 2006, derisa është nxjerrë një Dokument konsultativ për rishikim të mëtutjeshëm në vitin 2011. Synimi i Parimeve thelbësore është të vlerësojnë standardin e vendit në mbikëqyrjen bankare. Parimi 18 merret me parandalimin e keqpërdorimit të sistemit financiar që përdoret për pastrim të parave dhe financim të aktiviteteve terroriste.

1082. Pavarësisht kësaj situate, ky raport vlerëson pozitivisht punën që po kryhet nga BQK-ja në monitorimin e bankave dhe institucioneve financiare për respektimin nga ato të obligimeve sipas ligjeve LPP/LFT si dhe rregulloreve të nxjerra nga vetë BQK-ja.

1083. Megjithatë, për qëllimet e këtij vlerësimi, derisa paragrafët në vijim, aty ku është e mundur, do të analizojnë pushtetin dhe procedurat e BQK-së në mbikëqyrje si kujdes, raporti nuk mund të marrë masat e autorizimet e tilla si automatikisht të vlefshme për qëllimet e Ligjit LPP/LFT. Në rastet e tilla, raporti thjesht reflekton qëndrimet e vlerësuesve dhe ofron rekomandime për përmirësimin e situatës.

Institucionet financiare që i nënshtrohen rregullimit dhe mbikëqyrjes adekuate për LPP/LFT – Kriteri thelbësor 23.1

1084. KTh 23.1 kërkon nga vendet të sigurojnë që institucionet financiare t'i nënshtrohen rregullimit dhe mbikëqyrjes adekuate, si dhe që ato të implementojnë efektivisht rekomandimet e FATF-së.

1085. Ligji LPP/LFT fuqizon NjIF-në që të mbikëqyrë gjitha subjektet raportuese sipas Ligjit, me përjashtim të sektorit financiar.

1086. Ligji për BQK-në, Ligji për Bankat dhe Ligji për Pensionet, që të gjitha përcaktojnë përgjegjësitë e mbikëqyrjes së kujdesit nga BQK-ja për bankat, institucionet financiare dhe fondet pensionale.

1087. Ligji LPP/LFT megjithatë nuk vendos ndonjë autoritet kompetent mbikëqyrës për sektorin financiar.

1088. Edhe pse BQK-ja ka marrë përsipër përgjegjësinë për mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve financiare për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, siç përshkruhet më lart në hyrjen e nenit 3.9, baza juridike e kësaj përgjegjësie mungon.

1089. Dispozitat rregullative dhe mbikëqyrëse në Ligjin për BQK-në, Ligjin për bankat dhe Ligjin për fondet pensionale, që fuqizojnë BQK-në, merren vetëm me aspektin mbikëqyrës kujdestar (kapital, likuiditet, pasuri, të ardhura, qeverisje, etj.), por jo domosdoshmërisht apo automatikisht e vendosin BQK-në si mbikëqyrëse për qëllimet e ligjit LPP/LFT.

1090. Megjithatë, në praktikë, BQK-ja mbikëqyr sektorin financiar për respektimin e dispozitave të ligjit LPP/LFT si dhe në fakt ka nxjerrë rregullore për këtë qëllim. Në këto rrethana, kjo duhet lavdëruar, por prapë mbetet pa bazë ligjore – referojuni pjesës hyrëse të nenit 3.9.

1091. Pra, është e domosdoshme dhe urgjente që baza ligjore të vendoset. Nuk është pjesë e fushëveprimit të këtij Raporti që të vendosë për autoritetin kompetent që duhet të ketë autoritetin rregullativ dhe mbikëqyrës në këtë drejtim. Ky raport megjithatë ofron rekomandimet e veta për autoritetin mbikëqyrës sipas Ligjit LPP/LFT për sektorin financiar.

1092. Ekzistojnë mënyra të ndryshme të përcaktimit të bazës ligjore për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit financiar për respektimin e ligjeve dhe rregulloreve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe vendet e ndryshme kanë vendosur regjime të ndryshme. Fushëveprimi i mbikëqyrjes do të mund t'i jepej NjIF-it për gjitha subjektet raportuese sipas Ligjit LPP/LFT, duke përfshirë sektorin financiar. Mbikëqyrja e sektorit financiar për qëllimet e Ligjit LPP/LFT do të mund të mbetej nën fushëveprimin e BQK-së me bazë të shëndoshë ligjore, në të cilin rast dispozitat për bashkëpunim më të fortë me NjIF-në përmes Ligjit si dhe përmes një rishikimi të thukët të Memorandumit aktual të Bashkëpunimit mes NjIF-it dhe BQK-së, do të ishin të domosdoshme. Mbikëqyrja e sektorit

financiar do të mund t'i vishej NjIF-it, ku do të kishte dispozita ligjore që Njësia të emërojë BQK-në si agjente për ndërmarrjen e vizitave mbikëqyrëse të LPP/LFT si dhe për hartimin e udhëzimeve dhe rregulloreve të domosdoshme, duke i raportuar prapa NjIF-it. Prapë, dispozitat ligjore për bashkëpunim dhe bashkërendim efektiv do të ishin të domosdoshme, pasi që në këtë situatë, BQK-ja do t'i raportonte NjIF-it mbi gjetjet e saj, si dhe për masat e rekomanduara korrigjuese, mbi të cilat NjIF-i do të duhej të vepronte¹¹⁷.

Mbikëqyrja e institucioneve financiare për respektim të obligimeve të LPP/LFT-së – Kriteri thelbësor 23.2

1093. Pa paragjykuar analizën e sipërme për mungesën e autorizimit ligjor të BQK-së që të mbikëqyrë bankat dhe institucionet financiare për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, paragrafët në vijim do të përshkruajnë dhe analizojnë fushëveprimin e mbikëqyrjes kujdestare të BQK-së në pajtim me Ligjin për BQK-në, Ligjin për bankat, si dhe Ligjin për fondet pensionale.

1094. Në vendosjen e detyrave të BQK-së në përmbushje të synimeve të Bankës, sipas nenit 7 të Ligjit për BQK-në, theksohet që këto përfshijnë përgjegjësinë e BQK-së që të rregullojë, licencojë, regjistrojë dhe mbikëqyrë institucionet financiare. Neni 23 i Ligjit i jep përgjegjësi ekskluzive BQK-së në këtë drejtim, duke përfshirë edhe shqiptimin e dënimeve administrative, të përcaktuara me të njëjtin Ligj.

1095. Paragrafi (1) i nenit 65 të Ligjit për BQK-në më tutje fuqizon BQK-në që të nxjerrë rregulloret obligative, udhëzimet e urdhrat sipas nevojës për kryerjen e detyrave që i janë besuar BQK-së sipas këtij apo ndonjë ligji tjetër.

1096. Dispozitat e ndryshme në Ligjin për bankat fuqizojnë BQK-në që të nxjerrë rregullore obligative për banka dhe institucione financiare që merren me kërkesat e kapitalit; kërkesat e likuiditetit; kufijtë e ekspozimit; pagesat e dividendëve; personat e ndërlidhur; klasifikimin e asetëve; ekspozimin ndaj valutave të huaja; auditorët e jashtëm; etj.

1097. Sipas nenit 57 të Ligjit për bankat, secila bankë dhe secila degë e ndërlidhur e saj i nënshtrohet ekzaminimit nga BQK-ja, përmes ekzaminuesve të emëruar nga BQK-ja. Këta kontrollues mund të vizitojnë bankat në periudha të arsyeshme sipas BQK-së, si dhe mund të ndërmarrin veprime që konsiderohen të domosdoshme dhe të këshillueshme.

1098. Dispozita të ngjashme për mbikëqyrje të institucioneve mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare përcaktohen edhe me nenin 104 të Ligjit për bankat.

1099. BQK-ja ka shpjeguar që në ndërmarrjen e funksioneve të saj mbikëqyrëse, Banka përdor një qasje të bazuar në rrezik, e cila mundëson identifikimin e hershëm të rreziqeve, si dhe një shpërndarje më efektive të resurseve mbikëqyrëse. Si rezultat, strategjitë e mbikëqyrjes i përshtaten profilit të riskut të institucioneve financiare, duke përcaktuar fokusin e frekuencës dhe atë të vazhdimësisë në kontrollime në terren.

1100. Në bazë të fushëveprimit të saj, Rregulli X i BQK-së vlen për bankat dhe institucionet financiare të definuara me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2, tashmë të shfuqizuar, që veprojnë në Kosovë, duke përfshirë operatorët e transfertave të parave dhe këmbimore. Rregulli X është nxjerrë brenda termave të Rregullores së UNMIK-ut 1999/21 për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave, Rregullore kjo e shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit për bankat.

¹¹⁷ Ligji i amendamentuar LPP/LFT parasheh procedura të ngjashme me ato të mëparshmet.

1101. Qëllimi i Letrës Këshilluese 2007/1 nxjerrë nga BQK-ja, është të ofrojë udhëzime për ndihmë shtesë për bankat dhe institucionet financiare kur zbatojnë disa aspekte të caktuara të kërkesave të LPP/LFT të Rregullores së shfuqizuar të UNMIK-ut 2004/2 për parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave të ndërlidhura penale.

1102. BQK-ja ka informuar që ajo përmbush përgjegjësinë mbikëqyrëse përmes kontrollimeve së jashtmi dhe vizitave në vend. Sipas tabelës së ofruar nga BQK-ja si më poshtë në përgjigjet e saj ndaj Pyetësorit, inspektimet në terren duken të jenë pakësuar, si dhe janë fokusuar më shumë në zyrat e këmbimit, derisa duket që nuk ka pasur kontrollime së jashtmi, përveç nëse ky është proces i vazhdueshëm përmes raportimit që bëhet nga bankat dhe institucionet financiare. BQK-ja më tutje ka konfirmuar që kontrollimet në tabelë nuk janë me fokus në LPP/LFT, por janë të natyrës së kujdesit të duhur, me një pjesë të LPP/LFT.

Tabela 16 : *Inspektimet e kryera nga BQK-ja, duke përfshirë fushën LPP/LFT*

Viti	Bankat (plotë)		Bankat (pjeshme)		IFJB e IMF-të		Kursime / kredi		Këmbimoret		Shërbimet postare	
	Në vend	Së jashtmi	Në vend	Së jashtmi	Në vend	Së jashtmi	Në vend	Së jashtmi	Në vend	Së jashtmi	Në vend	Së jashtmi
2008	6											
2009	7								3			
2010	5				5				2			
2011	4		1		2				30			

1103. Dispozitat në Ligjin për BQK-në, Ligjin për bankat dhe Ligjin për fondet pensionale, që fuqizojnë BQK-në për të nxjerrë rregulla e rregullore i referohen rregullimit e mbikëqyrjes së kujdesit për sektorin financiar.

1104. Nuk ka dispozita në asnjë ligj, duke përfshirë Ligjin LPP/LFT, që fuqizojnë BQK-në për të nxjerrë rregulla apo rregullore për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Duket që këto kompetenca janë siguruar përmes rregulloreve të UNMIK-ut, të cilat tashmë janë shfuqizuar me hyrjen në fuqi të ligjeve përkatëse si ai LPP/LFT.

1105. Për më tepër, siç është shpjeguar në nenin 3.1 të këtij raporti, qasja e bazuar në risk, e përdorur nga BQK-ja për qëllime mbikëqyrjeje, qasja CAMEL, vetëm merr parasysh çështjet e kujdesit (Kapitali, Asetet, Menaxhmenti, të Ardhurat dhe Likuiditeti), pra nuk është vegla për metodologjinë e vlerësimit të rrezikut që duhet aplikuar për vlerësimin e riskut të pastrimit të parave në institucionet individuale për qëllime mbikëqyrjeje.

1106. Pavarësisht kësaj, në këtë raport vlerësohet pozitivisht puna mbikëqyrëse e kryer nga BQK-ja në sigurimin e respektimit të Ligjit LPP/LFT dhe rregulloreve për sektorin financiar.

1107. Megjithatë, rekomandohet që fushëveprimi mbikëqyrës përmes procedurave legislative për BQK-në (përtej autorizimit për qëllime kujdesi sipas nenit 85 të Ligjit për bankat), apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent për mbikëqyrjen e sektorit financiar për qëllimet e Ligjit LPP/LFT – shih analizën për KTh 23.1 në këtë raport – duhet përcjellë me autorizime për të hartuar rregullore detyruese e obliguese.

Parandalimi i kriminelëve të jenë pronarë apo menaxherë të institucioneve financiare – Kriteri thelbësor 23.3¹¹⁸

¹¹⁸ Referojuni edhe nenit 3.9.4 të raportit për “kriteret e duhura dhe të përshtatshme” për menaxhmentin e lartë.

1108. KTh 23.3 kërkon që vendet të kenë të vendosura dispozitat ligjore apo masat rregullative përmes të cilave autoritetet mbikëqyrëse apo autoritetet tjera kompetente mund të parandalojnë kriminelët apo ortakët e tyre nga mbajtja apo të qenit pronar përfitues i një interesi të konsiderueshëm apo kontrollues, apo mbajtjes së një funksioni të lartë menaxherial, duke përfshirë bordet mbikëqyrëse dhe ekzekutive, të një institucioni financiar.

1109. Sipas nenit 37 të Ligjit për bankat, BQK-ja ka kompetenca absolute në përcaktimin e aksionarëve të një banke. Ligji ndalon secilin person, në veprim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, si i vetëm apo në bashkëpunim me një person tjetër, nga të qenit aksionar i parë në një bankë pa marrë autorizimin paraprak me shkrim nga BQK-ja.

1110. Për më tepër, Ligji për bankat më tutje kërkon që autorizimi paraprak të merret nga BQK-ja kur aksionari i madh, në veprim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, si i vetëm apo në bashkëpunim me një person tjetër, synon të rrisë interesin pronësor në një bankë mbi 10, 20, 33, 50 apo 75 për qind (%) të kapitalit të saj.

1111. Neni 37 i Ligjit për bankat më tutje kërkon që bankat të njoftojnë BQK-në për përvetësimin e aksioneve brenda pesë (5) ditësh pas përvetësimit, nëse shuma e aksioneve të marra është e barabartë apo tejkalon pesë për qind (5%) të kapitalit, por nuk tejkalon dhjetë për qind (10%) në pajtim me atë formë, si dhe me përmbajtjen e informatave sipas kërkesës së BQK-së.

1112. Paragrafi (3) përcakton informatat që duhet të përfshihen në aplikacione për rritje të aksioneve në pajtim me nenin 37. Një prej kërkesave për secilin person fizik individual është *një deklaratë nga gjykata që shpalojë ndonjë dënim për vepra penale nga një gjykatë penale, dosjet personale të falimentimit, përjashtimi nga ushtrimi i profesionit, apo përfshirjen e tanishme a të kaluar në funksion menaxhues të një korporate ose të ndonjë sipërmarrësi tjetër që i nënshtrohet procedurës së paaftësisë së pagesës, nëse ekziston.*

1113. Sipas nenit 38 të Ligjit për bankat, BQK-ja vendos nëse miraton aplikimin e tillë në bazë të kriterëve të licencimit, por merr parasysh edhe përshtatshmërinë e aksionarëve të propozuar dhe pozitën e tyre në tregje financiare.

1114. Ligji për bankat definon “aksionarin kryesor” si person që ka në pronë, direkt apo indirekt, si i vetëm apo në bashkëpunim me ndonjë person tjetër, dhjetë për qind (10%) ose më shumë në çfarëdo klase të aksioneve votuese të një banke apo kompanie ose dhjetë për qind (10%) të interesit kapital në një bankë apo kompani.

1115. Nuk ka dispozita direkte të ngjashme mbi marrjen e aksioneve në institucione mikro-financiare dhe institucione financiare jo-bankare. Megjithatë, neni 95 i Ligjit për Bankat përcakton që disa transaksione kërkojnë miratimin paraprak të BQK-së. Këto përfshijnë situatat e shitjes apo transferimit të biznesit të institucionit tek një entitet tjetër; secilin përbashkim apo blerje të institucionit financiar apo institucionit financiar jo-bankar; si dhe situatat në të cilat institucioni financiar apo institucioni financiar jo-bankar është subjekt juridik dhe ka transaksione që ndryshojnë listën e aksionarëve me dhjetë për qind (10%) apo më shumë të kapitalit të aksioneve dhe/ose të drejtave të votimit në kompani.

1116. Neni 38 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 për licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe ndërmjetësve të sigurimeve, kërkon miratimin nga BQK-ja për ndryshimet në aksione të kompanive të sigurimeve apo ndërmjetësve të sigurimeve, në rastet kur personi synon të blejë aksione më të mëdha, ose kur personi synon të

ndryshojë masën e aksioneve të mëdha. Përbashkimet dhe amalgamimet ngjashëm kërkojnë autorizimin paraprak të BQK-së.¹¹⁹

1117. Për më tepër, në kuptimin e nenit 39 të Rregullores së UNMIK-ut, ndryshimet në bordin e drejtorëve apo zyrtarëve të kompanive apo ndërmjetësve të sigurimeve, duhen raportuar dhe shpjeguar para BPK-së.

1118. Blerja e aksioneve në një bankë duket të jetë e mbuluar në masë adekuate përmes dispozitave të nenit 37 të Ligjit për bankat. Megjithatë, nuk ka obligim për të informuar BQK-në kur shkarkohen aksionet përmes fazave të njëjta sipas nenit 37.

1119. Nuk ka ndonjë referencë në Ligj për obligimet në blerjen e të drejtave votuese që në mënyrë indirekte rrit aksionet e mbajtura, përveç nëse termi “direkt apo indirekt” synohet të interpretohet sipas rastit.

1120. Kërkesa për një deklaratë nga gjykatat, sipas paragrafit (3.3) të nenit 37 të Ligjit për bankat është element pozitiv në matjen e respektimit të kërkesave për Rekomandimin 23 të KTh 23.3.

1121. Për më tepër, kriteret që duhen aplikuar nga BQK-ja në vendosjen për aplikimin për ndryshim të aksioneve, sidomos në blerjen e tyre, nuk merr parasysh implikimet në lidhje me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

1122. Direktiva e BE-së për bashkime dhe blerje¹²⁰ përcakton pesë (5) kritere në bazë të të cilave autoriteti mbikëqyrës vendos nëse blerja e aksioneve në një bankë mund të miratohet. Kriteri i pestë (5) përcakton: *nëse ka baza të arsyeshme për të dyshuar që, në lidhje me blerjen e propozuar, pastrimi i parave apo financimi i terrorizmit, brenda kuptimit të nenit 1 të Direktivës 2005/60/EC (*) është duke u kryer a provuar, apo është kryer a provuar, ose që blerja e propozuar mund të rrisë rrezikun që kjo të ndodhë.*

1123. Pra, rekomandohet që paragrafi i ri (6) t'i shtohet nenit 37 të Ligjit për bankat si në vijim:

Neni 37 para (6) Personi që direkt apo indirekt, si i vetëm apo në bashkëpunim me një person tjetër, vendos që:

- (i) të lirohet nga aksionet kryesore në një bankë;
- (ii) të zvogëlojë aksionet kryesore në mënyrë që të pushojë së qeni aksionar kryesor;
- (iii) zvogëlojë aksionet ashtu që proporcioni i aksioneve të bjerë nën 20, 33, 50 apo 75 për qind (%) të kapitalit

Duhet të njoftojë BQK-në duke theksuar masën e aksioneve, si dhe duke ofruar informata përkatëse mbi lirimin nga aksionet apo zvogëlimin e tyre.

1124. Më tutje rekomandohet që paragrafi në nenin 38 të Ligjit për bankat të rinumërohet si paragrafi (1), derisa një paragraf i ri (2) të shtohet si në vijim, duke reflektuar kriterin nga direktiva e BE-së për bashkimet dhe blerjet:

¹¹⁹ Një projektligj i ri për sektorin e sigurimeve është në proces e sipër. Në ndërkohë Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 mbetet e vlefshme dhe e zbatueshme.

¹²⁰ Direktiva 2007/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 shtator 2007 që ndryshon Direktivën e Këshillit 92/49/EEC dhe Direktivat 2002/83/EC, 2004/39/EC, 2005/68/EC dhe 2006/48/EC në lidhje me rregullat procedurale dhe kriteret e vlerësimit për vlerësimin e kujdesshëm të blerjeve dhe rritjen e fondit në dispozicion në sektorin financiar – GZ L247, 05.09.2007, fq. 1-16.

Neni 38 para (2) BQK-ja më tutje vlerëson, në lidhje me blerjen e propozuar, është duke u kryer apo është kryer apo provuar pastrimi i parave apo financimi i terrorizmit në kuptimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ose që si rezultat i blerjes së propozuar, mund të ketë rrezik më të madh të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

1125. Në vijimësi të rekomandimit si më lart, rekomandohet gjithashtu të ndryshohet paragrafi (3) i nenit 39 për bashkimet, konsolidimet dhe përvetësimet në Ligjin për Bankat si në vijim (ndryshimet në shkronja italike):

Neni 39 para (3) Për qëllimet e vendosjes lidhur me kërkesën e parashtruar sipas këtij neni, kriteret për miratim paraprak të kërkesës për licencë bankare të parashtruara në nenin 7 si dhe kriteret për blerjen e aksioneve sipas nenit 38 të këtij Kapitulli zbatohen përshtatshmërisht.

1126. BQK-ja mund të marrë parasysh përfshirjen e rekomandimeve si më lart për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare kur ato janë në formën e një entiteti juridik.

Kriteret “e duhura dhe të përshtatshme” për drejtorët dhe menaxhmentin e lartë – Kriteri thelbësor 23.3.1

1127. KTh 23.3.1 kërkon që drejtorët dhe menaxhmenti i lartë i institucioneve financiare që i nënshtrohen Parimeve Thelbësore të Bazelit të vlerësohen në bazë të kriterëve të “duhura dhe të përshtatshme”, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me ekspertizën dhe integritetin.

1128. Neni 26 i Ligjit për bankat kërkon që secila bankë të administrohet nga një bord i drejtorëve, i zgjedhur nga aksionarët e bankës në një mbledhje të përgjithshme.

1129. Paragrafi (5) i nenit 26 vendos kriteret sipas të cilave personi nuk mund të bëhet kryetar i bordit të drejtorëve apo anëtar i tij:

- Personi i dënua për veprë penale, apo i shpallur përgjegjës për një veprë ekonomike sipas Kodit Penal;
- Personi që sipas një vendimi gjyqësor është shpallur i paaftë të kryejë aktivitete brenda kompetencës së bordit të drejtorëve; si dhe
- Personi më i moshuar sesa shtatëdhjetë (70) vjeç në ditën e emërimit.

1130. Neni 28 në anën tjetër përcakton kompetencat e bordit të drejtorëve, të cilat përfshijnë edhe emërimin e menaxhmentit të lartë.

1131. Sipas nenit 30 të Ligjit për bankat, menaxhmenti i lartë (kryeshefi ekzekutiv dhe zëvendësi i tij) emërohen nga bordi i drejtorëve me miratimin e BQK-së. Për më tepër, sipas nenit 34, asnjë person nuk mund të bëhet drejtor apo menaxher i lartë pa marrë miratimin paraprak të BQK-së.

1132. Dispozita të ngjashme për emërimin e individëve si anëtarë të bordit të drejtorëve dhe emërimin e menaxhmentit të lartë dhe menaxherëve të lartë për institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, sipas rastit, përcaktohen edhe me nenin 97 të Ligjit për bankat.

1133. Edhe pse në pajtim me Ligjin për fondet pensionale, BQK-ja ka përgjegjësinë e licencimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së fondeve pensionale, Ligji nuk duket t'i japë kompetencën BQK-së që të miratojë emërimin e drejtorëve në Bord apo emërimin e menaxhmentit të lartë apo menaxherëve të lartë. Megjithatë, emërimi i Bordit Qeverisës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës qeveriset me nenin 4 të Ligjit për Pensione. Sipas

Ligjit, personat që emërohen të jenë anëtarë të Bordit Qeverisës duhet të jenë persona me integritet të njohur dhe duhet të kenë ekspertizën dhe përvojën profesionale në çështje pensionesh, financash, investimesh e sigurimesh. Një (1) nga tetë (8) anëtarët emërohet nga Qeveria si anëtar jvotues, derisa Komiteti përzgjedhës, i kryesuar nga Guvernatori i BQK-së, si dhe duke përfshirë Auditorin e Përgjithshëm dhe Ministrin e Financave, i bën propozimet për Kuvendin, për emërim të anëtarëve tjerë.

1134. Në kuptimin e nenit 52 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/25, drejtorët dhe zyrtarët e një kompanie sigurimesh apo ndërmjetësi sigurimesh, si dhe zyrtarët përfaqësues të një dege, duhet të jenë persona “të duhur dhe të përshtatshëm” për ushtrimin e rolit të tyre. Ata nuk mund të lejojnë që marrëdhënia e tyre me aksionarët e kompanisë apo ndërmjetëses së sigurimeve, drejtorët tjerë, zyrtarët apo punëtorët tjerë të ndërhyjnë në detyrën e tyre të besuar ndaj të siguruarve, në asnjë mënyrë.

1135. Neni 35 i Ligjit për bankat parasheh që bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë të jenë personat të cilët janë të përshtatshëm dhe të duhur për pozita të tilla dhe t’i plotësojnë kriteret nga BQK mbi kualifikimet, përvojat dhe integritetin. Në praktikë, BQK ndërmerr një test të thukët të “duhur dhe të përshtatshëm” mbi ekspertizën dhe integritetin e personave individualë të propozuar për emërim si drejtorë në borde të bankave dhe institucioneve financiare, menaxhment i lartë apo menaxherë të lartë. BQK ka informuar se në lidhje me këtë ka hartuar një Rregullore që trajton kriterin “të duhur dhe të përshtatshëm” që duhet aplikuar dhe procedurat për të. Rregullorja nuk i është vënë në dispozicion ekipit të vlerësuesve.

Teste të ngjashme “të duhur dhe të përshtatshëm” bëhen edhe për sektorin e sigurimeve, në kuptimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/25.

1136. BQK ka informuar se Rregullorja e saj 24 mbi Qeverisjen Korporative të Kompanive të Sigurimeve dhe Agjentëve të Sigurimeve e trajton çështjen e kriterit “të duhur dhe të përshtatshëm” për drejtorët, zyrtarët e lartë dhe zyrtarët e tjerë të institucioneve. Për më tepër, BQK ka informuar më tutje se Manuali i Licencimit (i brendshëm) i trajton kriteret specifike të “duhur dhe të përshtatshëm” për personat të cilat sipas Rregullores së UNMIK-ut dhe Rregullores 24 duhet t’i plotësojnë kriteret e “duhur dhe të përshtatshëm”.

1137. Analiza megjithatë gjen që Ligji për fondet pensionale përcakton emërimin e Bordit Qeverisës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, por duket se nuk flet për emërimin e menaxhmentit të lartë dhe fondin e pensioneve. BQK ka informuar se përcaktimi i menaxhmentit të lartë mbetet përgjegjësi e Bordit drejtues të Trustit sipas Ligjit mbi fondet pensionale (04/L-101). Bordi pastaj e informon BQK-në në lidhje me vendimin.

Aplikimi i masave rregullative dhe mbikëqyrëse të kujdesit – Kriteri thelbësor 23.4

1138. KTH 23.4 përcakton që aplikimi i masave rregullative dhe mbikëqyrëse të kujdesit, të cilat vlejné edhe për pastrimin e parave në mënyrë të ngjashme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për institucione financiare që i nënshtrohen Parimeve Thelbësore – bankat, sigurimet dhe letrat me vlerë.

1139. Masat e kujdesit, të cilat mund të përfshijnë referencat ndaj parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe të cilat normalisht vlejné, do të mund të përfshinin procedurat e licencimit, rregullimin e emërimit të Drejtorit në Bord, si dhe menaxhmentit të lartë, kontrollit të brendshëm dhe procedurat parandaluese.

1140. Ligji për Bankat, Ligji për fondet e pensioneve dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 nuk i referohen atij aplikimi, pasi që nuk ka ndërlidhje mes dispozitave përkatëse në ato ligje apo rregullore dhe Ligjit LPP/LFT.

1141. Në praktikë, pavarësisht nga mungesa e bazës ligjore BQK-ja mbikëqyrë sektorin financiar për respektimin e dispozitave të Ligjit LPP/LFT, si dhe ka nxjerrë rregulla e rregullore për mënyrën, në të cilën bankat dhe institucionet financiare duhet të operojnë në përputhje me detyrimet e tyre të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1142. Pavarësisht kësaj, vlerësimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar për respektimin nga Kosova të Parimeve thelbësore bankare të Bazelit ka ardhur në përfundim që për shkak të mungesës së bazës ligjore që i jep autoritetin ose BQK-së ose NjIF-it që të bëjë kontrollet e përputhshmërisë me obligimet LPP/LFT në vend nga bankat dhe institucionet financiare është mangësi e rëndësishme në kornizën aktuale rregullative, e cila, e kombinuar me mungesën e koordinimit të mjaftueshëm mes dy institucioneve, si dhe me aranzhimet joadekuate të brendshme të BQK-së për parandalimin e aktivitetit të pastrimit të parave në sektorin bankar rezultojnë në notë të mospërputhjes për Parimin thelbësor 18 të Bazelit.

1143. Megjithatë, duhet theksuar që, siç reflektohet dhe analizohet si më lart, rregullat dhe rregulloret e licencimit dhe çështjet e qeverisjes të aplikuara për qëllime kujdesi nga BQK-ja, janë të vlefshme edhe për qëllimin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Rekomandimet e dhëna si më lart në këtë kuptim duhet të sigurojnë ndërlidhjen mes rregulloreve të kujdesit dhe parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sipas nevojës në ato dispozita, të cilat mund të gjenden vetëm në legjislacionin specifik financiar. Për këtë qëllim, në kontekstin e Ligjit LPP/LFT, ky raport bën rekomandime që i referohen, për shembull, kriterit për blerje të aksioneve.

1144. Megjithatë, rekomandohet që dispozitat e ardhme ligjore që i japin përgjegjësi një autoriteti kompetent për të rregulluar dhe mbikëqyrur bankat dhe institucionet financiare për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, të përcillen me autorizime për të nxjerrë rregulla e rregullore përkatëse, si dhe për të aplikuar autorizimet mbikëqyrëse të kujdesit sipas nevojës – në këtë drejtim, referojuni rekomandimeve të dhëna në nenin 3.10 të këtij raporti.

Licencimi apo regjistrimi i shërbimeve të transferimit të vlerave të parasë dhe këmbimit të valutës – Kriteri thelbësor 23.5

1145. KTh 23.5 parasheh që personat apo subjektet që ofrojnë shërbime të TP-së apo këmbimit të valutës t'i nënshtrohen procesit të licencimit apo regjistrimit nga një autoritet i emëruar kompetent.

1146. Sipas nenit 8 të Ligjit për BQK-në, që përcakton detyrat e Bankës, paragrafi (1.2) i tij përcakton njërin prej detyrave të Bankës, pra rregullimin, regjistrimin, si dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, siç specifikohet më tutje me këtë Ligj apo në ligje tjera. Sipas Ligjit për BQK-në, "institucioni financiar" definohet si: *subjekte si banka, zyra të këmbimit valutor, kompani të sigurimeve, fonde pensionale, si dhe subjekte të tjera që ushtrojnë aktivitete financiare, siç përcaktohet në ligjet relevante për qëllimet e këtij ligji, për të cilat Bankës Qendrore i është dhënë autoritet mbikëqyrës me ligj*. Ligji për BQK-në megjithatë mbetet i mangët në përkufizimin e "aktivitetit financiar".

1147. Neni 4 i Ligjit për bankat ngjashëm përcakton që: BQK-ja ka përgjegjësi ekskluzive për dhënien e licencave për të gjitha bankat dhe regjistrimin e të gjitha institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare.

1148. Në anën tjetër, Ligji për bankat definojnë "institucionin financiar" të përfshijë gjitha bankat, institucionet financiare jobankare dhe institucionet mikrofinanciare të rregulluara me vetë Ligjin. Ligji më tutje e definojnë "institucionin financiar jobankar" si: *- personi juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është licencuar nga BQK-ja sipas këtij*

ligji, për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënien e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënie financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kartat e kreditit; faktoringun, ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operationale, si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja.

1149. Si plotësim ndaj Ligjit për BQK-në në definicionin e “institucionit financiar”, Ligji për bankat jep një definicion të “aktivitetit financiar” në nenin 44, i cili, edhe pse përcakton shërbimet e transfertave të pagesave dhe këmbimit valutor, megjithatë kufizohet në banka.

1150. Definicioni i shërbimeve që mund të ofrohen nga institucionet financiare jobankare sipas nenit 94 të Ligjit për Bankat përfshin *transferimin dhe pranimin e parave, ose të shërbimeve të pagesave, për pagesat që kryhen brenda dhe jashtë vendit*, por nuk përfshin shërbimet e këmbimit valutor.

1151. Në definicionin e vet të “institucionit financiar”, Ligji LPP/LFT përfshin¹²¹ transferimet e valutës apo instrumenteve monetare, me çfarëdo mënyrë, duke përfshirë edhe sistemin joformal të transferimit të parave, ose rrjetin e personave apo entiteteve që mundësojnë transferimin e parave jashtë sistemit konvencional të institucioneve financiare; si dhe ndërrimin e parave dhe valutës.

1152. Rregullorja e UNMIK-ut 1999/21 për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave, e cila është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit për bankat, definonte “institucionin financiar” si: *personin juridik që nuk është bankë e që është licencuar nga BPK-ja për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënien e kredive, nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si menaxher i kompanisë së investimeve ose këshilltar i investimeve a ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë: shërbimet financiare për dhënien me qira të pajisjeve, shërbimet mikrofinanciare, këmbimi valutor ose shërbime të tjera financiare, informative, këshillëdhënëse dhe operationale*. Definicioni është tejet i ngjashëm me atë të përcaktuar nga Ligji për bankat që ka shfuqizuar Rregulloren e UNMIK-ut.

1153. Për më tepër, neni 25 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/21 definon aktivitetin financiar në të njëjtën mënyrë si ai në Ligjin për bankat, por ngjashëm përcakton vetëm aktivitetet që mund të ndërmerren nga bankat.

1154. Rregulli XVI i BQK-së për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe operationet e institucioneve financiare jobankare definon dhe përcakton që “Zyra e këmbimit valutor” konsiderohet të jetë “institucion financiar”, sipas definicionit të nenit 2 të Rregullores 1999/21, pra do të thotë subjekt fizik apo juridik që nuk është bankë, si dhe ndërmerr shitjen dhe blerjen e valutave të huaja. Ngjashëm, “zyra e transferimit të parave” konsiderohet të jetë “institucion financiar”, sipas definicionit të nenit 2 të Rregullores 1999/21, pra do të thotë subjekt fizik apo juridik që nuk është bankë, si dhe ofron shërbime të transferimit elektronik apo bankar të parave përmes një sistemi të autorizuar elektronik ndërkombëtar të transferimit. Rregullorja 1999/21 tanimë është e shfuqizuar dhe referimi ndaj saj bëhet i pavlefshëm, si dhe nuk ka efekt.

1155. Siç është theksuar tashmë me nenin 3 ‘Fusha e mbulimit të Ligjit LPP/LFT’, ekzistojnë dallime të mëdha dhe serioze në definicionet e ndryshme mbi atë se çfarë do të

¹²¹ Për definicionin e plotë të aktiviteteve të një institucioni financiar, për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, referojuni pjesës 3 të këtij raporti, mbi ‘Fushën e mbulimit të Ligjit LPP/LFT’.

thotë institucion financiar në ligje të ndryshme. Paragrafët në vijim vlerësojnë këtë situatë vetëm në lidhje me ato subjekte që ofrojnë shërbime të TP-së apo këmbimi valutor.

1156. Definicioni i “institucionit financiar” sipas Ligjit për BQK-na ka një referencë direkte ndaj zyrave këmbimore. Kështu, dispozita për shërbime të transferimit të parave duhet identifikuar përmes definicioneve të aktiviteteve financiare në ligjet tjera përkatëse.

1157. Ngjashëm, definicioni i institucionit financiar jobankar në Ligjin për bankat bën referencë direkte vetëm për shërbimet e këmbimit valutor, si dhe i lë shërbimet e transferimit të parave në definicionin e aktivitetit financiar.

1158. Definicioni i aktivitetit financiar në nenin 44 të Ligjit për bankat i referohet vetëm aktiviteteve që mund të ndërmerren nga bankat. Por, aktivitetet e një institucioni financiar jobankar, siç përshkruhet në nenin 94 të Ligjit për bankat, përmbajnë referenca ndaj shërbimeve të transferimit (që nuk përfshihen në definicion), por përjashtojnë shërbimet e këmbimit të valutës së huaj (që përfshihet në definicion).

1159. Është Rregulli XVI i BQK-së ai që mundohet të ndërlidhë edhe shërbimet e transferimit edhe ato të këmbimit valutor me definicionin e institucionit financiar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/21, e cila megjithatë është shfuqizuar nga Ligji për bankat, pra çfarëdo reference e tillë në Rregullin XVI bëhet irrelevante.

1160. Nga kjo rrjedh pra që definicionet e ndryshme të institucionit financiar, e që dallojnë në substancë, krijojnë paqartësi ligjore në kërkesat e licencimit apo regjistrimit, si dhe në obligimet për shërbime të transferimit dhe këmbimit valutor.

1161. Kështu, shërbimet e këmbimit të valutës së huaj ligjërisht mund të jenë pjesë e regjimit të licencimit apo regjistrimit të BQK-së, për shkak të referencës së drejtpërdrejtë në Ligj për BQK-në dhe Ligj për bankat, edhe pse aktiviteti i tillë nuk përfshihet në nenin 94 të Ligjit për bankat si aktivitet i një institucioni financiar jobankar.

1162. Në anën tjetër, shërbimet e transferimit nuk përfshihen në definicionin e institucionit financiar në Ligjin për BQK-në, si dhe në Ligjin për bankat, por përfshihen si një aktivitet në nenin 94 të Ligjit për bankat për institucione financiare jobankare.

1163. Referenca në Rregullin XVI të BQK-së ndaj shërbimeve të transferimit dhe këmbimit valutor në definicionin e institucionit financiar në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/21 bëhet e parëndësishme, pasi që Rregullorja e UNMIK-ut është shfuqizuar me Ligjin për bankat, si dhe krijon konflikte me definicionet e reja.

1164. Pra, duket që ka paqartësi ligjore në kuptimin e pushtetit të BQK-së për licencimin apo regjistrimin e shërbimeve të transferimit të parave.

1165. Rrjedhimisht, rekomandohet fuqimisht që definicionet e ndryshme të institucionit financiar në ligjet e lartpërmendura të harmonizohen mes vete, si dhe në lidhje me aktivitetet e institucioneve financiare jobankare me qëllim të krijimit të qartësisë juridike në autorizimet licencuese të BQK-së.

Monitorimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve të transferimit të parave apo vlerës apo të këmbimit valutor – Kriteri thelbësor 23.6

1166. KTh 23.6 kërkon që personat fizikë apo juridikë që ofrojnë shërbime të transferimit apo të këmbimit valutor t’i nënshtrohen sistemeve efektive për monitorimin dhe sigurimin e përmbushjes së kërkesave vendore për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1167. Në definicionin e vet të “institucionit financiar”, Ligji LPP/LFT përfshin¹²² transferimin e valutës apo instrumenteve monetare, në çfarëdo mënyre, duke përfshirë atë me anë të sistemit joformal të transferimit të parave, ose përmes një rrjeti personash apo entitetesh që mundësojnë transferimin e parave jashtë sistemit konvencional të institucioneve financiare; si dhe ndërrimin e parave dhe valutës.

1168. Sipas nenit 16 të Ligjit LPP/LFT, institucionet financiare siç definoohen në ligj konsiderohen të jenë subjekte raportuese, pra obligohen të respektojnë gjitha obligimet në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në kuptimin e termave të ligjit.

1169. Në fakt, neni 19 i Ligjit LPP/LFT përcakton obligime specifike për banka dhe institucione financiare që ofrojnë shërbime transferimi bankar dhe vendos procedurat që duhen ndjekur për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në kryerjen e transferimit.¹²³

1170. Megjithatë, siç theksohet tashmë me këtë Raport, Ligji LPP/LFT emëron NjIF-në si autoritet mbikëqyrës për gjitha subjektet raportuese me përjashtim të sektorit financiar, si dhe nuk cakton apo nuk emëron ndonjë autoritet për mbikëqyrjen e sektorit financiar.

1171. Pavarësisht kësaj, BQK-ja ka informuar që janë ndërmarrë disa inspektive në terren:

Tabela 17: Vizitat në terren tek operatorët e transferimit (të parave apo vlerave) me komponentin e LPP-së

	2008	2009	2010	2011
Operatorë MVT		1		2
Operatorë të këmbimit valutor		3	2	30
Total		4	2	32

1172. Pa marrë parasysh dallimet në definicionet e institucionit financiar në lidhje me shërbimet e transferimit të parave dhe këmbimit të parave apo valutës, prapë Ligji LPP/LFT i vë të dy entitetet si subjekte raportuese për qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit sipas ligjit.

1173. Emërimi apo përcaktimi i autoritetit kompetent për monitorimin dhe sigurimin që këto dy lloje entitetesh janë në përputhje me kërkesat për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në pajtim me Ligjin LPP/LFT, megjithatë, është përcaktuar tashmë si mungesë, pa anashkaluar faktin që BQK-ja tashmë ka marrë përgjegjësinë e tillë, si dhe në praktikë monitoron institucionet e tilla për të siguruar përmbushjen e kërkesave të Ligjit LPP/LFT.

1174. Pra, edhe një herë rekomandohet fuqimisht që autoriteti kompetent të emërohet me përgjegjësinë e monitorimit të këtyre llojeve të institucioneve financiare (si dhe gjithë sektorit financiar) për respektimin e obligimeve nga ligji LPP/LFT.

¹²² Për definicionin e plotë të institucionit financiar, për qëllimet e ligjit LPP/LFT, referojuni nenit 3 të këtij Raporti mbi “Fushën e mbulimit të Ligjit LPP/LFT”.

¹²³ Deri në një masë këto reflektojnë kërkesat sipas FATF RV VII.

Licencimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e gjitha institucioneve financiare nuk i nënshtrohet Parimeve thelbësore – Kriteri thelbësor 23.7

1175. KTh 23.7 parasheh që gjitha llojet e institucioneve financiare që nuk zbatojnë Parimet thelbësore për banka, kompani sigurimi apo kompani investuese, të licencohen apo regjistrohen, si dhe të rregullohen përshtatshëm, e t'i nënshtrohen mbikëqyrjes për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1176. Për hir të kompletimit të kësaj analize, do t'i referohemi autorizimeve të BQK-së në këtë drejtim për gjithë sektorin financiar, por fokusohemi tek ato entitete që nuk bëjnë pjesë tek Parimet thelbësore.

1177. Siç është përshkruar tashmë tek analiza për KTh 23.5 të këtij raporti, Ligji për BQK-në dhe Ligji për bankat përcaktojnë që BQK-ja ka përgjegjësinë ekskluzive të licencimit dhe rregullimit të institucioneve financiare, sipas definicioneve të tyre apo ligjeve tjera.

1178. Ligji për fondet pensionale ngjashëm përcakton përgjegjësitë e licencimit dhe rregullimit të BQK-së për fonde të pensioneve, derisa Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 përcakton pushtetin dhe përgjegjësitë e BQK-së për licencim dhe rregullim për kompani sigurimi dhe ndërmjetëse sigurimi.

1179. Pavarësisht kësaj, si dhe siç është theksuar tashmë në këtë Raport, nuk ka dispozitë ligjore në Ligjin LPP/LFT që emëron apo përcakton autoritetin kompetent për mbikëqyrjen e institucioneve financiare lidhur me respektimin nga to të obligimeve sipas Ligjit LPP/LFT.

1180. Pa paragjykuar analizën dhe konkludimet sipas analizës për KTh 23.5 si më lart, si dhe duke iu referuar shërbimeve të transferimit dhe këmbimit të valutës, duket që gjitha institucionet financiare që merren me aktivitete financiare, sipas definicioneve në ligjet përkatëse, i nënshtrohen një regjimi licencues apo regjistruar, si dhe i nënshtrohen rregullimit dhe mbikëqyrjes nga BQK-ja. Në fakt, Ligji për BQK-në dhe Ligji për bankat ia bartin BQK-së gjithë mbikëqyrjen e kujdesit mbi gjitha institucionet financiare.

1181. Siç është theksuar tashmë në këtë raport, në mungesë të bazës ligjore, në raport vlerësohet pozitivisht puna mbikëqyrëse e kryer nga BQK-ja në të siguarit që i gjithë sektori financiar të jetë në përputhje me obligimet sipas Ligjit LPP/LFT për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1182. Pra, është edhe një herë plotësisht e qartë që mungesa e emërimit apo përcaktimit specifik të një autoriteti kompetent për mbikëqyrje dhe monitorim të të gjithë sektorit financiar, për qëllimet e ligjit LPP/LFT mbetet një mangësi serioze në legjislacionin që pengon Kosovën në arritjen e përputhshmërisë me standardet e ndryshme ndërkombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Pra, edhe një herë fuqimisht rekomandohet që autoriteti kompetent të emërohet, me përgjegjësinë e mbikëqyrjes dhe monitorimit të të gjitha institucioneve financiare për respektimin nga to të obligimeve sipas Ligjit LPP/LFT.

Struktura, financimi, personeli dhe resurset tjera të autoriteteve mbikëqyrëse – Kriteri thelbësor 30.1

1183. Në KTh 30.1 parashihet që autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse të sigurojnë nga institucionet financiare përmbushjen e obligimeve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit sipas ligjeve përkatëse, që të kenë strukturën, financimin, personelin adekuat, si dhe të kenë resurse të mjaftueshme teknike dhe të tjera për të kryer plotësisht dhe efektivisht funksionet e tyre.


1184. Pa paragjykuar argumentet e dhëna me këtë raport mbi bazën ligjore të pushtetit mbikëqyrës të BQK-së për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, BQK-ja ushtron këtë funksion përmes Drejtoratit të saj të mbikëqyrjes bankare, i cili përfshin një Divizion kundër pastrimit të parave.

1185. Diagrami në vijim, i nxjerrë nga faqja zyrtare e BQK-së ofron strukturën e Drejtorisë së mbikëqyrjes bankare, pjesë e të cilës është edhe Divizioni LPP/LFT.

1186. Aktualisht janë dy persona në Divizionin kundër pastrimit të parave. Në vlerësimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi Parimet Thelbësore Bankare të Bazelit, theksohet: *Sa i përket Divizionit LPP të BQK-së, i njëjti ka dy punonjës: pra, shefi i Divizionit dhe një kontrollues tjetër. Megjithatë, vlerësuesit e PThB-ve kanë arritur të takohen vetëm me kontrolluesin, pasi që shefja e divizionit ka qenë në pushim për të përfunduar shkallën e doktoraturës jashtë vendit, deri në fund të vitit 2012. Përveç kësaj, vlerësuesit janë informuar në një takim të mbajtur me personelin e BQK-së që shefja e Divizionit LPP është shumë e afërt familjarisht me një deputete të Kosovës (është vajza e saj), si dhe si e tillë, duhet të konsiderohet si PEP – person i ekspozuar politikisht. Ngjashëm, ekipi vlerësues i PKEK-së gjithashtu nuk ka mundur të takohet me shefen e Divizionit të LPP-së në Bankën Qendrore, kështu që disa pyetje kryesore mbeten pa përgjigje.*

1187. Divizioni kundër pastrimit të parave në BQK financohet përmes Buxhetit të BQK-së, sipas dispozitës në nenin 64 të Ligjit të BQK-së, i cili vlen për gjitha fushat tjera të Bankës. Ky Divizion ka qasje në sistemet e TI-së dhe resurset tjera të Bankës.

1188. Ligji LPP/LFT parasheh që NjIF-ja të jetë autoritet mbikëqyrës për mbikëqyrjen e gjitha subjekteve raportuese, me përfshirje të të gjithë sektorit financiar.



1189. Fatkeqësisht, organogrami i NjIF-it ende nuk është vënë në dispozicion. Sipas Raportit vjetor të vitit 2011 nga NjIF, struktura e Njësisë, duke përjashtuar zyrtarët e EULEX-it dhe personelit të deleguar,¹²⁴ përbëhet nga 14 zyrtarë, si në vijim: drejtori i NjIF-it (1), menaxheri i TI-së (1), zyrtari ligjor (1), zyrtari për buxhet e financa (1), zyrtari i prokurimit (1), ndihmësi administrativ (1) dhe analistët e inteligjencës (8).

1190. Pavarësisht fushëveprimit mbikëqyrës të NjIF-it, të përcaktuar me Ligjin LPP/LFT, si dhe pavarësisht faktit që Raporti vjetor 2011 thekson që një numër vizitash inspektuese janë ndërmarrë gjatë periudhës, struktura e Njësisë, e definuar sipas Raportit vjetor, nuk paraqet ndonjë zyrtar përgjegjës për përputhshmëri, përveç nëse ky funksion kryhet nga Analiza Inteligjente. Në të vërtetë, NjIF ka konfirmuar se e ka një departament për analizime dhe operime, dhe një departament për përputhshmëri dhe inspektim. Megjithatë, një numër i analistëve të inteligjencës janë caktuar të bëjnë edhe inspektime të përputhshmërisë. Duke e njohur çështjen e burimeve, ekipi i vlerësuesve e vë në pikëpyetje mundësinë e analistëve të inteligjencës për t'i bërë edhe këto vizita të përputhshmërisë.

1191. NjIF-i ka buxhetin e vet përmes Ministrisë së Financave, derisa ka sistemet e veta të brendshme të TI-së, ndaras nga baza e të dhënave.¹²⁵

1192. Në këtë raport nuk është vlerësuar hollësisht struktura e përgjithshme të mbikëqyrjes së kujdesit mbi sektorin financiar në BQK, i cili megjithatë duket të jetë adekuat.

1193. Derisa fokusi i këtij vlerësimi ka qenë dispozicioni i resurseve për mbikëqyrjen e sektorit financiar për përputhshmëri me Ligjin LPP/LFT, si dhe rregullat e rregulloret e tjera përkatëse, ky raport merr parasysh vetëm Divizionin kundër pastrimit të parave në BQK.

1194. Duke marrë parasysh numrin e bankave dhe institucioneve financiare që rregullohen dhe mbikëqyren përmes LPP/LFT, duket që resurset njerëzore (2 punëtorë, vetëm një nga të cilët është kontrollues, edhe pse siç është thënë nga BQK, kryesuesi i Divizionit po ashtu merr pjesë në ekzaminime) në Divizionin kundër pastrimit të parave janë joadekuate dhe të papërshtatshme. Edhe pse sipas statistikave të ofruara nga BQK-ja, janë bërë disa vizita në terren, këto përfaqësojnë vetëm elementet e vizitës për kujdesin e duhur. Pra, BQK-ja ka mungesë të resurseve për të bërë kontrole të plota dhe të fokusuar LPP/LFT në banka e institucione financiare me kohë dhe në mënyrë adekuate, si dhe për të përcjellë e siguruar që masat korrigjuese ndërmerren aty ku ka rekomandime sipas gjetjes së kontroleve – kjo pa paragjykuar shqetësimet e shprehura në këtë raport mbi bazën ligjore të funksionit mbikëqyrës të BQK-së.

1195. Çështja e resurseve në BQK për detyrën e mbikëqyrjes për LPP/LFT do të bëhet edhe më brengosëse nëse BQK-ja merr përsipër autorizimet ekskluzive të mbikëqyrjes së gjithë sektorit financiar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1196. Struktura e NjIF-it dhe resurset e saj për përmbushjen e funksioneve mbikëqyrëse – të cilat aktualisht nuk përfshijnë sektorin financiar – mund të jenë tejet brengosëse, nëse NjIF-i merr përsipër mbikëqyrjen e sektorit financiar.

1197. Pra, rekomandohet fuqimisht që përgjegjësia e mbikëqyrjes së sektorit financiar për BQK-në apo NjIF-në për detyrat sipas ligjit LPP/LFT duhet përcjellë me kërkesën që të rivlerësohen dhe të përforcohen resurset për të përmbushur këtë përgjegjësi në mënyrë adekuate dhe efektive.

¹²⁴ Personeli i EULEX-it 9 (7 ndërkombëtarë, 2 vendorë); personeli i deleguar nga Dogana (1), Administrata Tatimore e Kosovës (1).

¹²⁵ Për më shumë hollësi për NjIF-në, referojuni nenit 2.6 të këtij raporti.

Standardet e larta profesionale – Kriteri thelbësor 30.2

1198. KTh 30.2 kërkon që autoritetet mbikëqyrëse me fushëveprimin e mbikëqyrjes së entiteteve për përmbushje të obligimeve për parandalimin e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit të kenë standarde të larta profesionale, duke përfshirë standardet në lidhje me konfidencialitetin, integritetin dhe shkathtësitë e kërkuara.

1199. Pasi që në Ligjin LPP/LFT nuk emërohet ndonjë autoritet kompetent me përgjegjësi të mbikëqyrjes së sektorit financiar për përmbushjen e kërkesave të ligjit, kjo analizë vlerëson standardet profesionale që aplikohen nga BQK-ja si autoritet që në praktikë aktualisht ushtron mbikëqyrjen në këtë kuptim, si dhe NjIF-i si autoritet i emëruar si kompetent për mbikëqyrjen e gjitha subjekteve raportuese, me përjashtim të sektorit financiar, sipas Ligjit LPP/LFT. Për më tepër, të dyja institucionet janë autoritetet potenciale kompetente për qëllimin e mbikëqyrjes së gjithë sektorit financiar pas rishikimit të Ligjit LPP/LFT.

1200. Neni 6 i Ligjit për BQK-në përcakton pavarësinë dhe autonominë e institucionit dhe anëtarëve të tij. Ligji kërkon që BQK-ja, anëtarët e organeve vendimmarrëse apo personelit të saj, të mos marrin udhëzime nga ndonjë person apo entitet tjetër, duke përfshirë organet qeveritare, si dhe që pavarësia e autonomia e BQK-së të respektohet gjithmonë.

1201. Për më tepër, neni 40 i Ligjit për BQK-në përcakton që për t'u kualifikuar për shërbim në organet vendimmarrëse të BQK-së, personi duhet të ketë integritet dhe të ketë diplomë universitare. Personi i tillë duhet të ketë së paku dhjetë (10) vjet përvojë profesionale apo akademike në fushat e ekonomisë, financave, bankave, kontabilitetit apo çështjeve juridike.

1202. Për më tepër, neni 52 i Ligjit për BQK-në më tutje përcakton që emërimi dhe ndërprerja e punësimit të punëtorëve i përket guvernatorit të Bankës, në pajtim me kushtet e përgjithshme të punësimit dhe kushtet e miratuara nga Bordi ekzekutiv. Në këtë kuptim, BQK-ja ka procedura rekrutimi, përmes të cilave sigurohet integriteti dhe aftësitë e kërkuara të punëtorëve të saj.

1203. Në pajtim me nenin 69 të Ligjit për BQK-në, anëtarët e organeve vendimmarrëse të BQK-së dhe personeli i saj kanë detyrë në mirëbesim tek BQK-ja, si dhe ndaj konsumatorëve të saj, që të vendosin BQK-në dhe interesat e klientëve të tyre para interesave vetanake, si dhe të shmangin çdo situatë që ka mundësi të krijojë konfliktin e interesit.

1204. Në krijimin e kulturës etike brenda Bankës, neni 69 i Ligjit për BQK-në më tutje kërkon që anëtarët e organeve vendimmarrëse të Bankës dhe personeli i saj të mos pranojnë nga asnjë burim asnjë përfitim, shpërblim, kompensim apo dhuratë përtej shumës së përcaktuar apo modeste, qoftë ajo financiare apo jofinanciare, përfitime, shpërblime, kompensime apo dhurata këto që mund të lidhen në çfarëdo mënyrë me aktivitetet e tyre në BQK. Në këtë drejtim, BQK-ja mund të vendosë rregullore e procedura të brendshme.

1205. Përfundimisht, neni 74 i Ligjit për BQK-në vendos detyrën e konfidencialitetit, përveç në rastet kur është e nevojshme për të përmbushur ndonjë detyrë apo punë të kërkuar sipas këtij apo ndonjë Ligji tjetër, mbi gjithë personat që kanë shërbyer apo aktualisht shërbejnë si anëtarë të Bordit, Komitetit ekzekutiv apo si pjesëtarë personeli, nga lejimi i qasjes, zbulimi apo publikimi i informatave jopublike, të cilat merren gjatë kryerjes së detyrave në Bankë apo në përdorimin e informatave të tilla, ose lejimi i informatave që të përdoren për përfitime personale. Më tutje, neni 74 përcakton mundësitë kur ky konfidencialitet mund të hiqet në pajtim me Ligjin.

1206. Neni 4 i Ligjit LPP/LFT përcakton NjIF-në si institucion qendror kombëtar të pavarur përgjegjës për kërkimin, pranimin, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente, zbulimin e informatave të cilat kanë të bëjnë me pastrimin e mundshëm të parave dhe financimin e terrorizmit. Në kuptimin e nenit 7 të Ligjit, Bordi menaxhues i Njesisë nuk ka të drejtë të ndërhyjë në asnjë mënyrë në rastet në trajtim nga NjIF-i.

1207. Neni 5 i Ligjit LPP/LFT përcakton anëtarët e Bordit menaxhues të NjIF-it përmes pozitave të mbajtura *ex officio*, pra nuk janë me emërim. Mes kompetencave të përcaktuara me Ligj, Bordi menaxhues emëron dhe shkarkon drejtorin e NjIF-it, me propozim të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në bazë të njohurisë, profesionalizmit dhe përvojës së demonstruar. Ligji LPP/LFT përcakton gjithë procesin e nominimit, përzgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të drejtorit.

1208. Përndryshe, Ligji LPP/LFT nuk flet për rekrutimin e personelit në NjIF. NjIF-i, megjithatë, ka informuar gjatë vizitës që rekrutimi i tillë i nënshtrohet kushteve normale të rekrutimit për shërbyes civilë, në kuptimin e Rregullores 02/2010 të Ministrisë së Administratës Publike për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil si dhe Rregullores 07/2010 të Ministrisë së Administratës Publike për emërimin e shërbyesve civilë. Në procesin e përzgjedhjes për personelin e Njesisë, e njëjta zakonisht përfaqësohet nga drejtori.

1209. Paragrafi (1.17) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT parasheh që personeli i NjIF-it të ruajnë si konfidenciale çdo informatë që ata marrin brenda fushëveprimit të detyrave të tyre, edhe pas përfundimit të detyrave të tyre brenda Njesisë, si dhe që të përdorin informatat e tilla vetëm për qëllimet e përcaktuara në pajtim me Ligjin LPP/LFT.¹²⁶

1210. Analiza e dispozitave ligjore për rekrutimin dhe funksionet e personelit, si dhe obligimet e konfidencialitetit, tregon që edhe BQK-ja edhe NjIF-i, si autoritetet aktuale apo potenciale të mbikëqyrjes për qëllimet e Ligjit LPP/LFT kanë standarde të larta profesionale në lidhje me konfidencialitetin, integritetin dhe shkathtësitë, në pajtim me kërkesat sipas FATF KTH 30.2.

1211. Nuk ka nevojë për rekomandime të mëtutjeshme në këtë drejtim.

Trajnimi adekuat dhe relevant për LPP/LFT

1212. Në KTh 30.3 parashihet që personeli përkatës i autoriteteve mbikëqyrëse të vijojë trajnime adekuate dhe relevante në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1213. Nuk ka dispozita në asnjë ligj në këtë drejtim, edhe pse paragrafi (1.10) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT parasheh që NjIF-i të organizojë dhe/ose ofrojë trajnime në lidhje me pastrimin e parave, financimin e aktiviteteve terroriste, si dhe obligimet e subjekteve raportuese. Këtu duhet të përfshijnë edhe trajnimet për vetë personelin e NjIF-it. Në përgjithësi, mund të pritët që trajnimi i tillë përbën pjesë të programeve të përgjithshme të trajnimit nga autoriteti përkatës mbikëqyrës.

1214. Sipas informatave të dhëna nga NjIF-i, punëtorët e ndryshëm në të kaluarën dhe të tashmen kanë ndjekur një numër seancash trajnimi. Trajnimet e tilla të ofruara nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me çështjet LPP/LFT, por gjithashtu mbulohen edhe trajnimet në lidhje me sistemet e TI-së (goAML); vizitat studimore dhe aspektet operacionale.

¹²⁶ Për më shumë hollësi mbi NjIF-në, referojuni nenit 2.6 të këtij raporti.

1215. Në përgjigjet e saj në pyetësor, BQK-ja ka informuar që në bazë të politikës së trajnimeve në BQK, personeli relevant (nga Divizioni LPP dhe Divizionet e tjera mbikëqyrëse) kanë përfituar nga trajnimet e organizuara nga 'JVI – Joint Vienna Institute'; 'Banque de France'; Thesari Amerikan dhe Policia e Kosovës; Programi Ndërkombëtar për Ndhimë në Trajnime për Hetime Penale (ICITAP) dhe të tjerë.

1216. Informatat e ofruara tregojnë që trajnimet për personelin përkatës të autoriteteve kompetente mbikëqyrëse, në këtë rast NjIF dhe BQK, janë duke u ndërmarrë si pjesë e programeve trajnuese dhe politikave të të dy institucioneve.

1217. Nuk ka nevojë për rekomandime specifike, por të dy institucionet ndoshta duhet të rishikojnë programet e tyre të trajnimit në këtë kuptim, për të reflektuar ndryshimet e mundshme në Ligjin LPP/LFT që do të vendosë autoritetin mbikëqyrës për gjithë sektorin financiar për qëllime të respektimit të Ligjit LPP/LFT.

Statistikat (KTh 32.3)

1218. KTh 32.2 parasheh nga autoritetet kompetente që të mbajnë statistika gjithëpërfshirëse mbi kontrollimet në terren të kryera nga kontrolluesit në lidhje me LPP/LFT apo duke përfshirë atë, si dhe për sanksionet e aplikuara. Këto dhe statistikat tjera të ndërlidhura duhet të jenë relevante për matjen e efektshmërisë dhe efikasitetit të implementimit të Rekomandimit 23 të FATF.

1219. Sipas Ligjit LPP/LFT nuk ka obligime për autoritetet kompetente që të mbajnë statistika të ndonjë lloji, edhe pse duket që në praktikë disa statistika mbahen.

1220. Edhe pse neni 25 i Ligjit për BQK-në merret me mbledhjen e statistikave nga Banka, statistikat e tilla nuk i referohen atyre që kërkohen sipas Rekomandimit 32 FATF. Në fakt, nuk ka obligim sipas Ligjit për BQK-në apo Ligjit për bankat që kërkon mbajtjen e statistikave nga vetë BQK-ja, qofshin ato të ndërlidhura me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit apo jo.

1221. Në përgjigjet e veta në pyetësor, BQK-ja ka ofruar statistika mbi numrin e vizitave në teren (kryesisht të kujdesit, me një komponent LPP/LFT) të kryera që prej vitit 2008.

1222. NjIF-i nuk ka ofruar statistika të ngjashme, edhe pse statistikat indikativë ofrohen në Raportin vjetor të Njësisë për vitin 2011.

1223. Edhe pse disa statistika janë ofruar, nuk duket që mbajtja e statistikave të tilla mjafton për të vlerësuar efektshmërinë e regjimit mbikëqyrës për qëllimet e Ligjit LPP/LFT.

1224. Mbajtja e përgjithshme e statistikave për matjen e efektshmërisë së gjithë regjimit LPP/LFT mund të ketë nevojë për rishikim, si dhe përforcim të gjithë formulimit ligjor përmes Ligjit LPP/LFT. Në fakt, një prej kompetencave të NjIF-it është *përpijojë statistika e regjistra, si dhe në bazë të tyre, të bëjë rekomandime.*

1225. Pra, rekomandohet që një nen i ri 30A nën titullin "Të dhënat statistikore" të futen në Ligjin LPP/LFT, duke imponuar mbajtjen e statistikave nga subjektet raportuese dhe autoritetet përkatëse kompetente, si në vijim:

Neni 30A Të dhënat statistikore

(1) NjIF-i, autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetet tjera kompetente me përgjegjësi për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, subjektet raportuese dhe personat apo entitetet tjera me obligime sipas këtij Ligji,

duhet të mbajnë të dhëna gjithëpërfshirëse statistikore për fushën e tyre të përgjegjësive.

(2) Në mbajtjen e të dhënave statistikore, personat, entitetet dhe autoritetet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni do të bashkëpunojnë me NjIF-në, e cila mund të përcaktojë llojin e të dhënave statistikore që kërkon.

(3) Të dhënat statistikore të mbajtura sipas këtij neni i vihen në dispozicion NjIF-it brenda periudhave kohore të konsideruara si të nevojshme nga NjIF-i për të rishikuar efektshmërinë e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandimet e nevojshme sipas nenit 14 të këtij Ligji.

Efektshmëria (në përgjithësi për Rekomandimin 23)

1226. Mangësitë dhe dobësitë e ndryshme të identifikuara në strukturën mbikëqyrëse për qëllimet e monitorimit të bankave dhe institucioneve financiare për respektimin nga to të obligimeve ligjore LPP/LFT mbeten brengë për efektshmërinë e regjimit mbikëqyrës LPP/LFT.

1227. Më së pari, është mosemërimi i autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e sektorit financiar për respektimin e Ligjit LPP/LFT, kombinuar me mungesën pasuese të kompetencave të atij autoriteti që të nxjerrë rregulla e rregullore për implementimin e Ligjit LPP/LFT, derisa rregullat aktuale të nxjerra nga BQK-ja i referohen ende Rregulloreve të shfuqizuara të UNMIK-ut.

1228. Edhe pse procedurat e licencimit për sektorin financiar janë adekuate, paqartësia ligjore për licencimin apo regjistrimin e shërbimeve të transferimit e rritë edhe më shumë brengën e efektshmërisë.

1229. Përfundimisht, efektshmëria e sistemit ndikohet edhe më tutje negativisht nga numri i vogël i vizitave në terren, mungesa e personelit dhe mungesa e statistikave adekuate dhe kuptimplote.

3.9.2. Rekomandimet dhe komentet (përgjithësisht për Rekomandimin 23 FATF)

1230. Analiza e përputhjes me rekomandimin 23 mbizotërohet kryesisht nga mungesa e bazës ligjore për BQK-në në fushëveprimin e saj si autoritet mbikëqyrës për sektorin financiar, për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, me përjashtimin e atyre kritereve në Rekomandimin 23 të cilat janë ekskluzivisht në fushëveprimin e BQK-së në lidhje me licencimin, aksionet dhe qeverisjen e bankave dhe institucioneve financiare të qeverisura nga dokumentet tjera ligjore specifike financiare.

1231. Pa anashkaluar këto, pasi që në praktikë BQK-ja bën mbikëqyrjen e sektorit financiar për qëllimet e LPP/LFT, pa paragjykuar mungesën e bazës ligjore, analiza e procesit mbikëqyrës të BQK-së gjen disa mangësi apo dobësi për Rekomandimin 23, që duhen adresuar:

- Mungesa e bazës ligjore për BQK-në apo autoritetet tjera kompetente që të veprojnë si autoritet mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllimet e Ligjit LPP/LFT (KTh 23.1; KTh 23.6 dhe KTh 23.7);
- Mungesa e mandatit për BQK-në që të nxjerrë rregulla e rregullore për qëllimet e Ligjit LPP/LFT (KTh 23.2 dhe KTh 23.4);
- Nuk ka obligim sipas Ligjit për Bankat për një person apo entitet që lirohet nga një interes i konsiderueshëm në një bankë që të informojë BQK-në (KTh 23.3);

- Kriteret në vlerësimin e kërkesës për ndryshime në aksione nuk merr parasysh implikimet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (KTh 23.3); si dhe
- Dallimet në definimin e “institucionit financiar” që krijojnë paqartësi ligjore në kërkesat e licencimit (KTh 23.5).

1232. Në dritën e dobësive apo mangësive të identifikuara si më lart për Rekomandimin 23, rekomandime të ndryshme janë dhënë në këtë nen, për të përforcuar kornizën legjislative për një sistem më efektiv për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Është e rëndësishme që rekomandimet e dhëna të lexohen në kontekstin e komenteve të dhëna më herët në këtë raport, për kriteret përkatëse thelbësore për Rekomandimet 23, 30 dhe 32:

- Vendosja e bazës ligjore që përcakton autoritetin kompetent që të veprojë si autoritet mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllimet e Ligjit LPP/LFT (KTh 23.1; KTh 23.6 dhe KTh 23.7);
- Mandati ligjor mbikëqyrës duhet përcjellë nga mandati i autoritetit të përcaktuar mbikëqyrës që të nxjerrë rregulla e rregullore obligative e detyruese për LPP/LFT (për BQK përtej autorizimeve të BQK-së në këtë drejtim, sipas nenit 85 të Ligjit për bankat për qëllime kujdesi (KTh 23.2 dhe KTh 23.4);
- Futja e një paragrafi të ri (6) në nenin 37 të Ligjit për Banka, duke kërkuar që personi apo entiteti, si i vetëm apo në bashkëpunim me tjetrin, që dëshiron të lirohet nga një interes i konsiderueshëm apo të zvogëlojë aksionet aktuale, të informojë BQK-në për këtë (KTh 23.3);
- Futja e një paragrafi të ri (2) në nenin 38 të Ligjit për Bankat, që kërkon aplikimin e kriterëve LPP/LFT të përcaktuara me Direktivën e BE-së për bashkimet dhe blerjet për miratim të ndryshimeve në aksione (KTh 23.3);
- Ndryshimi i paragrafit (3) të nenit 39 të Ligjit për Bankat për bashkimet, konsolidimet dhe blerjet në pajtim me paragrafin e propozuar (2) në nenin 38; si dhe
- Harmonizimi i definicioneve të “institucionit financiar” në ligjet e ndryshme (KTh 23.5).

1233. Disa elemente të Rekomandimit 30 që merren me resurse gjithashtu janë vlerësuar dhe janë identifikuar disa dobësi:

- Resurse joadekuate edhe në BQK edhe në NJIF për qëllime mbikëqyrëse për LPP/LFT (KTh 30.1).

1234. Në kuptimin e mangësive për Rekomandimin 30, ky raport bën disa rekomandime të cilat përndryshe duhet lexuar në kontekstin e analizës së gjendjes aktuale;

- Mandati ligjor që përcakton një autoritet kompetent për mbikëqyrjen e gjithë sektorit financiar për qëllimet e Ligjit LPP/LFT duhet përcjellur me rishikimin e resurseve adekuate njerëzore dhe të tjera (KTh 30.1).

1235. Në analizën e dispozicionit të statistikave për qëllimet e KTh 32.2 në Rekomandimin 32 të raportit, shihet nevoja për përforcimin e kësaj kërkesë përmes një obligimi ligjor për mbajtjen e statistikave.

1236. Raporti rekomandon që një nen i ri 30A të shtohet tek titulli “Të dhënat statistikore”, siç theksohet më lart, në Ligjin LPP/LFT, që kërkon ruajtjen e statistikave nga subjektet raportuese dhe autoritetet kompetente relevante.

3.9.3. Nota për Rekomandimin 23

	Nota	Përmbledhja e faktorëve që përbëjnë notën
Rek 23	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e mandatit ligjor për autoritetin kompetent mbikëqyrës për sektorin financiar; • Mungesa e mandatit për autoritetin kompetent mbikëqyrës për të nxjerrë rregulla e rregullore për LPP/LFT; • Nuk ka obligim për të informuar BQK-në për lirimin nga aksionet; • Nevoja për të përforcuar kriteret për miratimin e ndryshimeve në aksione në lidhje me çështjet LPP/LFT; • Dallimet në definimin e «institucionit financiar»; • Paqartësia ligjore në kërkesat e licencimit për disa institucione financiare; • Numri i vogël i vizitave në terren; si dhe • Çështjet e efektshmërisë që dalin nga mungesa e mandatit ligjor mbikëqyrës; mungesa e mandatit ligjor për të nxjerrë rregulla e rregullore, si dhe paqartësia ligjore në licencimin e shërbimeve të transferimit të parave. • Resurset njerëzore për autoritetet mbikëqyrëse janë të pamjaftueshme, duke ndikuar kështu në efektshmëri; • Mungesa e programeve relevante të trajnimit për personelin mbikëqyrës ndikon në efektshmëri; • Nevoja që autoritetet të mbajnë statistika më kuptimplote, përndryshe efektshmëria nuk mund të gjykohet në mënyrë adekuate.

3.10. Mbikëqyrësit (R.29)

3.10.1. Përshkrimi dhe analiza

1237. Rekomandimi 29 merret me autorizimet mbikëqyrëse të mbikëqyrësve për të monitoruar dhe për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë autoritetin për të ndërmarrë inspektime në terren.

1238. Siç është përcaktuar tashmë me këtë raport, në ushtrimin e funksionit të saj mbikëqyrës mbi sektorin financiar, për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, BQK-ja nuk ka mandat ligjor.

1239. Mungesa e një mandati ligjor mbikëqyrës bart me vete edhe mungesën e mandatit ligjor të BQK-së që të përdorë pushtetin mbikëqyrës sipas Ligjit për BQK-në dhe Ligjin për Bankat apo ndonjë ligji tjetër, autorizime këto që vendosen për qëllime kujdesi për ato institucione brenda kornizave të funksioneve mbikëqyrëse të BQK-së sipas këtyre ligjeve, e jo për qëllime të LPP/LFT-së.

1240. Vijimisht, edhe pse paragrafët në vijim do të analizojnë dhe vlerësojnë autorizimet mbikëqyrëse të kujdesit të BQK-së, kjo do të bëhet vetëm për qëllime vlerësimi, pa paragjykuar qëndrimin e këtij Raporti ndaj mungesës së mandatit të mbikëqyrjes ligjore. Duke mos anashkaluar këtë, Raporti prapë pozitivisht vlerëson punën mbikëqyrëse që bëhet nga BQK-ja në praktikë.

1241. Paragrafët që vijojnë gjithashtu do të marrin parasysh autorizimet mbikëqyrëse sipas Ligjit LPP/LFT që i janë dhënë NjIF-it si autoritet i emëruar mbikëqyrës për gjitha subjektet

raportuese, me përjashtim të sektorit financiar në dritën e vendimit në pritje për emërimin e një autoriteti relevant kompetent mbikëqyrës për sektorin financiar.

Autorizimet adekuate për monitorimin dhe sigurimin e përputhshmërisë – Kriteri thelbësor 29.1

1242. KTh 29.1 parasheh që autoritetet mbikëqyrëse të kenë autorizime adekuate për të monitoruar dhe siguruar përputhshmërinë nga institucionet financiare, me obligime për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

1243. Në nenin 30 të Ligjit LPP/LFT caktohet NjIF si autoritet mbikëqyrës që të mbikëqyrë gjitha subjektet raportuese sipas Ligjit, me përjashtim të sektorit financiar. Në këtë kuptim, neni 30 përcakton autorizimet e NjIF-it për të ndërmarrë efektivisht detyrat e veta të mbikëqyrjes. Në vendosjen e parametrave brenda të cilëve zyrtarët e autorizuar të NjIF-it mund të ndërmarrin inspektimet e tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për qasje, neni 30 më tutje obligon pronarin apo titullarin e lokaleve që inspektohen dhe secilin person të pranishëm në lokale që t'i ofrojnë zyrtarëve të autorizuar gjithë ndihmën e arsyeshme në kryerjen e përgjegjësisë të tyre.

1244. Neni 23 i Ligjit për BQK-në përcakton detyrat mbikëqyrëse të BQK-së, me përgjegjësinë ekskluzive të Bankës për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve tjera financiare. Brenda këtij konteksti, neni 30 më tutje përcakton autorizimet e zyrtarëve të autorizuar të BQK-së që të vizitojnë zyrat e institucioneve financiare. Përfundimisht, neni 30 kërkon nga institucionet financiare që të pajisin BQK-në me informata e dosje për operacionet dhe gjendjen e tyre financiare sipas kërkesës së BQK-së.

1245. Neni 57 i Ligjit për bankat më tutje përcakton autorizimet mbikëqyrëse të BQK-së në përmbushjen e detyrave të veta mbikëqyrëse sipas Ligjit për BQK-në për mbikëqyrjen e bankave. Neni 57 detyron gjithë zyrtarët e bankave që të bashkëpunojnë me BQK-në në kryerjen e inspektimeve që mund të jenë në vend apo së jashtmi si natyrë, derisa BQK-ja mund të kërkojë, si dhe bankat duhet të pranojnë këtë, çfarëdo informate që mund ta konsiderojë të nevojshme për përmbushjen e detyrave të veta mbikëqyrëse.

1246. Në përcaktimin e autorizimeve mbikëqyrëse të BQK-së për qëllimet e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve tjera financiare jo-bankare, neni 114 i Ligjit për Bankat fuqizon BQK-në që të nxjerrë rregullore e urdhra të tillë ashtu që të vizitojë zyrat e institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare, në kohë të arsyeshme që konsiderohen si të tilla nga Banka, për të kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe dosjet tjera, si dhe të ndërmarrë veprime tjera që BQK-ja i konsideron të nevojshme apo të këshillueshme për t'i dhënë efekt synimit të Ligjit në fjalë, apo Rregulloreve e urdhrave të nxjerrë.

1247. Në kuptimin e Ligjit për fonde pensionale, nenet e ndryshme përcaktojnë autorizimet mbikëqyrëse të BQK-së. Neni 13 përcakton autorizimet mbikëqyrëse të BQK-së për «fonde pensionale», derisa neni 20 përcakton autorizimet mbikëqyrëse të BQK-së për «ofruesit e pensioneve».

1248. Tutje, tek autorizimet mbikëqyrëse të BQK-së në lidhje me kompanitë e sigurimeve (si pjesë e definicionit të «institucionit financiar»), neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/25 përcakton autorizimet mbikëqyrëse të BQK-së¹²⁷ për mbikëqyrjen e kompanive dhe ndërmjetësve të sigurimeve.

¹²⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 I referohet Autoritetit të Bankave dhe Pagesave të Kosovës (BPK).

1249. Autorizimet mbikëqyrëse sipas nenit 30 të Ligjit LPP/LFT zbatohen drejtpërdrejt nga NjIF-i në përmbushjen e detyrave të saj sipas Ligjit për mbikëqyrjen e gjitha subjekteve raportuese, me përjashtim të tërë sektorit financiar.

1250. Si mbikëqyrëse e gjithë sektorit financiar, për qëllime kujdesi, BQK-ja bart gjitha autorizimet adekuate për të siguruar që bankat dhe institucionet financiare të jenë në përputhje me obligimet e tyre të kujdesit sipas ligjeve përkatëse.

1251. Edhe pse BQK-ja aktualisht aplikon këto autorizime mbikëqyrëse të kujdesit në monitorimin e sektorit financiar për qëllime të LPP/LFT-së, nuk ka mandat ligjor që fuqizon BQK-në që ta bëjë këtë.

1252. Pra, rrjedh që me mungesën e mandatit mbikëqyrës të BQK-së për LPP/LFT, si dhe rrjedhimisht edhe mosaplikimin e autorizimeve mbikëqyrëse të kujdesit për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, ka mangësi në përmbushjen e KTh 23.1.

1253. Në dritën e vendimeve në pritje mbi dispozitat ligjore të Ligjit LPP/LFT për emërimin e një autoriteti kompetent për mbikëqyrje të sektorit financiar, nëse BQK-ja emërohet si e tillë, ose si e vetme apo në ndërlidhje me NJIF-në, atëherë ka nevojë të krijohet fuqizimi ligjor për BQK-në në aplikim të autorizimeve mbikëqyrëse të saj për kujdesin – me përjashtim të vendosjes së sanksioneve sipas ligjeve përkatëse financiare për qëllime kujdesi – në funksionet e saj mbikëqyrëse të LPP/LFT.

1254. Nëse kjo ndodh, rekomandohet që të shtohet një nen i ri 30B (ose paragraf në nenin e ri që emëron apo përcakton autoritetin mbikëqyrës për sektorin financiar) në Ligjin LPP/LFT, në këtë kuptim, si në vijim:

Neni 30B

Autorizimet e autoritetit të emëruar mbikëqyrës

Autoriteti kompetent që emërohet sipas këtij Ligji që të mbikëqyrë dhe monitorojë subjektet raportuese për përputhshmëri me këtë Ligj, si dhe që ky autoritet ka mandat mbikëqyrës ekzistues për qëllime kujdesi që i është bartur tashmë me ligje të veçanta, do të zbatojnë autorizimet e tilla mbikëqyrëse të kujdesit ashtu siç janë përcaktuar për të, si dhe ashtu siç mund të aplikohen në përmbushjen e detyrave të veta mbikëqyrëse për qëllimet e këtij Ligji, me përjashtim të autorizimit të vendosjes së sanksioneve administrative apo të tjera që parashihen me ato ligje specifike për cenimin e atyre ligjeve.

1255. Neni 30B i propozuar përjashton vendosjen e sanksioneve administrative e të tjera e edhe ndëshkimeve, pasi që përndryshe do të kishte konflikt legjislativ me sanksionet për qëllime të LPP/LFT të parapara me atë Ligj, me sanksionet që janë të natyrës së kujdesit në ligje specifike financiare.

Autoriteti për të bërë inspektime të institucioneve financiare – Kriteri thelbësor 29.2

1256. KTh 29.2 kërkon që mbikëqyrësit të kenë autoritet që të bëjnë inspektime të institucioneve financiare, duke përfshirë inspektimet në vend, për të siguruar përputhshmërinë përmes shqyrtimit të politikave, procedurave, librave dhe dosjeve, duke përfshirë testimin e mostrave.

1257. Neni 30 i Ligjit LPP/LFT fuqizon zyrtarët e autorizuar të NjIF-it që të hyjnë në gjitha hapësirat, përveç atyre të banimit, në çfarëdo kohe gjatë orarit të zakonshëm të punës, nëse ka dyshim të arsyeshëm që dosjet që mbahen në bazë të neneve 16 deri në 28 të Ligjit LPP/LFT janë respektuar dhe gjenden në ato hapësira. Për më tepër, zyrtarët e autorizuar të NjIF-it

mund të kërkojnë dhe inspektojnë dosjet apo dokumentet; të kopjojnë apo përndryshe të riprodhojnë dosjet apo dokumentet e tilla; si dhe të bëjnë pyetje për të gjetur dhe kuptuar dosjet dhe dokumentet e tilla.

1258. Neni 23 i Ligjit për BQK-në fuqizon personelin e BQK-së, si dhe personat tjerë të kualifikuar të emëruar nga Bordi ekzekutiv, që të vizitojnë zyrat e institucioneve financiare për të kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe dosjet tjera, për të marrë informata e të dhëna nga to, si dhe për të ndërmarrë veprime që konsiderohen të nevojshme apo të këshillueshme nga BQK-ja.

1259. Në pajtim me nenin 57 të Ligjit për bankat, kontrolluesit e emëruar të BQK-së mund të vizitojnë bankat në kohë që konsiderohen të arsyeshme nga BQK-ja, si dhe mund të ndërmarrin veprime që konsiderohen të nevojshme dhe të këshillueshme. Kontrolluesit kanë të drejtë të kontrollojnë llogaritë, librat, dokumentet dhe dosjet tjera të bankës apo degëve të ndërlidhura; si dhe mund të kërkojnë nga drejtorët dhe menaxherët e lartë, punëtorët dhe agjentët e bankës apo degëve në kontrollim që të ofrojnë gjitha informatat mbi çfarëdo lënde në lidhje me administratën dhe operacionet, të cilat kërkohen me arsye nga ata.

1260. Neni 114 i Ligjit për bankat siguron autorizime të ngjashme për kontrollues kur bëjnë kontrole të institucioneve mikrofinanciare apo institucioneve të tjera financiare jobankare.

1261. Në përcaktimin e kompetencave mbikëqyrëse për BQK, nenet 13 dhe 20 të Ligjit për fondet pensionale saktësojnë dhe kufizojnë kompetencat mbikëqyrëse dhe nuk përcaktojnë drejtpërdrejtë vizitat në terren. BQK-ja mund të emërojë auditorë të pavarur për këtë qëllim dhe, pavarësisht nga kjo, BQK-ja mund ende të kryejë vizita në terren në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës për institucionet bankare dhe financiare kur ndërmerren këso lloj veprimtarish.

1262. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 për sektorin e sigurimeve përcakton që zyrtarët e autorizuar të BQK-së¹²⁸ mund të vizitojnë zyrat e kompanive të sigurimit dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit kur ajo e konsideron të arsyeshme për t'i kontrolluar llogaritë, librat dhe shënimet e tjera, si dhe për të ndërmarrë veprime të tjera nëse e konsideron të arsyeshme apo të nevojshme për të vënë në jetë qëllimin e kësaj rregulloreje apo rregullave, urdhrave apo udhëzimeve të nxjerra lidhur me të.

1263. Kompetencat mbikëqyrëse për NjIF, në kuptim të nenit 30, në përgjithësi i plotësojnë kërkesat sipas KJ 29.2 por vetëm deri në atë shkallë që këto zbatohen për sektorin jofinanciar.

1264. Siç u shpjegua tashmë më lartë në analizën e KJ 29.1, del se për shkak të mungesës së mandatit mbikëqyrës të LPP/LFT për BKQ dhe si rrjedhojë për shkak të moszbatimit të kompetencave mbikëqyrëse për qëllim të Ligjit të LPP/LFT, ekziston një zbrazëti në plotësimin e KJ 29.2.

1265. Si rrjedhojë dhe brenda rrethanave të njëjta që u përkufizuan, rekomandimi i propozuar në analizën e lartcekur të KJ 29.1 për një nen të ri në 30B në Ligjin LPP/LFT për zbatimin e kompetencave mbikëqyrëse të BKQ-së, në plotësimin e fushës së mundshme ligjore të mbikëqyrjes, do të zbatohet për qëllim të KJ 29.2.

Kompetencat për të detyruar dhënien e dokumenteve – Kriteri thelbësor 29.3

1266. KTh 29.3 përcakton që autoritetet mbikëqyrëse gëzojnë kompetencat për të detyruar prodhimin e apo fitimin e qasjes në të gjitha shënimet, dokumentet apo informatat për të mbikëqyrur respektimin.

¹²⁸ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/25 i referohet Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK).

1267. Në përputhje me dispozitat e nenit 30 të Ligji LPP/LFT, zyrtarët e autorizuar mund të kërkojnë dhe të inspektojnë shënimet apo dokumentet; kopjojnë apo ndryshe riprodhojnë shënimet apo dokumentin e tillë, si dhe të parashtrojnë pyetje me qëllim të gjetjes dhe kuptimit të shënimeve a dokumenteve të tilla. Për më tepër, neni 30 përcakton që pronari a personi përgjegjës i objekteve që inspektohen dhe çdo person i pranishëm në këto ambiente do t'ju japin të gjithë ndihmën zyrtarëve të autorizuar në qasjen dhe kopjimin a riprodhimin e dokumenteve dhe shënimeve që mbahen në mënyrë elektronike. Gjithashtu në kuptimin të të njëjtin nen, në rast se një person i cili është subjekt i këtij inspektimi refuzon që të jap dokumentet për arsyet e cekura me Ligji – për shembull, nëse dokumenti përmban informacion që është privilegj i marrëdhënies avokat-klient, atëherë zyrtari i autorizuar që kryen inspektimin e vendos dokumentin a shënimin e kontestuar në një zarf të mbyllur në prani të personit apo të përfaqësuesit të tij a saj, dhe nënshkruhet nga zyrtari dhe personi apo përfaqësuesi. Dokumenti a shënimi i mbyllur do të paraqitet brenda dhjetë (10) ditëve para një gjykatësi të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut, i cili do ta inspektojë atë dhe do të vendos nëse ai, apo ndonjë pjesë e tij, mund t'i nënshtrohet inspektimin dhe kopjimit sipas dispozitave të Ligjit LPP/LFT.

1268. Neni 23 i Ligjit për BQK kërkon nga institucionet financiare që t'i japin BQK-së informatat dhe shënimet e tilla përkitazi me operacionet e tyre dhe gjendjen financiare, sipas kërkesës së BQK-së.

1269. Në mënyrë të ngjashme, në kuptim të nenit 57 të Ligjit për bankat, zyrtarët e autorizuar të BQK-së mund të kërkojnë nga drejtorët dhe drejtuesit e lartë, punonjësit dhe agjentët e bankës apo filialeve që t'ju ofrojnë të gjitha informacionet ose çështjet e tjera lidhur me administrimin dhe operacionet e saj që ata me arsye mund t'i kërkojnë.

1270. Ndonëse nuk i referohet saktësisht kompetencave për të kërkuar ndonjë dokument a informacion, në përcaktimin e kompetencave mbikëqyrëse të BQK-së ndaj institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve të tjera jofinanciare, neni 114 i Ligjit për banka përcakton një kompetencë të përgjithshme për të *kontrolluar llogaritë, librat, dokumentet dhe shënimet e tjera*.

1271. Në autorizimin e BQK-së për rishikimin e të dhënave dhe shënimeve, nenet 13 dhe 20 nuk autorizojnë saktësisht BQK që të kërkojë ndonjë dokument që Banka e konsideron të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të saja të Ligjit për fondet pensionale, por kjo është një rrjedhojë e nevojshme duke qenë se BQK-ja përndryshe nuk do të ishte në gjendje që të rishikonte të dhënat dhe shënimet.

1272. Përfundimisht, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/25 përcakton që, në përmbushjen e përgjegjësiave të saja mbikëqyrëse, BQK-ja¹²⁹ mund të kërkojë sigurimin e çfarëdo informacioni nga kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimeve, duke përfshirë pronarët apo aksionarët e tyre, administratorët dhe punonjësit e tjerë në çfarëdo mënyre që parapëlqehet nga BQK-ja me kusht që të jepet njoftimi i arsyeshëm.

1273. Kompetencat e NJIF sipas nenit 30 të Ligjit LPP/LFT për të detyruar prodhimin e çfarëdo dokumenti a shënimi janë të lidhura me kontrollimet në vend të ngjarjes së Njësisë. Kompetencat për të detyruar paraqitjen e dokumenteve sipas nenit 30 bëhen të zbatueshme për kontrollimet në vend të ngjarjes, dhe NJIF nuk është në gjendje që të kryejë kontrollime jashtë vendit të ngjarjes, duke qenë se nuk mund të detyrojë prodhimin e dokumenteve dhe shënimeve për këtë qëllim. Në këtë aspekt, edhe neni 14 (paragrafi 1.13) që përcakton detyrat dhe kompetencat e NJIF për të *kërkuar dokumente dhe informata në përputhje me këtë Ligj*

¹²⁹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/25 i referohet Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës (BPK).

nuk mund të aplikohet për ekzaminime jashtë vendit të ngjarjes përveç nëse Ligji LPP/LFT përcakton se NjIF të ndërmarrë ekzaminime jashtë vendit të ngjarjes.

1274. Siç u shpjegua tashmë më lartë në analizën e KTh 29.1, del se për shkak të mungesës së mandatit mbikëqyrës të LPP/LFT për BKQ dhe si rrjedhojë për shkak të moszbatimit të kompetencave mbikëqyrëse për qëllim të Ligjit të LPP/LFT, ekziston një zbrastëritje në plotësimin e KJ 29.3

1275. Si rrjedhojë dhe brenda rrethanave të njëjta që u përkufizuan, rekomandimi i propozuar në analizën e lartcekur të KTh 29.1 për një nen të ri në 30B në Ligjin LPP/LFT për zbatimin e kompetencave mbikëqyrëse të BKQ-së, në plotësimin e fushës së mundshme ligjore të mbikëqyrjes, do të zbatohet për qëllim të KTh 29.3.

1276. Për më tepër, qoftë për kompetencën aktuale mbikëqyrëse si dhe duke pasur parasysh vendimet në pritje për dispozitat ligjore në Ligjin LPP/LFT për emërimin e autoritetit kompetent për mbikëqyrjen e sektorit financiar, dhe po që se NjIF emërohet, atëherë Njësisë do t'i duhen kompetenca të qarta ligjore për të kryer kontrollime jashtë vendit të ngjarjes.¹³⁰

1277. Prandaj propozojmë futjen e një paragrafi të ri (6) në nenin 30 si në vijim:

Neni 30 paragrafi (6) Me qëllim të vlerësimit të respektimit të dispozitave të këtij Ligji apo ndonjë rregulle a rregulloreje që nxjerrët, NjIF mund, me anë të një njoftimi me shkrim që i dërgohet subjektit raportues ashtu siç përkufizohet në paragrafin (1) të këtij neni, t'i kërkojë subjektit raportues që të jep – brenda afatit dhe vendit që saktësohet në atë njoftim – çfarëdo dokumenti duke përfshirë ato lidhur me procedurat e brendshme, siç përcaktohet me këtë Ligji a ndonjë rregullore, që mund të kërkohej nga NjIF për të përmbushur përgjegjësitë e saj sipas këtij neni edhe jashtë vendit të ngjarjes dhe prandaj zbatohen dispozitat e paragrafëve (3), (4) dhe (5) të këtij neni.

Kërkesa për një urdhër të gjykatës – Kriteri thelbësor 29.3.1

1278. KTh 29.3.1 përcakton atë nëse autoritetit mbikëqyrës i duhet urdhri i gjykatës për të detyruar dhënien a fitimin e qasjes në shënime, dokumente a informata për qëllime të mbikëqyrjes.

1279. Ligji LPP/LFT fuqizon NjIF për të kërkuar dhënien e dokumenteve dhe shënimeve që i nevojiten me qëllim të përmbushjes së detyrimeve nga fusha e inspektimeve në vendngjarje për subjektet raportuese përveç sektorit financiar.

1280. Pavarësisht nga kjo, neni 30 i Ligjit LPP/LFT i mundëson një subjektit raportues që inspektohet të refuzojë lejimin e inspektimit a kopjimit të shënimeve a dokumenteve, nëse ai a ajo vlerëson se dokumenti a shënimi nuk ruhet për qëllime të dispozitave të Ligjit LPP/LFT dhe prandaj nuk është relevant ose nëse dokumenti a shënimi përmban informatë që i nënshtrohet privilegjit avokat-klient.

1281. Në rrethana të tilla, Ligji LPP/LFT përcakton që dokumenti a shënimi do të paraqitet para një gjykatësi të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut, i cili do ta inspektojë atë dhe do të vendos nëse ai, apo ndonjë pjesë e tij, mund t'i nënshtrohet inspektimit dhe kopjimit sipas dispozitave përkatëse të nenit 30 të Ligjit LPP/LFT.

¹³⁰ Autoriteti për të kryer kontrollime jashtë vendit të ngjarjes për NjIF ende do të ishte i nevojshëm edhe nëse NjIF ruan rolin e saj mbikëqyrës për sektorin jofinanciar.

1282. Ligji për BQK, Ligji për bankat, Ligji për fondet pensionale dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 nuk parashohin nevojën për një urdhër gjykate për BQK që të kryejë kontrollime dhe inspektime dhe që të detyrojë dhënien e dokumenteve dhe informatave tjera për qëllime të ligjeve të zbatueshme.

1283. Përjashtimi sipas nenit 30 kur një subjekt raportues mund të refuzojë sigurimin e dokumenteve gjatë inspektimit në vendngjarje, edhe nëse NjIF nuk është tani për tani përgjegjëse për mbikëqyrjen e LPP/LFT në sektorin financiar, konsiderohet më shumë si një masë parandaluese sesa një ndalesë për NjIF që të merr dokumentet dhe shënimet për qëllime të mbikëqyrjes. NjIF ka informuar se në praktikë kjo dispozitë nuk është aplikuar kurrë.

1284. Supozohet se nëse ndryshimet e mundshme legjislative në Ligjin LPP/LFT sigurojnë bazën ligjore për BQK si autoritet mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT përmes futjes së nenit të propozuar 30B, sipas analizës KTh 29.1, atëherë në këtë aspekt nuk do të ketë nevojë për nxjerrjen e urdhrat të gjykatës.

1285. Si rrjedhojë, ky raport konstaton se kompetencat për të detyruar prodhimin e dokumenteve a fitimin e qasjes nuk pengohen nga kërkesa për një urdhër të gjykatës.

Kompetencat e duhura për zbatim dhe shqiptim të sanksioneve – Kriteri thelbësor 29.4

1286. KTh 29.4 përcakton që autoriteti mbikëqyrës duhet të ketë kompetencat e duhura të zbatimit dhe shqiptimit të dënimeve ndaj institucioneve financiare dhe drejtorëve dhe drejtuesve të lartë në rast se nuk respektojnë apo nuk zbatojnë në mënyrë të mirëfilltë kërkesat për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1287. Neni 31 i Ligjit LPP/LFT autorizon NjIF që të shqiptojë sanksione administrative e që megjithatë janë të kufizuara në fushëveprim kur zbatohen ndaj palëve të treta në krahasim me rastin kur zbatohen për subjektet raportuese: *Një vendim i marrë nga NjIF-ja, përmes së cilit njoftohet obliguesi i dështimit për të përmbushur kërkesat e nën-paragrafit 1.3, paragrafi 1. i nenit 14 të këtij ligji do të përbëjë një shkelje të detyrimeve të përcaktuara sipas këtij ligji, i cili do t'i nënshtrohet një sanksioni administrativ në formën e një gjobe prej pesëqind (500) Euro për çdo ditë të mos përmbushjes duke filluar nga data e njoftimit.*

1288. Nënparagrafi (1.3) i paragrafit (1) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT i referohet situatave kur NjIF për qëllime të analizimit të aktiviteteve të dyshuara për pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit mund të kërkojë dhe të pranojë nga organet publike ose qeveritare, apo organet a organizatat ndërkombëtare ose ndërqeveritare (në Kosovë), të dhëna, informacione, dokumente në lidhje me një person, subjekt, pronë ose transaksion.

1289. Neni 67 i Ligjit për BQK autorizon Bordin e BQK-së, me anë të vendimeve, që të shqiptojë ndëshkime administrative ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë që veprojnë në kundërshtim me Ligjin për BQK.

1290. Sipas nenit 67 të Ligjit për BQK, ndëshkimet përfshijnë ndëshkimet monetare si dhe masa të tjera administrative, si vërejtjet apo urdhrat me shkrim, suspendimet dhe largimet e administratorëve të institucioneve financiare të mbikëqyrura, revokimet e licencave si dhe masa të tjera ashtu si përcaktohen në këtë ligj apo ndonjë ligj tjetër.

1291. Sipas nenit 58 të Ligjit për bankat, BQK-ja mund të ndërmarrë veprimet e mëposhtme ose të vendos dënime të mëposhtme ndaj drejtorëve dhe menaxherëve të lartë, punonjësve, aksionarëve kryesorë dhe atyre që kanë interes të konsiderueshëm në të, nëse përcakton se personat e këtyre kanë shkelur një dispozitë të këtij ligji ose të ndonjë rregulloreje a urdhërese

të BQK-së, kanë shkelur çfarëdo kushti apo kufizimi të bashkëngjitur në një autorizim të lëshuar nga BQK-ja ose janë angazhuar në praktika të pasigurta dhe jo të shëndosha sipas gjykimit të BQK-së. Masat e tilla përfshijnë ndëshkimet që mund të zbatohen në baza shkallë-shkallë varësisht nga serioziteti i shkeljes e që përfshijnë lëshimin e paralajmërimit me shkrim deri te revokimi i licencës. Në anën tjetër, neni 82 përcakton dënimet civile që mund të shqiptohen ndaj bankës apo drejtorëve a drejtuesve të lartë të saj për shkelje të rënda të Ligjit për BQK.

1292. Neni 105 i Ligjit për bankat përcakton dënimet dhe masat përmirësues që mund të shqiptohen ndaj institucioneve mikrofinanciare, institucioneve jobankare financiare apo drejtuesve të lartë a drejtorëve, aksionarëve të saj të interesit të rëndësishëm, nëse në gjetjet e saj BQK-ja përcakton se institucioni i tillë a personi ka shkelur dispozitat e ndonjë rregulloreje a urdhërese të BQK-së ose janë angazhuar në praktika të pasigurta a të pabazuara. Sidoqoftë, për dallim prej situatës për bankat, Ligji për bankat nuk përcakton dënime civile që mund të shqiptohen ndaj institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve jobankare financiare për qëllimet e përcaktuara.

1293. Dispozita të ngjashme për masa përmirësuese gjenden në nenin 32 të Ligjit për fondet pensionale për shkeljet e dispozitave të Ligjit ose nëse janë angazhuar në praktika të pasigurta dhe të pabaza. Masat përmirësuese mund të zbatohen ndaj institucionit dhe drejtorëve të tij.

1294. Në mënyrë të ngjashme, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/25 për sektorin e kompanive të sigurimit përcakton shqiptimin e masave të ngjashme ndaj institucionit dhe personave në rrethana të njëjta siç përcaktohen me Ligjin për Bankat.

1295. Dënimet që mund të shqiptohen nga NjIF janë të kufizuara në fushëveprim dhe nuk mund të zbatohen ndaj drejtorëve apo drejtuesve të lartë.

1296. Ndonëse legjislacioni i ndryshëm për sektorin financiar përcakton masat përmirësuese që mund të ndërmerren ndaj një institucioni financiar a drejtorëve ose drejtuesve të lartë, dënimet e tilla mund të zbatohen për shkeljet e ligjit përkatës a rregulloreve të BQK-së dhe prandaj janë të zbatueshme vetëm për qëllime të përcaktuara.

1297. Për më tepër, mungesa e një mandati mbikëqyrës për qëllim të Ligjit LPP/LFT dhe mungesa e çfarëdo dispozite ligjore që autorizon BQK të zbatojë masat përmirësuese, siç përcaktohet me ligji për qëllimet e përcaktuara për shkeljen e Ligjit LPP/LFT, i bën masat e tilla të pazbatueshme për qëllim të Ligjit LPP/LFT.

1298. Si rrjedhojë, autoritetet mbikëqyrëse në Kosovë nuk kanë kompetencat e duhura për zbatim dhe shqiptim të sanksioneve ndaj institucioneve financiare dhe drejtorëve a drejtuesve të tyre të lartë në rast se nuk respektojnë dispozitat e Ligjit LPP/LFT.

1299. Ju lutemi shikoni analizën e Rekomandimit 17 në lidhje me rekomandimet gjegjëse.

Efikasiteti për Rekomandimin nr. 29

1300. Analiza e kryer në këtë pjesë ka identifikuar mangësi dhe dobësi të caktuara që kanë pasur një ndikim negativ në efikasitetin e sistemit mbikëqyrës për qëllim të LPP/LFT.

1301. Shkurt, këto mangësi dhe dobësi mund të përmbliidhen si në vijim: mungesë e mandatit ligjor për BQK për të zbatuar mjetet e saj të caktuara të mbikëqyrjes për qëllim të LPP/LFT, të plotësuar me mungesën e mandatit ligjor për qëllime të mbikëqyrjes sipas Ligjit LPP/LFT; mungesë e kompetencave të NjIF për të kërkuar dokumente apo informata për të kryer inspektive jashtë vendit të ngjarjes, si dhe mangësi serioze në kompetencat për zbatim.

3.10.2. Rekomandimet dhe komentet

1302. Mungesa e bazës ligjore për BQK për të marrë përsipër përgjegjësi mbikëqyrëse për qëllim të Ligjit LPP/LFT për tërë sektorin financiar lë zbrazëti të serioze në zbatimin e kompetencave të përcaktuara mbikëqyrëse sipas legjislacionit të veçantë financiar për qëllim të Ligjit LPP/LFT.

1303. Për më tepër, ndonëse Ligji LPP/LFT përcakton kompetencat mbikëqyrëse për NjIF, ato janë të kufizuar në fushëveprim dhe nuk mund të zbatohen për sektorin financiar duke qenë se NjIF nuk ka një rol mbikëqyrës në sektorin financiar.

1304. Edhe pse një lexim i thellë i tërë analizës dhe komenteve në kriteret thelbësore gjegjëse për Rekomandimin nr. 29 është jashtëzakonisht i rëndësishëm, dobësitë dhe mangësitë kyçe të identifikuar mund të renditen si në vijim:

- Mungesa e mandatit ligjor për rolin mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT (KTh 29.1; KTh 29.2)
- Mungesa e kompetencave mbikëqyrëse që mund të zbatohen për mbikëqyrjen e sektorit financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT (KTh 29.1; KTh 29.2)
- Mungesa e një mandati ligjor për zbatimin e kompetencave të përcaktuara mbikëqyrëse për qëllim të Ligjit LPP/LFT (KTh 29.1; KTh 29.2);
- Mungesa e një mandati për NjIF për të kryer inspektime jashtë vendit të ngjarjes në veçanti në rast se emërohet autoritet mbikëqyrës për sektorin financiar (KTh 29.3)¹³¹;
- Mospasja e kompetencave të duhura për zbatim dhe shqiptim të sanksioneve ndaj institucioneve dhe drejtorëve e drejtuesve të lartë të tyre në rast të mosrespektimit të dispozitave të Ligjit LPP/LFT (KTh 29.4).¹³²

1305. Në këtë aspekt, paraqesim rekomandimet në vijim ndaj rekomandimeve të mëparshme për përcaktimin e një baze ligjore për emërimin e një autoriteti mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllim të Ligjit LPP/LFT e të cilat duhet të lexohen në kontekst të analizës dhe komenteve për KTh gjegjëse:

- Futjen e një neni të ri 30B në Ligjin LPP/LFT me kusht që autoriteti mbikëqyrës i emëruar sipas Ligjit LPP/LFT që tashmë ka një rol mbikëqyrës sipas legjislacionit mund të zbatojë kompetencat e saj të përcaktuara mbikëqyrëse sipas ligjeve gjegjëse për qëllim të mbikëqyrjes së respektimit të Ligjit LPP/LFT, me përjashtim të zbatimit të sanksioneve a ndëshkimeve administrative sipas këtyre ligjeve duke qenë se këto përcaktohen me Ligjin LPP/LFT dhe
- Futjen e një paragrafi të ri (6) në nenin 30 të Ligjit LPP/LFT që përcakton kompetenca për inspektime jashtë vendit të ngjarjes për NjIF.

3.10.3. Vlerësimi për rekomandimi nr. 29

	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
Rek 29	MP	<ul style="list-style-type: none">• Mungesa e një mandati ligjor për autoritetin kompetent mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT;• Mungesa e kompetencave mbikëqyrëse që mund të zbatohen për

¹³¹ Ky rekomandim zbatohet edhe për NjIF në rolin e saj aktual mbikëqyrës sipas Ligjit LPP/LFT.

¹³² Rekomandimet për përmirësimin e kësaj dobësie janë në pjesën 3.11 për sanksionet.

	Vlerësi mi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		mbikëqyrjen e sektorit financiar për qëllim të LPP/LFT; <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e një mandati ligjor për zbatimin e kompetencave të përcaktuar mbikëqyrëse për qëllim të LPP/LFT; • Mungesa e një mandati për NjIF për të kryer inspektime jashtë vendit të ngjarjes; • Mospasja e kompetencave të duhura për zbatim dhe shqiptim të sanksioneve • Çështje të efikasitetit që dalin për shkak të mungesës së mandatit ligjor për mbikëqyrje dhe kompetencave të zbatimit; • Burimet njerëzore për autoritetet mbikëqyrëse janë të pamjaftueshme dhe prandaj kanë ndikim në efikasitet; • Mungesa e programeve përkatëse të trajnimit për personelin mbikëqyrës ka ndikim në efikasitet; • Nevoja që autoritetet të mbajnë më shumë të dhëna kuptimplote statistikore përndryshe efikasiteti nuk mund të vlerësohet ashtu siç duhet.

3.11. Sanksionet (R.17)

3.11.1. Përshkrimi dhe analiza

1306. Rekomandimi nr. 17 obligon shtetet që të sigurojnë ekzistimin e sanksioneve efektive, proporcionale dhe zbindëse, qofshin ato penale, civile a administrative, për t'u përdorur ndaj personave juridikë dhe fizikë, të cilët mbulohen nga detyrimet e LPP/LFT dhe të cilët nuk respektojnë kërkesat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1307. Duke pasur parasysh se BQK nuk ka mandat ligjor për të ndërmarrë mbikëqyrjen e sektorit financiar për qëllim të Ligjit LPP/LFT, dhe si rrjedhojë BQK nuk ka kompetenca për të shqiptuar sanksione, ndëshkime a masa tjera përmirësuese që i janë dhënë asaj për qëllimet e përcaktuara, paragrafët në vijim do të përqendrohen në sanksionet sipas Ligjit LPP/LFT dhe çfarëdo reference ndaj asaj është për hir të informacionit dhe përfundimit.

1308. Analiza për KTH 29.4 sipër zbatohet edhe për analizën për Rekomandimin 17 në këtë pjesë.

Sanksione efektive, proporcionale dhe zbindëse – Kriteri thelbësor 17.1

1309. KTh 17.1 pasqyron fushëveprimin kryesor të Rekomandimit 17 në sigurimin e asaj se sanksione efektive, proporcional dhe zbindëse, qofshin ato penale, civile a administrative janë në dispozicion dhe të zbatueshme ndaj personave fizikë dhe juridikë.

1310. Siç u përshkrua në pjesën 3.10 për analizën e KTh 29.4, legjislacioni i ndryshëm financiar përcakton shqiptimin e sanksioneve dhe ndëshkimeve të ndryshme që janë penale, civile dhe administrative në natyrë dhe që zbatohen për bankat dhe institucionet financiare që shkelin ligjet financiare përkatëse apo rregullat, rregulloret dhe urdhëresat që nxjerrën nga BQK-ja. Prandaj sanksionet dhe ndëshkimet e tilla, pa marrë parasysh a janë efektive, proporcionale dhe zbindëse, nuk janë të zbatueshme kur një institucion financiar apo drejtorët e drejtuesit e tij të lartë shkelin dispozitat e Ligjit LPP/LFT.

1311. Kjo gjë është e natyrshme duke qenë se vetë Ligji LPP/LFT përcakton, deri në një shkallë të caktuar, sanksionet dhe ndëshkimet penale, civile a administrative për mosrespektim të Ligjit.

1312. Neni 31 i Ligjit LPP/LFT autorizon NjIF që të shqiptojë sanksione administrative e që megjithatë janë të kufizuara në fushëveprim kur zbatohen ndaj palëve të treta në krahasim me rastin kur zbatohen për subjektet raportuese: *Një vendim i marrë nga NjIF-ja, përmes së cilit njoftohet kryesi i shkeljes për të përmbushur kërkesat e nënparagrafit 1.3, paragrafi 1. i nenit 14 të këtij Ligji do të përbëjë një shkelje të detyrimeve të përcaktuara sipas këtij ligji, i cili do t'i nënshtrohet një sanksioni administrativ në formën e një gjobe prej pesëqind (500) euro për çdo ditë të mos përmbushjes duke filluar nga data e njoftimit.*

1313. Për persona dhe subjekte të veçanta sipas Ligjit LPP/LFT, Ligji përcakton ndërmarrjen e masave administrative në kuptim të ligjeve përkatëse (nenet i referohen Ligjit LPP/LFT):

- *Neni 24(8)* Organi kompetent sipas Ligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare (nr. 03/L-134) mund të pezullojë ose revokojë regjistrimin e një OJQ-je për shkelje të ndonjë dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 21 të Ligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare (nr. 03/L-134). Shqiptimi i sanksionit të tillë nuk cenon çfarëdo procedure penale.
- *Neni 25(7)* Zyra për regjistrimin e partive politike mund të hetojë përputshmërinë e partisë politike me këtë nen dhe mund të pezullojë ose revokojë regjistrimin për shkelje të cilësdo dispozite të këtij neni në pajtim me nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/11. Sanksioni nga ky paragraf nuk cenon çfarëdo procedurë penale.
- *Neni 26(14)* Sanksioni që shqiptohet nga shoqata profesionale, Bordi i Kosovës për Standardet e Raportimit Financiar, apo ndonjë shoqatë tjetër relevante profesionale e profesionistëve të mbuluar për shkelje të këtij Ligji nuk ndalon e as paragjykon procedurat penale.
- *Neni 27(4)* Vendimi nga Zyra kadastrale komunale për të refuzuar regjistrimin me arsyetimin e dështimit të respektimit të nenit aktual, merret, si dhe mund të rishikohet, në pajtim me Ligjin nr. 2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave mbi pronën e paluajtshme, të shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/22 të 20 dhjetorit 2002.

1314. Duhet theksuar që Ligji LPP/LFT nuk përcakton masa administrative apo të tjera në rastin e kazinove apo lokaleve tjera të lojërave të fatit (neni 28 i Ligjit LPP/LFT).

1315. Neni 33 i Ligjit LPP/LFT parashih ndëshkimet për veprat penale në kompetencën e Gjykatave të Qarkut, për shkelje të dispozitave të Ligjit, kur veprat e tilla bëhen me qëllim dhe me dashje. Shembuj të këtyre veprave janë deklaratat e rrejshme me dashje, shkatërrimi i dokumenteve, zbulimi i informatave, pengimi i inspeksionit në terren, etj. Ndëshkimet në këtë nen mund të vendosen edhe për personin juridik, zyrtarët e lartë dhe anëtarët tjerë të personelit të subjekteve raportuese, personelin e NjIF-it apo ndonjë person tjetër që kryen vepër të tillë.

1316. Sipas nenit 5 të Ligjit për përgjegjësinë penale të personave juridikë: *Personi juridik është përgjegjës për veprën penale të personit përgjegjës, i cili duke vepruar në emër të personit juridik në kuadër të autorizimeve ka kryer veprën penale me qëllim që për atë personi juridik të realizoj ndonjë dobi ose ka shkaktuar dëm. Përgjegjësia e personit juridik ekziston edhe atëherë kur veprimi i atij personi juridik ka qenë në kundërshtim me politikën afariste*

apo urdhrat e personit juridik. Për më tepër, sipas të njëjtit nen 5: Përgjegjësia e personit juridik bazohet në fajësinë e personit përgjegjës.

1317. Në trajtimin e përgjegjësisë penale të personave juridikë për qëllimet e Ligjit LPP/LFT, neni 34 i Ligjit thekson që nëse një person juridik kryen një veprë të dënueshme sipas Ligjit LPP/LFT, secili drejtor dhe personat tjerë të angazhuar në menaxhmentin e atij personi juridik (si dhe personat që pretendojnë të veprojnë në atë cilësi) kryen veprën, përveç nëse personi arrin të dëshmojë që vepra është kryer pa njohurinë apo pëlqimin e tij/saj; si dhe kur ai/ajo ka marrë masa të arsyeshme për të parandaluar kryerjen e veprës, ashtu siç është dashur të veprohet nga ai person duke marrë parasysh natyrën e funksioneve të tij/saj në atë cilësi.

1318. Sanksionet administrative, civile apo penale që parashihen me ligje të ndryshme financiare për shkeljet e dispozitave të tilla ligjore nga bankat apo institucionet financiare, drejtorët apo menaxherët e tyre të lartë, si dhe që vendosen përshtatshëm për qëllime kujdesi apo penale, nuk vlejné për shkeljet e Ligjit LPP/LFT.

1319. Dispozitat në nenin 31 të Ligjit LPP/LFT janë të kufizuara në fushëveprim dhe vlejné vetëm për palët e treta, *organet publike apo qeveritare, ose organet apo organizatat ndërkombëtare a ndërqeveritare (në Kosovë)* të cilat dështojné në dhënien e informatave të kërkuara nga NjIF-i në lidhje me analizën e saj të dyshimeve për pastrim të parave apo financim të terrorizmit në lidhje me një person, subjekt, pasuri apo transaksion.¹³³

1320. Ligji LPP/LFT gjithashtu përcakton masat administrative që mund të merren nga autoritetet tjera, si heqja e licencave apo pezullimi i regjistrimit. Është e diskutueshme masa deri në të cilën këto dispozita në ligjet primare mund të aplikohen për shkeljet e Ligjit LPP/LFT kur autoritetet nuk kanë informatat e mjaftueshme për ato shkelje, duke mos pasur vetë autoritetin ligjor për të monitoruar personat e tillë brenda fushëveprimit të Ligjit LPP/LFT, duke krijuar gjithashtu një gjendje të pabarabartë në çështjet e mbikëqyrjes:

- *Neni 24(8)* Organi kompetent sipas Ligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare (nr. 03/L-134) nuk është i fuqizuar nga Ligji LPP/LFT që të monitorojë OJQ-të për qëllimet e Ligjit LPP/LFT. Kështu, është e diskutueshme masa deri në të cilën mund të aplikohen dispozitat e nenit 24(8);¹³⁴
- *Neni 25(7)* Në anën tjetër, në rastin e partive politike, Ligji LPP/LFT fuqizon Zyrën për regjistrimin e partive politike që të hetojë respektimin nga partitë politike të dispozitave të nenit 25 të Ligjit LPP/LFT para se ta fuqizojë atë që të pezullojë regjistrimin e partisë politike;¹³⁵
- *Neni 26(14)* Profesionistët e mbuluar, sipas definicionit të Ligji LPP/LFT, janë pjesë e fushëveprimit mbikëqyrës të NjIF-it, pra është e diskutueshme se në çfarë mase do të ishin në pozitë dhe do të kishin fuqi ligjore autoritetet kompetente relevante të kujdesit që të vendosin sanksione për shkeljet e Ligjit LPP/LFT – edhe më shumë pasi që të vetmet sanksione administrative mund të vendosen nga NjIF-i sipas nenit 31 të Ligjit LPP/LFT, si dhe vetëm në rrethana të kufizuara;

¹³³ Projektligji për ndryshim/plotësim të Ligjit LPP/LFT propozon një ndryshim të nenit 31, për të hequr këtë kufizim.

¹³⁴ Paragrafi (8) i nenit 24 mund të ketë nevojë për rishikim në kuptimin e Projektligjit për ndryshim/plotësim, i cili i vë OJQ-të si subjekte raportuese sipas nenit 16 të Ligjit LPP/LFT, duke i nënshtruar ato mbikëqyrjes së NjIF-it.

¹³⁵ Paragrafi (7) i nenit 25 mund të ketë nevojë për rishikim në kuptimin e Projektligjit për ndryshim/plotësim, i cili i vë partitë politike si subjekte raportuese, sipas nenit 16 të Ligjit LPP/LFT, duke i nënshtruar ato mbikëqyrjes së NjIF-it.

- *Neni 27(4)* Pasi që neni 27 parasheh kërkesën për dokumente specifike shtesë për regjistrimin apo bartjen e pronës së paluajtshme, Zyra kadastrale komunale mund të ketë pozitën për të ndërmarrë veprime sipas dispozitave të këtij paragrafi të nenit 27.

1321. Pra, rekomandohet që të rishikohen dispozitat si më lart, të cilat janë rezultat i Rregulloreve të UNMIK-ut, të shfuqizuara tashme, në kontekstin e rishikimit të rekomanduar të nenit 31 të Ligjit LPP/LFT, siç përshkruhet më poshtë.

1322. Sanksionet tjera të parapara me nenin 33 të Ligjit LPP/LFT janë të një natyre penale, në kompetencën e Gjykatës së Qarkut.¹³⁶

1323. Megjithatë, theksohet që neni 33 i Ligjit LPP/LFT bart disa vepra penale që rrjedhin nga ish-rregulloret e UNMIK-ut, si dhe të cilat mund të jenë të përshtatshme për ligjet tjera larg Ligjit LPP/LFT, si dhe të cilat krijojnë konflikte ligjore.

1324. Një rast i tillë është paragrafi (8) i nenit 33 të Ligjit LPP/LFT, i cili rrjedh nga Rregullorja e UNMIK-ut 2004/2 për pengimin e pastrimit të veprave dhe veprave të ngjashme penale, tashmë e shfuqizuar, përcakton që: *Kushdo që vepron në cilësinë e bankës apo institucionit financiar sipas përkufizimit në këtë ligj pa regjistrim në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores mbi bankat kryen vepër penale të dënueshme me burgim deri në një (1) vit ose me gjobë deri në njëqindmijë (100.000) Euro.*

1325. Paragrafi (5) i nenit 58 të Ligjit aktual për bankat përcakton që: *Çdo person që angazhohet në pranimin e paautorizuar të depozitave në kundërshtim me nenin 5 të këtij Ligji, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër, është subjekt i dënimeve penale. Përveç kësaj, BQK-ja mund të shqiptojë gjoba deri në dhjetë mijë (10,000) euro për çdo ditë sa zgjat shkelja dhe ka autorizim që të kërkojë likuidimin e detyruar të biznesit të një personi të tillë sipas dispozitave të ligjit në fuqi.*

1326. Për më tepër, neni 84 i Ligjit për bankat, i cili parasheh veprat penale sipas Ligjit, përcakton që: *Personi që ushtron veprimtari bankare pa marrjen e licencës bankare sipas këtij ligji kryen vepër penale dhe nëse shpallet fajtor mund të dënohet me burgim deri në tri (3) vite, me gjobë deri në dhjetëmijë (10,000) euro ose me të dyja bashkë.*

1327. Rrjedh pra që e njëjta vepër, që nuk ka të bëjë me pastrimin e parave, por që duhet përcaktuar me ligj të veçantë, Ligjin për bankat, konsiderohet vepër penale në të dy ligjet; por ka ndëshkime të ndryshme; krijon dykuptimësi ligjore dhe ndërlikim ligjor në zbatimin e ndëshkimeve penale.

1328. Pra, është tejet me rëndësi që në ndryshimin e Ligjit LPP/LFT, veprat aktuale penale dhe të tjera të rishikohen për të pasur siguri ligjore dhe për të hequr ndërlikimet ligjore në zbatim.¹³⁷

1329. Për më tepër, Ligji LPP/LFT nuk parasheh ndëshkime administrative për shkeljet e obligimeve individuale sipas Ligjit, të cilat mund të identifikohen për shembull në vazhdën e një inspektimi në terren, si dhe të cilat jo detyrimisht konsiderohen si vepra të mëdha.

1330. Në fakt, NjIF-i dhe BQK-ja kanë informuar që nuk kanë vendosur kurrë sanksione. Një prej arsyeve kryesore, që është brengë për aplikimin e sanksioneve sipas ligjeve

¹³⁶ Projektligji për ndryshim/plotësim do të heqë referencat ndaj Gjykatës së Qarkut në pajtim me ndryshimet në strukturën gjyqësore që prej 1 janarit 2013.

¹³⁷ Versioni aktual i Projektligjit për ndryshim/plotësim nuk parasheh rishikimin e kësaj dispozite të veçantë.

financiare për qëllimet e Ligjit LPP/LFT nga BQK-ja, në mungesë të një fushëveprimi ligjor mbikëqyrës, si dhe bazës ligjore për vendosjen e një sanksioni të tillë dhe kompetencat e kufizuara sipas nenit 31 të Ligjit LPP/LFT.

1331. Kështu, rekomandohet që neni 31 i Ligjit LPP/LFT të ndryshohet për të reflektuar kërkesat sipas Rekomandimit 17 të FATF-së:¹³⁸

Neni 31

Sanksionet administrative dhe masat korigjuese

(1) NjIF-i në konsultim dhe në bashkëpunim me, cilido autoritet tjetër kompetent mbikëqyrës i përcaktuar me këtë Ligj dhe sipas rastit në kuadër të funksioneve të tyre mbikëqyrëse, dhe në konsultim e bashkëpunim me autoritetet tjera kompetente përgjegjëse për sektorë specifikë që u nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji,¹³⁹ vendosin sanksione administrative dhe marrin masa korigjuese sipas përcaktimit të këtij Ligji, si dhe të cilat aplikohen, në proporcion me peshën e veprës, ndaj personave individualë dhe juridike sipas këtij Ligji, ose drejtorëve apo menaxhmentit të lartë të tyre, sipas rastit:

- Lëshimi i vërejtjeve me shkrim;
- Lëshimi i urdhrave me shkrim që kërkojnë nga subjekti raportues apo ndonjë person apo entitet tjetër të ndërmerren veprime korigjuese për të eliminuar dobësitë e identifikuara hollësisht brenda afatit të caktuar kohor;
- Urdhërimi i një subjekti raportues apo ndonjë personi apo entiteti tjetër që të raportojë kohë pas kohe mbi masat korigjuese që ndërmerren;
- Obligimi i një subjekti raportues apo ndonjë personi a entiteti tjetër që të mos angazhohet në një apo më shumë aktivitete të licencuara;
- Shkarkimi, pezullimi apo zëvendësimi i një personi nga pozita e tij apo saj në entitetin në fjalë;
- Ndalimi i atij personi nga shërbimi apo angazhimi në aktivitete që ndërmerren në të njëjtin sektor të biznesit për një periudhë të caktuar apo përjetë;
- Kufizimi i autorizimeve të menaxherëve, drejtorëve apo zyrtarëve tjerë të lartë;
- Shqiptimi i ndëshkimeve administrative në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe nenit 31A dhe 31B, pa paragjykuar procedurat penale;¹⁴⁰
- Pezullimi apo revokimi i licencës apo regjistrimit.

¹³⁸ Rishkrimi i propozuar i nenit 31 përfshin rekomandime për kritere tjera thelbësore për Rekomandimin 17. Këto do të theksohen sipas radhës në nenet përkatëse.

¹³⁹ Fjalët dhe në konsultim e bashkëpunim me autoritetet tjera kompetente përgjegjëse për sektorë specifikë që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji synojnë të krijojnë lidhjen e munguar me nenet e ndryshme në Ligjin LPP/LFT siç përmendet më lart, ku NjIF-i dhe autoritetet specifike kompetente mund të konsultohen dhe bashkëpunojnë para se të vendosin sanksione.

¹⁴⁰ Nenet e propozuara 31A dhe 31B në Projektligjin për ndryshim/plotësim parashohin aplikimin e ndëshkimeve të mundshme administrative vetëm për persona juridikë, derisa rekomandimi me këtë raport përfshin personat apo entitetet si subjekte raportuese, si dhe drejtorët dhe menaxhmentin e tyre të lartë, sipas rastit – Shih nenin 3.11.3 në lidhje me KTh 17.3.

(2) Vendimi i marrë nga NjIF-i që njofton subjektin raportues sipas këtij Ligji, apo ndonjë person a entitet tjetër që obligohet të ndërmarrë masa sipas këtij ligji, apo ndonjë person a entitet tjetër për të cilin NjIF-i ka nxjerrë një urdhër për t'i siguruar NjIF-it dokumente a informata që kërkohen nga NjIF-i për qëllimet e këtij ligji, për dështimin në zbatim të këtij Ligji, përbën shkelje të obligimeve të përcaktuara me këtë Ligj, e cila ndëshkrohet me një sanksion administrativ në formë të gjobës prej pesëqind (500) Euro për çdo ditë të mospërputhjes, që prej datës së njoftimit. Vendosja e gjobës së tillë bëhet pa paragjykuar ndëshkimet administrative sipas nenit 31A dhe nenit 31B, si dhe pa paragjykuar procedurat e mundshme penale.¹⁴¹

(3) Për qëllimet e paragrafit (2), NjIF, në konsultim me Ministrin e Financave, mund të nxjerrë një akt nënligjor për të definuar procedurën e kundërvajtjes administrative.¹⁴²

(4) Vendosja e sanksionit administrativ në pajtim me paragrafin (2) mund të apelohe në gjykatën kompetente.¹⁴³

Neni 31A –

Ndëshkimet administrative me para

(rekomandohet që të futen dispozitat e nenit të propozuar 31A në Projektligjin për ndryshim/plotësim, por të specifikohet autoriteti përgjegjës për t'i vendosur ato, siç kërkohet në KTh 17.2, në nenin 3.11.2 më poshtë. Ky formulim i propozuar – Neni 31(1) supozon që NjIF-i në konsultim me çfarëdo autoriteti tjetër mbikëqyrës i përcaktuar me Ligjin LPP/LFT dhe me autoritetet e tjera përkatëse, do të ketë edhe këtë autorizim, si plotësim ndaj fushëveprimit të mbikëqyrjes. Autoritetet kosovare mund ta shqyrtojnë këtë titull të nenit)

Neni 31B –

Ndëshkimet e tjera administrative me para

(Shih komentet për nenin 31A, por duke iu referuar nenit të propozuar 31B në Projektligjin për ndryshim/plotësim).

Përcaktimi i autoritetit për shqiptimin e sanksioneve – Kriteri thelbësor 17.2

1332. KTh 17.2 kërkon përcaktimin e një autoriteti (p.sh. mbikëqyrës apo NjIF-në) me kompetenca për të shqiptuar sanksione. Standardi nuk pret që vetëm një autoritet të përcaktohet, si dhe mundëson përcaktimin e autoriteteve të ndryshme, që mund të jenë përgjegjëse për shqiptimin e sanksioneve varësisht nga natyra e kërkesës që nuk është përmbushur sipas ligjit.

1333. Ligji LPP/LFT aktualisht nuk parasheh shqiptimin e sanksioneve apo ndëshkimeve administrative, përveç një përkrahimi të kufizuar përmes nenit 31.¹⁴⁴ Neni 31 fuqizon NjIF-në

¹⁴¹ Paragrafi i propozuar (2) bazohet në paragrafin ekzistues (1) të nenit 31 të Ligjit LPP/LFT, si dhe amandamentit të propozuar në Projektligjin për ndryshim/plotësim.

¹⁴² Paragrafi i propozuar (3) është frymëzuar nga paragrafi i propozuar (2) në Projektligjin për ndryshim/plotësim.

¹⁴³ Paragrafi i propozuar (4) reflekton paragrafin aktual (3) të nenit 31, por ndryshohet pak për t'iu referuar sanksionit administrativ financiar sipas paragrafit (2), vetëm pasi që sanksionet e propozuara administrative sipas paragrafit të ri (1) do të jenë në diskrecion të NjIF-it dhe autoriteteve përkatëse mbikëqyrëse – megjithatë, autoritetet e Kosovës mund ta marrin këtë parasysh brenda strukturës ligjore të Kosovës.

që të vendosë gjobën administrative ditore, por vetëm në rrethanat, ku për shembull, për qëllimet e përmbushjes së detyrave të veta analitike mbi dyshimet e pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, kërkon *dokumente dhe informata nga organet publike apo qeveritare ose nga trupat apo organizatat ndërkombëtare apo ndërqeveritare (në Kosovë) për një person, entitet, pasuri apo transaksion*, si dhe nuk merr dokumentet apo informatat e tilla.¹⁴⁵

1334. Pasi që Ligji LPP/LFT nuk ka dispozita për sanksionet administrative, përveç në një masë të kufizuar në nenin 31, si dhe për të cilat NJIF-i është e përcaktuar si autoritet për vendosjen e sanksioneve të tilla të kufizuara administrative, ka nevojë që të vendosen sanksionet e tilla, si dhe të përcaktohet autoriteti(et) për t'i vendosur ato.

1335. Siç është përcaktuar tashmë me këtë Raport, derisa legjislacioni financiar ka dispozita për sanksione administrative që mund të vendosen mbi sektorin financiar nga BQK-ja, sanksionet e tilla administrative janë të natyrës së kujdesit dhe nuk vlejné për shkeljet e Ligjit LPP/LFT siç është demonstruar tashmë me këtë Raport.

1336. Në fakt, nuk janë vendosur sanksione administrative nga BQK-ja e as NJIF-i për qëllimet e Ligjit LPP/LFT.

1337. Ndëshkimet penale të përcaktuara me Ligjin LPP/LFT bien në juridiksionin e Gjykatave të Qarkut.¹⁴⁶

1338. Pra, ka nevojë të dukshme që të vendosen sanksionet administrative, si dhe të caktohet autoriteti(et) për t'i vendosur ato.

1339. Reformulimi i propozuar i nenit aktual 31 të Ligjit LPP/LFT sipas rekomandimit për KTH 17.1 synon të mbulojë këtë kërkesë.

Sanksionet që vlejné për drejtorët dhe menaxhmentin e lartë – Kriteri thelbësor 17.3¹⁴⁷

1340. KTH 17.3 kërkon që sanksionet të jenë të përcaktuara jo vetëm për personat juridikë që janë institucionet financiare dhe bizneset, por edhe për drejtorët dhe menaxhmentin e tyre të lartë.

1341. Sanksionet administrative sipas nenit 31 të Ligjit LPP/LFT vlejné vetëm për personat juridikë si palë të treta.

1342. Neni 33 i Ligjit LPP/LFT përcakton veprat tjera penale. Në disa raste, ai i referohet “secilit... që kryen një veprë penale të dënueshme”. Në raste të tjera, për shembull në paragrafin (4), i referohet *zyrtarit, drejtorit, agentit apo punëtorit të një banke apo institucioni financiar*. Në raste të tjera, për shembull paragrafi (6), Ligji i referohet në mënyrë të veçantë një *zyrtari të NJIF-it që me dashje*:

¹⁴⁴ Projektligji për Ndryshim/Plotësim përcakton sanksione e ndëshkime të tilla administrative me nenet e reja 31A dhe 31B, të cilat janë reflektuar në amandamentet e propozuara për KTH 17.1 në këtë Raport. Projektligji për Ndryshim nuk përcakton në mënyrë specifike një autoritet për t'i vendosur ato. Amandamentet e propozuara në këtë Raport për KTH 17.1 synojné të përcaktojnë autoritetet e tilla.

¹⁴⁵ Projektligji për Ndryshim/Plotësim propozon ndryshimin e këtij neni për të zgjeruar pushtetin e NJIF-it. Kjo reflektohet në amandamentet e propozuara sipas KTH 17.1, por në mënyrë më specifike dhe të qartë.

¹⁴⁶ Projektligji për Ndryshim/Plotësim do të heqë referencën ndaj Gjykatës së Qarkut, në pajtim me ndryshimet në strukturën gjyqësore, në fuqi prej 1 janarit 2013.

¹⁴⁷ Referojuni edhe analizës dhe komenteve tek seksioni 3.10.5, në lidhje me KTH 29.4 për Rekomandimin 29 të FATF.

1343. Megjithatë, sipas nenit 34, në përcaktimin e përgjegjësisë penale të një personi juridik, Ligji LPP/LFT parashikon që: Nëse një person juridik kryen një veprë sipas këtij Ligji, secili drejtor dhe person tjetër që është në menaxhmentin e personit juridik (si dhe çdo person tjetër që vepron në atë cilësi) kryen veprën, përveç nëse ai person vërteton që:.

1344. Me mungesën e dispozitave për vendosjen e sanksioneve administrative, mungon edhe vendosja e sanksioneve mbi drejtorët dhe menaxhmentin e lartë sipas Ligjit LPP/LFT.

1345. Në rastet kur Ligji përcakton sanksione administrative, edhe pse në një masë të kufizuar dhe në sektorë specifikë, Ligji LPP/LFT prapë nuk përcakton vlefshmërinë e tyre për drejtorët dhe menaxhmentin e lartë.

1346. Në rastin e veprave penale, neni 33 i Ligjit LPP/LFT duket të jetë i mjegullt në interpretimin e tij. Ky mjegullim zbutet me dispozitat e nenit 34 të Ligjit LPP/LFT, i cili kërkon përgjegjësi nga drejtorët dhe menaxhmentin e lartë për një veprë që kryhet nga personi juridik, sipas Ligjit, përveç në rastet kur ai person vërteton të kundërtën.

1347. Në fakt, në përgjigjet ndaj Pyetësorit në lidhje me analizën e KTH 17.3, NJIF-i thekson që: Legjislacioni në fuqi në Kosovë nuk parasheh sanksione apo vepra të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë. Por, Ligji nr. 03-L/196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili është në procedurë ndryshim/plotësimi, si dhe është bërë rekomandimi që sanksionet e tilla të përfshihen në ligjin në fjalë.

1348. Kjo deklaratë është në kundërshtim me interpretimin që i bëhet nenit 34 të Ligjit LPP/LFT dhe lë brengat për zbatimin e nenit 34 në praktikë. Për më tepër, në kundërshtim me atë që thuhet, projektligji për ndryshim/plotësim, në nenet e reja të propozuara 31A dhe 31B thekson që *Ndëshkohen me para prej – deri personat juridikë për shkeljet në vijim:*.

1349. Pra, përtej rekomandimeve për rishikimin e nenit 31 të Ligjit LPP/LFT sipas analizës për KTH 17.1 të këtij Raporti, mund të jetë e nevojshme të qartësohet paragrafi (1) i nenit 34 të Ligjit LPP/LFT si në vijim (rekomandimi në italice):

Neni 34 para (1) Nëse një person juridik kryen një veprë penale sipas këtij ligji, çdo drejtor dhe person tjetër në lidhje me menaxhimin e personit juridik (dhe çdo person që pretendon të veprojë në kapacitet të tillë) kryen veprë penale dhe do të jetë përgjegjës për ndëshkimet e përcaktuara me këtë ligj, përveç nëse ai person dëshmon se:

Shkallët e sanksioneve – Kriteri thelbësor 17.4

1350. KTh 17.4 kërkon një sërë sanksionesh që janë të gjera dhe proporcionale për peshën e veprës. Kjo seri e sanksioneve do të përfshinte kompetencën për të vendosur sanksione disiplinore dhe financiare, si dhe autorizimin për të tërhequr, kufizuar apo pezulluar licencën e institucionit financiar, sipas rastit dhe ku vlen.

1351. Siç është theksuar më herët në këtë Raport, Ligji LPP/LFT nuk ofron shkallët e sanksioneve. Në fakt, nuk përcakton fare sanksionet administrative, përveç në masë të kufizuar në nenin 31, si dhe në lidhje me disa sektorë specifikë në ligjet përkatëse, të cilat janë vënë në pyetje nga ky Raport – shih analizën më lart për KTh 17.1.

1352. Sanksionet administrative përcaktohen me legjislacion financiar specifik, vetëm për qëllime kujdesi, për shkelje të ligjeve të veçanta.

1353. Ju lutemi t'i referoheni edhe përshkrimit dhe analizës në paragrafët e mëparshëm tek Rekomandimi 17.

1354. Derisa në përgjigjet ndaj pyetësorit, BQK-ja nuk ka ofruar përgjigje për këtë, përgjigja e NjIF-it ngre brenga që janë debatuar shumë herë në këtë raport.

1355. Në përgjigjet e saj, NjIF-i thekson që: *Legjislacioni në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nuk parasheh sanksione disiplinore dhe financiare si dhe kompetencë për tërheqjen, kufizimin apo pezullimin e licencës së institucionit financiar. Por, ka ligje të veçanta në Kosovë për subjekte raportuese, që i mundësojnë autoriteteve kompetente të suspendojnë licencën e atyre subjekteve, të cilat mbulohen edhe me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.*

1356. Kjo deklaratë tregon që, përkundër mungesës së mandatit ligjor të BQK-së apo ndonjë autoriteti tjetër mbikëqyrës të përcaktuar me Ligjin LPP/LFT, NjIF-i është e mendimit që autoritetet mbikëqyrëse, si BQK-ja, mund të aplikojnë masa të natyrës së kujdesit sipas legjislacionit specifik për qëllimet e Ligjit LPP/LFT.¹⁴⁸ Në fakt, Ligji LPP/LFT as nuk e fuqizon NjIF-në të propozojë aplikimin e masave të tilla të kujdesit për autoritetet tjera mbikëqyrëse – analiza për KTh 17.1 më lart në këtë raport në fakt vë në dyshim zbatueshmërinë e disa dispozitave në lidhje me OJQ-të, partitë politike dhe të tjerët, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin LPP/LFT.

1357. Për këto arsye, në këtë raport konstatohet që aktualisht nuk ka dispozita ligjore sipas Ligjit LPP/LFT për vendosjen e sanksioneve administrative, edhe pse Ligji parasheh veprat penale.

1358. Rekomandimet e dhëna si më lart në analizën e KTh 17.1 për riformulimin e nenit 31 të Ligjit LPP/LFT pra duhet të vlejnë edhe për qëllimet e KTh 17.4.

Efektshmëria – për Rekomandimin 17

1359. Regjimi sanksionues për qëllimet e LPP/LFT është mjaft i dobët, si dhe rrjedhimisht ndikon negativisht tek efektshmëria e regjimit LPP/LFT. Në fakt, autoritetet kanë raportuar që nuk janë vendosur kurrë sanksione të asnjë lloji natyre.

1360. Edhe pse Ligji LPP/LFT përcakton sanksionet administrative të vendosura nga NjIF-i, kjo gjë është tejet e kufizuar në fushëveprim, si dhe ekziston një mungesë e plotë e ndonjë sistemi të sanksioneve të përshkallëzuara që mund të zbatohet. Kjo më tej ngre brengat e efektshërisë, pasi që autoritetet theksojnë që sanksionet e tilla administrative mund të vendosen nga BQK-ja sipas ligjeve përkatëse të sektorit financiar, si Ligji për bankat. Për më tepër, ekziston një dyfishim i veprave në Ligji LPP/LFT dhe ligjeve tjera financiare, siç është Ligji për bankat, si dhe të cilët përmbajnë ndëshkime të ndryshme për të njëjtën vepër, duke krijuar kështu dykuptimësi ligjore të cilat në mënyrë negative ndikojnë në implementimin efektiv.

3.11.2. Rekomandimet dhe komentet

1361. Analiza e dispozitave ligjore për sanksione në Ligjin LPP/LFT identifikon mangësi tejet të mëdha dhe mungesë të qartësisë ligjore në aplikimin e sanksioneve të përcaktuara me ligje të tjera për qëllimet e Ligjit LPP/LFT. Për më tepër, duket të ketë konflikte në veprat penale të përcaktuara me ligjin LPP/LFT në lidhje me ligjet tjera që dalin nga Rregulloret e mëparshme të UNMIK-ut, të cilat tashmë janë shfuqizuar me miratimin e ligjeve të veçanta.

¹⁴⁸ Ndoshta për këtë arsye Projektligji për ndryshim/plotësim nuk përcakton sanksione të tilla administrative siç kërkohet për qëllimet e KTh 17.4

1362. Me pak fjalë, disa prej gjetjeve kryesore janë dhënë në vijim. Megjithatë, duhet përmendur që leximi i pikave në vijim nuk është zëvendësim i leximit të kontekstin në të cilin këto mangësi janë identifikuar;

- Brenga për zbatueshmërinë e disa dispozitave të Ligjit për qëllime të sanksioneve administrative, sidomos të nenit 24(8) për OJQ-të, si dhe nenit 26(14) për profesionistët e mbuluar (KTh 17.1);
- Brenga në lidhje me veprat penale në Ligjin LPP/LFT, të cilat gjithashtu janë reflektuar në legjislacionin e veçantë financiar, si dhe të cilat përmbajnë ndëshkime të ndryshme, duke krijuar kështu konflikt ligjor (KTh 17.1);
- Mungesa e ndëshkimeve administrative për shkeljen e obligimeve individuale në ligjin LPP/LFT (KTh 17.1);
- Mungesa e përcaktimit të autoritetit kompetent për vendosjen e sanksioneve administrative, përveç deri në një masë të kufizuar në nenin 31 (KTh 17.2);
- Pasiguria ligjore në aplikimin e ndëshkimeve administrative dhe të tjera për drejtorët dhe menaxhmentin e lartë të subjekteve raportuese (KTh 17.3);
- Mungesa e shkallëve të sanksioneve që duhen aplikuar proporcionalisht ndaj peshës së veprës (KTh 17.4); si dhe
- Brenga për zbatueshmërinë e sanksioneve administrative dhe të tjera të kujdesit, në legjislacionin e veçantë financiar për qëllimet e ligjit LPP/LFT (KTh 17.4).

1363. Për më tepër, asnjë sanksion nuk është aplikuar nga NJIF-i, BQK-ja apo ndonjë autoritet sipas Ligjit, për asnjë shkelje të ligjit LPP/LFT.

1364. Pas identifikimit të këtyre mangësive, Raporti ofron rekomandime të ndryshme për rregullimin e tyre. Është me rëndësi jetike që të gjitha rekomandimet e dhëna të lexohen brenda analizës së situatës dhe komenteve të bëra në këtë Raport, për KTh specifike.

- Rishikimi i nenit 24(8), nenit 25(7), nenit 26(14) dhe nenit 27(4) brenda kontekstit të amandamenteve të propozuara për nenin 31 të Ligjit LPP/LFT;
- Rishikimi i veprave penale dhe të tjera për siguri ligjore, si dhe shmangia e ndërlikimeve ligjore në aplikim për shkak të veprave të dyfishuara dhe ndëshkimeve të ndryshme mes vete;
- Reformulimi i nenit 31 dhe futja e neneve të reja 31A dhe 31B, siç përcaktohet me Projektligjin e ndryshim/plotësimit të Ligjit LPP/LFT;
- Përcaktimi i autoritetit/autoriteteve për vendosjen e sanksioneve përmes nenit 31 të rishikuar;
- Sigurimi që sanksionet të jenë të vlefshme për drejtorët dhe menaxhmentin e lartë, përmes rishikimit të nenit 31, si dhe për këtë qëllim, ndryshimi i nenit 34 të Ligjit LPP/LFT; si dhe
- Vendosja e shkallëve të sanksioneve përmes rishikimit të nenit 31 sipas propozimit.

3.11.3. Klasifikimi për Rekomandimin 17

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
Rek 17	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Brenga për zbatueshmërinë e disa dispozitave të Ligjit për qëllime të sanksionimit administrativ; • Brenga për veprat e dyfishuara penale në Ligjin LPP/LFT dhe ligjet e veçanta financiare me ndëshkime të ndryshme;

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
		<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e ndëshkimeve administrative për shkeljen e obligimeve individuale në Ligjin LPP/LFT; • Mospërcaktimi i autoritetit kompetent për vendosjen e sanksioneve administrative ; • Paqartësia ligjore në aplikimin e ndëshkimeve administrative dhe të tjera për drejtorë dhe menaxhmentin e lartë të subjekteve raportuese; • Mungesa e shkallëve të sanksioneve; • Brenga për zbatueshmërinë e sanksioneve administrative dhe të tjera të kujdesit sipas ligjeve të veçanta financiare për qëllimet e Ligjit LPP/LFT; si dhe • Çështjet e efektshmërisë që rrjedhin nga papërshtatshmëia e regjimit sanksionues dhe mungesa e aplikimit të sanksioneve.

3.12. Shërbimet e transferimit të parave apo vlerës (RV.VI)

3.12.1. Përshkrimi dhe Analiza

1365. RV VI për shërbimet alternative të dërgesave kërkon që personat apo subjektet juridike, duke përfshirë agjentët, që ofrojnë shërbime të TPV-së, duke përfshirë transferimet përmes sistemeve apo rrjeteve joformale, duhen regjistruar apo licencuar, si dhe i duhen nënshtruar mbikëqyrjes për përputhshmëri me obligimet për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të cilat aplikohen për banka dhe institucione financiare jobankare. Personat dhe subjektet që ofrojnë shërbime të tilla i duhen nënshtruar më tutje edhe sanksioneve administrative, civile apo penale.

1366. Ky Raport ka analizuar çështjen e «institucioneve financiare jobankare» tek neni 3, në nëntitullin *Fusha e mbulimit të masave parandaluese LPP/LFT* si dhe, me më shumë rëndësi për nenin 3.12 tek analiza për *Licencimin apo regjistrimin e shërbimeve të transferimit të parasë apo vlerës dhe këmbimit të valutës – KTh 23.5*

1367. Analiza që vijon për kriteret thelbësore për RV VI pra do t'i referohet analizës të lartpërmendur, ku analiza e tillë reflekton kriteret specifike thelbësore për RV.

Licencimi dhe/ose regjistrimi i shërbimeve të transferimit të parasë apo vlerës – Kriteri thelbësor RV VI.1

1368. KTh RV VI.1 kërkon që ofruesit e shërbimeve të TPV-së të licencohen apo regjistrohen, të mbahen në një regjistër referimi, si dhe t'i nënshtrohen monitorimit të përputhshmërisë me kushtet e tyre të licencimit apo regjistrimit.

1369. Analiza e këtij Raporti për KTh 23.5 që merret me licencimin apo regjistrimin e shërbimeve TPV dhe këmbimit të valutave vlen për analizën e KTh RV VI.1, si dhe duhet lexuar përshtatshëm.

1370. Në termat e Ligjit për bankat, shërbimet e TPV-së janë aktivitet që i atribuohen bankave sipas nenit 44, si dhe institucioneve financiare jobankare në termat e nenit 94 mbi aktivitetet e lejuara për institucione financiare jobankare. Definicioni i institucioneve financiare jobankare në Ligjin për bankat megjithatë nuk ia atribuon këtë aktivitet një institucioni financiar jobankar.

1371. Neni 8 i Ligjit për BQK-në thekson në paragrafin (1) që detyrat e BQK-së në përmbushjen e synimeve të përcaktuara me nenin 7 dhe në dispozitat tjera të Ligjit për BQK-në përfshijnë rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, siç përcaktohet më tutje në këtë Ligj apo ndonjë ligj tjetër. Për më tepër, neni 23 i Ligjit për BQK-në më tutje thekson që BQK-ja është përgjegjëse ekskluzivisht për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve tjera financiare, siç përcaktohet më tutje në ligjet përkatëse.

1372. Për më tepër, neni 4 i Ligjit për bankat ia atribuon përgjegjësinë e vetme për lëshimin e licencave për gjitha bankat dhe për regjistrimin e gjitha institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare BQK-së.

1373. Neni 4 i Ligjit për Bankat më tutje kërkon nga BQK-ja të mbajë një regjistër qendror që regjistron për gjitha institucionet financiare emrin, zyrën qendrore dhe adresat e degëve të tij, si dhe kopjet e reja të statutit apo dokumentacionit ekuivalent të themelimit, si dhe aktet korporative për inspektim publik. Regjistri gjithashtu duhet të ketë një listë të të gjitha institucioneve financiare, licenca apo regjistrimi i të cilave është revokuar, pa dokumentacionin e tyre themeltar dhe aktet korporative.

1374. Neni 91 i Ligjit për bankat përcakton që asnjë person nuk mund të angazhohet në biznesin e institucioneve financiare jobankare, përveç nëse ai person është regjistruar së pari në BQK, sipas dispozitave të Ligjit për bankat, si dhe nëse nuk ka qenë gjithmonë në respektim të plotë të Ligjit për bankat dhe gjitha rregulloreve e urdhrave të nxjerrë nga BQK-ja në autorizimet e veta rregullative sipas Ligjit. Për më tepër, neni 92 i Ligjit për bankat përcakton që gjitha institucionet financiare jobankare duhen rregulluar nga BQK-ja, derisa neni 104 kërkon që gjitha institucionet financiare jobankare t'i nënshtrohen kontrolleve nga kontrolluesit e BQK-së për të vlerësuar përputhshmërinë e tyre të kujdesit në licencë si dhe me Ligjin për bankat apo rregulloret e urdhrat e nxjerrë në këtë autorizim.

1375. Autorizimet ligjore rregullative dhe mbikëqyrëse të kujdesit në BQK për institucionet financiare jobankare reflektohen dhe qartësohen më tutje në Rregullin XVI të BQK-së për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe operacionet e institucioneve financiare jobankare.

1376. Kështu që ofruesit e shërbimeve të TPV-së nuk përfshihen në definicionin e institucionit financiar në Ligjin për BQK-në dhe në Ligjin për bankat, por shërbimi përfshihet si aktivitet në nenin 94 të Ligjit për bankat dhe institucionet financiare jobankare.

1377. Siç përcaktohet me analizën e kornizës licencuese për institucione financiare tek analiza për KTh 23.5 në këtë raport, rrjedh që definicionet e ndryshme të institucionit financiar, që ndryshojnë në substancë, krijojnë paqartësi ligjore, edhe pse nuk reflektohet në praktikë, në procedurat e licencimit apo regjistrimit të shërbimeve TPV.

1378. Kështu, në analizën për KTh 23.5 ky Raport rekomandon harmonizimin e definicioneve të ndryshme të “institucionit financiar” dhe aktivitetet e lejuara të institucionit financiar duhet të definohen ashtu si duhet në legjislacione të ndryshme për qartësi juridike për kompetencat e licencimit të BQK në këtë drejtim. Ky rekomandim vlen edhe për KTh RV VI.1

1379. Pa anashkaluar pikat si më lart, nga aspekti i kujdesit, BQK-ja ka procedurat e domosdoshme me Ligjin për Bankat dhe Ligjin për BQK-në për të rregulluar dhe mbikëqyrur personat që ofrojnë shërbime TPV, duke përfshirë edhe mbajtjen e regjistrimit përkatës.

Monitorimi i përputhshmërisë me LPP/LFT – Kriteri thelbësor VI.2 dhe Kriteri thelbësor VI.3

1380. KTh VI.3 kërkon që operatorët e shërbimeve TPV t'i nënshtrohen kërkesave dhe obligimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë ato për obligimet sipas RV VII për informatat që përcjellin transferimet në llogari.

1381. Në definicionin e „institucionit financiar“ për qëllimet e obligimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Ligji LPP/LFT specifikon përfshirjen e transferimit të valutës dhe instrumenteve monetare, me çfarëdo mënyre, duke përfshirë mënyrën e sistemit joformal të transferimit të parave ose rrjetit të personave apo entiteteve që mundësojnë transferimin e parave jashtë sistemit konvencional të institucioneve financiare.

1382. Institucionet financiare përfshihen si subjekte raportuese në nenin 16 për qëllimet e Ligjit LPP/LFT. Kështu, gjitha obligimet e subjekteve raportuese, si dhe në veçanti ato që kanë të bëjnë me bankat dhe institucionet financiare, sipas Ligjit LPP/LFT vlejnë për ofruesit e shërbimeve të TPV-së.

1383. Sipas nenit 19 të Ligjit LPP/LFT, si dhe në pajtim me RV VII, bankat dhe institucionet financiare që ofrojnë shërbime TPV janë të obliguara edhe që të:

- Marrin dhe verifikojnë emrin e plotë, numrin e llogarisë, adresën, ose në mungesë të adresës numrin e identitetit kombëtar, ose datën dhe vendin e lindjes, duke përfshirë sipas nevojës edhe emrin e institucionit financiar, ose pikën e nisjes të transferimit;
- Përdorin numër unik reference nëse nuk ka numër llogarie që përcjell transferimin;
- Përfshijnë informata të tilla në mesazh apo në formularin e pagesës që përcjell transferimin;
- Ruajnë gjitha këto informata dhe t'i transmetojnë ato kur veprojnë si ndërmjetës në zinxhirin e pagesave;
- Marrin masa për të siguruar dhe verifikuar informatat që mungojnë nga institucioni pagues ose përfituesi kur marrin transferime në llogari me informata që mungojnë;
- Refuzojnë pranimin e transferimit kur nuk sigurohen informatat që mungojnë; si dhe
- Raportojnë situata të tilla sipas nevojës tek Njësia e Inteligjencës Financiare.

1384. Për më tepër, Rregulli XVI i BQK-së për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe operacionet e institucioneve financiare jobankare ofron udhëzime të mëtutjeshme për ofruesit e shërbimeve TPV për operacionet e tyre.

1385. Në detyrimin e ofruesve të shërbimeve TPV për të qenë në përputhje me parimet e përgjithshme të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të përcaktuar me Rregull, Rregulli X i BQK-së gjithashtu përcakton procedurat e mëtutjeshme që duhen ndërmarrë gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre, edhe pse pjesa më e madhe e udhëzimeve të dhëna i referohen procedurave për Raportimin e transaksioneve në para që tejkalojnë pragun prej 10,000 €.

1386. KTh VI.3 më tutje kërkon që ofruesit e shërbimeve TPV t'i nënshtrohen sistemeve të monitorimit për përputhje me obligimet e tyre sipas Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1387. Ligji LPP/LFT nuk përcakton autoritet që është përgjegjës për monitorimin e bankave dhe institucioneve financiare për përputhshmërinë e tyre me Ligjin LPP/LFT dhe rregullat e rregulloret që nxirren sipas tij.

1388. Në praktikë, monitorimi i tillë bëhet nga BQK-ja brenda autorizimeve të përgjithshme mbikëqyrëse të kujdesit. Ky raport ka shprehur brenga serioze për këtë situatë, për shkak të mungesës së mandatit ligjor për të mbikëqyruar dhe për të aplikuar autorizimet mbikëqyrëse të kujdesit sipas Ligjit për BQK-në, Ligjit për bankat dhe ligjeve të tjera relevante financiare.

1389. Me harmonizimin e definicionit përmes futjes së shërbimeve TPV në definicionin e “institucionit financiar”, si dhe rrjedhimisht aplikimin e gjitha kërkesave dhe obligimeve sipas Ligjit LPP/LFT, pra rrjedh që gjitha dobësitë dhe mangësitë e identifikuara në analizën e këtij Raporti për këto obligime gjithashtu vlejné për shërbimet TPV të dhëna në analizën për KTH VI.2.

1390. Këto do të përfshinin brengat e përmendura në këtë raport për aplikimin e masave të plota KDK, duke përfshirë pronësinë përfituese (beneficuese); kohën e verifikimit; qasjen me bazë në rrezik; PEP; zbulimin, si dhe të tjerat të dhëna në raport.

1391. Gjitha rekomandimet përkatëse të përmendura në këtë Raport për mangësitë apo dobësitë e tilla pra vlejné edhe për ofruesit e shërbimeve TPV tek RV VI.

1392. Në anën tjetër, raporti vlerëson pozitivisht aplikimin e obligimeve të shtuara për ofruesit e shërbimeve TPV në pajtim me RV VII për përfshirjen e hollësive të konsumatorit në transferimet e dërgesave, si dhe veprimeve që duhen ndërmarrë kur informatat e konsumatorit mungojné në një transferim që pranohet.

1393. Raporti gjithashtu vlerëson pozitivisht punën mbikëqyrëse që kryhet nga BQK-ja në të siguruarit e përputhshmërisë me Ligjin LPP/LFT nga ofruesit e shërbimeve TPV, edhe pse vizitat në terren janë mjaft të rralla, pa anashkaluar mungesën e mandatit ligjor. Raporti ka shprehur një brengë të përgjithshme madhore e serioze për mungesën e mandatit mbikëqyrës ligjor për sektorin financiar për qëllimet e Ligjit LPP/LFT.

1394. Pra, rekomandohet që Ligji LPP/LFT të përcaktojë një autoritet kompetent që të jetë përgjegjës për monitorimin e ofruesve të shërbimeve TPV si institucione financiare brenda sektorit financiar për respektimin nga to të Ligjit dhe Rregullave e Rregulloreve përkatëse.

Lista e agjentëve – Kriteri thelbësor RV VI.4

1395. KTh RV VI.4 kërkon nga ofruesit e licencuar apo të regjistruar të TPV-së që të mbajnë një listë të agjentëve të tyre që i duhet vënë në dispozicion autoritetit të përcaktuar kompetent.

1396. Nuk është e qartë nga Ligji për Bankat nëse ofruesit e shërbimeve TPV lejohen nga Ligji që të kenë agjentë. Edhe pse nuk ka ndalesë specifike, gjithsesi nuk ka lejim apo autorizim specifik për ta bërë këtë. Analiza e Ligjit për bankat tregon që nuk ka definicion të termit “agjent”, edhe pse termi përdoret në gjithë Ligjin për qëllime të ndryshme, si dhe definicioni i termit “institucion financiar jobankar” nuk i referohet “agjentëve”.

1397. Neni 2 i Ligjit për bankat specifikon aplikimin e Ligjit tek të gjitha entitetet që ushtrojnë aktivitete bankare e financiare, aksionarët e tyre, bordet e drejtorëve dhe menaxherët e lartë, punëtorët, *agjentët* dhe degët e tyre, si dhe tek operacionet e institucioneve mikrofinanciare dhe institucionet tjera financiare jobankare.

1398. Brenda kontekstit të bankave, Ligji për bankat përmban referenca të ndryshme për “agjentët” e bankave – për shembull tek neni 57 në lidhje me autorizimet mbikëqyrëse të BQK-së; neni 77 në lidhje me dispozitat e falimentimit; si dhe neni 80 në lidhje me dispozitat e fshehtësisë. Në kontekstin e dispozitave në Ligjin për Bankat për institucione financiare

jobankare, Ligji gjithashtu i referohet “agjentëve” të institucioneve financiare jobankare – për shembull tek neni 100 për dispozitat e fshehtësisë.

1399. Ngjashëm, Ligji LPP/LFT nuk ofron definicion të termit “agjent”, derisa definicioni i “institucionit financiar” nuk i referohet “agjentëve”, edhe pse ky term përdoret në gjithë ligjin për qëllime të ndryshme.

1400. Pika (d) e Rregullit XVI të BQK-së për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Operacionet e Institucioneve Financiare Jobankare kërkon nga institucioni të informojë BQK-në për ndërrimin e adresës. Pika (e) më tutje kërkon që institucioni financiar të marrë paraprakisht miratimin e BQK-së para se të themelojë degë apo zyra të reja. Kjo reflektohet nga paragrafi (1.2) i nenit 95 të Ligjit për Bankat, që kërkon nga institucioni financiar jobankar të marrë miratimin paraprak të BQK-së para hapjes së lokacioneve të reja apo ndërrimit të lokacionit.

1401. Sipas nenit 22, në veprimin e Raportimit tek NJIF-i, e më veçanërisht në adresimin e çështjes së “zbulimit”, Ligji LPP/LFT i referohet drejtorëve, zyrtarëve, punëtorëve dhe *agjentëve* të secilës bankë apo institucioni financiar (paragrafi 4); si dhe në paragrafin (11) të nenit 26 në lidhje me profesionistët e mbuluar.

1402. Termi “lokacione të reja” në paragrafin (1.2) të nenit 95 të Ligjit për Bankat jo detyrimisht i referohet “agjentëve” në kontekstin e transferimit në llogari, pasi që “agjentë” mund të jenë, si dhe shpesh janë, entitete tjera që ushtrojnë biznese komerciale që mund të pranojnë apo transferojnë para në emër të ofruesit të autorizuar të shërbimit sipas ligjit.

1403. Megjithatë, në praktikë BQK-ja interpreton Rregullin e saj, si dhe rrjedhimisht edhe paragrafin (1.2) të nenit 95 që të lejojë institucionet financiare jobankare të kenë agjentë – në këtë rast ka nevojë për qartësi ligjore të definicionit të “agjentit” dhe funksioneve të tij. Edhe nëse thjesht për hir të argumentimit pranohet ky interpretim i BQK-së si autoritet kompetent rregullativ për sektorin financiar, çështja e pushtetit të BQK-së për licencim të ofruesve të shërbimeve TPV, siç theksohet me këtë Raport, mbetet brengë e përgjithshme.

1404. Pasiguria ligjore në kuptimin e asaj nëse një institucion financiar, e veçanërisht një ofrues shërbimesh TPV, mund të emërojë agjentë, është e rëndësishme për vlerësimin e përputhshmërisë me KTh VI.4.

1405. Në këto rrethana, rekomandohet që qartësia ligjore të sigurohet përmes dispozitave të përshtatshme në Ligjin për Banka, duke iu referuar “agjentëve” sipas nenit 95 të Ligjit për Bankat, me definicione të qarta të termit “agjent” për këto qëllime në Ligj dhe të krijohet një proces ligjor për emërimin e agjentëve nga ofruesit e shërbimeve TPV.

1406. Duke supozuar që institucionet financiare në përgjithësi, apo ofruesit e shërbimeve TPV në veçanti, lejohen të emërojnë agjentë, duhet marrë parasysh edhe shtimi i një dispozite ose në Ligjin LPP/LFT ose drejtpërdrejt në Ligjin për Bankat, si në vijim:

- Në rastet kur [një institucion financiar] [ofrues shërbimesh TPV] emërohen agjentë për të kryer aktivitete në emër të tij siç përcaktohet [me këtë ligj] [me Ligjin për Bankat], [institucioni financiar] [ofruesi i shërbimeve TPV] mban regjistër të atyre agjentëve, ku përfshihet emri, adresa, aktiviteti afarist, data e emërimit, si dhe informatat dhe kushtet tjera përkatëse dhe t’i vihet në dispozicion ai regjistër [autoritetit kompetent] [BQK-së].

Sanksionet – Kriteri Thelbësor RV VI.5

1407. KTh RV VI.5 kërkon që sanksionet efektive, proporcionale e ndaluese penale, civile apo administrative, siç kërkohen me Rekomandimin 17 të jenë në dispozicion për obligimet sipas FATF RV VI.

1408. Disponueshmëria e sanksioneve dhe aplikimi i tyre tashmë është diskutuar në analizën e Rekomandimit 17 të këtij Raporti. Analiza sipas Rekomandimit 17 vlen për KTh RV VI.5 si dhe paragrafët në vijim do të vënë atë analizë në perspektivën e RV VI.

1409. Sanksionet administrative të përcaktuara me nenin aktual 31 të Ligjit LPP/LFT janë të kufizuara në fushëveprim dhe vlejnjë për persona e entitete që nuk janë subjekte raportuese për qëllimet e nenit 16 të Ligjit LPP/LFT.¹⁴⁹

1410. Veprat tjera penale të përcaktuara me nenin 33 të Ligjit LPP/LFT do të vlenin për ofruesit e shërbimeve TPV si institucione financiare të njohura si subjekte raportuese tek neni 16 i Ligjit, si dhe që i nënshtrohen gjitha obligimeve të Ligjit LPP/LFT.

1411. Megjithatë, siç është shpjeguar tashmë tek Rekomandimi 17 i këtij Raporti, Ligji LPP/LFT nuk përcakton sanksione apo ndëshkime administrative për shkeljet e obligimeve individuale sipas Ligjit.¹⁵⁰

1412. Analiza për KTh 29.4 të Rekomandimit 29 ka identifikuar një numër mangësish e dobësish në aplikimin e sanksioneve tek sektori financiar. Këto gjetje vlejnjë edhe në këtë pjesë për ofruesit e shërbimeve TPV si institucione financiare sipas Ligjit LPP/LFT.

1413. Rrjedhimisht, rekomandimet dhe propozimet për rregullimin e kësaj situate përmes Ligjit LPP/LFT të dhëna me këtë Raport sipas analizës KTh 29.4 dhe Rekomandimit 17 për rishikimin e nenit 31 të Ligjit LPP/LFT vlejnjë ngjashëm për qëllimet e RV VI.

Zbatimi i Dokumentit të Praktikave më të Mira të FATF-së për RV VI – Kriteri Shtesë VI.6

1414. Kriteri Shtesë RV VI.6 mundohet të identifikojë nëse janë marrë masa dhe çfarë masash janë marrë nga vendi në implementim të rekomandimeve në Dokumentin e Praktikave më të Mira për RV VI.

1415. Në përgjithësi, Dokumenti i Praktikave më të Mira ofron udhëzime për kërkesat e licencimit apo regjistrimit për ofruesit e shërbimeve TPV; për strategjitë në identifikim të ofrimit të shërbimeve të tilla në tregun joformal; për të ndërmarrë fushata vetëdijesimi për të informuar ofruesit joformalë të shërbimeve me obligimet e tyre; si dhe për aplikimin e obligimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë obligimet e Raportimit. Dokumenti i praktikave më të mira ofron më tutje udhëzime për monitorimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve si dhe për aplikimin e sanksioneve.

1416. Edhe pse nuk ka dispozita specifike ligjore brenda këtij konteksti specifik, e rrjedhimisht as autoritet kompetent në Kosovë që ka përgjegjësi në këtë kuptim, duke marrë parasysh edhe faktin që Ligji LPP/LFT nuk emëron një autoritet kompetent mbikëqyrës për sektorin financiar, duhet theksuar që në përcaktimin e kompetencave të NJIF-it, Ligji LPP/LFT fuqizon Njësinë për organizimin dhe/ose ndërmarrjen e trajnimeve për pastrimin e parave, financimin e aktiviteteve terroriste dhe obligimeve të subjekteve raportuese. Për më tepër, si autoritet mbikëqyrës i kujdesit, BQK-ja ka publikuar Rregullin XVI për Regjistrimin,

¹⁴⁹ Projektligji për ndryshim/plotësim riformulon nenin 31, duke e zgjeruar në fushëveprim.

¹⁵⁰ Për këtë qëllim, Projektligji për ndryshim/plotësim shton nene të reja 31A dhe 31B, të cilat reflektohen në rishikimin e propozuar të nenit 31 të Ligjit LPP/LFT, për Rekomandimin 17 të këtij Raporti.

Mbikëqyrjen dhe Operacionet e Institucioneve Financiare Jobankare, edhe pse jo veçanërisht brenda kontekstit të shërbimeve TPV.

1417. Pa anashkaluar këto, nuk ka ndonjë strategji për identifikimin e ofrimit të shërbimeve joformale TPV, apo për ngritjen e vetëdijes për obligimet e tyre sipas Ligjit LPP/LFT, edhe pse Ligji për Bankat kërkon që asnjë person të mos ndërmarrë aktivitete të një institucioni financiar, përveç nëse ai person është i autorizuar nga BQK-ja.

1418. Mund të jetë e përshtatshme, prej aspektit të kujdesit, por që do të kishte edhe implikime për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që BQK-ja të zbatojë një strategji identifikimi të aktiviteteve joformale të shërbimeve TPV, si pjesë e një programi më të gjerë për vlerësimin e rrezikut dhe cënueshmërisë së sektorit financiar në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Efektshmëria

1419. Ky Raport gjen paqartësi të ndryshme ligjore në lidhje me institucionet TPV, që do të mund të kishte ndikim negativ në efektshmërinë e regjimit LPP/LFT në këtë kuptim.

1420. Brengat e përgjithshme të shprehura për pjesën e mbetur të sektorit financiar vlejné edhe për TPV-të, duke përfshirë mungesën e mandatit mbikëqyrës për qëllimet e LPP/LFT, si dhe në veçanti, procedurat e licencimit dhe regjistrimit për TPV. Për më tepër, ky Raport shpreh brengën për pasigurinë ligjore të TPV-ve për emërimin e agjentëve, si dhe vë në pikëpyetje interpretimin e Ligjit për Bankat në këtë drejtim, siç bëhet në praktikë nga BQK-ja.

1421. Brengat për efektshmërinë të shprehura në këtë Raport përforcohen edhe më shumë nga numri i vogël i vizitave në terren.

3.12.2. Rekomandimet dhe komentet

1422. Analiza dhe vlerësimi i implementimit të kërkesave sipas FATF RV VI pjesërisht mbulohen përmes analizës së Rekomandimeve tjera FATF, si rekomandimet 17, 23 dhe 29. Rrjedh që shumica e gjetjeve, mangësive dhe dobësive të identifikuara në analizën e këtyre Rekomandimeve bëhen të vlefshme për ofruesit e shërbimeve TPV si institucione financiare sipas Ligjit LPP/LFT.

1423. Derisa leximi i plotë i përshkrimit, analizës dhe komenteve për këtë pjesë dhe pjesëve tjera relevante të Raportit si më lart rekomandohet fuqimisht për të ditur kontekstin e gjetjeve të tilla, dobësitë më kryesore mund të grupohen si në vijim:

- Aplikimi i gjetjeve për Rekomandime tjera, si KDK, gjithashtu vlejné drejtpërdrejt për ofruesit e shërbimeve të TPV-së;
- Pasiguria ligjore për kërkesat e licencimit apo regjistrimit të ofruesve të shërbimeve TPV (KTh RV VI.1);
- Pasiguria ligjore në emërimin, funksionet dhe autorizimet e “agjentëve”;
- Mungesa e mandatit ligjor për autoritetin relevant mbikëqyrës për monitorimin e sektorit financiar për qëllime të LPP/LFT (KTh RV VI.3);
- Nuk ka obligim për mbajtjen e një liste agjentësh (KTh RV VI.4); si dhe
- Mungesa e sanksioneve efektive, proporcionale dhe frenuese penale, civile apo administrative (KTh RV VI.5).

1424. Për të rregulluar këtë situatë, janë dhënë rekomandime të ndryshme në këtë Pjesë dhe në pjesët relevante të Raportit si më lart. Rekomandimet e tilla duhen lexuar në kontekstin e

përshkrimit dhe analizës e komenteve të dhëna për kriteret përkatëse. Në vijim janë dhënë vetëm indikacionet e rekomandimeve të tilla:

- Harmonizimi i definicionit të “institucionit financiar” në ligjet përkatëse, duke përfshirë atë LPP/LFT, duke përfshirë aktivitetet që mund të ndërmerren nga institucionet financiare jobankare;
- Përcaktimi i një autoriteti kompetent me përgjegjësi rregullative dhe mbikëqyrëse për qëllimet e Ligjit LPP/LFT për tërë sektorin financiar;
- Qartësimi në Ligjin për Bankat i autorizimeve për institucionet financiare jobankare, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve TPV, për emërimin e agjentëve, si dhe kushteve për emërim apo për ndalim të tyre;
- Shtimi i definicionit të “agjentit” në Ligjin për Bankat;
- Shtimi i një paragrafi apo neni të ri në Ligjin për Bankat, ose Ligjin LPP/LFT, që obligon ofruesit e shërbimeve TPV të mbajnë një listë agjentësh, nëse Ligji për Banka nuk e ndalon këtë;
- Rishikimi i nenit 31 të Ligjit LPP/LFT siç rekomandohet në pjesën 3.11 të këtij Raporti.¹⁵¹

3.12.3. Klasifikimi për Rekomandimin e Veçantë VI

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
RV VI	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Pasiguria ligjore në kërkesat për licencim apo regjistrim; • Mungesa e mandatit ligjor për autoritetin relevant mbikëqyrës; • Pasiguria ligjore në emërimin, funksionet dhe autorizimet e “agjentëve”; • Si rrjedhojë, nuk ka obligim për ruajtjen e listës së agjentëve; • Mungesa e efektive, proporcionale dhe frenuese penale, civile apo administrative; dhe • Numri i vogël i inspektimeve në terren; si dhe • Çështjet e efektshmërisë që dalin kryesisht nga pasiguritë ligjore.

3.13. Teknikat moderne të transaksioneve të sigurta (R.20)

3.13.1. Përshkrimi dhe Analiza

1425. Rekomandimi 20 ka dy kuptime. Ai kërkon aplikimin e obligimeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit tek bizneset dhe profesionet tjera që përbëjnë rrezik të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (KTh 20.1) si dhe zhvillimit dhe përdorimit të menaxhimit të parave për zvogëlimin e cenueshmërisë së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (KTh 20.2).

1426. Ky Raport vlerëson vetëm KTh 20.2.

Zhvillimi dhe përdorimi i teknikave të menaxhimit të parave – Kriteri Thelbësor 20.2

¹⁵¹ Projektligji për ndryshim/plotësim propozon ndryshime në nenin 31 të Ligjit LPP/LFT, të cilat janë marrë parasysh në propozimet e pjesës 3.11 në këtë Raport.

1427. KTh 20.2 kërkon nga vendet që të marrin masa për të inkurajuar zhvillimin dhe përdorimin e teknikave moderne dhe të sigurta për të kryer transaksione financiare që janë më pak të cenueshme ndaj pastrimit të parave. Metodologjia FATF ofron shembuj teknikash apo masash që mund të aplikohen, si: zvogëlimi i varësisë nga paraja, përmbajtja nga nxjerrja e bankënotave tejet të mëdha në vlerë, si dhe sistemet e siguruara të transferimit automatik.

1428. Sipas nenit 16 të Ligjit për BQK-në, valuta e Kosovës përcaktohet me Ligj në pajtim me nenin 11 të Kushtetutës. Valuta ligjore aktualisht në Kosovë është Euroja. Gjitha denominimet e bankënotave Euro, duke përfshirë edhe atë prej €500, janë lëshuar në qarkullim. Sipas nenit 16 vetëm BQK-ja do të ketë të drejtë të lëshojë bankënota dhe monedha. Në këtë kuptim, BQK-ja është përgjegjëse për mbajtjen e një mase të përshtatshme të bankënotave dhe monedhave në Kosovë.

1429. BQK-ja ka ofruar informata për lëshimin dhe tërheqjen e bankënotave sipas prerjeve për periudhën 2003 - 2012 (fondi i nëntorit). Tabelat që vijojnë ofrojnë këto informata për periudhën 2009 deri më 2012 (fondi i nëntorit) me mesataret për periudhën 2003 deri në 2012 (fondi i nëntorit).

1430. Tabela në vijim e ofruar nga BQK-ja tregon masën e bankënotave Euro në qarkullim:

Tabela 18 : Valutat e lëshuara nga BQK-ja (valuta në qarkullim)

Prerje/Viti	2009	2010	2011	2012*	Mesatare**
500 €	30,200	18,000	9,000	13,600	45,978
200 €	500	2,000	1,000	100	19,035
100 €	299,100	319,000	302,000	379,000	529,223
50 €	1,662,500	2,273,000	2,335,000	2,136,100	1,512,703
20 €	1,901,400	2,207,000	2,303,000	3,346,700	1,575,593
10 €	1,822,400	2,086,000	2,140,000	3,518,500	1,422,947
5 €	1,059,000	1,140,000	1,125,000	1,062,100	759,181
Gjithsej copë	6,775,100	8,045,000	8,215,000	10,456,100	5,864,661
Gjithsej shuma	189,782,000	225,650,000	224,735,000	258,954,500	204,890,771
<i>Prej të cilave 500 EUR</i>	<i>15,100,000</i>	<i>9,000,000</i>	<i>4,500,000</i>	<i>6,800,000</i>	<i>22,989,050</i>
Raporti i 500 EUR me totalin	7.96%	3.99%	2.00%	2.63%	11.42%

* Deri më 30 nëntor 2012

** mesatarja për periudhën 2003 – 2012

1431. Tabela në vijim e dhënë nga BQK-ja tregon tërheqjen e bankënotave Euro nga qarkullimi:

Tabela 19 : Valutat e depozituara në BQK (tërheqje nga qarkullimi)

Prerje/Viti	2009	2010	2011	2012*	Mesatare**
500 €	317,200	342,000	425,000	345,400	287,385
200 €	158,100	186,000	214,000	174,100	175,487
100 €	1,334,400	1,415,000	1,650,000	1,651,700	1,315,664
50 €	3,875,100	4,283,000	5,027,000	4,784,400	3,549,810
20 €	2,553,700	2,633,000	2,774,000	3,301,200	2,001,450
10 €	2,447,800	2,453,000	2,494,000	3,238,900	1,857,830
5 €	1,246,000	1,329,000	1,293,000	1,248,800	1,043,161
Gjithsej copë	11,932,300	12,641,000	13,877,000	14,744,500	10,230,785
Gjithsej shuma	599,197,000	647,685,000	758,535,000	716,567,000	551,669,847
<i>Prej të cilave 500 EUR</i>	<i>158,600,000</i>	<i>171,000,000</i>	<i>212,500,000</i>	<i>172,700,000</i>	<i>143,692,600</i>
Raporti 500 EUR me totalin	26.47%	26.40%	28.01%	24.10%	25.98%

1432. Paragrafi (1) i nenit 22 të Ligjit për BQK-në përcakton që BQK-ja ka përgjegjësi ekskluzive për rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, kliringut dhe letrave me vlerë, siç përcaktohet më tutje me ligjet përkatëse. BQK-ja më tutje ka autorizimin të vendosë ndëshkime administrative sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për BQK-në. BQK-ja është gjithashtu e autorizuar të rregullojë dhe mbikëqyrë nxjerrjen dhe cilësinë e instrumenteve të pagesës.

1433. BQK-ja ka informuar që nuk ka strategji specifike të dokumentuar me plane për të zvogëluar përdorimin e parasë. Megjithatë, masa të ndryshme janë marrë dhe janë duke u marrë në këtë drejtim. Në fakt, aktualisht ekziston një projekt i planifikuar për ndërtimin e një sistemi pagesash. Në këtë drejtim, produktet për pagesat direkte do të vendosen, duke zvogëluar kështu nevojën për të kryer pagesat dhe faturat me para.

1434. Në fakt, përdorimi i kartelave debitorë dhe kreditorë gjithashtu po fiton dinamikë në Kosovë. BQK-ja ka ofruar statistikën në vijim për përdorimin e këtyre kartelave.

Tabela 20: Numri i kartelave kreditorë dhe debitorë në përdorim

Lloji	2009	2010	2011	2012 *
Kartela kreditorë	31,508	37,922	74,873	91,388
Kartelat debitorë	507,399	480,659	548,253	590,758

*Deri më 30 tetor 2012

1435. Një prej masave në përdorim të parave është përqindja e valutës në qarkullim në Bruto-Prodhimin Vendor. BQK-ja ka informuar që për tri vitet e kaluara, ky raport ka pasur trend në rritje, duke qëndruar tek shifra prej 18,8% më 2009; 19,9% më 2010 dhe 18,6% më 2011.

1436. Paragrafi (7) i nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat përcakton që: Çdo transaksion mbi pesëqind (500) euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitet ekonomik, pas 1 janarit të vitit 2009 kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare.

1437. Sipas paragrafit (1.26) i nenit 1 të Ligjit për Administratën Tatimore, termi ‘person’ përfshin personin fizik, personin juridik, partneritetin, si dhe grupimin apo shoqërinë e personave, duke përfshirë konzorciumet.

1438. Ligji për Administratën Tatimore më tutje përkufizon termin “aktivitet ekonomik”: çdo aktivitet të prodhuesve, tregtarëve ose personave që furnizojnë mallra dhe shërbime, duke përfshirë aktivitetet e minierave dhe ato bujqësore, si dhe aktivitetet e profesioneve. Eksploatimi në baza të vazhdueshme i pasurive të prekshme ose të pa prekshme me qëllim të sigurimit të të ardhurave në veçanti duhet të konsiderohet si një aktivitet ekonomik.

1439. Në vazhden e vizitës në terren, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka informuar që ka një sistem përmes të cilit mund të monitorojë të dhënat përkatëse për pagesat përtej 500 Eurove. Nëse vërehen shkeljet e kësaj kërkesë, zyrtarët e ATK-së vizitojnë bizneset në fjalë për të marrë më shumë informata. ATK-ja ka informuar që ka një vegël të analizës së riskut në këtë drejtim. Dështimi në respektim të këtyre dispozitave i nënshtrohet gjobave. ATK-ja ka mundësi të kërkojë dhe të marrë të dhëna nga gjitha autoritetet dhe institucionet që mund ta ndihmojnë në këtë proces. Gjitha entitetet janë të obliguara të raportojnë tek autoritetet tatimore secilën shitje apo blerje mbi 500 Euro që kryhen gjatë vitit të kaluar deri më 31 mars të vitit vijues. Mënyra në të cilën raportohet është e rregulluar për të pasur sistem

të unifikuar raportues. Kështu, ATK-ja ka mundësi të monitorojë ose në anën e blerësit apo atë të shitësit.

1440. Për më tepër, ATK-ja ka fuqi të ndalë kamionët bartës dhe të kontrollojë dokumente për pagesa, të cilat më vonë mund të krahasohen me transaksionet mes blerësit dhe shitësit. Një burim tjetër i kontrollimit të Raportimit është përmes formularëve të deklarimit të tatimit dhe deklaratat financiare dhe pasqyrat financiare të entiteteve në fjalë.

1441. Edhe pse nuk ka ndonjë strategji të dokumentuar me plane për të zvogëluar përdorimin e parasë, masa të ndryshme janë marrë apo janë duke u marrë në lidhje me këtë synim. Pa anashkaluar këto, informatat e dhëna dhe statistikat kohë pas kohe janë në konflikt, si dhe nuk e tregojnë këtë objektiv. BQK-ja pra ndoshta duhet të dokumentojë planet e veta për teknikat për menaxhim më të mirë të parasë, duke vendosur synimet dhe arritjet që duhen bërë.

1442. Statistikat e dhëna nga BQK-ja mbi tërheqjen dhe lëshimin e bankënotave tregojnë që më shumë bankënota (me numër e vlerë) depozitohen, duke zvogëluar kështu qarkullimin, sesa shumën e bankënotave që lëshohen nga BQK-ja në qarkullim. Kështu për shembull, më 2012, shifra në vlerën prej 259 milionë euro janë lëshuar, duke rritur qarkullimin, derisa shifra në vlerën prej 716.6 milionë euro është depozituar, duke zvogëluar kështu qarkullimin.

1443. Për më tepër, fokusimi tek bankënota prej €500 tregon që ka kërkesë të madhe për këtë prerje. Ngjashëm, statistikat tregojnë që më shumë prerje prej €500 depozitohen në BQK sesa që lëshohen në qarkullim. Kështu, derisa më 2012, BQK-ja ka lëshuar 6.8 milionë Euro në prerje prej €500, janë depozituar 172.7 milionë euro.

1444. Pavarësisht nga elementet pozitive të reduktimit të qarkullimit të valutës, këto statistika pra ngrenë disa brenga. Së pari për dallimin mes shumave të larta të depozituara dhe shumave të lëshuara. Së dyti, për përdorimin e madh të prerjeve 500-she, përkundër ndalesave në Ligjin për Administratën Tatimore për kryerjen e transaksioneve në kesh që tejkalojnë shumën prej €500.

1445. Derisa pranohet që me përdorimin e Euros si valutë, valuta në qarkullim mund të rritet nga paratë që vijnë në Kosovë nga udhëtarët *bona fide*, shumat janë tejet të larta, si dhe rrisin brengën e parasë që vjen prej kufijve dhe futet në sistemin bankar të Kosovës. Rekomandohet pra që BQK-ja të koordinojë dhe të ndërmarrë një studim për këto statistika, për të identifikuar burimin e këtyre dallimeve, me ndihmën e autoriteteve tjera, si Doganat dhe ATK-ja.

1446. Dallimi në valutën në qarkullim do të mund të vërtetonte informatat në dispozicion që përmasat e ekonomisë së zezë në Kosovë janë mjaft të mëdha – *Më 2007, përmasat e ekonomisë së zezë gjatë periudhës 2004-2006 janë vlerësuar të shkojnë mbi 300 milionë euro në Kosovë. Ekonomia e bazuar në kesh e bën Kosovën të cënueshme ndaj aktiviteteve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.*¹⁵² *Ekonomia e Kosovës, sidomos sektori privat, është i bazuar në kesh, kështu që të ardhurat nga aktivitetet kriminale janë më të lehta të pastrohen përmes tregut të zi, mallrave të kontrabanduara, si duhani, bizhuteria, kaffja, alkoholi dhe telefonat mobilë.*¹⁵³ *Kosova ka një treg të zi aktiv për mallra të kontrabanduara të konsumit dhe produkteve pirate.*

¹⁵² https://ritdml.rit.edu/bitstream/handle/1850/13011/BesartQerimi_CapstoneProject_Report_11-162010.pdf?sequence=6

¹⁵³ *Ibid.* p.44.

1447. Gjithashtu rekomandohet që ATK-ja të sigurojë efektshmërinë e monitorimit të ndalimit të pagesave në kesh që tejkalojnë shifrën prej 500 Eurosh, pasi që statistikat e tregojnë të kundërtën.

1448. Statistikat për përqindjen e valutës në qarkullim në raport me Bruto-Prodhimin Vendor tregojnë pozita të larta të cilat duhet të adresohen më tutje në kuptimin e ekonomisë tejet të bazuar në para në Kosovë.

1449. Përpjekjet e BQK-së për të vendosur sistemin e pagesave dhe për të ofruar produkte për pagesa direkte përmes sistemit bankar janë të mirëpritura dhe tregojnë një lëvizje pozitive kah qëllimi i zvogëlimit të përdorimit të keshit. Është me rëndësi që produktet e tilla të mundësojnë debi dhe kredi direkte. I ngjashëm është trendi në rritje i përdorimit të kartelave debi dhe kredi, gjë që mund të jetë indikacion i një përdorimi më të madh të sistemit bankar.

1450. Pa anashkaluar këto, në vazhden e vizitës në terren, janë dhënë informata që mundësitë e tilla nuk ofrohen, si dhe transferimi i parave nga një bankë në tjetrën kërkon tërheqjen e parave nga një bankë, si dhe depozitim fizik në tjetrën.

Efektshmëria për Rekomandimin 20

1451. Statistikat e dhëna nga BQK-ja për çështjen e valutës në qarkullim krijojnë brenga serioze për efektshmërinë e masave që merren nga vetë BQK-ja dhe autoritetet tjera, si ATK-ja dhe Doganat, për monitorimin dhe zvogëlimin e përdorimit të parasë në një sistem, që është relativisht shumë i bazuar në para, si dhe në lëvizjen e parasë mes kufijve.

3.13.2. Rekomandimet dhe komentet

1452. Në përmbledhje, duke iu referuar Rekomandimit 20, ky Raport shpreh brengën që:

- Edhe pse ka punë në vazhdim e sipër, BQK-ja nuk ka hartuar një strategji të dokumentuar, me qëllime e synime, për zvogëlimin e përdorimit të parasë;
- Ka përdorim të gjerë e të lartë të bankënotave me prerje të mëdha, që është indikacion i një ekonomie tejet të bazuar në para;
- Statistikat mbi valutën e lëshuar dhe të depozituar janë në mospërputhje, si dhe mund të jenë indikacion i importit të mundshëm të valutës përtej kufijve;
- Mungesa e procedurave të debitimit dhe kreditimit direkt në sistemin bankar;
- Efektshmëria e implementimit të nenit 13 të Ligjit nga Administrata Tatimore.

1453. Me qëllim të përmirësimit të sistemit për teknika më të mira të menaxhimit të parasë, ky Raport rekomandon që

- BQK-ja të dokumentojë strategjinë e saj për teknika të menaxhimit më të mirë të keshit, me qëllime e synime të arritshme, duke përfshirë ndërtimin e sistemit të debitimit dhe kreditimit direkt;
- BQK-ja të bashkërendojë një studim mbi statistikat e valutës së lëshuar dhe valutës së depozituar, për të identifikuar burimin e këtyre dallimeve në bashkëpunim me autoritetet tjera, si Doganat dhe Administrata Tatimore;
- Ky studim gjithashtu duhet të gjejë arsyet për përdorimin e madh të bankënotave me prerje €500;
- Sigurimi i efektshmërisë së zbatimit të nenit 13 të Ligjit për Administratën Tatimore nga Administrata Tatimore.

3.13.3. Klasifikimi për Rekomandimin 20

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
Rek 20 KTh 20.2	MP	<ul style="list-style-type: none">• Nuk ka strategji të dokumentuar me synime e qëllime për zvogëlimin e përdorimit të parasë;• Përdorimi i gjerë i bankënotave me prerje të mëdha;• Nuk ka mundësi për debitim dhe kreditim direkt përmes sistemit bankar;• Konfliktet në statistika mbi valutën e lëshuar dhe valutën e depozituar, si dhe• Mungesa e dukshme e efektshmërisë në monitorimin e përputhshmërisë me dispozitën e nenit 13 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe lëvizjen e valutës mes kufijve.

4. PERSONAT JURIDIKË – QASJA NË INFORMATAT MBI PRONËSINË PËRFITUESE DHE KONTROLLIN (R.33)

Korniza ligjore

- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Ligji nr. 03/L-196 i datës 30.09.2010), më tutje në tekst: LPP/LFT.
- Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123, i datës 27.09.2007).
- Ligji për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 04/L-006, i datës 23.06.2011).

4.1. Përshkrimi dhe Analiza

1454. Ligji për Shoqëritë Tregtare ka hyrë në fuqi më 27 shtator 2007. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/6 e datës 8 shkurt 2001 për Shoqëritë Tregtare dhe Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2002/22 e datës 11 tetor 2002 për zbatimin e Rregullores 2001/6 për Shoqëritë Tregtare, të dyja janë shfuqizuar.

1455. Ligji për ndryshimin/plotësimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare ka hyrë në fuqi më 23 qershor 2011. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, janë shfuqizuar Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/26 e 27 majit 2008 për Shpalljen e Ligjit për Shoqëri Tregtare, Rregullorja e UNMIK-ut Nr.2001/6, Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2002/22 dhe Urdhëresa Administrative Nr.2003/1.

1456. Analiza, komentet dhe rekomandimet në vijim pra do të bazohen në Ligjin për Shoqëritë Tregtare të ndryshuar, informatat e dhëna në përgjigjet ndaj Pyetësorit, si dhe informatat dhe dokumentet tjera të siguruar gjatë vizitës në terren, në vazhden e diskutimeve me autoritetet përkatëse.

1457. Për një pasqyrë më të hollësishme të kornizës së personave juridikë në ligjet e lartpërmendura, duke përfshirë llojet e personave juridikë, si dhe procesin e regjistrimit, bashkë me dokumentet e nevojshme, ju lutemi t'i referoheni nenit 1.5 të këtij Raporti.

Informatat për pronësinë përfituese dhe kontrollin – Kriteri Thelbësor 33.1

1458. KTh 33.1 kërkon nga vendet të marrin masa për të parandaluar përdorimin e paligjshëm të personave juridikë në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duke siguruar që ligjet komerciale, korporatave dhe të tjera kërkojnë transparencë adekuate në lidhje me pronësinë përfituese dhe kontrollin e personave juridikë.

1459. Metodologjia FATF përcakton tri lloje mekanizmash që janë të pranueshme për qëllimet e KTh 33.1 ose individualisht ose në kombinim për shkak të shkallës së tyre të plotësueshmërisë:

- Sistemi i zbulimit paraprak përmes një sistemi vendor që regjistron hollësitë e nevojshme të pronësisë dhe kontrollit;
- Përmes mbajtjes së informatave të kërkuara nga ofruesit e shërbimeve të kompanive; ose
- Përmes mbështetjes së autorizimeve hetimore të autoriteteve të zbatimit të ligjit, rregullative, mbikëqyrëse apo të tjera për të siguruar apo për të pasur qasje në këto informata.

1460. Çfarëdo sistemi që përdoret, KTh 33.1 kërkon tri elemente thelbësore:

- Qasja me kohë nga autoritetet kompetente ndaj pronësisë përfituese dhe kontrollit;
- Disponueshmëria e informatave adekuate, të sakta dhe me kohë; dhe
- Aftësia e autoriteteve kompetente për të ndarë informata të tilla me autoritetet kompetente relevante vendore apo të huaja.

1461. Kosova aplikon një sistem paraprak përmes sistemit të regjistrimit të biznesit, të rregulluar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

1462. ARBK-ja është autoriteti kompetent sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare që është përgjegjës për regjistrimin e gjitha entiteteve afariste sipas ligjit.¹⁵⁴ ARBK-ja është pjesë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe udhëhiqet nga një shërbyes i lartë civil, i cili quhet “Drejtor”, që sipas nenit 9 të Ligjit, duhet të ushtrojë funksionet e tij në mënyrë të pavarur pa ndonjë ndikim politik apo të paligjshëm.

1463. Sipas nenit 7 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, ARBK-ja është kryesisht përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe shoqëritë e huaja afariste, në pajtim me dispozitat dhe kërkesat e Ligjit. Agjencia megjithatë ka autoritetin dhe përgjegjësitë për të kryer funksionet tjera që janë të destinuara në mënyrë specifike dhe eksplicite për të sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

1464. Për më tepër, neni 11 i Ligjit kërkon që secila kompani që regjistrohet, ARBK-ja duhet të publikojë në një faqe të qasshme publike gjitha informatat relevante, si dhe ndryshimet e mundshme ndaj tyre, një muaj pas regjistrimit të kompanisë apo ndryshimit të tillë të informatave.

1465. Në kuptimin e nenit 13 të Ligjit, secila shoqëri tregtare ka obligim të vazhdueshëm të sigurojë që gjitha informatat e përcaktuara në dokumentet e saj të regjistruara të jenë të sakta dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Në anën tjetër, Agjencia është rreptësisht e obliguar të regjistrojë formalisht dhe zyrtarisht një dokument që i dorëzohet nëse ai dokument është në përputhje me kërkesat e përcaktuara me Ligj.

1466. ARBK-ja ka për obligim ligjor që të shënojë datën dhe kohën e pranimit të secilit dokument që dorëzohet për regjistrim, si dhe të ofrojë, në bazë të kërkesës, vërtetimin për regjistrimin e tillë për personin që dorëzon dokumente. Neni 14 i Ligjit më tutje obligon ARBK-në që të regjistrojë formalisht dhe zyrtarisht dokumentet e tilla brenda tri (3) ditësh kalendarike pas ditës së pranimit të dokumentit, nëse dokumenti i pranuar përmbush kërkesat e Ligjit.¹⁵⁵

1467. Në kuptimin e nenit 15 të Ligjit, fakti që një dokument është regjistruar është vetëm akt informues dhe administrativ. ARBK-ja nuk është e obliguar të verifikojë informatat që ofrohen në ndonjë dokument regjistrimi. Ligji ia mvesh përgjegjësinë për saktësinë e informatave në gjitha dokumentet e regjistrimit personit që nënshkruan atë dokument. Në fakt, regjistrimi i një dokumenti nuk përbën asnjë lloj të përcaktimit apo prezumimit ligjor për vlefshmërinë e dokumentit, apo që informatat në atë dokument janë të sakta apo të pasakta.

1468. Kopjet origjinale të shënimeve dhe dokumenteve të pranuar apo regjistruara duhen ruajtur vazhdimisht në formë fizike dhe elektronike.

¹⁵⁴ Më parë i njohur si Regjistri i Shoqërive Tregtare dhe Markave Tregtare të Kosovës

¹⁵⁵ Sipas ndryshimeve të fundit nga dhjetë (10) ditët kalendarike më parë.

1469. Neni 23 i Ligjit kërkon që secila shoqëri tregtare të specifikojë adresën e vet fizike të regjistruar në Kosovë, si dhe emrin e agjentit të saj, duke qenë personi që ka vendin primar të punës apo banimit në atë adresë.

1470. Në rastin e shoqërive aksionare dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, Ligji kërkon që ndryshimet në informatat e dhëna në një statut të regjistruar të shoqërive aksionare dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuar t'i raportohet ARBK-së.

1471. Për më tepër, neni 42 i Ligjit obligon secilën shoqëri tregtare që të dorëzojë një raport vjetor tek Drejtori i Agjencisë, i cili, në rastin e shoqërive aksionare dhe shoqërive me përgjegjësi të kufizuar përfshin detajet e emrave dhe adresave të (i) bordit të drejtorëve dhe (ii) gjithë aksionarëve dhe (iii) personave të autorizuar (si dhe kufizimeve të autorizimeve të tilla). Mosregjistrimi i Raportit vjetor mund të çojë tek çregjistrimi.

1472. Sipas nenit 78, interesi pronësor në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mundet, por nuk duhet, të evidentohet me një vërtetim, si dhe mund të quhet edhe “aksion”. Statuti apo marrëveshja e kompanisë mund të përcaktojë që interesat pronësorë apo aksionet në kompani do të evidentohen me certifikata të lëshuara nga kompania. Transferimi i pronësisë mes pronarëve aktualë rregullohet ngushtë me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

1473. Në anën tjetër, sipas nenit 126 të Ligjit, aksionet në një shoqëri aksionare janë njësi në të cilat ndahen interesat pronësorë në kompani, si dhe janë prona e aksionarit, si dhe mund të barten lirisht, plotësisht apo pjesërisht, nga aksionari tek cilido person apo organizatë. Shoqëria aksionare mund të ketë një apo më shumë persona, shoqëri tregtare dhe/ose organizata tjera si aksionar apo aksionarë. Shoqëria aksionare gjithashtu është e obliguar të mbajë një listë të përditësuar të aksionarëve të saj.

1474. Sipas paragrafit (5) të nenit 141, Shoqëria aksionare nuk është e autorizuar që të emetojë, dhe nuk do të emetojë, aksione në prurësin ose letra me vlerë në prurësin. Të gjitha aksionet ose letrat me vlerë të emetuara në kundërshtim me këtë nen, si dhe të gjitha të drejtat apo pretendimet që rrjedhin si pasojë e këtyre aksioneve ose letrave me vlerë do të jenë nule, të pavlefshme dhe të pazbatueshme.

1475. Në praktikë, ARBK-ja synon të ofrojë “një vend për gjitha (one stop shop)” për regjistrimin e bizneseve. Në këtë drejtim, Agjencia funksionon me 28 Qendra Komunale. Gjitha qendrat kontrollojnë dokumentet dhe kontrollojnë aspektet e tyre juridike. Nëse gjitha dokumentet janë korrekte, ato mund të miratojnë dhe t'i japin atyre një numër regjistrimi. Në të ardhmen e afërt, përveç numrit të regjistrimit, Qendrat do të jenë në gjendje t'i japin entitetit afarist numrin tatimor, si dhe numrat e TVSH-së dhe Doganave. Gjitha sistemet janë të ndërlidhura, pra Agjencia mund të jetë një “vend për të gjitha” për gjitha regjistrimin e bizneseve. Ekziston një regjistër kryesor për gjitha bizneset e regjistruara, si dhe që është në dispozicion të publikut për informim.¹⁵⁶

1476. ARBK-ja ka rreth 16 zyrtarë dhe personel tjetër në Qendra. Secili zyrtar ka një Kod identifikues unik që është i lidhur me gjitha regjistrimet që ai/ajo bën. Kështu, në mënyrë elektronike, Agjencia mund të përcjellë procesin e regjistrimit deri tek zyrtari përgjegjës për regjistrimin e atij biznesi. Personeli përfshin edhe personat në TI, që janë përgjegjës për sistemet elektronike që lidhin Qendrat me Zyrën Qendrore. ARBK-ja është e mendimit që sistemi aktual elektronik është adekuat, si dhe shërben mirë për operacionet e veta.

¹⁵⁶ Regjistri i bizneseve, i mbajtur nga ARBK-ja, është i ndarë nga Regjistri i OJQ-ve, që mbahet nga DRNOJQ-ja (seksioni 5), si dhe Regjistri i Bankave dhe Institucioneve Financiare, që mbahet nga BQK-ja (seksioni 3).

1477. Nuk ka nevojë për ndërmjetës (avokatë, kontabilistë, etj.) që të regjistrojnë biznesin. Gjithë formularët e regjistrimit gjenden në internet, derisa vetë regjistrimi mund të bëhet në internet.

1478. Sistemi i regjistrimit për shoqëri tregtare duket adekuat, edhe pse disa dobësi mund të identifikohen kryesisht në lidhje me mirëmbajtjen dhe përditësimin e informatave, si dhe informatave në lidhje me pronësinë përfituese.

1479. Në rastin e shoqërive aksionare dhe atyre me përgjegjësi të kufizuar, edhe pse Ligj kërkon që të gjitha ndryshimet e informatave të dhëna në dokumentin regjistruar të shoqërive aksionare dhe atyre me përgjegjësi të kufizuar t'i raportohet ARBK-së, si dhe pa anashkaluar obligimin e shoqërive aksionare që të ruajnë listën e aksionarëve, nuk ka obligim direkt që të informohet menjëherë ARBK-ja për ndryshimet e aksionarëve.

1480. Në fakt, ARBK-ja ka informuar që për të marrë informata të tilla më herët sesa Raporti vjetor, vetë Agjencia insiston tek shoqëritë tregtare që të emërojnë një person me përgjegjësinë për të informuar Agjencinë menjëherë për ndryshimet e tilla.

1481. Edhe saktësia e informatave në dispozicion mund të vihet në pyetje, për shkak të dispozitave në Ligj që regjistrimi i një dokumenti nuk përbën asnjë lloj përcaktimi apo prezumimi të vlefshmërisë së dokumentit, apo faktit nëse ndonjë informatë aty është e saktë apo e pasaktë. Pra, ekziston mungesë e kujdesit të duhur së paku tek themeluesit e një shoqërie tregtare.

1482. Emërimi i një "agjenti" që përfaqëson kompaninë në adresën e saj të regjistrimit jo detyrimisht do të thotë që një "kompani guaskë" nuk mund të regjistrohet me aksione korporate apo trusti.

1483. Për më tepër, duket që sistemi nuk ofron mundësinë që ARBK-ja apo ndonjë person apo autoritet tjetër të identifikojë nëse një numër shoqëri tregtare i përkasin të njëjtit individ. Megjithatë, autoritetet kanë informuar se një mundësi e tillë ekziston për ATK vetëm përmes numrit të regjistrimit tatimor.

1484. Për më tepër, gjithashtu duket që sistemi nuk identifikon ndërlidhjet mes shoqërive tregtare ku, përmes shtresimit të pronësisë, disa kompani mund të jenë pronare të kompanive tjera.

1485. Këto mangësi mund të ketë ndikim negativ në identifikimin e pronarit përfitues përmes shtresave të aksioneve në korporata.

1486. Ligji për ndryshimin/plotësimin e Ligjit për Shoqëri Tregtare ka zvogëluar periudhën e regjistrimit në tri (3) ditë kalendarike, nga afati dhjetëditor i kaluar. Gjithashtu ka zvogëluar kapitalin themeltar për regjistrim të shoqërive aksionare nga 25,000 në 10,000 euro. Për më tepër, kapitali i mëparshëm minimal themelues për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar prej 1,000 Euro është hequr, që do të thotë se në thelb, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen pa kapital.

1487. Edhe pse nga një këndvështrim ekonomik, ndryshimet si më lart mund të kenë kontribut pozitiv, nga këndvështrimi LPP/LFT, ato mund të krijojnë brenga, pasi që e bëjnë regjistrimin e subjekteve afariste më të lehtë, përveç nëse monitorohet afërsisht në fazën e regjistrimit, duke marrë parasysh mungesën e kujdesit të duhur.

1488. Në dritën e gjetjeve si më lart, edhe pse nuk mund të bëhen rekomandime specifike për ndryshimet legjislative apo të tjera, është tejet e këshillueshme që ARBK-ja të shënojë të

dhënat dhe të shqyrtojë procedurat e autorizimet e veta për të marrë masa në korrigjim të gjetjeve të bëra:

- Vendosija e obligimit për Raportim të menjëhershëm të ndryshimeve në aksione dhe drejtorë përtej emërimit *ad hoc* të një personi përgjegjës për ta bërë këtë;
- Vendosija e procedurave dhe sistemeve për autoritetet kompetente dhe industrinë për të identifikuar ku një person është pronar i më shumë se një shoqërie tregtare;
- Vendosija e procedurës administrative për të vërtetuar deri në masën e mundshme saktësinë e dokumenteve dhe integritetin e përmbajtjes – për shembull duke kontrolluar themeluesit tek listat e Kombeve të Bashkuara dhe listave tjera për persona të përcaktuar e entitete;
- Vendosija e procedurave për të verifikuar ndërlidhjen mes shoqërive tregtare;
- Vendosija e masave më të forta për saktësi dhe vlefshmëri të kërkesave për regjistrim për të mbuluar periudhën e shkurtër të regjistrimit dhe kapitalit të nevojshëm e të zvogëluar.

Qasja me kohë në informata – Kriteri Thelbësor 33.2

1489. KTh 33.2 kërkon që autoritetet kompetente të jenë në gjendje të sigurojnë apo të kenë qasje, me kohë, në informata adekuate, të sakta dhe të përditësuara për pronarin përfitues dhe kontrollin e personave juridikë.

1490. Neni 10 i Ligjit për Shoqëri Tregtare përcakton që gjitha dosjet, dokumentet, parashtrësas, formularët, rregullat, si dhe materialet tjera që kërkohen me Ligj që t'i dorëzohen ARBK-së ose të përgatitura nga ARBK-ja në lidhje me operacionet apo procedurat ose me ndonjë shoqëri tregtare, janë pa përjashtim dokumente publike, si dhe duhet të jenë vazhdimisht në dispozicion të cilitdo person, sipas kërkesës së atij personi, për shikim dhe kopjim. Në këtë drejtim, Agjencia i shënon ato kopje të kërkuara nga eprsoant si “kopje të vërtetuara”.

1491. Për më tepër, neni 11 i Ligjit kërkon që për secilën kompani që regjistrohet, ARBK-ja të publikojë në një faqe publikisht të qasshme informatat në vijim, apo ndryshimet në këto informata, një muaj pas regjistrimit të asaj kompanie apo ndryshimeve të atyre informatave:

- Emri i kompanisë;
- Lloji i kompanisë (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare);
- Adresa e zyrës së regjistruar të kompanisë dhe emri i agjentit të regjistruar të kompanisë në atë adresë;
- Përshkrimi i shkurtër i qëllimit afarist apo qëllimeve të kompanisë, qëllime të cilat thjesht mund të përshkruhen “qëllim për t'u angazhuar në aktivitete të ligjshme afariste”;
- Emri dhe adresa e secilit themelues;
- Emrat e drejtorëve dhe personave të autorizuar, si dhe, nëse specifikohet në dokumentet e regjistrimit të kompanisë, kufizimet e autoriteteve të tyre;
- Kohëzgjatja e kompanisë, nëse nuk është e përhershme; dhe
- Kapitali themeltar i kompanisë.

1492. Qasja në këto informata është e hapur për publikun në përgjithësi përmes faqes së internetit të Agjencisë. Për t'u qasur në këto të dhëna, personi duhet të ketë informata qoftë për numrin e regjistrimit të biznesit, emrin e biznesit, numrin identifikues të personit të

autorizuar, numrin identifikues personal të pronarit, aktivitetin kryesor ashtu edhe për veprimtari tjera.

1493. Me regjistrimin e një shoqërie tregtare, ARBK-ja informon autoritetet tjera, si Administrata Tatimore, Doganat, Entin Statistikor, administratat komunale, e të tjera. Në fakt, disa autoritete si Policia e Kosovës dhe Administrata Tatimore kanë konfirmuar pranimin e informatave dhe qasjen në informata që mbahen nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit të Kosovës.

1494. Duket se ndryshimet në pronësinë e aksioneve raportohen vetëm përmes obligimit të raportimit vjetor. Njëjtë, ndryshimet në drejtor i komunikohën ARBK-s përmes raporteve vjetore. Kështu që kalon njëfarë kohe kur informacioni i disponueshëm mund të mos jetë në kohë dhe i saktë.

1495. Për më tepër, kërkesat në nenin 11 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare për gjitha informatat e regjistrimit apo ndryshimet në to që mund të vihen në faqe të internetit “brenda një muaji” krijon brengën e “përditësimit” të informatave në dispozicion, edhe pse në praktikë, Agjencia thekson të marrë më pak kohë.

1496. Në dritën e këtyre gjetjeve, edhe pse nuk mund të bëhen rekomandime specifike për ndryshime legjislative apo të tjera, është tejet e këshillueshme që ARBK-ja të shënojë sipas nevojës dhe të rishikojë procedurat e autorizimit e saj për të marrë masa në korrigjim të këtyre gjetjeve, duke marrë parasysh rekomandimet e dhëna tek ky seksion si më lart.

Efektshmëria për Rekomandimin 33

1497. Qëndrueshmëria e regjimit të regjistrimit të kompanive ndikohet negativisht nga mangësitë e identifikuara, të cilat ndikojnë në efektshmërinë e tij dhe informatat e pronësisë përfituese. Në veçanti janë dobësitë në sistem në lidhje me kujdesin e duhur për themeluesit dhe aksionarët kryesorë, si dhe rrjedhimisht edhe saktësinë e informatave, si dhe mungesa e mundësive për të identifikuar ndërlidhjet ndërmjet kompanive dhe pronësisë së ndarë të aksionarëve të njëjtë.

4.2. Rekomandimet dhe Komentet

1498. Edhe pse korniza legjislative deri në një masë është adekuate për regjistrimin e shoqërive tregtare, disa gjetje, të natyrës legjislative dhe procedurale/operacionale, ndikojnë në kërkesat e Rekomandimit 33 në kontekstin e analizës së këtij raporti.

1499. Me leximin e plotë të analizës dhe komenteve që rekomandohen fuqimisht, në vijim janë gjetjet kryesore:

- Nuk ka obligim direkt për të informuar ARBK-në për ndërrimet në aksionarë dhe drejtorë menjëherë pas ngjarjes së tyre;
- Brengat për saktësinë e informatave në dispozicion;
- Brengat për afatshmërinë e informatave në dispozicion të autoriteteve kompetente;
- Mungesa e procedurave për autoritetet kompetente përveç ATK për identifikimin nëse një numër shoqëriish tregtare i përket të njëjtit individ;
- Mungesa e procedurave për autoritetet kompetente për identifikimin e ndërlidhjeve mes shoqërive tregtare ku, përmes shtresave të pronësisë, disa kompani mund të jenë pronare të tjerave; si dhe

- Brengat për lehtësinë e regjistrimit.

1500. Në prizmin e këtyre gjetjeve, Raporti ofron disa rekomandime, edhe pse jo në kuptimin e veçantë të ndryshimeve legislative. Megjithatë, është me rëndësi që rekomandimet të lexohen në kontekstin e analizës dhe komenteve për Kriterin Thelbësor përkatës:

- Vendosja e obligimit për Raportim të menjëhershëm të ndryshimeve në aksionarë dhe drejtor, përtej emërimit ad hoc të një personi përgjegjës për këtë;
- Vendosja e procedurave dhe sistemeve për autoritetet kompetente dhe industrinë e sektorit për të identifikuar nëse një person është pronar i më shumë se një shoqërie tregtare;
- Vendosja e procedurave administrative për të vërtetuar deri në masë të mundshme saktësinë e dokumenteve dhe përmbajtjes nga ARBK-ja, për të siguruar që personat fizikë dhe juridikë që themelojnë kompani të kontrollohen e monitorohen në kuptimin e dosjeve të mundshme penale apo diskualifikimeve profesionale, por edhe në listën e Kombeve të Bashkuara dhe listat e tjera për persona të përcaktuar dhe entitete;
- Vendosja e procedurave për të identifikuar ndërlidhjen mes shoqërive tregtare të regjistruara;
- Vendosja e masave për saktësi dhe vlefshmëri të kërkesave për regjistrim, për të mbuluar periudhën e shkurtër të regjistrimit.

4.3. Klasifikimi për Rekomandimin 33

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
Rec 33	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka obligim direkt për të informuar ARBK-në për ndryshimet në aksionarë apo drejtorë menjëherë pasi të bëhen; • Brengat për saktësinë dhe afatshmërinë e informatave në dispozicion; • Brengat për kujdesin e duhur për themelues dhe aksionarë kryesorë; • Brengat për afatshmërinë e informatave në dispozicion për autoritetet kompetente; • Mungesa e procedurave për autoritetet kompetente përveç ATK, për identifikimin nëse një numër shoqëriish tregtare i përkasin të njëjtit individ; • Mungesa e procedurave për autoritetet kompetente për identifikimin e ndërlidhjeve mes shoqërive tregtare ku, përmes shtresave të pronësisë, disa kompani mund të jenë pronare të tjetrës; • Brengat për lehtësinë e regjistrimit; si dhe • Çështjet rezultuese të efektshmërisë.

5. ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE¹⁵⁷ (RV.VIII)

Korniza ligjore

- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (Ligji nr. 03/L-196 i datës 30.09.2010), më tutje në tekst: LPP/LFT
- Ligji për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare (Ligji nr. 04-L-057 i datës 29.08.2011), më tutje në tekst Ligji për OJQ-të.

5.1. Përshkrimi dhe Analiza

1501. RV VIII kërkon nga vendet të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me subjektet që mund të keqpërdoren për financim të terrorizmit. OJF-të (nganjëherë të quajtura edhe OJQ) janë veçanërisht të cenueshme, si dhe vendet duhet të marrin masa për të siguruar që ato të mos mund të keqpërdoren apo abuzohen për qëllime të tilla kriminale. Masat e tilla përcaktohen hollësisht me Kriteret Thelbësore në Metodologjinë FATF, ashtu siç edhe janë analizuar në paragrafët në vijim.

1502. Në këtë kuptim, FATF ka botuar një Shënim Interpretimi për RV VIII, plotësuar me Praktikat më të Mira Ndërkombëtare për luftimin e keqpërdorimit të OJF-ve.

1503. Sipas nenit 1 të Ligjit për OJQ-të, që përcakton qëllimin dhe fushëveprimin e ligjit, Ligji për OJQ-të definon themelimin, regjistrimin, menaxhimin e brendshëm, veprimtarinë, shpërbërjen dhe shlyerjen nga regjistri të personave juridikë të organizuar si OJQ në Kosovë. Megjithatë, Ligji nuk vlen për partitë politike, sindikatat dhe organizatat sindikale, si dhe qendrat apo tempujt fetarë dhe fushat tjera që rregullohen me ligje të veçanta.

1504. Ligji për OJQ-të definon OJQ-në vendore si shoqatë (organizatë që ka anëtarësi) ose fondacion (organizatë pa anëtarësi) të themeluar në Kosovë, për arritjen e qëllimeve në bazë të ligjit, për dobi publike apo interes të ndërsjellë.

1505. Në anën tjetër, Ligji definon OJQ-në e huaj apo ndërkombëtare si person juridik të themeluar jashtë Kosovës, me legjislacion që në substancë përmbush kërkesat e nenit 4 të Ligjit për OJQ-të – i cili merret me mosshpërndarjen e të ardhurave.

1506. Në kuptimin e nenit 17 të Ligjit për OJQ-të, OJQ-ja e regjistruar sipas ligjit mund të aplikojë për status të Përfituesit Publik nëse është e organizuar dhe vepron për të kryer një apo më shumë veprimtari kryesore si në vijim: ndihmë dhe përkrahje humanitare, përkrahje personave me aftësi të kufizuara, aktivitete bamirëse, arsim, shëndetësi, kulturë, ruajtje dhe përparim të mjedisit, rindërtim dhe zhvillim ekonomik, mbrojtje dhe përparim të të drejtave të njeriut, mbështetje të praktikave demokratike dhe shoqërisë civile, apo çfarëdo veprimtarie tjetër që është në funksion të së mirës së publikut. Sipas Ligjit, OJQ-të me status të përfituesit publik gëzojnë lirime tatimore e fiskale, përveç atyre që janë thjesht detyrime për shërbime publike komunale.

1507. Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të (më tutje: DRNOJQ) në Ministrinë e Administratës Publike është autoriteti kompetent për zbatimin e Ligjit për OJQ-të, duke përfshirë regjistrimin.

¹⁵⁷ Pasi që legjislacioni dhe dokumentet e tjera për Kosovën u referohen “organizatave joqeveritare” (OJQ) ky term do të përdoret në këtë pjesë, si dhe duhet lexuar dhe kuptuar si referencë ndaj “organizatave jofitimprurëse” (OJF) sipas Standardeve dhe Metodologjisë FATF.

1508. Departamenti ka 11 punëtorë të ndarë në dy divizione. Njëri divizion është përgjegjës për regjistrime, ndërsa tjetri për shqyrtim të raporteve dhe analiza financiare. DRNOJQ-ja beson që resurset aktuale janë të kënaqshme për mandatin e tij ligjor.

1509. Analiza, komentet dhe rekomandimet vijuese pra do të bazohen në Ligjin për OJQ-të, informatat e dhëna në përgjigje në Pyetësor, si dhe informatat e dokumentet tjera që janë siguruar gjatë dhe pas vizitës në terren, në vazhden e diskutimeve me autoritetet relevante.

Shqyrtimi i përshtatshmërisë së ligjeve e rregulloreve vendore për OJQ-të – Kriteri thelbësor RV VIII.1

1510. KTh RV VIII.1 kërkon nga vendet të rishikojnë përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me OJQ-të si dhe të vlerësojnë cenueshmërinë e OJQ-ve që mund të keqpërdoren për financim të terrorizmit.

1511. DRNOJQ-ja ka informuar që kryen funksionet në pajtim me Ligjin për OJQ-të, derisa çështja e kompetencave për regjistrim dhe ndërlidhje ka mandat të kufizuar. Që prej përfundimit të luftës, regjistrimi i OJQ-ve për herë të parë është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/22, si dhe më vonë me ligjin e miratuar si Ligji nr. 03/L-134 më 2009. Më vonë, është vërejtur që Ligji kishte disa mangësi dhe duhej ndryshuar. Vijimisht, më 29 gusht 2011, u miratuar Ligji i ri 04/L-057. Që prej atëherë, është miratuar një Rregullore për përputhshmëri nga Qeveria, derisa Rregullorja për regjistrim duhet miratuar së shpejti¹⁵⁸. DRNOJQ-ja ka informuar që palët e shoqërisë civile janë angazhuar në hartimin e ligjit të ri. DRNOJQ vepron vetëm brenda dispozitave të Ligjit për OJQ-të dhe Rregullores. Ligji përcakton procedurat për regjistrim, duke përfshirë strukturat e brendshme dhe dhënien e statusit të përfituesit publik, pra DRNOJQ nuk merr përgjegjësi të tjera që nuk i mvishen me ligj. Gjitha OJQ-të e regjistruara duhet të respektojnë Ligjin dhe ligjet tjera që vlejné për to.

1512. Sipas DRNOJQ-së, ndryshimet në ligj janë iniciuar kryesisht për mungesën e dispozitave kundër OJQ-ve që dështonin të raportonin sipas Ligjit. Kjo kryesisht ndodhte për shkak të ndërlidhjes së dobët të paragrafëve apo neneve në Ligjin e vjetër që nuk ekzistonin, apo kishin referenca të gabueshme.¹⁵⁹

1513. Që prej 1999-ës, 6,926 OJQ janë regjistruar, prej të cilave 6,428 janë vendore, ndërsa të tjerat ndërkombëtare. Deri në kohën e hartimit të këtij Raporti, 88 OJQ pushuan së ekzistuari.

1514. DRNOJQ nuk është në gjendje të tregojë rrezikun dhe cenueshmërinë ndaj rrezikut të financimit të terrorizmit ndaj të cilave OJQ-të mund të jenë të ekspozuara, pasi që sipas Departamentit, kjo çështje nuk është në mandatin e tij sipas Ligjit për OJQ-të, mandat ky që kufizohet tek regjistrimi. DRNOJQ-ja siguron që OJQ-të të raportojnë për aktivitetet financiare mes janarit dhe marsit të secilit vit, ashtu siç kërkohet me Ligj, si dhe nëse nuk raportojnë DRNOJQ-ja do të marrë masa kundër tyre me një bazë të përshkallëzuar sanksionesh, të cilat mund të përfshijnë edhe pezullimin, por vetëm në pajtim me Ligjin. Njëkohësisht, ekipi vlerësues nuk ka marrë ndonjë konfirmim nga autoritetet tjera që OJQ-të përbëjnë vërtetë ndonjë rrezik sa i përket financimit të terrorizmit.

1515. Dispozitat për obligimet tjera për OJQ-të për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, më parë me nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/2 të shkurtit 2004 mbi Pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale, si dhe e cila është

¹⁵⁸ Këto dokumente nuk i janë vënë në dispozicion ekipit të vlerësimit.

¹⁵⁹ Për shembull neni 19 i Ligjit të parë i referohet paragrafit (4) dhe (5) të nenit 20 ndërkohë që këto paragrafë nuk ekzistojnë.

shfuqizuar nga Ligji LPP/LFT megjithatë janë mbajtur dhe reflektuar në nenin 24 të Ligjit LPP/LFT- shih po ashtu edhe analizën e Rekomandimit 17 për Sanksionet.

1516. Edhe pse ligji i parë për OJQ-të, Ligji nr. 03/L-134 të vitit 2009, është shqyrtuar dhe zëvendësuar me Ligjin e ri, Ligji nr. 04/L-057 i 2011-ës, nuk duket që shqyrtimi i ligjit është rezultat i ndonjë studimi mbi përshtatshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve në lidhje me OJQ-të.

1517. Për më tepër, asnjë studim nuk është kryer për karakteristikat e OJQ-ve në Kosovë për të identifikuar ato lloje që mund të jenë në rrezik të keqpërdorimit për pastrim parash apo financim terrorizmi.

1518. Në fakt, DRNOJQ ka qëndrimin që ka vetëm fushëveprimin që i është përcaktuar me Ligjin për OJQ-të, i cili është në parim regjistrimi dhe çregjistrimi i OJQ-ve. Kjo do të mund të kishte konsekuencë me definicionin e «Organit Kompetent» në ligj, i cili definohet si «regjistrimi i OJQ-ve dhe heqja nga regjistri». Kjo përbën brengë për kornizën e përgjithshme të OJQ-ve.

1519. Administrata Tatimore ka informuar që pasi që OJQ-të nuk kanë detyrime të larta tatimore, nuk bartin rreziqe të mëdha për qëllimet tatimore. Kështu, derisa pranohet rëndësia e monitorimit të statusit të OJQ-ve, ATK-ja i konsideron brengat e mëparshme të sektorit të hequra me hyrjen në fuqi të ligjeve përkatëse. Kështu, ATK-ja nuk bën vlerësime risku të sektorit, por edhe po t'i bënte, do t'i bënte vetëm në lidhje me tatimet.

1520. Vlerësimi i përshtatshmërisë së ligjeve dhe rregulloreve për OJQ-të, si dhe vlerësimet e cënueshmërisë së OJQ-ve ndaj keqpërdorimit për pastrim parash apo financim terrorizmi do të mund të adresoheshin përmes një vlerësimi kombëtar rreziku¹⁶⁰ ose drejtpërdrejt nga DRNOJQ ose autoritetet tjera kompetente.

1521. Brenda këtij konteksti, si dhe në kuptimin e qëndrimeve të DRNOJQ-së që Ligji dikton mandatin e tij të përgjithshëm në lidhje me OJQ-të, dhe këtë në një mënyrë më të ngushtë dhe më të kufizuar, rekomandohet që të shtohet një nen i ri 2A në Ligjin për OJQ-të, i cili do të fliste për emërimin e Organit Kompetent, si dhe kompetencat e tij me ligj:

Neni 2A

Përcaktimi dhe kompetencat e organit kompetent¹⁶¹

- (1) Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të brenda Ministrisë së Administratës Publike është Organi Kompetent përgjegjës për zbatimin e këtij Ligji.
- (2) Organi Kompetent është përgjegjës për ndërmarrjen e gjitha funksioneve që i atribuohen me këtë Ligj, në lidhje me regjistrimin, çregjistrimin dhe rregullimin e OJQ-ve për përputhshmërinë e tyre me këtë Ligj, si dhe rregulloret që nxirren sipas tij.
- (3) Në ndërmarrjen e mbikëqyrjes së OJQ-ve të regjistruara, Organi Kompetent mund të aplikojë qasje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut, me mbikëqyrje më të madhe për OJQ-të me resurse të konsiderueshme financiare

¹⁶⁰ Vlerësimi kombëtar i riskut është tashmë i detyrueshëm sipas Rekomandimit 1 të Standardeve të reja FATF 2012

¹⁶¹ Neni i propozuar 2A flet për mangësitë e tjera të identifikuara në pjesët në vijim të Raportit. Këto të gjitha përfshihen në një rekomandim, për hir të qartësisë dhe vazhdimësisë. Referencat ndaj nenit të propozuar bëhen sipas nevojës në nenet përkatëse.

nën kontroll, si dhe OJQ-të me aktivitete substanciale ndërkombëtare dhe të cilat mund të bartin rrezik më të madh. Mbikëqyrja më e madhe përfshin kontrollimin e librave, dokumenteve dhe informatave tjera në lokalet e OJQ-së, si dhe për këtë qëllim, dhe pas identifikimit të mirëfilltë, zyrtarët e Organit Kompetent kanë të drejtë të qasjes në hapësirat e OJQ-së gjatë orarit zyrtar të punës dhe kanë të drejtë të kërkojnë gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme, duke përfshirë kopjimin dhe riprodhimin e dokumenteve sipas nevojës, si dhe pyetjet e qartësimet që kërkojnë në përmbushje të këtyre përgjegjësisë. Organi kompetent mund të aplikojë si më lart për ekzaminimin e OJQ-ve në baza të vizitës jashtë vendit të ngjarjes.

(4) Organi kompetent, periodikisht si dhe siç e vlerëson të nevojshme, mbledh informata të mjaftueshme për të vlerësuar aktivitetet, madhësinë dhe karakteristikat tjera përkatëse të OJQ-ve për të identifikuar rreziqet dhe cenueshmërinë ndaj të cilëve mund të jetë i ekspozuar sektori, të rrisë vetëdijen dhe të bëjë rekomandimet sipas nevojës për ndryshime të këtij Ligji dhe rregulloret që nxirren sipas tij. Në këtë kuptim, Organi Kompetent bashkëpunon me autoritetet tjera që posedojnë informata për sektorin, si dhe do të ndajë informatat sipas nevojës dhe sipas diskrecionit të vet.

1522. Në përputhje me nenin e ri 2A të propozuar, propozohet më tutje që definicioni i “organit kompetent” në nenin 2 të ndryshohet, si dhe të riformulohet si *organi i emëruar me nenin 2A të Ligjit*.

1523. Përgjegjësia e mbikëqyrjes në nenin e ri të propozuar 2A mund të arrihet duke zgjeruar dhe përforcuar rolin e Divizionit brenda DRNOJQ-së që është përgjegjës për shqyrtimin e raporteve dhe analizës financiare, me fushëveprimin e kontrollimit të OJQ-ve në terren dhe/ose jashtë tij. Për t’u fokusuar tek OJQ-të e mëdha, ose ato që mbartin rrezik më të madh të keqpërdorimit për aktivitete kriminale, propozohet që të aplikohet qasja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut në funksione të mbikëqyrjes, e cila do të mund të zhvillohej përmes analizës së Raportimit financiar dhe të aktiviteteve, tek Ligji për OJQ-të.

1524. Paragrafi (9) i nenit 18 të Ligjit për OJQ-të gjithashtu njeh nocionin e dallimit të OJQ-ve të mëdha, në kuptimin e pasqyrave financiare që dorëzohen me Raportin e kërkuar vjetor.

1525. Më tutje rekomandohet që Kosova të kryejë, pa vonesë, një vlerësim të gjitha rreziqeve dhe cenueshmërisë së karakteristikave dhe llojeve të OJQ-ve në Kosovë që janë në rrezik të keqpërdoren apo përdoren për financim të terrorizmit apo pastrim të parave.

1526. Për më tepër, Kosova duhet të implementojë pjesët e Strategjisë LPP/LFT sa më shpejt që është e mundur.

Përafrimi me sektorin OJF – Kriteri thelbësor RV VIII.2

1527. KTh RV VIII.2 kërkon nga vendet që të ndërmarrin shërbime informimi me OJQ-të për të rritur vetëdijen, ashtu që të mbrohet sektori nga abuzimet kriminale të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

1528. Ligji për OJQ-të nuk krijon obligime të këtij lloji për DRNOJQ-në. I ngjashëm me këtë është edhe neni 24 i Ligjit LPP/LFT për obligimet shtesë të OJQ-ve.

1529. Ligji LPP/LFT nuk u referohet në mënyrë specifike OJQ-ve në përcaktimin e detyrave dhe kompetencave të NjIF-it, por në përgjithësi kërkohej nga NjIF-i të organizojë

dhe/ose të mbajë trajnime në lidhje me pastrimin e parave, financimin e aktiviteteve terroriste dhe obligimet e subjekteve raportuese.

1530. Përgjigjet në pyetësor theksojnë që janë organizuar tashmë disa tryeza të rumbullakëta e seminare nga NjIF-i në këtë drejtim. NjIF ka informuar se në tetor 2007 ka zhvilluar disa sesione trajnimi për OJQ-të në lidhje me obligimet e tyre sipas Ligjit LPP/LFT dhe në lidhje me inspektimet e përputhshmërisë.

1531. DRNOJQ-ja ka informuar që në debatet e mbajtura me shoqërinë civile, diskutohen obligimet e sektorit për të zbatuar ligjet e Kosovës. Në këtë kuptim, DRNOJQ-ja siguron që OJQ-të janë të mbrojtura nga aktivitetet kriminale.

1532. Edhe pse nuk është specifike për sektorin e OJQ-ve, duhet theksuar që në nëntor të vitit 2007, Qeveria e Kosovës ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Platformën CiviKos. Ky memorandum përfaqëson dokumentin e parë formal që flet për përkushtimin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin institucional në partneritet të vërtetë mes Qeverisë dhe shoqërisë civile. Platforma CiviKos është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e filluar në vitin 2007, e regjistruar zyrtarisht më 2 shtator 2007, me qëllim të krijimit të një mjedisi mundësues për bashkëpunimin e sektorit formal të shoqërisë civile dhe Qeverisë. Një takim i përbashkët është mbajtur në prill të vitit 2012, për të adresuar temat në lidhje me zhvillimin e një strategjie bashkëpunimi mes Qeverisë dhe shoqërisë civile.

1533. Nuk ka pra obligim specifik për asnjë autoritet për të ndërmarrë aktivitete përafrimi me sektorin e OJQ-ve në kontekstin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1534. Duke mos anashkaluar dispozitat e nenit 24 të Ligjit LPP/LFT, nuk ka obligim për të ndërmarrë aktivitete të përafritimit me sektorin e OJQ-ve për t'i bërë ato së paku të vetëdijshme për obligimet e tyre, edhe pse moralisht kjo përgjegjësi duhet të merret më tutje nga NjIF-i ose DRNOJQ-ja ose bashkërisht.

1535. Megjithatë, duhet theksuar pozitivisht që sipas informatave të dhëna, ka aktivitete vetëdijshme që ndërmerren, derisa Platforma CiviKos do të shërbente më mirë këtë qëllim.

1536. Megjithatë, ekziston nevoja definitive të identifikohen përgjegjësitë dhe të formalizohet dhe strukturohet më mirë përafrimi për të përforcuar vetëdijen për cenueshmërinë dhe rreziqet e OJQ-ve, që krijohen nga keqpërdorimi i atyre organizatave.

1537. Në këtë drejtim, ka nevojë për më shumë bashkëpunim, bashkërendim dhe ndarje informatash mes autoriteteve përkatëse, si DRNOJQ-ja, NjIF-i, Administrata Tatimore dhe autoritetet tjera që mund të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes.

1538. Paragrafi (4) i nenit 2A të ri të propozuar siç rekomandohet sipas analizës të KTh RV VIII. 1 si më lart synon të përcaktojë për këtë pjesërisht sipas përgjegjësisë të ZNROJQ në bashkëpunim me autoritetet e tjera, në veçanti me NjIF.

1539. Si rrjedhojë është me rëndësi që DRNOJQ-ja në bashkëpunim me NjIF ndërmerr një program urgjent të përafritimit me sektorin e OJQ-ve me synim të mbrojtjes së sektorit nga financimi i terrorizmit apo pastrimit të parave. Kjo duhet të përfshijë prodhimin e publikimeve të qasshme për përputhshmërinë ligjore dhe praktikat e politikave të mira për OJQ-të dhe terrorizmin, si dhe OJQ-të që veprojnë ndërkombëtarisht. Në këtë kuptim, DRNOJQ-ja dhe NjIF duhet që më tutje të organizojnë trajnime për ngritjen e vetëdijes lidhur me financimin e terrorizmit dhe parandalimin e pastrimit të parave, duke filluar me shpalljen e tipologjive të FATF-së për keqpërdorimin të FT/PP në sektorin OJF.

Mbikëqyrja apo monitorimi efektiv – Kriteri thelbësor RV VIII.3

1540. KTh RV VIII.3 kërkon promovimin e një regjimi efektiv të mbikëqyrjes apo monitorimit të atyre OJQ-ve që mbajnë një pjesë të konsiderueshme të resurseve financiare në kontroll në sektor, si dhe ato që mbajnë një hise të konsiderueshme të aktiviteteve ndërkombëtare të sektorit.

1541. Në pajtim me Ligjin për bankat, OJQ-ja mund të kërkojë edhe të regjistrohet si institucion mikrofinanciar në BQK, si dhe prapë të mbajnë statusin e OJQ-ve. Në raste të tilla, institucioni, i përmendur në Ligj si “Institucioni Mikrofinanciar OJQ”, do të kërkohej të respektonte disa dispozita të Ligjit për bankat që aplikohen për institucione mikrofinanciare. Për më tepër, sipas nenit 111 të Ligjit për bankat, si dhe në pajtim me procedurat që përcaktohen me të, një IMF OJQ mund të konvertohet në institucion mikrofinanciar shoqëri aksionare. Neni 116 i Ligjit për bankat përcakton që *pas dorëzimit të kërkesës, si dhe përfundimit të regjistrimit sipas Ligjit në BQK, Institucionet Mikrofinanciare OJQ nuk rregullohen më nga Ministria e Administratës Publike*. Ia vlen të theksohet gjatë vizitës në terren, DRNOJQ-ja ka shprehur disa rezerva sa i përket kësaj procedure në Ligjin për bankat.¹⁶²

1542. Neni 18 i Ligjit për OJQ-të vendos obligime të ndryshme të raportimit financiar dhe të aktiviteteve të OJQ-ve me status të përfituesit publik. Në këtë kuptim, organizatat e tilla duhet të dorëzojnë çdo vit një raport vjetor tek organi kompetent, në lidhje me operacionet dhe aktivitetet brenda Kosovës. Kjo përfshin pasqyrat financiare të përgatitura në pajtim me kërkesat e organit kompetent dhe informatat tjera të përcaktuara me Ligj. Mosdorëzimi i raportit vjetor i nënshtrohet sanksioneve nga Organi Kompetent në pajtim me Ligjin.

1543. Për më tepër, Ligji për OJQ-të përcakton masat rregullative që DRNOJQ-ja mund të ndërmarrë në rastet kur OJQ-ja dështon të përmbushë ndonjërin obligim raportues sipas Ligjit, duke përfshirë pezullimin apo heqjen e statusit të përfituesit publik të OJQ-së, ose shlyerjen e saj nga Regjistri.

1544. Në përgjigjet e tij ndaj pyetësorit, DRNOJQ-ja pretendon që sipas dispozitave të Ligjit për OJQ-në, monitorimi apo mbikëqyrja nuk është kompetencë e DRNOJQ-së, si dhe që kjo duhet të bëhet nga organet tjera që janë më kompetente për këto qëllime.

1545. Në lidhje me dispozitat e nenit 24 të Ligjit LPP/LFT për obligimet shitesë për OJQ-të, DRNOJQ-ja është e mendimit që nuk ka kapacitet apo fushëveprim për të monitoruar brenda mandatit sipas Ligjit për OJQ-të për të regjistruar organizatat e tilla.

1546. Pa anashkaluar këto, Memorandumi i Mirëkuptimit për këmbimin e informave mes NJIF-it dhe DRNOJQ-së më 16 dhjetor 2011, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut të

¹⁶² Më 24 dhjetor 2012, Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për masë të përkohshme (rasti 97/12 – Avokati i Popullit) për një periudhë prej 31 janarit 2013 që të pezullohet menjëherë zbatimi i neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, nr. 04/L-093, të datës 12 prill 2012, për të njëjtën kohëzgjatje. Neni 90 merret me definicionin e Institucionit Mikrofinanciar OJQ; neni 95(1.6) ndalon OJQ-në Institucion Mikrofinanciar që të mos shesë apo bartë biznesin, bashkimin, ndarjen apo ndërrimet e ndryshme të strukturës; neni 110 për trajtimin e kapitalit të dhuruar dhe atij suficit; neni 111 për procedurat e transformimit në shoqëri aksionare, si dhe neni 116 për dispozitat kalimtare dhe rregullimin e OJQ IMF-ve. Më 30 janar 2013, Gjykata zgjati masën e përkohshme për 3 muaj të tjerë më 30 prill 2013. Me 12 prill, 2013 Gjykata Kushtetuese ka vendosur përfundimisht (Nr. AGJ403/13) t’i shpallë nenet 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit mbi bankat dhe Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093 të datës 12 prill 2012 si të papajtueshme me Nenet 10, 44 dhe 46 të Kushtetutës dhe kështu i ka deklaruar si të pavlefshme.

aplikuar asokohe, përfshin dispozitat për pjesëmarrje në inspektimet e OJQ-ve nga të dyja palët:¹⁶³

5.1 QIF-ja mundet, në diskrecionin e saj, si dhe nëse konsideron si përfituese, të ftojë MAP/DRNOJQ-në që të përcaktojë zyrtarin e Departamentit që të përcjellë zyrtarët e QIF-së gjatë kryerjes së një inspektimi në vend të ndonjë OJQ-je.

5.2 MAP/DRNOJQ-ja mundet, në diskrecionin e tij, si dhe nëse konsideron si përfituese, të ftojë QIF-në që të emërojë një zyrtar për të përcjellur zyrtarët e MAP/DRNOJQ-së gjatë kryerjes së një inspektimi të ndonjë OJQ-je.

1547. Në kontekstin e brengave të shprehura në vizitën në terren mbi mungesën e mbikëqyrjes së sektorit të OJQ-ve për rreziqe të përdorimit për qëllime kriminale, Administrata Tatimore informoi që mbikëqyrja që ajo ndërmerr ka të bëjë me çështjet tatimore (si tatimi në burim dhe kontributet e sigurimit social të punëtorëve të tyre), edhe pse për këtë qëllim, ajo mund të kontrollojë aktivitetet e një OJQ-je. Administrata Tatimore informoi që ka pasur raste në të cilat kanë kontrolluar OJQ-të. Përmes këtyre kontrolleve. Administrata Tatimore ka identifikuar parregullsi, pasi që me ato kontrolle, inspektorët e Administratës Tatimore mund të kenë qasje në gjitha llogaritë, dosjet dhe informatat në dispozicion të OJQ-së nën kontroll. Kontrollat tjera kanë të bëjnë me raportet vjetore të dorëzuara sipas Ligjit për OJQ-të për pozitën e tyre financiare, operacionet dhe aktivitetet. Fushëveprimi i kontrolleve megjithatë mbetet vetëm qëllim tatimor. Administrata Tatimore ka informuar që shumica e parregullsive të gjetura gjatë kontrolleve kanë pasur të bëjnë me dokumentacionin që nuk ka qenë në përputhje me obligimet tatimore.

1548. Në praktikë, mbikëqyrja apo monitorimi adekuat i ndonjë kategorie të OJQ-ve mungon krejtësisht. Administrata Tatimore bën kontrolle të sektorit vetëm për qëllime të detyrimeve tatimore të cilat, sipas Administratës Tatimore, janë të vogla. DRNOJQ-ja pohon që nuk ka mandat monitorimi sipas Ligjit për OJQ-të, pra nuk bën mbikëqyrje të sektorit, i cili, sipas pohimeve të saj, duhet të jetë fushëveprim i autoriteteve tjera kompetente, pa anashkaluar faktin që Ligji i jep DRNOJQ-së autorizimet adekuate për të ndërmarrë masa korrigjuese dhe për të vendosur sanksione administrative, si pezullimi apo heqja e statusit të përfituesit publik. NJIF-i nuk ka mandat sipas Ligjit LPP/LFT që të monitorojë OJQ-të për qëllimet e nenit 24 të Ligjit LPP/LFT – pa anashkaluar këtë, paragrafi (4) i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT kërkon nga OJQ-të t'i vënë në dispozicion NJIF-it dhe DRNOJQ-së për inspektim gjitha dokumentet e ruajtura, në kuptimin e paragrafit të përmendur të Ligjit. Për më tepër, Ligji LPP/LFT i jep autoritet DRNOJQ-së që të pezullojë apo revokojë regjistrimin e një OJQ-je për shkeljen e ndonjë dispozite të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT sipas nenit 21 të Ligjit për OJQ-të, por nuk i jep mekanizma se si të bëhet kjo në mungesë të mandatit mbikëqyrës për NJIF-në apo DRNOJQ-në, ku kjo e fundit pohon që nuk ka autorizime të tilla monituese sipas Ligjit për OJQ-të.

1549. Mungesa e monitorimit apo mbikëqyrjes së OJQ-ve manifestohet në situatat kur një institucion joqeveritar ka statusin e një “Institucioni Mikrofinanciar OJQ”, i cili mbetet nën qeverisjen e DRNOJQ-së, deri sa të humbë statusin “OJQ”, kur do të duhej të binte nën fushëveprimin e BQK-së, sipas Ligjit për bankat¹⁶⁴.

1550. DRNOJQ pohon që nuk ka mandat monitorimi sipas Ligjit për OJQ-të. Ky Raport pohon të kundërtën. DRNOJQ ka për obligim sipas Ligjit për OJQ-të që të monitorojë OJQ-të së jashtmi, përmes dorëzimit të deklaratave të kërkuara me nenin 12 të Ligjit, si dhe Raportet

¹⁶³ Referencat ndaj QIF-it duhen lexuar si referenca ndaj NJIF-it.

¹⁶⁴ Kjo pa paragjykim të vendimit më të fundit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me suspendimin e disa neneve relevante të Ligjit për bankat.

vjetore në pajtim me nenin 18 të Ligjit për OJQ-të-por jo për qëllime të LPP/LFT. Në fakt, siç shpjegohet, DRNOJQ përbëhet nga dy divizione – një për regjistrim dhe tjetri për shqyrtim të raporteve dhe analizë financiare. Sipas faqes së Ministrisë për Administratë Publike, e më saktësisht për DRNOJQ-në, Divizioni brenda DRNOJQ-së përgjegjës për “Raportim dhe Monitorim” kryen aktivitetet në vijim:

- Pranon dhe analizon raportet vjetore me paraqitjen financiare të OJQ-ve;
- Monitoron aktivitetet e OJQ-së për të gjetur se sa respekton statusin e saj, si dhe ligjet tjera të detyrueshme, si dhe rekomandon avancimet e nevojshme;
- Bashkëpunon me institucionet tjera;
- Merr vendime në përputhje me ligjin; si dhe
- Regjistron OJQ-të, i jep atyre statusin e përfituesit publik, merr vendime për pezullimin e SPP-së, revokimin dhe çregjistrimin e OJQ-ve.

Pra, ose DRNOJQ-ja në fakt ka përgjegjësi monitorimi sipas Ligjit për OJQ-të, ose aktivitetet që kryen sipas faqes së Ministrisë nuk janë të sakta.

1551. Për më tepër, mund të vihet në dyshim vlefshmëria aktuale e dispozitave sipas nenit 5 të Memorandumit, për pjesëmarrjen në inspektime, nëse të dyja Palët në marrëveshje nuk kanë aktualisht mandat ligjor mbikëqyrës. Në këto rrethana, anomalia në nenin 5 të Memorandumit mund të ketë vlefshmëri ligjore vetëm me mandat të mirëfilltë e të qartë të mbikëqyrjes. Përndryshe, neni duhet rishikuar.¹⁶⁵

1552. Në fakt, mandati mbikëqyrës i NjIF-it në lidhje me OJQ-të tek neni 30 i Ligjit LPP/LFT është i paqartë. Neni 30 përcakton autorizimet mbikëqyrëse të NjIF-it për subjektet raportuese sipas *përcaktimit në nënparagrafët 1.4 deri 1.8, paragrafi 1 i nenit 16 të këtij Ligji*. Kjo përjashton OJQ-të (dhe partitë politike), pasi që neni 16 nuk merr parasysh OJQ-të (dhe partitë politike) si subjekte raportuese. Kështu, referencat ndaj *shënimeve që mirëmbahen sipas neneve 16 deri 28 të këtij Ligji, ose dokumentet relevante për përcaktimin nëse detyrimet sipas neneve 16 deri 28 të këtij ligji kanë qenë në përputhje me të bëhet irrelevante për nenin 24 për obligimet shtesë të OJQ-ve, pasi që OJQ-të nuk janë pjesë e nënparagrafëve 1.4 deri në 1.8, paragrafi 1 të nenit 16 të ligjit LPP/LFT* si subjekte raportuese – pa marrë parasysh që paragrafi (4) i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT kërkon nga OJQ-të që t’i vënë në dispozicion NJIF-it dhe DRNOJQ-së për inspektim çdo dokument që mirëmbahet në kuptimin e paragrafit të përmendur të Ligjit¹⁶⁶.

1553. Brenda këtij konteksti, rekomandimet e dhëna sipas nenit 5.1, si dhe në veçanti paragrafët (2) dhe (3) të këtij Raporti duhen zbatuar për të korrigjuar këto dobësi të identifikuar.

1554. Për më tepër, Ligji i ndryshuar LPP/LFT duhet të heqë dykuptimësinë e nenit 30 të Ligjit LPP/LFT si dhe të përcaktojë një autoritet për të monitoruar sektorin e OJQ-ve për qëllimet e nenit 24 të Ligjit LPP/LFT. Kjo përgjegjësi mund t’i vishet ose NjIF-it ose DRNOJQ-së.¹⁶⁷ Kudo që kjo përgjegjësi vihet, Ligji duhet të sigurojë bashkëpunimin mes NJIF-it dhe DRNOJQ-së – shih analizën e KTh VIII.4.1. për masat e bashkëpunimit.

¹⁶⁵ Ndryshimet në Ligjin LPP/LFT tani e përcaktojnë NjIF si autoritet mbikëqyrës për OJQ-të për qëllime të përputhshmërisë.

¹⁶⁶ Sipas Ligjit të amenduar LPP/LFT, OJQ-të njihen si subjekte raportuese sipas nenit 16 dhe i nënshtrohen monitorimit dhe mbikëqyrjes nga NjIF për qëllime të Ligjit LPP/LFT. Neni 2A i propozuar në Ligjin për OJQ-të do të ofrojë më shumë kompetenca mbikëqyrëse të DRNOJQ-së.

¹⁶⁷ Projektligji për ndryshim/plotësim të Ligjit LPP/LFT parasheh përgjegjësi mbikëqyrëse për OJQ-të që sipas Ligjit i jepet NJIF-it, derisa OJQ-të shtohen si subjekte raportuese tek neni 16 i Ligjit.

1555. Përfundimisht, si pjesë e regjimit të tij mbikëqyrës, DRNOJQ-ja duhet të bëjë një vlerësim strategjik për të përcaktuar se cilat OJQ zënë një pjesë të konsiderueshme të resurseve financiare nën kontroll brenda sektorit, ose mbajnë një hise të konsiderueshme të aktiviteteve ndërkombëtare të sektorit. Ky vlerësim duhet të ndahet edhe me NjIF-në.

Mirëmbajtja e informatave të qeverisjes – Kriteri thelbësor RV VIII 3.1

1556. KTh RV VIII.3.1 kërkon nga OJQ-të që të ruajnë informatat mbi qëllimin dhe synimin e aktiviteteve të tyre të theksuara, si dhe për identitetin e personit apo personave që janë pronarë, kontrollojnë apo drejtojnë aktivitetet. Këta të fundit duhet të përfshijnë zyrtarët e lartë, anëtarët e bordit dhe aksionarët në mirëbesim.

1557. Neni 12 i Ligjit për OJQ-të obligon organin kompetent që të mbajë një regjistër të OJQ-ve që duhet të përmbajë: emërtimin, adresën, formën e organizimit dhe qëllimet e çdo OJQ-je, listën e anëtarëve deri në ditën e regjistrimit, si dhe emrin, adresën dhe informacionin tjetër të personit kontaktues të përfaqësuesit të autorizuar. Regjistri duhet të tregojë nëse OJQ-ja ka status të përfituesit publik.

1558. Derisa organi kompetent është i obliguar të mbajë regjistrin publik të përditësuar, neni 12 më tutje obligon OJQ-të vendore, të huaja dhe ndërkombëtare të dorëzojnë një deklaratë vjetore tek organi kompetent që ose konfirmon që informatat që duhen mbajtur në regjistër janë ende valide, ose që janë bërë ndryshime. Dështimi në dorëzimin e kësaj deklarate vjetore mund të çojë në shlyerjen e OJQ-së nga Regjistri.

1559. Neni 18 i Ligjit për OJQ-të më tutje i kërkon OJQ-ve me status të përfituesit publik që të dorëzojnë një raport vjetor tek organi kompetent për operacionet dhe aktivitetet e tyre në Kosovë. Raportet duhen dorëzuar deri në fund të marsit për vitin raportues që përfundon më 31 dhjetor të vitit të kaluar. Raporti përmban tri pjesë për menaxhimin dhe administrimin, aktivitetet dhe arritjet, si dhe pasqyrat financiare. Në kontekstin e KTh RV VIII.3.1 ia vlen të theksohet që pjesa e menaxhmentit dhe administrimit përmban hollësi mbi emrin, akronimin, adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe emailit të organizatës; emrin e zyrtarit kryesor ekzekutiv (p.sh. menaxheri apo drejtori ekzekutiv), si dhe emrat e anëtarëve të organit qeverisës, duke përfshirë emrat dhe titujt e gjithë zyrtarëve në pozita të larta. Gjithashtu, në këtë kontekst, pjesa e aktiviteteve dhe arritjeve më tutje përfshin edhe një deklaratë të misionit dhe qëllimit të përfitimit publik të OJQ-së raportuese.

1560. Nuk ka kërkesa Raportimi për OJQ-të që nuk gëzojnë statusin e përfituesit publik.

1561. Obligimi i OJQ-ve që t'i dorëzojnë DRNOJQ-së një deklaratë vjetore për përditësim të Regjistrimit dhe informatat e dorëzuara me Raportin Vjetor sipas Ligjit, ofrojnë pjesën më të madhe të informatave që kërkohen sipas KTh RV VIII.3.1, edhe pse mund të ketë një distancë kohore, pasi që informatat dorëzohen një herë në vit.

1562. Për më tepër, pasi që OJQ-të janë të obliguara të raportojnë, rrjedh që duhet të ruajnë këto informata. Paragrafi (11) i Nenit 9 i Ligjit mbi OJQ kërkon nga OJQ-të të raportojnë për ndryshimet në statute brenda 30 ditëve nga ngjarja e tyre. Megjithatë, nuk duket se ky obligim përfshin emrat e zyrtarëve të përcaktuar sipas paragrafit (4.2) dhe (4.3) të Nenit 18 të Ligjit për OJQ-të..

1563. Për më tepër, nuk ka obligim për të ruajtur apo raportuar informatat mbi pronarin(ët) e një OJQ-je nëse këta të fundit janë ndryshe nga themeluesit, pasi që pavarësisht nga referencat tek “pronarët” në FATF EC RV VIII.3.1. autoritetet e Kosovës kanë informuar se OJQ-të nuk kanë ”pronar” të ndarë nga themeluesit.

1564. Pavarësisht obligimit për raportim të vazhdueshëm sipas paragrafit (11) të nenit 9 të Ligjit për OJQ, rekomandohet të ndryshohet ky paragraf duke shtuar fjalët *dhe informacionin e kërkuar sipas paragrafit (4.2) dhe paragrafit (4.3) të Nenit 19 të këtij Ligji* pas fjalëve aktuale “dhe paragrafit 5 të këtij neni”.

Masat e duhura për sanksionimin e shkeljeve – Kriteri thelbësor RV VIII.3.2

1565. KTh RV VIII.3.2 kërkon disponueshmërinë e masave të mirëfillta për sanksionimin e shkeljeve të masave apo rregullave të mbikëqyrjes, ose nga OJF-ja ose nga personat që veprojnë në emër të saj. Sanksionet e tilla nuk mund të pengojnë procedurat civile, administrative apo penale ndaj OJF-së apo personave që veprojnë në emër të saj, sipas nevojës.

1566. Ligji për OJQ-të nuk parasheh ndonjë sanksion për shkeljen e masave të mbikëqyrjes, përveç shlyerjes së OJQ-së nga Regjistri (neni 21) si dhe pezullimin apo revokimin e “statusit të përfituesit publik” (neni 19).

1567. Organi kompetent mund të shlyejë OJQ-në nga Regjistri si sanksion për shkeljen e ligjit vetëm nëse për tri (3) vjet OJQ-ja dështon të dorëzojë deklaratën vjetore të parashikuar sipas paragrafit (5) të nenit 12 të Ligjit për OJQ-të që merret me informatat që mirëmbahen nga organi kompetent në regjistrin publik. Ligji për OJQ-të nuk specifikon që shlyerja e një OJQ-je nga Regjistri nuk paragjykon procedurat civile, penale apo administrative në lidhje me vetë organizatën apo personat që veprojnë në emrin e saj.

1568. Neni 19 i Ligjit për OJQ-të e autorizon organin kompetent që të pezullojë apo revokojë “statusin e përfituesit publik” si dhe gjithë beneficionet sipas këtij Ligji, me procedurat e përcaktuara me ligj, në rastet kur:

- Një OJQ dështon të dorëzojë raportin e plotë vjetor në pajtim me nenin 18 të Ligjit për OJQ-të brenda afatit të përcaktuar;
- Pas shqyrtimit të raportit vjetor të dorëzuar nga OJQ-ja, organi kompetent përcakton që OJQ-ja nuk përmbush më kërkesat për statusin e përfituesit publik të paraparë me nenin 17 të Ligjit.

1569. Ligji për OJQ-të nuk specifikon që pezullimi apo revokimi i “statusit të përfituesit publik” është pa paragjykuar procedurat civile, penale apo administrative në lidhje me vetë organizatën apo personat që veprojnë në emrin e saj.

1570. Neni 24 i Ligjit LPP/LFT vendos obligime shtesë për OJQ-të. Paragrafi (8) i nenit kërkon nga organi kompetent që të pezullojë apo revokojë regjistrimin e një OJQ-je për shkelje të dispozitave të këtij neni, sipas nenit 21 të Ligjit për liri të asocimit në organizata joqeveritare (nr. 03/L-134). Vendosja e sanksionit të tillë nuk paragjykon procedurat penale.

1571. Siç argumentohet në këtë raport, sanksionet administrative të përcaktuara me nenin 31 të Ligjit LPP/LFT janë të kufizuara në fushëveprim, si dhe mund të vihet në dyshim fakti nëse këto mund të aplikohen për OJQ-të brenda kontekstit të obligimeve tjera të tyre sipas nenit 24 të Ligjit LPP/LFT.

1572. Në anën tjetër, veprat tjera penale dhe ndëshkimet e përcaktuara me nenin 33 të Ligjit LPP/LFT duket se vlejnë për OJQ-të ose personat që veprojnë në emrin e tyre për shkelje të obligimeve të tjera për OJQ-të, të cilat përcaktohen me nenin 24 të Ligjit LPP/LFT.

1573. OJQ-ja që është e autorizuar nga BQK-ja që të veprojë si OJQ Institucion Mikrofinanciar i nënshtrohet ndëshkimeve dhe masave korrigjuese që përcaktohen me nenin 105 dhe 106 të Ligjit për bankat.¹⁶⁸

1574. Në përgjithësi, dispozitat si më lart në masë të madhe mbulojnë kërkesat e KTh RV VIII.3.2. Sanksionet për masat e mbikëqyrjes për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit mbulohen pjesërisht me Ligjin LPP/LFT.

1575. Megjithatë, Ligji për OJQ-të nuk përcakton sanksione të kujdesit në dy raste:

- Shkeljet e obligimeve të nenit 4 që ndalojnë shpërndarjen apo të ardhurat;
- Shkeljet e paragrafit (11) të nenit 9 për mosRaportimin e ndryshimeve të dokumenteve të regjistrimit brenda periudhës së dhënë.

1576. Autoritetet e Kosovës mund të marrin parasysh vënien e masave administrative dhe/ose sanksioneve në këtë drejtim.

1577. Për më tepër, theksohet që derisa paragrafi (5) i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT i referohet autorizimeve të organit kompetent sipas Ligjit për OJQ-të për të pezulluar apo revokuar regjistrimin e një OJQ-je për shkelje të ndonjë dispozite të nenit aktual, sipas nenit 21 të Ligjit për liri të asocimit në organizata joqeveritare, neni 21 i Ligjit për OJQ-të vetëm fuqizon organin kompetent për të shlyer OJQ-në nga Regjistri.

1578. Pra, derisa dispozitat në nenin 24 të Ligjit LPP/LFT dhe ato në nenin 21 të Ligjit për OJQ-të duhen harmonizuar, rekomandohet që të krijohet një lidhje në Ligjin për OJQ-të me dispozitat e nenit 24 të Ligjit LPP/LFT. Në këtë drejtim, rekomandohet që të shtohet një paragraf i ri (1.3) tek neni 21 i Ligjit për OJQ-të:¹⁶⁹

Neni 21 para (1.3) nëse OJQ-ja qartazi nuk është në përputhje me obligimet e shtuara sipas nenit 24 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (Ligji nr. 03/L-196 të datës 30.09.2010).

Licencimi apo regjistrimi i organizatave joqeveritare – Kriteri thelbësor RV VIII.3.3

1579. KTh RV VIII.3.3 kërkon që OJQ-të ose të licencohen ose të regjistrohen nga autoritetet kompetente.

1580. DRNOJQ-ja, brenda Ministrisë së Administratës Publike, është autoriteti kompetent për të zbatuar Ligjin për OJQ-të, duke përfshirë regjistrimin.

1581. Ligji për OJQ-të parasheh regjistrimin dhe çregjistrimin e OJQ-ve. Sipas informatave të dhëna nga DRNOJQ-ja, OJQ-ja së pari regjistrohet si OJQ sipas Ligjit për OJQ-të, si dhe pastaj konsiderohet si person juridik. Nuk ka regjistrim tjetër sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, pasi që ekzistojnë dy regjistra të ndarë sipas dy ligjeve. Pa anashkaluar këtë fakt, mund të ketë raste kur ARBK-ja mund të kërkojë informata për një OJQ që regjistrohet në DNROJQ sipas Ligjit për OJQ-të.

1582. Pasi që një OJQ vendore mund të jetë në formën e një shoqate apo fondacioni, neni 6 i Ligjit për OJQ-të qartësisht jep kërkesat për themelimin e secilit prej këtyre llojeve.

¹⁶⁸ Pa paragjykuar vendimin për Masa të përkohshme të marrë nga Gjykata Kushtetuese më 24 dhjetor 2012 dhe vendimet më pas.

¹⁶⁹ Përveç nëse neni 24 i Ligjit LPP/LFT duhet t'i referohet në fakt neni 19 të Ligjit për OJQ-të, në të cilin rast paragrafi i propozuar (1.3) duhet konsideruar për t'u shtuar sipas nevojës.

1583. Ligji për OJQ-të parasheh që secili person ka të drejtë të regjistrojë një OJQ sipas kushteve dhe afateve të Ligjit. Në anën tjetër, personat nuk kanë nevojë të regjistrojnë OJQ-në për të ushtruar të drejtën e lirisë së asociimit. Megjithatë, pasi të regjistrohet, OJQ-ja duhet të respektojë dispozitat e Ligjit për OJQ-të. Në këtë kuptim, neni 9 i Ligjit për OJQ-të artikulon procedurat për regjistrim. Ligji për OJQ-të më tutje parasheh çregjistrimin e OJQ-ve në rrethanat e përshkruara me Ligj sipas nenit 21.

1584. Megjithatë, duhet theksuar që nga informatat që janë dhënë nga DRNOJQ, në procesin e regjistrimit, DRNOJQ nuk ndërmerr e as nuk aplikon masa të kujdesit të shtuar për të siguruar që OJQ-ja nuk themelohet për qëllime të paligjshme. Në fakt, ka informuar që as nuk i kontrollon emrat e themeluesve tek listat e personave të autorizuar që mbahet nga Kombet e Bashkuara, Shtetet e Bashkuara apo Bashkimi Evropian – në fakt, DRNOJQ ka informuar se as që ka ose pranon kopje të këtyre listave.

1585. Siç theksohet me analizën e sipërme të KTh RV VIII.3 të këtij raporti, në pajtim me Ligjin për bankat, OJQ-ja mund të kërkojë të regjistrohet si institucion mikrofinanciar në BQK, si dhe ende të ruajë statusin e një OJQ-je.¹⁷⁰

1586. Pasi të regjistrohet në DRNOJQ, me Ligjin për OJQ-të, OJQ-së i duhet të regjistrohet në ATK për qëllime tatimore.

1587. Përcaktimi i DRNOJQ-së si organ kompetent për regjistrimin e OJQ-ve, bashkë me kërkesat dhe procedurat e regjistrimit sipas Ligjit për OJQ-të, mbulojnë kërkesat e KTh RV VIII.3.3 në masë të madhe.

1588. Megjithatë, është brengosëse që në procesin e regjistrimit, i cili qartësisht është pjesë e kompetencave të DRNOJQ-së, nuk ka procedura të kujdesit të shtuar për themeluesit, pra bëhet e pamundur që DRNOJQ-ja të identifikojë, në fazën e regjistrimit, nëse një OJQ themelohet si organizatë për qëllime të paligjshme.

1589. Pra, rekomandohet që në procedurat e veta të brendshme të regjistrimit, DRNOJQ-ja të fusë edhe kërkesën për të bërë analizën e thukët të themeluesve, së paku duke kontrolluar emrat e dhënë me ata emra të personave të përcaktuar me Rregulloret e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Shtetet e Bashkuara, si dhe Bashkimit Evropian.

1590. Në këtë drejtim, Urdhërsa administrative e NjIF-it që kërkon nga subjektet raportuese që të kenë vëmendje të veçantë ndaj individëve dhe organizatave të përcaktuara nga RKSKB duhet të zgjerohet menjëherë për të mbuluar edhe DRNOJQ-të.

Mbajtja e dosjeve – Kriteri thelbësor RV VIII.3.4

1591. KTh RV VIII.3.4 kërkon që OJQ-të të mbajnë më së paku për pesë vjet, si dhe t'i vënë në dispozicion autoriteteve përkatëse, dosjet e transaksioneve vendore dhe ndërkombëtare, me hollësi të mjaftueshme për të verifikuar përdorimin e fondeve në përputhje me qëllimin dhe synimin e organizatës.

1592. Edhe pse në përgjigjet e veta ndaj pyetësorit, DRNOJQ-ja pohon që OJQ-të janë të obliguara të mbajnë dosjet e lartpërmendura në arkivat e tyre, Ligji për OJQ-të nuk duket të ketë ndonjë obligim për mirëmbajtjen e llojeve të dosjeve nga një OJQ, as për qëllime kujdesi.

¹⁷⁰ Referojuni Vendimit për masë të përkohshme të marrë nga Gjykata Kushtetuese më 24 dhjetor 2012.

1593. Për më tepër, në përgjigjen ndaj pyetësorit, Prokurori i Shtetit dhe Administrata Tatimore theksojnë që OJQ-të obligohen të mbajnë dosjet në pajtim me Ligjin LPP/LFT dhe Ligjin për Administratën Tatimore.

1594. Paragrafi (4) i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT që merret me obligimet tjera të OJQ-ve, obligon gjithashtu OJQ-të që të mbajnë llogari që dokumentojnë të gjitha të ardhurat dhe shpërndarjet. Llogaritë duhet të identifikojnë të ardhurat sipas burimit, shumës, si dhe mënyrës së pagesës, si urdhri i valutës apo pagesës, si dhe të identifikojnë shpërndarjet sipas pranuesit, përdorimit të fondeve, si dhe mënyrës së pagesës. Ligji kërkon që dokumentet e llogarive të ruhen për pesë (5) vjet, si dhe t'i vihen në dispozicion për inspektim NjJF-it dhe organit kompetent sipas Ligjit për OJQ-të.¹⁷¹

1595. Paragrafi (2.1) i nenit 13 të Ligjit për Administratën Tatimore, i përmendur nga Prokurori i Shtetit dhe Administrata Tatimore, përcakton që personi që obligohet të krijojë dosje sipas Ligjit për Administratën Tatimore obligohet gjithashtu që të ruajë ato dosje për një periudhë së paku gjashtëvjeçare pas përfundimit të periudhës tatimore në të cilën ka lindur detyrimi tatimor.

1596. Nuk ka obligime ligjore sipas Ligjit për OJQ-të për të mbajtur regjistra të transaksioneve vendore dhe ndërkombëtare.

1597. Obligimet e ruajtjes së regjistrave, edhe sipas llojeve edhe sipas periudhave të ruajtjes, sipas paragrafit (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT në një masë të madhe mbulojnë kërkesat e KTh RV VIII.3.4. Neni 24 megjithatë nuk përcakton periudhën e fillimit të periudhës së ruajtjes.

1598. Pra, rekomandohet që të ndryshohet paragrafi (4) i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT si në vijim, për harmonizim më të mirë me KTh RV VIII.3.4:¹⁷²

*Neni 24 para (4) OJQ-të do të ruajnë llogaritë të cilat dëshmojnë të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet. Llogaritë do të identifikojnë të ardhurat sipas burimit, sasisë dhe mënyrës së pagesës, me para ose me urdhërpagesë, do të identifikojnë shumat e paguara sipas marrësit, destinimit të shfrytëzimit të fondeve dhe mënyrës së pagesës. **Për qëllime të këtij Ligji**, dokumentet e llogarive do të ruhen pesë (5) vite *pas ekzekutimit të transaksionit si dhe do të ruhen në një mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të arrijnë të verifikojnë që transaksionet e kryera janë në përputhje me qëllimin dhe synimet e OJQ-së. Në këtë kuptim, dokumentet e llogarive do t'i vihen në dispozicion për inspektim me kërkesë të NJJF-së dhe organit kompetent sipas Ligjit për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare (Nr. 03/L-134) (Nr 04/L 057), si dhe autoriteteve tjera kompetente relevante për qëllimet e përmbushjes së obligimeve të veta ligjore.**

1599. Ndryshimi i propozuar në paragrafin (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT përcakton kohën e fillimit të periudhës së ruajtjes, siguron mënyrën në të cilën ruhen dokumentet, si dhe siguron disponueshmërinë e tyre sipas kërkesës për gjitha autoritetet kompetente relevante që duhet të përmbushin obligimet e tyre ligjore në lidhje me OJQ-të.

¹⁷¹ Projektligjit për ndryshim/plotësim të Ligjit LPP/LFT propozon një ndryshim në nenin 16, për të shtuar OJQ-të si “subjekte raportuese” për qëllimet e Ligjit. Në këto rrethana, gjitha obligimet e mbajtjes së regjistrave tek Ligji LPP/LFT për subjekte raportuese duhet të vlejnë edhe për OJQ-të. Nuk ka propozim për rishikimin e paragrafit (4) të nenit 24.

¹⁷² Duhet siguruar që ndryshimi i propozuar në nenin 24 të mos jetë në konflikt eventuale me ndryshimet në statusin e OJQ-ve sipas Ligjit LPP/LFT, ashtu siç propozohet të ndryshohet përmes Projektligjit për ndryshim/plotësim.

Hetimet dhe grumbullimi i informatave – Kriteri thelbësor RV VIII.4

1600. KTh RV VIII.4 kërkon nga vendi që të marrë masa për të siguruar hetimin efektiv dhe grumbullimin e informatave mbi OJQ-të.

1601. Neni 12 i Ligjit për OJQ-të kërkon nga organi kompetent që të mbajë një Regjistër të OJQ-ve me hollësitë mbi emrin, adresën, formën organizative dhe qëllimet, themeluesit e OJQ-së, emrin dhe informatat tjera të kontaktit të përfaqësuesit të saj të autorizuar, si dhe një indikacion nëse OJQ-ja ka status të përfituesit publik. Neni 12 parasheh që të gjitha OJQ-të të dorëzojnë një deklaratë vjetore tek organi kompetent në lidhje me ndryshimet. Për më tepër, regjistri është në dispozicion të publikut, me kushtin e ruajtjes së të dhënave.¹⁷³

1602. Neni 18 i Ligjit për OJQ-të gjithashtu obligon gjitha OJQ-të që kanë fituar statusin e përfituesit publik që të dorëzojnë një raport vjetor tek organi kompetent. Raporti vjetor domosdoshërisht duhet të përbëhet nga tri pjesë, që merren me menaxhmentin dhe administratën; aktivitetet dhe arritjet; si dhe pasqyrat financiare. Këto raporte i vihen publikut në dispozicion.

1603. Pa marrë parasysh faktin që raportet e dorëzuara nga OJQ-të tek organi kompetent (DRNOJQ) janë në dispozicion të publikut, paragrafi (9) i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT kërkon që ato raporte t'i vihen në dispozicion NjIF-it sipas kërmesës.

1604. Paragrafi (4) i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT gjithashtu kërkon që informatat dhe dokumentet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e llogarive, që dokumentojnë gjitha të ardhurat dhe shpenzimet, t'i vihen në dispozicion NjIF-it dhe organit kompetent.¹⁷⁴

1605. Ligji për OJQ-të dhe Ligji LPP/LFT vendos obligime për OJQ-të që të raportojnë dhe ofrojnë informata për administratën e tyre, operacionet dhe gjendjen financiare tek organi kompetent dhe tek NjIF-i. Informatat e tilla bëhen publike.

1606. Megjithatë, nuk ekzistojnë dispozita fuqizuese për DRNOJQ-në sipas Ligjit për OJQ-të që të kërkojë informata të tjera sipas nevojës – ndoshta, edhe pse nuk specifikohet, me përjashtim të qartësimeve në raportet e dorëzuara në pajtim me nenin 18 – me përjashtim të dokumenteve që ruhen nga OJQ-të për qëllimet e paragrafit (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT.

1607. Në këtë kuptim, paragrafët e propozuar (3) dhe (4) të nenit të ri të rekomanduar 2A në Ligjin për OJQ-të – shih analizën për KTh RV VIII.1 në këtë raport – parashohin mandatin e domosdoshëm ligjor dhe fuqizimin për DRNOJQ-në.

1608. Ngjashëm, si dhe pa anashkaluar faktin që OJQ-të janë të obliguara të raportojnë çdo akt apo transaksion të dyshimtë tek NjIF-i, neni 24 i Ligjit LPP/LFT nuk fuqizon NjIF-në që të kërkojë informata nga OJQ-të, përveç raporteve vjetore që hartohen sipas nenit 18 të Ligjit për OJQ-të si dhe dosjeve që ruhen sipas paragrafit (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT.

1609. Pra, rekomandohet që të shtohet një paragraf i ri (5A) në nenin 24 të Ligjit LPP/LFT, i cili, në përputhje me paragrafin e ri të propozuar (1.2A) në nenin 14 të Ligjit LPP/LFT,¹⁷⁵ fuqizon NjIF-në që të kërkojë informata, të dhëna apo dokumente nga OJQ-të për qëllimet e përbushjes së obligimeve të saj sipas Ligjit, përveç paragrafit (4) të nenit 24:

¹⁷³ Referojuni në analizën për KTh RV VIII.3.1. të këtij Raporti për më shumë informata e analiza.

¹⁷⁴ Shih ndryshimet e propozuara në paragrafin (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT, sipas analizës së KTh RV VIII.3.4 të këtij raporti

¹⁷⁵ Referojuni analizës KTh RV VIII.13,1 të këtij raporti.

Art 24 para (5A) Përveç autorizimeve sipas paragrafit (4) dhe atij (9) të këtij neni, për qëllimet e përmbushjes së obligimeve të saj sipas këtij Ligji, NJIF-i mund të kërkojë nga çdo OJQ informata, të dhëna apo dokumente sipas kërkesës së njesisë.

Bashkëpunimi, bashkërendimi dhe ndarja e informatave – Kriteri thelbësor RV VIII.4.1

1610. KTh RV VIII.4.1 parasheh themelimin e sistemeve efektive të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe ndarjes së informatave brenda vendit, deri në masën më të madhe të mundshme, mes gjitha autoriteteve apo organizatave përkatëse që mbajnë informata mbi OJQ-të, mbi brengat e mundshme të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit.

1611. Nuk ka dispozita për ndarjen e informatave nga DRNOJQ-ja në Ligjin për OJQ-të, pasi që gjitha raportet që dorëzohen në DRNOJQ sipas nenit 12 dhe atij 18 të Ligjit, bëhen publike. Megjithatë, DRNOJQ mund të posedojë informata tjera mbi OJQ-të që nuk bëhen publike, pra nuk ndahen.

1612. Paragrafi (1.5) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT kërkon nga NJIF-i dhe organet e institucionet tjera në Kosovë që të bashkëpunojnë ndërmjet vete dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin në kryerjen e detyrave të tyre, si dhe të bashkërendojnë aktivitetet në kompetencat e tyre, në përputhje me ligjet në fuqi. Kjo deklaratë është e përgjithshme, si dhe do të mund të aplikohet brenda kontekstit të dispozitave të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT mbi obligimet tjera të OJQ-ve.

1613. NJIF-i ka informuar që më 16 dhjetor 2011, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me DRNOJQ-në për këmbim informatash. Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton procedurat, kushtet dhe kriteret për këmbim të informatave dhe obligimet e secilës palë në trajtimin e informatave të këmbyerë. Përmes Marrëveshjes, NJIF-i mund të kërkojë informata nga DRNOJQ-ja, derisa ky i fundit duhet të jetë në përputhje *për qëllimet e analizës financiare, si dhe aktivitetet tjera brenda fushëveprimit të NJIF-it*. Megjithatë, derisa Marrëveshja obligon të dyja palët në kuptimin e kushteve të këmbimit të informatave, Memorandumi nuk fuqizon DRNOJQ-në që të kërkojë informata nga NJIF-i, duke krijuar kështu paqartësi.

1614. NJIF-i më tutje ka informuar, derisa DRNOJQ-ja ka konfirmuar, që sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, Njësia ka themeluar qasje/lidhje direkte me bazën e të dhënave në DRNOJQ. Një lidhje tjetër është për këmbimin e informatave me zyrtarët e DRNOJQ-së përmes platformës goAML, që është mënyrë e sigurt e këmbimit të informatave të brendshme.

1615. Në përgjigjet e saj në pyetësor, Administrata Tatimore ka informuar që varësisht nga kërkesat e organeve kompetente, ajo ofron gjitha informatat që ka për OJQ-të.

1616. Paragrafi (1.5) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT vendos obligimin tek të gjitha autoritetet kompetente që të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Megjithatë, nuk parasheh mekanizma për ta vënë këtë obligim në jetë.

1617. Në rastin e autoriteteve që mbajnë informata për OJQ-të, kjo bëhet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit si dhe në baza të kërkesave individuale – ku NJIF-i ka qasje të drejtpërdrejtë në bazën e të dhënave të DRNOJQ-së.

1618. Megjithatë rekomandohet rishikimi i nenit 4 të Memorandumit për të qartësuar më mirë obligimet e të dyja palëve.

1619. Kështu, derisa një lloj baze bashkëpunimi e ndarje të informatave mund të ekzistojë, efektshmëria e saj në praktikë nuk mund të matet.

1620. Rrjedhimisht, rekomandohet që autoritetet përkatëse që kanë informata për OJQ-të ose të bëhen pjesë e një grupi më të gjerë koordinues për parandalim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në kuptimin e obligimit sipas paragrafit (1.5) të nenit 14 të Ligjit LPP/LFT, ose të sigurojnë takime periodike për të diskutuar çështjet e rëndësishme dhe të dokumentojnë rezultatet e takimeve të tilla.

Qasja në informata për qëllime hetimi – Kriteri thelbësor RV VIII.4.2

1621. Kriteri thelbësor RV VIII.4.2 kërkon që autoritetet të kenë qasje të plotë në informatat e administratës dhe menaxhmentit të një OJQ-jë, në vazhden e një hetimi.

1622. Siç përshkruhet me analizën e KTh RV VIII.4 si më lart, Ligji për OJQ-të dhe Ligji PP/LFT vendosin obligime për OJQ-të që të raportojnë dhe të ofrojnë informata mbi administratën, operacionet dhe gjendjen financiare tek Organi Kompetent dhe NJIF-i. Informatat e tilla bëhen publike.

1623. Në pajtim me nenin 18 të Ligjit për OJQ-të, gjitha OJQ-të që kanë fituar statusin e përfituesit publik obligohen të dorëzojnë raport vjetor tek organi kompetent. Raporti vjetor gjithsesi duhet të ketë tri pjesë që merren me menaxhmentin dhe administratën, aktivitetet dhe arritjet, si dhe pasqyrat financiare.

1624. Për më tepër, dispozitat e Memorandumit mes NjIF-it dhe DRNOJQ-së i mundësojnë NjIF-it që të kërkojë dhe të marrë çdo informatë nga DRNOJQ-ja për të përmbushur përgjegjësitë e veta sipas Ligjit. Përmes kësaj marrëveshjeje, NjIF-i më tutje ka qasje direkte në bazat e të dhënave në DRNOJQ.

1625. Për më tepër, neni 119 i KPK-së i jep Prokurorit të drejtën të marrë gjitha dëshmitë dokumentare, duke përfshirë regjistrat financiarë. Për më tepër, nenet 70 - 73¹⁷⁶ të KPK-së së ri i jep autorizim agjencive të zbatimit të ligjit që të mbledhin informatat për të hetuar krimet në fazën fillestare hetimore.

1626. Pa marrë parasysh dorëzimin e raporteve vjetore, autorizimet e NjIF-it dhe DRNOJQ-së për kërkim të informatave duket të jenë të kufizuara. Në këtë drejtim, vlejné analiza dhe rekomandimet e dhëna si më lart tek KTh RV VIII.4.

1627. Dispozitat e KPK-së në lidhje me Prokurorin dhe agjencitë e zbatimit të ligjit megjithatë kontribuojnë pozitivisht në përputhshmërinë me KTh RV VIII.4.2.

Ekspertiza dhe kapacitetet hetimore – Kriteri thelbësor RV VIII.4.3

1628. KTh RV VIII.4.3 kërkon nga vendet që të zhvillojnë dhe zbatojnë mekanizma për këmbim të shpejtë të informatave mes gjitha autoriteteve kompetente relevante, për të ndërmarrë masa parandaluese apo hetimore, kur ka dyshim apo baza të arsyeshme për të dyshuar që një OJF e caktuar keqpërdoret për qëllime të financimit të terrorizmit, ose thjesht është mbulesë për financim të terrorizmit.

1629. Nëse një OJF duhet hetuar (si dhe nuk ka statistika për të vërtetuar nëse janë hetuar ndonjëherë), atëherë vlejné proceset normale hetimore dhe sanksionet penale të përshkuara tjetërkund. (neni 200 i KPK-së së vjetër, kapitulli IX i KPK-së së ri).¹⁷⁷

¹⁷⁶ Neni 201 i KPK-së së vjetër – Autorizimet e përgjithshme të policisë për hetim.

¹⁷⁷ FATF RV VIII 4.

1630. Fushëveprimi i veprave të terrorizmit përkufizohet me nenin 135 të KP-së së ri 04/L-082. nënparagrafi 4 definon grupin terrorist, por jo organizatën terroriste. Përkufizimi i financimit të terrorizmit në Ligjin LPP/LFT në nenin 2.1.36 parasheh;

Dhënia dhe mbledhja e fondeve, në çfarëdo mënyrë, direkt apo indirekt, me qëllimin që duhen përdorur, ose me njohurinë që do të përdoren, plotësisht apo pjesërisht, për të kryer ndonjërin prej veprave në kuptimin e neneve 112 dhe 113 të Kodit Penal të Kosovës, si dhe brenda përkufizimeve specifike të përcaktuara me FATF në Rekomandimin e veçantë II.

1631. Ekziston një ndryshim i propozuar në Ligjin LPP/LFT¹⁷⁸ që veçanërisht penalizon financimin e organizatave terroriste

36.B.1. Kushdo, kur kryen veprën me dashje, merr pjesë si bashkëpunëtor, ofron apo mbledh fonde, apo organizon ose drejton të tjerët për të ofruar apo mbledhur fonde ose bën përpjekje për ta bërë këtë, me çfarëdo mënyrë, direkt apo indirekt, me qëllimin që ato të përdoren apo me njohurinë që do të përdoren, në tërësi apo pjesërisht:

1.1 për të kryer një akt terrorist;

1.2 nga një terrorist; ose

1.3 nga një organizatë terroriste;

Konsiderohet të ketë kryer veprën e financimit të terrorizmit.

2. Vepra kryhet pa marrë parasysh ndodhjen e aktit terrorist të përmendur në paragrafin 1, ose pa marrë parasysh nëse fondet janë përdorur në të vërtetë për të kryer atë vepër.

1632. Ndryshimet si më lart nuk përmbajnë definicionin e organizatës terroriste.

1633. Siç është theksuar më herët në këtë nen, në regjistrimin e OJQ-ve, DRNOJQ-ja nuk ndërmerr procedura të analizës së thukët të themeluesve, e as nuk përcjell ndërrimet në pronësi përmes një procesi të kujdesit të shtuar. Për më tepër, DRNOJQ-ja thekson që nuk është në fushëveprimin e vet ligjor që të kontrollojë nëse OJQ-ja themelohet për aktivitete kriminale, përveç deri në masën e ndalimeve në Ligjin për OJQ-të për themelimin e OJQ-ve, pra ndalesa sipas paragrafit (1.4) të nenit 10. Kështu, është e vështirë të identifikohen OJQ-të e tilla që autoritetet relevante të ndërmarrin hetime.

1634. Për më tepër, qëndrimi i DRNOJQ-së që nuk ka mandat mbikëqyrës sipas Ligjit për OJQ-të, pra as mandat mbikëqyrës për qëllimet e nenit 24 të Ligjit LPP/LFT mbi obligimet tjera të OJQ-të sipas Ligjit, është e vështirë për DRNOJQ-në apo ndonjë autoritet tjetër që të identifikojnë nëse një OJQ e caktuar keqpërdoret për qëllime të financimit të terrorizmit, si dhe për t'i hetuar ato.

1635. Kështu, pa anashkaluar atë që theksohet më lart, nëse duhet hetuar një OJQ, atëherë proceset hetimore normale dhe sanksionet penale të përshkruara tjetërkund në këtë raport do të vlenin, pra ka problem serioz nëse OJQ-të që duhen hetuar nuk mund të identifikohen.

1636. Rrjedhimisht, rekomandimet e bëra në këtë pjesë të raportit për autorizimet mbikëqyrëse të DRNOJQ-së, si dhe për aplikimin e masave të kujdesit të duhur (analizës së thukët) të themeluesve fitojnë edhe më shumë rëndësi.

¹⁷⁸ Neni 36B.

Pikat e kontaktit dhe procedurat për kërkesa ndërkombëtare – Kriteri thelbësor RV VIII.5

1637. KTh RV VIII.5 kërkon nga vendet që të kenë persona kontakti të mirëfilltë, si dhe procedura për të reaguar ndaj kërkesave ndërkombëtare për informata në lidhje me OJF-të e caktuara që dyshohen për financim terrorizmi e forma tjera të përkrahjes për terrorizmin.

1638. Ligji për OJQ-të është i heshtur tek pika e ndarjes së informatave me autoritetet tjera, por siç është theksuar më herët, gjitha raportet e dorëzuara nga OJQ-të në pajtim me Ligjin për OJQ-të, bëhen publike.

1639. Paragrafi (1.7) i nenit 14 të Ligjit LPP/LFT fuqizon NjIF-në që, spontanisht apo me kërkesë, të këmbjë informata me ndonjë agjenci të huaj simotër që kryen funksione të ngjashme, si dhe i nënshtrohet obligimeve të ngjashme të konfidencialitetit, pa marrë parasysh natyrën e agjencisë, me kushtin e reciprocitetit.

1640. Në bazë të këtyre dispozitave, NjIF-i nënshkruan Memorandume Mirëkuptimi me homologët e saj të huaj, përmes të cilave përcaktohen personat kontaktues dhe procedurat për këmbimin e informatave dhe të tjera.

1641. Pavarësisht kësaj, në përgjigjet e veta ndaj pyetësorit në lidhje me Rekomandimin 26, NjIF-i ka informuar që ende nuk ka arritur as që të aplikojë për anëtarësim në Grupin Egmont, dhe se nuk merr parasysh *‘Parimet për Këmbim Informatash mes njërive të inteligjencës financiare për rastet e pastrimit të parave’* të Grupit Egmont.

1642. Për më tepër, bashkëpunimi ndërkombëtar apo informatat që kërkohen, si dhe nuk bëhen drejtpërdrejt mes NjIF-ve, duhen referuar përmes NJBNZL-së (ILECU), brenda Ministrisë së Brendshme, si dhe Departamentit për ndihmë juridike ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë. Nuk ka ndonjë provë që kjo ka ndodhur ndonjëherë me OJQ-të.

1643. Deri në një masë, duket që Kosova ka të përcaktuar personat kontaktues dhe procedurat për reagim ndaj kërkesave ndërkombëtare. Edhe pse procedurat e tilla nuk janë vendosur veçanërisht për OJQ-të, procedurat e përcaktuara mund të përdoren në këto raste.

1644. Pa anashkaluar këto, këshillohet që, pa marrë parasysh që nuk ka aplikuar ende për anëtarësim në Egmont, NjIF-i duhet të marrë parasysh Parimet e Egmontit për këmbim informatash në përcaktimin e procedurave përmes memorandumeve me NjIF-të e huaja.

1645. Megjithatë, brengat e shprehura në analizën për KTh RV VIII.4,3, të këtij Seksioni në lidhje me identifikimin e OJQ-ve që mund të keqpërdoren apo themelohen për qëllime të paligjshme, si financimi i terrorizmit, mund të ndikojnë negativisht në këmbimin efektiv të informatave në reagim ndaj kërkesave të huaja.

1646. Kështu, rekomandimet e dhëna aty fitojnë edhe më shumë rëndësi në këtë kontekst.

Efektshmëria

1647. Ky raport shpreh brengën serioze në lidhje me efektshmërinë e sistemit të OJQ-ve. Edhe pse ka një proces regjistrimi, nuk ka ndonjë procedurë të analizës së thukët. Për më tepër, duket që procesi ndalon në fazën e regjistrimit, pasi që DRNOJQ-ja pohon që regjistrimi dhe çregjistrimi është i vetmi mandat që ka sipas Ligjit për OJQ-të.

1648. Nuk ka ndonjë përafrim me sektorin, monitorimi i sektorit mungon plotësisht nga autoritetet tatimore për qëllime tatimore, si dhe kjo është është tejet e kufizuar, për shkak të detyrimeve të vogla tatimore të OJQ-ve, si dhe ka konflikte mes Ligjit LPP/LFT dhe Ligjit për OJQ-të.

1649. Brengat për efektshmërinë e regjimit më tutje theksohen për faktin që një OJQ mund të kërkojë statusin e institucionit financiar sipas Ligjit për bankat.¹⁷⁹

5.2. Rekomandimet dhe komentet

1650. Disa dispozita në Kriteret thelbësore për masat parandaluese për RV VIII mund të gjenden në legjislacionin në zbatim apo edhe në praktikë. Megjithatë, janë identifikuar një numër mangësish që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të regjimit të OJQ-ve.

1651. Derisa rekomandohet fuqimisht që të lexohet pjesa e plotë e analizës dhe komenteve, për KTh përkatës në vijim janë dhënë indikacionet e dobësive kryesore të identifikuara:

- Nuk ka vlerësim të ligjeve dhe rregulloreve si dhe të rreziqeve e cenueshmërisë, pasi që asnjë autoritet nuk mbart këtë përgjegjësi (KTh RV VIII.1);
- Nuk ka obligim për përafrim e as obligim ligjor për autoritetet që të bëjnë aktivitete përafrimi me sektorin e OJQ-ve, pra asnjë autoritet nuk mbart këtë përgjegjësi (KTh RV VIII.2);
- Mbikëqyrja e kujdesit apo monitorimi i cilësdo kategori të OJQ-ve mungojnë plotësisht (KTh RV VIII.3);
- Dykuptimësia ligjore për mbikëqyrjen e OJQ-ve për qëllimet e Ligjit LPP/LFT në kuptimin e nenit 30, që i bën autorizimet mbikëqyrëse të pazbatueshme (KTh RV VIII.3);
- Anomalia e autorizimeve mbikëqyrëse në nenin 5 të Memorandumit të Mirëkuptimit (KTh RV VIII.3);
- Nuk ka obligim për OJQ-të që të mbajnë informata të qeverisjes së tyre në baza të vazhdueshme në të gjitha instancat (KTh RV VIII.3.1);
- Nuk ka obligim për të identifikuar dhe raportuar informatat mbi pronarin(ët) e një OJQ-je, nëse është ndryshe nga themeluesit (KTh RV VIII.3.1);
- Ligji për OJQ-të nuk përcakton sanksione kujdesi për shkeljet e nenit 4 dhe paragrafit (11) të nenit 9 të Ligjit për OJQ-të (KTh RV VIII.3.2);
- Ka konflikt mes paragrafit (8) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT si dhe nenit 21 të Ligjit për OJQ-të, për autorizimet sanksionuese të organit kompetent (KTh RV VIII.3.2);
- Nuk ka procedura të kujdesit të duhur për themeluesit në fazën e regjistrimit (KTh RV VIII.3.3);
- Nuk ka dispozita fuqizuese për DRNOJQ-në sipas Ligjit për OJQ-të, për të kërkuar informatat që i nevojiten (KTh RV VIII.4);
- Neni 24 i Ligjit LPP/LFT nuk e fuqizon NjIF-në që të kërkojë informata shtesë nga OJQ-të (KTh RV VIII.4);
- Dykuptimësia në nenin 4 të Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkëpunim mes NjIF-it dhe DRNOJQ-së (KTh RV VIII.4.1);
- Çështjet e efektshmërisë në këmbimin e informatave dhe bashkërendimin mes autoriteteve me informatat relevante për OJQ-të (KTh RV VIII.4.1);

¹⁷⁹ Pa paragjykuar Vendimin për masa të përkohshme që është marrë nga Gjykata Kushtetuese më 24 dhjetor 2012

- Brenga e mundësisë së hetimit të OJQ-ve që keqpërdoren për financim të terrorizmit ose që janë themeluar për mbledhje fondesh për terrorizëm (KTh RV VIII.4.3); si dhe
- Çështjet e efektshmërisë në lidhje me pikëpamjet e ngushta të DRNOJQ-së për përgjegjësitë e tij sipas Ligjit për OJQ-të dhe këmbimin e informatave.

1652. Pasi ka identifikuar mangësi apo dobësi, raporti ofron rekomandime konkrete për korrigjimin e tyre. Pra, rekomandohet fuqimisht që të lexohen plotësisht analiza dhe rekomandimet e dhëna në këtë pjesë, që merren me RV VIII, për ta pasur të qartë kontekstin e rekomandimeve:

- Shtimi i një neni të ri 2A për “Përcaktimin dhe kompetencat e organit kompetent” në Ligjin për OJQ-të, duke vendosur kompetencat e organit kompetent në lidhje me përcaktimin, funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit; mbikëqyrjen e OJQ-ve; si dhe vlerësimin periodik të rrezikut, duke përfshirë këmbimin e informatave;
- Ndryshimi i definicionit të “organit kompetent” në nenin 2 të Ligjit për OJQ-të;
- Heqja e dykuptimësisë ligjore në autorizimet mbikëqyrëse në nenin 30, si dhe përcaktimi i autoritetit për monitorimin e OJQ-ve për qëllimet e nenit 24 të Ligjit LPP/LFT;¹⁸⁰
- Ndryshimi i paragrafit (11) të nenit 9 të Ligjit për OJQ-të, që kërkon nga OJQ po ashtu të raportojë ndryshimet në lidhje me paragrafin (4.2) dhe (4.3) i nenit 18 të Ligjit mbi OJQ.
- Shtimi i një paragrafi të ri (3A) në nenin 12 të Ligjit për OJQ-të, duke obliguar OJQ-të që të ruajnë informatat e nevojshme për Regjistrin, si dhe informata të tjera që kërkohen me raportin vjetor, në baza të vazhdueshme;
- Të merret parasysh vendosja e sanksioneve të kujdesit për shkelje të nenit 4 dhe paragrafit (11) të nenit 9 të Ligjit për OJQ-të;
- Harmonizimi i nenit 24 të Ligjit LPP/LFT dhe nenit 21 të Ligjit për OJQ-të për autorizimet sanksionuese të organit kompetent;
- Shtimi i një paragrafi të ri (1.3) në nenin 21 të Ligjit për OJQ-të, duke bërë ndërlidhjen me nenin 24 të Ligjit LPP/LFT për shlyerjen e regjistrimit për mosrespektimit të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT;
- Shtimi i masave në procedurat e brendshme të licencimit në DRNOJQ për kujdes të duhur për themeluesit, së paku duke iu referuar listës së Kombeve të Bashkuara dhe listave tjera të personave dhe subjekteve të përcaktuara;
- Ndryshimi i paragrafit (4) të nenit 24 të Ligjit LPP/LFT për të paraparë mirëmbajtjen e dosjeve të transaksioneve dhe disponueshmërinë e tyre për autoritetet kompetente;
- Shtimi i një paragrafi të ri (5A) në nenin 24 të Ligjit LPP/LFT, duke fuqizuar NjIF-në që të kërkojë informata, të dhëna apo dokumente nga OJQ-të për qëllimet e përmbushjes së obligimeve të saj sipas Ligjit, përtej paragrafëve (4) dhe (9) të të njëjtit nen;
- Rishikimi i nenit 4 të Memorandumit të Mirëkuptimit mes NjIF-it dhe DRNOJQ-së;
- Vendosja e mekanizmave praktikë për bashkëpunim dhe këmbim informatash mes autoriteteve relevante për sektorin e OJQ-ve;

¹⁸⁰ Projektligji për ndryshim/plotësim të Ligjit LPP/LFT propozon që kjo përgjegjësi t’i jepet NjIF-it.

- Ndërmarrja e një vlerësimi të rreziqeve e cenueshmërisë ndaj të cilave OJQ-të mund të ekspozohen, ose që mund të keqpërdoren për financim të terrorizmit, si dhe implementimi i një programi përafrimi me OJQ-të, për të rritur vetëdijen për rreziqe e cenueshmëri të tillë, duke përfshirë seanca trajnuese të vetëdijesimit;
- DRNOJQ-ja duhet të ndërmarrë një vlerësim strategjik për të vlerësuar se cilat OJQ mbajnë një pjesë të konsiderueshme të resurseve financiare nën kontroll, apo që kanë një hise të konsiderueshme të aktiviteteve ndërkombëtare të sektorit. Ky vlerësim duhet ndarë me NjIF-në;
- Zgjerimi i Urdhëresës administrative të NjIF-it, duke kërkuar nga subjektet raportuese që t'i kushtojnë vëmendje të veçantë individëve dhe organizatave të përcaktuara sipas RSKSB-së; si dhe
- Implementimi i pjesëve relevante të Strategjisë LPP/LFT me efekt të menjëhershëm.

5.3. Klasifikimi për Rekomandimin e veçantë VIII

1653. Edhe pse Kosova ka zhvilluar një sistem adekuat për regjistrimin e OJQ-ve, derisa Ligji LPP/LFT ka vendosur obligime tek ato, duke përfshirë raportimin e akteve apo transaksioneve të dyshimta, janë identifikuar gjithsesi dobësi të ndryshme në lidhje me regjistrimin, mbikëqyrjen dhe mbajtjen e librave të tyre. Për më tepër, mungesa e mbikëqyrjes dhe çështjet e efektshmërisë në bashkëpunim dhe këmbim informatash ndikojnë negativisht në implementimin e një pjese të madhe të kërkesave sipas RV VIII. Rrjedhimisht, në këtë kontekst, nota për RV VIII është e dobët (nuk ka përputhshmëri).

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
RV VIII	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka vlerësim të rrezikut të sektorit; • Nuk ka obligim për përafrim apo obligim ligjor që autoritetet të bëjnë përafrim të tillë me sektorin e OJQ-ve; • Mungesa e mbikëqyrjes së kujdesit; • Dykuptimësia ligjore tek autorizimet mbikëqyrëse për OJQ-të, sipas nenit 30 të Ligjit LPP/LFT; • Rrjedhimisht edhe mungesa e mbikëqyrjes për LPP/LFT; • Nuk ka obligim për mbajtjen e informatave të qeverisjes në baza të vazhdueshme në të gjitha instancat; • Nuk ka obligim për identifikim dhe raportim të informatave për pronarin(ët) e një OJQ-je; • Sanksionet e kujdesit nuk janë në dispozicion për gjitha shkeljet sipas Ligjit për OJQ-të; • Konflikti mes Ligjit LPP/LFT dhe Ligjit për OJQ-të; • Nuk ka procedura të kujdesit të duhur për themeluesit në fazën e regjistrimit; • Nuk ka dispozita fuqizuese për DRNOJQ-në që të kërkojë informatat tjera që i nevojiten; • Nuk ka dispozita fuqizuese sipas Ligjit LPP/LFT që NjIF-i të kërkojë informatat tjera që i nevojiten; • Brengat për identifikimin e OJQ-ve që duhen hetuar, pra edhe për mundësinë e hetimeve; si dhe • Çështjet e efektshmërisë që kanë të bëjnë me pikëpamjet e ngushta të DRNOJQ-së mbi përgjegjësitë e tij si dhe në

	Klasifikimi	Përmbledhje e faktorëve bazë për klasifikim
		këmbimin e informatave.

6. BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

6.1. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi kombëtar (R.31)

6.1.1. Përshkrimi dhe analiza

Bashkëpunimi i nivelit të lartë

1654. Ndonëse rolet e autoriteteve të ndryshme që kanë një funksion në LPP/LFT janë qartësuar deri në një shkallë të caktuar në pjesë të ndryshme të legjislacionit, ende ka shumë punë për t'u bërë për të siguruar funksionalitetin e plotë të zinxhirit duke filluar me mbledhjen e informatave dhe duke përfunduar me nxjerrjen e aktgjykimit. Në këtë aspekt, zbatimi i suksesshëm i një strategjie të bashkuar të LPP/LFT është jetike për Kosovën.

1655. Në këtë nivel politikash, zhvillimi më i rëndësishëm ka të bëjë me hartimin e strategjisë për LPP/LFT që u miratua në shtator të vitit 2012. Për zbatimin e kësaj strategjie është themeluar një grup punues i përbërë nga agjenci të ndryshme. Nëse dhe kur të përfundohet, kjo strategji do të ketë një ndikim të madh në kapacitetin e Kosovës për të organizuar dhe informuar vetëm për të luftuar më mirë kërcënimet që burojnë nga pastrimi i parasë, krimi ekonomik dhe financimi i terrorizmit.

1656. Kjo strategji përcakton një hartë për:

- *Të krijuar dhe punësuar personelin e Zyrës kombëtare për luftimin e krimeve ekonomike.*
- Të rishkruar apo ndryshuar në masë të konsiderueshme Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për të qenë në përputhje të plotë me FATF 40 dhe të drejtën e Bashkimit evropian.
- Të përfunduar vlerësimin e rrezikut për LShP/LFT në Kosovë.
- T'u anëtarësuar në grupin Egmont të NjIF.
- Të nënshkruar marrëveshje ndërqeveritare me NjIF fqinje dhe me vendet me të cilat Kosova ka bashkëpunim.
- Të ndërtuar dhe mirëmbajtur kapacitetin e komunitetit të zbatimit të ligjit për të përbushur detyrimet e tyre.
- Të themeluar Institutin Kombëtar për Krimet Ekonomike që do të jetë përgjegjës për të gjitha llojet e trajnimeve për LPP/LFT dhe për ngritjen e vetëdijesimit.
- Të identifikuar në mënyrë të vazhdueshme nevojat për trajnim dhe për të hartuar dhe organizuar kurse sipas nevojës.
- Të mbajtur komunikimin me komunitetin e zbatimit të ligjit përmes masmediave të shtypura dhe elektronike.
- Të vendosur kanalet e komunikimit me hisedarët privat dhe shoqërinë civile, posaçërisht OJT.
- Të përfshirë praktikën e drejtimit të përqendruara në parandalimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe veprave të financimit të terrorizmit.
- Të përcjellë hetimit dhe ndjekjet penale me qëllim të shtimit të arrestimeve, dënimeve, konfiskimeve dhe sekuestrimeve.
- Të zgjeruar përgjegjësinë për hetimet e pastrimit të parasë për të gjitha agjencitë e zbatimit të ligjit kur nisen të gjitha ndjekjet e krimeve.
- Të mirëmbajtur komunikimin dhe bashkëpunimin me komunitetin e zbatimit të ligjit përmes takimeve të rregullta të grupit punues për krimet ekonomike.
- Të pasur një hetim të task forcës me burime të mjaftueshme dhe të udhëhequr nga inteligjenca të përmasave të papara.

- Të siguruar se Kosova ka një program të mirëfilltë analize të udhëhequr nga inteligjenca për luftimin e financimit të terrorizmit.

1657. Zyra kombëtare duhet të shërbejë si një mekanizëm kyç i bashkërendimit dhe mbikëqyrjes për veprimtaritë e të gjithë aktorëve qeveritarë në fushën e luftimit të krimit ekonomik, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

1658. Këshilli Prokurorial i Kosovës rishtazi ka hartuar një Plan strategjik për bashkëpunimin ndërinstitucional në luftën kundër krimit dhe korrupsionit 2013-2015. Nuk ishte e qartë nëse ky dokument ishte miratuar apo nëse është hartuar plani i veprimit ashtu siç parashikohej.

1659. Ky dokument mëton të përmirësojë bashkëpunimin midis agjencive dhe shkëmbimin e informatave në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

1660. Qëllimet e strategjisë përfshijnë përmirësimin dhe standardizimin e bashkëpunimit midis agjencive si edhe të informatave për zbulimin, hetimin, ndjekjen penale dhe vendimet gjyqësore për llojet e veçanta të rasteve penale, të cilat *përfshijnë* pastrimin e parave si një nga synimet. Strategjia gjithashtu mëton që të *përmirësojë identifikimin e përfitimeve materiale nga veprat penale dhe që të ngritë nivelin e konfiskimit të përfitimeve materiale nga veprat penale*. Synimet po ashtu rendisin parandalimin e pastrimit të parave, përmirësimin e cilësisë së informatave dhe të dhënave statistikore në dispozicion, ndër të tjera në lidhje me veprat penale të pastrimit të parave. Ndër veprimtaritë kyçe të strategjisë janë: nënshkrimi i MM në mes të agjencive, trajnimet e përbashkëta, standardizimi i formularëve të kallëzimeve penale, harmonizimi i informatave statistikore që mbahen nga institucionet e ndryshme qeveritare. Strategjia gjithashtu përcakton emërimin (nga Prokurori i Shtetit dhe shefi i PSRK) e prokurorëve ekspert të cilët në të vërtetë do të jenë përgjegjës për ofrimin e mbështetjes së plotë për zbatimin e të gjitha aspekteve të strategjisë.

1661. Po që se zbatohen në mënyrë efektive, masat e përcaktuara me strategji do të zbusnin në masë të konsiderueshme mangësitë e identifikuar në këtë raport vlerësimi, duke qenë se kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërinstitucional dhe harmonizimin e sistematizimin e të dhënave statistikore. Sipas mendimit të ekipit vlerësues, strategjia e KPK duhet të jetë më e saktë përkritazi me promovimin e informatave kthyesë në mes të autoriteteve gjegjëse e që do të arrihej përmes futjes së obligimeve detyruese në MM. Kjo gjë duhet gjithashtu të ceket në planin e veprimit të strategjisë.

1662. Është e qartë se strategjia e KPK dhe ajo kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik mbulojnë një numër të çështjeve të njëjta. Kjo ngjallë shqetësimin për atë se si këto dy strategji ndërliken në lidhje me zbatimin praktik. Strategjia kundër pastrimit të parave do të bashkërendohet nga Ministria e Financave ndërsa dokumenti i KPK-së nga Zyra e Prokurorit të Shtetit. Është e rëndësishme që të ketë bashkëpunim strategjik të nivelit të lartë në nivel të këtyre institucioneve dhe në nivel çfarëdo organeve përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e dy strategjive dhe planeve të veprimit. Tani për tani, duhet se ky bashkëpunim po mungon, duke qenë se lista e institucioneve që janë konsultuar gjatë hartimit të strategjisë së KPK nuk ka përfshirë NJIF apo Ministrinë e Financave.

1663. Në nivel qeveritar ekziston një Bord i përbashkët bashkërendues për sundimin e ligjit që bashkërendon politikat kombëtare dhe nismat në mes të ministrive të qeverisë. Ky bord kryesohet nga zëvendëskryeministri Kuçi dhe PSBE në Kosovë. Bordi diskuton çështje të ndryshme që përfshihen në fushën e sundimit të ligjit duke filluar me shërbimin korrektues, ligjin për konfiskimin e pasurisë, mbrojtjen e dëshmitarëve, pastrimin e parave, etj. Bordi takohet çdo tre mua. Ky bord duhet gjithashtu të jetë i njoftuar për zbatimin e të dyja strategjive, pra për zbatimin e strategjisë kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik dhe

planit strategjik të KPK-së për të siguruar bashkërendimin dhe plotësimin me çështjet e tjera që diskutohen në rendin e tij të ditës.

Bashkëpunimi operativ dhe bashkërendimi

1664. Bashkëpunimi operativ në mes të autoriteteve të ndryshme është përshkruar në hollësi në pjesë të ndryshme të këtij Raporti (shih pjesën 2.6-2.8). Në përgjithësi, është e qartë se agjencitë e zbatimit të ligjit janë ende në fazën fillestare të krijimit të mekanizmave të duhur dhe sistematik për shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimin në mes të agjencive. Për këtë qëllim, Policia, Doganat, NjIF dhe prokurorët kanë nënshkruar disa marrëveshje të mirëkuptimit; megjithatë, disa aranzhime kyçe, të tilla si MM në mes të Policisë dhe NjIF¹⁸¹, NjIF dhe Prokurorisë, janë në hartim e sipër apo ende nuk janë shqyrtuar. Disa MM (NjIF-Banka Qendrore) janë të vjetërsuara duke qenë se janë trashëguar nga koha e UNMIK-ut dhe si të tilla nuk pasqyrojnë kornizën e tanishme rregullatore. Ato as nuk respektohen ashtu siç duhet nga agjencitë pjesëmarrëse, për shembull informatat kthyese në mes të Bankës Qendrore dhe NjIF duket se janë një çështje (në të dyja anët) ndonëse MM ekziston dhe është në fuqi.

1665. Disa MM që ekzistojnë në mes të agjencive të ndryshme mbulojnë vetëm shkëmbimin e informatave sipas kërkesës apo të dhëna të veçanta, të tilla si RTP nga doganat për NjIF. Përndryshe nuk ekzistojnë mekanizmat sistematik për bashkërendimin operativ në mes të autoriteteve kompetente, dhe Zyra kombëtare mund të jetë një forum i duhur për ndërmarrjen e përpjekjes së organizuar për të bashkërenduar aktorët e ndryshëm qeveritarë.

Efikasiteti

1666. Në përgjithësi regjimi kundër pastrimit të parave, si një sistem shumë nivelesh në mes të agjencive të ndryshme, ishte në gjendje që të prodhonte një numër rezultatesh sporadike dhe të parëndësishme. Ndonëse mund të jetë e padrejtë që të këto rezultate të vogla të konsiderohen si të rastësishme, në përgjithësi ato më shumë vërtetojnë sesa që mohojnë paaftësinë e përgjithshme të zinxhirit institucional të LPP për të funksionuar në një mënyrë të duhur dhe të integruar, me përfshirjen e të gjitha pjesëve përbërëse të tij: Raportimit – inteligjencës/analizës – hetimit – ndjekjes penale – dënimit/konfiskimit. Kjo shkaktohet nga një numër i faktorëve të gërshetuar duke përfshirë mungesën e bashkëpunimit sistematik/mekanizmave bashkërendues dhe informatave kthyese nga të gjitha segmentet si dhe kryesisht nga mungesave e burimeve të nevojshme.

1667. Analiza e pjesëve të ndryshme, e kryer në këtë raport, gjithashtu ka prodhuar një listë të gjerë të faktorëve të veçantë në nivel të institucioneve të veçanta që ndikojnë negativisht në sistemin si tërësi ndërsa faktorët më të rëndësishëm janë si në vijim:

- Efikasiteti i ulët në pjesën parandaluese që në mënyrë të konsiderueshme është e vështirësuar nga regjimi i mangët rregullator (mangësi të mëdha në Ligjin për LPP/LFT dhe dokumentet e tjera) dhe mungesa e mbikëqyrjes së duhur dhe regjimit të zbatimit/sanksionimit. Kjo do të thotë se sistemi parandalues po dështon në masë të madhe sa i përket dy funksioneve të tija kryesore: pengimin e hyrjes së të ardhurave kriminale në sistemin financiar dhe sigurimin e asaj se autoritetet gjegjëse janë të njoftuar kur këto gjëra ndodhin;

¹⁸¹ Ekipi i vlerësimit është informuar në vijim se NjIF dhe Policia kanë nënshkruar MB me 19 shkurt 2013, megjithatë kjo bjen jashtë fushëveprimit të këtij vlerësimi, pasi që nënshkrimi është bërë më shumë se dy muaj pas vizitës në terren.

- Pozita e paqëndrueshme e NjIF që pasqyrohet në kapacitetin e saj për të zgjeruar bashkëpunimin me autoritetet e tjera vendase, qasjen në informata dhe përmirësimin e cilësisë së analizave;
- Ngurrimi, mungesa e mirëkuptimit dhe i kapacitetit të agjencive të zbatimit të ligjit/prokurorëve për të hetuar/ndjekur penalisht pastrimin e parave dhe konfiskimin dhe sekuestrimin e të ardhurave kriminale;
- Mungesa e kapaciteteve në gjyqësor dhe ngurrimi i kësaj dege për të pasur një qasje aktive në çështjet e konfiskimit dhe sekuestrimit të ardhurave kriminale.

6.1.2. Rekomandimet dhe komentet

1668. Me strategjitë e KPK dhe LPP, qeveria ka demonstruar se kupton që ekzistojnë probleme të rëndësishme në mes të agjencive; përndryshe miratimi i një strategjie vetëm për qëllime të bashkëpunimit ndërinstitucional (nga KPK) nuk do të ishte i nevojshëm. Megjithatë ky veprim drejt politikave do të kërkojë përpjekje dhe burimeve të konsiderueshme për t'u zbatuar në mënyrë efektive duke marrë parasysh mangësitë e mëdha në sistem.

1669. Me qëllim të përmirësimit të mangësive në fushën e bashkëpunimit në mes të agjencive, autoritetet në Kosovë duhet ta kenë prioritet zbatimin e strategjive të KPK dhe LPP/krimin ekonomik. Kjo, megjithatë, duhet të bëhet në një mënyrë të bashkërenduar duke pasur parasysh një numër të çështjeve të gërshetuara në të dyja dokumentet.

1670. Sipas mendimit të ekipit të vlerësimit, strategjia e KPK duhet të jetë më e saktë në lidhje me promovimin e informatave kthyesë në mes të autoriteteve gjegjëse e që mund të arrihet duket futur obligime detyruese në MM. Kjo po ashtu duhet të ceket në planin e veprimit të kësaj strategjie.

1671. Bordi i përbashkët bashkërendues për sundimin e ligjit duhet mbahet i njoftuar për zbatimin e të dyja strategjive, pra për zbatimin e strategjisë kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik dhe planit strategjik të KPK-së, për të siguruar bashkërendimin dhe plotësimin me çështjet e tjera që diskutohen në rendin e tij të ditës

6.1.3. Vlerësimi për rekomandimin nr. 31

	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
R. 31	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e informatave kthyesë, ndarjes së informatave dhe bashkërendimit në mes të autoriteteve rezulton në mosefikasitetin e përgjithshëm të regjimit LPP; • Mungesa e bashkërendimit në nivelin e planifikimit strategjik dhe politikëbërjes në mes të institucioneve kyçe (KPK dhe Ministrisë së Financave); • Vonesat në zbatimin e strategjisë kombëtare e posaçërisht në themelimin e Zyrës Kombëtare për luftimin e krimeve ekonomike.

6.2. Ndihma juridike ndërkombëtare (R. 36)

6.2.1. Përshkrimi dhe analiza

Detyrimet e bazuar në traktat për NNJ

1672. Ndonëse Kosova ka miratuar legjislacionin e duhur vendas, në mbështetje të së cilit mund të bëhet palë e traktateve ndërkombëtare (Ligji nr. 04/L-052 për marrëveshjet ndërkombëtare), pozita e saj e veçantë si subjekt i së drejtës ndërkombëtar (për shkak të njohjes së saj të pjesshme si shtet sovran) deri më tani ka penguar atë në nënshkrimin e konventave multilaterale (evropiane apo rajonale) për ndihmën juridike ndërkombëtare. Edhe pse Kosova nuk ka detyrime multilaterale që burojnë nga traktatet për ndihmën juridike në çështjet penale, ajo megjithatë ka nënshkruar disa marrëveshje bilaterale në këtë fushë.

1673. Megjithatë, nga të gjithë këto marrëveshje, vetëm disa prej tyre në të vërtetë i referohen ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në çështjet penale dhe janë në të vërtetë në fuqi, pra një marrëveshje është nënshkruar me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe një tjetër me Kroacinë (marrëveshjet e zbatueshme pra mbulojnë vetë këto dy vende në rajon). Ekziston edhe një marrëveshje tjetër bilaterale e NJD me Turqinë që është ratifikuar nga Kosova por jo edhe nga pala tjetër dhe dy marrëveshje të tjera (me Shqipërinë dhe Gjermaninë) që tani për tani janë në përfundim e sipër.

Gama më e mundshme e gjerë e ndihmës së ndërsjellë juridike ndërkombëtare/ofrimi i ndihmës me kohë, në mënyrë konstruktive dhe efektive - (Kriteri thelbësor R.36.1)

1674. Ofrimi i ndihmës juridike ndërkombëtare nga Kosova është përcaktuar me anë të Ligjit nr. 04/L-031 (2011) për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për NNJ) që është në fuqi që nga tetori i vitit 2011 (para miratimit të këtij ligji, dispozitat e caktuara përcaktoheshin me anë të Kodit të përkohshëm të procedurës penale). Në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe një shteti të huaj, ndihma juridike ndërkombëtare mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit (neni 1.2 i Ligjit për NNJ).

1675. Format e mundshme të ndihmës juridike ndërkombëtare mbulojnë një gamë të gjerë të fushave, duke përfshirë ndihmën juridike në çështjet penale në përgjithësi (kreu XII), ekstradimin (krerët II deri IV) apo transferimin e procedurave penale (krerët V deri VII).

1676. Sa i përket ndihmës juridike procedurale në çështjet penale, lutjet për ndihmë juridike ndërkombëtare dorëzohen përmes Ministrisë së Drejtësisë (Departamenti për bashkëpunim juridik ndërkombëtare) e që më pas i dorëzohet autoritetit gjyqësor vendas (neni 3.1 i Ligjit për NNJ). Autoriteti gjyqësor vendas mund të jenë, së paku në teori, gjykatat apo prokuroritë (neni 2.1.7) por për qëllimet e ndihmës juridike ndërkombëtare autoriteti vendas gjithmonë duhet të jetë prokuroria që ekzekuton letrën e porosisë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Nëse Kodi i Procedurës Penale përcakton se për zbatimin e kësaj mase nevojitet urdhri i gjykatës, atëherë prokurori kompetent do t'ia paraqes kërkesën e nevojshme gjykatës (neni 75).

1677. Sipas nenit. 73.1 të Ligjit për NNJ autoriteti gjyqësor vendas për ekzekutimin e letrës së porosisë së huaj duhet të jetë gjithmonë zyra e prokurorit të qarkut. Megjithëkëtë, Ministria e Drejtësisë ka përcaktuar se, në praktikë, kjo dispozitë duhet të interpretohet në përputhje me Ligjin për PSRK që i jep juridiksion të veçantë Zyrës së prokurorisë speciale në çështjet e veçanta si pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit. Si rrjedhojë, Ministria e interpreton nenin 73.1 të Ligjit për NJD në një mënyrë të tillë ashtu që të lutjet që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duhet t'i barten PSRK për ekzekutim.

1678. Ligji për NNJ nuk i lejon autoritet gjyqësor në Kosovë që të kenë bashkëpunim të drejtpërdrejtë me homologët e tyre të huaj në lidhje me ndihmën juridike ndërkombëtare në

çështjet penale. Në rastet kur autoriteti gjyqësor vendas pranon një lutje të huaj, drejtpërdrejtë apo përmes INTERPOL-it¹⁸², apo përmes çfarëdo mënyre tjetër të komunikimit, atëherë ai mund ta ofrojë ndihmën e kërkuar vetëm me kusht që shteti që e kërkon ndihmën garanton dërgimin e lutjes dhe dokumenteve autentike përmes kanaleve të rregullta (domethënë përmes Ministrisë së Drejtësisë) brenda 18 ditëve. Ligji nuk e përcakton në mënyrë të saktë por duket se është e nënkuptueshme se në këto raste Ministria më pas do të ushtronte autoritetin e saj për të vërtetuar pranueshmërinë e letër porosisë (neni 73.1).

1679. Komunikimi i drejtpërdrejtë në mes autoriteteve gjyqësore vendase dhe të huaja përcaktohet vetëm në rastin e shkëmbimit të rastësishëm të informatave në përputhje me nenin 88 të Ligjit për NNJ, i cili përcakton se autoritet e Kosovës mund, pa kërkesë paraprake, t'ia përcjellin autoritetit kompetent të shtetit të huaj informatat e siguruara gjatë hetimeve të tyre kur konsiderojnë se zbulimi i informatave të tilla mund të ndihmojë shtetin pranues në nisjen apo marrjen përsipër të hetimeve apo të procedurave penale, ose mund të shpie në një lutje për ndihmë juridike të ndërsjellët nga shteti pranues. Sidoqoftë ky komunikim është përtej fushëveprimit të FATF R.36.

1680. Gama e veprimtarive procedurale që mund të ekzekutohen sipas kërkesës së një shteti të huaj nuk përcaktohen me anë të Ligjit për NNJ. Duke pasur parasysh se, megjithatë, neni 1.3 përcakton se procedurat për ndihmë juridike ndërkombëtare përcaktohen me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale (përveçse rregullohet ndryshe me anë të Ligjit për NNJ), atëherë është e qartë se të gjitha masat hetimore në dispozicion në LPP, të cilat janë fuqi, janë në mënyrë të barabartë në dispozicion për ekzekutimin e letër porosisë.

1681. Ekipit të vlerësimit nuk i janë paraqitur të dhëna statistikore përkritazi me NNJ të ofruar apo të kërkuar përmes Ministrisë së Drejtësisë në rastet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Sa i përket shifrave të përgjithshme të ndihmës juridike ndërkombëtare, Ministria i siguroi të dhënat statistikore të mbledhura për periudhën në mes të 01.01.2010 dhe 29.06.2012, për të cilat mund të thuhet se shumica dërmuese e 19.241 rasteve të cekura nga Ministria e Drejtësisë përbëheshin nga dërgesa e dokumenteve, qindra letrave të porosisë (në këtë aspekt, kategoritë e “ndihmës juridike të natyrave të ndryshme” dhe “letër porosisë” mund të mbivendosen deri në një masë të caktuar) e për të cilat, megjithatë, kontrolluesit nuk kanë marrë informata të mjaftueshme. Domethënë, zberthimi i shifrave nuk ka mundësuar nxjerrjen e konstatimeve përkritazi me trendët në ndihmën juridike ndërkombëtare, shtetet e përfshira, veprat penale, kohën e ekzekutimit të lutjes së parashtruar, etj.

Ofrimi i ndihmës që nuk ndalohet apo që i nënshtrohet kushteve të paarsyeshme (Kriteri thelbësor 36.2)

1682. Baza ligjore për refuzimin e lutjes përcaktohet në nenin 74 të Ligjit për NNJ, sipas së cilit ndihma mund të refuzohet nëse lutja ka të bëjë me veprë politike apo nëse ekzekutimi i saj do të paragjykonte sovranitetin, sigurinë, rendin publik apo interesat e tjera jetike të Kosovës.

1683. “Veprat penale politike” trajtohen në nenin 12 të Ligjit për NNJ që janë në kreun II në lidhje me kërkesat për ekstradim ndërsa dispozitat për ekzekutimin e letër porosisë janë në pjesë të ndryshme të Ligjit. Megjithëkëtë dispozita e nenit 12.2 duket se është e zbatueshme për tërë Ligjin e NNJ duke qenë se është formuluar për të ofruar një përkufizim të përgjithshëm “për qëllim të këtij Ligji” (dhe jo vetëm për rastet e ekstradimit).

¹⁸² Tekst juridik i cituar e që më vonë është korigjuar nga autoritetet e Kosovës.

1684. Sipas nenit 12.2 shprehja vepra penale politike nuk përfshin listën e veprave penale (privimin nga jeta të Kryetarit apo të anëtarëve të tij/saj të familjes, vrasjen, lëndimin e rëndë trupor, rrëmbimin, dhunimin, marrjen e pengjeve, shantazhin apo detyrimin, shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm, tentativat për t'i kryer këto vepra dhe të tjera) dhe nuk mund të zbatohen për krimet që bien në kategorinë e gjenocidit, krimeve kundër njerëzisë, krimeve të luftës dhe terrorizmit.

1685. Lista në nenin 74 është shumë më e shkurtër nëse krahasohet me rregullimet përkatëse të juridiksioneve tjera. Ajo është e heshtur nëse dhe deri në cilën shkallë *ne bis in idem* mund të jetë pengesë në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare, duke pasur parasysh se kjo çështje është e rregulluar vetëm me anë të nenit 11 për rastet e ekstradimit. Nuk ka arsye të veçantë për refuzimin e ekzekutimit të lutjes kur ka bazë për diskriminimin e të dyshuarit për shkak të racës, fesë, shtetësisë, etj., apo se i dyshuari nuk do të dënohet, për çfarëdo arsye, sipas ligjit vendas të Kosovës.

1686. Pa dyshim, këto veçori të legjislacionit nuk duhet kritikuar në përgjithësi duke qenë se mungesa e dukshme e akteve nënligjore me gjasë do të mbështeste ofrimin e ndihmës juridike në një masë më të madhe dhe përfundimisht në zbatimin më efektiv të FATF R. 36 në anën tjetër, shembujt nga juridiksionet tjera tregojnë për një mungesë të dispozitave të veçanta (për rastet e tilla kur letra e porosisë e huaj për një vepër penale tashmë i është nënshtruar vendimit të gjykatës në Kosovë) mund shumë lehtë të çojnë në zbatimin e gjerë e pa kufizime të bazës së përgjithshme për refuzimi, ashtu siç përcaktohet në nenin 74.2 (soveraniteti, siguria dhe rendi publik).

1687. Sa i përket zbatimit të parimit të procedimit të dyfishtë penal, kjo sigurohet vetëm me anë të nenin 79 në lidhje me letër porosinë e huaj për kontrollim dhe konfiskim të pasurisë (në rastin kur vepra penale, që ka çuar në paraqitjen e lutjes, duhet të jetë e dënueshme me anë të ligjit të shtetit kërkues si dhe me anë të ligjit të Kosovës). Përtej fushëveprimit të këtyre masave të veçanta detyruese, nuk zbatohet asnjë standard i procedimit të dyfishtë penal.

1688. Deri më tani, Kosova nuk ka refuzuar asnjë rast për të ofruar ndihmë juridike ndërkombëtare për shkak se procedurat në shtetin kërkues ende nuk kanë filluar ose për shkak të interpretimit tepër të ngushtë të parimit të reciprocitetit a inkriminimit të dyfishtë, ose për shkak të ndonjë shkak tjetër të paarsyeshëm.

Procese të qarta dhe efikase - (KTh. 36.3)

1689. Sa i përket proceseve të qarta dhe efikase për ekzekutimin e lutjeve të NNJ me kohë dhe pa vonesa të paarsyeshme, as Ligj për NNJ, as KPK e as ndonjë legjislacion i caktuar nuk përcakton afate procedurale. Gjatë kohës së vizitës në terren, Ministria e Drejtësisë ishte në proces të hartimit të legjislacionit, që është ose akt nënligjor (një udhëzim administrativ) për zbatimin e Ligjit për NNJ apo një ligj që ndryshon Ligjin LPP me qëllim të qartësimin të procedurave dhe përkufizimit të afateve kohore në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare. Megjithatë, vlerësuesit nuk ishin vënë në dijeni për çfarëdo hollësi në këtë aspekt.

1690. Në çdo rast, Ministria e Drejtësisë ka thënë se të gjitha autoritetet kompetente i kushtojnë vëmendje e veçantë për lutjet e huaja për NNJ, së cilave i jepet prioritet ndaj çfarëdo procedure tjetër. Afatet kohore për ekzekutimin e letër porosisë varen nga përmbajtja e lutjeve të veçanta. Në këtë kontekst, thuhet se koha mesatare për ekzekutim ishte 2 deri në 3 muaj. Kontrolluesit nuk ishin të njoftuar nga shtetet e tjera për çfarëdo përvojë tjetër, duke përfshirë vonesat e panevojshme në ekzekutimin e lutjeve për NNJ në bashkëpunim me Kosovën.

Ofrimi i ndihmës pa marrë parasysh përfshirjen e mundshme të çështjeve fiskale apo ekzistencën e ligjeve të fshehtësisë apo konfidencialitetit - (FATF R.36.4 dhe R.36.5)

1691. Asgjë bazë për refuzim për veprat që përfshijnë çështjet fiskale nuk është e rregulluar me legjislacionin e Kosovës. Ngjashëm, asnjë pjesë e legjislacionit nuk lejon refuzimin e lutjeve të NNJ në bazën e kërkesave të fshehtësisë dhe konfidencialitetit. Me legjislacionin e Kosovës, duket se asnjë ligj për fshehtësinë e institucioneve financiare nuk pengon zbatimin e rekomandimeve të FATF dhe kjo qasje e përgjithshme duhet të respektohet gjithashtu për ekzekutimin e letrave të huaja të porosisë. Kontrolluesit nuk kanë asnjë informatë për çfarëdo praktikë kufizuese në këtë fushë.

1692. Neni 37 i Ligjit për LPP/LFT përcakton që sekreti profesional, duke përfshirë sekretin financiar, nuk mund të përdoren si arsye për refuzimin e sigurimit të informatave që kërkohen nga NJIF apo policia lidhur me një hetim për pastrimin e parave. Përjashtimi i vetëm në këtë aspekt është për informatat që janë subjekt i privilegjit avokat-klient në përputhje me nenin 30 (3.2) të Ligjit.

Disponueshmëria e kompetencave të autoriteteve gjegjëse (në zbatim të FATF R. 28 në R. 36.6 dhe 36.8)

1693. Në mbështetje të zbatimit të drejtpërdrejtë të dispozitave të KPP në fuqi, kompetencat e autoriteteve gjegjëse janë në dispozicion për përdorim sipas kërkesave për NNJ. Brenda kufizimeve të letër porosisë që duhet ekzekutuar, autoritetet ndjekëse gëzojnë të njëjtat kompetenca procedurale në krahasim me hetimin kombëtar të veprave penale.

1694. Siç u cek më lartë, të gjitha kërkesat e huaja për NNJ duhet ose të dorëzohen, ose pranohen përmes autoritetit qendror (Ministrisë së Drejtësisë), prandaj nuk ekziston asnjë mundësi ligjore që autoritetet gjyqësore vendase të pranojnë dhe ekzekutojnë drejtpërdrejtë kërkesat nga homologët e tyre të huaj.

Shmangia e konflikteve të juridiksionit (Kriteri thelbësor 36.7)

1695. Në Kosovë nuk ekziston legjislacioni i veçantë që përcakton mekanizmat për komunikim dhe bashkërendim me shtetet e tjera për të përcaktuar rrugën më të mirë për ndjekjen penale të pandehurve në rastet që i nënshtrohen ndjekjes penale në më shumë se një shtet, me qëllim të shmangies së konflikteve të juridiksionit, përveç zbatimit të transferimit të procedurave penale në një ose nga shteti tjetër e që mund të konsiderohet – deri në një shkallë të caktuar – si masë që i shërben këtij qëllimi.

Efikasiteti dhe të dhënat statistikore

1696. Ndërmjet periudhës nga janari i vitit 2010 dhe deri në qershor të vitit 2012, Departamenti për ndihmë juridike ndërkombëtare përpunoi 4866 kërkesa të reja për ndihmë dhe 6758 kërkesa për ndihmë të mëtutjeshme në rastet ekzistuese. Këto kërkesa mund të zbërthehen si në vijim:

- 3509 Kërkesa për shërbimin e dokumenteve
- 397 Kërkesa për ndihmë juridike të natyrave të ndryshme
- 272 Kërkesa për letër porosive
- 321 Kërkesa për vërtetimin e dokumenteve
- 35 Kërkesa për ekstradim
- 66 Kërkesa për transferimin e procedurave gjyqësore
- 136 Kërkesa për ekzekutimin e vendimeve
- 4 Kërkesa për rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve
- 32 Kërkesa për transferimin e personave të dënuar
- 11 Kërkesa për rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve;
- 3 Kërkesa për krime lufte
- 80 Kërkesa për lëshimin e urdhër-kërkimin ndërkombëtar

1697. Ekipi i vlerësimit u njoftua që së paku njëra prej këtyre kërkesave kishte të bënte me sekuestrimin e të ardhurave nga krimi, ku janë konfiskuar përafërsisht 400 000 EUR (në bazë të kërkesës nga Gjermania). Në të njëjtën kohë, ekipit të vlerësimit nuk iu siguruan të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse me zberthimin e të dhënave për NNJ dhe në veçanti për PP, FT dhe veprat e ndërlydhura penale.

1698. Autoritetet në Kosovë deklarojnë se bashkëpunimi kryhet me kohë dhe se janë konstruktive dhe efektive në zbatimin e tij. Nuk ekzistojnë të dhëna statistikore në dispozicion për të treguar “kohën e kthimit të përgjigjes” për kërkesat ndërkombëtare. Me sa duket, ka vonesa të gjata dhe lëndë e procedura të stërzgjatura në gjykata. Nëse kërkesa lyp ndonjë formë të urdhrit gjyqësor, atëherë nuk ka tregues se sa gjatë duhet të pritët për atë. Në të njëjtën kohë, autoritetet në Kosovë deklarojnë se i japin prioritet kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare ndaj procedurave të tjera. Ministria e Drejtësisë është në proces të hartimit të legjislacionit në formë të një udhëzimi administrativ për zbatimin e Ligjit për NNJ me qëllim të qartësimit të procedurave dhe afateve kohore në dispozitat e ndihmës juridike ndërkombëtare.

6.2.2. Rekomandimet dhe komentet

1699. Autoritetet e Kosovës duhet të përcaktojnë standarde të qarta të shërbimit për kthimin e përgjigjes për kërkesat e huaja për NNJ.

1700. MD duhet të përshpejtojë hartimin e udhëzimit administrativ për zbatimin e Ligjit LPP apo, si opsion tjetër, hartimin e një ligji përkatës amendamentues me qëllim të qartësimit të procedurave dhe afateve kohore në dispozitat për ndihmën juridike ndërkombëtare.

1701. Autoritetet e Kosovës duhet të mbajnë të dhëna statistikore të hollësishme për NNJ me një referencë për veprat penale të përfshira si dhe për kërkesat për konfiskimin dhe sekuestrimin e të ardhurave.

6.2.3. Vlerësimi për rekomandimin 36

	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve gjegjës për s.6.3. që përbejnë vlerësimin e përgjithshëm
R.36	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekzistojnë standarde të shërbimit për afatet e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesave të huaja që mund të pengojnë efikasitetin e sistemit; • Efikasiteti nuk mund të demonstrohej për shkak të mungesës së të

		<p>dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat për NNJ lidhur me PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lëndët e pazgjidhura përkritazi me kërkesat për NNJ që kërkojnë nxjerrjen e urdhrave gjyqësor.
--	--	---

6.3. Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar (R. 40).

6.3.1. Përshkrimi dhe analiza

1702. Në përputhje me Ligjin për PP/FT (neni 36), autoritetet e Kosovës duhet të ndërmarrin sigurimin e masave më të gjëra të bashkëpunimit me autoritetet e shteteve të huaja me qëllim të shkëmbimit të informatave, hetimeve dhe procedurave gjyqësore në lidhje me masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë dhe urdhrave për konfiskim lidhur me mjetet e pastrimit të parave dhe pasurinë e fituar me anë të veprës penale, si dhe me qëllim të ndjekjes së kryerësve të pastrimit të parave dhe veprimtarive terroriste.

1703. Bashkëpunimi ndërkombëtar jashtë NNJ në fushën e PP/LFT kryhet nga NjIF dhe Policia. Shih analizën për bashkëpunimin ndërkombëtar të Doganave në pjesën 2.8 të këtij raporti.

1704. Neni 14.1.7 i Ligjit nr. 03/L-196 LPP i lejon NjIF që spontanisht ose me anë të kërkesës të ndajë informacionin me agjencinë homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht natyrës së agjencisë që i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e agjencisë dhe vetëm për qëllime të luftimit të pastrimit të parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit.

1705. NjIF është në gjendje që të kryejë hetime në emër të homologëve të huaj për informatat që janë në dispozicion publik dhe bazat e veta të dhënave (informacioni i ndërlidhur me RTD). NjIF gëzon të drejtën për të kërkuar dhe për të pranuar nga organet publike a qeveritare apo organet ose organizatat ndërkombëtare a organizatat ndërqeveritare (në Kosovë) të dhëna, informacione, dokumente në lidhje me personin, subjektin, pronën apo transaksionin dhe mund që spontanisht ose me anë të kërkesës ndajë informacionin me agjencinë homologe të huaj që kryen funksione të ngjashme dhe që i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht natyrës së agjencisë që i nënshtrohet reciprocitetit.¹⁸³ Në të njëjtën kohë, Ligji LPP/LFT nuk i lejon NjIF që të kërkojë informacione nga institucionet financiare në bazë të një kërkesë nga një NjIF e huaj (shih po ashtu analizën në pjesën 2.6).

1706. Duke qenë se NjIF nuk është anëtare e Grupit Egmont, ajo nuk ka qasje në ueb faqen e sigurt të Egmont. NjIF është në gjendje që të përdor mjetet e sigurta të dërgimit të porosive në kuadër të sistemit goAML. Ajo ka vendosur një lidhje të tillë të drejtpërdrejtë për këmbimin e informatave me NjIF nga Shqipëria dhe kurdoherë që është e mundur do të kërkojë që të bëjë po të njëjtën gjë edhe me NJIF e tjera. NJIF ka paraqitur kërkesën për t'u anëtarësuar në sistemin FIU.NET të BE-së por është në pritje të përgjigjes.

1707. Kërkesat për ndihmë nuk refuzohen mbi bazën e vetme se kërkesa gjithashtu përfshin çështje fiskale. Nëse kërkesa i drejtohet NJIF, atëherë sipas Ligjit LPP përgjigja do të mbulojë vetëm çështje që janë në mandat të NJIF, pra çështjet që kanë të bëjnë me PP dhe FT.

¹⁸³ Rec. 40.4.1.

Kërkesat që pranohen përmes NJBNZL/Interpol që kanë të bëjnë me çështjet fiskale i referohen autoritetit kompetent e që në këtë rast është ATK.¹⁸⁴

1708. Në vitin 2011, Policia e Kosovës themeloi Njësinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit (NJBNZL) në kuadër të kornizës së një projekti rajonal që mëton të lehtësojë shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit në mes të autoriteteve për zbatimin e ligjit. NJBNZL ekzistojnë në Shqipëri, Maqedoni, Serbi, BH, Kroaci dhe Slloveni. Me përjashtim të BH dhe Serbisë, informacioni me shtetet e tjera këmbëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Me Serbinë dhe BH si dhe me vendet e tjera, këmbimi i informacionit bëhet përmes Interpolit në kuadër të UNMIK/EULEX. Doganat e Kosovës janë gjithashtu të përfaqësuara në NJBNZL.

1709. Në rastet kur kërkesat i referohen NJIF, neni 37 i Ligjit LPP përcakton se sekreti profesional nuk mund të përdoret si arsye për refuzimin e sigurimit të informacionit që duhet të përcaktohet me ligji ose është mbledhur në përputhje me këtë ligj. Ekzistojnë përjashtime përkitazi me dhënien dhe sigurimin e këshillave ligjore.

1710. Policia e Kosovës dhe Doganat duhet të respektojnë kërkesat e Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kërkesat për informacionin që do të lëshohet duhet të respektojnë standardet minimale. Pala që parashtron kërkesën duhet të paraqes arsyet për kërkesën, veprën e dyshuar penale dhe një përvijim të rrethanave, se si do të përdoret informacioni i kërkuar dhe se si do të ruhet nëse i jepet palës që ka parashtrua kërkesën për atë informacion.¹⁸⁵

1711. Informatat e pranuar nga shtetet e huaja si përgjigje ndaj një kërkesë, apo të cilat janë dhënë në mbështetje të një kërkesë nga autoritetet e Kosovës, i nënshtrohen dispozitave të Ligjit nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duhet të ruhen në mënyrë të sigurt në përputhje me nenet 3 & 14.¹⁸⁶

1712. Shkëmbimi i informatave me palët e tjera bëhet përmes kanaleve të tërthorta. NJBNZL ose INTEPOL-i e paraqesin kërkesën por në rastin e INTERPOL-it duhet të parashtrohet një kërkesë përmes kanaleve diplomatike brenda 18 ditëve – pra përmes në rrugë të tërthortë. Në çdo rast, pozita e NJBNZL ose e INTERPOL-it do të thotë se ekziston një ndërmjetës në këtë proces.¹⁸⁷

1713. Gjatë shkëmbimit autoriteti që parashtron kërkesën duhet të zbulojë qëllimin e kërkesës, atë se për çka do të përdoret informacioni dhe duhet të paraqes informata të tjera për t'i mundësuar palës që përpunon kërkesën që të kërkojë informata të mjaftueshme për të vërtetuar nëse kërkesa është në përputhje me ligjin.¹⁸⁸

A mund NJIF të bashkëpunojë me të gjitha llojet e NJIF-ve (CETS 198, neni 46.3)

1714. Neni 14 i Ligjit LPP i lejon NJIF-të që të bashkëpunojë me agjencitë homologe që kryejnë funksione të ngjashme në një shtet të huaj, pavarësisht natyrës së agjencisë (NJIF).

Baza për kërkesë nga ana e NjIF (CETS 198, neni 46.4)

¹⁸⁴ Rec 40.7

¹⁸⁵ Rec 40.8

¹⁸⁶ Rec 40.9

¹⁸⁷ Rec 40.1

¹⁸⁸ Rec 40.10.1

1715. NjIF harton kërkesën e saj për informacion që i adresohet NjIF të huaj, ku përshkruhen faktet dhe bazat në një deklaratë të shkurtër për paraqitjen e një kërkesë të tillë. Kjo përfshinë një deklaratë për atë se si do të përdoret informacioni në fjalë (neni 46.4). Çfarëdo vazhdimi i përdorimit të informacionit i referohet autorit për leje.

Ofrimi i informacionit nga NjIF pa Letër të kërkesës (CETS 198, neni 46.5)

1716. NjIF mund të ndajë informata në lidhje me mandatin e saj. Nenet 14 dhe 15 të Ligjit nr. 03/L-196 LPP i mundësojnë NjIF që të kërkojë informacione të veçanta nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe ministrinë e qeverisë dhe që të ndajë këtë informacion me agjencitë homologe që kryejnë funksione të ngjashme. Ky informacion lëshohet vetëm për qëllime informative dhe nuk mund të përdoret si prova pa miratimin e veçantë me shkrim nga ana e Drejtorit të NjIF. NjIF nuk mund të kërkojë nga subjektet e obliguara informata në bazë të një kërkesë të NjIF të huaj (shih pjesën 2.6).

A refuzon NjIF që të zbulojë informacionin (CETS 198, neni 46.6)

1717. Ka pasur raste kur NjIF ka refuzuar një kërkesë por vetëm për arsye teknike, domethënë kërkesa në fjalë nuk ka përmbajtur informata të mjaftueshme për të vërtetuar dyshimin për krim të organizuar, pastrim parash apo financim të terrorizmit. Nuk ka të dhëna statistikore për këto raste.

Kufizimet për përdorimin e informacionit nga palët e treta (CETS 198, neni 46.7)

1718. Neni 15 i Ligjit nr. 03/L-196 LPP kufizon përdorimin e informatave që NjIF u jep homologëve të huaj vetëm "sa për informim". Nuk lejohet vazhdimi i përdorimit të informacionit pa lejen me shkrim nga ana e drejtorit të NjIF.

A cakton NJIF kufizime dhe kushte për përdorimin e informacionit? (CETS 198, neni 46.8)

1719. NJIF përfshin një dispozitë kufizuese kur u ofron informata homologëve të huaj. Ajo përcakton se pala që parashtron kërkesën për informacion duhet ta ruajë fshehtësinë e një dokumenti dhe ta përdor atë vetëm për qëllime të inteligjencës.

Rrethanat në të cilat NJIF do të refuzonte përdorimin e informacionit si provë në hetime (CETS 198, neni 46.9)

1720. Ndonëse neni 15 i Ligjit LPP i lejon drejtorit të NjIF që të autorizojë përdorimin e informacionit për qëllime të inteligjencës që të përdoret si provë, kjo duhet të bëhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur të gjitha mundësitë e tjera për të siguruar materialin në formën e provës janë shterur. Kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare duhet të përdoren si rruga kryesore për sigurimin e provave të nevojshme për hetime dhe ndjekje penale.

Masat e sigurisë që përdoren për të siguruar se informacioni i transmetuar nuk është i qasshëm për agjencitë e tjera (CETS 198, neni 46.11)

1721. Kosova nuk është anëtare e grupit Egmont dhe prandaj nuk ka qasje në ueb faqen e sigurt të Egmont. NJIF-K ka parashtruar kërkesën për anëtarësim në sistemin e komunikimit të brendshëm të NJIF në BE por deri më tani nuk ka marrë asnjë përgjigje. NJIF-K përdor sistemin goAML të furnizuar nga OKB-ja që ka të instaluar shërbimin e porosive të sigurt dhe NJIF-K dëshiron që ta përdorë këtë sistem me sa më shumë NJIF tjerë që është e mundshme.

Informatat kthyese (CETS 198, neni 46.12)

1722. NJIF-K mund, varësisht nga rasti, të bëjë komente dhe paraqes komente për homologët me qëllim të shtimit të efikasitetit të analizës që ka të bëjë me parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave. Kurdoherë që NJIF-K nënshkruan MM me homologët e huaj, ajo përmban një dispozitë që përcakton kërkesën për informata kthyesë lidhur me përdorimin e informatave të shkëmbyera.

Mundësitë e ngrirjes urgjente në bazë të kërkesës së një NJIF të huaj (CETS 198, neni 47)

1723. Nuk ekziston asnjë dispozitë për NJIF-K që të ndërmerr këtë veprim. Kjo çështje i është vënë në dijeni deputetëve dhe një përmirësim duhet të përfshihet në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit LPP por deri më tani nuk ka asnjë referencë ndaj kësaj në projektligj.

Të dhënat statistikore dhe efikasiteti

1724. NJIF i Kosovës ka siguruar të dhënat statistikore në vijim për shkëmbimin ndërkombëtar të informatave

Tabela 21: Kërkesat e pranuar nga NJIF e huaja

Viti Kërkesat	2011	2012
NJIF Kroaci	0	1
NJIF Holandë	0	1
NJIF Maqedoni	3	4
NJIF Mal i Zi	4	4
NJIF Shqipëri	2	0
NJIF Gjermani	1	0
Në përgjithësi	10	10

Tabela 22: Kërkesat e përpunuara nga NJIF e huaja

Viti Kërkesat	2011	2012
NJIF Kroaci	0	1
NJIF Holandë	0	1
NJIF Maqedoni	3	4
NJIF Mal i Zi	4	4
NJIF Shqipëri	2	0
NJIF Gjermani	1	0
Në përgjithësi	10	10

Tabela 23: Përgjigjet ndaj kërkesave të NJIF të huaja

Viti Kërkesat s	2011	2012
NJIF Kroaci	0	1
NJIF Holandë	0	1
NJIF Maqedoni	3	4
NJIF Mal i Zi	4	4
NJIF Shqipëri	2	0
NJIF Gjermani	1	0

Viti Kërkesat s	2011	2012
Në përgjithësi	10	10

1725. Ekipi i vlerësimit u njoftua se NJIF Kosovë ka nisur 2 shpërndarje spontane për NJIF të huaja (Shqipëri dhe Maqedoni).

1726. Autoritetet e Kosovës nuk sigurojnë të dhëna statistikore në lidhje me shkëmbimin ndërkombëtar të informatave nga policia, as përmes NJBNZL e as përmes kanaleve tjera, duke e bërë të pamundshme vlerësimin e efikasitetit të tyre.

6.3.2. Rekomandimet dhe komentet

1727. NJBNZL duhet të mbajë të dhëna statistikore duke përfshirë hollësi të mjaftueshme për identifikimin e veprave të ndërlidhura penale dhe posaçërisht kur pjesë e tyre janë pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, si edhe të kërkojë afatet për kthimin e përgjigjes pa të cilat është e pamundshme që të vlerësohet efikasiteti.

1728. (CETS 198 19.1) Ligji për LPP duhet të përfshijë kompetencat për NjIF apo prokurorinë që të kërkojë një urdhër për mbikëqyrjen e xhirrollogarisë bankare.

1729. (CETS 198 Art 28.1.e) Autoritetet e Kosovës duhet të sqarojnë nëse refuzojnë apo jo bashkëpunimin ndërkombëtar në bazat që kanë të bëjnë me veprat penal jopolitike.

1730. (CETS 198 47) NjIF duhet të ketë kompetenca për të ngrirë apo shtyrë transaksionet në bazë të kërkesës së një NjIF të huaj.

6.3.3. Vlerësimi për rekomandimin nr. 40

	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
R.40	KP	<ul style="list-style-type: none"> Efikasiteti përkitazi me bashkëpunimin ndërkombëtar policor nuk mund të dëshmohej për shkak të mungesës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat e NJBNZL për PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT; Nuk ekzistojnë standarde të shërbimit për afatet e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesave të huaja që mund të pengojnë efikasitetin e sistemit.

7. ÇËSHTJET E TJERA

7.1. Burimet dhe të dhënat statistikore

1731. Teksti i përshkrimit, analizës dhe rekomandimeve për përmirësim në lidhje me Rekomandimet 30 dhe 32 gjendet në të gjitha pjesët gjegjëse të raportit, domethënë në tërë pjesën 2, segmente të caktuara në pjesët 3, 4, 5 dhe 6. Ekziston një vlerësim i vetëm për secilin prej këtyre rekomandimeve ndonëse rekomandimet trajtohen në pjesë të ndryshme. Pjesa 7.1 e Raportit përmban kuti që përmbajnë vlerësimin dhe faktorët që përbëjnë këtë vlerësim.

Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin e përgjithshëm
-----------	---

R. 30	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Shtimi i lëndëve të PSRK në lidhje me rastet e PP tregon mungesën e burimeve dhe nivelet e ulëta të efikasitetit; • Personeli i papërshtatshëm në njësinë e specializuar për PP në polici ndikon në efikasitet; • Nuk ka vetëdijesim/kapacitet të mjaftueshëm në polici në lidhje me nevojën për të ndjekur në mënyrë aktive pasurinë e fituar me vepra penale kur trajtojnë krimet monetare; • Personeli në numër të vogël ndikon në efikasitetin e Doganave; • Burimet njerëzore për autoritetet mbikëqyrëse janë të pamjaftueshme dhe kështu ndikojnë në efikasitet; • Mungesa e programeve gjegjëse të trajnimit për personelin mbikëqyrës ka ndikim në efikasitet.
R. 32	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Duhet të fuqizohet obligimi për të gjitha autoritetet kompetente, subjektet raportuese dhe personat dhe subjektet e tjera për të mbajtur të dhëna statistikore përmes një dispozite ligjore; • Nuk mbahen të dhëna statistikore për pasurinë e konfiskuar dhe sekuestruar, duke e bërë kështu të vështirë matjen e saktë të nivelit të efikasitetit të regjimit; • Mungesa e të dhënave statistikore për rezultatet e raporteve nga NJIF nuk mundëson vlerësimin e duhur të efikasitetit dhe rëndësisë së analizave të NJIF; • Mungesa e të dhënave të njësuara statistikore e bën të pamundshme vlerësimin e efikasitetit të hetimeve dhe ndjekjeve penale të PP me saktësi të plotë; • Ekziston nevoja që autoritetet mbikëqyrëse të mbajnë të dhëna statistikore më kuptimplote përndryshe nuk mund të vlerësohet efikasiteti i tyre ashtu siç duhet; • Efikasiteti nuk mundet të dëshmohej për shkak të mungesës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat për NNJ lidhur me PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT; • Efikasiteti përkitazi me bashkëpunimin ndërkombëtar policor nuk mund të dëshmohej për shkak të mungesës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat e NJBNZL për PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT.

8. TABELAT

Tabela 1: Vlerësimi i përputhshmërisë me rekomandimet e FATF

Vlerësimi i përputhshmërisë kundrejt rekomandimeve të FATF duhet të bëhet sipas katër niveleve të përputhshmërisë që ceken në metodologjinë e vitit 2004: në përputhje [P], kryesisht në përputhje [KP], pjesërisht në përputhje [PP] dhe në mospërputhje [MP], ose mund, në rrethana të veçanta të shënohet si e pa zbatueshme [PZ]. Këto vlerësime bazohen vetëm në kriteret thelbësore dhe përkufizohen si në vijim:

Në përputhje (P) ➤ Rekomandimi respektohet plotësisht sa i përket të gjitha kriterëve jetike.
(C)

- Kryesisht në përputhje (KP) ➤ Ekzistojnë disa mangësi të vogla ndërsa shumica dërmuese e kritereve thelbësore përmbushen.
- Pjesërisht në përputhje (PP) ➤ Shteti ka ndërmarrë veprime të rëndësishme dhe respekton disa nga kriteret thelbësore.
- Mospërputhje (MP) ➤ Ekzistojnë mangësi të mëdha ndërsa shumica dërmuese e kritereve thelbësore nuk përmbushen.

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
<i>Sistemet ligjore s</i>		
R. 1 Veprat penale të PP	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Vepra penale e manipulimit të tregut nuk është e mbuluar ndër veprat e ndërlidhura penale të PP • Ka huti dhe tepriçë në përkufizimet që kanë të bëjnë me të ardhurat nga krimi si dhe në kuptimin të asaj nëse të ardhurat e veprimtarive kriminale në përgjithësi mund t'i nënshtrohen PP • Rregullimi i papërshtatshëm i nivelit të domosdoshëm të provës për veprat e ndërlidhura penale në nenin 32, paragrafi 4.1. shkakton pasiguri dhe mosnjohje të dispozitave ndër praktikuesit • Formulim i paqartë dhe i papërshtatshëm i dispozitave që përkufizojnë mbulimin e vetë pastrimit (neni 32, paragrafi 4.2) • Nevojitet harmonizimi në mes Ligjit LPP dhe KP përkitazi me konceptet dhe terminologjinë për veprat e ndërlidhura • Efikasiteti i zbatimit të veprave penale të PP nuk mund të vlerësohet për shkak të dhënave statistikore kontradiktore që iu siguruan ekipit të vlerësimit.
R. 2 Përgjegjësia për veprat penale të PP	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Pasiguri serioze në legjislacion në lidhje me elementet themelore të përgjegjësisë penale të subjekteve (pa marrë parasysh a varet nga përgjegjësia e personit fizik) • Dispozita sanksionuese joefikase e të buta për subjektet juridike për vepra penale (shkalla e ulët e dënimit) • Nevojitet harmonizimi në mes Ligjit LPP dhe KP përkitazi me konceptet dhe terminologjinë për veprat e ndërlidhura • Njohuria standarde e zbatueshme në rastet e veprave penale të PP (Ligji LPP/LFT kundrejt KP) • Elementet themelore të përgjegjësisë penale të subjekteve dhe ato të ndërlidhura me personat fizikë (neni 34 i Ligjit LPP/LFT kundrejt nenit 40 të Kodit Penal / neni 5 i PPPF).
R. 3 Sekuestrimi dhe konfiskimi	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekziston ndonjë procedure apo standard i provës në KPP që lejon konfiskimin e mjeteve që përdoren për vepra penale • Ndonëse dispozitat e konfiskimit nga pala e tretë të përfshira në KP përmbushin standardet ndërkombëtare, nenet mbështetëse të KPP janë në kontradiktë me këto dispozita • Standardi i provës për palët e treta <i>bona fide</i> është në mënyrë të paarsyeshme i lartë, shpeshherë e bën të pamundshme për atë që të dëshmojë të drejtat e tyre

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		<p>legjitime në lidhje me pasurinë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekziston ndonjë autoritet për ndërmarrjen e hapave për parandalimin apo anulimin e veprimeve, kontraktuese apo të tjera, kur personat e përfshirë e dinin apo do të duhej ta dinin që, si pasojë e këtyre veprimeve, autoritetet do të paragjykonin në aftësinë e tyre për të rimarrë pasurinë që i nënshtrohet konfiskimit • Efikasiteti i masave ekzistuese konsiderohet si i ulët për shkak të pamjaftueshmërisë së ndjekjeve penale që rezultojnë në nivele të ulëta të konfiskimit të ardhurave nga krimi • Nuk mbahen të dhëna statistikore kuptimplote për pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke e bërë të vështirë matjen e saktë të nivelit të efikasitetit të regjimit. • Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet prokuroriale nuk ndërmarrin në mënyrë aktive ndjekjen e pasurisë dhe kthimin e saj kur ndjekin krimet monetare.
<i>Masat parandaluese për institucionet financiare</i>		
<p>R. 4</p> <p>Ligjet e fshehtësisë janë në përputhje me rekomandimet</p>	<p>KP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekziston nevoja për një qartësi ligjore për përmirësimin e fshehtësisë për BQK në lidhje dhe për qëllime të dispozitave të Ligjit LPP/LFT përtej çështjeve të kujdesshme.
<p>R. 5</p> <p>Kujdesi i duhur ndaj klientit</p>	<p>PP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ky raport shpreh shqetësimin në lidhje me vlefshmërinë e Letrës këshilluese 2007/1 dhe Rregullit X të BQK në kontekst të asaj ë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/2 është shfuqizuar tërësisht • Ky raport gjithashtu shpreh shqetësimin për përkufizimin e “institucionit financiar” në ligjet gjegjëse e që dallon në disa raste <p><i>Mangësi të veçanta në rekomandimin 5;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekziston detyrimi ligjor për të zbatuar plotësisht masat e kujdesit të duhur ndaj klientit • Nuk ka ndalim të shprehur qartë për mbajtjen e xhirollogarive me emra fiktivë • Pragu për transferime nuk është i qartë • Kur shfaqen dyshime për vërtetësinë apo mjaftueshmërinë e identifikimin e mëparshëm të klientit, të dhënat zbatohen vetëm për transaksionet e rastësishme • Detyrim i pamjaftueshëm ligjor për identifikimin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë • Fuqizimi i detyrimit për të kuptuar pronësinë dhe strukturën e kontrollit të klientit • Fuqizimi i detyrimit për të kuptuar qëllimin dhe natyrën e menduar të marrëdhënies afariste • Fuqizimi i detyrimit për të ushtruar mbikëqyrjen e vazhdueshme të marrëdhënieve afariste dhe transaksionit në të gjitha rrethanat përtej klientëve me rrezik të lartë • Fuqizimi i detyrimit për institucionet financiare për

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		<p>zbatimin e një qasje të bazuar në rrezik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e udhëzimeve për zbatimin e qasjes së bazuar në rrezik • Mospërputhjet në kohën e procesit të verifikimit kundrejt kohës së procesit të identifikimit • Dështimi për të përfunduar procesin e KDK zbatohet vetëm për procesin e verifikimit • Dështimi për të përfunduar KDK ku nuk mbulohet ashtu siç duhet marrëdhënia afariste tashmë ekzistuese • Detyrimi për të zbatuar KDK ndaj klientëve ekzistues është e vjetërsuar dhe përcaktohet vetëm me anë të rregullës X në lidhje me rregulloret e shfuqizuara të UNMIK-ut • Shpërndarja më e mirë dhe zbatimi i listave të personave të caktuar dhe • Çështjet e efikasitetit në lidhje me fushëveprimin dhe gjerësinë e zbatimit të KDK, identifikimit të mbajtësit të së drejtës së pronësisë dhe zbatimit të qasjes së bazuar në rrezik
<p>R. 6 Personat e ekspozuar politikisht</p>	<p>PP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa në përkufizimin e PEP • Mos zbatim i masave të shtuara për PEP e huaj që qëndrojnë në Kosovë • Nuk ekziston detyrimi për të identifikuar nëse një mbajtës i së drejtës së pronësisë është PEP • Nuk ekziston detyrimi për miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e punës me një PEP • Detyrimi ligjor për identifikimin e burimit të pasurisë nuk është i qartë • Shqetësimet për zbatimin e shprehjes së PEP, si dhe • Çështjet e efikasitetit lidhur me përkufizimin e PEP, udhëzimet për mbikëqyrjen e vazhdueshme dhe statusin e mbajtësit të së drejtës së pronësisë .
<p>R. 10 Ruajtja e shënimeve</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e dispozitave për fillimin e periudhës së ruajtjes për transaksionet e ndërlidhura të rastësishme • Mungesa e udhëzimeve për metodologjinë e ruajtjes së shënimeve • Mungesa e kompetencave ligjore për vazhdimin e periudhës 5 vjeçare të ruajtjes për transaksionet dhe shënimet identifikuese sipas nevojës • Papajtueshmëri ligjore për kohën e fillimit të periudhës së ruajtjes për shënimet identifikuese • Paqartësi në lidhje disponueshmërinë e shënimeve për autoritetet kompetente si dhe • Çështjet e efikasitetit lidhur me dispozitat ligjore kontradiktore apo që mungojnë dhe niveli i pabarabartë ndër të gjitha subjektet raportuese.
<p>R. 13 Raportimi i transaksioneve të dyshimta</p>	<p>PP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekziston asnjë detyrim për raportim në situatat kur informacioni në dispozicion tregon pastrim të mundshëm të parave apo financim të veprimtarive të terrorizmit • Nuk ekziston asnjë detyrim për Raportim për financimin e terrorizmit

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekziston detyrimi për raportim për veprat e dyshimta në tentativë apo transaksionet • Numri i ulët i RTD • Shqetësime për mosdorëzimin e RTD dhe RTPG si dhe • Çështjet e efikasitetit lidhur me cilësinë dhe sasinë e Raportimit të RTD dhe Raportimit të RTPG të dyshimta.
R. 14 Mbrojtja dhe moszbulimi	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është e qartë nëse mbrojtja për zbulim zbatohet për drejtorët, zyrtarët dhe punonjësit, e përkohshëm apo të përhershëm • Ndalesa e moszbulimit nuk zbatohet për bankat dhe institucionet financiare në cilësinë e subjekteve • Ndalesa e moszbulimit nuk përcakton saktësisht nëse zbatohet edhe për punonjësit e përhershëm dhe të përkohshëm • Ndalesa e moszbulimit mbulon situatat kur vetë Raporti i jepet palës së tretë • Ndalesa e raportimit nuk mbulon situatat kur kryhet apo mund të kryhet një hetim • Pasiguria ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve të cilët hartojë raportin apo sigurojnë informacionin • Kufizimet në heqjen e ndalesës së moszbulimit në rrethana të veçanta, si dhe • Çështjet e efikasitetit për shkak të dallimeve në standardin ndërkombëtar.
R. 17 Dënimet	MP	<ul style="list-style-type: none"> • Shqetësime në lidhje me zbatimin e disa dispozitave të caktuara të Ligjit për qëllime të dënimeve administrative; • Shqetësime në lidhje me procedimet e dyfishta penale në Ligjin LPP/LFT dhe legjislacionin e posaçëm financiar që shqipton dënime të tjera • Mungesa e gjobave administrative për shkeljen e detyrimeve individuale sipas Ligjit LPP/LFT • Nuk është caktuar autoriteti kompetent për shqiptimin e dënimeve administrative • Pasiguri ligjore për zbatimin e dënimeve administrative dhe të tjera për drejtorët dhe drejtuesit e lartë të subjekteve raportuese • Mungesa e gamës së dënimeve • Shqetësime në lidhje me zbatimin e dënimeve administrative dhe të tjera sipas legjislacionit të veçantë financiar për qëllim të Ligjit LPP/LFT • Çështjet e efikasitetit që shfaqen si pasojë e papërshtatshmërisë së regjimit të dënimeve dhe mungesës së zbatimit të dënimeve.
R. 18 Bankat guaskë	PP	<ul style="list-style-type: none"> • Vërejtje: Gjatë vlerësimit të respektimit të rekomandimit nr. 18, Raporti ka analizuar dispozitat për licencimin e bankave dhe institucioneve financiare në ligjet dhe rregulloret gjegjëse për bankat. • Mungesë e sigurisë ligjore në dallimin në mes të bankës koresponduese dhe asaj reaguese gjatë punës me bankat

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		<p>guaskë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka asnjë përkufizim të marrëdhënieve korresponduese bankare • Nuk ka asnjë detyrim për bankat që të sigurojnë se institucionet reaguese nuk lejojnë që xhirollogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë • Shqetësime rreth efikasitetit për shkak të mungesës së sigurisë ligjore.
<p>R. 20 KTH 20.2 Teknikat e menaxhimit të parasë së gatshme</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekziston asnjë dokument strategjik me synime dhe objektivë për zvogëlimin e përdorimit të parasë së gatshme • Përdorim i gjerë i kartëmonedhave me vlerë të lartë • Nuk ekziston asnjë mjet për debitë e drejtpërdrejta dhe kreditë e drejtpërdrejta përmes sistemit bankar • Ka kontradikta në të dhënat statistikore për kartëmonedhat e lëshuara dhe të depozituara, si edhe • Mungesë e dukshme e efikasitetit në mbikëqyrjen e respektimit të nenit 13 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe qarkullimin e kartëmonedha jashtë kufijve.
<p>R. 23 Rregullimi, mbikëqyrja dhe monitorimi</p>	<p>PP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e mandatit ligjor për një autoritet kompetent mbikëqyrës për sektorin financiar • Mungesa e mandatit për një autoritet kompetent mbikëqyrës për nxjerrjen e rregullave dhe rregulloreve LPP/LFT • Nuk ekziston asnjë detyrim për të njoftuar BQK për heqjen e së drejtës në aksione • Ekziston nevoja për të fuqizuar kriterin e miratimit të ndryshimit në aksionet lidhur me çështjet LPP/LFT • Dallime në përkufizimin e ‘institucioneve financiare’; • Pasiguri ligjore në kërkesat për licencim të disa institucioneve financiare • Numri i ulët i inspektimeve në vend • Çështjet e efikasitetit që shfaqen si rrjedhojë e mungesës së mandatit ligjor për mbikëqyrje; mungesa e mandatit ligjor për nxjerrjen e rregullave dhe rregulloreve dhe pasiguri ligjore në licencimin e TPV • Burimet njerëzore për autoritetet mbikëqyrëse nuk janë të mjaftueshme dhe prandaj ndikojnë në efikasitet • Mungesa e programeve gjegjëse të trajnimit për personelin mbikëqyrës ndikon në efikasitet • Nevoja që autoritetet të mbajnë të dhëna statistikore më kuptimplote përndryshe efikasiteti nuk mund të vlerësohet.
<p><i>Masat institucionale dhe të tjera</i></p>		
<p>R. 26 NjIF dhe funksionet e saj</p>	<p>PP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Gama dhe lloji i qasjes së NjIF në bazat e ndryshme të dhënave është e pamjaftueshme dhe kjo ndikon negativisht në funksionin analitik të njësisë • Dykuptimësia në kompetencat e NjIF për të kërkuar informata shtesë nga subjektet raportuese ka krijuar hapësirë për konteste ligjore • Kosova duhet të merre parasysh miratimin e parimeve të grupit Egmont për shkëmbimin ndërkombëtar të

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		<p>informatave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e informatave kthyese nga agjencitë e zbatimit të ligjit për NJIF ndikon negativisht në efikasitetin e saj • Mungesa e të dhënave statistikore për rezultatet e raporteve të NJIF nuk mundëson vlerësimin e duhur të efikasitetit dhe rëndësisë së analizave të NJIF • Formularët e rreptë të Raportimit dhe mungesave e informatave kthyese të veçanta dhe strategjike dhe e udhëzimeve për subjektet raportuese çon në RTD të cilësisë së dobët dhe kërkesat me informata shtesë krijojnë barrë për NJIF dhe sektorin bankar dhe kështu ulin efikasitetin • Nevoja për të kërkuar tepër informata shtesë (që buron nga RTD të cilësisë së dobët dhe joinformativ) krijon barrë për burimet e NJIF dhe ndikon negativisht në efikasitetin e saj • Raporti vjetor i NJIF nuk përmban tipologjinë e PP dhe nuk i është vënë në dispozicion opinionit të gjerë.
<p>R. 27 Autoritetet e zbatimit të ligjit</p>	<p>PP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e të dhënave të njësuar statistikore e bën të pamundshme vlerësimin e efikasitetit të hetimeve dhe ndjekjeve penale të PP me saktësi të plotë. • Shtimi i lëndëve të PSRK në lidhje me rastet e PP tregon mungesën e burimeve dhe nivelet e ulëta të efikasitetit • Personeli i papërshtatshëm në njësinë e specializuar për PP në polici ndikon në efikasitet • Policia nuk i siguron informata kthyese NJIF për rastet, prandaj ul efikasitetin e përgjithshëm të sistemit • Nuk sigurohen informata kthyese sistematike nga prokurorët për policinë dhe organet e tjera të zbatimit të ligjit për rezultatet e ndjekjes penale • Rënia e madhe në numrin e rasteve të raportuara të PP nga policia në PSRK në vitin 2012 tregon për uljen e efikasitetit të policisë në ndjekjen e PP • Nuk ka vetëdijësim të mjaftueshëm në polici në lidhje me nevojën për të ndjekur në mënyrë aktive pasurinë e fituar me vepra penale kur trajtojnë krimet monetare • Nuk ka kompetenca të qarta për të shtyrë apo për të heq dorë nga arrestimi me qëllim të mbledhjes së provave apo identifikimit të personave të përfshirë.
<p>R. 28 Kompetencat e autoriteteve kompetente</p>	<p>P</p>	<p>Ky rekomandim është përmbushur në plotësi.</p>
<p>R. 29 Mbikëqyrësit</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e mandatit ligjor për një autoritet kompetent mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT; • Mungesa e kompetencave mbikëqyrëse që mund të zbatohen për mbikëqyrjen e sektorit financiar për qëllime të LPP/LFT • Mungesa e mandatit ligjor për zbatimin e kompetencave mbikëqyrëse për qëllime të Ligjit LPP/LFT • Mungesa e një mandati për NJIF për të kryer inspektime jashtë

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka kompetenca të duhura për zbatim dhe dënime • Çështjet e efikasitetit që shfaqen si rrjedhojë e mungesës së mandatit mbikëqyrës dhe kompetencave të zbatimit • Burimet njerëzore për autoritetet mbikëqyrëse janë të pamjaftueshme dhe prandaj ndikojnë në efikasitet • Mungesa e programeve gjegjëse të trajnimit për personelin mbikëqyrës ka ndikim në efikasitet • Nevoja që autoritetet të mbajnë të dhëna statistikore më kuptimplote përndryshe efikasiteti nuk mund të vlerësohet.
<p>R. 30 Burimet, integriteti dhe trajnimet</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shtimi i lëndëve të PSRK në lidhje me rastet e PP tregon mungesën e burimeve dhe nivelet e ulëta të efikasitetit; • Personeli i papërshtatshëm në njësinë e specializuar për PP në polici ndikon në efikasitet; • Nuk ka vetëdijesim/kapacitet të mjaftueshëm në polici në lidhje me nevojën për të ndjekur në mënyrë aktive pasurinë e fituar me vepra penale kur trajtojnë krimet monetare; • Personeli në numër të vogël ndikon në efikasitetin e Doganave • Burimet njerëzore për autoritetet mbikëqyrëse janë të pamjaftueshme dhe kështu ndikojnë në efikasitet; • Mungesa e programeve gjegjëse të trajnimit për personelin mbikëqyrës ka ndikim në efikasitet.
<p>R. 31 Bashkëpunimi kombëtar</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mungesë e informatave kthyesë, ndarjes së informatave dhe bashkërendimit në mes të autoriteteve çon në mosefikasitet në regjimin LPP • Mungesa e bashkërendimit në nivelin e planifikimit strategjik dhe politikëbërjes në mes të institucioneve kyçe (KPK dhe Ministrisë së Financave) • Vonesat në zbatimin e Strategjisë kombëtare e posaçërisht në themelimin e Zyrës kombëtare për luftimin e krimeve ekonomike.
<p>R. 32 Ruajtja e të dhënave statistikore</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Duhet të fuqizohet obligimi për të gjitha autoritetet kompetente, subjektet raportuese dhe personat dhe subjektet e tjera për të mbajtur të dhëna statistikore përmes një dispozite ligjore • Nuk mbahen të dhëna statistikore kuptimplote për pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke e bërë të vështirë matjen e saktë të nivelit të efikasitetit të regjimit • Mungesa e të dhënave statistikore për rezultatet e raporteve të NJIF nuk mundëson vlerësimin e duhur të efikasitetit dhe rëndësisë së analizave të NJIF • Mungesa e të dhënave të njësuara statistikore e bën të pamundshme vlerësimin e efikasitetit të hetimeve dhe ndjekjeve penale të PP me saktësi të plotë • Ekziston nevoja që autoritetet mbikëqyrëse të mbajnë të dhëna statistikore më kuptimplote përndryshe nuk mund të vlerësohet efikasiteti i tyre ashtu siç duhet • Efikasiteti nuk mundet të dëshmohej për shkak të mungesës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat për NNJ lidhur me PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT • Efikasiteti përkitazi me bashkëpunimin ndërkombëtar

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		policor nuk mund të dëshmohej për shkak të mungesës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat e NJBNZL për PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT
R.33 Personat juridikë – mbajtësit e së drejtës së pronësisë	PP	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ekziston detyrimi i drejtpërdrejtë për njoftimin e ARBK për ndryshimet në menaxhment dhe ndarjen e aksioneve posa ato të ndodhin Shqetësime rreth saktësisë dhe volisë së informacionit në dispozicion; Shqetësime rreth kujdesit të duhur rreth themeluesve dhe hisedarëve kryesorë Shqetësime rreth volisë së disponueshmërisë së informacionit për autoritetet kompetente Nuk ka procedura për autoritetet kompetente përveç për ATK për identifikimin e asaj nëse numri i organizatës afariste i takon të njëjtit person Nuk ka procedura për autoritetet kompetente për identifikimin e lidhjeve në mes të organizatave afariste kur, përmes shtresave të ndryshme të pronësisë, disa kompani mund të kenë në pronësi njëra-tjetrën Shqetësime rreth lehtësisë së regjistrimit dhe Çështjet e efikasitetit si rrjedhojë
R. 36 Ndihma juridike ndërkombëtare	PP	<ul style="list-style-type: none"> Nuk ekzistojnë standarde të shërbimit për afatet e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesave të huaja që mund të pengojnë efikasitetin e sistemit Efikasiteti nuk mund të demonstrohej për shkak të mungesës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat për NNJ lidhur me PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT Lëndët e pazgjidhura përkitazi me kërkesat për NNJ që kërkojnë nxjerrjen e urdhrave gjyqësor.
R. 40 Format e tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar	KP	<ul style="list-style-type: none"> Efikasiteti përkitazi me bashkëpunimin ndërkombëtar policor nuk mund të dëshmohej për shkak të mungesës së të dhënave statistikore gjithëpërfshirëse për kërkesat e NJBNZL për PP, veprat e ndërlidhura penale dhe FT Nuk ekzistojnë standarde të shërbimit për afatet e kthimit të përgjigjes ndaj kërkesave të huaja që mund të pengojnë efikasitetin e sistemit
Nëntë rekomandimet e veçanta		
RV.II Vepra penale e FT	PP	<ul style="list-style-type: none"> Financimi nga një person terrorist (për çfarëdo qëllimi) nuk është në mënyrë të qartë i mbuluar me veprën penale të FT Terminologjia e paqëndrueshme apo e tepërt përdoret në dispozitat që kanë të bëjnë me FT në KP Përkufizim i mangët i “veprës terroriste” siç përcaktohet me nenin. 2(1) të konventës kundër FT Nuk ekziston një përkufizim i plotë dhe i përgjithshëm i veprës penale të terrorizmit “në përgjithësi” si subjekt i FT Përkufizim i mangët i “shkeljeve të traktatit” si subjekt i FT duke paraqitur një element shtesë funksional

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
		<ul style="list-style-type: none"> • Është e paqartë nëse përkufizimi i “veprës terroristet” në nenin 135.1 vlen edhe për veprat e ndërlidhura me terrorizmin (p.sh., rekrutimin për terrorizëm) ashtu që financimi i këtyre veprave mund të konsiderohet si vepër penale e FT
<p>RV.III Ngrirja e aseteve të terroriste</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekzistojnë ligje dhe procedura efektive në fuqi për ngrirjen e fondeve të terroriste dhe të pasurisë së tjetër të persona dhe subjekteve të caktuar në përputhje me RKSOKB 1267/1988 dhe 1373 apo sipas procedurave të nisura nga vendet e tjera dhe për të siguruar se veprimet për ngrirje vlejnë për fondet apo pasurinë e kontrolluar nga personat e caktuar • Nuk ekziston autoriteti përkatës për zbatimin e RKSOKB 1373; • Nuk ekziston një sistem efektiv për komunikimin e veprimeve për mekanizmat e ngrirjes për sektorin financiar dhe nuk ka udhëzime praktike në këtë fushë • Nuk ekzistojnë procedura për heqjen nga lista të kërkesave dhe shkrirjen e fondeve apo aseteve të tjera të subjekteve a personave që ndikohen pa qëllim nga mekanizmi i ngrirjes • Nuk ekzistojnë procedura për autorizimin e qasjes në fondet ose pasurinë e ngrira në mbështetje të RKSOKB 1267/1988 e në përputhje me RKSOKB 1452 • Nuk ekzistojnë procedura të veçanta për kontestimin e veprimeve të ngrirjes që ndërmerren sipas RKSOKB gjegjëse • Nuk ekzistojnë masa për mbikëqyrjen e respektimit të obligimeve sipas RV III dhe për shqiptimin e dënimeve
<p>RV. IV Raportimi i dyshimeve për financimin e terrorizmit</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekziston asnjë detyrim për Raportim në situatat kur informacioni në dispozicion tregon pastrim të mundshëm të parave apo financim të veprimtarive të terrorizmit • Nuk ekziston asnjë detyrim për Raportim për financimin e terrorizmit • Nuk ekziston detyrimi për Raportim për veprat e dyshimta në tentativë apo transaksionet • Numri i ulët i RTD • Shqetësime për mosdorëzimin e RTD dhe RTPG si dhe • Çështjet e efikasitetit lidhur me cilësinë dhe sasinë e Raportimit të RTD dhe Raportimit të RTPG të dyshimta
<p>RV.VI Kërkesat e LPP për shërbimet e transferimit të parave/shumave</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Pasiguri ligjore për licencim apo kërkesat e regjistrimit • Mungesa e mandatit ligjore për një autoritet përkatës mbikëqyrës • Pasiguri ligjore për emërimin, funksionet dhe kompetencat e ‘agjentëve’ • Si rrjedhojë, nuk ekziston detyrimi për të mbajtur një listë të agjentëve • Mungesa e dënimeve efikase, proporcionale dhe zbindëse penale, civile a administrative • Numri i vogël i inspektimeve në vend të ngjarjes • Çështjet e efikasitetit që shfaqen kryesisht për shkak të pasigurisë ligjore

Rekomandimi	Vlerësimi	Përmbledhje e faktorëve që përbëjnë vlerësimin
<p>RV.VIII</p> <p>Organizatat jofitimprurëse</p>	<p>MP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk është kryer vlerësimi i rrezikut për sektorin • Nuk ekziston asnjë detyrim ligjor që autoritetet të ndërgjegjësojnë sektorin e OJQ-ve • Mungesë e vizitave mbikëqyrëse • Paqartësi ligjore për kompetencat mbikëqyrëse për OJQ sipas nenit 30 të Ligjit LPP/LFT • prandaj nuk ka mbikëqyrje LPP/LFT • Nuk ekziston detyrimi për të mbajtur informata për organizatën në baza të vazhdueshme në të gjitha instancat. • Nuk ekziston detyrimi për identifikimin dhe Raportimin e informacionit për pronarin (pronarët) e OJQ-së • Nuk ekzistojnë dënime për të gjitha shkeljet sipas Ligjit për OJQ • Kontradikta në mes të Ligjit LPP/LFT dhe Ligjit për OJQ • Nuk ekzistojnë procedura të kujdesit të duhur për themeluesit në fazën e regjistrimit • Nuk ekzistojnë dispozita autorizuese për DRNOJQ për të kërkuar çfarëdo informacioni tjetër sipas nevojës • Nuk ekzistojnë dispozita autorizuese për NJIF sipas Ligjit LPP/LFT për të kërkuar çfarëdo informacioni tjetër sipas nevojës • Shqetësime rreth identifikimit të OJQ-ve që duhet hetuar dhe prandaj ekziston mundësia e hetimit • Çështje të efikasitetit si rrjedhojë e pikëpamjes së ngushtuar të DRNOJQ për përgjegjësitë e saj dhe për ndarjen e informacionit
<p>RV.IX</p> <p>Deklarimi gjatë kalimit të kufijve dhe paraqitja</p>	<p>KP</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ekzistojnë rregulla për ruajtjen e shënimeve në Doganat në lidhje me deklaratimet/deklarimet e rreme dhe dyshimet për PP/FT • Prokurorët nuk japin informata kthyesë të strukturuar për rastet që iu referohen nga Doganat • Personeli në numër të vogël ndikon në efikasitetin e Doganave.

Tabela 2: Plani i veprimit i rekomanduar për përmirësimin e sistemit LPP/LFT

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
1. Pjesa e Përgjithshme	Nuk kërkohet tekst
2. Sistemi Ligjor dhe Masat e Ndërlidhura Institucionale	
2.1 Kriminalizimi i Pastrimit të Parave (R.1)	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i përkufizimeve ligjore në lidhje me pasurinë e fituar me atë të veprës penale në mënyrë që të eliminohet konfuzioni dhe hutia në këtë fushë. • Ri-definimi i nivelit të kërkuar të provës për krimin kryesor (Neni 32 par. 4.1) dhe/apo ofrimi i udhëzimeve adekuate për praktikantët në këtë drejtim. • Ri-formulimi i dispozitave që definojnë mbulimin e vet-pastrimit (Neni 32 parag. 4.2) në mënyrë që të përmirësohet mos papërshtatshmëria aktuale. • Harmonizimi i dispozitave përkatëse të Ligjit LPP/LFT dhe KP, në kuptim të konceptit dhe terminologjisë në lidhje me veprat ndihmëse. • Ofrimi i një kriminalizimi adekuate për veprën penale për manipulim të tregut dhe përfshirja e saj si vepër penale kryesore e PP.
2.2 Përgjegjësia për veprën penale të PP	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i përgjegjësisë bazike penale të korporatave siç përcaktohet aktualisht me anë të legjislacionit (nëse apo jo varet mbi fajësinë e personit juridik) • Harmonizimi i dispozitave përkatëse të Ligjit LPP/LFT dhe KPP në aspekt të konceptit dhe terminologjisë në lidhje me: <ul style="list-style-type: none"> ○ Standardin e njohurisë që aplikohet në rast të veprave penale të PP (Ligji LPP/LFT kundrejt KP) ○ Gjërat bazike në lidhje me përgjegjësinë penale të korporatave dhe atë të personave fizik të ndërlidhur (Neni 34 Ligji LPP/LFT kundrejt Nenit 40 KP/Neni 5 LPPJ) • Përshkrimi i sanksioneve më të rrepta (rritja e llojeve të gjobave) që aplikohen për entitetet ligjore për vepra penale.
2.3 Kriminalizimi i Financimit të Terrorizmit (RV.II)	<ul style="list-style-type: none"> • Kriminalizimi i dyfishtë i FT (në KP në një anë dhe në Ligjin e ndryshuar rishtazi LPP/LFT në anën tjetër) duhet urgjentisht të adresohet nga autoritetet Kosovare (përfshirë edhe Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave) në mënyrë që të ofrohet një vepër penale e vetme, autonome dhe gjithëpërfshirëse e FT që përmbush të gjitha aspektet e RV II. • Ndryshimi i mbulesës aktuale të “aktit terrorist” (akti i terrorizmit” etj) dhe ri-definimi i tij në pajtim të plotë me Nenin 2(1) të Konventës FT përfshirë:

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ofrimin për një mbulesë të kompletuar dhe të përgjithshme të veprës penale “gjenerike” të terrorizmit. ○ Heqja e kërkesës të elementit shtesë të shkakut për “veprat traktat” si subjekt i FT ○ Të bëhet e qartë se definimi i “aktit terrorist” në Nenin 135.1 shtrihet në veprat që kanë të bëjnë me terrorizmin (p.sh. rekrutimin për terrorizëm) në mënyrë që financimi i këtyre veprave mund të konsiderohet vepër penale e FT. ● Veprimet e listuara më poshtë të gjitha i referohen kriminalizimit të FT siç ofrohet aktualisht me KP: <ul style="list-style-type: none"> ○ Kriminalizimi i financimit të një terroristi individual (për çfarëdo qëllimi) në veprën penale FT. ○ Ndryshimi dhe ri-formulimi i terminologjisë jo konsistente të përdorur në dispozitat që kanë të bëjnë me FT
2.4 Konfiskimi, ngrirja dhe marrja e pasurisë së fituar përmes krimit (R.3)	<ul style="list-style-type: none"> ● Kodi i Procedurës Penale duhet të ndryshohet për të përfshirë dispozita të cilat tregojnë standarde të provës që kërkohen për të mundësuar konfiskimin e instrumentaliteteve të synuara për përdorim në një vepër penale. ● Kosova duhet të harmonizojë dispozitat e KP dhe KPP në lidhje me konfiskimet e palëve të treta. Në këtë rast, prioritet i duhet dhënë kornizës së vendosur në KP, e cila është në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare, dhe nuk do të paraqiste probleme efektshmërie në lidhje me implementimin, për dallim nga dispozitat e KPP. ● Kosova duhet të ndryshojë dispozitat e KPP që rregullojnë mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë në mirëbesim. Standardi i kërkuar i provës për mirëbesim për të dëshmuar të drejtat e tyre legjitime dhe qëllimet në lidhje me pronën që duhet të zvogëlohet. ● Kosova duhet të themelojë mekanizma për të parandaluar ose anuluar veprime, kontraktuale ose të tjera, kur personat e përfshirë kanë ditur ose është dashur ta dinë që si rezultat i këtyre veprimeve autoritetet do të paragjykoreshin në aftësinë e tyre për t’i kthyer pronat e konfiskuara. ● Gjyqësori duhet të lejohet dhe të inkurajohet të marrë qasje proaktive në ndërmarrjen e masave të nevojshme, ku prokurori ka dështuar qartazi në një rrethanë të dukshme të rastit konkret të procedojë me marrje dhe konfiskim të instrumentaliteteve/përfitimeve të njohura nga krimi.

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<ul style="list-style-type: none"> • Kosova duhet të ndryshojë komponentët relevante të strategjisë LPP/LFT sa më shpejt që është e mundur, në veçanti lidhur me përmirësimin e rolit të hetimeve financiare, mekanizmave të kthimit të aseteve dhe koordinimit mes agjencive në këto fusha. • Zyra Kombëtare për Zbatim të Krimeve Ekonomike, e paraparë sipas Strategjisë duhet të bëhet operacionale dhe e pajisur me staf sa më shpejtë që është e mundur në mënyrë që ta monitorojë dhe përmirësojë efektshmërinë e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të agjencive në fushën e krimeve financiare. • Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Policia, KPK, KGJK duhet të mbajnë statistika të koordinuara me një nivel më të madh të detajeve mbi sasinë e pronave të ngrira, marra dhe të konfiskuara në lidhje me veprat penale të PP, FT, pasurive të fituara nga krimi dhe veprat penale kryesore. • Duket të ketë konsistencë të terminologjisë në tërë legjislacionin për t'i larguar paqartësitë, përfshirë mospërputhjet në mes të Ligjit LPP/LFT, KP dhe KPP. • Zëvendësim i pasurive jo të fituara përmes veprës penale në lidhje me konfiskimin e të ardhurave/përfitimeve materiale nënkuptohet në nenin 97.1 të Kodit Penal. Kjo duhet të ri-hartohet për ta larguar çfarëdo dyshimi. • Urdhrat për Ngrirje të Përkohshme iniciohen nga Prokurori. Ka dispozita për ankesë nga ata të cilët preken nga Urdhri por nuk përmendet në mënyrë shprehimore në KPP që aplikimi i këtyre Urdhrave është <i>ex parte</i>. Gjuha e dispozitave relevante (Neni 274 KPP) duhet të jetë e shprehur për ta hequr çfarëdo dyshimi. • Kosova duhet ta mendojë implementimin e një sistemi të konfiskimit <i>in rem</i> të pasurisë së fituar përmes veprës penale. Ndryshimet në ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit nuk e ofrojnë këtë.
2.5 Ngrirja e fondeve të përdorura për financimin e terrorizmit (RV.III)	<ul style="list-style-type: none"> • Hartimi dhe miratimi i ligjeve dhe procedurave efektive për ngrirjen e fondeve terroriste dhe aseteve të tjera të personave të caktuar dhe ndërmarrjeve në pajtim me RKS KB 1267/1988 dhe 1373 apo përmes procedurave të iniciuara nga vendet e treta dhe sigurimi që këto veprime të ngrirjes përfshijnë fondet apo asetet e kontrolluara nga personat e caktuar. • Themelimi i një autoriteti kompetent të caktuar për qëllime të RKS KB 1373.

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<ul style="list-style-type: none"> • Themelimi i një sistemi efektiv për komunikimin e veprimeve sipas mekanizmave të ngrirjes për sektorin financiar dhe ofrimi i udhëzimeve praktike adekuatë në këtë fushë. • Vendosja e procedurave të duhura <ul style="list-style-type: none"> ○ Për të shqyrtuar heqjen nga lista dhe shkrirjen e fondeve dhe asetëve të tjera të personave apo të ndërmarrjeve të fshirë nga lista apo ndërmarrjeve dhe personave të prekur nga një mekanizëm i ngrirjes; ○ Për të autorizuar qasje në fondet apo asetet e tjera të ngrira sipas RKSKB 1267/1988 në pajtim me RKSKB 1452; ○ Dhe, për procedura specifike për të sfiduar veprimet e shkrirjes të marra sipas RKSKB përkatëse. • Ofrimi i masave për monitorimin e përputhshmërisë me implementimin e obligimeve sipas RV.III dhe shqiptimi i masave.
2.6 Njësiti i Inteligjencës Financiare dhe funksionet e tij (R.26)	<ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Financave dhe Bordi Drejtues i NJIF duhet të marrë masa për ta lehtësuar dhe promovuar qëndrimin institucional të NJIF në lidhje me autoritetet e tjera. • Numri i bazës së të dhënave në të cilat ka qasje NJIF duhet të zgjerohet. Çka është me e rëndësishmja, NJIF duhet të ketë qasje në bazën e të dhënave të Policisë. Këto baza të të dhënave ku NJIF i njihet qasje direkte duhet të jene të integruara në kornizën kryesore analitike të goAML për ta përmirësuar kualitetin, fushëveprimin, dhe shpejtësinë e analizave. • Format e raportimit nuk duhet të paraqesin obligim mbi entitetet raportuese të cilat shkojnë përtej ligjit LPP/LFT (barra e shtuara e burimeve mbi sektorin privat) • NJIF duhet të marrë masa shtesë për ta rritur kualitetin e RTD dhe ta zvogëlojë barrën e kërkesave shtesë duke punuar me sektorin raportues, duke ofruar informacione të përgjithshme (tipologji) dhe të targetuar të shpërndarjes së RTD. • Një sistem formal dhe i rregullt i informacionit mbi progresin e referimeve të NJIF duhet të implementohet bashkërisht me Policinë, Doganat dhe Prokurorinë. Çështja duhet të konsiderohet si një prej prioriteteve nga Zyra Kombëtare për Zbatimin e Krimeve Ekonomike, kur të themelohet kjo Zyrë. • Mungesa e statistikave të kuptimita që demonstronë rezultatet e shpërndarjeve të NJIF tek zbatimi i ligjit është zbrazëtia kryesore dhe duhet të përmirësohet

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<p>nga autoritetet e Kosovës në një kohe sa me të shkurtër të mundshme përmes një përpjekje kolektive në mes të agjencive.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Publikimi i raportit vjetor nga NJIF duhet të konsiderohet prioritet në mënyrë që të ngrihet vetëdija në lidhje me aktivitetet e NJIF në mes të komunitetit me të gjere nder-agjencial, si dhe sektorit raportues. Ky raport duhet të përdoret, në mes tjerash, si një mjet efektiv nga NJIF për të ofruar informacione për sektorin raportues, dhe kështu duhet gjithmonë të përfshijë informacione në lidhje me tipologjitë aktuale PP. • Rekomandohet ndryshimi i tekstit të Ligjit LPP/LFT për t'i bere kompetencat NJIF për të kërkuar informacione shtesë të padiskutueshme dhe të mos i nënshtrohen asnjë lloj interpretimi. • NJIF duhet të implementojë Parimet Egmont për Shkëmbim Informacionesh në komunikimin e tij me NJIF të huaj. • NJIF duhet ta beje një vlerësim të nevojave financiare dhe teknike përfshirë një vizion tri vjeçar. Kjo duhet të plotësohet dhe të informohet me një vlerësim të rreziqeve dhe kërcënimeve të pastrimit të parave për Kosovën (siç parashihet me strategjinë LPP/LFT), ku NJIF duhet të mere rol udhëheqës. Dy vlerësimet duhet të prodhojnë një plan të veprimeve të integruara/alokim të resurseve me prioritete të përbashkëta të përcaktuara për NJIF, zbatimin e ligjit, autoritetet mbikëqyrëse dhe politikëbërëse.
2.7 Zbatimi i ligjit, prokuroria dhe autoritetet tjera kompetente (R.27)	<ul style="list-style-type: none"> • Zyra Kombëtare për Zbatim të Krimeve Ekonomike duhet të dizajnoje urgjentisht masa për bashkëpunim me të ngushte të NJIF/Policisë dhe monitoroje implementimin e tij në mënyrë që ta ngrejë eficiencën në përdorimin e resurseve të NJIF nga policia. • Zyra Kombëtare për Zbatim të Krimeve Ekonomike duhet ta krijojë një sistem të mbajtjes së statistikave të unifikuara në mesin e policisë dhe prokurorisë mbi rastet e PP në mënyrë që të sigurojë analize të sakta të efektshmerisë së sistemit. • Shtimi i personelit për njësitin për krime financiare dhe pastrim të parave të Policisë së Kosovës. • Zyrtari ndërlidhës i policisë i vendosur në NJIF pas nënshkrimit të MB duhet të jete kanali kryesor i informacionit në mes të dy agjencive, në veçanti në lidhje me ofrimin e informacioneve mbi progresin e rasteve të NJIF. Kjo duhet të specifikohet në mënyrë shprehimore në tekstin e MB. Përveç kësaj, NJIF duhet të mbaje konsultime dhe takime koordinuese të rregullta me njësitin e Policisë PP mbi çështjet që

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<p>kane të bëjnë me përmbajtjen e materialit të ofruar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i kritereve objektive dhe transparente për emërimin/shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe top menaxhmentit të Policisë në mënyrë që të sigurohet pavarësia operationale e Policisë (shih përshkrimin në Raportin KK, Seksioni 2.3) • Rekomandohet adoptimi i udhërrëfimeve për Policinë në lidhje me aprovimin e angazhimit të jashtëm të jashtëzakonshëm të zyrtareve policor dhe vendosjen e një limiti për pagesën e angazhimit të tillë (shih përshkrimin në Raportin KK, Seksioni 2.3) • Roli i Inspektoratit të Policisë së Kosovës duhet të zgjerohet për ta përfshirë një vlerësim mbi atë nëse PK është efektive dhe “e duhur për qëllimin”. Këto raporte duhet të jene publike. • Duhet të ketë përpjekje të harmonizuara për ta larguar grumbullimin e rasteve të PP në sistemin prokurorial. • Autoritetet kompetente të Kosovës duhet të ndërmarrin rishikim të trendeve dhe teknikave të PP/LT në baza të rregullta në mes të agjencive me inpute të detajuara nga policia dhe prokuroria.
2.8 Deklarimi dhe zbulimi ndërkufitar (RV.IX)	<ul style="list-style-type: none"> • Duhet kushtuar rëndësi fuqizimit të mëtutjeshëm të Doganave përmes alokimit të burimeve shtesë për të motivuar dhe lehtësuar plotësimin e vendeve të lira të punës, si dhe fuqizimin e integritetit të stafit. • Një vlerësim periodik i jashtëm “në forme për qëllimin” duhet të behet në lidhje me Doganat e Kosovës në mënyrë që të vlerësohet funksioni, struktura, efektshmëria dhe vlera për para. Rezultatet duhet bere publike.
3. Masat Preventive- Institucionet Financiare	
3.1 Rreziku i pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit	<ul style="list-style-type: none"> • Autoritetet Kosovare duhet të ndërmarrin një vlerësim kombëtar të rreziqeve të PP dhe LT.
3.2 Kujdesi i shtuar i konsumatorëve, përfshirë masa të përmirësuar dhe të zvogëluara (R.5)	<ul style="list-style-type: none"> • Një rishikim i Rregullit X, që përfshin Letrën Këshillëdhënëse 2007/1 të BQK në kontekst të legjislacionit të ri dhe shfuqizimit të Rregulloreve të UNMIK-ut. • Harmonizimi i definicionit të ‘institucioneve financiare’ në ligjet dhe rregulloret përkatëse; • Obligimet ligjore për aplikimin e masave të plote të KSHK siç definohet në Ligjin LPP/LFT për dallim nga aplikimi i proceseve të identifikimit dhe verifikimit të cilat vetëm përbejnë një komponent të konceptit të KSHK; • Një rishikim i shpërndarjes dhe aplikimit të listës së Kombeve të Bashkuara dhe listave të tjera të personave

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<p>dhe entiteteve të caktuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> Një rishikim i përgjithshëm i Ligjit LPP/LFT në fushat specifike që kanë të bëjnë me KSHK të përmirësuar dhe reduktuar në kuadër të kontekstit të aplikimit dhe udhëzimit mbi qasjen të bazuar në rrezik dhe harmonizimin e dispozitave siç përshkruhet në Kriteret Thelbësore përkatëse.
3.3 Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP) (R.6)	<ul style="list-style-type: none"> Harmonizimi i definicionit të një PEP me definicionin e FATF në Ligjin LPP/LFT; Krijimi i obligimit ligjor për ta identifikuar nëse një pronar përfitues i një ndërmarrje ligjore përfshihet në definicion të PEP; Ndryshimi i nenit 21 të Ligjit LPP/LFT për të siguruar se procedurat aplikohen për të identifikuar nëse një konsumator apo një pronar përfitues është eventualisht i identifikuar si PEP ose behet PEP; Qartësimi në nenin 21 të Ligjit LPP/LFT se identifikimi i burimit të fondeve aplikohet në baza të vazhdueshme për të gjitha transaksionet me PEP; Ofrimi i udhëzimeve për industrinë.
3.4 Sekreti ose konfidencialiteti i institucioneve financiare (R.4)	<ul style="list-style-type: none"> Të shtohet një pikë në Nenin 74(2) të Ligjit mbi BQK, në veçanti, nëse BQK-së eventualisht i jepen kompetenca mbikëqyrëse sipas dhe për qëllime të Ligjit LPP/LFT, të qartësohet heqja e konfidencialitetit kur BQK i ofron informacione NJIF.
3.5 Mbajtja e shënimeve (R.10)	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshimi i paragrafit (6.2) i Nenit 17 në lidhje me kohëzgjatjen e periudhës së mbajtjes për një seri të transaksioneve të rastësishme të ndërlydhura; Futja e një paragrafi të ri (7) në Nenin 17 që i jep kompetencë NJIF për ta zgjatur periudhën e mbajtjes në disa raste specifike; Ndryshimi i paragrafit (6.1) i Nenit 17 në pajtim me paragrafin (6) të Nenit 18; dhe Harmonizimin e nenit 17 dhe nenit 20 mbi disponueshmërinë e të dhënave të mbajtura për autoritetet kompetente.
3.6 Raportimi i Transaksioneve të Dyshimta (R.13 & RV.IV)	<ul style="list-style-type: none"> Ndryshimi i definicionit të `veprave dhe transaksioneve të dyshimta` për të përfshirë situata kur informacioni tregon se një person ose ndërmarrje mund të jete i përfshirë në aktivitete kriminale; Ndryshimi i Nenit 22 për të krijuar obligime raportuese për financim të terrorizmit; Ndryshimi i definicionit nga `veprat apo transaksionet e dyshimta` në veprat apo transaksionet në tentative; dhe NJIF të ndërmarrë masa për të siguruar që CTR të cilat krijojnë dyshime janë po ashtu të raportuara si RTD dhe të krijohet ndërgjegjësimi po ashtu.

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
3.7 Mbrojtja dhe mosnxjerrja e informacionit (R.14)	<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i Nenit 35 të ligjit LPP/LFT për ta shtrirë mbrojtjen për drejtorët, zyrtarët, punonjësit, të përkohshëm ose të përhershëm; • Ndryshimi i paragrafit (4) i Nenit 22 që parasheh ndalim të shpalesjes në pajtim me standardet ndërkombëtare; • Shqyrtimi i mundësisë për ta zgjeruar shpalesjen tek subjektet dhe entitetet tjera raportuese; • Sigurimi që paragrafi (1.3) i Nenit 15 nuk përfshin emra apo detaje personale të personelit në banka ose institucione financiare që bëjnë raport ose ofrojnë informacion; • Rishikimi i paragrafit (2) i Nenit 15 të ligjit për të kufizuar entitetet apo autoritetet të cilëve do të mund t'u jepej informacion në ata të cilëve NJIF iu përcjell raportet e veta; • Shtimi i një paragrafi të ri (4) Nenit 15 të Ligjit LPP/LFT që obligon çdo autoritet që për çfarëdo arsye ka në posedim informacione personale mbi personelin e subjektit raportues të cilët kane paraqitur raport apo kane ofruar informacione, t'i mbrojnë ato informacione dhe t'i mbajnë ato konfidenciale; • Shqyrtimi i dispozitave të Nenit 28 të Direktivës së Tretë të BE-së mbi heqjen e ndalesave të shpalesjes në rastet e veçanta; dhe • Shqyrtimi i futjes së një paragrafi të ri (4A) në Nenin 22 të Ligjit LPP/LFT që ndalon shpalesjen në rrethana siç përcaktohet në Konventën e Këshillit të Evropës (CETS 198)
3.8 Bankat guaskë (R.18)	<ul style="list-style-type: none"> • Ri-hartimi i paragrafit (6) të Nenit 21 për ti larguar paqartësitë ligjore; • Futja e një definicioni të 'marrëdhënies së bankës korresponduese' që përfshin institucionet 'korrespondente' dhe 'pranuese' në pajtim me definimin në Glosarin FATF për Metodologji; • Futja e një paragrafi të ri (4.6) në Nenin 21 të Ligjit LPP/LFT për të siguruar se bankat konfirmojnë se institucionet e tyre korrespondente nuk lejojnë përdorimin e llogarive të tyre nga bankat guaskë.

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
3.9 Mbikëqyrja dhe monitorimi i vazhdueshëm dhe Hyrja në Treg (R.23)	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një baze ligjore për emërimin e autoritetit ligjor për të vepruar si autoritet mbikëqyrës për sektorin financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT; • Një mandat ligjor mbikëqyrës duhet të përcillet me një mandat për autoritetin e emëruar mbikëqyrës për të lëshuar rregulla dhe rregullore të detyrueshme për qëllime të Ligjit LPP/LFT (për BQK përtej kompetencave të BQK në këtë drejtim sipas nenit 85 të ligjit mbi bankat për qëllime kujdesi; • Futja e një paragrafi të ri (6) në Nenin 37 të Ligjit mbi Bankat që kërkon nga një person apo entitet, që vetëm ose me dikë tjetër, të heqë dorë nga një përqindje e konsiderueshme ose zvogëlojë aksionet, dhe ta informojë siç duhet BQK; • Futja e një paragrafi (2) në nenin 38 të Ligjit mbi Bankat që kërkon aplikimin e kriterit të LPP/LFT siç përcaktohet sipas Direktivës së BE-së për Shkrirje dhe Blerje për aprovimin e ndryshimit të aksionareve.; • Ndryshimi i paragrafit (3) i Nenit 39 i Ligjit mbi Bankat me shkrirjet, konsolidimet dhe blerjet pas paragrafit të propozuar (2) në Nenin 38; dhe • Harmonizimi i definicionit të ‘institucionit financiar’ në ligje të ndryshme.
3.10 Mbikëqyrësit (R.29)	<ul style="list-style-type: none"> • Futja e një Neni të ri 30B në Ligjin LPP/LFT sipas të cilit një autoritet mbikëqyrës i emëruar sipas Ligjit LPP/LFT i cili veç ka pas autoritet mbikëqyrës sipas ndonjë legjislacioni tjetër, mund të ushtroje kompetencat e veta mbikëqyrëse sipas ligjeve përkatëse për të mbikëqyrur përputhshmërinë sipas Ligjit LPP/LFT me përjashtim të aplikimit të dënimeve dhe sanksioneve administrative ose të tjera sipas këtyre ligjeve, pasi që këto janë plotësuar në ligjin LPP/LFT; dhe • Futja e një neni të ri (6) në nenin 30 të Ligjit LPP/LFT që parasheh kompetenca për ekzaminime jashtë terrenit të NJIF.

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
3.11 Sanksionet (R.17)	<ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i Nenit 24(8), Nenit 25(7), Nenit 26(14) dhe Nenit 27(4) brenda kontekstit të ndryshimeve të propozuara në Nenin 31 të Ligjit LPP/LFT; • Rishikimi i veprave aktuale penale dhe veprave të tjera për qartësi juridike dhe shmangie të komplikimeve ligjore në aplikimin e veprave penale të dyfishta dhe dënimeve të ndryshme; • Ri-hartimi i Nenit 31 dhe prezantimi i Neneve të reja 31 A dhe 31B siç janë reflektuar në Ligjin që ndryshon Ligjin LPP/LFT; • Caktimi i autoritetit/autoriteteve për shqiptimin e sanksioneve përmes Nenit 31 të ndryshuar; • Të sigurohet që sanksionet aplikohen për drejtor dhe menaxhmentin e larte përmes ndryshimit të Nenit 31 dhe për këtë qëllim të ndryshohet neni 34 i Ligjit LPP/LFT; dhe • Prezantimi një varg sanksionesh përmes ndryshimit të Nenit 31 siç është propozuar.
3.12 Shërbimet e transferit të parave ose vlerave (RV.VI)	<ul style="list-style-type: none"> • Harmonizimi i përkufizimit ‘institucione financiare’ në legjislacionin përkatës, përfshirë Ligjin LPP/LFT, përfshirë aktivitetet të cilat mund të ndërmerren nga institucionet financiare jo-bankare; • Caktimi i një autoriteti kompetent me kompetenca rregullative dhe mbikëqyrëse për qëllime të Ligjit LPP/LFT për tere sektorin financiar; • Qartësimi në Ligjin mbi Bankat i kompetencave për institucione financiare jobankare, përfshirë ofruesit e shërbimeve të TPV, për të emëruar agjent dhe nën çfarë kushtesh, dhe për t’i ndaluar ata; • Futja e një definicioni të ‘agjentit’ në Ligjin për Bankat; • Futja e një paragrafi apo Neni në Ligjin mbi Bankat apo Ligjin LPP/LFT që i obligon ofruesit e shërbimeve të TPV-ve ta mbajnë një liste të agjenteve nëse Ligji mbi Bankat nuk e ndalon këtë; • Ri-hartimi i nenit 31 i Ligjit LPP/LFT siç rekomandohet sipas Seksionit 3.11 të këtij Raporti.
3.13 Teknikat moderne e transaksioneve të sigurta (R.20)	<ul style="list-style-type: none"> • BQK duhet ta dokumentojë strategjinë e vet për teknika me të mira të menaxhimit të parasë në dore me objektiva dhe qëllime përfshirë prezantimin e sistemeve të huave dhe krediteve direkte; • BQK duhet ta koordinojë një studim mbi statistikat mbi valutën e lëshuar dhe valutën e deponuar për ta identifikuar burimin e këtyre dallimeve në bashkëpunim me autoritetet e tjera siç janë Doganat dhe Administrata Tatimore; • Ky studim duhet po ashtu t’i identifikojë arsyet për përdorim të lartë të bankënotës prej €500;

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<ul style="list-style-type: none"> • Rekomandohet të sigurohet efektshmëria e implementimit të Nenit 13 të Ligjit për Administratën Tatimore nga Administrata Tatimore.
4. Personat juridikë dhe marrëveshjet	
4.1 Personat juridikë - qasja në pronësi përfituese dhe informacion kontrolli (R.33)	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i një detyrimi për raportim të menjëhershëm të ndryshimeve në aksionar dhe drejtor përveç emërimit sipas rastit të një personi përgjegjës për ta bërë atë; • Prezantimi i procedurave dhe sistemeve për autoritetet kompetente dhe industrinë për të identifikuar ku një person ka me shume se një shoqëri tregtare në pronësi; • Prezantimi i procedurave administrative për të vërtetuar aq sa është e mundur vërtetësinë e dokumenteve dhe përmbajtjen e tyre nga ARBK në mënyrë që të sigurohet se si personat fizikë ashtu edhe ata juridikë që themelojnë kompani të kontrollohen dhe monitorohen në lidhje me të dhëna të mundshme kriminale apo diskualifikime profesionale si dhe kundruall listës së Kombeve të Bashkuara dhe listave të tjera të personave dhe entiteteve të caktuara; • Prezantimi i procedurave për ta identifikuar lidhshmërinë në mes të shoqërive tregtare të regjistruara; • Prezantimi i masave për saktësinë dhe vlefshmërinë e aplikacioneve për regjistrim për të ruajtur për periudhe të shkurtër të regjistrimit.
5. Organizatat Joprofitabile	
5.1 Organizatat Jo-Profitabile (RV.VIII)	<ul style="list-style-type: none"> • Të futet një nen i ri 2A mbi ‘Caktimin dhe Kompetencat e Organit Kompetent’ në Ligjin mbi OJQ që parasheh kompetencat e Organit Kompetent në lidhje me caktimin; funksionet dhe përgjegjësitë sipas Ligjit; mbikëqyrjen e OJQ-së; dhe vlerësimin periodik të rrezikut përfshirë ndarjen e informacionit; • Të ndryshohet përkufizimi i ‘Organit Kompetent’ në Nenin 2 të Ligjit mbi OJQ; • Të largohet paqartësia ligjore mbi kompetencat mbikëqyrëse sipas Nenit 30 dhe të caktohet një autoritetet për monitorim të OJQ-ve për qëllime të Nenit 24 të Ligjit LPP/LFT;¹⁸⁹ • Të ndryshohet paragrafi (11) i Nenit 9 i Ligjit mbi OJQ që kërkon nga OJQ-të po ashtu të raportojnë ndryshimet në lidhje me paragrafin (4.2) dhe (4.3) të Nenit 18 të Ligjit mbi OJQ; • Të shqyrtohet mundësia e futjes së sanksioneve gjyqësore për shkelje të Nenit 4 dhe paragrafit (11) të Nenit 9 të

¹⁸⁹ Projektligji i ndryshuar që ndryshon Ligjin LPP/LFT propozon që këtë përgjegjësi t’ia kalojë NJIF.

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<p>Ligjit mbi OJQ;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Harmonizimi i Nenit 24 të Ligjit LPP/LFT dhe Nenit 21 të Ligjit mbi OJQ mbi kompetencat sanksionuese të Organit Kompetent; • Futja e një paragrafi (1.3) i Nenit 21 i Ligjit mbi OJQ-të që ofrojnë një lidhje në mes të Nenit 24 të Ligjit LPP/LFT mbi largimin e regjistrimit për mospërputhshmëri me Nenin 24 të Ligjit LPP/LFT; • Përfshirja e masave në procedurat e brendshme të licencimit të DRNOJQ për kujdes të shtuar ndaj themeluesve, së paku me reference në listën e Kombeve të Bashkuara dhe listave të tjera të personave dhe entiteteve të caktuara; • Ndryshimi i paragrafit (4) i Nenit 24 të Ligjit LPP/LFT për të parapare mbajtje të të dhënave të transaksioneve dhe disponueshmërinë e tyre për autoritetet kompetente; • Futja e një paragrafi (5A) në Nenin 24 të Ligjit LPP/LFT që i jep kompetenca NJIF për të kërkuar informacione, të dhëna apo dokumente nga OJQ-të për qëllime të përmbushjes së obligimeve të veta sipas Ligjit në vijim të paragrafëve (4) dhe (9) të Nenit të njëjtë; • Rishikimi i Nenit 4 i Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të NJIF dhe DRNOJQ; • Vendosja e mekanizmit praktik për bashkëpunim dhe ndarje të informacioneve në mes të autoriteteve relevante për sektorin e OJQ-ve; • Ndërmarrja e një vlerësimi të rreziqeve dhe dobësive ndaj të cilave mund të ekspozohen OJQ-të apo të shfrytëzohen për financim terrorizmi dhe implementimi i një programi vetëdijesimi për OJQ për të krijuar me shume vetëdije të rreziqeve dhe dobësive të tilla përfshirë sesione trajnimi vetëdijesuese; • DRNOJQ duhet të ndërmarrë një vlerësim strategjik për të përcaktuar se cilat OJQ mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve financiare sipas kontrollit të sektorit apo kane një hise të konsiderueshme në aktivitetet e sektorit ndërkombëtar. Ky vlerësim duhet të ndahet me NJIF; • Zgjerimi i Udhëzimit Administrativ të NJIF që kërkon nga entitetet raportues t'i kushtojnë vëmendje të veçantë RKSKB mbi caktimin e individëve dhe organizatave në DRNOJQ; dhe • Implementimi i komponentëve relevante të Strategjisë LPP/LFT me efekt të menjëhershëm.
6. Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar	
6.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi kombëtar (R.31)	<ul style="list-style-type: none"> • Në mënyrë që të përmirësohen mangësitë në fushën e bashkëpunimit ndërmjet agjencive, autoritetet në Kosovë duhet të bëjnë prioritet implementimin e Strategjive

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<p>LPP/Krimit Ekonomik. Kjo megjithatë, duhet të behet në mënyrë të koordinuar, duke pas parasysh numrin e çështjeve të ndërlidhura në mes të dy dokumenteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> Në sytë e ekipit të vlerësimit, Strategjia e KGJK duhet të jete me eksplicite në lidhje me promovimin e rezultateve në mes të autoriteteve relevante, që mund të arrihet përmes futjes së obligimeve të detyrueshme në MB-i. kjo duhet po ashtu të përmendet në Planin e Veprimit të Strategjisë. Ky Bord i Koordinimit të Përbashkët të Sundimit të Ligjit duhet të mbahet i informuar për implementimin e Strategjisë LPP/Krimit Ekonomik dhe Planit Strategjik të KGK mbi bashkëpunimin ndërinstitucional në mënyrë që të sigurohet koordinimi dhe plotësimi me çështjet e tjera që diskutohen në agjendën e saj.
6.2 Ndhma Juridike e Dyanshme (R.36)	<ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i standardeve të shërbimeve për kohën e kthimit të kërkesave të huaja të cilat do të mund ta dëmtonin efektivitetin e sistemit. Ndryshimi i legjislacionit procedural në mënyrë që të shmangen grumbullimet e gjate të rasteve në lidhje me kërkesat e NJD të cilat kërkojnë lëshim të Urdhrave Gjyqësor.
6.3 Format e tjera të bashkëpunimit (R.40)	<ul style="list-style-type: none"> ILECU duhet të mbaje statistika përfshirë detaje të mjaftueshme për të identifikuar veprat penale kryesore ku pastrimi i parave/FT është pjesë, si dhe kohën e kthimit të kërkesave pa të cilën është e pamundur të gjykohej efektshmëria. Ligji LPP duhet të përfshijë një mundësi për NJIF apo prokuror për të kërkuar urdhër për të kërkuar monitorim të të llogarisë bankare. Kosova duhet ta qartësojë nëse e refuzon apo jo bashkëpunimin ndërkombëtar mbi baza që kanë të bëjnë me shkelje politike. NJIF duhet të ketë kompetenca për të ngrirë ose shtyrë transaksionet mbi kërkesat e NJIF-ve të huaja.
7. Çështje të tjera	
7.1 Resurset dhe Statistikat (R. 30 & 32)	<ul style="list-style-type: none"> Një mandat ligjor që cakton autoritetin kompetent për të mbikëqyrur tërë sektorin financiar për qëllime të Ligjit LPP/LFT duhet të përcillet nga një rishikim i burimeve adekuate njerëzore dhe të tjera. Agjencia për Menaxhimin e Aseteve, policia, KPK dhe KGJK duhet të mbajnë statistika të koordinuara me një nivel më të madh të detajeve mbi shumat e pronës së ngrirë, marrë dhe konfiskuar në lidhje me veprat penale të PP, FT, pasuritë kriminale dhe veprat penale kryesore. Mungesa e statistikave të kuptueshme që demonstronin rezultatet e shpërndarjeve të NJIF të agjencitë e zbatimit të ligjit është zbrazëtira kryesore dhe duhet të përmirësohet

Sistemi LPP/LFT	Veprimet e Rekomanduara (të listuara sipas prioritetit)
	<p>nga autoritetet e Kosovës në kohën sa më të shkurtër të mundshme përmes një përpjekje kolektive në mes të agjencive.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zyra Kombëtare për Zbatim të Krimeve Ekonomike duhet ta nisë një sistem të mbajtje së statistikave të unifikuara në mes të policisë, prokuroreve mbi rastet KPP në mënyrë që të siguroje analize të sakte të efektshmërisë së sistemit. • Rritja e personelit të njësitit për krime financiare dhe pastrim të parave e Policisë së Kosovës. • Një konsideratë duhet dhënë fuqizimit të mëtutjeshëm të Doganave përmes alokimit të burimeve shtesë dhe plotësimit të vendeve të lira të punës, si dhe fuqizimit të integritetit të personelit. • Një Nen i ri 30A nën titullin ‘Të Dhëna Statistikore’ duhet të shtohet në Ligjin LPP/LFT që kërkon mbajtjen e statistikave nga subjektet raportuese dhe autoritetet kompetente relevante. • ILECU duhet të mbajë statistika përfshirë detaje të mjaftueshme për të identifikuar veprat penale të mjaftueshme në veçanti ku pastrimi i parave/FT është pjesë, si dhe kohën e kthimit të kërkesave pa të cilën do të jete e mundur të gjykohet efektshmëria.

SHTOJCAT

Shtojca 1: Lista e shkurtesave

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPCJF	Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DRNOJQ	Departamenti për Regjistrimin dhe Ndërlidhje me OJQ
EULEX	Misioni i Sundimit të Ligjit i Bashkimit Evropian
FATF	Task Forca për Veprim Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FT	Financim i Terrorizmit
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IMF	Institucion Mikrofinanciar
KDK	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
KFOR	Prania ushtarake ndërkombëtare në Kosovë
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
KTH	Kriter(e) thelbësor(e)
KK	Kundër korrupsionit
KNF	Korporata Ndërkombëtare Financiare
KP	Kodi Penal
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPK	Korporatë me Përgjegjësi të Kufizuar
KPP	Kodi i Procedurës Penale
LFT	Luftimi i Financimit të Terrorizmit
LPP/LFT	Luftimi i Pastrimit të Parave/Luftimi i Financimit të Terrorizmit
LPPPJ	Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë për Shkeljet Penale

MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MM	Marrëveshje e mirëkuptimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NAP	Ndërmarrje Afariste Personale
NJBZNZL	Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
NNJ	Ndihma e Ndërsjellë Juridike
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PEP	Person i Ekspozuar Politikisht
PK	Partneritet i Kufizuar
PK	Policia e Kosovës
PP	Pastrimi i parave
PP	Partneritet i Përgjithshëm
PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare (paraardhësi i NJIF)
RKSOKB	Rezolutë e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara
RTD	Raport për Transaksion të Dyshimtë
RTPG	Raporti për Transaksion me Para të Gatshme
RV	Rekomandim i Veçantë i FATF
STKE	Seria e Traktateve të Këshillit të Evropës
SHA	Shoqëri Aksionare
TPV	Transaksion i Parave dhe i Vlerave
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Shtojca 2: Hollësitë për të gjitha organet me të cilat janë organizuar takime gjatë vizitës në terren

- Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF)
- Banka Qendrore e Kosovës (BQK)
- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)
- Policia e Kosovës (PK)
- Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)
- Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP)
- Zyra e Prokurorisë së Shtetit (PSh)
- Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK)
- Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)
- Gjykata Kushtetuese (GJK)
- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK)
- Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK / MTI)
- Departamenti për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ-të (DRNOJQ / MAP)
- Gjyqtarët nga gjykatat themelore dhe komunale të Prishtinës
- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)
- Dogana e Kosovës (DK)
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI)
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBEK)
- Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) - Përfaqësuesit që mbulojnë policisë, prokurorinë, gjyqësorin dhe doganat
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSBE)
- Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED)
- Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKCAK)
- Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)
- Përfaqësues të bankave tregtare (Raiffeisen, ProCredit, Banka Kombëtare Tregtare) dhe
- Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare në Kosovë (AMIK).

Shtojca 3: Lista e ligjeve kryesore, rregulloreve dhe materialit tjetër të pranuar

- Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Ligji LPP/LFT
- Ligji nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës
- Ligji nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare
- Ligji nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës
- Rregullorja e UNMIK-ut 2001/25 për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit

- Kodi i ri Penal (Ligji nr. 04/L-082 datë 20/04/2012)
- Kodi i ri i Procedurës Penale (Ligji nr. 04/L-123 datë 13/12/2012)
- Ligji nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
- Ligji nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbartimore
- Ligji nr. 04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve
- Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit
- Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Kosovës
- Ligji nr. 03/L-053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë
- Ligji nr. 03/L-117 për Avokatinë
- Ligji nr. 03/L-010 për Noterinë
- Ligji nr. 04/L-002 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-010 për Noterinë
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë
- Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës
- Ligji nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike
- Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror
- Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë
- Ligji nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar
- Ligji nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim
- Kodi Doganor dhe i Akcizave i Republikës së Kosovës nr. 03/L-109
- Ligji nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë
- Ligji nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat
- Ligji nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222
- Ligji nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare
- Ligji nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare
- Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridike për Vepra Penale
- Ligji nr. 04/L-057 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare
- Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë
- Ligji nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit
- Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare
- Ligji nr. 04/L-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale
- Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare
- Ligji nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

- Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK) - Letër Këshilluese 2007-1 maj 2007 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- AQBK – Rregulli X për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- Qendra/Njësia e Inteligjencës Financiare (QIF/NjIF) – Direktiva Administrative